

## **FJALA E AVOKATIT TË POPULLIT**

**E nderuar Zj. Kryetare e Kuvendit,  
Të nderuar përfaqësues të popullit,**

Avokati i Popullit funksionon tashmë prej 9-të vitesh si institucion për të ofruar cilësi në qeverisje. “Mirëqeverisja” dhe “të drejtat e njeriut”, për fat të keq, disa herë na rezultojnë si slogane të hedhura kuturu. Por pa u zgjatur në përsiatje filozofike, më lejoni të evokoj para jush, aspiratën tonë si popull për t’u mirëqeverisur. Si Avokat i Popullit, por edhe si qytetar, këtë aspiratë dhe vullnet mbarëkombëtar e shoh edhe në ato raste, kur disa mendje kritike bëjnë ekzorcizmin moral përmes kritikave të momenteve historike të pashfrytëzuara “siç duhet” nga baballarët e kombit tonë ndër vite. E shoh dhe ndjem krenar për këtë popull si dhe e vlerësoj klasën politike, jo për faktin se më ka dhënë besimin dhe mundësinë të punoj gjatë mandatit të dytë si Avokat i Popullit, por për faktin se klasa politike në Shqipëri ka kuptuar që stabiliteti politik, aq i nevojshëm për të ecur përpara, bazohet në mirëfunksionimin jo vetëm të institucioneve tradicionale, por dhe atyre të reja, sikurse është edhe Avokati i Popullit.

**Të nderuar deputetë,**

Nëse ju drejtohem me mesazhe mirënjohjeje të gjithëve, pavarësisht nga krahët politikë, këtë e bëj edhe për faktin tjetër, se të gjithë Ju, dikush më parë e dikush tani, në një mënyrë apo tjetër, qoftë edhe kur me ndonjë nga përfaqësuesit tuaj në qeverinë e radhës kam patur përplasje institucionale, Ju si Parlament keni ushtruar autoritetin tuaj për ta orientuar qeverisjen të jetë mendjehapur ndaj kritikave, sidomos kur ato kanë ardhur nga Avokati i Popullit. Mbi bazën e përvojës së deritanishme, ju garantoj për një gjë: Sa më korrekt dhe reagues të jete një pushtet, qoftë ky ekzekutivi, legjislativi apo gjyqësori ndaj problemeve që ngre Avokati i Popullit, aq më shumë vlerësohet imazhi i emancipimit të vetë pushtetit. Me këtë që them, nuk është se kërkoj ndonjë falënderim apo mirënjohje, pasi kam mendimin tim të kahershëm se, nëse ka vend për të tilla, ato u takojnë të qeverisurve nga qeverisësit, taksapaguesve nga taksapërfituesit e kështu me radhë.

Me syrin vetëkritik mendoj se Avokati i Popullit duhej të kishte qenë edhe më kërkues ndaj Qeverisë dhe segmenteve të caktuara të saj, të cilët e lanë procesin e regjistrimit të banesave apo të zgjedhësve në zgrip të mandatit; ndaj disa drejtuesve të policisë, të cilët me “torturë” nuk kuptojnë përkufizimin ligjor të saj sipas Konventave ndërkombëtare, por atë sipas kodeve të mesjetës; ndaj disa gjyqtarëve, të cilët mbajnë pezull jo vetëm frymën, me sytë nga politika, por edhe çështjet që zvarriten nëpër gjykata; ndaj disa prokurorëve, të cilët harrojnë se dikush pas hekurave i numëron ditët njëlloj me sekondat e orës; me disa drejtues spitalesh apo edhe mjekë, të cilët e shesin profesionin e tyre për bamirësi. Të gjitha këto i bëj për t’u solidarizuar shpirtërisht dhe institucionalisht qoftë dhe me një grua që dhunohet nga bashkëshorti, me një fëmijë që shikohet si pjesë këmbimi, me një të moshuar që ndodhet në udhëkryqin e jetës me sytë sa nga azili, aq edhe nga të afërmit e munguar.

### **Të nderuar deputetë,**

Më falni për retorikën, por të gjitha këto janë probleme që na prekin dhe i prekim përditë, qoftë si qytetarë, qoftë si zyrtarë. Të tilla probleme do t’i gjeni, si çdo vit tjetër, të pasqyruara me ftohtësinë e ligjit, edhe në këtë Raport Vjetor të radhës për vitin 2008. Do t’i gjeni, besoj, edhe në 2009-ën dhe më tej, dhe jo sepse dua unë t’i përsëris nga njëri vit në tjetrin. Kjo ndodh për arsyen e thjeshtë sepse problemet pak dhe ngadalë ndryshojnë. Ndërsa ne nuk mund të bëjmë gjë tjetër, vetëm se të ndryshojmë përgjigjet ndaj tyre përmes qasjeve të reja nëpërmjet Rekomandimeve tona.

Duke u munduar të respektoj pavarësinë dhe paanshmërinë time dhe të institucionit që drejtoj, respektoj dhe do të vazhdoj të jem shumë i vëmendshëm ndaj çdo mesazhi politik që marr nga ju të gjithë, qoftë si përfaqësues të popullit, qoftë si liderë të partive politike.

Unë dhe bashkëpunëtorët e mi jemi pjesë e përgjegjësive tuaj dhe si të tillë mirëpresim çdo kritikë dhe nxitje për të vazhduar më tej punën tonë në mbrojtje të të drejtave të qytetarëve shqiptarë dhe për të kërkuar më fort rritjen e cilësisë qeverisëse në Republikën e Shqipërisë.

Me respekt,  
**Ermir DOBJANI**

**AVOKATI I POPULLIT**

**Tirane, me 02.03.2009**

## PERMBAJTJA

	<b>Faqe</b>
Fjala e Avokatit të Popullit	1
Përmbajtja	3
Avokati i Popullit dhe parimet mbi te cilat ai funksionon.	6
Prezantim i shkurtër i Raportit	8
<b>KREU I PARE</b>	
1. Struktura, organika dhe cilësitë e personelit të zyrës së Avokatit të Popullit.	11
2. Buxheti i institucionit për vitin 2008.	15
3. Bashkëpunimi dhe mbështetja ndërkombëtare për Institucionin e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2008.	16
4. Sfidat dhe objektivat e institucionit për vitin 2009 e në vazhdim	22
<b>KREU I DYTE</b>	
1. Statistika përmbledhëse e vitit 2008.	25
2. Opinione të përgjithshme për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri.	29
3. Marrëdhëniet me Kuvendin e Shqipërisë.	38
4. Raportet e Veçanta të Institucionit të Avokatit të Popullit, drejtuar Kuvendit.	44
5. Kontributi i Avokatit të Popullit për ngritjen e institucioneve të reja të krijuara në fushën e të drejtave të njeriut gjatë viteve 2006-2008.	49
6. Marrëdhëniet e Avokatit të Popullit me publikun dhe median.	71
a. Sektori i Pritjes së Popullit	73
b. Ditët e hapura – përvojë për t’u vazhduar	77
7. Konferenca Kombëtare “Në mbrojtje të së drejtës së konsumatorit”.	78
8. Bashkëpunimi me Organizatat Joqeveritare dhe aktivitete të tjera të Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2008.	87

## KREU I TRETE

Veprimtaria konkrete e Avokatit të Popullit për ankesat, kërkesat dhe njoftimet, të grupuara sipas institucioneve qeveritare

1.	Këshilli i Ministrave (Qeveria).	90
2.	Ministria e Drejtësisë	94
	a. Sistemi i burgjeve dhe paraburgimeve	94
	b. Zyrat e Përmbarimit	110
	c. Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	118
	ç. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish Pronarëve	122
3.	Ankesat për pushtetin gjyqësor dhe administratën gjyqësore. Kontributi i Avokatit të Popullit për Reformën në Drejtësi.	124
4.	Ankesat për Prokurorinë.	138
5.	Ministria e Brendshme.	154
6.	Ministria e Mbrojtjes.	188
7.	Ministria e Financave.	194
8.	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve.	207
9.	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.	215
10.	Ministria e Shëndetësisë.	219
11.	Ministria e Arsimit dhe e Shkencës	228
12.	Ministria e Punëve të Jashtme.	231
13.	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	235
14.	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.	241
15.	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.	243
16.	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	246
17.	Veprimtaria e Nën Seksionit të të Drejtave të Fëmijëve. Nevoja e ngritjes së Ombudsmanit të Fëmijëve.	251 257
18.	Veprimtaria e Njesisë për Parandalimin e Torturës dhe çdo Trajtimi Çnjerëzor dhe Degradues.	261
19.	Veprimtaria e Avokatit të Popullit pas tragjedisë së Gërdecit	268

## **KREU I KATERT**

1. E drejta e Avokatit të Popullit për rekomandime legislative. 278
  - Pasqyra Nr.1. Evidenca e rekomandimeve për plotësime apo ndryshime të ligjeve të Kuvendit të Shqipërisë për periudhën 2000-2008. 280
  - Pasqyra Nr.2. Evidenca e rekomandimeve për nxjerrje, ndryshime apo plotësime në aktet nënligjore të Këshillit të Ministrave për periudhën 2000-2008. 297
  - Pasqyra Nr.3. Evidenca e rekomandimeve për nxjerrje, ndryshime apo plotësime për aktet nënligjore të ministrave dhe drejtuesve të institucioneve të tjera qendrore për periudhën 2000-2008. 309
2. Çështje të filluara me iniciativën e Avokatit të Popullit (“ex officio”) 321

## **ANEKSE**

1. Letra falënderimi nga qytetarët dhe shoqata të ndryshme. 322
2. Tabela dhe grafikët 326

## **Avokati i Popullit dhe Parimet mbi të cilat ai Funkcionon**

Avokati i Popullit përfaqëson një mekanizëm shtetëror, ekstragjyqësor për hetimin e pavarur të ankesave apo kërkesave të qytetarëve ndaj sjelljes, vendimeve, veprimeve apo mosveprimeve të parregullta e të paligjshme të administratës publike. Parimet dhe tiparet thelbësore të Zyrës janë pavarësia, fleksibiliteti, paanshmëria, besueshmëria dhe transparenca ndaj publikut.

Pavarësia gjen shprehje si në bazueshmërinë e saj në Kushtetutën e shqiptare dhe Ligjin “Për Avokatin e Popullit”, ashtu edhe në diskrecionin që Avokati i Popullit ka në përzgjedhjen e një pjese të stafit të tij, sikundër, dhe më e rëndësishmja, në raportet që Avokati i Popullit ndërton me Qeverinë dhe Kuvendin. Pavarësisht se është një organ i dalë nga Parlamenti, Avokati i Popullit, në veprimtarinë e tij, nuk mund dhe nuk duhet të pranojë ndërhyrje që do të diktonin politikën e tij institucionale.

Fleksibiliteti shprehet në rrugët dhe format që Avokati i Popullit ndjek për t’ju afruar shërbimin dhe rivendosur të drejtën e pretenduar ose të shkelur të qytetarit. Ky parim vlen edhe për komunikimin zyrtar të Avokatit të Popullit me përfaqësuesit e administratës publike. Madje edhe zgjidhja që synon të arrijë Avokati i Popullit në favor të qytetarit, nuk kushtëzohet patjetër nga afatet ligjore të apelimit të shkeljes. Sikundër edhe qëllimi i Avokatit të Popullit nuk është penalizimi i zyrtarit, por ndërgjegjësimi i tij për t’u shërbyer qytetarëve sipas ligjit.

Paanshmëria dhe objektiviteti janë parime të rëndësishme, ku bazohet i gjithë veprimi i Avokatit të Popullit për të hetuar ankesa të veçanta, parime ku bazohet edhe funksioni i tij ndërmjetësues, gjithmonë si mekanizëm i kontrollit dhe balancës së pushteteve. Ky parim siguron më pas edhe besueshmërinë e Avokatit të Popullit, si palë që shikon të dyja anët e medaljes, për të siguruar jo vetëm zgjidhje të drejta, por mbi të gjitha ligjore.

Transparenca është një parim, pa të cilin Avokati i Popullit nuk do të kishte mundur të kryente misionin e tij. Aleanca e natyrshme me median e bën më të nevojshëm zbatimin e këtij parimi, pasi, përmes transparencës, Avokati i Popullit arrin të informojë, ndërgjegjësojë apo deri edhe të demaskojë sjelljen abuzive të zyrtarit publik në dëm të të drejtave të qytetarëve. Transparenca është mjeti më i mirë, përmes të cilit

Avokati i Popullit siguron integritetin e tij personal dhe institucional, sikundër edhe përgjegjshmërinë e tij para publikut.

Funksioni dhe misioni i Avokatit të Popullit është të shqyrtojë çështjet që lindin si pasojë e keqadministrimit në administratën publike. Instrumenti i përditshëm, përmes të cilit Avokati i Popullit synon të arrijë rezultatin e tij është rekomandimi. Pas shqyrtimit dhe hetimit të çështjeve të ndryshme, Avokati i Popullit realizon ndërmjetësimin dhe, nëpërmjet rekomandimeve të tij synon t'i zgjidhë problemet mbi baza ligjore. Zgjidhjet e arritura nga ai synojnë të sjellin përmirësime në standardet dhe cilësinë e shërbimeve të administratës publike ndaj qytetarëve.

Por ç'është keqadministrimi? Me "keqadministrim" kuptojmë sjelljen, pra veprimet apo mosveprimet e zyrtarit në kundërshtim me Kushtetutën, me ligjet në fuqi dhe me normat e gjithëpranuara morale në shtetin tonë. Duke goditur këtë dukuri, Avokati i Popullit promovon mirëqeverisjen dhe ndershmërinë në administratën publike.

Qëndrimi që administrata mban ndaj rekomandimeve të Avokatit të Popullit është tregues i përgjegjshmërisë së saj ndaj shkeljeve që kryen si edhe i faktit se sa e gatshme është ajo për t'i riparuar ato.

Raporti Vjetor i Avokatit të Popullit është instrumenti më i rëndësishëm i Avokatit të Popullit, përmes të cilit ai informon Parlamentin çdo vit, në mënyrë që ky i fundit të realizojë funksionin e tij si kontrollues i Qeverisë. Edhe këtë vit, teksa përpiqemi të paraqesim para Kuvendit një pasqyrë analitike ndaj ankesave të popullit në vend, synimi ynë është ndikimi për realizimin e standardeve të larta në mirëqeverisje. Fokusi i punës së Avokatit të Popullit ka qenë dhe është praktika e përditshme e marrëdhënieve individ-shtet dhe niveli i mirëqeverisjes si e drejtë e njeriut.

Në rastet e paraqitura në këtë Raport, jemi munduar të pasqyrojmë punën tonë, sikundër edhe të vëmë gishtin mbi dukuritë abuzive që shfaqin përfaqësuesit e administratës publike, në nivel qendror dhe vendor. Përtej kësaj, Avokati i Popullit synon të qartësojë rrugët që duhen ndjekur për të krijuar kulturën e shërbimit cilësor dhe të ndershëm ndaj qytetarëve.

Avokati i Popullit ka punuar me administrata qendrore dhe vendore të ndryshme për nga orientimi politik. Ne jemi përpjekur të dëshmojmë se Avokati i Popullit, duke ofruar oponencë për mirëqeverisje, nuk punon të bëjë Opozitën ndaj Qeverisë. Kjo ka qenë, është dhe do të jetë filozofia e funksionimit të tij, e zhveshur nga çdo anësi politike. Nëse do të ishim orientuar drejt konfliktualitetit ose, në të kundërt, drejt kompromisit politik me pushtetmbajtësit e radhës, parimet themelore, mbi të cilat ne mbështetemi, do të komprometoheshin rëndë dhe institucioni do të dështonte, si në sytë e opinionit publik shqiptar, ashtu edhe të organizmave ndërkombëtare që na monitorojnë nga afër.

## PREZANTIM I SHKURTER I RAPORTIT

Raporti Vjetor është publikimi më i rëndësishëm i Institucionit të Avokatit të Popullit, nëpërmjet të cilit bëhet e mundur njohja e anëtarëve të Kuvendit me punën e Avokatit të Popullit gjatë vitit për të cilin ai bën raportimin dhe në të njëjtën kohë, ndihmohet administrata publike dhe agjencitë e ndryshme që ofrojnë shërbime për publikun të përmirësojnë administrimin e tyre. Raporti Vjetor e bën punën e Avokatit të Popullit të aksesueshme edhe nga publiku që është i interesuar të ndjekë aktivitetin e tij, duke përfshirë këtu publikun e gjerë, mediat, nëpunësit civil etj. Në këtë raportim, ndryshe nga raportimet e mëparshme, kemi prezantuar më shumë analiza të veprimtarisë së Institucionit dhe nuk kemi bërë thjesht një listim të aktiviteteve të tij. Raporti Vjetor përmban refleksionet tona për çështjet më të rëndësishme të prezantuara gjatë vitit si dhe identifikon problemet të cilat kanë nevojë për përmirësime në të ardhmen.

Një vend të veçantë në këtë raport i kemi kushtuar veprimtarisë së Institucionit të Avokatit të Popullit në kuadër të Mekanizimit Kombëtar për Parandalimin e Torturës dhe çdo Dënimi tjetër Çnjerëzor dhe Degradues. Kjo strukturë është ngritur në zbatim të “Protokollit Opsional të Konventës kundër Torturës dhe çdo Dënimi tjetër Çnjerëzor dhe Degradues” (OPCAT) ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me anë të Ligjit Nr.9094 dt.03.07.2007, dhe ka filluar veprimtarinë në Qershor 2008.

Po kështu, duke marrë shkas nga tragjedia që ndodhi në 15 Mars 2008 në fshatin Gërdec, Institucioni i Avokatit të Popullit, në ushtrim të kompetencave të njohura me ligj, ndërmori një hetim për identifikimin dhe kontrollin e të gjitha objekteve dhe veprimtarive që përbëjnë “burim të rrezikut të shtuar” për jetën e individëve. Edhe gjatë vitit 2009 po vazhdojmë me trajtimin e konkluzioneve paraprake që kemi nxjerrë nga ky hetim. Por në këtë raport, do të prezantojmë disa nga rekomandimet që kemi bërë me këtë rast deri në fund të vitit 2008 drejtuar strukturave përkatëse përgjegjëse për kontrollin e këtyre veprimtarive.

Raporti i nëntë vjetor i Avokatit të Popullit që paraqet veprimtarinë e tij gjatë vitit 2008 është i ndarë në katër krerë dhe dy anekse dhe fillon me fjalën e veçantë të Avokatit të Popullit.

Kreu i parë ndër të tjera shpjegon shkurtimisht funksionimin e Institucionit dhe në veçanti objektivat e tij për të ardhmen. Gjithashtu i kushton vëmendje bashkëpunimit të Institucionit tonë me zyrat homologe



dhe detajon pjesëmarrjen aktive të Institucionit të Avokatit të Popullit në aktivitete të ndryshme ndërkombëtare.

Kreu i dytë ka të bëjë me aktivitete të informimit dhe komunikimit të Institucionit të Avokatit të Popullit në radhë të parë me Kuvendin e Shqipërisë. Ky kre është ndarë në 8 seksione ku një vend të veçantë zënë opinionet për situatën e të drejtave të njeriut si dhe për mirëqeverisjen në Shqipëri. Një seksion i veçantë i është kushtuar organizimit të “ditëve të hapura” dhe bashkëpunimit me mediat, nëpërmjet të cilave kemi siguruar aksesin e nevojshëm në publik. Në vazhdim, kemi prezantuar krijimin gjatë viteve 2006-2008 të disa Institucioneve të reja, në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut si dhe kontributin e Avokatit të Popullit për to. Po ashtu, shkurtimisht kemi bërë një përshkrim të tre Raporteve të Veçanta që Avokati i Popullit, i ka drejtuar Kuvendit të Shqipërisë për tre probleme që i gjykojmë të rëndësishme.

Kreu i tretë, i cili zë dhe pjesën më të madhe në raport, ka të bëjë me ankesat, kërkesat dhe njoftimet e trajtuara nga Avokati i Popullit, të ndara sipas ministrive përkatëse dhe organeve të tjera të administratës publike, hetimet e kryera për disa raste si dhe rezultatet. Këtu kemi prezantuar dhe zgjidhjet e rasteve tipike dhe të përsëritura, të cilat mendojmë se duhet të shërbejnë si udhërrëfyes për veprimet e organeve përgjegjëse të administratës në situata të ngjashme. Ky kre gjithashtu përmban rekomandime dhe propozime për eliminimin e shkeljeve dhe padrejtësive, të cilat janë identifikuar gjatë shqyrtimit të ankesave të paraqitura tek Avokati i Popullit. Në një seksion të veçantë kemi prezantuar veprimtarinë e nënseksionit për fëmijët për vitin 2008, veprimtarinë e Njësisë për Parandalimin e Torturës dhe çdo Dënimi tjetër Çnjerëzor dhe Degradues si dhe disa nga rekomandimet më të spikatura që Avokati i Popullit i ka bërë organeve të Administratës Publike, pas tragjedisë së Gërdecit.

Kreu i katërt paraqet veprimtarinë shumë të rëndësishme të Avokatit të Popullit, të realizuar nëpërmjet rekomandimeve për nxjerrjen, ndryshimin apo plotësimin e ligjeve apo akteve nënligjore, në rastet kur është përmbajtja e këtyre dhe jo zbatimi ose moszbatimi i tyre shkak që krijon premisa apo kushte për shkelje të të drejtave të njeriut apo keq qeverisje. Për shkak të kësaj rëndësie, në tre tabelat përkatëse kjo veprimtari paraqitet për të 9 vitet e ekzistencës së Avokatit të Popullit në Shqipëri. Gjithashtu në këtë kre prezantohen edhe çështjet e filluara me iniciativë nga Avokati i Popullit.

Në aneksin 1 kemi paraqitur disa nga letrat e falënderimit të qytetarëve dhe shoqatave të ndryshme drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit.

Aneksi 2 prezanton në mënyrë grafike statistikën kryesore të punës së Institucionit.

Analizat e bëra në këtë raport synojnë të hedhin dritë mbi problematikën e përgjithshme të situatës në vend, me prirjen për t'u orientuar drejt praktikave më të mira që ofron legjislacioni ndërkombëtar, jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të Strasburgut dhe veprimtaria e zyrave homologe në botë. Avokati i Popullit është i ndërgjegjshëm se sfidat e integritit, edhe për këtë institucion, vijnë gjithmonë e në rritje, ashtu si edhe vetë sfidat e integritit të Shqipërisë. Në këtë kuptim, kemi deklaruar gjithmonë se Avokati i Popullit synon që t'u përshtatet sfidave të qeverisjes, madje të ndihmojë në rritjen e cilësisë vetëqeverisëse të klasës politike në vend.

## KREU I PARE

### 1. Struktura, organika dhe cilësitë e personelit të zyrës së Avokatit të Popullit

Ligji nr.8600, datë 10.04.2000 “Për disa ndryshime në ligjin 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i jep Avokatit të Popullit të drejtën e përcaktimit të strukturës dhe organikës (numrit të personelit) të tij. Kurse pagat janë caktuar me vendim të veçantë të Qeverisë Nr.500, dt. 18.07.2003 “Për miratimin e strukturës së pagave të punonjësve të Avokatit të Popullit”.

Zyra e Avokatit të Popullit funksionon me tre seksione të specializuara, siç i ka përcaktuar neni 31 i ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar me ligjin nr.9398 dt.12.05.2005.

**Seksioni i parë** merret me ankesat dhe kërkesat për organet e administratës qendrore, pushtetit vendor dhe të tretëve që veprojnë për llogari të tyre dhe drejtohet nga zj. Florina Nuni.

**Seksioni i dytë** merret me ankesat dhe kërkesat për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura, prokurorinë e pushtetin gjyqësor dhe drejtohet nga z. Skënder Haluci.

**Seksioni i tretë** ose seksioni i përgjithshëm, drejtohet nga z.Riza Poda dhe trajton çështjet jashtë fushave të mësipërme, ndjek bashkëpunimin me organizatat joqeveritare dhe kryen studime në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Që nga janari 2008, institucioni i Avokatit të Popullit, luan dhe rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës dhe çdo trajtimi tjetër çnjerëzor. Me miratimin e buxhetit për vitin 2008 u miratua dhe kërkesa për 5 vende të reja pune. Pastaj u bë dhe ndryshimi në strukturën e Institucionit të Avokatit të Popullit, duke përcaktuar një Njësi të veçantë, e cila është në varësi direkte të Avokatit të Popullit, dhe quhet Njësia për Parandalimin e Torturës dhe drejtohet nga z. Ervin Karamuço.

Hallkë e rëndësishme e strukturës së institucionit është edhe Kabineti, në përbërje të të cilit janë Drejtori i Kabinetit dhe këshilltarët, të cilët janë në vartësi direkte nga Avokati i Popullit.

Sektorët mbështetës që ndihmojnë në realizimin e detyrave kryesore të Institucionit janë Drejtoria e Informacionit, Marrëdhëniet me Publikun dhe me Jashtë si dhe Drejtoria e Personelit dhe Administratës, të cilat janë në varësi direkte të Sekretarit të Përgjithshëm.

Pjesë të rëndësishme të këtyre drejtorive, janë Sektori i Informacionit e Pritjes së Popullit dhe Sektori i Financës. Kjo strukturë, e cila është përcaktuar nga Avokati i Popullit, ka rezultuar e efetshme, në përputhje me prioritetet e vendosura për vitin 2008.


Kuvendi në ligjin “Për Buxhetin e Shtetit për vitin 2008” ka miratuar 50 punonjës dhe po kaq kanë qenë të punësuar. Nga këta janë 18 juristë që quhen ndihmëskomisionerë, të cilët merren direkt me zgjidhjen e ankesave. Juristë janë edhe Sekretari i Përgjithshëm, Drejtori i Kabinetit, 2 këshilltarë, 3 komisionerët, drejtuesi i Njësisë dhe vetë Avokati i Popullit.

Një element i rëndësishëm lidhur me strategjinë e Avokatit të Popullit është dhe rritja e vazhdueshme e kapaciteteve të institucionit. Pjesëmarrja në trajnimet e ndryshme e ndihmëskomisionerëve brenda dhe jashtë vendit dhe e punonjësve të tjerë të Administratës, ka ndihmuar në ngritjen e tyre profesionale, gjë kjo që vërtetohet edhe me pajisjen e tyre me çertifikatat e marra nga Instituti i Trajnimit të Departamentit të Administratës Publike.

Titullin Master e kanë fituar 6 anëtarë të stafit, kurse 3 të tjerë janë në proces të fitimit të këtij titulli. Kurse 5 juristë të tjerë aktivizohen për mësimdhënie si pedagogë të jashtëm në Fakultetet e Drejtësisë dhe në Shkollën e Magjistraturës.

Pjesa më e madhe e specialistëve të Zyrës së Avokatit të Popullit zotërojnë dhe përdorin mirë një ose më shumë gjuhë të huaja, kryesisht anglisht, frëngjisht, italisht, rusisht, gjermanisht, etj.

**STRUKTURA E INSTITUCIONIT TE AVOKATIT TE POPULLIT**



**Pasqyra nr.2**

**ORGANIKA E INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT**

Nr.	EMËRTIMI	NËPUNËS
<b>I.</b>	<b>AVOKATI I POPULLIT</b>	<b>(1)</b>
<b>II.</b>	<b>KABINETI</b> Shefi i Kabinetit + Zëdhënës i Avokatit të Popullit Këshilltarë të Avokatit të Popullit Sekretare e Avokatit të Popullit	<b>(5)</b> 1 3 1
<b>III.</b>	<b>SEKSIONI I ORGANEVE TË ADMINISTRATËS QENDRORE DHE VENDORE</b> Komisioner Ndihmëskomisionerë (jurist) Sekretare + Rregjistruese	<b>(7)</b> 1 5 1
<b>IV.</b>	<b>SEKSIONI I SHËRBIMEVE TË VEÇANTA</b> Komisioner Ndihmëskomisionerë (jurist) Sekretare + rregjistruese	<b>(7)</b> 1 5 1
<b>V.</b>	<b>SEKSIONI I PËRGJITHSHËM</b> Komisioner Ndihmëskomisionerë (jurist) Nënsëksioni për Fëmijët (Ndihmëskomisioner) Sekretare + rregjistruese	<b>(7)</b> 1 4 1 1
<b>VI.</b>	<b>MEKANIZMI PER PARANDALIMIN E TORTURES</b> Drejtues (Ndihmëskomisioner) Ndihmëskomisionerë (Juristë)	<b>(5)</b> 1 4
<b>VII.</b>	<b>SEKRETARI I PËRGJITHSHËM</b>	<b>(1)</b>
<b>VIII.</b>	<b>DREJTORIA E INFORMACIONIT, MARREDHENIEVE ME PUBLIKUN DHE ME JASHTË</b> Drejtore Shef Sektori Specialist Arkivist+Sekretare e Sekretarit të Përgjithshëm	<b>(5)</b> 1 2 1 1
<b>IX.</b>	<b>DREJTORIA E PERSONELIT, ADMINISTRATËS DHE FINANCES</b> Drejtore Shef Sektori Specialist Shofer Punëtore Teknik Mirëmbajtës	<b>(12)</b> 1 2 1 5 2 1

Punonjës gjithsej të Institucionit të Avokatit të Popullit janë 50 veta.

## 2. Buxheti i Institucionit për vitin 2008

Për të funksionuar me efikasitet një institucion për të drejtat e njeriut siç është Avokati i Popullit, kërkohet jo vetëm mbështetje politike, institucionale, potenciale njerëzore, por dhe mbështetje financiare.

Në këtë vështrim ne mendojmë se një konceptim i drejtë ka ekzistuar nga Kuvendi dhe Qeveria Shqiptare. Për vitin 2008 Institucionit të Avokatit të Popullit i është dhënë një buxhet në shumën 93.418.000 leke, i cili për periudhën objekt raportimi është konsumuar në masën 94% e konkretisht:

Nr. Llog.	Emërtimi	Plan lekë	Realizim lekë	Realiz. %
600	Pagat	56.520.000	51.297.493	90.7%
601	Sigurim shoqëror	6.998.000	6.998.000	100%
602	Shp operative	17.790.000	17.789.044	100 %
605	Kuote anëtarësie	300.000	144.698	48 %
604	Transfertë	210.000	210.000	100%
231	Investime (Rikonstruksion)	9.400.000	9.360.409	100%
231	Pajisje zyre	2.200.000	2.179.087	99%
	<b>Totali</b>	<b>93.418.000</b>	<b>87.978.731</b>	<b>94%</b>

Buxheti është përdorur për paga punonjësish, blerje kancelarie, riparime automjesh, blerje karburanti, parkim automjesh, shpenzime për energji elektrike, shpenzime telefoni, shpenzime poste, shërbim telegrafik, abonime gazetash, sigurime automjesh, shërbim interneti etj. Nuk është përdorur tërësisht fondi i pagave për arsye se stafi i Njësisë Kundër Torturës filloi punën në 6-mujorin e dytë të vitit 2008.

Ne vitin 2007 u krye rikonstruksioni i zyrave të institucionit të Avokatit të Popullit. Ndërsa në vitin 2008 u krye rikonstruksioni i rrugës kryesore nëpërmjet Ministrisë së Jashtme me anë të të cilës realizohet hyrja në institucion. Ambientet e rinovuara tashmë paraqesin një institucion bashkëkohor, mjaft të përshtatshëm për punë dhe mikpritës për çdo qytetar që paraqitet pranë nesh për të kërkuar ndihmën e Avokatit të Popullit.

Në lidhje me kuotat e anëtarësisë ne bëjmë pagesën në Institutin Europian të Ombudsmanëve, Institutin Ndërkombëtar të Ombudsmanëve, Shoqatën e Ombudsmanëve Frankofonë, Shoqatën e Ombudsmanëve në Amerikë (TOA), Shoqatën e Ombudsmanëve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (USOA).

### 3. Bashkëpunimi dhe mbështetja ndërkombëtare për Institucionin e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2008

Marrëdhëniet e Institucionit të Avokatit të Popullit me Jashtë janë bazuar kryesisht në tre drejtime. Së pari, në shkëmbimin on-line të informacioneve mbi zhvillimet në forumet ndërkombëtare të familjes së Ombudsmanit dhe të Institucioneve Kombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (marrëdhënie shumëpalëshe). Së dyti, në shkëmbimin e vizitave njohëse dhe trajnimeve me zyrat homologe (marrëdhënie dypalëshe). Së treti, në pjesëmarrjen në konferenca, seminare, tavolina të rrumbullakta etj. ku diskutohet për të drejtat e njeriut dhe veprimtarinë e Ombudsmanëve apo institucioneve kombëtare të kësaj natyre.

Veprimtaritë e Avokatit të Popullit në këto drejtime kanë konsistuar në prezantimin e arritjeve të institucionit tonë, sikurse dhe të përpjekjeve që bën Shteti Shqiptar për të përmbushur standartet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, një që nga të cilat është ngritja dhe konsolidimi i institucionit të Avokatit të Popullit apo si quhet kryesisht në gjuhën ndërkombëtare Ombudsmani Parlamentar.

Një drejtim tjetër i marrëdhënieve me faktorin ndërkombëtar, është edhe bashkëpunimi me organizmat vepruese në Shqipëri, interesimi i të cilave për shtetin ligjor dhe të drejtat e njeriut është tejet i artikuluar. Kështu, mund të përmendim bashkëpunimin e vazhdueshëm me Departamentin Amerikan të Shtetit, përmes Ambasadës Amerikane në Tiranë, për përditësimin e Raportit Vjetor të këtij Departamenti për të Drejtat e Njeriut. Falë besueshmërisë së shfaqur në veprimtarinë e Avokatit të Popullit, Ambasada Amerikane në Tiranë vazhdon ta konsiderojë Avokatin e Popullit si partner dhe një ndër filtrat informativ, të vlefshëm për referim në rastet e shumë trajnimeve që kjo Ambasadë ofron për nëpunësit dhe autoritetet publike shqiptare, duke afishuar me këtë rast si standart sjelljen dhe figurën e tyre përsa i përket rekordit të shkeljeve të mundshme të të drejtave të njeriut. I tillë është edhe bashkëpunimi me Zyrën e OSBE-së në Tiranë për probleme të ndryshme që lidhen me respektimin e të drejtave të njeriut dhe standartet e shtetit ligjor.

Institucioni i Ombudsmanit, forcohet më shumë dhe zhvillohet më tej edhe përmes bashkëpunimit me zyrat homologe si dhe pjesëmarrjes aktive në forumet ndërkombëtare, cilësuar joformalisht si Familja Ndërkombëtare e Ombudsmanit.

Avokati i Popullit është anëtar me të drejta të plota i Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanit (IOI), i Ombudsmanit European (EOI), Shoqatës së Ombudsmanit dhe Mediatorit Frankofon (AOMF), Shoqatës së Ombudsmanit të Shteteve të Bashkuara (USOA), Shoqatës Ndërkombëtare të Ombudsmanit (IOA). Të drejtat dhe detyrimet që



rrjedhin nga anëtarësia, Avokati i Popullit i realizon përmes pjesëmarrjes në aktivitete si brenda, ashtu edhe jashtë vendit.

Vlen për t'u përmendur vendimi përfundimtar i Byrosë së Komitetit Koordinues Ndërkombëtar të Institucioneve Kombëtare për Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, bazuar mbi propozimin e Sekretariatit të këtij Komiteti, në Nëntor 2008. Ky Sekretariat pasi shqyrtoi me imtësi materialet e dërguara nga ana e Zyrës së Avokatit të Popullit, por edhe pasi bëri verifikimet e rastit sipas procedurave të tyre, e gjeti Institucionin tonë të bazuar plotësisht mbi parimet e Parisit. Mbi këtë bazë u bë edhe propozimi që Institucionit të Avokatit të Popullit të Shqipërisë t'i rrijepej statusi A, tashmë pa rezerva, çka do të thotë një imazh më autoritar për në strukturat ndërkombëtare.

## **I. Aktivitete të organizuara nga Këshilli i Evropës:**

Që në fillim të mandatit të tij, si Komisioner për të Drejtat e Njeriut pranë Këshillit të Evropës, z. Thomas Hammarberg e ka konsideruar Avokatin e Popullit, si partner kryesor në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Shqipëri. Për këtë arsye, Zyra e Komisionerit dhe Avokati i Popullit zhvillojnë një proces bashkëpunimi të vazhdueshëm, bazuar në shkëmbimin e informacioneve për praktikën e mira qeverisëse, në mënyrë që t'i shërbehet më mirë veprimeve të përbashkëta, tashmë në nivel evropian.

Në Prill 2007, Zyra e Komisionerit organizoi një Tryezë të Rrumbullakët në Athinë me krerët e institucioneve kombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ku u vendos që bashkëpunimi të kanalizohet përmes personave të kontaktit, të cilët do të realizonin bashkëpunimin konkret. Bashkë me këta të fundit, Zyra e Komisionerit ka hartuar edhe programin e punës, mbi bazën e nevojave dhe problemeve specifike të çdo zyre kombëtare që është përfshirë në këtë projekt partneriteti, të titulluar "Peer to Peer" ose "Partneri për Partnerin". Ideja e Projektit është krijimi i një rrjeti aktiv midis Zyrës së Komisionerit për të Drejtat e Njeriut dhe institucioneve përkatëse të vendeve anëtare të Këshillit të Evropës.

1. Gjatë vitit 2008, në kuadër të këtij Projekti, Zyra e Avokatit të Popullit ka marrë pjesë në aktivitetin bashkë financiar nga Këshilli i Europës dhe Bashkimi Evropian dhe bashkë-organizuar nga Zyra e Komisionerit për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës dhe Qendra për të Drejtat e Njeriut e Universitetit të Padovës, me qëllimin e ngritjes së një rrjeti aktiv të strukturave të pavarura jogjyqësore për të drejtat e njeriut. Dy përfaqësues të Avokatit të Popullit morën pjesë në Seminarin e Parë me temë "Të drejtat e personave të privuar nga liria: Roli i

strukturave kombëtare për të drejtat e njeriut që janë ose jo pjesë e mekanizmave të OPCAT-it”, që u zhvillua në Padova të Italisë më 9-10 prill 2008.

2. Po ashtu, në kuadrin e Projektit “Peer-to-Peer”, bashkë financuar nga Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian dhe organizuar në bashkëpunim me Qendrën e Strategjisë Humanitare dhe të Shkencave Politike të St. Petersburg, dy përfaqësues të Avokatit të Popullit morën pjesë në Seminarin e Dytë me temë “Trajtimi nga strukturat e të Drejtave të Njeriut të ankesave ndaj forcave të policisë”, që u zhvillua në St. Petersburg, Federata Ruse, më 20-21 maj 2008.

3. Më 18-10 qershor 2008, një përfaqësues i Avokatit të Popullit mori pjesë në Seminarin e Tretë në kuadrin e Projektit “Peer-to-Peer”, organizuar në Padova të Italisë, me temë “Mbrojtja nga strukturat e të drejtave të njeriut e migracionit të parregullt”.

4. Edhe në Seminarin e Katërt në kuadrin e Projektit “Peer-to-Peer”, zhvilluar përsëri në Padova të Italisë, më 21-23 tetor 2008, me temë “Promovimi dhe mbrojtja nga strukturat e të drejtave të njeriut e lirisë së shprehjes dhe informacionit” pati pjesëmarrje të një përfaqësuesi të Avokatit të Popullit.

5. Më 19-20 nëntor 2008, në kuadër të Projektit “Peer -to-Peer” dhe me organizim të Zyrës së Komisionerit për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës, Drejtori i Kabinetit të Avokatit të Popullit mori pjesë në Konferencën Vjetore të Personave të Kontaktit si dhe në Mbledhjen e Komitetit Drejtues që u zhvilluan në ambientet e Këshillit të Evropës në Strasburg, Francë.

6. Dy përfaqësues të Avokatit të Popullit morën pjesë në Seminarin e Pestë dhe të fundit për vitin 2008 të Projektit “Peer-to-Peer”, që u zhvillua në Budapest, Hungari më 2-3 dhjetor 2008, me temë “Roli i strukturave kombëtare për të drejtat e njeriut në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar”.

## **II. Konferenca të tjera ndërkombëtare:**

1. Në kuadër të Komponentit për Mbrojtjen e Konsumatorit, dy përfaqësues të Avokatit të Popullit morën pjesë në takimin Rajonal të Grupit të Dytë të Punës për “Acquis-en e konsumatorit” që u zhvillua në Zagreb, Kroaci më 3-6 shkurt 2008, me financim të Fondit të Hapur Rajonal për Reformën Ligjore (GTZ-ORF). Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të Institucioneve shtetërore dhe OJF që veprojnë në këtë fushë në rajon dhe u bënë prezantime për përafrimin dhe përputhshmërinë e legjislacionit vendas me atë komunitar.

2. Me ftesë të Komisioneres Parlamentare për të Drejtat e Njeriut të Ukrainës, Avokati i Popullit mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare

me temë “Sfidat bashkohore të të drejtave dhe lirive të njeriut”, dedikuar 60-Vjetorit të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut si dhe 10-Vjetorit të krijimit të Institucionit të Ombudsmanit për të Drejtat e Njeriut të Ukrainës që u zhvillua në Kiev, më 12-14 prill 2008.

3. Me ftesë të Komisionerit për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut të Polonisë, një përfaqësues i Avokatit të Popullit mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare me rastin e 20 Vjetorit të krijimit të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në Poloni që u zhvillua në Varshavë, më 15 maj 2008.

4. Më 12 qershor 2008, një përfaqësues i Avokatit të Popullit mori pjesë në Takimin e Dytë të Punës së Rrjetit të Ombudsmanëve për të Drejtat e Fëmijëve, ë u zhvillua në Novi Sad, Vojvodinë, Serbi.

5. Një përfaqësues i Avokatit të Popullit mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare “Të drejtat e njeriut në një botë të globalizuar”, me rastin e 60 Vjetorit të Deklaratës për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara si dhe Ditës së parë Kombëtare të Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut në Azerbaixhan, organizuar në Baku, Azerbaixhan, më 18-19 qershor 2008, nën kujdesin e Komisionerit për të Drejtat e Njeriut të Republikës së Azerbaixhanit.

6. Me ftesë të Qendrës Ndërkombëtare për Tranzitimet Demokratike (ICDT), Avokati i Popullit mori pjesë në konferencën me temë: “Funksionimi i Ombudsmanit në Demokracitë e Brishta” që u zhvillua në Budapest, më 27 qershor 2008.

7. Më 10 shtator 2008, Avokati i Popullit mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare me temë: “Të drejtat e njeriut dhe të drejtat e minoriteteve në Evropë” që u zhvillua në Shkup, Maqedoni, nën kujdesin e Fondacionit Konrad Adenauer.

8. Me ftesë të Ministrisë së Integritimit dhe Barazisë Gjinore të Suedisë, një përfaqësues i Avokatit të Popullit, mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare mbi Punën Sistematike për Zbatimin e të Drejtave të Njeriut, që u zhvillua në Stokholm, Suedi, më 6-7 nëntor 2008.

9. Avokati i Popullit mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare “Pavarësia dhe Integriteti i Institucionit të Ombudsmanit” që u zhvillua në Novi Sad, Vojvodine më 6-7 nëntor 2008, nën kujdesin e Institucionit të Ombudsmanit të Provincës Autonome të Vojvodinës.

10. Një përfaqësues i Avokatit të Popullit mori pjesë në Konferencën e Dytë të Rrjetit të Mediatorëve dhe Ombudsmanëve të Zonës Mesdhetare me temë: “Ombudsmanët e zonës Mesdhetare – sfidat e përbashkëta” që u zhvillua në Marsejë, Francë, më 18 - 19 dhjetor 2008, organizuar nga Zyra e Mediatorit të Francës.

### **III. Vizita të Autoriteteve Homologe të Avokatit të Popullit në Shqipëri**

1. Më 20-24 mars 2008, me ftesë të Avokatit të Popullit dhe Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit Shqiptar erdhi në Shqipëri për një vizitë zyrtare Kontrollori i Shtetit dhe Ombudsman i Shtetit të Izraelit, Z. Micha Lindenstraus. Gjatë vizitës së tij pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ai u njoh nga afër me punën dhe arritjet e këtij Institucioni gjatë 8 vjetëve të aktivitetit të tij dhe u prit nga autoritetet më të larta të Shtetit shqiptar.

2. Me ftesë të Avokatit të Popullit erdhi për një vizitë zyrtare në Tiranë, më 23-24 qershor 2008, Mediatori i Francës, Z. Jean Paul Delevoye. Sipas programit të hartuar me këtë rast, Mediatori i Francës u takua me autoritetet më të larta të vendit të cilët shprehën vlerësimin e tyre për institucionin e Avokatit të Popullit në Shqipëri. Gjatë kësaj vizite u shkëmbyen eksperiencat përkatëse dhe u vlerësua vazhdimësia e bashkëpunimit në të ardhmen i të dy institucioneve homologe.

3. Më 13-15 korrik 2008, erdhi në Shqipëri për të pestën herë në 8 vjet, Ombudsmani Parlamentar i Danimarkës, Z. Hans Gammeltoft-Hansen, i ftuar nga Avokati i Popullit dhe Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës si dhe me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Danimarkës në Tiranë, për të marrë pjesë në Tryezën e Rrumbullaket me temë “Shqipëria dhe Protokoli Opsional për Parandalimin e Torturës”. Kjo veprimtari dyditore ofroi një mundësi konkrete diskutimi dhe shkëmbimi idesh mbi masat e mëtejshme që duhet të ndërmerren Shqipëria në fushën e parandalimit të torturës dhe zbatimit në praktikë të OPCAT-it.

Ne kuadër të këtij aktiviteti, Ombudsmani i Danimarkës u prit edhe nga Presidenti i Republikës, Z. Bamir Topi dhe nga Kryetarja e Kuvendit, Zj. Jozefina Topalli.

4. Mbrojtësi i të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Malin e Zi, Z. Shefko Crnovshanin vizitoi Tiranën më 16-17 Tetor 2008, me ftesë të Avokatit të Popullit.

Krahas takimeve me homologun e tij dhe stafin e Avokatit të Popullit, delegacioni i Ombudsmanit të Malit të Zi u takua edhe me personalitete të larta të vendit. Teme e bisedave ishte nxitja e bashkëpunimit rajonal në një fushë të ndjeshme sikurse është ajo e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Bashkëpunimi rajonal ka qenë një ndër prioritetet e Zyrës së Avokatit të Popullit qysh në fillimet e saj. Avokati i Popullit ka bashkëpunuar vazhdimisht me të gjithë partnerët e tij në rajonin e Ballkanit, si për mbrojtjen e të drejtave të shtetasve shqiptarë që jetojnë në shtetet fqinj, ashtu edhe për arritjen e standarteve evropiane që

vetë shtetet e rajonit ballkanik i kanë vënë si qëllim vetes për t'u integruar në Bashkimin Evropian.

#### **IV. Vizitat e Avokatit të Popullit në Zyrat e Ombudsmanëve të vendeve të tjera.**

1. Më 26-30 tetor 2008, me ftesë të Kontrollorit dhe Ombudsman i Shtetit të Izraelit, Avokati i Popullit së bashku me Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, shkoi për një vizitë zyrtare në Jerusalem. Gjatë kësaj vizite u shkëmbyen eksperiencat mes dy zyrave homologe dhe Avokati i Popullit u njoh nga afër me aktivitetin dhe sukseset e këtij Institucioni. Të gjitha takimet zyrtare me Ombudsmanin, stafin e tij dhe autoritetet e vendit u gjetën shumë të rëndësishme dhe frutdhënëse.

#### **V. Vizita studimore të realizuara jashtë Shqipërisë**

1. Me mbështetje dhe organizim të Fondacionit Konrad Adenauer, Avokati i Popullit mori pjesë në një Program Studimi dhe Dialogu së bashku me Avokatin e Popullit të Maqedonisë që u zhvillua në Berlin, në Republikën Federale të Gjermanisë më 5-9 maj 2008. Qëllimi i kësaj vizite studimore ishte që ata të njiheshin nga afër me përvojën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, për dialogun ndërkulturor dhe për forcimin e strukturave dhe parimeve shtetërore sipas modelit Gjerman.

2. Më 8-12 dhjetor 2008, Avokati i Popullit mori pjesë në vizitën studimore të organizuar në Berlin nga Fondacioni Friedrich Ebert, lidhur me temën e hapjes së dosjeve të ish bashkëpunëtorëve të sigurimit të shtetit në Shqipëri.

#### **VI. Vizitat për shkëmbim eksperience në Institucionin e Avokatit të Popullit**

1. Në kuadrin e shkëmbimit të eksperiencave midis zyrave homologe, erdhi për trajnim profesional pranë Institucionit të Avokatit të Popullit një delegacion nga Institucioni i Ombudspersonit të Kosovës, më 17-18 nëntor 2008, i kryesuar nga Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit, Z. Hilmi Jashari.

2. Gjithashtu, më 24-25 nëntor 2008, një delegacion nga Institucioni i Mbrojtësit të të Drejtave dhe Lirive të Njeriut të Republikës së Malit të Zi erdhi pranë Zyrës së Avokatit të Popullit në Tiranë për një program trajnimi një ditor për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

#### 4. Sfidat dhe objektivat e Institucionit për vitin 2009 e në vazhdim

Avokati i Popullit gjithmonë pretendon një përgjegjshmëri në rritje të të gjitha organeve shtetërore, në raport me respektimin e të drejtave të njeriut. Ai shikon përtej referencave ligjore, të cilat natyrisht të orientojnë drejt dhënies së drejtësisë. Por që kjo të quhet e tillë, edhe duhet të perceptohet nga publiku si e tillë. Prandaj, Avokati i Popullit ka reaguar fort, qoftë edhe për raste të veçanta, sa herë që ka marrë informacione për shkelje flagrante të të drejtave të njeriut, nga cilido përfaqësues i administratës publike shqiptare.

Shqetësimi i Avokatit të Popullit, por edhe i shoqërisë dhe shtetit tonë është bërja e drejtësisë sipas ligjit. Megjithëse qysh në fillim të veprimtarisë së institucionit Avokati i Popullit ka paralajmëruar, për çështjet që kalojnë në filtrat e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg dhe Shqipëria penalizohet si shtet, për një procedurë apo zvarritje të paligjshme, thënë ndryshe për drejtësi të vonuar apo të mohuar, ne nuk ndihemi mirë për rastet në rritje.

Me rifitim të statusit “A” të akreditimit, Avokati i Popullit do të vazhdojë të jetë anëtar me të drejta të plota i Komitetit Koordinues Ndërkombëtar. Ky Komitet koordinon nismat dhe politikat në forumet ndërkombëtare të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut në kuadrin e OKB-së.

Sfidat dhe objektivat e Avokatit të Popullit janë gjithmonë përplotësuese me vetë sfidat dhe objektivat e qeverisjes së vendit, në nivel qendror dhe lokal.

Avokati i Popullit do të vazhdojë t’u kushtojë vëmendje të veçantë objektivave të mëposhtëm:

1. Rritja e partneritetit të Avokatit të Popullit me institucionet e administratës publike, me synim zgjidhjen sa më të shpejtë të kërkesave dhe ankesave të përditshme të qytetarëve.

2. Rritja e efikasitetit të zyrës për të mundësuar zgjidhjen e ankesave, kryesisht pas shterimit të rrugëve të ankimit administrativ, me synim parandalimin e rritjes së ngarkesës së punës së gjykatave, aksesit ndaj të cilave gjithsesi mbetet gjithmonë i garantuar.

3. Bashkërendimi dhe bashkëpunimi me organet e zbatimit të ligjit, sikurse janë Policia e Shtetit, organi i Prokurorisë, drejtoritë e burgjeve etj, në funksion të realizimit të drejtësisë dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

4. Rritja e bashkëpunimit të Avokatit të Popullit me organizmat e shoqërisë civile, për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duke përfshirë në këtë proces edhe lobimin për probleme të veçanta, të

bëra kauza të përbashkëta me grupe të caktuara të interesit, fjala vjen, për të drejtat e grave, fëmijëve etj.

5. Rritja e vëmendjes për ndjekjen e rasteve me vetiniciativë, fokusuar në mbrojtjen e të drejtave që prekin grupe të mëdha njerëzish apo grupet më në nevojë e më të prekshëm, pa përjashtuar rastet individuale të bëra publike nga media.

6. Funkcionalizimi më efikas i Njesisë për Parandalimin e Torturës përmes rritjes së frekuencës së kontroleve të befasishme që kjo Njësi kryen në kuadrin e Institucionit të Avokatit të Popullit si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës.

7. Angazhimi më i madh i Njesisë për Parandalimin e Torturës në përgatitjen e raporteve të posaçme për Kuvendin si dhe integrimi i tyre në Raportet e institucioneve ndërkombëtare të fushës.

8. Vazhdimi i praktikës së ditëve të hapura, në mënyrë periodike dhe në zona të ndryshme të vendit, jo si qëllim në vetvete dhe thjesht për të grumbulluar ankesa, por për të rritur praninë fizike të Avokatit të Popullit pranë qytetarëve, qoftë edhe për të kompensuar mungesën objektive të zyrave rajonale.

9. Rritja e bashkëpunimit me median, për të shtuar presionin pozitiv mbi administratën, ka qenë dhe mbetet një kusht i domosdoshëm dhe jetik për vetë ekzistencën e Avokatit të Popullit, me synim ngulitjen e praktikave të mira administrative dhe denoncimin e praktikave korruptive.

10. Rritja e transparencës së institucionit, përmes publikimit më të mirë dhe më shumë të problemeve kryesore të evidentuara nga shkeljet e Administratës Publike në fushën e të drejtave të njeriut, duke pasuruar në mënyrë të vazhdueshme faqen tonë në Internet.

11. Nxitja e nismave ligjvënëse të deputetëve, për të bërë rregullimet e duhura ligjore sipas rekomandimeve tona si dhe rritja e informimit të Parlamentit për problematika specifike.

12. Fuqizimi i përpjekjeve për zgjidhjen përfundimtare që duhet të japë Kuvendi për dilemën, nëse duhet konsoliduar nënseksioni për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve apo duhet pranuar propozimi alternativ për krijimin e Ombudsmanit të Fëmijëve.

13. Fitimi i statusit “A” si Institucion Kombëtar për Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut kërkon rritjen e pjesëmarrjes aktive të Avokatit të Popullit në tryezat ndërkombëtare, qoftë të atyre shumëpalëshe, në kuadrin e Këshillit të Evropës apo të Zyrës së Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut pranë Kombeve të Bashkuara në Gjenevë, qoftë të atyre dypalëshe, në kuadrin e bashkëpunimit me zyrat homologe.

14. Angazhimi më aktiv, si për t’iu përgjigjur kërkesave të institucioneve shqiptare, për të kontribuar për hartimin e raporteve që

Shteti shqiptar paraqet pranë organizmave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ashtu edhe për të kërkuar nga gjithë institucionet përkatëse qeveritare, dhe organizmat e shoqërisë civile informacione përgjithësuese, në mënyrë që më pas, të kemi mundësinë të raportojmë në mënyrë më të plotë dhe koherente për standardet që Shteti e Qeveria shqiptare synon të arrijë apo ka arritur në fushën e mirëqeverisjes dhe të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

15. Ruajtja e qëndrueshmërisë teknike, pavarësisht se kjo është e kushtëzuar deri diku edhe nga qëndrueshmëria financiare. Rrjeti ynë i sistemit kompjuterik kërkon mirëmbajtje të vazhdueshme, prandaj do të vazhdojë të ketë përparësi.

16. Organizimi i aktiviteteve për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përmes sigurimit të financimeve edhe nga partnerë ndërkombëtarë. Këtë e kemi parë dhe do ta shohim me përparësi për qëndrueshmërinë financiare të institucionit, pasi shteti shqiptar është i detyruar të ndjekë një politikë të rreptë në shpenzimet operative dhe nga kjo nuk pretendojmë të privilegjohemi vetëm ne.

Garanci për përballimin e këtyre sfidave dhe të tjerave që lidhen me to është një angazhim më i madh i të gjithë punonjësve të Avokatit të Popullit për të kryer secili detyrat funksionale, duke shfrytëzuar më me efikasitet përvojën e deritanishme.



## K R E U I D Y T E

### **1. Statistika përmbledhëse e vitit 2008**

*(Rastet sipas fushave përkatëse dhe mënyra e përfundimit të tyre)*

Edhe më parë kemi nënvizuar faktin se Institucioni i Avokatit të Popullit, nëpërmjet veprimtarisë së tij, kontribuon në përmirësimin e praktikave të mirëqeverisjes, duke mbikqyrur sjelljen e organeve të administratës publike për mënyrën se sa ju shërbejnë qytetarëve. Në këtë ndërveprim të përditshëm, objektivi i Avokatit të Popullit është respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të individit, dhe eventualisht rivendosja e së drejtës së tij të shkelur nga nëpunësi i administratës publike. Nëpërmjet ndërhyrjeve me mjetet që i lejon ligji, Avokati i Popullit ndihmon për ta bërë administratën shqiptare më të përgjegjshme për cilësinë e vendimeve që ajo merr dhe për përgjegjësinë ndaj publikut, për ta bërë atë të kuptojë se roli i vërtetë i saj është t'i shërbejë qytetarëve që të realizojnë të drejtat e tyre. Ajo duhet të veprojë me transparencë, të administrojë pronën publike me profesionalizëm dhe përgjegjësi si dhe te japë llogari përpara taksapaguesve.

Gjatë veprimtarisë së përditshme të punës sonë jemi ndeshur me forma të ndryshme të rezistencës nga ana e organeve të administratës apo të autoriteteve publike. Kjo sepse, administrata shqiptare, ashtu si administrata e shumë vendeve të tjera, nuk i ka shpëtuar tendencës për të qenë e mbyllur, por për të urdhëruar më tepër se sa për të dëgjuar dhe sqaruar qytetarët. Nëpërmjet aktivitetit tonë përpiqemi ta bëjmë publikun të kuptojë se të drejtat e tij përbëjnë detyrim për administratën publike.

Ajo që vihet re këtë vit të raportimit është numri në rritje, në krahasim me vitet e tjera, i rekomandimeve drejtuar organeve të administratës. Për një pjesë të tyre, nuk kemi marrë akoma përgjigje nga organet të cilave i kemi drejtuar. Kjo për ne tregon mosangazhim sa duhet të këtyre organeve për të trajtuar me përgjegjësi rekomandimet e një organi kushtetues siç është Avokati i Popullit. Si rrjedhim kemi përsëritje të problemeve dhe shfaqje të keqadministrimit tek këto organe.

Gjatë periudhës 1 Janar - 31 Dhjetor 2008 janë trajtuar nga Zyra e Avokatit të Popullit **3657** ankesa, kërkesa dhe njoftime, duke përfshirë dhe ato të Zyrës së Pritjes së Popullit, të cilave ju është dhënë përgjigje menjëherë. Nga **3657** ankesa, **425** kanë qenë të mbartura nga viti 2007,

**2862** janë raste të regjistruara në vitin 2008 dhe **370** janë raste të cilave iu është dhënë përgjigje menjëherë në Zyrën e Pritjes së Popullit. Në vështrim të parë, duket se numri i ankesave për vitin 2008, është më i ulët se viti 2007. Në fakt, referuar dhe shifrave që po prezantojmë në këtë raportim, gjatë vitit 2008 është ulur ndjeshëm numri i ankuesve të cilëve ju jepej përgjigje menjëherë, nga Zyra e Pritjes së Popullit, për ankesat që ata vazhdimisht paraqisnin dhe të cilat kanë qenë jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit. Një gjë e tillë është arritur, falë punës së bërë në vazhdimësi për ndërgjegjësimin e publikut lidhur me juridiksionin e Avokatit të Popullit. Kjo ka bërë që gjatë vitit 2008, të rritet numri i ankesave të cilat i janë nënshtruar shqyrtimit nga ana e Zyrës sonë.

Kështu, ankesa, kërkesa dhe njoftime të cilat i janë nënshtruar shqyrtimit nga ana e Zyrës sonë kanë qenë **3287** ose **269** më shumë se në vitin 2007. Nga këto, **365** ankesa ose rreth **11 %** e tyre kanë kaluar për shqyrtim në vitin 2009. Gjatë vitit 2008 janë përfunduar së shqyrtuari gjithsej **2922** ankesa, nga të cilat ka rezultuar se **1292** ankesa, ose **44 %** e tyre, kanë qenë jashtë juridiksionit dhe kompetencës. Por për këto ankesa është bërë punë efektive, sepse qytetarët janë sqaruar për rrugën që ata duhej të ndiqnin për zgjidhjen e problemit të prezantuar tek ne. **734** ose **25 %** e ankesave kanë rezultuar të padrejta, kurse **773** ose **26.5 %** e tyre janë zgjidhur në favor. Në vitin 2007 janë zgjidhur në favor **616** ankesa apo kërkesa, të cilat përbënin **24 %**. Për **22** ankesa, ose **0.75 %** e ankesave të përfunduara, rekomandimet me shkrim drejtuar organeve përkatëse të administratës për shkelje të konstatuara prej tyre, nga zyra jonë, janë refuzuar. Për **101** raste, ose **3.5 %** të tyre, të paraqitura për shqyrtim pranë nesh, ankuesit kanë hequr dorë gjatë procesit të shqyrtimit. Për ankesat e gjetura të bazuara, për **153** prej tyre janë bërë rekomandime apo propozime përkatëse me shkrim, drejtuar autoriteteve publike me qëllim që të rritet cilësia e administrimit publik dhe të sigurohen standarte mirëqeverisje. Për pjesën tjetër (620) zgjidhjet pozitive janë arritur që në fazën e marrjes së shpjegimeve apo ndërmjetësimit tonë verbal me organet e Administratës Publike. Këto organe pas komunikimit me ne kanë rregulluar gabimin e bërë ose kanë hequr dorë nga qëndrimet refuzuese apo negative që kanë mbajtur me ankuesit. Rekomandimet e bëra nga Avokati i Popullit dhe të pranuar nga organet të cilave ato u janë drejtuar tregojnë për ndërhyrje të argumentuara nga institucioni ynë për rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura qytetarëve.

Në këtë Raport Vjetor do të prezantojmë, ashtu si dhe vitet e kaluara, rastet e trajtuara nga Zyra e Avokatit të Popullit, të ndara sipas Ministrive përkatëse dhe organeve apo enteve të tjera të Administratës Publike Shqiptare në vartësi të tyre, ndaj të cilave janë drejtuar ankesat

apo kërkesat, duke shprehur shpesh dhe opinionet tona për fushat përkatëse.

Më poshtë po paraqesim numrin e ankesave, kërkesave apo njoftimeve të trajtuara në vitin 2008, të ndara për Këshillin e Ministrave dhe sipas Ministrive përkatëse, organeve apo enteve të tjera të administratës publike.

<b>1. Këshilli i Ministrave</b>	<b>63</b> , nga të cilat
për vetë Qeverinë	36
a. Instituti i Integritit të ish të	
Përndjekurve politikë	25
<b>2. Ministria e Drejtësisë</b>	<b>677</b> nga të cilat:
për vetë ministrinë	35
a. Për burgjet dhe paraburgimet	314
b. Zyrat e Përmbarimit	113
c. Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	117
d. Agjensia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave	88
<b>3. Organet e pushtetit gjyqësor</b>	<b>312</b>
<b>4. Prokuroria</b>	<b>214</b>
<b>5. Ministria e Brendshme</b>	<b>635</b> nga të cilat:
Organet e policisë	233
Organet e pushtetit vendor	401
a. Komunat	91
b. Bashkite	276
c. Prefekturat	4
d. Qarqet	9
dh. Gjëndja Civile	19
<b>6. Ministria e Mbrojtjes</b>	<b>149</b>
<b>7. Ministria e Financave</b>	<b>186</b>
Për vetë ministrinë	
a. Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve dhe deget ne varesi te saj	
b. Drejtoria e Pergjithshme e Doganave dhe degët në varesi te saj	
c. Agjensia Kombetare e Privatizimit	
ç. Instituti i Sigurimeve Shoqërore	147
d. Bankat	4
<b>8. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit</b>	<b>133</b> , nga të cilat:
Për vetë ministrinë	16

a. Inspektoratet ndërtimore	75
b. Ujësjiellës kanalizime	12
c. Albtelekom dhe telefonia mobile	16
ç. Posta Shqiptare	3
d. Enti Kombëtar i Banesave	10
<b>9. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës</b>	<b>87</b> , nga të cilat:
Për vetë ministrinë	28
KESH	59
<b>10. Ministria e Shëndetësisë</b>	<b>46</b>
<b>11. Ministria e Arsimit dhe Shkencës</b>	<b>43</b>
<b>12. Ministria e Punëve të Jashtme</b>	<b>41</b>
<b>13. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta</b>	<b>40</b> , nga të cilat:
Për vetë ministrinë	31
a. Shërbimi Social Shtetëror	9
<b>14. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit</b>	<b>8</b>
<b>15. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave</b>	<b>9</b>
<b>16. Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve</b>	<b>7</b>
<b>17. Ministria e Integrimit</b>	<b>1</b>
<b>Të tjera</b>	<b>212</b>
<b>TOTALI</b>	<b>2862 ankesa</b>

Siç do të shihet dhe nga pjesët e veçanta të këtij raporti, përveç trajtimit të ankesave të ardhura nga qytetarë të ndryshëm, shoqëri apo shoqata, Avokati i Popullit ka punuar aktivisht duke kryer hetime për probleme të ndryshme me iniciativë “ex officio”, duke takuar përfaqësues të ndryshëm të administratës qendrore dhe vendore dhe duke i bërë të ditur qytetarëve të drejtat e tyre. Po kështu, gjatë vitit 2008, e rëndësishme është zgjidhja në favor të ankuesve të një numri të konsiderueshëm të ankesave, (**773 ankesa**).

## 2. Opinione të përgjithshme për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri

Shqipëria, veç pranimin të garantuar në NATO në prill 2009 do të jetë kandidat për t'u anëtarësuar edhe në BE. Ratifikimi i MSA-së nga të gjithë parlamentet e vendeve anëtarë të Bashkimit Evropian e ngarkon edhe më me shumë përgjegjësi atë për të rritur cilësisht standartet e mirëqeverisjes dhe të të drejtave të njeriut.

Në bazë të kriterëve politike dhe të tjera, si për pranimin, ashtu edhe për pezullimin nga Bashkimi Evropian (kriteret e anëtarësimit, të parashtruara në Qershor të vitit 1993 në Kopenhagen), qëndron "stabiliteti i institucioneve që garantojnë demokracinë, respektimin e ligjit, të drejtat e njeriut ... etj". Një institucion i tillë, që garanton demokracinë, sundimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut, pra mirëqeverisjen, është parashikuar të jetë edhe Avokati i Popullit (Ombudsmani). Për më tepër kur ky në vendin tonë luan edhe rolin e Institucionit Kombëtar për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Njeriut, edhe rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës.

Avokati i Popullit është i vetmi institucion kombëtar me status kushtetues për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut në Shqipëri. Në ushtrim të këtij funksioni, ne jemi shprehur jo vetëm në Raportet tona, por edhe në analizat, diskutimet apo rekomandimet, kur kemi shqyrtuar ankesa apo kërkesa të qytetarëve ndaj administratës publike. Për opinionet që do të paraqesim më poshtë, nuk jemi bazuar vetëm në ankesat e paraqitura tek Institucioni ynë, por dhe në informacionet e marra nga organizatat jofitimprurëse, për fusha të veçanta të së drejtës, nga sondazhet dhe informacionet e publikuara në mediat shqiptare si dhe në raportet e organizmave dhe institucioneve ndërkombëtare që analizojnë gjendjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Shqipëri, siç janë Raportet e Komisionit Evropian, Këshillit të Evropës, Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Amnesty International, komitetet e të drejtave të njeriut pranë organizmave të Kombeve të Bashkuara, natyrisht pa përjashtuar edhe raportet zyrtare të qeverisë shqiptare, etj. Padyshim që viti 2008 ka patur zhvillime pozitive edhe në fushën e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Shqipëri. Por Avokati i Popullit është institucion që duhet të kërkojë gjithmonë standarde gjithnjë e më të larta. Prandaj edhe Raportet apo informacionet tona përshkohen më tepër nga kritika konstruktive.

Praktika e përditshme e raporteve individ-shtet dëshmon se niveli i mirëqeverisjes, si një e drejtë e njeriut, akoma nuk i ka arritur standardet e caktuara si detyrë shtëpie për klasën politike në vend. Avokati i Popullit, edhe gjatë vitit 2008, e ka ngritur zërin në çdo rast që ka konstatuar shkelje të të drejtave të personit nga policia, për respektimin e të drejtave

të të burgosurve, për të drejtën e qytetarëve për t'u shprehur përmes referendumit (funktionalizimin e këtij mekanizmi të demokracisë së drejtpërdrejtë), për të drejtën dhe lirinë e shprehjes, për të drejtën e informimit, të drejtat që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës, për ndotjen e ambientit, për zvarritjet në procedurat gjyqësore etj. Reagimet tona të forta ndjehen në të gjitha rekomandimet tona që kanë pasuar inspektimet dhe kontrollet periodike nëpër burgje, në dhomat e paraburgimit, në spitalet psikiatrike apo ambiente të tjera të mbyllura. Në të gjitha këto raste, ne kemi qenë tepër kërkuar ndaj punonjësve të policisë së shtetit, për të mos përdorur dhe eliminuar dhunën, torturën dhe çdo formë tjetër keqtrajtimi të lidhur me to. Këtij qëllimi i ka shërbyer edhe fakti se, qysh nga Qershori i vitit 2008, në plotësim të detyrimeve ndërkombëtare që vendi ynë ka marrë përsipër, pas ratifikimit të konventave ndërkombëtare, filloi nga funksionimi struktura e re pranë Avokatit të Popullit, që quhet Njësia për Parandalimin e Torturës.

Të gjitha raportet e institucioneve dhe organizmave ndërkombëtare monitoruese theksojnë se “në Republikën e Shqipërisë janë miratuar pothuajse të gjitha ligjet specifike që kanë si objekt respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut”. Por dihet gjithashtu se hartimi i ligjeve të reja nuk është i mjaftueshëm. Aftësia për t'i zbatuar ato mirë, është elementi thelbësor i garantimit të demokracisë dhe sundimit të ligjit. Prej vitesh në Shqipëri, në drejtim të zbatimit me efikasitet të kuadrit ligjor pozitiv, vazhdojnë të hasen një sërë problemesh serioze që kërkojnë zgjidhje.

E drejta e jetës, si e drejtë themelore e njeriut, ka qenë në qendër të vëmendjes dhe angazhimit të Avokatit të Popullit qysh në fillim të veprimtarisë së tij. Kështu, në Konferencën së parë Kombëtare që Avokati i Popullit ka organizuar, synimi ka qenë inicimi i një strategjie kombëtare të përbashkët, nga të gjithë organet shtetërore dhe OJF-të, për masa parandaluese të ngutshme dhe të qëndrueshme, në mbrojtje të së drejtës së jetës dhe në veçanti, ndaj fenomenit të gjakmarrjes. Pas vitit 2004 ka patur një angazhim më serioz ndaj fenomenit të gjakmarrjes dhe faktikisht, nga organet e policisë raportohet se fenomeni ka rënë. Pozitiv është fakti se Kuvendi ka miratuar Ligjin nr.9389, datë 04.05.2005, “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër Gjakmarrjes”. Në Shkurt 2007 u miratuan ndryshime në Kodin Penal, për të ndëshkuar penalisht nxitësit e gjakmarrjes. Është punuar për t'u siguruar “arsimin në shtëpitë e tyre” të fëmijëve të ngujuar, madje për këtë është krijuar edhe një qendër në Poliçan dhe kjo është pozitive. Nga ana tjetër, për fat të keq, Këshilli Koordinues është mbledhur vetëm një herë deri tani. Këshilli i Ministrave nuk ka nxjerrë aktet nënligjore përkatëse në zbatim të këtij ligji. Veç të tjerave, kjo mangësi bën që të mos dihet me saktësi numri i familjeve në përgjithësi dhe i fëmijëve në

veçanti, të cilësuar “në gjakmarrje”. Problemi bëhet më i ndjeshëm po të kemi parasysh se vetëm nga ngujimi i të rriturve dhe fëmijëve, shkelen njëkohësisht një sërë të drejtash, si ajo e lëvizjes, e votës, e shkollimit e kështu me radhë, të gjitha të kushtëzuara nga cënimi i së drejtës themelore të jetës. Megjithëse që të gjitha institucionet qeveritare e kanë kuptuar se duhet të angazhohen më seriozisht për këtë “plagë”, që e bën të papranueshme Shqipërinë në familjen e madhe të Bashkimit Evropian, edhe gjatë vitit 2008 nuk kemi konstatuar ndonjë zhvillim apo nismë të rëndësishme qeveritare.

Sikur të mos mjaftonte ekzistenca e fenomenit të mësipërm, e drejta e jetës në Shqipëri, si e drejtë themelore e njeriut, vazhdon të jetë e rrezikuar, për sa kohë që armët vazhdojnë të jenë pa kontrollin e duhur në duart e popullsisë civile. Këto armë përditë marrin jetë njerëzish nëpërmjet krimeve brenda familjes, vetëvrasjeve, krimeve me dashje apo pakujdesive në administrimin e tyre. Stoqet e mëdha të municioneve dhe ngjarja në fshatin Gërdec, më datën 15 mars 2008, ku humbën jetën 26 persona dhe u plagosën qindra të tjerë, tregon për një burim tjetër rreziku të shtuar për jetën e shtetasve shqiptarë. Ndonëse nga policia ka patur disa rezultate për trafikun e armëve dhe zbatimin e ligjit për armëmbajtësit pa leje është forcuar, numri i armëve pa leje në duart e popullsisë vazhdon të jetë ende i madh. Për t’i dhënë fund kësaj gjendjeje mendojmë se çarmatimin nuk mund ta presim që ta bëjnë vetëm strukturat e Policisë së Shtetit. Ne vazhdojmë të insistojmë se duhen gjetur zgjidhje të reja që mund të jenë që nga kombinimi i pagesës, për çdo armë të dorëzuar, deri tek ligjësimi rast pas rasti i armëmbajtjes nga çdo individ i rritur, i përgjegjshëm dhe pa precedentë penale. Këto janë propozime që Avokati i Popullit i ka përsëritur çdo vit.

Liritë dhe të Drejtat Vetjake si liria e shprehjes, e shtypit, medias televizive, liria individuale, paprekshmëria e banesës, liria e fshehtësia e korrespondencës janë të garantuara me ligj. Për to ka patur dhe do të ketë ankesa dhe mbrojtje të tyre, si nga ana e Avokatit të Popullit, ashtu edhe me anë të proceseve gjyqësore. Mendimi ynë është se këto të drejta dhe liri, përgjithësisht respektohen. Megjithatë, ka patur raste sporadike shkeljeje, sikundër ishte bllokimi i një spoti dhe gjobitja e një televizioni privat nga ana e KKRT-së. Me këtë rast Avokati i Popullit, i ka rekomanduar Qeverisë dhe Komisioneve Parlamentare ndërmarrjen e nismës legjislative për ndryshimin e pikës 8, të nenit 55 të Ligjit nr.8410, datë 30.09.1998, “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, për të garantuar respektimin pa kufizime dhe barazinë thelbësore të fjalës së lirë në radiot dhe televizionet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në vendin tonë.

Autoritetet duhet të reagojnë më shpejt për të identifikuar shkaktarët e shkeljes së të drejtave të gazetarëve dhe rivendosjen e tyre.

Kjo sidomos kur pas proceseve ligjore të rregullta janë vërtetuar shkelje të kryera nga autoritetet publike apo nga individë të veçantë që u kanë cënuar këto të drejta, qoftë në rastet kur janë ankuar tek Avokati i Popullit, qoftë në rastet kur janë shprehur organet gjyqësore.

Gjatë vitit 2008 janë evidentuar përpjekje të vetë organeve të medias apo të komunitetit të gazetarëve, për të krijuar mekanizma vetërregullues në drejtim të rritjes së profesionalizmit dhe përgjegjshmërisë. Ky është një zhvillim pozitiv, pasi mjafton të kujtojmë faktin se, më parë, për një kohë të gjatë, në median tonë nuk konsiderohej shkelje publikimi me hollësi i të dhënave personale që shkelin të drejtën e privatësisë.

Shumë gazetarë, në kushtet e anonimitetit, ankohen se mungesa e kontratave të punës shpesh pengon aftësinë e tyre për të raportuar në mënyrë objektive dhe kjo konsiderohet autocensurë. Si rrjedhojë, edhe gazetaria investigative nuk është shumë e përdorur, me përjashtim të emisionit “Fiks Fare” të Televizionit Top Channel apo “Zonë e Ndaluar” dhe “Njerëz të Humbur” në TV Klan, “Me zemër të hapur” në News 24 apo “Misioni Vazhdon” në Vizion +. Rol të madh parandalues duhet të luajnë shoqatat e gazetarëve, nëpërmjet bashkimit në sindikata apo unione aktive si dhe të aftësimin profesional të tyre. Edhe institucioni ynë duhet të bëjë më shumë në këtë drejtim, për të vepruar me iniciativë dhe bërë kauza të përbashkëta me gazetarët, për të ngritur opinionin publik kundër shkeljeve në fushën e të drejtës së informimit, mbrojtjes në punë apo shkeljeve të së drejtës së privatësisë. Kjo pavarësisht se për këtë të fundit tashmë është përgjegjës një institucion i krijuar rishtas gjatë vitit 2008, ai i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Liria e ndërgjegjes dhe e fesë njihen dhe respektohen nga shteti. Avokati i Popullit nuk ka munguar të trajtojë ankesa që lidhen me respektimin e lirisë së shprehjes dhe të besimit privatisht dhe publikisht. Në disa raste ka mundur të arrijë zgjidhje me mirëkuptim të këtyre rasteve. Gjatë vitit 2008 mund të themi se shteti shqiptar dhe Administrata Publike më së fundi kanë marrë përgjegjësinë për të rregulluar sipas Kushtetutës marrëdhëniet midis shtetit dhe fesë, përmes nënshkrimit të marrëveshjeve me komunitetet fetare dhe ratifikimit të tyre në Parlament, si duke përgatitur një ligj të posaçëm, që pritet të garantojë të drejtën e ushtrimit të besimit dhe të funksionimit të komuniteteve fetare në vend. Modeli sipas të cilit do të hartohet ligji shpresojmë se do të ketë parasysh traditën e bashkekzistencës paqësore fetare në vend, sikundër edhe dimensionin evropian që shteti shqiptar synon të zhvillojë në këtë fushë, ku si shteti, ashtu dhe feja kanë të njëjtin objektivi: individin shqiptar.

Ky rregullim ligjor është ngritur çdo vit në Raportet vjetore të institucionit të Avokatit të Popullit. Avokati i Popullit ka dhënë



kontributin e tij institucional në hartimin e projektmarrëveshjeve të komuniteteve fetare me shtetin, sikundër ka paraqitur mendimin e tij lidhur edhe me ligjin që pritet të diskutohet dhe eventualisht të miratohet nga Parlamenti gjatë vitit 2009.

Liritë dhe të Drejtat Politike, si e drejta e zgjedhjeve, e organizimit, e tubimeve dhe manifestimeve paqësore, janë të garantuara me ligj. Të gjitha institucionet publike punojnë që ato të respektohen. Për fat të keq për zgjedhjet vazhdojnë diskutimet dhe dyshimet, mungesa e besimit reciprok, rrjedhur nga proceset elektorale të shkuara. Natyrisht ka dhe do të ketë opinione të ndryshme në këto drejtime, sidomos nga partitë politike. Avokati i Popullit ka zbatuar dhe është mbështetur fort në parimin e paanësisë, për të mos u komprometuar në pakënaqësitë e natyrshme të partive politike, që gjithmonë shoqërojnë garat elektorale për pushtetin qendror dhe atë vendor.

Pavarësisht vonesës së pajustificuar, me të cilën u shoqërua procesi i krijimit të Regjistrit të saktë të zgjedhësve dhe pajisjes së shtetasve me karta identiteti, si një element bazë për zgjedhjet e ardhshme të 2009, Avokati i Popullit e përshëndet këtë zhvillim dhe ka inkurajuar shtetasit të kryejnë detyrimet e tyre ligjore në emër të së mirës publike, si parakusht për të përfutur zgjedhje të lira, të ndershme, të pakontestuar.

Në kuadrin e propozimeve për zgjidhjet teknike që do të jepen, Avokati i Popullit vazhdon ta konsiderojë si opsion edhe Rekomandimin e tij të hershëm për përdorimin e skanerëve elektronikë për të numëruar votat. Për këtë problem ne kemi paraqitur edhe përlllogaritjet tona, si në drejtim të reduktimit të subjektivizmit njerëzor, ashtu edhe në drejtim të kostos me përfitim ekonomik për buxhetin e shtetit. Megjithatë, sa më sipër është një zgjidhje alternative, pasi jemi të ndërgjegjshëm se vendosja e besimit ndërmjet palëve konkurruese kërkon mbi të gjitha vullnet politik, i cili është mjeti më i saktë për të zhvleftësuar ose vlerësuar saktësisht çdo zgjidhje teknike që mund të ofrohet.

Avokati i Popullit ka ngritur me kohë edhe nevojën e zbatimit të së drejtës pozitive, që parashikon kuotën jo më pak se 30 përqind për përfshirjen e grave në formacionet vendimmarrëse në të gjitha nivelet apo funksionimin e gjithë strukturave të shtetit. Kjo është një arsye më shumë që Avokati i Popullit përshëndet sanksionimin e kuotës 30 përqind, në Kodin e ri Zgjedhor, për pjesëmarrjen e grave dhe vajzave në politikë dhe vendimmarrje. Avokati i Popullit vazhdon të insistojë që në Kodin Zgjedhor të bëhen amendimet përkatëse për të ndaluar me ligj përfshirjen e fëmijëve në fushatat zgjedhore.

Gjatë vitit 2008 Avokati i Popullit dhe Qendra “Fëmijët Sot” organizuan aktivitetin e përbashkët me temë: “Konventat për të drejtat e fëmijëve dhe çështjet e ratifikimit dhe botimit të akteve ndërkombëtare në Shqipëri”. Ky aktivitet, ku morën pjesë deputetë, dhe konkretisht Kryetari

dhe Nënkyetari i Nënkomisionit për të Drejtat e Fëmijëve dhe Grave, synoi ndërgjegjësimin e strukturave të shtetit shqiptar për rëndësinë e njohjes dhe botimit të instrumenteve ndërkombëtare, të ratifikuara nga shteti shqiptar ndër vite. Akoma më i ndjeshëm dhe konkret bëhet problemi nën fokusin e konventave për të drejtat e fëmijëve, të kësaj shtrese që edhe Avokati i Popullit, ashtu si të gjitha strukturat e shtetit dhe shoqëria shqiptare, mendon se i është borxhli, në kuptimin se mund të kishte bërë më shumë brenda mundësive juridikionale.

Është pozitive se po miratohen ligje të posaçme për të drejtat e fëmijëve si dhe krijimi i një sistemi gjyqësor të veçantë. Për minorenët duhet të krijohet sa më parë qendra për edukimin e atyre personave që nuk kanë arritur moshën për përgjegjësi penale, mundësisht edhe një institucion riedukimi i veçantë për ta.

Në fund të vitit 2008, ne i kemi paraqitur Parlamentit propozimin që, ankesat për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, të shqyrtohen ose duke krijuar një institucion më vete, siç mund të jetë Ombudsmani për Fëmijët, ose duke fuqizuar me më shumë burime njerëzore dhe financiare Avokatin e Popullit.

Një problem tjetër, që gjithnjë e më shumë po zë vend në tryezat evropiane për të drejtat e njeriut, ka të bëjë me të drejtat e personave me orientime të ndryshme seksuale. Në të njëjtën gjatësi vale me Zyrën e Komisionerit për të Drejtat e Njeriut pranë Këshillit të Evropës, këndvështrimi i Avokatit të Popullit është se të drejtat e këtyre personave nuk duhen parë vetëm si të drejta të pakicave, por si të drejta humane dhe, si të tilla, nuk duhen trajtuar mbi baza diskriminuuese. Avokati i Popullit konsideron se duhen realizuar përpjekje konkrete kundër homofobisë dhe diskriminimit të bazuar mbi orientimin seksual dhe identitetin gjinor. Jurisprudenca e Strasburgut tashmë ka grumbulluar praktika të mjaftueshme pozitive, bazuar në legjislacionin ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përse i përket çështjeve të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Fatkeqësisht, modeli i këtyre personave në Tiranë, në mënyrë absurde vazhdon të identifikohet me stereotipin e pasqyruar edhe nga media, për disa të mjerë që punojnë si punëtorë seksi diku pas Pallatit të Kulturës. Kjo duhet të marrë fund dhe për këtë duhet të sensibilizohemi të gjithë. Në çdo rast, arbitrariteti ndaj këtyre personave është i papranueshëm.

Në lidhje me trafikun e qenieve njerëzore, nuk duhen mohuar rezultatet pozitive të viteve të fundit që kanë patur të bëjnë sidomos me rritjen e kontrollit të kufijve. Trafikimi i femrave për prostitucion dhe i fëmijëve ekziston, por rastet janë pakësuar. Çdo ditë e më tepër njoftohet për vënie para ligjit të cilitdo që ka kryer vepra të tilla, qoftë edhe gjatë viteve të shkuara. Besojmë se ndryshimet e kërkuara kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Ligjin e ri “Për gjendjen civile”, të paraqitur tashmë

në Kuvend. Me zbatimin e tij shpresojmë t'i jepet fund praktikës, që shumë fëmijë mbeten pa regjistruar në zonat rurale, pasi këta dhe ata të komunitetit Rom janë kontigjentet më të preferuara nga trafikantët.

Në lidhje me të drejtat e grave, konstatohet që vitet e fundit ka rënie të ndjeshme të trafikut të femrave. Kjo ka ardhur edhe si rrjedhojë e fushatave ndërgjegjësuere të ndërmarra nga OJF-të e ndryshme në media, shkolla, universitete etj. Por kryesore ka qenë ndjekja dhe zbatimi me rreptësi i ligjit ndaj trafikantëve, miratimi dhe zbatimi i politikave dhe programeve të posaçme për mbrojtjen e viktimave të trafikut si dhe monitorimi i këtij procesi nga organizmat që janë krijuar enkas nga strukturat qeveritare. Në këtë drejtim ne kemi patur një bashkëpunim të mirë edhe me Zyrën e Koordinatorës Kombëtare për Luftën Kundër Trafikut pranë Ministrisë së Brendshme.

Një çështje tjetër që mbetet problem serioz ka të bëjë me keqtrajtimin bashkëshortor apo dhunën në familje ndaj grave, fëmijëve apo vajzave. Situata duket që përmirësohet ngadalë. Puna parandaluese, që bëhet nga organizatat joqeveritare, është shoqëruar me miratimin e ligjeve përkatëse për dhunën në familje, por edhe me kujdesin për të hetuar dhe gjykuar me rreptësi çdo shfaqje dhune që përbën vepër penale. Duhet të ketë më shumë mjete efektive në kuadrin e nje mekanizmi, për të garantuar që të ruhen dhe zbatohen të drejtat e grave, për të përmirësuar trajtimin dhe pozitën e femrave në familje dhe në shoqërinë shqiptare. Duhet punuar më mirë nga organet shtetërore për realizimin e detyrimeve të tyre për t'i shkuar drejtësisë deri në fund, pavarësisht se viktimat e kësaj dhune mund të heqin dorë nga akuza për një arsye apo tjetër. Nuk duhet harruar se dhuna në familje nuk është atribut vetëm i familjeve të varfra apo atyre me shkollim të pamjaftueshëm. Ajo ka prekur dhe prek edhe familjet në gjendje të mirë ekonomike dhe me arsim të lartë.

Në një studim të Këshillit të Evropës, botuar më 11 Nëntor 2008, i cili kërkon realizimin e një sërë standardesh, ndër të tjera, thuhet: “Së pari, një grua, që ka qenë viktimë e dhunës seksuale, ka nevojë për një mundësi që të flasë dhe të mendojë për atë ç’ka i ka ndodhur, në mënyrë që të arrijë ta quajë dhunën dhunë. Kjo, sepse shpesh gratë kanë tendencën e minimizimit të akteve të dhunës”. Ndihtë në këtë drejtim mund të japë edhe një numër telefoni në një zyrë këshillimore. Dhe të tilla ka tashmë edhe në Shqipëri. Grave u duhen treguar mjetet dhe rrugët për t’u mbrojtur nga dhuna. Ka mundësira të ndryshme për të riparuar dëmet e shkaktuara nga aktet e dhunshme dhe njëra nga ato është përpjekja për zhvillim procesesh gjyqësore kundër autorëve, sipas rastit, civile ose penale. Vajtja në ndonjë “shtëpi për gratë e dhunuara” ose “shtëpi për njerëzit e braktisur” është një mundësi tjetër. Ndihta e specialistëve mund të synojë edhe ndryshimin e raporteve të dhunshme

ose largimin e viktimës nga dhunuesi. Gratë, viktima të dhunës, duhet të kenë mundësi të marrin ndihmë mjekësore në atmosferë të ngrohtë mirëkuptimi. Kjo do të thotë që një grua të mos druhet kur të bëjë analizat; që në proceset hetimore të ruhet sfera private dhe dinjiteti i viktimës; që zyrat e ndihmës apo këshillimoret të mund të jenë në gjendje të merren me të gjitha llojet e dhunës. Të gjitha këto, duke u bazuar minimalisht në tre parime bazë: t'u besosh grave; të mos i fajësosh gratë; të forcosh përgjegjësinë e tyre personale.

Në Shqipëri vazhdon të jetë problematike situata në lidhje me zbatimin e rregullave për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit në punë, sidomos në sektorët e ndërtimit, metalurgji dhe miniera. Mungojnë shpesh pagesat e sigurimeve për paaftësi të përkohshme për aksidente, për sëmundje ose për pensione, edhe sepse mjaft punëtorë punojnë në të zezë. Kushtet në vendet e punës, sidomos tek punëdhënësit privatë, janë të këqija dhe në disa raste të rrezikshme për jetën. Autoritetet publike dhe mediat shqiptare herë pas here kanë ngritur alarmin se “në Shqipëri, humbjet njerëzore nga mungesat në kushtet e punës dhe siguria në qarkullimin rrugor, janë më të mëdha se ato në raste luftrash apo fatkeqësish natyrore”. Tragjedia e Gërdecit, më datën 15 mars 2008, e vërteton plotësisht këtë konstatim. Rastet e humbjes së jetëve në minierat e Bulqizës e bëjnë situatën edhe më dramatike. Avokati i Popullit sugjeron që duhet të ndryshojnë metodat e punës së inspektorateve që shteti ka krijuar për këto fusha. Justifikimet e natyrës se, “duke toleruar shkeljet e rregullave të sigurisë në punë, Qeveria ka dashur të mbështesë biznesin”, janë të dëmshme dhe të dënueshme.

Trajtimi i të ndaluarve dhe të paraburgosurve në dhomat e izolimit pranë komisariateve të policisë, apo të të dënuarve në burgje, megjithë përmirësimet nga viti në vit, vazhdon të ketë probleme dhe ankesa. Edhe trajtimi i të sëmurëve mendorë në spitalet psikiatrike vazhdon të jetë problem shqetësues. Inspektimet e kryera nga Avokati i Popullit, në të gjitha institucionet e shëndetit mendor, sidomos gjatë vitit 2008 e në vazhdim, kur funksionon edhe Njësia për Parandalimin e Torturës, kanë konstatuar se spitalet vazhdojnë të kenë mungesa stafi, barnash dhe pajisjesh mjekësore, kushte të papranueshme higjieno sanitare dhe mungesa në pajisje për jetesë normale. Për të bërë të mundur rregullimin e gjendjes në standarde të pranueshme ne kemi rekomanduar ndryshime dhe përmirësime të legjislacionit si dhe të infrastrukturës së sistemit të kujdesit për shëndetin mendor në Shqipëri.

Qeveria Shqiptare duhet t'i kërkojë më tepër llogari institucioneve vartëse të drejtësisë, policisë e mjekësisë, që të punojnë më seriozisht për zbatimin e vendimeve të saj, për t'i ndarë përgjegjësitë. Avokati i Popullit ka theksuar vazhdimisht se problemi i mbipopullimit të burgjeve nuk mund të zgjidhet vetëm duke ndërtuar burgje të reja. Mënyra më efikase

për të ulur nivelin e lartë të mbipopullimit në burgje është aplikimi i dënimeve alternative, veç llojit të burgimit apo arrestit me burgim. Prokurorët dhe gjyqtarët ngurojnë t'i zbatojnë dënimet alternative nga frika se mos i akuzojnë se “tregohen të butë ndaj kriminalitetit” apo se “mos i akuzojnë për korrupsion”.

Institucioni i Avokatit të Popullit, mbi bazën e mbi 50 kontrolleve të befasishme që ka ushtruar në shkallë vendi vetëm gjatë vitit 2008, është i ndërgjegjshëm se, ndonëse ka përmirësime në trajtimin e të ndaluarve dhe të të paraburgosurve në dhomat e izolimit pranë komisariateve të policisë apo nëpër burgje, ka patur mjaft ankesa dhe kërkesa për të cilat kemi bashkëpunuar me Ministrinë e Drejtësisë dhe atë të Brendshme. Ne kemi bërë hetimet përkatëse për rastet arbitrare të arrestimit dhe ndalimit, përdorimin e dhunës nga oficerët e policisë, keqtrajtimin e të ndaluarve në dhomat e paraburgimit si dhe përdorimin e dhunës për të detyruar të ndaluarit të pranojnë fajin. Gjithashtu, ne kemi rekomanduar masa të rrepta për eliminimin e të gjitha rasteve të keqtrajtmeve nga punonjësit e policisë, dhe kjo është pasqyruar në pjesët përkatëse të këtij Raporti.

Për prokurorinë dhe gjykatat vazhdon të ketë një numër të madh ankesash, sidomos për vonesat e paarsyeshme (zvarritjet) e çështjeve gjyqësore, duke kërkuar që të paraburgosurit e padënuar të dalin para gjyqit sa më shpejt që të jetë e mundur. Në këto kushte, ne kemi rekomanduar vazhdimisht se duhet vazhduar puna për përmirësimin dhe hartimin e ligjeve të reja për luftën kundër korrupsionit brenda sistemit gjyqësor; zbatimin pa kushte të vendimeve gjyqësore; për përqasjen e legjislacionit vendas me marrëveshjet ndërkombëtare, përmirësimin e marrëdhënieve konkrete të punës së përditshme midis prokurorisë, policisë gjyqësore dhe gjykatave kundër krimit të organizuar etj.

Për të siguruar më mire të drejtën e jetës dhe të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, edhe në kuadrin e reformës në drejtësi, Avokati i Popullit ka paraqitur pranë Komisionit Parlamentar të Ligjeve si dhe pranë Ministrisë së Drejtësisë, propozimin për përgatitjen e një ligji për Investigatorin privat dhe për pjesëmarrjen e avokatit të personit të dëmtuar (viktimës), qysh në fazën e hetimit, siç e kanë edhe shumë vende të tjera të botës së qytetëruar. Njohja e këtyre dy funksioneve, me të drejta dhe detyrime proceduriale në procesin penal, do të rrisë forcën zbuluese ndaj krimeve, do të parandalojë vonesat në hetime dhe gjykime, si dhe do të reduktojë edhe korrupsionin në prokuroritë dhe gjykatat tona, veçse edhe krijohet konkurrencë dhe rriten mundësitë e individit në luftën kundër kriminalitetit.

Procesi i trajnimit dhe testimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve duhet të vazhdojë, por me kritere e kontroll të rreptë për aftësitë e tyre profesionale. Gjithashtu, atyre u duhen siguruar kushte më të mira jetese dhe sigurie për jetën e tyre. Avokati i Popullit vlerëson se ligji i ri i

miratuar kohët e fundit, në kuadër të Reformës në Drejtësi, është një përpjekje serioze në këtë fushë dhe beson se do të rrisë efektivitetin e drejtësisë shqiptare.

Njëlloj si dhe në Raportin e vitit të kaluar, edhe në këtë Raport, Avokati i Popullit përsërit shqetësimin për mospërkthimin dhe mosbotimin në Fletoren Zyrtare të të gjitha Konventave dhe akteve ndërkombëtare, të nënshkruara nga Qeveria dhe ratifikuara nga Parlamenti. Kjo situatë sjell dëme të mëdha, sepse këto tekste akoma nuk janë në përdorim të të gjitha institucioneve zyrtare të interesuara dhe në veçanti të gjykatave shqiptare, duke dëmtuar si shtetin, ashtu edhe qytetarët.

Në përfundim të kësaj paraqitjeje, theksojmë se Raporti i Avokatit të Popullit nuk përbën një pasqyrë tërësore, shteruese për nivelin e respektimit të të gjitha të drejtave që parashikojnë Kushtetuta dhe ligjet në Republikën e Shqipërisë. Ky Raport është pjesë e një sistemi informacioni, që mbetet për t'u plotësuar me të dhëna të tjera dhe nga burime të tjera.

Është e qartë për të gjithë, se përgjegjëse për gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, në çdo vend, janë Parlamenti dhe Qeveria e dalë prej tij. Avokati i Popullit mbështet vlerësimet realiste që Qeveria Shqiptare ka bërë përmes Zëdhënëses së saj, njëkohësisht Ministre e Integritimit, botuar në shtypin e përditshëm me 25 Janar 2009, ku thuhet:

“... Shqipëria po bind gjithnjë e më tepër partnerët e BE-së, se është e gatshme për të aplikuar për statusin e vendit kandidat për në këtë organizëm ... Por, tani fillojnë edhe vështirësitë më të mëdha, sepse pas çdo hapi progresiv në këtë proces, shtohen detyrime dhe përgjegjësi edhe më të mëdha. Për ne është e rëndësishme që procesi të jetë cilësor...”.

Çdo institucion duhet të bëjë punën e tij në funksion të veprimit me vizion, thënë ndryshe, të miradministrimit. Institucioni i Avokatit të Popullit e ka të qartë rolin që ka kryer dhe do të vazhdojë të kryejë me rigorozitet detyrën e tij themelore për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe rritjen e cilësisë mirëqeverisëse në Republikën e Shqipërisë.

### 3. Marrëdhëniet me Kuvendin e Shqipërisë

Institucioni i Avokatit të Popullit që nga krijimi i tij dhe në vazhdimësi ka ndjerë kujdesin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për forcimin dhe konsolidimin e tij.

Tashmë për të gjithë, si për popullin shqiptar, ashtu dhe për individët që ky popull ka zgjedhur për t'i shërbyer atij, është e qartë se ky Institucion është krijuar me ligj nga Kuvendi i Shqipërisë dhe që vetë Avokati i Popullit si person (individ), është zgjedhur po nga ky Kuvend.

Por, ne vazhdimisht deklarojmë se e ndjejmë veten, "... krahu i zgjatur i Parlamentit mbi Administratën Publike, me qëllim që gjatë zbatimit të ligjit, të punojë që të arrihen qëllimet e ligjvënësit".

Gjatë gjithë periudhës 9-vjeçare të ngritjes dhe funksionimit të institucionit të Avokatit të Popullit (2000-2008) asnjë organ apo autoritet publik nuk e ka vënë në dyshim rolin pozitiv të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për institucionin tone në vazhdimësi. Edhe gjatë vitit 2008, ashtu si në tetë vitet e mëparshme, Avokati i Popullit ka vazhduar të informojë here pas here me shkrim si Kryesinë e Kuvendit, ashtu edhe komisionet e përhershme parlamentare. Gjithashtu kemi bashkëpunuar edhe me grupe deputetësh për çështje të veçanta, si dhe kemi dhënë mendime për projektligje të veçanta, kur na është kërkuar mendimi. Një vend të veçantë kanë zënë sidomos informacionet dhe rekomandimet tona, me synim që deputetët të informohen si për shkallën e respektimit të të drejtave të njeriut nga organet, autoritetet dhe institucionet e ndryshme politike, por edhe për nxitjen e nismave legislative direkt nga vetë deputetët.

Kryesia e Kuvendit është treguar e gatshme dhe në çdo rast ka pritur homologët e Avokatit të Popullit që kanë zhvilluar vizita zyrtare tek ne si dhe ka shprehur opinionet pozitive të Kuvendit për veprimtarinë tonë.

Sipas Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë të datës 14 prill 2008 "Për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2007", Kuvendi kërkoi që për vitin 2008 t'u kushtohej vëmendje e posaçme këtyre objektivave konkrete:

- Angazhimit më të plotë të institucionit të Avokatit të Popullit për kryerjen e një punë informuese dhe sqaruese për kompetencat e tij kushtetuese dhe ligjore, si dhe për mbrojtjen e respektimin e të drejtave të njeriut;

- vendosjen e një marrëdhënie bashkëpunimi të vijueshëm me Televizionin Publik Shqiptar për të vendosur një komunikim të drejtpërdrejtë me të gjithë shtetasit shqiptarë;

- rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit të publikut për kërkimin e të drejtave të shkelura apo të mohuara;

- vendosjen e mbajtjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit e mirëkuptimit si me organizmat ndërkombëtare, ashtu edhe me forcat politike, shoqërinë civile, organizatat jofitimprurëse dhe median;

- ndjekjen deri në përmbushje të rekomandimeve të bëra dhe masave të propozuara të këtij institucioni drejtuar institucioneve shtetërore dhe administratës publike;

- denoncimin në vijimësi të shkeljeve të të drejtave të shtetasve nga administrata shtetërore, qendrore apo vendore.

Nga ky Raport që paraqesim para Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, të shoqëruar me shifrat përkatëse për veprimtaritë konkrete si në fushën e pranimit dhe zgjidhjes së kërkesave apo ankesave të shtetasve, të marrëdhënieve me mediat, bashkëpunimit me organizatat jo fitimprurëse apo rekomandimeve për nxjerrjen apo plotësimin e ligjeve apo akteve nënligjore kemi nxjerrë konkluzionin paraparak **se në tërësi gjatë vitit 2008 është punuar më mire edhe në krahasim me vitin 2007 për realizimin e objektivave që na ka caktuar Kuvendi.**

**A.** Gjatë vitit 2008 Kryesia e Kuvendit apo Komisionet e Përherëshme Parlamentare janë informuar me shkrim për 25 raste, në një kohë që në vitin 2007 janë informuar vetëm në 12 raste.

1. Rekomandimin për mospranimin e propozimit të ri të KESH sha për rritjen e çmimit të energjisë elektrike gjatë vitit 2008, më datën 15.02.2008.

2. Rekomandimin për krijimin e institucionit të edukimit, për vendosjen e të miturve që kanë kryer vepra penale, por nuk kanë mbushur moshën 14 vjeç, më datën 28.02.2008.

3. Rekomandimin për disa plotësime në Projektligjin “Për kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, më datën 07.03.2008.

4. Rekomandimin për dhënien e masave disiplinore ndaj Shefit të Komisarariatit të Policisë Vlorë, z. Asllan Shyti dhe oficerit të policisë gjyqësore z. Elidon Imeraj, si dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në dhomat e izolimit të Komisarariatit të Policisë Vlorë, më datën 16.04.2008.

5. Informacion për rekomandimet e workshopit ndërkombëtar me temë: “Të drejtat e personave të privuar nga liria dhe roli i institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut që funksionojnë sipas OPCAT” më datën 16.04.2008.

6. Rekomandimin për përmirësimin e kushteve të jetës dhe të qëndrimit të dhomave të sigurimit dhe të shoqërimit të shtetasve në organet vendore të Policisë së Shtetit, të ambienteve ku bëhet aplikimi për pajisjen me pasaporta, zbatimin e kriterëve ligjore për shoqërimin e shtetasve si dhe gjatë arrestimit apo ndalimit të tyre nga punonjësit e policisë, më datën 18.04.2008.

7. Rekomandimin për marrjen e masave të menjëhershme për eliminimin e çdo forme të dhunës, trajtimit ç’njerëzor dhe degradues në Burgun e Burrelit, më datën 02.05.2008.

8. Propozimin për kryerjen e inspektimeve të përbashkëta në disa burgje dhe dhoma paraburgimi problematike në vendin tone, bashkë me gjithë deputetët të Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, më datën 12.05.2008.



9. Informacion për rekomandimin për ndryshime të ligjit nr.9380 datë 28.04.2008 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera lidhur me të” në datën 12.05.2008.

10. Informacion për sugjerimet e Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë për ndryshimet e ligjit nr.9323 datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin Farmaceutik” më datën 27.05.2008.

11. Informacion për masat që duhen marrë për pagesën e ish punonjësve të Institutit të Fizikës Bërthamore, më datën 29.05.2008.

12. Informacion për kërkesën e 12 deputetëve (nismë legjislative), për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8661 datë 18.12.2000 “Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit” që nuk është futur në procedurat parlamentare, më datën 30.05.2008.

13. Rekomandimi për hartimin dhe më pas paraqitjen për miratim të projekt-ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronës së luajtshme”, më datën 04.06.2008. Përsëritur më datën 22.12.2008.

14. Rekomandimet për ndryshimin dhe përmirësimin e Ligjit nr.9087, date 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, më datën 04.07.2008.

15. Rekomandimin për përgatitjen e ligjit “Për hetuesin (investigatorin) privat”, më datën 09.07.2008.

16. Rekomandimet për mbrojtjen dhe respektimin e se drejtës themelore kushtetuese të individëve, të të dhënave personale dhe zbatimin korrekt të Ligjit nr.9887 date 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, më datën 04.09.2008.

17. Rekomandimet për disa shtesa e ndryshime në Kodin e Procedurës Penale dhe në Kodin e Procedurës Civile në kuadrin e Reformës në drejtësi, më datën 23.09.2008.

18. Informacion për shqyrtimin e ankesës së televizionit “News 24” për gjobën e vënë nga KKRT, më datën 24.09.2008.

19. Informacion për kërkesën për të analizuar produktet ushqimore me origjinë nga Kina që dyshohen për substanca të dëmshme për shëndetin dhe kontrollin e tregut, më 02.10.2008.

20. Rekomandimet për të bërë të mundur realizimin e detyrës së Avokatit të Popullit për ankesat kundër vendimeve gjyqësore të formës së prerë, duke bërë plotësimet e duhura në Kodin e Procedurës Penale dhe Civile, bazuar edhe në Rekomandimet e Këshillit të Evropës, më datën 02.10.2008.

21. Rekomandimin për ndryshimin e pikës 8, te nenit 55 të Ligjit nr.8410 date 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, për të zgjeruar lirinë e shprehjes, më datën 06.10.2008.

22. Informacion për ankesën e shtetasve Bep e Marije Cefa nga Shkodra, më 22.10.2008.

23. Njoftim lidhur me rastin e bërë publik në media për kanosjen, fyerjen dhe dhunimin e dy punonjësve të mjekësisë nga një punonjës policie, më datën 23.12.2008.

24. Informacion për inspektimin në Qendrën e Fëmijëve të ngjuar në Poliçan, më datën 30.12.2008.

25. Informacion mbi situatën e të Drejtave të Njeriut të konstatuar muajt e fundit gjatë veprimtarisë së Avokatit të Popullit me organet e Policisë së Shtetit, më datën 30.12.2008.

Për të gjitha rastet e mësipërme, bashkë me informacionin apo rekomandimin përkatës, Kuvendi apo Komisionet përkatëse janë informuar edhe për institucionet apo organet e administratës publike, të cilëve ju janë dërguar këto materiale, bashkë me propozimet për rrugëzgjdhjen e tyre, sipas këndvështrimit tonë.

**B.** Gjithashtu Kuvendit të Shqipërisë i janë dërguar mendimet dhe propozimet e Institucionit të Avokatit të Popullit për projektligjet e mëposhtme, për të cilat na janë kërkuar mendimet nga Komisionet përkatëse, si dhe kur ka qenë rasti kemi marrë pjesë edhe në diskutimin e tyre në komisionet parlamentare.

1. Për projekt-ligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.8328 datë 02.04.1998, Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, më datën 18.02.2008.

2. Për projektligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, më datën 06.03.2008.

3. Për projekt-ligjin “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri”, më datën 13.03.2008.

4. Për projekt ligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9418 date 20.05.2005 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, më datën 07.07.2008.

5. Për projekt-ligjin “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm”, më datën 09.09.2008.

**C.** Kryetares së Kuvendit i janë dërguar edhe tre Raporte të Veçantë:

1. Për mungesën e botimit në Fletoren Zyrtare të Akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Shteti Shqiptar, më datën 23.05.2008.

2. Për gjendjen e Shëndetit Mendor në Republikën e Shqipërisë, më datën 03.06.2008.

3. Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit në mbrojtje të të drejtave të Fëmijëve, më datën 20.11.2008.

Këto tre Raporte të Veçanta është hera e parë që u përgatiten nga ne. Ato janë bërë në përmbushje të detyrimeve tona kushtetuese si dhe për të vënë në zbatim detyrat e lëna nga Rezoluta e fundit Kuvendit të Shqipërisë për të prezantuar edhe gjatë vitit tematika të rëndësishme të gjendjes së të drejtave të njeriut në formën e Raporteve të Veçanta apo të Posaçme.

*Paraqitja e këtyre Raporteve bazohet në nenin 63, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: “Avokati i Popullit raporton përpara Kuvendit kur i kërkohet prej këtij, si dhe mund t’i kërkojë Kuvendit të dëgjohet për çështje që ai i çmon të rëndësishme”, si dhe në nenin 27 të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, ku thuhet se:*

“Përveç raportimit në kushtet e nenit 26, Avokati i Popullit mund të raportojë para Kuvendit me nismën e tij ose me kërkesën me shkrim të Kryetarit të Kuvendit ose të një grupi deputetësh. Kryetari i Kuvendit vlerëson nëse ky raportim do të bëhet:

- a. në seancë plenare;
- b. me shpërndarje të raportit;
- c. në komisionet e përhershme të Kuvendit;”

Sipas ligjit këto kopje të tre Raporteve të veçantë i janë dërguar edhe Presidentit të Republikës, Kryeministrit, si dhe organit më të lartë epror, vartësit e të cilëve janë përmendur në këto raporte, siç janë Ministri i Punëve të Jashtme, Ministri i Drejtësisë, Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministri i Shëndetësisë etj.

Ne kemi sugjeruar që këto Raporte të veçantë të shqyrtoheshin në seanca të veçanta me pjesëmarrjen e deputetëve të dy apo tre Komisioneve të përhershme siç janë: Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, Komisioni i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë apo Komisioni i Integritetit etj.

Ne kemi besuar që Kuvendi i Shqipërisë do t’i konsideronte posaçërisht dhe do t’i përdorte këto Raporte të veçanta si mjete, të cilët do të bëjnë të mundur njohjen më të mirë dhe marrjen e masave të duhura për të përmirësuar sa më shumë standardet e të drejtave të njeriut në përgjithësi, dhe në veçanti ato të të sëmurëve mendorë; apo të realizimit të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, sidomos duke krijuar një Ombudsman të veçantë për fëmijët; apo duke caktuar një Komisioner brenda institucionit të Avokatit të Popullit. Por për fat të keq për asnjërin nga këto tre Raporte të veçanta, Kryetarja e Kuvendit nuk ka proceduar sipas ligjit për të vendosur se si dhe para kujt do të shqyrtoheshin këto Raporte. Kështu që, me sa jemi në dijeni, ato nuk ju janë shpërndarë Komisioneve parlamentare që ju takojnë, por kanë qëndruar në sirtarët e aparatit juridik të Kuvendit.

Pavarësisht qëndrimin neglizhues për aspektin e tre Raporteve të veçantë, Avokati i Popullit do të vazhdojë ta ketë prioritet të tij detyrën për të informuar dhe bashkëpunuar sa më shumë me Kuvendin e Shqipërisë dhe në veçanti me Komisionet e përhershme të tij, në interes të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve shqiptarë.

#### 4. Tre Raportet e veçanta dërguar Kuvendit të Shqipërisë

Gjatë vitit 2008, për herë të parë Avokati i Popullit i ka dërguar Kuvendit të Shqipërisë tre Raporte të Veçanta.

Këto raporte janë bërë në përmbushje të detyrimeve tona kushtetuese dhe ligjore, si dhe për të vënë në zbatim detyrat e lëna nga Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë e datës 14 prill 2008 për të prezantuar gjatë vitit 2008 tematika të rëndësishme të gjendjes së të drejtave të njeriut në formën e Raporteve të Posaçme.

*Paraqitja e këtyre Raporteve bazohet në nenin 63, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: “Avokati i Popullit raporton përpara Kuvendit kur i kërkohet prej këtij, si dhe mund t’i kërkojë Kuvendit të dëgjohet për çështje që ai i çmon të rëndësishme”, si dhe në nenin 27 të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, ku thuhet se:*

“Përveç raportimit në kushtet e nenit 26, Avokati i Popullit mund të raportojë para Kuvendit me nismën e tij ose me kërkesën me shkrim të Kryetarit të Kuvendit ose të një grupi deputetësh. Kryetari i Kuvendit vlerëson nëse ky raportim do të bëhet:

- d. në seancë plenare;
- e. me shpërndarje të raportit;
- f. në komisionet e përhershme të Kuvendit;

Edhe në këto raste, kopje të këtij raporti i dërgohen Presidentit të Republikës, Kryetarit të Këshillit të Ministrave, si dhe organit më të lartë epror, vartësit e të cilëve janë përmendur në raport”.

#### **1. Raporti i veçantë Nr.1 “Për botimin në Fletoren Zyrtare të Akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Shteti Shqiptar”, dërguar më datën 23.05.2008.**

Qëllimi i këtij raporti ka qenë nxjerrja në pah e rëndësisë që paraqesin për respektimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri, aktet ndërkombëtare të ratifikuara si dhe vënia në lëvizje e institucioneve kompetente për të kryer detyrat e tyre për botimin në Fletoren Zyrtare të teksteve të përkthyer në gjuhën shqipe të të gjithë këtyre akteve ndërkombëtare, të ratifikuara nga vendi ynë, para dhe pas vitit 1990.

Duke patur parasysh faktin se Shqipëria tashmë ka nënshkruar aplikimin për t'u pranuar në një të ardhme në Bashkimin Evropian, Avokati i Popullit ka synuar që, nëpërmjet veprimtarisë së tij, të garantojë zbatimin e shtetit ligjor dhe respektimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri. Institucioni ynë, për më tepër se 7 vite nuk ka arritur që të bëjë të mundur që institucionet kompetente të shtetit shqiptar të realizojnë detyrimin kushtetues që marrëveshjet ndërkombëtare që ka ratifikuar shteti shqiptar të botohen të përkthyer në gjuhën shqipe në Fletoren Zyrtare.

Në përfundim të këtij Raporti të Veçantë kemi ritheksuar se përkthimi zyrtarisht në gjuhën shqipe dhe botimi në Fletoren Zyrtare i teksteve të akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë është një proces mjaft i rëndësishëm dhe duhet bërë me urgjencë dhe përparësi. Për këtë kemi rekomanduar:

1. Ky raport të shqyrtohej në një mbledhje të përbashkët të deputetëve përfaqësues nga Komisioni i përhershëm parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut; Komisioni për Integrimin Evropian; Komisioni për Politikën e Jashtme dhe Komisioni për Ekonominë dhe Financat. Në këtë mbledhje të ftohen të marrin pjesë edhe Ministri i Drejtësisë, Ministri i Punëve të Jashtme, Ministri i Integritit dhe Ministri i Financave për arsye se janë këto dikasteret që duhet të bashkëpunojnë që të realizohet detyra e botimit dhe publikimit të akteve ndërkombëtare. Mbledhja të kryesohej nga Kryetarja e Kuvendit ose një nga Zëvendësit e saj.

2. Mbledhja të caktonte afat për përfundimin e gjithë procesit dhe të nxjerrë detyrat konkrete të cilat do t'i realizojnë një grup pune, i krijuar me përfaqësues të të gjitha dikastereve të përfshira në këtë proces. Grupi i punës të drejtohej nga Administrata e Kuvendit.

3. Grupi i Punës ndër të tjera duhet të realizojë:

- evidentimin e akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë, teksti i të cilave nuk është botuar në Fletoren Zyrtare;
- Shpërndarjen e këtyre akteve institucioneve kompetente sipas fushës së aktit të ratifikuar për përkthimin në shqip, ose grumbullimin e tyre pranë një strukture që mund të ngrihet pranë Kuvendit të Shqipërisë, të mbështetur me fondet përkatëse për të paguar burimet njerëzore për përkthimin.
- Çertifikimin e përkthimit nga Sektori i përkthimeve në Ministrinë e Drejtësisë dhe,
- Kalimi i të gjithë materialit në Kuvendin e Shqipërisë, i cili duhet t'ja përcjellë Qendrës së Publikimeve Zyrtare për botim.

4. Në perspektivë, të planifikohet buxheti për të botuar në një përmbledhje të veçantë të gjitha aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga

Shteti Shqiptar dhe që janë bërë pjesë e së drejtës sonë të brendshme, me qëllim që si publiku, ashtu edhe organet e zbatimit të ligjit të kenë lehtësi për njohjen e këtyre akteve.

Ne shpresuam që Kuvendi i Shqipërisë do ta konsideronte dhe përdorte këtë raport të veçantë si mjet, i cili do të bëjë të mundur analizën e gjendjes në këtë fushë, do t'u kërkojë llogari dhe do të ushtrojë “presion” ndaj organeve kompetente, përgjegjëse për të përmbushur detyrimin kushtetues të botimit në Fletoren Zyrtare të gjitha teksteve të Konventave të ratifikuara.

## **2. Raporti i veçantë Nr.2 “Për Shëndetin Mendor në Republikën e Shqipërisë”**

Në këtë Raport, Avokati i Popullit është fokusuar në gjendjen e të sëmurëve mendorë dhe në trajtimin e tyre në qendrat shëndetësore. Kjo vëmendje është kushtuar për arsye se sëmundjet mendore i bëjnë këta individë qeniet më vulnerabile në shoqërinë tonë dhe më të ekspozuar ndaj dhunës, trajtimit çnjerëzor dhe degradues.

Ky dallim dhe kushtet në përgjithësi që ofron shërbimi shëndetësor për këtë kategori personash në vendin tonë janë elementet bindës që provojnë se ende në Shqipëri mungojnë kushtet për rehabilitimin dhe shoqërizimin e personave me probleme mendore. Madje ka arsye të forta për të besuar se mjedisi dhe shërbimi shpesh jashtë standarteve të Spitaleve Psikiatrike rëndon edhe më tej shëndetin mendor, duke e bërë të pamundur përmbushjen e misionit për të cilën ato janë ngritur.

Sipas raporteve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë OBSH (ËHO fact sheet 2003-2006) 47% e personave që vuajnë nga depresioni nuk marrin kurim për shkak të mungesës së një sistemi efikas shëndetësor, mos diagnostikimit apo të problemeve me mentalitetin e tyre. Ky ka qenë shkaku kryesor i rritjes së numrit të vetëvrasjeve apo ngjarjeve të tjera që kanë patur për protagoniste të sëmurët mendorë.

Përqindja e njerëzve me skizofreni në Shqipëri që nuk trajtohen me mjekim është rritur nga 36% në 45 %, gjë e cila në disa raste ka çuar që në vendin tonë të kemi raste flagrante të shfaqjes agresive të simptomave të tyre si p.sh. *Rasti i vrasjes së një të mituri në Dibër, sulmet sistematike të një të sëmurit mendor në disa zyra publike në Tiranë, tentativa e vrasjes së një kirurgu në Tiranë, vrasësi i mitur në Berat, sulmi ndaj hyrjes së selisë së Presidencës, vrasja në qendër të Qytetit të Himarës etj, të realizuara këto nga të sëmurë mendorë të diagnostikuar ose jo si të tillë.*

Në përfundim të prezantimit të një sërë çështjesh që shqetësojnë sot shërbimin mendor në vendin tonë, Avokati i Popullit parashtrori në fund të raportit disa përfundime dhe rekomandime, të cilat shpresuam që do t'i

nevojiteshin Kuvendit të Shqipërisë në reagimet e tij për përmirësimin e një sërë aspektesh të kësaj fushe.

1. Ky raport të shqyrtohej në një mbledhje të posaçme, të përbashkët, me pjesëmarrjen e deputetëve nga Komisioni i përhershëm parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, Komisioni i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë si dhe Komisioni i Ekonomisë dhe Financave. Në këtë mbledhje të ftohen të marrin pjesë Ministri i Drejtësisë, Ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Financave. Mbledhja të kryesohet nga Kryetarja e Kuvendit ose një nga zëvendësit e saj.

2. Në një kohë të përshtatshme një grup deputetësh së bashku me Avokatin e Popullit të vizitojnë disa nga Spitalet Psikiatrike dhe Qendrat Komunitare për të parë nga afër respektimin e të drejtave të pacientëve të sëmurë mendorë.

3. Mbledhja t'u kërkonte Ministrive përkatëse që të japin shpjegime për shkeljet e konstatuara në këtë raport dhe për masat që do të merrnin që të korrigjohen këto dukuri sa më shpejt.

4. Kuvendi i Shqipërisë, nëpërmjet Komisioneve të përhershme parlamentare të mbajë në një vëmendje afatgjatë problematikat e ngritura dhe në mënyrë periodike të kërkojë nga ministrat e linjave informacione.

5. Në bashkëpunim të ngushtë edhe me përfaqësues të OBSH-së dhe OJF-ve të tjera të organizohen forume të mëdha debati për mënyrat më të mira se si mund të dalë ky shërbim nga kriza që e ka përfshirë.

6. Gjendja e trajtimit të të sëmurëve mendorë në vendin tonë vijon të mbetet problematike dhe ka tendenca të rrisë shkallën e cënimit të të drejtave dhe interesave të ligjshme të pacientëve.

7. Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Drejtësisë dhe institucionet e tjera shtetërore kompetente që ofrojnë asistencën e tyre në shëndetin mendor kanë neglizhuar ndër vite të marrin në konsideratë serioze çështjet që shqetësojnë këtë kategori personash, duke dhënë një imazh negativ të këtij shërbimi.

8. Organet shtetërore nuk kanë arritur të trajtojnë me interesim të veçantë çështjet ligjore dhe nënligjore që kanë nevojë për ndryshim apo miratim, me qëllimin për të përmirësuar aspekte mjaft të rëndësishme të shëndetit mendor.

9. Ende nuk është formësuar një mentalitet i ri në administratën shtetërore që të vlerësojë dhe të tregojë rëndësinë e duhur ndaj shtresave në nevojë dhe veçanërisht ndaj të sëmurëve psikikë.

10. Shërbimi shëndetësor nuk po punon të rrite standartet e kërkuara ndaj personave me sëmundje mendore për vetë mungesën e ideve dhe strategjive për të ofruar mjek të rinj në këtë shërbim, për t'ju krijuar atyre dhe stafëve mbështetëse lehtësitë e nevojshme.

Me anë të këtyre përgjithësimeve, të cilat vijojnë të jenë një shqetësim për spitalet psikiatrike në vendin tonë, Avokati i Popullit kërkon të verë dhe një herë në vëmendje të Kuvendit të Shqipërisë faktin se një situatë e tillë është e papranueshme dhe duhet të ndryshojë sa më parë nëpërmjet një koordinimi efektiv të punës të disa ministrive dhe organeve të tjera shtetërore, duke mos përjashtuar dhe ndërmarrjen e nismave ligjore dhe nënligjore për përmirësimin e situatës.

### **3. Raporti i Veçantë Nr.3 “Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve”.**

Konventa e Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Mbi të Drejtat e Fëmijës” është konventa më e ratifikuar në të gjithë botën dhe përbën pikën më të gjerë të referencave ligjore dhe politike për çështjet e të drejtave të fëmijës.

Shqipëria e ka ratifikuar këtë Konventë më 28 Shkurt të vitit 1992. Si rrjedhojë të gjitha institucionet publike, të mbrojtjes sociale, gjykatat dhe autoritetet administrative në vendimet e tyre duhet të kenë parasysh gjithmonë, si interesin me të lartë, atë të fëmijës.

Keqtrajtimi i fëmijëve është sot një nder problemet me të mprehta me të cilat ballafaqohet shoqëria shqiptare. Gjithnjë e më tepër po behet i pranishëm realiteti i hidhur i keqtrajtimit të fëmijëve në forma të ndryshme brenda dhe jashtë familjes, duke filluar nga rrahjet, përdhunimet dhe deri tek vrasjet apo vetëvrasjet. Po kështu, Shteti shqiptar, të gjithë ne, nuk nderohemi dhe nuk duhet të na zërë gjumi derisa edhe një fëmije i vetëm do të vazhdojë të mos shkojë në shkollë për shkak të ngujimit. Ndërsa është rritur përgjegjësia ndaj disa shkeljeve të të drejtave të fëmijëve, kryesisht nga komuniteti i OJF-ve, numri i fëmijëve të cilëve nuk u janë respektuar të drejtat është duke u rritur.

Neni 54 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë garanton të drejtën e fëmijëve të kenë një mbrojtje të veçantë nga shteti. Fëmijëve u nevojitet një organizëm i posaçëm që të shumëfishojë zërat e tyre, në mënyrë që kërkesat dhe interesat e tyre të paraqiten në mënyrë sa më efektive tek Qeveria dhe shoqëria si një e tërë. Me mungesën e mekanizmit të posaçëm koordinues dhe monitorues për zbatimin e të drejtave të fëmijëve, Qeveria, komuniteti dhe OJF-të kanë kapacitete të kufizuara për të marrë masa më efektive, edhe për shkak të mungesës së burimeve njerëzore dhe financiare. Meqenëse tashmë kanë kaluar më se tre vjet që nga koha e ngritjes së Nënseksionit për të drejtat e fëmijëve, Avokati i Populli e ndjeu si detyrë dhe obligim ligjor, paraqitjen e këtij Raporti të posaçëm para Kuvendit të Shqipërisë për të bërë të njohur më në thellësi gjendjen e fëmijëve, veprimtarinë e institucionit në këtë fushë, si dhe nevojën për krijimin e bazës së nevojshme ligjore për



institucionalizimin dhe forcimin e punës për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Ky synim i fundit arrihet ose nëpërmjet shtesave e ndryshimeve në ligjin “Për Avokatin e Popullit” ose nëpërmjet krijimit të një Institucioni të posaçëm të pavarur. Objektivi themelor i krijimit të një institucioni të veçantë e të qëndrueshëm për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, është ngritja e standardeve të përmirësimit të të drejtave dhe shërbimeve për fëmijët, për të influencuar më shumë në politikën dhe praktikën e qeverisë, në zbatim të Strategjisë Kombëtare për Fëmijët si dhe të Strategjisë Kombëtare për luftën kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve, viktimat e trafikimit.

Për t’ju përgjigjur kërkesave të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës vitet e fundit, ne të gjithë botën, janë ngritur organizma të posaçëm për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve. Prandaj në mjaft vende këto detyra ju janë caktuar me ligj institucioneve të veçanta të pavarura, që shpesh quhen Ombudsmanë për fëmijët. Por në disa vende kjo detyrë ju është caktuar krahas detyrave të tjera edhe institucioneve të Ombudsmanëve Kombëtare (të përgjithshëm).

## 5. Kontributi i Avokatit të Popullit për ngritjen dhe mirëfunksionimin e institucioneve të reja në fushën e të drejtave të njeriut gjatë viteve 2006-2008

Ruajtja dhe respektimi i të drejtave të njeriut, ku sot përfshihet si e tillë edhe e drejta e miradministrimit, është një nga kriteret dhe kërkesat për vendosjen e shtetit të së drejtës dhe për zhvillimin demokratik të jetës së një vendi.

Hapat e ndërmarra në këtë proces kompleks dhe gjithëpërfshirës për shoqërinë shqiptare, identifikojnë si një domosdoshmëri dhe standard primar, ngritjen dhe konsolidimin e institucioneve të pavarura, garante për respektimin e të drejtave të njeriut.

Këto institucione janë një hallkë e rëndësishme dhe e pazëvendësueshme në tërësinë e mekanizmave publike, të cilët jo vetëm ruajnë dhe përmirësojnë punën e administratës publike në funksion të respektimit të të drejtave të njeriut, por japin ndihmesën e tyre në goditjen e fenomeneve gërryese të një shoqërie, siç është fenomeni i korrupsionit.

Zhvillimi i parë domethënës në këtë proces, është ngritja e institucionit të pavarur kushtetues të Avokatit të Popullit, që në vitin 2000. Pas më shumë se 9 vitesh veprimtarie të vlerësuar si të suksesshme, Avokati i Popullit ka krijuar tashmë fizionominë e tij të plotë. Koncepti i Ombudsmanit klasik i mishëruar tek Avokati i Popullit në Shqipëri, siç parashikohet shprehimisht në Kushtetutë, identifikon një institucion të pavarur kushtetues, monokratik, me kompetenca të posaçme dhe me

karakter rekomandues, jo vendimmarrës. Ky lloj Ombudsmani në teorinë e të drejtës kushtetuese dhe administrative njihet si Ombudsmani Parlamentar. Thelbi i kontrollit që ky institucion zhvillon dhe ka për objekt të punës së tij, bazuar në Ligjin nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, është mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të njeriut në përgjithësi, nëpërmjet kontrollit të veprimtarisë së administratës publike dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj.

Por sfida të reja janë shfaqur me nënshkrimin më 12 qershor 2006 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, si hap konkret drejt anëtarësimit në familjen evropiane.

Ky angazhim shtroi nevojën e nxitjes dhe inkurajimit të çdo iniciative dhe reforme që proceset integruese i sheh të lidhura ngushtë me nevojën për arritje dhe forcim të standarteve dhe institucioneve demokratike, sipas modeleve më të përparuara perëndimore.

Një nga përparësitë kryesore të këtij angazhimi ka qenë adoptimi i legjislacionit të brendshëm, me direktivat dhe standartet e legjislacionit të BE-së, në të gjitha fushat e përfshira në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit. Pashmangshmërisht e lidhur ngushtë me këtë angazhim, është edhe krijimi i institucioneve të reja që zgjerojnë kuadrin e nevojshëm të mekanizmave garantues të të drejtave të njeriut. Në veçanti gjatë viteve 2006-2008 ka patur një reformë pozitive në këtë drejtim, për të cilën Qeveria Berisha duhet përgëzuar.

### **1. Ombudsmani i prokurimeve, një institucion i ri i krijuar për mbrojtjen e të drejtës së miradministrimit**

Kur flasim për të drejtat e njeriut, nuk mund të lemë jashtë vëmendjes një nga të drejtat bazë që duhet të respektohet në funksionimin e administratës dhe që ka të bëjë me miradministrimin. Koncepti i miradministrimit në fushën e prokurimit publik do të thotë, mirpërdorim i fondeve publike, nxitje e konkurrencës, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues dhe sigurimi i integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik.

Reforma e ndërmarrë nga ana e Qeverisë edhe në fushën e prokurimeve publike është konkretizuar me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, ku ndër të tjera parashikohet dhe ngritja dhe funksionimi i një institucioni të ri të emërtuar Avokati i Prokurimeve.

Para hyrjes në fuqi të këtij ligji, instrumentet ligjore që kanë vepruar për kontrollin e zbatueshmërisë së legjislacionit në fushën e prokurimeve publike kanë qenë;

1. Agjencia e Prokurimit Publik (organ qendror)
2. Kontrolli i Lartë i Shtetit (institucion i pavarur kushtetues)

### 3. Auditimi i brendshëm ne sektorin publik.

Agjencia e Prokurimit Publik, parashikuar ne Ligjin nr.7971 date 26.07.1995 “Për prokurimin publik”, përfshin ne kompetencat e saj inspektimin e dokumenteve dhe proçes-verbaleve te enteve prokurorese, kryerjen e inspektimit administrativ te ankesave, dhe me e rëndësishmja, është organ i administratës publike vendim-marres, për ankesat qe paraqiten ndaj procedurave te ndryshme te tenderimit rast pas rasti nga ana e subjekteve pjesëmarrëse ne to. Ne këtë ligj përcaktohet se “vendimi i Agjencisë do të jetë përfundimtar”.

Kontrolli i Larte i Shtetit, bazuar ne Ligjin nr.8270 date 23.12.1997 “Për Kontrollin e Larte te Shtetit”, te ndryshuar, ka për objekt pune kontrollin e përdorimit efektiv dhe te dobishëm te fondeve publike, zhvillimin e miradministrimit financiar si dhe kontrollin e zbatimit te ligjshmërisë ne fushën ekonomike e financiare. Ne këtë objekt veprimtarie futet edhe kontrolli qe ushtrohet ndaj gjithë subjekteve qe përfshihen ne juridiksionin e këtij institucioni, përse i përket prokurimeve publike. Fakti është se ne baze te nenit 9 te këtij ligji, KLSH mund te japë rekomandime përse i përket kontrollit te drejtimit dhe te kontroll revizionit te brendshëm, jep opinionet e tij si dhe bën propozime përse i përket përmirësimit te mëtejshëm te legjislacionit ne fushat brenda detyrave te tij. Po kështu, nëse KLSH gjate kontrollit konstaton akte ligjore dhe nënligjore ne kundërshtim me ligjet baze, atëherë mund te kërkojë ndryshimin ose shfuqizimin e tyre nga organet qe i kane nxjerre. Pra ne thelb, ky institucion është rekomandues dhe organ kontrolli administrativ i jashtëm, ne kuadër te përdorimit te buxhetit te shtetit nga subjektet e përcaktuara ne nenin 7 te ligjit.

Një rol jo pak te rëndësishëm luan aktualisht auditimi i brendshëm, por gjithmonë për aq sa ai mund te ndikojë si një instrument vetërregullues ne veprimtarinë e subjekteve qe operojnë ne fushën e prokurimeve.

Pozicioni i Agjencisë se Prokurimit, vazhdon te mbetet i njëjtë edhe me Ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, ku ajo emërtohet si organi me i larte ne fushën e prokurimeve dhe se vendimet dhe udhëzimet e saj janë përfundimtare ne rruge administrative.

Por risia ne këtë ligj qëndron pikërisht ne parashikimin e krijimit dhe funksionimit te Institucionit te Avokatit te Prokurimeve, qe ne vetvete përfaqëson një institucion Ombudsmani me objekt te veprimtarisë se tij, mbrojtjen dhe garantimin e te drejtës se miradministrimit, si e drejte specifike ne korpusin e te drejtave te njeriut.

Natyrshëm lind pyetja, cili është profili ligjor i Avokatit (Ombudsmanit) të Prokurimeve?

Pikë së pari, duhet theksuar se ky institucion i ri është një profil i specifikuar i modelit te Ombudsmanit klasik.

Avokati i Prokurimeve përcaktohet si një institucion i pavarur, i parashikuar shprehimisht me ligj, qe mbron te drejtat dhe interesat e ligjshme te një grupimi te caktuar individësh, te cilët marrin pjese apo janë subjekte te procedimeve administrative qe zhvillohen prej autoriteteve kontraktore ne fushën e prokurimit publik.

Ne parashikimet e bëra ne nenet 14-19 te Ligjit nr.9643 date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, ai ka karakteristikat e një organi monokratik te administratës publike, qendror, me kompetenca te posaçme dhe me karakter informues-rekomandues, jo vendimmarrës.

Një kompetence dhe element i vlefshëm për veprimtarinë e tij është shfrytëzimi i insiativës se tij te pakushtëzuar kur vëren ose dyshon se ka pasur shkelje te ligjit për prokurimin publik gjate zhvillimit te procedurave përkatëse (neni 70), gjë qe vjen ne te njëjtën linje me objektin e tij specifik te punës dhe te drejtën për te monitoruar zbatimin e ligjit.

Megjithatë, gjykojmë se në këtë ligj mbetet disi e paqarte mënyra e bashkëveprimit dhe raporti qe krijohet ndërmjet Avokatit te Prokurimeve dhe Agjencisë së Prokurimit Publik.

Pyetja e pare qe mund te ngrihet për aq sa parashikohet ne ligj, është nëse vete Agjencia e Prokurimit Publik, përfshihet apo jo ne juridiksionin e Avokatit te Prokurimeve. E thënë ndryshe, a është Agjencia e Prokurimit Publik një autoritet kontraktor, veç funksioneve te tjera qe asaj i njihen me ligj?

Gjykojmë se ne rastet kur autoriteti kontraktor është çdo subjekt tjetër qe parashikohet si i tille ne Ligjin nr.9643 date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, pozicioni i Avokatit te Prokurimit është me i qarte, pasi ai zhvillon procedurën e vet te hetimit apo monitorimit dhe pasi ka nxjerre konkluzionet përkatëse, mbyll hetimin ne një nga mënyrat e parashikuara ne nenin 71/1, ku gjithsesi ai detyrohet t’i dërgojë një *informacion* APP-se, apo t’i *raportoje* autoritetit kompetent shkeljen e qëllimshme te ligjit për prokurimet nga ana e një zyrtari te caktuar te autoritetit kontraktor.

Terminologjia e përdorur “informon”, apo “raporton”, nuk është korrekte për funksionin e një ombudsmani ne këtë rast.

Nuk është e qarte dhe nuk thuhet shprehimisht ne ligj se, çfarë vlere apo fuqie detyruese ka informacioni qe i dërgohet ne këto raste APP-se. Po kështu mbetet krejtësisht i paqarte parashikimi i bere ne paragrafin e dyte te pikës 2, te nenit 70, te Ligjit nr.9643 date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, ku thuhet shprehimisht se:

*“Kur Agjencia e Prokurimit Publik është duke shqyrtuar ankesën me te njëjtin objekt, Avokati i Prokurimeve bashkërendon veprimet për realizimin e hetimit”.*

Nga këto parashikime të bëra në ligj, vërehet një disproporcion mes qëllimit dhe konceptimit ligjor për krijimin e këtij institucioni, si ombudsman parlamentar (pasi ai zgjidhet nga parlamenti) dhe kompetencave që atij i janë dhënë shprehimisht, në nenet 69-71 dhe nenet 73-74 të ligjit.

Te krijohet ideja se veprimtaria e këtij institucioni është pjesë e veprimtarisë së një strukture mbështetëse të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe jo një funksion normal i një Ombudsmeni, që veç subjekteve të tjera të juridiksionit të tij, mund të kontrollojë edhe APP-ne.

I vetmi moment ku del qartë roli rekomandues i Avokatit të Prokurimeve, është e drejta për rekomandimin e propozimeve për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjit apo akteve të tjera normative të nxjerra në zbatim të tij, kur përmbajtja e tyre krijon premisa për shkelje të procedurave të prokurimit publik (neni 74).

Nga praktika e Institucionit të Avokatit të Popullit, deri në hyrjen në fuqi të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, konstatohet se ngelej shumë pak vend për ndërhyrje nga ana e një ombudsmeni në procesin e prokurimeve. Ky fakt lidhet me atë që si shkallë ankimi administrativ, legjislacioni kishte parashikuar se pari, entin publik dhe me pas Agjencinë e Prokurimit Publik, ndërkohë që përfundimisht mbetet ankimi në rrugë gjyqësore i çështjes.

Vërejmë se kjo strukture e ankimit administrativ ndaj vendimeve që merren ose mosveprimeve për këtë qëllim, gjatë procedurave të prokurimit publik, ruhet e njëjtë në nenin 63 të ligjit në fuqi “Për prokurimin publik”.

Pra, sikurse Avokati i Popullit edhe Avokati i Prokurimeve nuk mund të konsiderohet shkallë e ankimit administrativ. Megjithatë, mbetet krejtësisht e paparashikuar mundësia e Avokatit të Prokurimeve për të kontrolluar APP-ne në respektimin e kërkesave procedurale ligjore të ankimeve që paraqiten tek ky organ, për procedura të ndryshme tenderimi.

Efektivisht, roli i institucionit të referuar atyre pak rasteve që kemi shqyrtuar në lidhje me prokurimet publike, ka qenë konstatimi për mënyrën se si është vepruar në kuadër të respektimit të afateve të procedimit nga ana e Agjencisë së Prokurimit dhe nga ana tjetër të respektimit apo jo të vendimeve të saj, nga ana e enteve të ndryshme prokuruese.

Që në fillim të lançimit të idesë për krijimin e një Ombudsmeni për Prokurimet, duke patur parasysh legjislacionin ekzistues dhe atë që ka përfaqësuar një Ombudsman, ka qenë e qartë se është e pamundur që një institucion i tillë të marrë vendime të karakterit përfundimtar, për çështje të cilat ankimohen në rrugë administrative.

Kjo vlen edhe ne rastin kur nuk do te kishim një ombudsman parlamentar, por te tille qe mandatohet nga ana e qeverise.

Aktualisht kemi një institucion te ri te krijuar për fushën e prokurimit publik, qe me sa duket me tepër është qëllimuar për informimin e Agjencisë se Prokurimit Publik, se sa për evidentimin e shkeljeve dhe rekomandimin e masave qe duhen marre për vënien e se drejtës se shkelur ne vend, qofte nga autoriteti kontraktues, qofte edhe nga vete Agjencia e Prokurimit Publik.

Kjo forme e konceptimit te Ombudsmanit te Prokurimeve, gjykojmë se nuk ndihmon sa duhet ne realizimin e miradministrimit, pasi nuk mund te raportohet ne Kuvend, qofte për punën e një viti, apo qofte për kërkesa te veçanta (pikat 1,2 neni 18), mbi bazën e informacionit qe i dërgohet Agjencisë se Prokurimit Publik.

Çfarë do te ndodhte nëse APP-ja nuk do te reagonte ndaj informacioneve qe i dërgohen nga ana e Avokatit te Prokurimeve? Këtë pyetje legjislatori e ka lënë pa përgjigje??

Në fakt Qeveria dhe iniciatorët e projektit nuk bashkëpunuan me Avokatin e Popullit për asnjë moment apo aspekt gjatë hartimit të këtij ligji. Po të kishin bashkëpunuar mbase do të ishin eliminuar të metat e mësipërme.

Por këto konstatime do t'i lenë vend periudhës kohore qe cilësohet si periudha transitore e zbatimit te ligjit. Gjate kësaj kohe do te evidentohet edhe eficaenca e këtij institucioni te ri dhe rolin qe ai luan ose duhej te luante ne fushën e prokurimeve.

Është me se e natyrshme qe ne këtë kontribut te përbashkët institucional ne mbrojtje dhe respektim te te drejtave te njeriut, te bashkëpunojmë intensivisht edhe me këtë institucion te ri, fakt qe nuk mund te na përjashtojë nga proceset e ideimit apo hartimit te drafteve ligjore qe, mundësojnë krijimin dhe funksionimin e institucioneve analoge ne vend.

## **2. Krijimi i Komisionerit për mbrojtjen e te dhënave personale, si një “Autoritet Mbikëqyrës”**

Avokati i Popullit si një institucion për mbrojtjen dhe respektimin e te drejtave te njeriut, gjate viteve 2000-2008 ka dhënë kontributin e tij edhe ne fushën e mbrojtjes se te dhënave personale. Kjo eksperience është e lidhur jo vetëm me trajtimin e çështjeve konkrete, por edhe me ndihmën e vazhdueshme qe i është dhënë institucioneve te tjera shtetërorë ne hartimin e legjislacionit ne këtë fushe.

Ratifikimi nga ana e shtetit tone te Konventës “Për mbrojtjen e individëve ne lidhje me përpunimin automatik te të dhënave personale” me ligjin nr.9288, date 7.10.2004 dhe Protokollit te saj shtese “Mbi

mbrojtjen e individëve ne lidhje me përpunimin automatik te te dhënave personale nga organet mbikëqyrëse dhe fluksi ndërkufitar i te dhënave”, me ligjin nr.9287 date 7.10.2004, parashikon te drejtat dhe përgjegjësitë qe merr përsipër pala nënshkruese për respektimin e te drejtës për mbrojtjen e te dhënave personale, ndaj përpunimit automatik te tyre.

Konkretisht, një nga përgjegjësitë e palës nënshkruese ne baze te nenit 1 te Protokollit Shtese te Konventës, është ngritja e një “Autoriteti Mbikqyrës”, i cili do te gëzojë pushtet investigues dhe ndërhyrës, si dhe qe ka si kompetence përfshirjen e tij ne procedurat gjyqësore, duke sjelle para autoriteteve juridike kompetente rastet e dhunimit te parimeve baze te Konventës.

Për këtë çështje, ne datën 23.03.2007, Avokati i Popullit ka pritur ne një takim një delegacion te Këshillit te Evropës, te përbëre nga z. Emilio Aced Felez, z. Graham Sutton dhe zj. Sophie Meudal Leenders, eksperte të Këshillit të Evropës ne fushën e mbrojtjes se te dhënave personale, ku u diskutua në lidhje me vlerësimin e situatës për mbrojtjen e te dhënave personale ne Shqipëri. Thelbi i gjithë diskutimit te zhvilluar, veç te tjerave, u përqendrua ne faktin nëse është dhe a mund te jete “Autoriteti Mbikqyrës”, Institucioni i Avokatit te Popullit ne Shqiperi? Faktikisht, ne nenin 15 te Ligjit nr.8517 date 22.07.1999 “Per mbrojtjen e te dhënave personale”, përcaktohej se;

“Ankimi tek Avokati i Popullit dhe kompetencat e tij ne fushën e te dhënave personale rregullohen nga ligji nr.8454 date 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

Avokati i Popullit krijon një regjistër te trajtimit te te dhënave personale”.

Rastet e ankesave kane qene te pakta. Por edhe regjistri nuk është krijuar, sepse vete ligji nuk ishte i qarte ne përcaktimin konkret se çfarë do te kuptohej me regjistrin e trajtimit te te dhënave personale qe duhej te mbahej nga Avokati i Popullit si dhe nga ana tjetër, si do te aplikohet ky regjistër brenda kuadrit te kompetencave te Avokatit te Popullit, pa dubluar funksionin e regjistrave te protokollit apo arkivës se institucionit??

Pas këtyre diskutimeve, Avokati i Popullit ka mbajtur qëndrimin se nuk mund te ishte Institucioni i Avokatit te Popullit, “Autoriteti Mbikqyrës” i përcaktuar ne termat e dhëna te Protokollit Shtese te Konventës “Për mbrojtjen e individëve ne lidhje me përpunimin automatik te te dhënave personale”, për këto arsye:

1. Sipas protokollit shtese, “Autoriteti Mbikqyrës” duhet te jete një organ i pavarur, i cili ka kompetencën e hetimit dhe ndërhyrjes, si dhe kompetencën për t’u përfshirë ne procese gjyqësore, për te sjelle ne vëmendjen e organeve kompetente gjyqësore shkeljen e dispozitave te ligjit te brendshëm (neni 1 / 2a). Avokati i Popullit është një organ i

pavarur kushtetues, por edhe pse ai ka kompetenca investiguese dhe ndërmjetësimi (dhe jo ne termat e ndërhyrjes), ai nuk mund të përfshihet në procese gjyqësore, veç rasteve që kanë të bëjnë me çështje që i përkasin në kuptimin privat atij vete si institucion.

2. Legjislacioni i vendeve të tjera në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, në rrethin e subjekteve të cilët futen në juridiksionin e ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, përfshinte edhe subjektet private të cilët përpunojnë të dhënat personale. Ligji “Për Avokatin e Popullit”, e kufizon rrethin e subjekteve në juridiksionin e tij vetëm tek administrata publike dhe të tjeret që veprojnë për llogari të saj por jo ndaj subjekteve private. Edhe ky fakt tregon ndryshimin e një organi mbikqyrës në këtë kontekst me Avokatin e Popullit.

3. “Autoriteti Mbikqyrës” paraqitet si i pavarur, ai përkufizohet në termat e organit vendimmarrës dhe si një hallkë efektive e ankimit administrativ. Kurse Avokati i Popullit është një organ i pavarur, por ai vepron në termat e ndërmjetësimi (dhe jo ndërhyrjes) dhe të rekomandimit (e jo të vendimmarrjes). Për më tepër që ai nuk mund të konsiderohet si hallkë efektive e ankimit administrativ. Për këto arsye, Avokati i Popullit (Ombudsmeni) për nga vete natyra klasike, natyre që është përcaktuar në Kushtetutën Shqiptare dhe mishëruar në Ligjin nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, nuk ka pika takimi të ndjeshme dhe nuk mund të konsiderohej “Organ Mbikqyrës” për mbrojtjen e të dhënave personale.

4. Vendimet e “Autoriteteve Mbikqyrëse”, kundër të cilëve ka ankesa, mund të apelojnë në gjykatë. Në thelb dhe për nga natyra e tij klasike, si institucion i parashikuar në Kushtetute, Avokati i Popullit si produkt i tij përfundimtar njihë rekomandimet dhe propozimet dhe jo vendimet. Po kështu nisur nga parashikimet e bëra në Ligjin “Për Avokatin e Popullit”, të gjitha përgjigjet apo rekomandimet e këtij institucioni nuk mund të ankimohen sikurse aktet administrative (në 131 i Kodit të Procedurës Administrative), pasi vete natyra e tij nuk e përfshin atë në rrethin e organeve të administratës publike që mund të konsiderohen si hallka të ankimit administrativ, për çështje që futen në objektin e shqyrtimit nga ana e tij.

5. Në qoftë se kjo detyrë do t’i caktohej Avokatit të Popullit me këto terma kërkohej detyrimisht ndryshimi i Kushtetues së Republikës së Shqipërisë, që është një proces jo i lehtë, pasi kërkon votim të cilësuar (jo me pak se 93 vota).

6. Eksperiencat e vendeve të tjera si p.sh ajo e Spanjës, ka treguar se nuk është e lehtë t’i atribuosh Avokatit të Popullit një detyrë të tillë, sikurse është ajo e një organi mbikqyrës për mbrojtjen e të dhënave personale, ndaj edhe janë krijuar organizma të tjerë me efikasë. Për më tepër edhe atje ku ekziston një Ombudsman me funksion mbrojtjen e të



dhënave personale, ky i fundit nuk ka një objekt kaq te gjere pune, sikurse ka Avokati i Popullit ne Shqipëri. Ky qëndrim është mbajtur nga ana jone ne shkresën nr.65 date 3.04.2007, drejtuar Kryeministrit dhe Ministrit te Drejtësisë. Duke patur parasysh edhe sa me sipër, edhe Institucioni i Avokatit te Popullit, ka luajtur një rol shume aktiv gjate procesit te përgatitjes se këtij ligji, duke dhënë mendime dhe duke mbajtur qëndrime konkrete, për te dyja draftet paraprake qe janë diskutuar deri ne miratimin e ligjit.

Ky qëndrim është mbajtur nga ana e institucionit tone edhe ne takimin e zhvilluar nga ana e Ministrisë se Drejtësisë, ne datën 18 Tetor 2007, ku është diskutuar draft projektligji i parë.

Eksperienca e vendeve te tjera si Hungaria apo Kanadaja, ka evidentuar ekzistencën e ombudsmaneve apo komisionerëve për mbrojtjen e te dhënave personale dhe te se drejtës për informim. Megjithatë, fizionomia e tyre mbetet e njëjtë me atë te institucionit te Avokatit te Popullit tek ne dhe nuk mund te pretendohet se kane funksionet e një “Autoriteti Mbikëqyrës”. Ne vende te tjera si Italia, janë ngritur organe te veçanta si “Garanti për Mbrojtjen e te Dhënave Personale”, organe te cilat kane një juridiksion me te gjere se sa një Ombudsman dhe kompetenca te një lloji tjetër, por qe përsëri nuk mund te cilësohen si “Autoritet Mbikëqyrës”.

Si konkluzion te mendimeve tona dërguar Ministrisë se Drejtësisë për draft projektligjin e pare, kemi gjykuar se i formuluar ne këtë forme dhe me këtë përmbajtje, ai nuk i mundësonte efektivisht Avokatit te Popullit marrjen përsipër te funksionit te “Autoritetit Mbikëqyrës”.

Gjithashtu, kemi gjykuar se ekzistenca e këtyre problemeve te harmonizimit te legjislacionit te brendshëm, kërkonte një ripunim apo hartim te një projektligji te ri, duke respektuar jo vetëm ato çfarë kërkoheshin dhe përcaktoheshin ne marrëveshjet ndërkombëtare te ratifikuara nga shteti ynë ne fushën e mbrojtjes se te dhënave personale, por ne radhe te pare Kushtetutën e Republikës se Shqipërisë.

Këto mendime tonat janë dhenë, bazuar ne eksperiencën tone te deritanishme dhe nisur nga roli specifik qe luan Avokati i Popullit ne procesin e mbrojtjes se te dhënave personale.

Mendimet e dhëna nga ana e Institucionit tone dhe nga ana e një sere aktoreve te tjerë kryesore ne fushën e mbrojtjes se te dhënave personale, kane qene pjese e reflektimit pozitiv nga ana e Ministrisë se Drejtësisë gjate përgatitjes se draft projektligjit te dyte, “Për mbrojtjen e te dhënave personale”.

Ne procesin e përgatitjes se këtij projektligji, institucioni ynë ka dhënë mendimet e tij te cilat, kane shërbyer si baze per variantin e dërguar per procedure miratimi ne Kuvend.

Pas procedurës së miratimit të këtij drafti në Kuvendin e Shqipërisë, ka hyrë në fuqi Ligji nr.9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i cili mendohet se në përgjithësi përfaqëson një përpjekje të dukshme për përmirësimin dhe plotësimin e kuadrit ligjor në vend, duke krijuar bazën ligjore të nevojshme për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave personale.

Në kreun e tetë të ligjit (nenet 29-39), parashikohet ngritja e autoriteti përgjegjës për mbikqyrjen e mbrojtjes së të dhënave personale, të emërtuar Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ai parashikohet si një autoritet i pavarur i krijuar me ligj.

Ngritja e këtij autoriteti vjen si një përmbushje e detyrimit të shprehur në Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit, ku përcaktohet se: “Shqipëria do të ngrejë organe mbikqyrëse të pavarura, me burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për të monitoruar dhe garantuar në mënyrë efektive zbatimin e legjislacionit të brendshëm për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Kompetenca më kryesore e Komisionerit është mbikqyrja dhe monitorimi i procesit të përpunimit të të dhënave, duke e shtrirë veprimtarinë e tij, si mbi autoritetet e administratës publike, ashtu edhe mbi ato private. Në kompetencat e dhëna dallohen, nxjerrja e udhëzimeve, ku përcaktohet koha e mbajtjes së të dhënave personale, sipas qëllimit të tyre, në veprimtarinë e sektorëve të veçantë; zgjidhja e ankimeve të çdo personi për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tij, për përpunimet e të dhënave personale dhe vënia e tij në dijeni për ecurinë; kontrolli i zbatimit të gjobave; përgatitja në bashkëpunim të kodeve të etikës, krijimi i një regjistri për dokumentimin e të gjitha njoftimeve dhe autorizimeve, që ai kryen në ushtrim të kompetencave të tij.

Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale, në përcaktimet e bëra në ligj, është një organ vendimmarrës (neni 30, neni 31) dhe hallkë ankimi administrativ (neni 16/1).

Ndërkohë, duke analizuar gjithë kompetencat që i jepen këtij organi gjykojmë se, është e pakuptimtë përmbajtja e nenit 30/2, në të cilën thuhet që:

“Komisioneri, në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme, të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

Funksionimi i këtij institucioni të ri të pavarur, të krijuar me ligj dhe kompetencat që atij i janë dhënë e radhisin në grupimin e organeve vendimmarrëse dhe jo rekomanduese, ndaj edhe pjesa e moszbatimit të rekomandimeve e parashikuar këtu, mendohet se është e pakuptimtë dhe nuk ndjek rrjedhën e parashikimeve të ligjit.

Nisur nga koha e krijimit te këtij institucioni te ri, gjykojmë se është ende herët për te folur lidhur me performancën dhe efektivitetin e tij. Por nga ana tjetër, konstatojmë se ende nuk ka filluar funksionimi normal i këtij institucioni, megjithëse ligji ka hyre ne fuqi qe ne muajin Maj te vitit 2008. Gjithsesi është zgjedhur Komisionerja, është miratuar organika dhe buxheti për vitin 2009. Me datën 4.02.2009 u organizua edhe Konferenca e pare promovuese e këtij institucioni.

Gjithashtu, gjykojmë se ne këtë ligj, ndeshen probleme kushtetuese qe kane te bejne me përmbajtjen e dispozitave te caktuara te tij.

Kështu, në nenin 7 të ligjit, trajtohet përpunimi i të dhënave sensitive, të cilat përbëjnë një nga rastet përjashtimore të përpunimit, duke respektuar të drejtën e subjektit për ruajtjen e sekretit. Edhe në këtë ligj, sikurse në ligjin e vitit 1999, ruhet elementi i dhënies së pëlqimit në rastin e përpunimit të të dhënave sensitive, pëlqim që mund të revokohet në çdo çast nga subjekti i të dhënave. Njëkohësisht në këtë nen janë përcaktuar rastet, në të cilat përjashtohet kushti i domosdoshëm i dhënies së pëlqimit, si p.sh kur autorizohet nga autoriteti përgjegjës për një interes të rëndësishëm publik, kur të dhënat janë bërë haptazi publike nga vetë subjekti i tyre, ose kur përpunimi është i nevojshëm për ushtrimin apo mbrojtjen e një të drejte ligjore, përpunimi është i nevojshëm për përmbushjen e detyrimit ligjor dhe të drejtave specifike të kontrolluesit në fushën e punësimit, në përputhje me Kodin e Punës, etj.

Gjykojmë se në këtë nen mbetet shumë problematik përkufizimi i dhënë në pikën tre të tij, ku thuhet që: *“Përpunimi i të dhënave sensitive, në rrethana të tjera nga ato të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm për qëllime të interesave të rëndësishëm publikë, nën masa të përshtatshme mbrojtjeje”*.

Kjo pasi ky përcaktim nuk vjen në përputhje me parashikimin e bërë në nenin 17 të Kushtetutës, lidhur me kufizimin e të drejtave dhe lirive të parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ku thuhet që:

“1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.

2. Këto kufizime nuk mund të çenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

Edhe në logjikën e ndërtimit të vetë këtij neni evidentohet se, rasti i parashikuar në pikën 2/c është një përjashtim, që lidhet me një kufizim në mbrojtjen e të dhënave personale sensitive të subjektit përkatës të të dhënave personale, për një interes të rëndësishëm publik. Pra duhet bërë një rregullim me ligj dhe jo me vendim te Qeverise.

Ne vazhdim, përcaktimi i bërë në nenin 11 të ligjit, gjykojmë se nuk ruan një balancë të drejtë të raportit të ruajtjes dhe respektimit të të drejtave dhe lirive vetjake themelore të njeriut, të parashikuara shprehimisht në Kushtetutë.

Në këtë nen thuhet shprehimisht që:

“Përpunimi i të dhënave personale vetëm për qëllime gazetarie, literature ose artistike përjashtohet nga zbatimi i neneve 5,6,7,8,12,18,21 e 28 të këtij ligji, vetëm nëse ruajtja e konfidencialitetit, sipas këtyre dispozitave, pengon ushtrimin e të drejtës së lirisë së shprehjes”.

Është pranuar tashmë se të drejtat themelore të individit nuk janë të pakufizuara dhe kufizimi qëndron pikërisht aty ku e drejta e individit ndeshet në radhe të parë me të drejtën konkrete të një individi tjetër, apo kur peshorja anon dukshëm nga interesi publik dhe jo nga interesi i ngushtë i individit. Në këtë kuptim, kushdo që përpunon të dhëna personale vetëm për qëllime gazetarie, literature ose artistike, do të ndeshet në radhë të parë me të drejtën e individit, subjekt i këtyre të dhënave personale, për t’i mbrojtur ato. A duhet në këtë rast që ruajtja e konfidencialitetit si një e drejtë themelore e individit për mbrojtjen e të dhënave të tij personale, të dalë si një pengesë e dorës së dytë, ndaj të drejtës së lirisë së shprehjes së gazetarit apo çdo subjekti tjetër të parashikuar sipas këtij neni? A ka një interes publik konkret në përpunimin e të dhënave personale siç parashikohet në këtë nen? A mundet që një nen i tillë përgjithësues të mbulojë çdo rast specifik të përpunimit të të dhënave personale vetëm për qëllime gazetarie, literature ose artistike? Mendojmë që jo. Është e vërtetë se liria e shprehjes nuk i nënshtrohet censurës paraprake, por kjo censurë nuk ka të bëjë me mospasjen e të drejtës së individit për të mbrojtur të dhënat e tij personale. Në këtë përcaktim gjykojmë se veç sa më lart, nuk është marrë parasysh as legjislacioni në fuqi për Arkivat.

Pavarësisht këtyre konstatimeve, mendojmë se përmirësimi i legjislacionit të brendshëm në kuadër të mbrojtjes dhe garantimit të të drejtave themelore të njeriut, si dhe arritja e standardeve të kërkuara në këtë drejtim, është një proces kompleks i cili, kërkon pjesëmarrjen e të gjithë aktoreve që kontribuojnë në këtë fushe.

Me kënaqësi konstatojmë se koordinimi dhe rrahja e mendimeve alternative nga Avokati i Popullit dhe Ministria e Drejtësisë ka rezultuar shumë pozitive në këtë rast dhe me një produkt që është i gjithëpranueshëm nga të gjithë aktoret dhe faktorët në vend, për të realizuar një kuadër sa më të plotë dhe bashkëkohor ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.

### **3. Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Dënimin të egër, çnjerëzor ose poshtërues**

Pas ratifikimit nga ana e Kuvendit të Shqipërisë, me ligjin nr.9094, datë 03.07.2003, të Protokollit Opsional të Konventës kundër Torturës dhe trajtimit ose dënimit të egër, në nenin 17 të tij përcaktohej ndër të tjera një nga kërkesat kryesore të detyrueshme për zbatim nga ana e shtetit tone dhe me konkretisht:

“Çdo Shtet Palë mban, emëron ose krijon, jo më vonë se një vit pas hyrjes në fuqi të këtij protokollit ose të ratifikimit apo të aderimit, një ose disa mekanizma të pavarur, kombëtar parandalues për parandalimin e torturës në nivel kombëtar. Mekanizmat e krijuar si njësi të decentralizuara mund të emërohen si mekanizma kombëtare parandalues për qëllimet e këtij protokollit, nëse ato janë në pajtim me dispozitat e tij”.

Në dispozitat vijuese të këtij Protokollit, tashme pjesë e legjislacionit tone të brendshëm, kërkohet që nga shtetet palë të garantohet pavarësia funksionale dhe e personelit për këto mekanizma, vënia në dispozicion e burimeve të nevojshme (njerëzore dhe financiare) për funksionimin e tyre, dhënia e kompetencave të nevojshme për të realizuar këtë detyrë etj.

Fakti është se, megjithëse shteti ynë prej vitit 2003 kishte detyrimin ligjor për ngritjen e mekanizmave të pavarur, kombëtar parandalues për parandalimin e torturës në nivel kombëtar, deri në vitin 2007 ende nuk i kishte krijuar ato.

Duke qenë i ndjeshëm ndaj performancës konkrete dhe ushtrimit të përgjegjësisë institucionale, si dhe arritjes së standardeve të kërkuara në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, dhe sidomos të parandalimit të torturës, si një nga shfaqjet më të ashpra të shkeljes së të drejtave të njeriut, Avokati i Popullit ka qenë gjithmonë kërkues dhe shumë aktiv për përmbushjen e kërkesave të Protokollit Opsional të Konventës kundër Torturës dhe trajtimit ose dënimit të egër.

Që nga viti 2005, Avokati i Popullit i ka drejtuar Kuvendit të Shqipërisë një sërë rekomandimesh të perseritura për një ndryshim përkatës në Nenin 86 të Kodit Penal, për t'i bërë Torturës përkufizimin adekuat, në përputhje me konventat ndërkombëtare, ndryshim i cili u realizua në mars të vitit 2007.

Në funksion të këtij qëllimi ka qenë organizimi më datën 26.07.2007, nga ana e Avokatit të Popullit në bashkëpunim me Qendrën Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe Torturës të Konferencës së parë Kombëtare me temë “Drejt një Shqipërie pa torturë”.

Pas kësaj Konference, më datën 06.09.2007, duke shqyrtuar këto kërkesa të Protokollit, veprimtarinë konkrete disa vjeçare të institucionit të Avokatit të Popullit për parandalimin, hetimin dhe vënien para

përgjegjësisë të personave zyrtarë që kanë kryer vepra torture, si dhe krahasuar kompetencat e ligjit nr.9094 datë 03.07.2003 me ato të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999, të ndryshuar “Për Avokatin e Popullit”, që janë të njëjta, Avokati i Popullit iu drejtua Qeverisë dhe Kuvendit me propozimin për emërimin (ngarkimin me detyrë) të institucionit të Avokatit të Popullit si Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e Torturës.

Në kete propozim u theksua se:

1. Ngritja e Mekanizmit Kombëtar është detyrim ndërkombëtar dhe kërkesa e ligjit përkatës shqiptar.

2. Në qoftë se do të pajtoheshin me mendimin për të ngarkuar Avokatin e Popullit me këtë detyrë, nuk do të ishte nevoja për të nxjerrë ndonjë ligj të veçantë apo akt të Qeverisë për këtë qëllim. Do të mjaftonte që Kuvendi i Shqipërisë, në Rezolutën që do të përpilonte pasi të shqyrtonte Raportin për veprimtarinë tone gjatë vitit 2007, të na ngarkonte detyrën e Mekanizmit kombëtar për parandalimin e Torturës. Theksuam se aktualisht Avokati i Popullit nuk ishte penguar dhe faktikisht i kishte hetuar rastet e torturës dhe dhunës për të cilat kish patur ankesa, bazuar në ligjin “Për Avokatin e Popullit”. Pra nuk bëhej fjalë për ndonjë “fuqizim me kompetenca” të Avokatit të Popullit, veçse për specifikim të tyre në një fushë tepër të ndjeshme, siç është tortura dhe trajtimi çnjerëzor.

3. Për të mos krijuar organizma të reja që rrjedhimisht do të kishin kosto financiare të konsiderueshme për buxhetin e shtetit për paga për personelin, përgatitje dhe kualifikim të tyre, godinë (zyra), mjete pune, etj; detyrat e Mekanizmit t’i ngarkohej Avokatit të Popullit.

4. Për këtë Avokati i Popullit kërkoi vetëm një shtesë personeli prej 5 personash dhe fondin përkatës të pagave nga buxheti i shtetit për vitin 2008 e në vazhdim. Shtesa prej 5 specialistësh do të quhej Mekanizëm apo “nënseksion” dhe do të shërbente për të hetuar pa përjashtim gjithë rastet e torturës, për të inspektuar më në gjerësi dhe thellësi gjithë burgjet, dhomat e paraburgimit etj, dhe sidomos për të organizuar dhe zhvilluar më tepër veprimtarinë parandaluese. Për t’i dalë para këtij propozimi, në projekt buxhetin e institucionit tonë për vitin 2008, është nënvizuar kjo kërkesë.

Duke e vlerësuar si realist kete propozim, Qeveria dhe Kuvendi e pranuan dhe u miratua shtesa e personelit prej 5 personash për vitin 2008. Gjithashtu, nga buxheti i shtetit për vitin 2008 na u miratua pjesërisht edhe fondi i pagave.

Megjithate, hapi kryesor dhe shume pozitiv ne kete drejtim eshte realizuar nga ana e Kuvendit me miratimin e Ligjit nr.9888 date 10.03.2008 “Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin nr.8328 date 16.04.1998 “Per te drejtat dhe trajtimin e te dënuarve me burgim”, te ndryshuar”. Ne nenin 74/1 te këtij ligji u parashikua ngritja e Mekanizmit

Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, si një strukturë e veçantë nën autoritetin e Avokatit të Popullit.

Kompetencat e kësaj strukture të re, siç parashikohet në paragrafin e dytë të nenit 74/1 të ligjit, janë:

-vëzhgimi rregullisht i trajtimit të individëve, që u është hequr liria në vendet e ndalimit, arrestimit ose burgosjes, me qëllim që të forcohet, kur është e nevojshme, mbrojtja e individëve nga tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues;

-paraqitja e rekomandimeve për organet përkatëse, me qëllim përmirësimin e trajtimit dhe kushteve të individëve që u është hequr liria dhe të parandalimit të torturës dhe trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues.

Njëkohësisht në nenet 74/2 dhe 74/3 të ligjit, janë parashikuar garancitë ligjore dhe mekanizmat e mbikqyrjes të veprimtarisë së Mekanizmit Kombëtar.

Ky Mekanizëm ka filluar veprimtarinë e tij si strukturë e posaçme brenda institucionit të Avokatit të Popullit që nga qershori 2008.

Gjatë kësaj kohe të shkurter që nga krijimi i tij, Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, ka kryer një aktivitet shumë të dendur dhe sensibilizues në të gjitha qendrat ku ekziston rrezik i vazhdueshëm dhe potencial për shkeljen e të drejtës për mbrojtjen e individëve nga tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues.

Jane të shumta rekomandimet që i janë dërguar organeve përkatëse shtetërore për përmirësimin e trajtimit dhe kushteve të individëve që u është hequr liria dhe të parandalimit të torturës dhe trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues.

Nepermjet strukture së Mekanizmit Kombëtar, Avokati i Popullit ka kritikuar edhe Prokurorinë dhe Gjykatat, për rastet, kur nga policia janë dërguar para tyre persona të ndaluar, me shenja të dukshme dhune, sepse në shumë pak raste janë vënë para përgjegjësisë personat përgjegjës.

Po kështu, në vijim të rekomandimit të Komitetit të Këshillit të Europës kundër Torturës (CPT) në do vazhdojmë të sugjerojmë që të gjitha autoritetet më të larta të Shtetit, Presidenti, Kryeministri, Ministrat e Drejtësisë e të Brendshëm, Prokurorja e Përgjithshme etj, të japin herë pas here mesazhe kundër akteve të torturës dhe për vënien para përgjegjësisë të zyrtarëve që zbatojnë atë. Është kënaqësi që gjatë vitit 2008 kryeministri Berisha e ka bërë këtë praktikë në tre raste. Në gjykojmë se vendosja e kësaj linje ka ndikuar dhe do të ndikojë shumë në parandalimin e shkeljeve, sepse do të rritë më shumë edhe mundësinë tonë për mbrojtjen e të drejtave të individëve.

Krijimi i kesaj strukture te re prane institucionit te Avokatit te Popullit, e cila rezulton perdite e me e suksesshme ne misionin e saj ne mbrojtje te drejtave te njeriut, tregon se permbushja e detyrimeve ndërkombëtare dhe e kërkesave te legjislacionit përkatës shqiptar, kerkon bashkepunimin dhe nderveprimin e te gjithë faktoreve dhe institucioneve qe bejne pjese ne familjen e madhe te aktoreve ne mbrojtje te drejtave te njeriut.

Ne kete Raport vjetor kesaj strukture i eshte kushtuar nje raportim i veçante, ne lidhje me veprimtarine e saj.

#### **4. Sherbimi i Proves**

Denimet alternative jane nje institut i rendesishem i se drejtes penale dhe si te tilla ato jane pasqyruar ne kreun VII, te Ligjit nr.7895 date 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikes se Shqiperise”. Megjithe parashikimin e bere ne ligj, praktika e ndjekur nga gjykatat ne vend ka treguar se keto dispozita kane gjetur fare pak zbatim.

Ne keto kushte, per nje funksionim efektiv te ketij instituti dhe ne kuader te reformes ne sistemin penenciar dhe te drejtesise penale, eshte miratuar Ligji nr.10023 date 27.11.2008 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin nr.7895 date 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikes se Shqiperise”. Ligji ne dispozitat e tij parashikon nje listim me te zgjeruar te shkaqeve se kur gjykata mund te vendose pezullimin e ekzekutimit te vendimit me burgim dhe venien ne prove te personit te denuar. Kjo dispozite realizon dy qellime kryesore; pergjegjesine e sherbimit te proves ne kete drejtim dhe detyrimin e personit te denuar per te mbajtur kontakte me te.

Ky ligj percakton vetem formulime baze dhe parime, duke mos u marre me detajime dhe percaktime detyrash konkrete te sherbimit te proves. Ndaj ne vazhdim eshte miratuar Ligji nr.10024 date 27.11.2008 “Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin nr.8331 date 21.04.1998 “Per ekzekutimin e vendimeve penale”.

Risija e ketij ligji qendron ne faktin se per here te pare ne dispozitat e tij parashikohet mbikqyrja e ekzekutimit te denimeve alternative, ne rastin kur gjykata vendos per pezullimin e vendimit te dhene dhe zevendesimin e tij me nje denim alternativ.

Ne kete ligj percaktohet mekanizmi konkret i zbatimit te denimeve alternative dhe raportet qe ai krijon me institucionet shteterore, prokurorine dhe gjykatën. Organi shteteror qe mbikqyr ekzekutimin e denimit alternativ dhe qe ndihmon personin e denuar ne kapercimin e veshtiresive per riintegrimin social e shteteror, eshte Sherbimi i Proves.

Objekti i veprimtarise se ketij organi parashikohet ne Kreun II/1 te Ligjit nr.10024 date 27.11.2008 “Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin



nr.8331 date 21.04.1998 “Per ekzekutimin e vendimeve penale”, ku thuhet shprehimisht se:

“Sherbimi i proves eshte organi shteteror, qe mbikqyr zbatimin e denimeve alternative, paraqet informacion dhe raporte para prokurorit ose gjykates, sipas ketij ligji dhe ndihmon ne ekzekutimin e denimit alternativ, si dhe ndihmon personin e denuar ne kapercimin e veshtiresive per riintegrimin social. Organet shteterore qendrore dhe organet e njesive te qeverisjes vendore i japin sherbimit te proves ndihmen e nevojshme per permbushjen e detyrave ligjore. Sherbimi i proves bashkepunon me OJF-te dhe sherbimin e ndermjetesimit, ne baze te rregullave te hollesishme, te percaktuara nga Ministri i Drejtesise. Sherbimi i proves ndihmon personin e denuar ne kapercimin e veshtiresive per riintegrimin social, duke vendosur kontakte me familjen dhe mjedisin shoqeror te te denuarit, me organizatat jofitimpruresse dhe individet”.

Megjithate nisur nga pervoja e tij, institucioni i Avokatit te Popullit, i cili edhe ne hartimin dhe diskutimin e ketij ligji ka luajtur nje rol shume aktiv mendon se, detyrat e Sherbimit te Proves ne raport me individet, duhen te percaktohen qarte rast pas rasti nga gjykata, pasi mund te lindin ne praktike raste abuzive, si pasoje e subjektivizmit te personave te vecante te kesaj strukture.

Nga ana tjeter, gjykojme se eshte e nevojshme venia sa me pare ne pune e Sherbimit te Proves, nisur edhe nga koha e miratimit te Ligjit nr.10024 date 27.11.2008 “Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin nr.8331 date 21.04.1998 “Per ekzekutimin e vendimeve penale”.

Ne paragrafin e dyte te nenit 31/12 te ketij ligji, eshte parashikuar se, rregullat e hollesishme per organizimin, te drejtat dhe detyrimet dhe standartet e mbikqyrjes percaktohen ne Rregulloren e brendshme, te miratuar nga Keshilli i Ministrave.

Aktualisht, Ministria e Drejtesise eshte ne procedure e siper te hartimit te kesaj rregulloreje, diskutimit te saj me te gjithe institucionet dhe aktoret e interesuar ne vend dhe paraqitjes se saj per miratim ne Keshillin e Ministrave. Se fundmi, kjo ministri i ka derguar per dhenie mendimi institucionit tone, projekt-rregulloren; “*Mbi standartet dhe proçedurat e mbikqyrjes se ekzekutimit te denimeve alternative, si dhe organizimin dhe funksionimin e sherbimit te proves*”.

Avokati i Popullit vlereson se përgjithësisht ky akt ka mbajtur në konsideratë nevojën e forcimit të garancive mbi të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve që përfitojnë nga shërbimi i provës, duke percaktuar proçedura te qarta dhe nje organizim të efektshëm.

Megjithate, si rezultat i një studimi të hollësishëm të kryer nga ana jonë për këtë projekt-rregullore, jane paraqitur disa mendime dhe vërejtje me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të këtij drafti si vijon:

1. Ne preambul të rregullores duhet të vendoset baza ligjore në zbatim të së cilës miratohet kjo rregullore. Ky është edhe nje kriter kushtetues i pajtueshmerisë së aktit sipas Nenit 118 pika 1 te Kushtetutes.

2. Në nenin 6, pika 2 te Rregullores, në caktimin e punonjësit të shërbimit të provës nga Kryetari i Zyrës Vendore, duhet te shtohet kushti i mungeses së konfliktit të interesit me të dënuarin, si nje kriter i domosdoshëm për një raport të ndershem midis palëve.

3. Në nenin 6, pika 10 duhet të specifikohen se cilat janë substancat e caktuara dhe masa e lejueshme qe konsumon i denuari per te mos patur probleme me Sherbimin e Provës dhe Prokurorinë gjatë fazes se ekzekutimit të dënimit alternativ.

4. Në nenin 7, pas gërmes (i) mendojmë që në dosjen personale të të dënuarit pranë Sherbimit të administrohen edhe kopjet e ankesave të të dënuarit për këtë sherbim dhe menyren e permbushjes se procedurave.

5. Në nenin 9, pika 4, duhet të specifikohet se në cilën menyrë dhe cilin organ i dënuari kundërshton të dhenat dhe permbajtjen e dosjes personale.

6. Ne nenin 11 ku trajtohen detyrat e asistimit nga ana e Shërbimit të Proves, duhet të shtohet edhe nje paragraf me këtë permbajtje:

*“Të respektoje te drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të të denuarve dhe te garantoje respektimin e dinjitetit personal të tyre”.*

7. Neni 12, pika 4 të riformulohet për të gjetur një kuptim më të qartë.

8. Në nenin 17 ku flitet per hartimin e një programi nga Shërbimi i Provës, duhet te specifikohet në pikën (d) se cilat janë shprehimisht kushtet e tjera që duhet të plotësohen në program.

9. Në nenin 22, paragrafi i dyte ku flitet per mbikqyrjen e te denuarit me qendrim në shtepi, mendojmë se Sherbimi i Proves, duhet te kete të shprehur qartë se në cilë mënyrë do të mbikqyre të dënuarin në banesë. Në përmbajtjen e këtij projekti të lihet përshtypja sikur punonjësi i shërbimit të provës do të kete te drejten te kontrolloje banesen ne çdo kohe, çka kërkon respektimin e disa detyrimeve të Kodit të Proçedurës Penale të pa shprehura në këtë projekt.

10. Të percaktohet statusi civil i punonjësve të shërbimit të provës dhe statusi i punonjësve të tjerë ndihmës të këtij shërbimi, në referencë të statusit të administratës gjyqësore.

11. Të specifikohet profili i arsimit të lartë për çdo kategori punonjësish të shërbimit të provës të rolit drejtues dhe ekzekutues. Padyshim arsimi i lartë juridik është profili më i pranueshëm që duhet marrë në konsideratë.

Për sa më sipër dhe në këndvështrimin e objektit të veprimtarisë së tij, në mbrojtje të lirive dhe të drejtave të ligjshme të individëve, Avokati i Popullit e konsideron vënien në funksionim të Shërbimit te Proves si nje

zhvillim mjaft pozitiv ne rritjen e standarteve te trajtimit te te denuarve ne vendin tone dhe shpreh ne parim, mbeshtetjen per nje realizim sa me te shpejte dhe efikas te ketij institucioni ne sherbim te te drejtave dhe interesave te te denuarve.

## **5. Sherbimi i Ndhimes Juridike per Individet, i dhene nga shteti**

E drejta për një proces të rregullt ligjor, është një prej temave më të rëndësishme, dhe është bërë shpesh objekt i diskutimeve dhe debateve si midis profesionistëve, ashtu dhe midis politikanëve. Nje koncept dhe element perberes shume i rendesishem ne realizimin efektiv te kesaj te drejte, eshte dhënia e ndihmës juridike për individët ne nevojë, të cilët nuk mund te përballojne shpenzimet e shërbimit të mbrojtjes ligjore në një proces, civil, penal apo administrativ. Sigurimi, përmirësimi dhe rritja e standartit te dhënies së ndihmës juridike për individët ne nevojë, perben ne kete kendveshtrim nje nga sfidat e perafrimit te legjislacionit tone me “Acquis Communautaire”, ne kete fushe.

Ne funksion te arritjes se ketyre standarteve, Reforma ne Drejtesi ka pervijuar zhvillimet e saj me miratimin nga ana e Kuvendit te Shqiperise dhe hyrjen ne fuqi te Ligjit nr.10039 date 22.12.2008 “Per ndihmen juridike”.

Ky ligj rregullon specifikisht institutin e sherbimit te ndihmes juridike per individet, te dhene nga shteti. Ligji parashikon parimet themelore te ofrimit te kesaj ndihme, administrimin e saj prej Ministrise se Drejtesise, Dhomes Kombetare te Avokatise si dhe Komisionit Shteteror per Ndhimen Juridike. Ky i fundit krijohet per here te pare si nje organ shteteror kolegjal, me kompetenca rregullatore ne kete fushe.

Ofrimit te ndihmes juridike nga avokatet e autorizuar sipas ketij ligji, ne nivel paresor dhe dytesor, i bashkengjitet nje sherbim i ri qe eshte per t’u vleresuar dhe qe parashikohet ne piken 2 te nenit 11 te ligjit, ku thuhet shprehimisht qe:

*“Ndhima juridike jepet edhe nepermjet edukimit ligjor te publikut, permes ndihmes qe i ofrohet komunitetit me klinika levizese, publikime, fushata televizive dhe ne median e shkruar, si dhe masa te tjera te ngjashme, duke u kushtuar vemendje te vecante problemeve te grupeve ne nevoje”.*

Institucioni i Avokatit te Popullit, ka luajtur nje rol shume aktiv gjate pergatitjes dhe diskutimit te projektligjit perkates nga ana e Ministrise se Drejtesise, duke dhene mendime dhe sugjerime per pergatitjen e nje ligji sa me te mire ne kete fushe.

I. Megjithate konstatojme se, sikurse nje pjese e sugjerimeve tona jane marre ne konsiderate nga grupi i punes i ngritur per pergatitjen e

ketij ligji, disa te tjera nuk jane reflektuar ne te, duke bere qe aktualisht ne permbajtjen e dispozitave te ligjit te verehen mangesi apo perseritje nga legjislacioni tjeter ekzistues ne fuqi.

Me konkretisht, nënvizojmë se ky ligj, parashikon ndërhyrje shumë të thella ne shërbimin e Avokatise dhe te Noterise, ne ligjet e tyre organike, qe deri tani kane dhënë dhe japin ndihmën juridike si ne çdo vend te botes. Ky ligj kerkon gjithashtu ndryshime ne Kodin e Procedures Penale dhe atij te Procedures Civile, ne ligjin “Per organizimin e Ministrise se Drejtesise” etj.

Ligji “Per ndihmen juridike”, qe ne nenin 1 percakton dhenien e ndihmes juridike vetem per individet, duke perjashtuar personat juridike, kur eshte sanksionuar se keta kane te drejta dhe pergjegjesi ne fushat penale dhe civile, duke shkelur keshtu parimin kushtetues te barazise midis tyre.(neni 16/2 i Kushtetutes). Jo te pakta kane qene rastet nga praktika e deri tanishme kur, persona juridike jane ndodhur ne gjendje te paaftesise paguese dhe per shkak te mungeses se mundesise per te paguar sherbimin e duhur te avokatise, nuk kane mundur t’i drejtohen gjykates per te realizuar te drejtat e tyre te njohura nga Kushtetuta dhe ligjet e tjera. Aq më tepër që si personat fizikë, ashtu edhe ata juridikë kur kërkojnë tituj pronësie, shpërblime etj, mund të detyrohen paraprakisht të lidhin kontratë me shërbimin që në rast të fitimit të së drejtës, të kompesojnë ndihmën e dhënë. Po keshtu ne te nuk permendet fare nese kete ndihme e gezojne edhe personat pa shtetesi apo te huajt. (neni 16/1 i Kushtetutes)

Sherbimi i ndihmes juridike nga shteti per individet (neni 3 i ligjit), nuk eshte pergjegjesi e Ministrise se Drejtesise apo Komisionit Shteteror per Ndhimen Juridike, por e Keshillit te Ministrave (neni 95/2 i Kushtetutes). Ministria ngarkohet per zbatimin e ligjit. Nga menyra se si jane shkruar, neni 4/a dhe neni 10/a te vete ligjit duket se vijne ne kundërshtim me nenin 3 te tij. Ligji ka perseritje te shumta te normave ligjore te parashikuara ne ligje te tjera ne fuqi (neni 4, 5, etj).

Eshte e pashpjegueshme qe ndersa ne nenin 6 te ligjit, Komisioni Shteteror per Ndhimen Juridike parashikohet si organ kolegjal, ne nenin 17/1 vendimarrës eshte Kryetari i Komisionit.

Ndersa ne ligj nenvizohet disa here kompetenca profesionale, si nje nga shkaqet qe ka provokuar nxjerrjen e tij, nuk ka garanci se ndihma juridike do te jete me cilesore se deri tani, madje neni 7/c provon te kunderten.

Ligji ne nenin 6 te tij, parashikon pjesemarrjen e nje anetari te Keshillit te Larte te Drejtesise (KLD) ne Komisionin Shteteror te Ndhimes Juridike. Duke qene anetar i Keshillit te Larte te Drejtesise, pra anetar i nje organi kolegjal qe eshte pergjegjes per mbrojtjen, emerimin, transferimin, shkarkimin, edukimin, vleresimin moral e profesional,

karrieren dhe kontrollin e veprimtarise se gjyqtareve te gjykatave se shkalles se pare dhe te gjykatave te apelit, realisht veprimtaria e tij me pas si anetar i Komisionit Shteteror te Ndhimes Juridike, peson nje transformim dhe merr nje drejtim krejt tjetër. Eshte e vertete se, ne nenin 2/f te Ligjit nr.8811 date 17.05.2001 “Per organizimin dhe funksionimin e Keshillit te Larte te Drejtesise”, parashikohet qe Keshilli i Larte i Drejtesise veç detyrave te percaktuara shprehimisht ne kete nen, kryen edhe detyra te tjera te percaktuara me ligj. Por duhet te mbajme ne konsiderate faktin se, kjo tager i jepet organit kolegjal te Keshillit te Larte te Drejtesise dhe jo nje anetari te tij, siç ndodh ne kete rast. Ne keto kushte pjesemarrja e nje anetari te KLD-se ne Komisionin Shteteror te Ndhimes Juridike, eshte nonsens.

II. Qe ne diskutimin e projektligjit perkates kemi propozuar qe, në qoftë se do të pranohej ndërhyrja e shtetit në shërbimin e avokatisë private, mund te parashikohej edhe një organizim tjetër si vijon:

Shërbimi i avokatisë për këta persona të organizohej si një degë pranë zyrave të Avokatit të Shtetit. Kjo degë duhet të jetë totalisht e pavarur nga pikëpamja e dhënies së ndihmës. Avokatët që do të punonin në këtë zyrë do të kishin vetëm vartësi administrative për disiplinën në punë dhe pagat që do të merrnin. Punësimi në ato zyra do të bëhej me konkurse të hapura dhe transparente dhe si emërimi, ashtu dhe largimi nga ofrimi i shërbimit te ndihmes juridike.

Kjo mënyrë organizimi duhej te stimulonte avokatët që do punonin ne kete shërbim, duke i paguar ata relativisht mire, me rroga mujore. Varianti i propozuar prej nesh kishte si avantazh edhe faktin se infrastruktura e zyrave është tashme e ngritur pranë Avokatit të Shtetit në rrethe apo qarqe.

Me rregullimin qe i eshte bere aktualisht ne ligj dhenies se ndihmes juridike, verejme se parashikohen mire procedurat dhe format e dhenies se kesaj ndihme, por mbetet e paqarte dhe shume konfuze infrastruktura e nevojshme per mundesimin e dhenies se kesaj ndihme.

Nisur nga keto konstatime dhe koha e shkurter qe nga miratimi dhe hyrja ne fuqi e ligjit, vleresojme se eshte ende heret te gjykohet nese dispozitat e tij ligjore do te sjellin pasojat e deshiruara gjate zbatimit te tyre ne praktike.

Sikurse edhe ne fusha te tjera te veprimtarise se administrates publike dhe te treteve qe veprojne per llogari, edhe ne kete institut te ri te se drejtes qe luan nje rol te rendesishem ne mbrojtjen dhe respektimin e se drejtes se individit per nje proces te rregullt ligjor, institucioni i Avokatit te Popullit do te vazhdoje te kete nje rol aktiv ne observimin e zbatimit te tij, ne kuader te mbrojtjes se lirive dhe te drejtave te ligjshme te individeve.

## 6. Shërbimi përbarimor gjyqësor privat

Rikonceptimi dhe transformimi i sektorit publik ne kryerjen e shërbimeve te ndryshme është një nga çështjet e rëndësishme te reformës ligjore qe po realizohet ne vendin tone. Kjo reforme nënkupton zgjidhjen e detyrave qe kane nevojë te realizohen nga qeveria, garantimin e veprimit te arsyeshëm, ligjor, ekonomik, profesional dhe modern pa burokraci te tepërta dhe ne te njëjtën kohe promovimin e metodave alternative te shpërndarjes se shërbimit publik, me qëllim kryesor rritjen e efijçences, efektshmërinë dhe cilësisë së shërbimeve publike.

Ne këtë kontekst mund të flitet njëkohësisht edhe për një reformë paralele në sektorin publik, me veçori kryesore *tregtimin e shërbimit publik*. Një nga synimet kryesore te kësaj veçorie është sistemi pluralist i formave te pronësisë, ne shpërndarjen e shërbimit publik. Pikërisht shpërndarja e shërbimeve publike ne formën e bashkëpjesëmarrjes publik-privat është një proces ligjor, ekonomik dhe intensiv i nevojshëm edhe në fushën e Drejtësisë.

Kushtet për një realizim te suksesshëm te kësaj bashkëpjesëmarrje kërkojnë; një mjedis te duhur ligjor për zhvillimin e bashkëpjesëmarrjes publike-private, pjesëmarrjen e qytetareve ne transparencën e procesit te vendimmarrjes publike, matjen e performancës ne sektorin publik, si dhe një forme moderne te menaxhimit te shpërndarjes se shërbimit publik.

Pjese e këtyre reformave është reformimi i shërbimit përbarimor gjyqësor, i cili ka bere një hap cilësor me miratimin e Ligjit nr.10031 date 11.12.2008 “Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat”.

Nëpërmjet këtij ligji, qe padyshim përfaqëson një zhvillim shume pozitiv ne këtë fushe, vlerësojmë se është ndërmarrë hapi i pare shume i rëndësishëm për shpërndarjen e shërbimit publik, në fushën e drejtësisë.

Tashmë, Shërbimi Përbarimor ne Republikën e Shqipërisë organizohet ne Shërbimin Përbarimor Gjyqësor Shtetëror, ne përputhje me dispozitat e Ligjit nr.8730 date 18.01.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përbarimor Gjyqësor”, si dhe ne Shërbimin Përbarimor Gjyqësor Privat, ne përputhje me dispozitat e Ligjit nr.10031 date 11.12.2008 “Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat”.

Ne nenin 5 te Ligjit “Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat”, përcaktohet se; “*Shërbimi Përbarimor Gjyqësor Privat është një funksion i pavarur me karakter publik, i cili ushtrohet nga përbaruesit gjyqësorë private dhe shoqëritë përbaruese private*”.

Kriteret e ushtrimit të kësaj veprimtarie nga personat fizike të licensuar apo shoqëritë përmbaruese private, procedurat e licensimit të tyre dhe përgjegjësitë e Ministrisë së Drejtësisë si autoritet përgjegjës për këtë proces, janë të përcaktuara qartë në nenet 4-20 të ligjit.

Krijimi i Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Private është një nga risitë e ligjit dhe një nga modelet e zbatimit të teorisë të së drejtës administrative për krijimin e enteve publike, si subjekt i së drejtës publike joshitetërore, i krijuar me ligj dhe që synon realizimin e një interesi publik. Organizimi i saj, kompetencat dhe raportet që krijohen me Ministrinë e Drejtësisë, flasin konkretisht për rolin dhe funksionin që Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Private do të luajë në Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat.

Te drejtat, detyrimet, procedurat që ndiqen nga ana e përmbaruesve gjyqësorë private, tarifatat e aplikueshme për shërbimin e ofruar, ndalimet në ushtrimin e profesionit, konfidencialiteti, mbrojtja e veçante që ligji ofron për ta janë të përcaktuara në dispozitat e Ligjit “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”.

Megjithatë ligji i sipërcituar ka hyre në fuqi, është herët për të folur për zbatimin e tij, pasi ende nuk janë dhënë licensat e para nga ana e autoritetit përgjegjës, Ministrisë së Drejtësisë, për ushtrimin e këtij aktiviteti nga subjektet e lejuara me ligj.

Megjithatë, në vlerësojmë dhe përshëndesim krijimin e këtij instituti të ri të ekzekutimit të titujve ekzekutivë, i cili veç dimensionit të ri që i jep kësaj fushe, gjykojmë se do të japë ndihmesën e tij për zbatimin e të drejtës së ligjshme të individit, që ka të bëjë me procesin e rregullt ligjor.

## 6. Marrëdhëniet e Avokatit të Popullit me Publikun dhe Median

Qysh në fillim të veprimtarisë së Avokatit të Popullit kemi patur vizionin se një Ombudsman i panjohur nuk mund të justifikojë as emrin dhe as misionin e tij në mbrojtje të të drejtave të qytetarëve.

Në tashmë prej vitesh funksionojmë mbi bazën e një strategjie të hartuar në detaje, e cila ka parashikuar edhe promovimin e funksionit tonë dhe të të drejtave të njeriut që ne mbrojmë, edhe rrugët dhe mënyrat e komunikimit tonë të përditshëm me Median. Duke synuar njohjen tonë nga publiku, qëllimi ka qenë dhe mbetet rritja e autoritetit të Institucionit të Avokatit të Popullit në të mirë të zgjidhjes sa më të shpejtë të problemeve që qytetarët ngrejnë pranë këtij Institucioni. Konkretisht, duke pasuruar më tej faqen tonë të Internetit, ne mendojmë se kemi vënë në dispozicion të publikut dhe gazetarëve të gjithë problematikën tonë të ditës. Nga ana tjetër, këtë vit botuam edhe pesë fletëpalosje të

përditësuar, të qëllimuar për grupe të popullsisë në përgjithësi si dhe për grupe të veçanta, sikurse janë të burgosurit, policia, forcat e armatosura, gratë, fëmijët dhe nëpunësit publikë.

Praktika na ka mësuar se marrëdhëniet me median duhen menaxhuar me qartësi dhe gjakftohtësi. Kjo do të thotë informim intensiv i publikut mbi gjithçka të prodhuar nga Zyra jonë, por edhe kujdes për të mos rënë në protagonizëm të pajustificuar. Dhënia e informacionit nuk duhet të bëhet qëllim në vetvete dhe të rrezikojë dhe të komprometojë marrëdhëniet institucionale si me qytetarët, ashtu dhe me përfaqësuesit e institucioneve të tjera, karshi të cilëve ata presin qëndrimin ndërmjetësues të Avokatit të Popullit.

Në natyrën e reagimit të Avokatit të Popullit nuk është dhënia e informacioneve për skup mediatik, por informimi i publikut dhe administratës për zgjidhjet tona, në menyre që ato të kenë njëkohësisht efektin a posteriori dhe a priori. E para, në kuptim të rivendosjes të së drejtës së shkelur të qytetarit dhe e dyta, në favor të parandalimit të shkeljes së ngjashme të këtyre të drejtave. Efekti i parandalimit vlen si për uljen e rasteve jashtë juridiksionit, ashtu edhe për edukimin e administratës me të drejtat e njeriut, të cilat përbëjnë thelbin e mirëqeverisjes dhe të cilësisë së lidershipit.

Efekti i parandalimit vlen edhe për uljen e rasteve që paraqiten në Gjykata, e për pasojë edhe të ngarkesës së punës së tyre, mjaft që qytetarët të orientohen për të shtuar të gjitha rrugët e ankimit administrativ.

Në tabelat përkatëse të paraqitura në fund të këtij raporti, për mbulimin mediatik të veprimtarisë tonë, viti 2008 paraqitet me një mbulim mediatik të dendur, referuar kjo si medias së shkruar, ashtu edhe asaj elektronike. Kështu, gjatë vitit 2008, Avokati i Popullit dhe problematika e ndjekur prej tij ka qenë e pranishme 299 herë në median e shkruar dhe 106 herë në atë elektronike. Ndërkohë që, për vitin 2007, ka qenë respektivisht 183 herë në median e shkruar dhe 84 herë në atë elektronike.

Një problem tjetër që kemi patur parasysh gjatë vitit 2008 ka qenë shtimi i pranisë më të madhe të Avokatit të Popullit në kronikat e Televizionit Publik Shqiptar. Në vlera shifrore rezulton që prania mediatike e Avokatit të Popullit në Televizionin Publik, gjatë vitit 2008, ka qenë rreth 28 herë, ose e trefishuar në krahasim me një vit më parë. Për këtë kemi patur parasysh edhe sugjerimin e disa deputetëve, të përmendur edhe në një nga pikat e Rezolutës së Kuvendit me rastin e raportimit të Avokatit të Popullit për veprimtarinë e vitit 2007. Për hir të së vërtetës, me një letër dërguar Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së, ne i kemi kërkuar dhe shprehur gadishmërinë tonë për vendosjen e një bashkëpunimi të tillë, jo thjesht dhe vetëm për faktin se diçka e tillë na



kërkohej në Rezolutën e Kuvendit. E kemi parë këtë edhe si nevojën tonë për të qenë më të pranishëm në Entin Kombëtar të Televizionit Publik, duke patur parasysh faktin e padiskutueshëm të mbulimit më të madh territorial që ky Televizion realizon sot për sot në vend. Duhet të themi se deri tani kemi gjetur mirëkuptimin e plotë të drejtuesve të Televizionit Publik për të mbuluar veprimtarinë e Avokatit të Popullit, jo vetëm përmes kronikave, por edhe përmes emisioneve që ata realizojnë dhe ku, herë pas here, kanë ftuar Avokatin e Popullit apo përfaqësues të tij. Përcaktimi i një kohe televizive posaçërisht për Avokatin e Popullit ka qenë i pamundur, sikurse ka qenë i tillë edhe prodhimi i emisioneve apo dokumentarëve përjashtimisht për Avokatin e Popullit. Të tilla ndër marrje kërkojnë stafe televizive dhe shpenzime financiare të posaçme. Megjithatë, ne shpresojmë se në të ardhmen kjo do të mund të realizohet me një angazhim më të madh nga të dyja palët.

Për t'iu rikthyer bashkëpunimit tonë me median, ritheksojmë faktin se shtypi i përditshëm përbën burimin tonë më të sigurtë për vjeljen e informacionit me interes publik, gjë që na jep edhe mundësinë për të filluar çështje ex officio, pra me vetinisativë. Kontrolli i imtë i shtypit të përditshëm ka qenë dhe mbetet detyrë parësore, jo vetëm për personin që e mbulon këtë fushë, por edhe për të gjithë të tjerët, të cilët nuk mund të qëndrojnë indiferentë ndaj problemeve që ngre shtypi dhe gazetarët, të cilët ne i kemi konsideruar sikurse ata janë, pra “rojtare publikë” dhe “avokatë në terren” të të drejtave të qytetarëve.

Përfundimisht, tabloja e vërtetë e kësaj pranie mediatike del e qartë, qoftë edhe duke i hedhur një sy titujve të shtypit të shkruar dhe atij televiziv. Për këtë mund t'u referoheni tabelave përkatëse të mbulimit mediatik të Institucionit, pa komente, që ndodhen në fund të këtij Raporti.

## **a) Sektori i Pritjes së Popullit**

### **1- Organizimi i punës**

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, që prej vitit 2001 funksionon sukseshëm Sektori i Pritjes së Popullit. Kjo zyrë u krijua për përballimin në vazhdimësi të fluksit në rritje të individëve, të cilët paraqiten pranë nesh për të parashtruar ankesa, kërkesa apo njoftime në lidhje me shkeljen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të tyre. Ky shërbim ndaj qytetarëve vazhdon me ritme të larta dhe ka krijuar një fizionomi pozitive për Institucionin e Avokatit të Popullit, duke u i shfaqur më afër ankuesve dhe duke i orientuar drejtë ata për zgjidhjen e problemit të tyre.

Për këtë një nga juristët e institucionit tonë, në një zyrë të posaçme, lehtësisht të arritshme për qytetarët, pret në çdo kohë gjatë orarit zyrtar, pa pengesa me kulturë e profesionalizëm, ankesat e individëve te

ndryshëm. Duke u udhëhequr nga motoja e Institucionit tonë “Avokati i Popullit një derë e hapur për ju”, kjo zyre u mundëson qytetarëve që paraqiten për ankesa apo kërkesa, të ndjehen të mirëpritur dhe të përfitojnë në kohë të shkurtër, shërbimet që mund t’u ofrojë institucioni ynë.

Spektori i Pritjes së Popullit, si pikë takimi e parë e Marrëdhënieve me Publikun, ka ofruar shërbimin e tij, si nëpërmjet ndihmës në përpilimin e ankesës apo kërkesës që individë të ndryshëm parashtrojnë, ashtu dhe nëpërmjet këshillimeve ose orientimeve ligjore profesionale që ata kërkojnë, kur çështja që parashtrohet prej tyre nuk është objekt i veprimtarisë së Avokatit të Popullit. Përveç materialeve të gatshme, të prodhuara nga Zyra e Avokatit të Popullit, që ndodhen në dispozicion të qytetarëve, këtyre të fundit u ofrohet informacioni i kërkuar dhe njohja me legjislacionin në fuqi, si dhe u jepen sqarime të mëtejshme për rrugën që ndiqet pas ankesës së bërë.

Nëpërmjet sqarimeve me gojë dhe përgjigjeve me shkrim, ne kemi mundur t’u vijmë në ndihmë qytetarëve, me synimin për të eliminuar sa më shumë sorollatjet e tyre në dyert e Administratës Publike, ku shpesh hasin mjaft pengesa burokratike. E gjithë kjo procedurë direkt nën kontrollin dhe kujdesin e Avokatit të Popullit, rrit besimin te qytetarët dhe bënë të mundur shtimin e ankesave apo këshillimeve nga viti në vit. Ngarkesa e punës e kësaj njësie paraqitet si më poshtë:

## 2. Statistikat përmbledhëse.

Gjatë vitit 2008, numri i përgjithshëm i ankesave të paraqitura pranë Zyrës së Pritjes së Popullit është 1033 ankesa apo kërkesa. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen ankesat e paraqitura çdo muaj dhe numri i pranimit të atyre që kanë qenë brenda juridiksionit dhe kompetencave të Avokatit të Popullit.

<b>Muaji</b>	<b>Ankesa gjithësej</b>	<b>Ankesa për tu shqyrtuar</b>
Janar	102	44
Shkurt	48	38
Mars	46	39
Prill	87	67
Maj	82	53
Qershor	87	28
Korrik	80	59
Gusht	41	31
Shtator	108	77
Tetor	113	80
Nëntor	147	86
Dhjetor	92	61
<b>Totali</b>	<b>1033</b>	<b>655</b>

Siç mund të konstatohet nga numri i përgjithshëm i ankesave ose kërkesave verbale që janë paraqitur pranë Zyrës së Pritjes të Popullit, janë pranuar për shqyrtim 655 ankesa apo kërkesa të cilat u janë bashkuar ankesave, kërkesave apo njoftimeve të tjera që i janë dërguar Avokatit të Popullit me letra, fax, telegrame etj.

Zyra e Pritjes së Popullit në përmbushje të detyrave të saj funksionale gjatë vitit 2008, ka pritur, këshilluar, orientuar dhe kthyer përgjigje të menjëhershme 388 kërkesave dhe ankesave të paraqitura verbalisht. Është konstatuar se këto ankesa apo kërkesa kanë qenë dhe jashtë juridiksionit dhe kompetencave të Avokatit të Popullit. Megjithatë të gjithë këtyre individëve ju është dhënë këshillim profesional, mbi rrugën ligjore dhe institucionale që duhet të ndjekin dhe afatet që duhet të respektojnë për zgjidhjen e çështjeve që ata i shqetësojnë.

### 3- Problematika e shfaqur

Në ndryshim nga vitet e tjera Sektori i Pritjes së Popullit, ka evidentuar me kujdes, problematikat që nuk janë pranuar për shqyrtim, pasi janë jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit. Ankuesve u është dhënë konsulenca e nevojshme juridike si dhe adresa e institucioneve në të cilat duhet të paraqiten për zgjidhjen e ankesave të tyre.

Nga evidentimi del se ankesat jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit kanë qenë si më poshtë:

Ankesa ndaj vendimeve të Gjykatave Shqiptare	95
Kërkesa për përfaqsim në gjykatë	14
Konflikt midis individëve	35
Ankesa ndaj subjekteve private	29
Konflikte në familje	20
Kërkesa për punësim	4
Ankesa ndaj përfaqësive të huaja në Shqipëri	18
Ankesa ndaj shteteve të huaja	10
Këshillime për përfitimin e pensionit të pleqërisë apo invaliditetit	10
Këshillime për përpilim aktesh për njohje pronësie, korrigjim moshe, libreze pune etj	20
Këshillime për mënyrën e ndryshimit apo zgjidhjes së kontratave midisë subjekteve të ndryshëm	16
Këshillime për mënyrën e kërimit të dëmshpërblimeve	6
Këshillime për mënyrën e ndryshimit të akteve administrative	10
Këshillime lidhur me ankesat e kryera ndaj policisë, prokurorisë, burgjeve, Z.V.RR.P.P, ministrive, Z.GJ.Civ.	40
<u>Të tjera</u>	<u>51</u>
<b>Totali =</b>	<b>338</b>

Siç konstatohet në tabelën e mësipërme numri më i madh i këtyre ankesave drejtohet ndaj gjykatave shqiptare të të gjitha niveleve. Këto ankesa zenë përqindjen më të madhe në të gjithë ankesat jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit. Sipas pretendimeve të individëve të paraqitur vendimet e gjykatave shqiptare mbartin padrejtësi, paragjykim, pavërtetësi dhe njëanshmëri. Ata nuk janë dakort me vendimet e gjykatave, kanë pretendime për trupin gjykues, ankohen për korrupsion si dhe marrje rryshfeti. Gjithashtu, ankohen për punën pa nivel të avokatëve mbrojtës, të cilët në disa raste, sipas ankuesve, bëjnë lojë (mbrojtje) të dyfishtë kundrejt rryshfetit.

Edhe gjatë këtij viti, mjaft qytetarë janë ankuar se nuk mund të kundërshtojnë vendimet e gjykatave për çështje penale mbasi këtë të drejtë ligji ia njeh vetëm Prokurorisë e cila në mjaft raste, kërkon masë ndëshkimi të ulët në krahasim me pretendimet e të dëmtuarve. Ky problem është ngritur shpesh nga Avokati i Popullit, për të ndryshuar Kodin e Procedurës Penale në mënyrë që familjet e dëmtuara të kenë të drejtë ankimi. Kjo për faktin se në të shumtën e rasteve janë familjet e viktimave që mendojnë se vendimi nuk ka qenë i drejtë, por prokurorët nuk bëjnë ankime të vendimeve

Një problem tjetër që është evidentuar gjatë pritjes së individëve në Zyrën e Pritjes së Avokatit të Popullit, janë konfliktet në familje si dhe konfliktet midis individëve. Këto ankesa zënë gjithashtu një përqindje të konsiderueshme të ankesave jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit. Në të shumtën e rasteve, problematika e këtyre ankesave ka patur të bëjë me probleme të familjes, marrëdhënieve burrë-grua dhe fëmijë, probleme trashëgimie, të pronës etj. Nga ana jonë është bërë kujdes në dhënien e konsulencës për mënyrën e zgjidhjes së ankesave, duke këshilluar për rrugën e saktë ligjore që duhet të ndiqet, me qëllim eliminimin e konflikteve të mundshme. Për këtë, veç konsultave tona është bashkëpunuar me organizata jofitimprurëse dhe në veçanti me organizata për mbrojtjen e të drejtave të grave e fëmijëve, gjithmonë në funksion të parandalimit të konflikteve të mundshme.

Për sa i përket kërkesave për punësim, vihet re një rënie e numrit të tyre, krahasuar me vitin e kaluar. Në këto raste, qytetarët janë këshilluar të paraqiten në zyrat e punës. Në këtë mënyrë, mendojmë se kemi kontribuar sado pak në uljen e informalitetit në këtë sektor si dhe për edukimin e qytetarëve për ndjekjen e rrugës ligjore në përmbushjen e qëllimeve të tyre. Kjo statistikë mund t'i shërbejë organeve kompetente shtetërore në hartimin e strategjive efikase për punësim.

Ankesat e kryera kundër subjekteve private janë të natyrave të ndryshme si, mosrespektim dhe prishje e njëanëshme e kontratave, sidomos nga ndërtues që nuk zbatojnë kontratat e sipërmarrjes dhe të shitjes, mosdhënie e pagës nga punëmarrësit, largime nga puna,

mospagim i sigurimeve shoqërore, e të tjera probleme që rëndojnë mbi qytetarët edhe për shkak se strukturat e tjera të shtetit nuk veprojnë.

Si dhe vitet e kaluara, një numër ankesash drejtohen ndaj përfaqësive të huaja, të cilat ndaj kërkesave të shtetasve për pajisje me vizë, reagojnë me sjellje aspak dinjitoze dhe diskriminuese. Ky diskriminim i vërejtur pothuajse në pjesën më të madhe të përfaqësive të huaja në vend, shprehet shpeshherë, me mosdhënie të arsyes për mospajisjen me vizë ndaj individëve, të cilët kanë bërë një kërkesë të tillë. Gjithashtu një numër i madh ankesash drejtohet ndaj institucioneve të shteteve të huaja që kanë të bëjnë me padrejtësi të ndryshme ndaj shtetasve shqiptarë që jetojnë në shtete të tjera.

Për sa i përket ankesave drejtuar shteteve apo përfaqësive të huaja, Avokati i Popullit, ka bashkërenduar punën me Ministrinë e Jashtme dhe përfaqësitë tona jashtë vendit. Por e shikojmë me vend të theksojmë se puna e përfaqësive tona jashtë vendit, duhet të jetë më afër problemeve dhe shqetësimeve të shtetasve shqiptarë, sepse ka shumë ankesa për paaftësi dhe zvarritje në punën e tyre.

Vend të rëndësishëm zënë dhe këshillimit juridike që u jepen shtetasve për shqetësimet që ata prezantojnë pranë Institucionit të Avokatit të Popullit. Këshillimet e kryera nga Zyra e Pritjes së Popullit konsistojnë në mënyrë ligjore se si duhet kryer kërkitimi dhe fitimi i të drejtave të tyre si dhe mënyrën e përpilimit të akteve përkatës për institucionin ku duhen depozituar ato.

Në të gjitha rastet, ankuesve ju është bërë e qartë se Avokati i Popullit është i gatshëm të ndërhyjë me kompetencat që i jep ligji, vetëm kur organet apo autoritetet për të cilat ka ankesa apo kërkesa, janë pjesë e administratës publike dhe kur prej tyre nuk konstatohet angazhimi i duhur institucional. Në rastet e tjera, qytetarëve i është ofruar këshillim ligjor, ose orientim dhe sugjerim për zgjidhjen e problemeve të prezantuara.

Nga konkluzionet e arritura, si rrjedhim i një eksperience prej më shumë se 8 vjetësh të Zyrës së Pritjes së Avokatit të Popullit dhe të marrëdhënieve me individ në përgjithësi, mendojmë se angazhimi ynë në të ardhmen është i domosdoshëm për t'i ardhur sa më tepër në ndihmë qytetarëve që kërkojnë ndihmën e Avokatit të Popullit.

### **b. “Ditët e Hapura” Përvojë për t’u vazhduar**

Gjatë vitit 2008 ne vazhduam praktikën tashmë të konsoliduar të komunikimit të drejtëpërdrejtë me qytetarët, që ne i kemi quajtur “ Ditë të Hapura “. Kjo ka rezultuar të jetë një praktikë shumë e frutshme që jo vetëm shkurton procedurat burokratike, rrugët e gjata drejtë Tiranës, shpenzimet ekonomike, por edhe manipulimet e mundëshme me të drejtat e qytetarëve, pa folur këtu dhe për vlerën njohëse që ka kjo praktikë edhe

për vetë stafin e Avokatit të Popullit, duke u mundësuar atyre prekjen nga afër të halleve dhe shqetësimeve të qytetarëve.

Problemet që kanë të bëjnë me shërbime të tilla publike si energjia elektrike, ujësjellës kanalizime, probleme të pronësisë, zyrat e rregjistrimit të pasurive të paluajtëshme nëpër rrethe, marrëdhëniet e punës, sigurimet shoqërore e kështu me rradhë, natyrshëm çojnë në orientimin se më e mira është që problemet të zgjidhen atje ku kanë lindur dhe me ata persona që i kanë krijuar këto probleme.

Gjatë vitit 2008, ekspertët e Avokatit të Popullit kanë organizuar “Ditë të Hapura” në 40 bashki, 9 komuna dhe 4 reparte ushtarake të vendit. Janë pritur gjithësej 610 ankues por në vend janë sqaruar e këshilluar edhe 311 ankues.

Takimeve tona në “ Ditet e Hapura “ u kanë paraprirë bisedat në televizionet lokale nga ekspertët e Zyrës së Avokatit të Popullit, si dhe njoftimet e bëra nga zyrtarët e bashkive dhe komunave përkatëse. Veçori e vitit që shkoi ishte zgjerimi gjeografik i organizimit të këtyre ditëve. Ka rezultuar se në shumicën e rasteve, objekti i ankesave të tyre ka patur të bëjë me politikat sociale të shtetit ( punësimi, strehimi, ndihma sociale etj), me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore, me procedurat e ndjekura nga Zyrat e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme, konflikte të lindura në marrëdhëniet e punës, ankesa në lidhje me shtesat e pensioneve apo dhe probleme të tjera.

Për t’u njohur më nga afër me zbatimin e të drejtave të sanksionuara me ligj, ka dalë domosdoshmëri që kjo punë të thellohet në të ardhmen, me synim rritjen e efikasitetit dhe shpejtësisë së zgjidhjes së ankesave atje ku lindin.

## 7. Konferenca Kombëtare për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve

Më datën 16 Dhjetor 2008, u zhvillua Konferenca Kombëtare “*Mbrojtja e të Drejtave të Konsumatorëve*”. Ky aktivitet u organizua me inisiativë të Institucionit të Avokatit të Popullit, në bashkëpunim me shoqatën “Zyra për Mbrojtjen e Konsumatorit” dhe pjesëmarrjen aktive të Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës, Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministrisë së Integritetit dhe Ministrisë së Shëndetësisë.

Pikënisja dhe baza e zhvillimit të kësaj konference, ishte vizioni i institucionit të Avokatit të Popullit, sipas të cilit, konsumatori shqiptar duhet të ndihet i barabartë me konsumatorin e çdo shteti tjetër evropian.

Duke e trajtuar problemin në raportet “organ shtetëror-biznes”, “biznes-shoqata të konsumatorit” dhe “shoqata të konsumatorit-konsumator”, roli i Avokatit të Popullit si mediator, merr një rëndësi të veçantë, pa mohuar rolin e institucioneve dhe organeve shtetërore që mbikqyrin respektimin e këtyre raporteve dhe të shoqërisë civile në tërësi.

Në konference veç fjalëve të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit z. Jemin Gjana, Ministres së Shëndetësisë zj. Anila Godo, diskutuan përfaqësues të ministrive të ndryshme dhe të shoqatave të konsumatorit, të cilët trajtuan praktikën dhe problemet që kanë dalë dhe dalin në jetën e përditshme për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve, nga këndvështrimet përkatëse.

Të drejtat e konsumatorit përfaqësojnë në ditët e sotme një grupim shumë të rëndësishëm të të drejtave dhe lirive të individit, të cilat kërkojnë jo vetëm njohjen dhe sanksionimin e tyre në aktet normative ligjore, por edhe zhvillimin e një debati të hapur e të vazhdueshëm me qëllim informimin, ndërgjegjësimin dhe evidentimin e problematikës së tyre, të zbatimit të legjislacionit të brendshëm, si dhe të përshtatjes së tij me “Acquis Communautaire” në këtë fushë. Këto të drejta janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me standartin dhe cilësinë e jetës së konsumatorëve. Nuk duhet të harrojmë se të drejtat e konsumatorit na vendosin të gjithëve në një nivel, sepse të gjithë jemi së pari konsumatorë dhe përfitues shërbimesh, pavarësisht funksioneve të momentit. Në këtë kuadër, kryerja korrekte e detyrës funksionale të të gjithë institucioneve dhe organeve shtetërore të ngarkuara nga ligji, ofron një shans më shumë në jetën tonë individuale dhe kolektive.

Të drejtat e konsumatorëve si një grupim i veçantë i të drejtave të individëve apo grupeve të tyre, janë parë me prioritet nga Institucioni i Avokatit të Popullit, i cili që në fillimet e punës së tij ka qënë tepër i ndjeshëm, lidhur me respektimin e këtyre të drejtave. Sikurse në ligjin tashmë të shfuqizuar nr.9135 datë 11.09.2003 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, edhe në Ligjin nr.9902 datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, në fuqi, Avokatit të Popullit i njihet një rol i veçantë në nenin 56 të tij, për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në bazë të ankesave që ata paraqesin në këtë institucion, apo edhe përmes çështjeve që ai mund t’i shqyrtojë me iniciativë. Ankesat e trajtuara kanë qënë jo vetëm individuale, por edhe ankesa të një komuniteti më të gjerë që ka përfaqësuar qoftë konsumatorë rajonalë, apo edhe konsumatorët në shkallë vendi. Ato kanë qënë të ndryshme dhe të larmishme, duke filluar që nga garantimi i cilësisë së ofrimit të ujit të pijshëm; marrëdhënia konkrete konsumator-furnizues ndërmjet individëve dhe KESH-it; ofrimi i shërbimit dhe tarifave nga ana e operatorëve të telefonisë celulare dhe mbikqyrja e këtij tregu nga ana e ERE-së; rrezikshmëria e ndotjeve elektromagnetike dhe mungesa e legjislacionit në këtë fushë; përmirësimi

i faturimit ndaj konsumatorit të telefonisë fikse; kushtet e shërbimit udhëtar në transportin hekurudhor dhe në atë detar; ofrimi i shërbimeve shëndetësore; eliminimi i mbetjeve mjedisore; ofrimi i shërbimeve nga kompanitë e sigurimit për mbulimin e transportit të mjeteve motorike në rast aksidenti, apo ankesat për cilësinë dhe origjinën e produkteve ushqimore.

Një dimension të ri dhe objektiv ka marrë puna e Institucionit të Avokatit të Popullit, krahas organeve të tjera të administratës publike, pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit të vendit tonë me vendet e BE-së në Qershor 2006, për shkak të detyrimeve që tanimë merren përsipër në nenin 76 të kësaj marrëveshjeje, si në kuadër të përafrimit të legjislacionit, ashtu dhe për përvetësimin e praktikave më të mira korresponduese.

Sidoqoftë, veprimtaria e vazhdueshme e Avokatit të Popullit ka konsistuar në tre drejtime:

Së pari; në drejtim të konstatimit të shkeljeve dhe të problemeve lidhur me zbatimin e legjislacionit të fushës, si dhe në marrjen pjesë aktive në procesin e mirëbërjes dhe përmirësimit të legjislacionit specifik, që lidhet me të drejtat e konsumatorit, konkretisht të Ligjit nr.9902 datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorit”;

Së dyti; në drejtim të zbatimit të Strategjisë ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikqyrjen e Tregut, e miratuar nga Këshilli i Ministrave me VKM-në nr.797 datë 14.11.2007;

Së treti; të ndërhyrjes në organet shtetërore që kanë kompetence zgjidhjen e ankesave dhe marrjen e masave parandaluese, për mospërsëritjen e shkeljeve ndaj të drejtave të konsumatorëve.

Në mbyllje të punimeve të Konferencës, pasi u shqyrtuan dhe u patën në konsideratë të gjitha fjalimet, diskutimet dhe propozimet e pjesëmarrësve, dolëm me këto konstatime dhe përfundime :

1. Hapa të dukshëm janë ndërmarrë në krijimin e një legjislacioni të ri, në përputhje me standartet e BE-së, për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit. Pa dyshim që vendin kryesor në këtë bazë ligjore të re, e zë Ligji nr.9902 datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorit”. Kështu, konstatohet se jemi në fillimet e implementimit të këtij legjislacioni, i cili përfaqëson një praktikë tërësisht të re për ambientin shqiptar dhe që kërkon një ndryshim të mentalitetit të operatorëve ekonomikë, konsumatorëve dhe organeve shtetërore përgjegjëse për kontrollin e tregut, në lidhje me të drejtat dhe detyrimet që ata kanë në këtë marrëdhënie.

2. Këshilli i Ministrave me VKM-në nr.797 date 14.11.2007, ka miratuar Strategjinë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikqyrjen e Tregut, e cila parashikon adoptimin e masave dhe iniciativave në mbrojtje të të drejtave të konsumatorëve dhe mbikqyrjes



së tregut në vend, për një periudhë 7 vjeçare. Mbi bazën e kësaj strategjie, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës ka një rol kyç dhe parësor. Roli i kësaj ministrie deri tani ka qenë më i prekshëm në përgatitjen e drafteve të ligjeve specifike për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.9902 datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, kjo ministri është përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit për fushën e tregtisë, nëpërmjet strukturës përkatëse administrative, Drejtorisë së Mbikqyrjes së Tregut.

3. Konstatohet se megjithë përpjekjet dhe reformimin e bazës ligjore për njohjen dhe garantimin e të drejtave të konsumatorëve, stadi aktual përfaqëson një situatë kaosi dhe ndërthurje kompetencash midis institucioneve të ndryshme lokale dhe qendrore, si dhe shfaqje shqetësuese të fenomenit të korrupsionit në strukturat shtetërore të ngarkuara me kontrollin e tregut apo në ofrimin e shërbimeve parësore.

4. Ndër strukturat përgjegjëse në këtë fushë, mbështetur në Ligjin nr.9902 datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, është edhe Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorit, me kompetenca vendimmarrëse. Një instrument i rëndësishëm është gjithashtu edhe Këshilli Bashkërendues, me rolin konsultativ për shqyrtimin e politikave dhe masave organizative në mbrojtje të interesave të konsumatorit, me një përfaqësim nga ministritë e linjës, organizatat jofitimprurëse të konsumatorëve dhe organizatat e biznesit.

5. Parë nga këndvështrimi i Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, çështje parësore mbetet, jo vetëm mbrojtja e konsumatorit, sigurimi i standarteve të sigurisë ushqimore dhe shëndetit të konsumatorëve në vendin tonë, por edhe të konsumatorëve në ato vende ku ne eksportojmë. Në kushtet e një tregu të hapur dhe me nënshkrimin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë, me të gjitha vendet e rajonit dhe me një pjesë të mirë të vendeve të BE-së, identifikohen si thelbësore problemet e sigurisë ushqimore, si pjesë e proceseve tërësore të integritetit dhe e detyrimeve që lindin nga nënshkrimi nga ana e vendit tonë të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, me vendet e BE-së. Përafrimi i legjislacionit kombëtar me atë komunitar ka njohur zhvillime pozitive, si në procesin e diskutimit të projektligjeve konkrete, ashtu edhe në miratimin dhe hyrjen e tyre në fuqi, siç edhe Ligji “Për ushqimin”, Ligji “Për shëndetin e kafshëve, mbrojtjen e bimëve dhe produktet e mbrojtjes së bimëve”. Po kështu janë përshtatur më shumë se 33 direktiva të BE-së dhe kanë dalë 10 VKM dhe një sërë udhëzimesh, që i përkasin kësaj fushe. Pranë kësaj ministrie funksionojnë drejtori si, Drejtoria e Standarteve apo Drejtoria e Sigurisë Ushqimore dhe e Mbrojtjes së Konsumatorëve, të cilat kane kompetenca ligjore në garantimin e sigurisë të produkteve ushqimore që ofrohen në treg për konsumatorin shqiptar.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.9863 datë 28.01.2008 “Për Ushqimin”, do të krijohet Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, në varësi të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, i cili ende nuk ka filluar nga funksionimi, por që parashikohet të fillojë funksionimin e tij gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2009.

6. Në kuadër të projektit të Paktit të Stabilitetit për “Forcimin e shërbimeve të sigurisë ushqimore”, një nga objektivat kryesore të së cilës është rritja e kapaciteteve kombëtare në fushën e sigurisë ushqimore, përmirësimit, plotësimit dhe përgatitjes së legjislacionit, që ka lidhje me sigurinë ushqimore dhe ushqyerjen sipas standarteve të Bashkimit Europian, rritjen e efektivitetit të aktiviteteve për promovimin e shëndetit dhe reduktimin e sëmundjeve që lidhen me ushqimin dhe ushqyerjen, Ministria e Shëndetësisë ka një rol të pazëvendësueshëm dhe ndërveprues për të bashkëpunuar me institucionet similare në vendet e tjera të rajonit. Reformimi i sistemit shëndetësor, mbështetur në Strategjinë e Sistemit Shëndetësor, ka për qëllim përmirësimin e standarteve të cilësisë së shërbimeve të ofruara dhe aksesit në shërbimet shëndetësore, për vendosjen e pacientit si konsumator në qendër të këtij sistemi.

7. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve, duke konsideruar optimizimin e elementëve të dobishëm të transportit, si shpejtësia dhe komoditeti i lëvizjes, përkundrejt ndikimit negativ mjedisor dhe sigurisë së lëvizjes, ka hartuar politika në funksion të ndërtimit të një rrjeti rrugor modern në të gjithë territorin e vendit dhe të zhvillimit të një transporti në përputhje me udhëzimet dhe kushtet e politikave të vendeve të BE-së. Këto politika kanë si synim që si në transportin rrugor, transportin ndërkombëtar detar të pasagjerëve, transportin hekurudhor të udhëtarëve, apo edhe në transportin ajror të tyre, të arrijnë përmirësimin cilësor të shërbimit ndaj udhëtarëve si konsumatorë dhe mbrojtjen e ambientit nga ndotjet dhe shkarkimet e gazrave. Megjithatë, në këtë proces konstatohet një ndërthurje e kompetencave mes pushtetit qendror dhe atij vendor, gjë që kërkon një bashkëpunim të vazhdueshëm, për respektimin e mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve udhëtarë. Gjithashtu konstatohet, ekzistenca e konkurrencës së pandershme në transportin e udhëtarëve, mungesë e investimeve në transportin hekurudhor ku cilësia e shërbimit lë për të dëshiruar, nevojë për përmirësimin e terminaleve të trageteve në porte dhe të sigurisë që ofrohen në to.

8. Një ndër aktorët kryesorë në fushën e mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të konsumatorit, është Ministria e Integritit. Përmes drejtimit teknik dhe bashkërendimit të procesit të integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian, nëpërmjet përafrimit të legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Europian, hartimit të politikave të integritit, bashkërendimit të ndihmave financiare dhe informimit të

publikut për këte proces, ajo realizon një mbikqyrje të afërt dhe graduale të legjislacionit tonë me atë evropian, lidhur me mbrojtjen e konsumatorit.

9. Ndër strukturat përgjegjëse shtetërore për zbatimin e detyrimeve në fushën e mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve, vend të rëndësishëm zënë Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, Autoriteti i Konkurrencës, Enti Rregullator i Energjisë, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare etj.

10. Shoqatat për mbrojtjen e konsumatorit përfaqësojnë sot një pjesë të pazëvendësueshme të shoqërisë civile, për sensibilizimin, njohjen, respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit. Partneriteti me to, ndërveprimi dhe dinamika e bashkëpunimit të vazhdueshëm janë një domosdoshmëri, e cila kërkohet të konkretizohet në veprimtarinë e përditshme të organeve shtetërore të krijuara në mbrojtje të të drejtave të konsumatorëve, si dhe në hartimin e politikave dhe strategjive në këtë fushë.

11. Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikqyrjen e Tregut, mbulon një spektër të gjerë të të drejtave të konsumatorëve. Ajo përfshin çështje të sigurisë së produkteve dhe shërbimeve, mbikqyrjes së tregut, aspektet ekonomike dhe ligjore në lidhje me pozicionin e konsumatorit në treg, informimin dhe edukimin e konsumatorëve dhe të operatorëve ekonomike, mekanizmat e dëmshpërblimit të konsumatorëve, inkurajimin e shoqatave të konsumatorëve dhe kontributin e tyre së bashku me aktorë të tjerë në implementimin e kësaj strategjie.

12. Në gjykimin tonë, cilësia e prodhimit dhe tregtimit të mallrave ushqimore si dhe cilësia e ofrimit të shërbimeve shëndetësore, të transportit dhe telekomunikacionit, të furnizimit me ujë, me energji elektrike, të shërbimeve të sigurimeve dhe ato bankare etj, ndaj konsumatorëve, është përgjegjësi e subjektit publik apo privat që i ofron këto mallra apo shërbime. Veçse siguria e konsumatorëve dhe mbrojtja e shëndetit dhe interesave të tyre, është përgjegjësi jo vetëm e subjektit prodhues, tregtues apo ofrues, por edhe e shtetit, që duhet të veprojë me mekanizmat e ndryshëm që ai ka ngritur për këtë qëllim.

13. Funkcionimi i Këshillit Bashkërendues për Mbrojtjen e konsumatorëve, ende nuk është në nivelet e kërkuara. Ky konstatim vjen në kushtet kur, ndikimi i këtij instrumenti ndihmës në bërjen e politikave për mbrojtjen e konsumatorit, si nga ana e Qeverisë ashtu edhe nga shoqëria civile në përgjithësi, rezulton shumë i rëndësishëm.

14. Për produktet ushqimore të ofruara në treg, konstatohen probleme që lidhen jo vetëm me cilësinë e tyre, papërputhshmërinë e përbërësve të deklaruar në etiketën e mallit me ato faktike, mungesën faktike të peshës nga ajo e deklaruar në reklamim, por edhe mungesë

veprimi dhe apati e organeve shtetërore kompetente që duhet të veprojnë në këto raste, duke ndëshkuar proporcionalisht biznesin abuzues. Edhe informimi i konsumatorit është në nivele jo të mjaftueshme dhe shpesh sipërfaqësor.

15. Edhe në ofrimin e shërbimeve nga ana e subjekteve publike apo private, konstatohen një sërë problemesh. Ato kanë të bëjnë me vendosjen faktike në kushte të pabarabarta në marrëdhënien konsumator-ofrues shërbimi dhe mosrespektim të njëanshëm të kushteve kontraktuale në ofrimin e shërbimit si në rastin e KESH-it, mosveprim për vendosjen e kontrollit ndaj operatorëve private që ofrojnë shërbime me tarifa tepër të larta kryesisht në fushën e telefonise celulare, si në rastin e ERT-së, cilësi e dobët shërbimi si në transportin hekurudhor, apo edhe çmime që nuk justifikojnë cilësinë e ofruar të shërbimit siç rezulton në transportin detar të udhëtarëve me tragetet e huaja.

16. Megjithëse janë krijuar një sërë strukturash apo organesh shtetërore të reja, për të kontrolluar në treg respektimin e të drejtave të konsumatorit, aktualisht konstatohet se ato nuk janë tërësisht funksionale apo veprimtaria e tyre rezulton të jetë apatike. Ky mosfunksionim ka ndikuar në efektshmërinë e mekanizmit të ankimimit nga ana e konsumatorëve pranë këtyre organeve, duke bërë që të vazhdojë përsëritja e rasteve të shkeljes së të drejtave të tyre, të ketë pasiguri në atë që konsumohet si mall apo shërbim dhe të ketë mungesë besimi në adresimin e individëve konsumatorë për ankesat e tyre pranë këtyre organeve.

17. Ekzistenca e tregut informal është një tjetër shkak për mosfunksionimin normal dhe në baza ligjore të marrëdhënies së konsumatorit me ofruesin e mallit apo të shërbimeve. Megjithë përpjekjet e bëra nga ana e Qeverisë për eliminimin e këtij tregu, ai mbetet përsëri një problem shqetësues.

Mbi bazën e përfundimeve dhe konstatimeve të mësipërme, Konferenca doli me këto rekomandime:

1. Duhet rritur bashkëpunimi ndërmjet organeve të pushtetit qëndror dhe atij vendor, OJF-ve dhe Avokatit të Popullit, si një faktor i rëndësishëm që ndikon në promovimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të konsumatorëve. Gjithashtu nevojitet në vazhdimësi një koordinim më i mirë dhe i kujdesshëm ndërmjet gjithë aktorëve, për të gjitha iniciativat, si në fushën e mbikqyrjes së tregut, ashtu edhe në mbrojtjen e konsumatorëve.

2. Të rritet ndërgjegjësimi i qytetarëve si konsumatorë për të drejtat e tyre, nëpërmjet aktivitetit të OJF-ve që veprojnë në këtë fushë.

3. Ripunimi dhe përmirësimi i legjislacionit të kësaj fushe, duhet të jetë një çështje primare e vazhdimit të procesit të përafrimit të legjislacionit kombëtar me standartet e kërkuara të “Acqius Communautaire”, si dhe për të zgjidhur kaosin aktual dhe mospërputhjen e

kompetencave ligjore, që ekzistojnë ndërmjet organeve të pushtetit qëndror dhe organeve të pushtetit vendor. Legjislacioni i mbrojtjes së konsumatorëve dhe kuadri përkates institucional, duhet të jenë koherente, me përgjegjësi të shpërndara qartë për të shmangur maksimalisht mbivendosjet e kompetencave.

4. Duhet të zhvillohet një aktivitet më intensiv dhe më i prekshëm prej organeve të administratës publike apo enteve rregullatore, të caktuara për mbikqyrjen e respektimit të të drejtave të konsumatorit në treg, sidomos për kontrollin e sasisë dhe cilësisë së ushqimeve, karburanteve, apo të ofrimit të shërbimeve të telefonise fikse, celulare apo edhe të furnizimit me energji, siç p.sh Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, Autoriteti i Konkurrencës, Enti Rregullator i Energjisë Elektrike, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare etj.

5. Duhet të rritet kontrolli ndaj shërbimeve bankare nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare. Njëkohësisht duhet të krijohen mekanizma kontrolli edhe për cilësinë e shërbimeve që merr konsumatori që nga arsimi parashkollor deri tek ai parauniversitar.

6. Përpjekje maksimale duhen bërë për arritjen në një periudhë afat-shkurtër të çertifikimit të produkteve ushqimore të vendit dhe të standartizimit të tyre sipas kërkesave bashkëkohore. Kjo duhet të arrihet me forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe laboratorike.

7. Është i domosdoshëm riorganizimi dhe ristrukturimi i tregut në Shqipëri. Ky riorganizim duhet të përbëjë një nga prioritetet e Qeverisë, e cila deri tani ka kryer investime në disa sektorë të tjerë duke mos i kushtuar rëndësinë e duhur tregut në tërësi. Kjo kërkon përfshirjen imediate dhe të efektshme jo vetëm të investimeve publike, por edhe të atyre private, dhe duke bërë përpjekje për të luftuar informalitetin në treg.

8. Përmirësimi i infrastrukturës së tregjeve, është një nga kërkesat që garantojnë cilësinë e shërbimit ndaj konsumatorit. Del e nevojshme, për shkak të prapambetjes së theksuar në këtë drejtim, nxitja e kapitalit privat për zhvillimin e këtij sektori.

9. Është i nevojshëm fillimi i funksionimit sa më të shpejtë të instrumenteve ndihmës për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve, si Këshilli Bashkërendues apo Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, të cilët do të ndikojnë në të ardhmen që politikat e konsumatorit të jenë jo vetëm të qeverisë, por edhe të shoqërisë civile në përgjithësi. Rol më aktiv duhet të luajë edhe Komisioni për Mbrojtjen e Konsumatorëve në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës.

10. Reformimi i sistemit shëndetësor duhet të synojë përmirësimin e standarteve të cilësisë së shërbimit ndaj pacientit dhe aksesit në shërbimet shëndetësore. Ky reformim duhet të përfshijë në të gjitha programet dhe duhet të gjejë mbështetjen e vazhdueshme të Urdhërave të Profesionistëve (Urdhëri i Mjekut, Urdhëri i Farmacistëve, Urdhëri i

Infermjerit) shoqatave të profesionistëve, shoqatave të pacientëve dhe të të gjithë grupeve të interesit. Del e nevojshme përfshirja e të drejtave të pacientit në një kuadër specifik ligjor, pasi aktualisht nuk ekziston një i tillë.

11. Të bëhen përpjekje për të rritur shkallën e kualifikimit të nëpunësve apo punonjësve të strukturave shtetërore të kontrollit të zbatimit të legjislacionit, për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve dhe të strukturave të menaxhimit të konflikteve në këto raste, si në drejtim të përafrimit të legjislacionit me atë evropian, ashtu edhe për zbatimin e tij në praktikë. Është i nevojshëm gjithashtu, shtimi i stafit për të mundësuar plotësimin dhe zbatimin efektiv të kuadrit ligjor të fushës.

12. Nevojitet një bashkërendim i politikave të konkurrencës dhe politikave për mbrojtjen e konsumatorit, si një domosdoshmëri për realizimin e qëllimit final të rritjes së mirëqënies së konsumatorëve, në një vend në zhvillim si Shqipëria. Aq sa konkurrenca ndihmon konsumatorët, po aq konsumatorët mund ta ndihmojnë konkurrencën dhe të bëhen faktor në luftën ndaj konkurrencës së pandershme.

13. Të konsolidohen të gjitha strukturat e kontrollit dhe mbikqyrjes së tregut nëpërmjet reformave strukturore, shtrirjes së kontrollit jo vetëm në zonat urbane, por dhe në ato rurale, rritjes së shkallës së profesionalizmit, luftës kundër korrupsionit, shkëmbimit të eksperiencave me institucione homologe vendase dhe të huaja. Ky proces duhet të ndikojë në minimizimin e funksionimit të tregut informal.

14. Drejtimet kryesore në veprimtarinë e të gjithë aktorëve dhe faktorëve që veprojnë në garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve, duhet të konsistojnë në:

- Zhvillimin e kontroleve intensive të tregut
- Zhvillimin e fushatave ndërgjegjësuese jo vetëm për konsumatorët por edhe për komunitetin e biznesit
- Gjetjen e një sistemi të përshtatshëm për menaxhimin e ankesave të konsumatorëve
- Gjetjen e një modeli për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtë gjyqësorit.

15. Nevojitet një bashkëpunim më intensiv ndërmjet institucioneve homologe në vendet fqinje, por edhe më gjerë, për të krijuar një ambient ligjor dhe institucional sa më të sigurtë për konsumatorin në vend dhe në rajon.

\*

\* \*

Në përfundim Konferenca konkludoi se, përmirësimi dhe përshtatja e legjislacionit aktual me “Acquis Communautaire”, si dhe një anagazhim serioz dhe më me përgjegjësi i të gjitha institucioneve dhe organeve

shtetërore të kontrollit të tregut, pa përjashtuar këtu kontributin e vlefshëm dhe të vazhdueshëm të të gjithë aktorëve dhe faktorëve të tjerë që veprojnë në këtë fushë, do të ndikojnë ndjeshëm dhe pozitivisht në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të konsumatorëve në vend.

Sipas mendimit të përgjithshëm, Konferenca ja arriti qëllimit për sensibilizimin dhe angazhimin më të madh të të gjitha organeve, strukturave dhe autoriteteve të administratës publike për zbatimin e Kushtetutës, akteve të njohura ndërkombëtare, ligjeve përkatëse si dhe rekomandimeve të kësaj Konference. Rekomandimet ju dërguan Presidentit, Kuvendit, Kryeministrit dhe gjithë ministrive etj, që kanë detyrime në fushën e garantimit dhe mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve. Materialet e Konferencës do të botohen dhe do t'i shpërndahen të gjithë të interesuarve.

Shpresojmë se rekomandimet e kësaj Konference do të vlerësohen me seriozitet dhe do të fillojnë të implementohen nga të gjitha organet kompetente. Institucioni i Avokatit të Popullit do të ndjekë zbatimin e këtyre rekomandimeve.

## 8. Aktivitete të tjera të Institucionit të Avokatit të Popullit, të organizuara në bashkëpunim me organe të tjera shtetërore apo organizata joqeveritare

I. Në bazë të nenit 30 dhe 31 të Ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, njëri nga tre seksionet e Zyrës së Avokatit të Popullit merret edhe me bashkëpunimin me Shoqërinë Civile, dhe konkretisht me OJF-të që veprojnë në fushën e të drejtave dhe lirive të njeriut. Në kryerjen e funksioneve të veta, Avokati i Popullit bashkëpunon ngushtë me këto organizma joqeveritare, duke marrë në mënyrë periodike mendimet e tyre për gjëndjen e të drejtave të njeriut, si dhe organizon një herë në vit një veprimtari kombëtare për një problematikë të caktuar që paraqet gjëndja e të drejtave të njeriut në vend. Për vitin 2008, ky aktivitet, i cilësuar Konferencë Kombëtare, iu kushtua çështjes së të drejtave të konsumatorëve, duke u ndalur veçanërisht në domosdoshmërinë e ripunimit dhe pëmirësimit të legjislacionit në këtë fushë, me qëllim përafrimin e tij me standartet e *Acquis Communautaire* si dhe rritjen e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve përgjegjëse që mbulojnë këtë fushë, të të dyja niveleve. Përveç domosdoshmërisë së riorganizimit dhe ristrukturimit të tregut në Shqipëri, rezultoi i nevojshëm dhe funksionimi sa më shpejt i instrumentave ndihmëse për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve. Ky aktivitet u realizua në bashkëpunim me Zyrën për Mbrojtjen e Konsumatorit (ZMK), ashtu siç shpjeguar më lart.

Për vitin 2008 ka zhvilluar një aktivitet të dëndur, të pakrahasueshëm edhe me vitet e mëparshme, për organizimin e disa konferencave apo aktivitete të tjera të rëndësishme:

1. Tryezë e rumbullakët me temë “Vënia në funksionim e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, sfidat dhe vështirësitë”, Mars 2008.

2. Tryezë e rumbullakët me temë: “Konventat për të drejtat e fëmijëve dhe çështjet e ratifikimit dhe botimit të akteve ndërkombëtare në Shqipëri”, organizuar nga Avokati i Popullit dhe Qendra “Fëmijët Sot”, Prill 2008.

3. Tryezë e Rumbullakët me temë “Shqipëria dhe OPCAT, një hap më tej për parandalimin e torturës”, Korrik 2008.

4. Tryezë e rumbullakët “Mbi Ligjin e ri Për Policinë e Shtetit” në lidhje me shoqërimet, ndalimet e bëra nga policia dhe problemet që dalin në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut”, organizuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit, Ministria e Brendëshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Tetor 2008.

5. Tryezë e rumbullakët me temë “Reforma ligjore dhe sfidat në respektimin e të drejtave dhe trajtimin e të dënuarve në Shqipëri, dhe problemet e dala gjatë ekzekutimit të vendimeve”, organizuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Prokurorinë e Përgjithshme, Dhjetor 2008.

6. Aktiviteti i Avokatit të Popullit në ndihmë të të përmjekurve politikë, dhjetor 2008. Kjo konferencë dhe dy të tjera për torturën janë organizuar bashkërisht me Qendrën Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe Torturës.

II. Krahas ndjekjes së problematikës së përditshme për të shqyrtuar ankesat e qytetarëve, Avokati i Popullit ose përfaqësues të tij, kanë marrë pjesë duke dhënë kontributin e tyre në aktivitete të ndryshme, organizuar nga organizma qeveritare dhe të shoqërisë civile. Ashtu siç kemi theksuar dhe në Raportet Vjetore të mëparshme një gjë e tillë ka qenë dhe mbetet një angazhim sa institucional, aq edhe qytetar i Institucionit të Avokatit të Popullit, për tu investuar dhe thënë fjalën e tij për një problematikë edhe më të gjerë se ajo që paraqitet në statistikat e punës së tij normale.

Më poshtë po ju njohim thjesht me tematikën e këtyre aktiviteteve, që janë organizuar nga partnerë të tjerë dhe ku Institucioni i Avokatit të Popullit ka kontribuar në mënyrë aktive bashkë me grupet e interesit.

1. Pjesëmarrje në Konsorciumin Ndërkombëtar për reformën ligjore në burgje, Shkurt 2008.

2. Tryezë e Rumbullakët me temë: “Roli i shërbimit avokator falas në Shqipëri në mbrojtje të të drejtave të njeriut”, organizuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Mars 2008.



3. Pjesëmarrje në kursin e trajnimit “Lobim dhe Advokim për të Drejtat e Fëmijëve”, organizuar nga Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri -CRCA, Prill 2008.

4. Tryezë e rrumbullakët “Për diskutimin e projekt ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale”, organizuar nga Ministria e Drejtësisë, Prill 2008.

5. Pjesëmarrje në dy tryeza periodike pune pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme, për përgatitjen e Raportit Vjetor mbi punën për zbatimin e rekomandimeve të Komitetit për Parandalimin e Torturës të Këshillit të Evropës dhe Komitetit kundër Torturës të OKB-së, Maj 2008.

6. Tryezë e rrumbullakët me temë “Prezantimi paraprak i projekt strategjisë kombëtare të luftës kundër trafikimit të qënieve njerëzore dhe planit të saj të veprimit 2008-2010”, organizuar nga Ministria e Brendëshme, Maj 2008.

7. Pjesëmarrje në takimin e dytë të punës së Rrjetit të Ombudsmaneve për Fëmijë të Evropës Juglindore, Qershor 2008.

8. Konferenca "Mbi reformën në Administratën Publike", organizuar nga Departamenti i Administratës Publike, Korrik 2008

9. Pjesëmarrje në Konsorciumin Ndërkombëtar për reformën në sistemin penitenciar, organizuar nga OSBE dhe Euroalius, Shtator 2008.

10. Konferencë me temë “Raporti i dytë monitorues për Strategjinë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara dhe Rekomandime për të ardhmen”, Tetor 2008

11. Tryezë e rrumbullakët mbi projektligjin “Për Ndhimën Juridike”, e organizuar nga Shërbimi Ligjor Falas, Ministria e Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë, Tetor 2008.

12. Konferencë me temë “Çështje të zbatimit të nenit 1 të Protokollit të parë Shtesë dhe nenit 3 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut në këndvështrimin e jurisprudencës në Gjykatën Evropiane për vendin tonë”, organizuar nga Ministria e Jashtme, Nëntor 2008.

\*  
\*       \*  
\*

Në të gjitha këto aktivitete dhe të tjera, Institucioni i Avokatit të Popullit ka promovuar rolin, kompetencat dhe juridiksionin e tij në ndërveprimin me institucionet e tjera shtetërore dhe ato të shoqërisë civile. Problematika e diskutuar në to na ka ndihmuar në sqarimin e pozicioneve të ndryshme, në të cilat ndodhemi, në raport me instancat të cilave u drejtohem, nisur nga ankesat konkrete që vijnë pranë zyrës tonë. Kjo pjesëmarrje aktive do të vazhdojë edhe në të ardhmen, pasi bashkëpunimin me organet e administratës publike si dhe me organizmat e shoqërisë civile e shohim si domosdoshmëri për perfeksionimin e mëtejshëm të punës tonë.

## KREU I TRETE

Veprimtaria konkrete e Avokatit të Popullit për ankesat, kërkesat apo njoftimet, të grupuara sipas institucioneve qeveritare

### 1. Këshilli i Ministrave (Qeveria)

Veprimtaria e institucionit të Avokatit të Popullit nuk mund të imagjinohet pa bashkëpunimin e tij konkret me organet e ekzekutivit shqiptar dhe në veçanti me Kryeministrin dhe anëtarët e Qeverisë së tij.

Gjatë vitit 2008 Qeverisë, të kryesuar nga Kryeministri, zoti Sali Berisha, i kemi dërguar zyrtarisht këto rekomandime, propozime apo informacione.

1. Informacion për rekomandimin për mospranimin e propozimit të ri të KESH sha për rritjen e çmimit të energjisë elektrike gjatë vitit 2008, dërguar Kryeministrit, më datë 15.02.2008.

2. Rekomandimi për krijimin e institucionit të edukimit për vendosjen e të miturve që kanë kryer vepra penale, por nuk kanë mbushur moshën 14 vjeç, dërguar Kryeministrit dhe Ministrit të Drejtësisë, më dt. 28.02.2008.

3. Informacion për vdekjen e një foshnje në Fushe-Mamurras të Kurbinit dhe nevojën e rregullimit të legjislacionit për parandalimin e rasteve të tilla, dërguar Kryeministrit, Ministrit të Brendshëm dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, më dt.07.03.2008.

4. Rekomandim për disa plotësime në Projektligjin “Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, dërguar Kryeministrit dhe Ministrit të Shëndetësisë, më datë 07.03.2008.

5. Informacion për përfundimet dhe Rekomandimet e tavolinës së rumbullaket me temë “Shqipëria dhe protokoli Plotësues i Konventës kundër Torturës (CPCAT). Mekanizmi Kombëtar i Parandalimit, mundësi konkrete për parandalimin e Torturës dhe çdo trajtimi tjetër çnjerëzor”, dërguar Kryeministrit, Ministrit të Punëve të Jashtme dhe Ministrit të Shëndetësisë më datë 07.04.2008.

6. Informacion për rekomandimet e Workshopit ndërkombëtar me temë: “Te drejtat e personave të privuar nga liria dhe roli i institucioneve kombëtare të drejtave të njeriut që funksionojnë sipas OPCAT”, dërguar Kryeministrit më datën 17.04.2008.

7. Informacion lidhur me hetimin e pavarur të kryer nga Avokati i Popullit për rastin e shtetasës T. Sh., të bërë publik në media, dërguar Kryeministrit dhe Ministrit të Brendshëm më datën 17.04.2008.

8. Rekomandimi për përmirësimin e kushteve të jetës dhe të qëndrimit në dhomat e sigurimit të shoqërimit të shtetasve në organet vendore të Policisë së Shtetit, të ambienteve ku bëhet aplikimi për pajisjen me pasaporta si dhe për zbatimin e kritereve ligjore për shoqërimin e shtetasve, dërguar Kryeministrit, Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Drejtësisë, më datën 18.04.2008.

9. Rekomandimi për marrjen e masave të menjëhershme për eliminimin e çdo forme të dhunës, trajtimit ç'njëzësor dhe degradues në burgun e Burrelit, dërguar Kryeministrit dhe Ministrit të Drejtësisë, më datën 02.05.2008.

10. Rekomandimi për përsheptimin e punës për realizimin e ndryshimeve ligjore për thjeshtimin e sistemit dhe të procedurave në dhënien dhe rinovimin e lejeve të drejtimit, sipas sistemit "One stop Service", dërguar Kryeministrit dhe Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, më datën 05.05.2008.

11. Rekomandimi për realizimin e iniciativës legjislative, për ndryshime në ligjin nr.9380 dt.28.04.2008 "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të", dërguar Kryeministrit dhe Ministrit të Turizmit dhe Kulturës, më datën 12.05.2008.

12. Rekomandimi për marrjen e masave urgjente për të mundësuar marrjen e vizës italiane për shtetasit Meltina Haka, Klodian Kodra dhe Anisa Sogani, të dëmtuar në aksidentin e Gërdecit, dërguar Kryeministrit, Ministrit të Punëve të Jashtme dhe Ministrit të Shëndetësisë, më datën 16.05.2008.

13. Sugjerimi që të merren në konsideratë mendimet e Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë në hartimin e ndryshimeve të Ligjit Nr.9323, dt.25.11.2004 "Për barnat dhe shërbimin Farmaceutik", dërguar Kryeministrit dhe Ministrit të Shëndetësisë, më datën 27.05.2008.

14. Rekomandimi për marrjen e masave për të bërë pagesat për ish-punonjësit e Institutit të Fizikës Bërthamore, dërguar Kryeministrit dhe Ministrit të Arsimit dhe Shkencës më datën 29.05.2008.

15. Rekomandimi për marrjen e masave organizative dhe ligjore për zgjidhjen e problemit për mosderdhjen e kontributeve shoqërore të bashkëshortit/es së ushtarakeve që kanë përfitur pagesën e papunësisë për periudhën 1993-2003, dërguar Kryeministrit dhe Ministrave të Mbrotjtjes, të Brendshëm dhe atij të Financave, më datën 30.05.2008.

16. Rekomandimi për hartimin dhe paraqitjen për miratim të projekt-ligjit "Për kthimin dhe kompensimin e pronës së luajtshme", dërguar Kryeministrit, Ministrit të Financave dhe atij të Drejtësisë, më datën 04.06.2008. Përsëritur më datën 22.12.2008.

17. Rekomandimi për përgatitjen e ligjit "Për hetuesin (Investigatorin) privat", dërguar Kryeministrit dhe Ministrit të Drejtësisë më datën. 09.07.2008.

18. Rikujtohet sugjerimi për planifikimin e dublimit të rrugës së Plazhit, Plepa-Mali i Robit-Kavajë, dërguar Kryeministrit dhe Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, më datën 18.07.2008.

19. Rekomandimi për miratimin e VKM-se "Për kohën e punës dhe të pushimit të punonjësve të Policisë së Shtetit", në bazë të për zbatim të nenit 87, pika 6, të ligjit nr.9749, dt.04.06.2007, "Për Policinë e Shtetit", dërguar Kryeministrit, më datën 16.09.2008.

20. Rekomandimi për revokimin e pjesshëm të Urdhrit të Ministrit të Rendit Publik Nr.1980, dt.04.06.2004 "Për disa ndryshime në Udhëzimin e MRP Nr.1627, dt.22.01.2002 "Mbi procedurat për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaporta për jashtë shtetit", dërguar Kryeministrit dhe Ministrit të Brendshëm, më datën 19.09.2008.

21. Informacion lidhur me problemet e mos ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prere dhe kërkesë për të nxitur publikisht organet e administratës publike për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, dërguar Kryeministrit më datën 23.09.2008.

22. Rekomandime për disa shtesa e ndryshime në Kodin e Procedurës Penale dhe në Kodin e Procedurës Civile në kuadrin e Reformës në Drejtësi, dërguar Kryeministrit dhe Ministrit të Drejtësisë më datën. 23.09.2008.

23. Informacioni për kërkesën për analizimin e produkteve me origjinë nga Kina që dyshohen për substanca të dëmshme për shëndetin dhe kontrollin e tregut, dërguar Kryeministrit, Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministrit të Shëndetësisë më datën 01.10.2008.

24. Informacion për rekomandimin për të bërë të mundur realizimin e detyrës së Avokatit të Popullit për ankesat kundër vendimeve gjyqësore të formës së prere, duke bërë plotësimet e duhura në Kodin e Procedurës Penale dhe Civile, bazuar edhe në Rekomandimet e KE, dërguar Kryeministrit dhe Ministrit të Drejtësisë më datën 02.10.2008.

25. Informacion mbi kushtet dhe trajtimin aktual të të dënuarit Ilir Dybeku në zbatim të Vendimit përfundimtar Nr.41153/06, dt.18.12.2007 të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut, dërguar Kryeministrit, Ministrit të Punëve të Jashtme dhe Ministrit të Drejtësisë më datën 02.10.2008.

26. Përsëritet Rekomandimi "Për shpejtimin e procedurave, për shqyrtimin e dosjeve të prapambetura në Komisionin Qendror të Dëshmoreve të Atdheut, sipas VKM, nr, 54, dt. 31.01.2007", dërguar zv.kryeministrit më datën 02.10.2008.

27. Rekomandimi për ndryshimin e pikës 8, te nenit 55 te Ligjit nr.8410 dt.30.09.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat ne Republikën e Shqipërisë", për te zgjeruar lirinë e shprehjes, dërguar Kryeministrit më datën 06.10.2008.

28. Informacion për rekomandimin për dhënien e masës disiplinore për zv. Drejtorin e Policisë Qarkut Shkodër Artan Hasani, dërguar Kryeministrit dhe Ministrit të Brendshëm më datën 24.11.2008.

29. Rekomandimi për marrjen e masave te menjëhershme për ekzekutimin e vendimit gjyqësor Nr.44, dt.04.02.1977 te Gjykatës Rrethit Gjyqësor Kurbin, mbështetur nga vendimi Nr.43, dt.19.12.2007, të Gjykatës Kushtetuese, ne favor te shtetasit Beg Haxhiu, dërguar Kryeministrit dhe Ministrit të Brendshëm më datën 04.12.2008.

30. Përsëritet propozimi për ndryshimin dhe përmirësimin e V.K.M., nr.552, dt.27.11.1999 "Për trajtimin ekonomik e financiar te familjeve te punonjësve te policisë te vrare apo plagosur për shkak te detyrës", dërguar Kryeministrit më datën 12.12.2008.

31. Njoftim lidhur me rastin e bere publik ne media për kanosjen, fyerjen dhe dhunimin e dy punonjësve te mjekësisë nga një punonjës policie, dërguar Kryeministrit, Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë më datën 24.12.2008.

32. Informacion për inspektimin ne Qendrën e Fëmijëve te Ngujuar ne Poliçan, dërguar Kryeministrit, Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, si dhe Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, më datën 30.12.2008.

Gjithashtu Kryeministrit dhe ministrave përkatës u janë dërguar edhe tre Raportet e Veçantë:

1. Për mungesën e botimit në Fletoren Zyrtare të Akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Shteti Shqiptar, më datën 23.05.2008.

2. Për gjendjen e shëndetit mendor në Republikën e Shqipërisë, më datën 03.06.2008.

3. Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve, më datën 20.11.2008.

Duke e krahasuar me shifrat e vitit 2007, edhe në zërat e mësipërm ka patur rritje për vitin 2008. Qeveria shqiptare është njoftuar apo vënë në lëvizje nga Avokati i Popullit më shumë dhe më mirë. Në përgjithësi rekomandimet tona janë mirëpritur nga Qeveria dhe ka patur mirëkuptim për t'u marrë me problemet dhe impenjim për t'i zgjidhur ato. Në veçanti përmendim takimin e realizuar nga Avokati i Popullit më datën 4 dhjetor 2008 me kryeministrin Berisha. Siç është theksuar në njoftimin për shtyp të bërë publik nga zëdhënësi i Qeverisë më datën 5 dhjetor 2008...

"Avokati i Popullit, zoti Dobjani e njohu Kryeministrin Berisha me të gjitha përpjekjet e tij dhe të institucionit që përfaqëson në zbatim të Kushtetutës dhe ligjit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të qytetarëve.

Zoti Dobjani shprehu vlerësimin e tij për bashkëpunimin mes institucionit të Avokatit të Popullit dhe Policisë së Shtetit, por u ndal edhe në disa probleme që janë shfaqur këto javët e fundit në këtë bashkëpunim, probleme të cilat janë krejtësisht të shmangshme.

Kryeministri Berisha vlerësoi veprimtarinë e Avokatit të Popullit dhe institucionit të tij në garantimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve. Kryeministri e siguroi zotin Dobjani për mbështetjen e plotë të tij dhe të qeverisë që ai drejton në këtë aspekt. Kryeministri Berisha kërkoi që Avokati i Popullit të mbajë të gjitha qëndrimet ligjore ndaj çdokujt që dhunon apo nuk mbron të drejtat e liritë e qytetarëve dhe të përdorë të gjitha mekanizmat ligjorë në mbrojtje të qytetarëve, të cilëve u cënohen të drejtat nga segmentet e administratës”.

## 2. Ministria e Drejtësisë

Gjatë vitit 2008 janë trajtuar gjithsej 677 ankesa dhe kërkesa që kanë të bëjnë me struktura apo autoritete që janë nën juridiksionin e Ministrisë së Drejtësisë dhe konkretisht me sistemin e burgjeve dhe paraburgimeve (Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve), Zyrat e Përmbarrimit, Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish pronarëve etj.

### A. Ankesat për burgjet dhe administratën e burgjeve

Në lidhje me burgjet dhe personelin e burgjeve kemi patur 322 ankesa. Gjatë vitit 2008, punonjës të stafit të Avokatit të Popullit kanë vizituar të gjitha burgjet dhe paraburgimet e sistemit shqiptar të burgjeve, ashtu si dhe dhomat e shoqërimit dhe të ndalimit të komisariateve të policisë në rrethe. Në fund të vitit 2008 ka patur **4857** të burgosur dhe të paraburgosur në burgjet dhe paraburgimet e sistemit shqiptar të burgjeve, ndërkohë që kapaciteti i tyre është për **4166** të burgosur, pra **691** të burgosur mbi kapacitetin. Gjithësej kanë qenë **4875** persona të privuar nga liria, nga **4554** persona që ishin në fund të vitit 2007, pra **303** persona më shumë.

Gjatë inspektimeve dhe vizitave në këto institucione janë takuar personalisht 427 të dënuar apo të paraburgosur. Në 123 raste ankesat e të dënuarve janë bërë me shkrim.

Në Shqipëri, nga njëri vit në tjetrin vjen duke u rritur dhe konsoliduar interesi i shtetit dhe publikut në drejtim të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të burgosurve dhe të paraburgosurve. Edhe në vitin 2008 të burgosurve ju është ardhur në ndihmë nëpërmjet linjës telefonike që funksionon falas për ankesat e tyre. Edhe gjatë vitit 2008 ka patur ankesa nga të burgosurit se nuk janë lejuar nga administratat e burgjeve të marrin në telefon Avokatin e Popullit dhe se ju është penguar

korrespondenca me Avokatin e Popullit. Prandaj, gjatë vitit 2008 Avokati Popullit në bashkëpunim me OSBE-në ka filluar një projekt për vendosjen e kutive postare në të gjitha burgjet dhe paraburgimet me qëllim për të ardhur në ndihmë të burgosurve dhe te paraburgosurve që të komunikojnë lirshëm me Avokatin e Popullit

Të ndarë sipas burgjeve, gjëndja e ankesave paraqitet si më poshtë:

1. Paraburgimi “Jordan Misja”	Tiranë	ankuar	10 persona
2. Paraburgimi “Mine Peza”	Tiranë	ankuar	5 persona
3. Burgu “Ali Demi”	Tiranë	ankuar	53 persona
4. Burgu i Lushnjës		ankuar	15 persona
5. Burgu i Tepelenës		ankuar	6 persona
6. Burgu i Burrelit		ankuar	11 persona
7. Burgu i Vaqarrit		ankuar	6 persona
8. Spitali burgjeve		ankuar	5 persona
9. Burgu i Rrogozhinës		ankuar	6 persona
10. Burgu i Lezhës		ankuar	19 persona
11. Burgu i Krujës		ankuar	21 persona
12. Burgu i Peqinit		ankuar	78 persona
13. Paraburgimi Vlore		ankuar	2 persona
14. Paraburgimi Durrës		ankuar	1 persona
15. Paraburgimi Kukës		ankuar	2 persona
16. Paraburgimi Sarandë		ankuar	2 persona
17. Paraburgimi Korçë		ankuar	3 persona
18. Paraburgimi Tropojë		ankuar	2 persona
19. Paraburgimi Berat		ankuar	0 persona
20. Nga burgjet jashtë vëndit		ankuar	12 persona

Por në këtë numër nuk janë përfshirë ankesat apo kërkesat me shkrim të familjarëve të burgosurve si dhe kërkesa të tjera që janë paraqitur nga drejtoritë e burgjeve, komisariatet e policisë në rrethe, punonjës të administratës së burgjeve dhe të policisë së burgjeve.

Të ndarë sipas gjinisë, në 108 raste kanë bërë ankesë burrat, në 12 raste gratë dhe në rastet e tjera ankesat apo kërkesat janë dërguar nga drejtoritë e burgjeve, komisariatet e policisë në rrethe apo familjarët e të burgosurve dhe të paraburgosurve.

Sipas mënyrës së përfundimit ankesat paraqiten si vijon:

Për vitin 2008 janë përfunduar 275 ankesa apo kërkesa të ardhura me shkrim, nga 322 të ardhura gjithësej. Ndërsa janë në shqyrtim 47 çështje. Nga këto 78 ose 29% prej tyre janë zgjidhur në favor, 34 kanë qenë jashtë juridiksionit dhe kompetencës, kurse 99 janë gjetur të padrejta.

### Numri i personave në burgje dhe paraburgimet më datë 31.12.2008

Nr.	Institucioni	TE DENUAR											Mbipopullimi
		Burra				Gra		Te mitur		Te semure mendore	shuma	Kapaciteti	
		Siguri e larte	Siguri e zakonshme	Siguri e pashprehur	Te paraburgosur	Te denuara	Te paraburgosura	Te denuar	Te paraburgosur				
1	P/burg "Jordan Misja"				362		32		22		416	320	96
2	P/burg Vlore				145				23		168	125	43
3	P/burg "M.Peza"				236						236	170	66
4	I.E.D.P. Lezhe		410		196				16		622	703	-81
5	I.E.D.P.Burrel	77	50	21	37						185	198	-13
6	I.E.D.P. Tepelene	41	20		76						137	70	67
7	I.E.D.P. Peqin	290	395		105						790	685	105
8	I.E.D.P. Lushnje		271	6							277	189	88
9	I.E.D.P. Vaqarr		144					9			153	146	7
10	I.E.D.P.Rrogozhine		279	6	189						474	343	131
11	I.E.D.P. Ali Demi		65			94					159	80	79
12	I.V. Kruje		138		16						154	196	-42
13	I.E.V.P. Fushe Kruje	136	161		55						352	312	40
14	Spitali i Burgjeve		17		49					79	145	138	7
15	P/burg Durres		3		134				14		151	50	101
16	P/burg Kukës				10						10	36	-26
17	P/burg Sarande				50						50	31	19
18	P/burg Korçe	50	147		88				6		291	312	-21
19	P/burg Tropoje				18						18	25	-7
20	P/burg Berat		1		68						69	37	32
<b>SHUMA</b>		<b>594</b>	<b>2101</b>	<b>33</b>	<b>1834</b>	<b>94</b>	<b>32</b>	<b>9</b>	<b>81</b>	<b>79</b>	<b>4857</b>	<b>4166</b>	<b>691</b>



**Informacion mbi moshën, llojin e veprave penale dhe masat e dënimit për personat që ndodhen në burgje në dhjetor 2008**

Emërtimi	M O S H A							Shuma.	LLOJI I VEPRES PENALE								MASA E DENIMIT						Aktive ne pune	
	Nën 18 vjeç	18<21 vjeç	21<30 vjeç	30<40 vjeç	40<50 vjeç	50<60 vjeç	Mbi 60 vjeç		Vjedhje me dhunë	Vjedhje	Vrasje	Plagosje	Marr Seks	K/vajtje	Droga	Të tjera	0<1 vjet	1<2 vjet	2<5 vjet	5<15 vjet	15<20 vjet	20<25 vjet		Per jete
Burgu 313				1	2			<b>3</b>						1	1	1	1		2					1
I.R.325 (B)		18	33	26	11	4	1	<b>93</b>	14	27	9	5	2	2	18	16	27	18	31	14	1	2		25
I.R.325(G)			22	27	36	11	5	<b>101</b>		5	50		13		19	14	6	3	31	36	15	10		37
I.R.Lushnje		9	70	121	56	27	9	<b>292</b>	13	30	89	9	7	2	85	57	14	18	47	147	35	31		75
B. Burrel		4	45	61	37	8	13	<b>168</b>	44	10	92	3	3		5	11	7	2	15	66	45	13	20	42
B.Tepelen		2	16	38	11	1		<b>68</b>	15	1	23		5		14	10	10	6	20	21	6		5	20
B. Vaqarr	13	24	42	50	28	14	2	<b>173</b>	56	30	20	1	6	2	50	8	15	7	20	80	43	8		51
B. 302			1	2	2	1		<b>6</b>	2	1		2			1				1	5				1
B. Rrogozhi		28	149	67	50	10	4	<b>308</b>	38	16	79	8	8		73	86	13	13	89	155	29	9		101
B. Kruje			14	34	23	18	64	<b>153</b>	8	3	128	1	5		7	1		5	14	79	37	18	10	21
B.F.Kruje		17	103	124	56	18	10	<b>328</b>	40	40	175	3	6		46	18	40	30	59	137	27	13	22	64
B. Peqin		14	299	216	103	45	11	<b>688</b>	65	74	334	12	24		84	95	13	26	75	270	143	102	59	122
B. Lezhe		38	156	165	61	16	7	<b>443</b>	73	15	172	13	6		40	124	55	75	153	140	20			99
Korça		30	47	43	50	30		<b>200</b>	20	12	68	50	20		20	10	3	50	28	88	8	6	7	
<b>SHUMA</b>	<b>13</b>	<b>184</b>	<b>997</b>	<b>975</b>	<b>526</b>	<b>203</b>	<b>126</b>	<b>3024</b>	<b>388</b>	<b>264</b>	<b>1239</b>	<b>107</b>	<b>105</b>	<b>7</b>	<b>463</b>	<b>451</b>	<b>204</b>	<b>253</b>	<b>585</b>	<b>1238</b>	<b>409</b>	<b>212</b>	<b>123</b>	<b>659</b>

## **I. Problematikat e ankesave të të dënuarve me gjykatat**

1. Një nga problematikat që vijon të mbetet shqetësuese për Avokatin e Popullit është mbajtja pa të drejtë në burg e personave që duhet të sistemoheshin në një ambient spitalor për shkak të nevojës për mjekim të detyruar dhënë me vendim nga gjykatat kompetente. Në vijim problem i hapur mbetet mosveprimi i gjykatave për të rimarrë çdo vit në shqyrtim vendimet për mjekim të detyruar, me qëllim për të ekzaminuar rast pas rasti përmirësimin e mundshëm të gjendjes së këtyre personave.

Konkretisht në nenin 46 të Kodit Penal parashikohet se masat mjekësore jepen nga gjykata ndaj personave të papërgjegjshëm që kanë kryer një vepër penale. Vendimi gjyqësor për vendosjen e personit me mjekim të detyruar në një spital është i revokueshëm në çdo kohë, kur zhiduken rrethanat për të cilat ai është dhënë. Por në çdo rast ligji parashikon se gjykata kryesisht është e detyruar që pas kalimit të një viti nga data e dhënies së vendimit, të marrë në shqyrtim vendimin e saj. Nga inspektimet e kryera në Spitalin e Burgut Tiranë, rezulton se aty vazhdojnë të ndodhen 83 persona me vendim gjyqësor me mjekim të detyruar. Mjaft prej tyre kanë një periudhë të gjatë që qëndrojnë aty dhe ndaj tyre gjykatat nuk kanë rimarrë në shqyrtim vendimet përkatëse. Avokati i Popullit e ka ngritur këtë çështje jo vetëm në institucionet qëndrore të shtetit dhe Këshillin e Lartë të Drejtësisë, por edhe në Kuvendin e Shqipërisë me anë të një raporti të posaçëm. Megjithatë vënien në lëvizje të disa prej gjykatave, gjykojmë se ka ende shumë punë për t'u bërë.

Ritheksojmë se mbajtja e këtyre personave në Spitalin e Burgut Tiranë është një veprim i kundraligjshëm, mbasi ato duhet të vendosen në një institucion të veçantë mjekësor, jashtë sistemit të burgjeve. Mbajtja e tyre në Spitalin e Burgut është shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut. Kohët e fundit jemi njohur me përpjekjet e Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë për të hapur Institutin e Shërbimit Mjekësor Ligjor në qytetin e Durrësit. Por përsëri ka probleme për mënyrat se si do të administrohet kjo qendër dhe garancitë që do të gëzojnë personat që do të shtrohen aty, për të cilat institucioni ynë po punon që të zgjidhen sipas ligjit.

2. Ulja e dënimit parashikohet nga neni 63 i Ligjit nr.8328 datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim", ku thuhet se: "Të dënuarit që zbatojnë rregullat dhe kanë pjesëmarrje shembullore në veprimtarinë trajtuese, duke dhënë prova për riintegrimin në shoqëri mund të përfitojnë një ose disa ulje deri në 90 ditë në çdo vit të vuajtjes së dënimit. Në burgjet e sigurisë së lartë ulja e dënimit bëhet deri në 45 ditë. Për dhënien e këtij shpërblimi të veçantë, vlerësohet qëndrimi i të dënuarit nga ulja e mëparshme ose gjatë 12 muajve të fundit.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka patur shpesh ankesa nga të dënuarit ku pretendimet kryesore kanë qenë se këto gjykime vonohen nga gjykatat; se gjykatat këto lloj gjykimesh nuk i zhvillojnë në burg dhe për rrjedhojë shpesh konstatohen edhe shkelje të afateve të gjykimeve të çështjeve, ç'ka ndikon negativisht në përfitimin e kësaj të drejte nga të dënuarit. Nga një studim i bërë së fundi nga ana jonë për Burgjet e Kosovës së Lushnjës dhe Peqinit del se rreth 1500 kërkesa që i drejtohen çdo vit Gjykatës së Elbasanit janë një numër i papërballueshëm për t'u shqyrtuar në kohe dhe me cilësi nga ajo gjykatë.

Ndaj duhet parë një ndarje më e mirë e ngarkesës së gjykatave që të mos tolerohen zvarritjet e gjykimeve dhe për rrjedhojë humbjet e së drejtës për përfitim ulje dënimi nga ana e të dënuarve. Për këtë Avokati i Popullit ka rekomanduar që Gjykata e Lushnjës të marrë brenda juridiksionit të saj Burgun e Kosovës së Lushnjës, si dhe gjykimet aty ku është e mundur të realizohen brenda ambienteve të burgut, siç është vepruar me parë në Burgun e Peqinit. Në përgjigje të këtij rekomandimi, Drejtoria e Përgjigjithme e Burgjeve e ka përkrahur këtë propozim dhe po vazhdojnë diskutimet në Ministrinë e Drejtësisë për rregullimin ligjor të kësaj çështje.

**3.** Në nenin 64 të Kodit Penal, thuhet se: “I dënuari me burgim mund të lirohet para kohe nga vuajtja e dënimit vetëm për arsye të veçanta nëse me sjelljen dhe me punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij si dhe ai të ketë vuajtur jo më pak se gjysmën e dënimit të dhënë për kundravajtje penale, dhe jo më pak se 2/3 e dënimit për krime me masa dënimi gjer në 5 vjet burgim, dhe jo më pak se 3/4 e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi nga 5 deri 25 vjet burgim. Në dënimin e vuajtur llogaritet vetëm koha efektive e vuajtjes së dënimit me burgim, duke mos u përfshirë në të, koha e përfituar nga amnistia apo me falje”.

Në këtë drejtim ka lindur problemi se a duhet llogaritur në këtë rast koha e përfituar nga ulja e dënimit nga gjykatat në aplikim të Nenit 63 të Ligjit “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”. Gjykatat në disa rretheve në vendimet e uljeve të dënimit kanë shprehur qëndrime të ndryshme mbi këtë fakt. Ndërkohë që Avokati i Popullit duke marrë në këtë rast në konsideratë edhe pretendimet e të dënuarve është i mendimit që uljet 90 dhe 45 ditore duhet të llogariten në kohën për lirimin para kohe. Gjithsesi për shkak të qëndrimeve të ndryshme që kanë gjykatat, është e nevojshme që kjo çështje të bëhet sa më parë objekt shqyrtimi për unifikim praktike gjyqësore nga ana e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

**4.** Një problem tjetër që është ndeshur gjatë kësaj periudhe nga ankesat e ardhura në institucionin tonë ka qënë edhe fakti se gjykatat në

vendimet e tyre nuk kanë përcaktuar llojin e sigurisë së Burgut se ku duhet vuajtur dënimi i dhënë nga gjykata.

Në nenin 13 të ligjit nr.8328 date 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, thuhet se :” Burgu i sigurisë së lartë është institucioni ku ekzekutohen vendimet me burgim për subjekte të krimit të organizuar, dhe të dënuar të tjerë të cilët në kryerjen e veprës penale ose gjatë vuajtjes së dënimit janë karakterizuar nga qëndrime e sjellje që bëjnë të pamundur qëndrimin në burgjet e kategorive të tjera”.

Vendosja e të dënuarit në Burgun e sigurisë së lartë kur nuk është shprehur gjykata në vendim, bëhet me kërkesë të Prokurorit tek ajo gjykatë.

Kur i dënuari vuan dënimin dhe është vendi për transferimin e tij në një burg të sigurisë së lartë sipas kriterëve të këtij ligji, kërkesa e Prokurorit i paraqitet gjykatës së vendit ku ndodhet institucioni.

Transferimi nga burgu i sigurisë së lartë në institucionet e tjera të vuajtjes së dënimit bëhet me kërkesë të vet të dënuarit, pra të gjykatës ku ndodhet institucioni.

Në këtë drejtim ka patur dhe ka ende probleme, mbasi nga ankesat e ardhura dhe nga inspektimet tona janë konstatuar raste flagrante ku persona të moshuar apo me probleme fizike vuajnë dënimin në burgje të sigurisë së lartë, apo persona të tjerë për të cilët gjykata në vendimin e tyre nuk janë shprehur që ato të vuajnë dënimin me burgim në burgje të sigurisë së lartë. Nga ana e jonë rast pas rasti mbasi janë kryer verifikimet e nevojshme është bërë rekomandim për ndreqjen e shkeljeve dhe ato janë pranuar. Megjithatë duhet thënë se ende ka persona të cilët vuajnë dënimin në burgjet e sigurisë së lartë, kur në fakt nuk duhet ta vuajnë dënimin me burgim, në regjimet e sigurisë së lartë.

**5.** Një problem që ka dalë nga ankesat e ardhura në Institucionin tonë, është edhe llogaritja e paraburgimit pas qëndrimit në dhomat e paraburgimit mbasi vendimet gjyqësore kanë marrë formë të prerë. Në këtë drejtim është kërkuar nga të dënuarit që ndaj tyre të zbatohen kërkesat e nenit 57 të Kodit Penal, ku 1 ditë paraburgim t’u njihet e barabartë me 1 ditë e gjysëm burgim. Nga institucioni ynë ky problem është ngritur disa here, madje edhe Kuvendit të Shqipërisë për faktin se disa persona kanë qëndruar nga disa muaj deri në 2-3 vjet në paraburgim mbasi vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë. Për këtë është kërkuar të bëhet plotësim i ligjit nr.7941 datë 31.05.1995 për hyrjen në fuqi të Ligjit nr.7895 datë 27.01.1995 Për Kodin Penal në RSH, që të përfitojnë edhe personat e dënuar dhe të mbajtur për disa kohë në kushte paraburgimi. Kjo kerkese megjithë interesimin e madh të institucioneve kompetente nuk ka marre ende nje zgjidhje definitive.

## **II. Problemet e ankesave të të denuarve dhe paraburgosurve me Prokurorine**

1. Avokati i Popullit me iniciativën e tij ka regjistruar dhe filluar hetimin e rastit të bërë publik në media dhe konkretisht në “Gazetën shqiptare” të datës 17.07.2008 , në artikullin “ E harrojnë në qeli , kallëzon prokurorin”. Nga hetimi administrativ i kryer rezultoi se:

Shtetasi K. P nga Saranda me vendimin penal nr.276 datë 14.10.2007 të Gjykatës Ushtarake Tiranë është gjykuar dhe dënuar në mungesë me 6 muaj burgim për veprën penale të “Shmangies nga shërbimi i detyrueshëm ushtarak”. Nga policia e Tiranës ai është kapur dhe arrestuar më datën 11.03.2008. Pavarësisht se organi i akuzës është përfaqësuar me prokurorin A.P. në gjyqin për rivendosjen në afat të ankimit të shtetasit K. P , Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datën 14.04.2008 i ka dërguar Prokurorisë kopjen e vendimit të saj Nr. 587 akti me të cilin është vendosur pranimi i kërkesës së kërkuarit për rivendosjen në afat të ankimit kundër vendimit Nr. 276 datë 14.11.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ndërkohë Gjykata i ka dërguar Prokurorisë dhe kopjen e ankimit të shtetasit.

Me kërkesën e tij me objekt rivendosjen në afat më datën 18.03.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka rivendosur në afat kërkesën e tij të ankimit ndaj vendimit gjyqësor. Nga verifikimi ynë rezultoi se ky person ka qëndruar padrejtësisht në burg nga data 18.03.2008 deri më datën 17.07.2008, pra mbi 3 muaj e 17 ditë. Me datën 17.07.2008 Prokuroria ka lëshuar urdhërin për lirim të tij.

Në bazë të nenit 417 të Kodit të Procedurës Penale me rivendosjen e kërkesës në afat nga gjykata, për t’u ankuar ndaj vendimit gjyqësor deri në shqyrtimin e çështjes nga Gjykata e Apelit Tiranë, ekzekutimi i vendimit penal duhej të pezullohej mbasi ai nuk ka qënë më vendim i formës së prerë.

Me këtë veprim të kryer nga Prokurorët e sektorit të ekzekutimit të vendimeve penale në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, shtetasit K. P i është hequr padrejtësisht liria e garantuar në nenet 27 dhe 30 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, dhe dispozitat proceduriale të parashikuara në nenet 417, 462-464 të Kodit të Procedurës Penale.

Në këtë rast Avokati i Popullit ka rekomanduar Prokurores së Përgjithshme fillimin e hetimeve ndaj 4 prokurorëve në Prokurorinë e Tiranës, për veprat penale të “Mosmarrjes së masave për të ndërprerë gjendjen e paligjshme” dhe “Shpërdorim detyre”, parashikuar përkatësisht nga nenet 251 dhe 248 të Kodit Penal.

Rast i njëjtë është edhe ankesa e shtetasit B. D. nga Tirana, i cili është mbajtur 17 ditë në burg pa të drejtë.

Po kështu edhe shtetasi kosovar I. S, është mbajtur padrejtësisht në burg për 8 ditë.

Por edhe para vitit 2008 Institucioni ynë ka ndjekur ankesa të kësaj natyre, për mbajtje të padrejtë në burg nga Prokuroria në Tiranë apo në Fier etj.

Për t'i dhënë zgjidhje këtij fenomeni, kemi bashkëpunuar me Prokurorinë e Përgjithshme dhe Ministrinë e Drejtësisë, por ende nuk është gjetur një zgjidhje e përshtatshme për t'i prerë rrugën rasteve të tilla.

2. Ankesën e të dënuarve që vuajnë dënimin në I.E.V.P.Burrel si Z.F. Gj.R. etj, që janë ankuar ndaj Prokurorisë së atij rrethi për faktin se në mënyrë të padrejtë ju ka hequr ditët e punës për efekt të shlyerjes së dënimit.

Konkretisht këta të dënuar bëjnë fjalë për punën që ata dhe të dënuare të tjerë kryejnë në mjedise brenda burgut si kuzhinier, elektrikist, punonjës i bibliotekës, hidraulikut etj. Pas llogaritjeve të bëra rezultojnë se të dënuarit Z.F. i janë njohur për efekt të shlyerjes së dënimit 8 muaj e 16 ditë vuajtje dënimi. Ndërsa për të dënuarin Gj.R. 4 muaj e 15 ditë. Në zbatim të urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 3223 datë 08.10.2004, Prokurori i Rrethit Gjyqësor Mat ka urdhëruar korrigjimin e ditëve të vuajtjes së dënimit. Gjykata e Matit ka rrëzuar kërkesën e të dënuarve kundër vendimit të mësipërm të Prokurorit të Matit.

Urdhëri i Prokurorit të Përgjithshëm detyron prokuroritë e rretheve që të kundërshtojnë vendimet e gjykatave për rastet kur të dënuarve u janë ulur dënimet, si dhe të nxjerrin urdhërat përkatëse drejtuar Administratës së Burgjeve për korrigjimin e evidencave, duke quajtur praktikë të gabuar njohjen e ditëve të punës për efekt të shlyerjes së dënimit. Përsa i përket të dënuarve që kanë ardhur nga burgjet e huaja thuhet se, të dënuarit e ardhur nga Greqia duhej t'i ishin drejtuar gjykatës përkatëse të shtetit grek.??

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në shkresën e saj nr. 3802 datë 09.08.2005 përgjigjet ndërmjet të tjerave se urdhërin e Prokurorit të Përgjithshme e zbaton vetëm Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Mat.

Për sa me lart, rezultojnë se për shpërblimin e punës të të dënuarve nuk ka dalë asnjë akt nënligjor në zbatim të nenit 34 të Ligjit Nr. 8328 datë 16.4.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim" i ndryshuar, megjithëse Avokati i Popullit i ka rekomanduar disa herë Qeverisë dhe Ministrisë së Drejtësisë që të nxjerrin aktet nënligjore të nevojshme, por deri tani kjo gjë nuk është bërë e mundur.

Problemi që ngrenë ankuesit është shqetësim dhe i një numri të konsiderueshëm të dënuarish që punojnë në burgje të ndryshme të vendit. Zbatimi i urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm jo vetëm mbron shpërblimin për punën e kryer, por krijon premisa që të dënuarit që

punojnë brenda territorit të burgut në shërbimet e sipërpërmendura , ta bojkotojnë atë.

Në këto rrethana Avokati i Popullit qysh më datën 22.09.2005 i ka dërguar Ministrin të Drejtësisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm, rekomandim për rregullimin e çështjes së uljes së dënimit për të dënuarit që punojnë në burgje dhe marrjen e masave për korrigjimin e pasojave të aktit të nxjerrë nga Prokurori i Përgjithshëm me shkresën Nr. 3223 datë 08.10.2004, dërguar Prokurorive në rrethe.

Në përgjigjen e tij ish Prokurori i Përgjithshëm refuzoi rekomandimin tonë duke e quajtur kërkesën e të dënuarve të padrejtë dhe të pabazuar në ligj. Ndërsa Ministri i Drejtësisë mirëpriti rekomandimin e Avokatit të Popullit duke sqaruar se po punohet për përgatitjen e aktit normativ për organizmin dhe zhvillimin e veprimtarisë së punës në Institucionet e Ekzekutimeve të Vendimeve Penale.

Më datën 17.07.2008 ne kemi përsëritur rekomandimin Prokurores së Përgjithshme, duke kërkuar revokimin e urdhërit të ish Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 3223 datë 08.10.2004, i cili shkel të drejtat e të dënuarve dhe konsideruar atë si një akt relativisht të pavlefshëm.

Prokuroria e Përgjithshme ka kthyer përgjigje duke sqaruar se më datën 09.09.2008 i është kërkuar Ministrin të Drejtësisë që të iniciojë një amendament shtesë në Ligjin “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, ku të përcaktohet qëndrimi të dënuarve për punën e kryer nga ana e tyre në burgje.

### **III. Problemet e ankesave të të dënuarve dhe paraburgosurve me Administratën e Burgjeve**

1. Megjithë masat e marra për hapjen e institucioneve të reja të vuajtjes së dënimit, mbipopullimi vijon të mbetet një problem kryesor në burgje. Avokati i Popullit e ka nënvizuar shpesh rëndësinë e uljes së numrit të të dënuarve në burgje, për të respektuar standartet e hapësirës për jetesë, pasi mbipopullimi është shkaku kryesor i amortizimit të ambienteve të burgjeve dhe cilësisë së dobët të shërbimeve ndaj të dënuarve. Gjithashtu mbipopullimi ka sjellë në shumë raste që të mos respektohet rregulli që vuajta e dënimit të bëhet pranë qendrës së banimit, duke shkaktuar vështirësi jo vetëm për të dënuarin, por dhe për familjarët e tij. Po ashtu mbipopullimi ka sjellë që shpesh të dënuarit me regjim të ndryshëm sigurie të sistemohen brenda të njëjtit ambient, apo që të dënuar të ndryshëm të strehohen me afate të gjata kohore në dhomat e izolimit, pa qenë të dënuar me masa disiplinore siç ka ndodhur në Burgun Vaqar.

2. Avokati i Popullit gjatë inspektimeve të tij ka konstatuar se burgjet nuk kanë patur një rregullore për menaxhimin dhe monitorimin e

veprimtarisë vetjake të blerjes së ushqimeve dhe mallrave të tjera të konsumit të të dënuarve. Gjatë këqyrjes në dhomat e burgut dhe torturave është vënë re se shitësit e produkteve kanë spekuluar me çmimet dhe cilësinë e produkteve ushqimore, nën hundën e drejtuesve të burgjeve (veçanërisht me kartat e telefonisë fikse). Ky problem ka gjetur së fundi zgjidhje, pasi me propozim të Avokatit të Popullit dhe duke e ndjerë një nevojë imediate, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka nxjerrë një rregullore të veçante mbi menaxhimin e shërbimit të mësipërm.

**3.** Një nga pretendimet e drejta që ngrenë shpesh të dënuarit janë masat e tyre disiplinore, të cilat nuk parashkruhen në rastin e kalimit të periudhës 6 mujore dhe pasqyrohen në dokumentet që paraqiten në gjykatë për uljet vjetore të dënimit të dënuarve ose lirimit para kohe. Në fakt në këto raste masat e marra pasqyrohen në kartelën e të dënuarit dhe përbëjnë pengesën kryesore për një qëndrim të drejtë të gjykatës në favor të të dënuarve. Avokati i Popullit ka kërkuar shpesh që kjo praktikë të ndryshojë dhe t'i hapet rrugë lehtësimit të pozitës së të dënuarit, pasi në kushtet kur parashkruhen vepra penale është e palejueshme që kjo të mos ndodhë edhe për shkeljet disiplinore në burg.

**4.** Në disa nga burgjet në vend vijnë të konstatohen probleme të amortizimit dhe kushteve të papërshtatshme të tyre, veçanërisht të lagështirës (Burgu Kosovë i Lushnjes, Burrel), mungesës së ujit (Peqin, Fushë-Krujë), dëmtimit të hidroizolimit dhe kanalizimit (Burgu 313), kushteve në tualete, dushe, ambienteve të ajrimit, dhomave të izolimit etj. Këto probleme janë ngritur shpesh pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Por mendojmë se ato janë një çështje që nuk i takon vetëm këtij institucioni. Për përmirësimin e standarteve të të drejtave të njeriut në vend dhe veçanërisht atyre me statusin e të dënuarit, krahas angazhimit kërkon edhe mbështetje të madhe financiare. Për këtë qëllim në të gjitha rekomandimet që ka parashtruar Avokati i Popullit, veç arritjeve i është kërkuar njëkohësisht Qeverisë për të marrë masa financiare për zgjidhjen e problemeve në infrastrukturën e burgjeve dhe qendrave të paraburgimit.

**5.** Gjatë transferimeve të të dënuarve ka patur ankesa për vonesa në transferimin e numrave të llogarisë dhe të hollave të tyre pranë institucionit të ri të vuajtës së dënimit. Në këtë rast Avokati i Popullit ka sugjeruar që për të kryer në kohë këto procedura Drejtoritë e Burgjeve përkatëse duhet t'i paraprijnë transferimit të të dënuarit me anë të veprimeve paraprake për kalimin e llogarive të tyre. Një propozim i tillë është mirëpritur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe ka filluar të implementohet me sukses.

**6.** Institucioni i Avokatit të Popullit konstaton me shqetësim nevojën e trajnimit të stafit të burgjeve, lidhur me të drejtat e të burgosurve gjatë grevave të urisë, takimeve me familjarët, kontrolleve të të dënuarve dhe familjarëve të tyre. Në këtë aspekt është kërkuar që të



zbatohen Rregullat e Organizatës Botërore të Shëndetësisë mbi menaxhimin e grevave të urisë në burgje. Gjithashtu në respekt të dinjitetit të të dënuarve është kërkuar të trajtohen me një rëndësi të veçantë kontaktet e të dënuarit me familjarët, duke caktuar vende të përshtatshme, pasi në disa burgje ato nuk ekzistojnë.

Gjithashtu për kontrollet që ushtrohen ndaj të dënuarve dhe familjarëve të tyre, duhet nxjerre një akt nënligjor i veçantë, ku të përcaktohen rregulla strikte, të cilat të mos çenojnë dinjitetin e personit. Ky ka qenë se fundi edhe rekomandimi i Avokatit të Popullit në kuadrin e miratimit të Ligjit të ri për Policinë e Burgjeve.

7. Institucioni i Avokatit të Popullit ka përshëndetur miratimin e normës së re të ushqimit në burgje, por referuar ankesave të të dënuarve ka kërkuar nga administrata e burgjeve që të tregohet më tepër kujdes për larminë e tij, pasi në disa burgje ka ankesa të shpeshta në këtë drejtim.

8. Institucioni i Avokatit të Popullit ka treguar shpesh maturi në ndërhyrjet e tij në çështje të veçanta problematike brenda burgjeve, sidomos në rastet e revoltave. Por është rasti të nënvizojmë rëndësinë që duhet të ketë komunikimi dhe negociimi me të dënuarit në vazhdimësi nga drejtuesit e burgjeve dhe jo zgjidhja e problemeve vetëm me forcat e Policisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim është kërkuar që të luhet nga Drejtorët e Burgjeve dhe Sektori i Edukimit.

9. Institucioni i Avokatit të Popullit pa ndërhyrë në punët e brendshme të sigurisë inteligjente në administrimin e burgjeve, ka kërkuar shpesh që puna e SH.K.B-së duhet të fokusohet brenda objektit të përcaktuar me ligj dhe jo të deformatojë kompetencat e saj duke u marrë në disa raste me çështje që kanë të bëjnë me vete të dënuarit. Kjo kërkesë është ngritur, pasi në disa raste të dënuarit janë ankuar se ju bëhet presion nga punonjës të SHKB-se të burgjeve për nxjerrjen e informacioneve apo të dhënave mbi punonjës të veçantë të burgut përkatës.

#### **IV. Rekomandimet e paraqitura nga Avokati i Popullit në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të ligjshme të të dënuarve dhe paraburgosurve për vitin 2008**

Avokati i Popullit gjatë vitit 2008 ka bërë 25 rekomandime me shkrim me objekt përmirësimin e gjendjes në burgje dhe qendrat e paraburgimi në favor të të drejtave dhe trajtimit sa me dinjitoz të të dënuarve. Në vijim po ju paraqesim shkurtimisht rekomandimet:

1. Rekomandim për marrjen e masave të menjëhershme për eliminimin e çdo forme të dhunës, trajtimit ç'njerëzor dhe degradues në Burgun e Burrelit. Ky rekomandim u paraqit nga Avokati i Popullit në përfundim të një inspektimi të bërë nga ana e tij në këtë burg, pas shume ankesave të të burgosurve për dhunë fizike dhe psikologjike. Kjo dhunë

sipas tyre kishte si shkak futjen e frikës tek te dënuarit për parandalimin e arratisjeve te mundshme. Pas propozimeve që parashtrioi Avokati i Popullit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve mori masa disiplinore ndaj disa punonjësve te Burgut Burrel. Njëkohësisht shumë nga problemet e infrastrukturës të ngritura ne këtë raport janë përmirësuar pas disa punimeve te bëra në këtë burg.

**2.** Rekomandim për fillimin e hetimit në ngarkim të shtetasve K. F dhe G. F me detyrë specialistë në sektorin e shoqërim- transferimeve pranë Drejtorisë të Përgjithshme të Burgjeve Tiranë, si dhe të disa policëve efektiv të kësaj drejtorie, për veprën penale të “Torturës” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 86 e 25 të Kodit Penal.

**3.** Rekomandim për marrjen e masave te menjëhershme për eliminimin e trajtimit te dhunshëm dhe degradues ndaj personave që qëndrojnë ne ambientet e paraburgimit Korçë. Ky rekomandim u paraqit nga Avokati i Popullit ne përfundim te një inspektimi te bere nga ana e tij ne këtë qendër, pas shumë ankesave te të paraburgosurve për dhunë fizike. Pas propozimeve qe parashtrioi Avokati i Popullit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve mori masa disiplinore ndaj disa punonjësve te policisë se Qendrës së Paraburgimit Korçë, si dhe ndaj vete Drejtorit te këtij institucioni. Problemet e infrastrukturës te ngritura ne këtë raport janë zgjidhur pas transferimit te kësaj qendre pranë Burgut te ri te Korçës.

**4.** Rekomandim për përmirësimin e procedurave te gjykimit te kërkesave të të dënuarve, për te evituar elemente te procesit te parregullt ligjor nga organet gjyqësore. Ky rekomandim i paraqit nga Avokati i Popullit si rezultat i një studimi te kryer nga ana e tij mbi cilësinë e gjykimeve qe kryente Gjykata e rrethit gjyqësor Elbasan për kërkesat e te burgosurve (në Peqin dhe Lushnje) me objekt lirim para kohe, apo te uljeve vjetore te dënimit. Propozimi i Avokatit te Popullit drejtuar Ministrisë se Drejtësie është qe te ndahet ngarkesa e kërkesave, duke kaluar nen juridiksionin e Gjykatës se Lushnjes Burgun e Kosovës. Ky propozim është duke u shqyrtuar dhe nuk ka marre ende një përgjigje.

**5.** Rekomandim për zbatimin e nenit 27 të V.K.M Nr. 96. datë 09.03.2000 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve. “Për ritet dhe ushqimin fetar në burgje”. Ky rekomandim u paraqit nga Avokati i Popullit ne përfundim te një shqyrtimit te një ankese te paraqitur nga një i dënuar i Burgut Peqin, i cili pretendoi se nuk i respektohej e drejta e konsumimit te një ushqimi sipas besimit te tij. Pas propozimeve qe parashtrioi Avokati i Popullit, Drejtoria e Burgut Peqin mori masa për evidentimin dhe zgjidhjen e këtij problemi ne mënyrë te përhershme.

**6.** Rekomandim për marrjen e masave për ekzaminimin mjekësor dhe sistemimin e mëtejshëm ne Spitalin e Burgut Tirane apo ne Spitalin e Burgut atyre te burgosurve te IEDP-se Burrel te cilët pretendonin se vuajnë nga sëmundje te rënda mendore. Ky rekomandim u paraqit nga

Avokati i Popullit ne përfundim te një inspektimi te bere nga ana e tij ne Burgun e Burrelit, ku u konstatuan 14 te dënuar, qe kërkonin ndihmë të specializuar mjekësore. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve mori masa duke ngritur një grup pune, i cili ekzaminoi nga afër te dënuarit me probleme mendore. Ne përfundim te kësaj procedure 8 te dënuar u transferuan ne Burgun Kruje dhe në spitalin e Burgut Tirane për një kurim me te kualifikuar. Gjithsesi ankesa të tilla tolerohen ne mjaft raste, për shkak te mbipopullimit qe kane këto dy qendra.

**7.** Rekomandim për inspektimin e te drejtave dhe trajtimin e të dënuarve ne Burgun e Grave Nr.325 Tirane. Në përfundim te një inspektimi te bere nga ana e tij në këtë burg Avokati i Popullit i propozoi Drejtorisë se Përgjithshme te Burgjeve qe te merrte masa për përmirësimin e gjendjes se godinave dhe shërbimit ndaj te burgosurave. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve është përgjigjur se do te filloje këtë vit të kryejë disa punime ne këtë burg për përmirësimin e kushteve të domosdoshme.

**8.** Rekomandim për përmirësimin e kushteve dhe trajtimit te te dënuarve te Burgut Vaqar, Tirane. Pas një inspektimi te bërë nga ana e tij ne këtë burg. Avokati i Popullit i propozoi Drejtorisë se Përgjithshme te Burgjeve qe te merrte masa për përmirësimin e gjendjes se godinave dhe shërbimit ndaj te burgosurave, veçanërisht atyre te mitur. Ne këtë burg u evidentuan mjaft probleme lidhur me mbipopullimin. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ne përgjigjen e saj njoftoi se ka përgatitur një plan investimi për meremetimin e këtij burgu, i cili do te vihet ne zbatim gjate vitit 2009.

**9.** Rekomandim për marrjen e masave për përmirësimin e kushteve dhe trajtimit të të dënuarve të sëmurë në Qendrën Spitalore te Burgjeve Tiranë. Ky rekomandim ka lidhje me një sërë problemesh qe u vunë re gjate inspektimit te radhës ne këtë qendër, ku përveç mbajtjes ende te paligjshme te të sëmurëve mendore, u konstatuan edhe probleme te tjera ne shërbimin mjekësore, si p.sh. mos vënia ende ne pune e dhomës se reanimacionit, mbipopullimi, veprimtaritë rehabilituese etj. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Ministria e Shëndetësisë nuk kanë kthyer ende përgjigje për qëndrimin dhe masat qe kane marre për këtë rekomandim. Ndërkohë qe këtë vit pritet te vihet ne pune qendra e re e trajtimit mjekësor ne qytetin e Durrësit për këtë kategori personash.

**10.** Rekomandim për përmirësimin e kushteve dhe trajtimit te të dënuarve te Burgut Kosove, Lushnje. Në përfundim te një inspektimi te bërë në këtë institucion u konstatuan një sërë problemesh lidhur me ambientet e amortizuara te këtij burgu. Pas propozimeve qe parashtroi Avokati i Popullit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka informuar se së shpejti do të ndërhyhet me investime te pjesshme për rregullimin e gjendjes.

**11.** Rekomandim për zgjidhjen e problemeve të konstatuara ne Dhomat e Paraburgimit Kukës. Gjatë inspektimit ne këtë qendër u konstatuan probleme te kushteve te jetesës se te paraburgosurve. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ne përgjigjen e saj njoftoi marrjen e masave për një zgjidhje te shpejte te disa prej problemeve te ngritura, pas miratimit të një projekti te ri te Qendrës se Paraburgimit Kukës, i cili do te vihet ne zbatim këtë vit.

**12.** Rekomandim për përmirësimin e kushteve dhe trajtimit te të dënuarve dhe te paraburgosurve ne Burgun e Peqinit, ku një vend të veçantë zinin mungesa e ujit, mbipopullimi, kontrollet, mungesa e një mjekimi efikas, mungesa e larmisë se ushqimit, çmimet abuzuese me artikujt ushqimor etj.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve pasi verifikoi çështjet e ngritura mori masa konkrete, siç ishte nxjerrja e një akti nënligjor nga ana e Drejtorisë se Përgjithshme te Burgjeve, i cili normoi me rregulla te sakta vepritarine e blerje-shitjeve ne burgje.

**13.** Rekomandim për marrjen e masave te menjëhershme për përmirësimin e trajtimit te të dënuarve ne Burgun e Fushe-Krujës. Pas një inspektimi në këtë burg, pas protestave që bënë te dënuarit për mungesën e ajrimit në dhoma dhe mbylljen e dyerve të qelive 22 orë në ditë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve mori masa te menjëhershme duke modifikuar te gjitha dhomat e burgut me elemente shtesë për sigurimin e një ajrimi te bollshëm ne dhomat e të dënuarve.

**14.** Rekomandim për zgjidhjen e problemeve te konstatuara ne Dhomat e Paraburgimit në Qytetin e Bajram Currit. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ne përgjigjen e saj njoftoi marrjen e masave për një zgjidhje te shpejte te disa prej problemeve te ngritura, dhe informoi për miratimin e projektit të ri të Qendrës se Paraburgimit Kukës, i cili do te zgjidhe në mënyrë përfundimtare trajtimin edhe për te paraburgosurit e rrethit të Tropojës.

**15.** Rekomandim për marrjen e masave për përmirësimin e disa aspekteve te trajtimit te te burgosurve qe mbahen ne Burgun e Krujës. Ky rekomandim u ngrit ne kuadër te një verifikimi për një pretendim te një te dënuari për dhune te ushtruar nga Policia e Burgut. Ne përfundim, Avokati i Popullit, megjithëse nuk provoi te bazuar një pretendim te tille i propozoi Drejtorisë se Përgjithshme te Burgjeve marrjen e disa masave te rëndësishme për te parandaluar dhunën apo vetëvrasjet midis te burgosurve. Ne mënyrë te veçante u kërkua heqja e brisqeve te rojeve, bombulave te gazit etj nga mjediset e sigurisë se te dënuarve, te cilat mund te bëhen shkak për rrezik ndaj jetës se tyre.

Ne projekt-rregulloren e re te burgjeve qe po përgatitet nga Ministria e Drejtësisë këto propozime janë pranuar dhe janë pasqyruar ne dispozita konkrete.

**16.** Rekomandim për përmirësimin e kushteve dhe trajtimit të të dënuarve të Burgut Bënçë Tepelenë. Në përfundim të një inspektimi të bërë nga ana e tij në këtë institucion, ku u konstatuan një sërë problemesh lidhur me ambientet e amortizuara të këtij burgu dhe me mungesa në disa elemente thelbësore të jetesës. Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve ka informuar se së shpejti do të ndërhyhet me investime të pjesshme për rregullimin e gjendjes, pasi në planin afatmesëm në qytetin e Gjirokastrës pritet të ndërtohet një burg i parametrave bashkëkohore.

**17.** Rekomandim për marrjen e masave me qëllim dhënien e një mundësie për të dënuarin A. N, të takojë nënën e tij në burgun 313, në Tiranë. Rekomandimi është ngritur në kuadër të një detyrimi që kanë sektorët e edukimit në burgje për të siguruar lidhjen e të dënuarit me familjarët e tjerë apo me botën e jashtme. Rekomandimi është pranuar. Gjithashtu janë bërë edhe disa rekomandime të tjera për të plotësuar kërkesat e të dënuarve për transferime etj.

**18.** Rekomandim për të rritur bashkëpunimin për kryerjen e detyrës së Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës. Ky rekomandim u krye në kuadër të intensifikimit të rolit inspektues të Avokatit të Popullit në burgje, veçanërisht për verifikimin dhe dokumentimin e rasteve të dhunës. Konkretisht është kërkuar që brenda ambienteve të burgjeve të lejohet përdorimi i aparateve audio dhe video nga Avokati i Popullit për këqyrjen dhe fiksimin e dëmtimeve të mundshme ndaj të dënuarve që pretendojnë për ushtrim dhune. Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve megjithëse e ka mirëkuptuar këtë propozim në parim, nuk ka sjellë pengesa, por ende nuk ka bërë të ditur një qëndrim zyrtar mbi këtë çështje.

Gjatë vitit 2008 bashkëpunimi i Institucionit të Avokatit të Popullit me Ministrinë e Drejtësisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe me të gjitha Institucionet e vuajtjes së dënimit ka qënë në nivele të kënaqshme dhe është vlerësuar për frytet që ka dhënë në zgjidhjen e mjaft problemeve me rëndësi për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve . Mjaft pozitive kanë qenë takimet e përbashkëta ku janë diskutuar një sërë çështjesh me prioritet për miradministrimin e burgjeve.

Njëkohësisht projekti i OSBE-se për vendosjen e kutive postare nëpër burgje dhe qendra paraburgimi është bërë tashmë realitet, duke bashkëpunuar ngushtë me Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve. Projekti është implementuar plotësisht në Tiranë dhe po vijon realizimi i tij i plotë edhe nëpër burgjet e tjera. Ndërkohë që kjo nismë ka gjetur një përkrahje të madhe edhe nga të dënuarit, të cilët shikojnë tek ky projekt garanci të mëdha për parashtrimin pa pengesa të halleve dhe shqetësimeve të tyre.

## **b. Ankesat për Zyrat e Shërbimit Përmbartimor**

Institucioni i Avokatit të Popullit ka treguar një vëmendje të veçantë për veprimtarinë ndaj ekzekutimit dhe zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Për vitin 2008 ankesat për Zyrat e Përmbartimit në Tiranë e Rrethe zënë një përqindje jo të vogël në ankesat drejtuar institucionit tonë. Për vitin 2008 janë regjistruar 113 ankesa.

Nga këto, janë përfunduar 80 ankesa, nga të cilat 17 janë zgjidhur në favor të ankuesve. Për shkeljet nga shërbimit përmbartimor kemi bërë 18 rekomandime, nga të cilat 9 janë pranuar dhe 9 janë pa përgjigje apo në proces shqyrtimi.

Gjithashtu 21 ankesa kanë rezultuar të pabazuara, 2 kanë qënë jashtë juridiksionit, 34 jashtë kompetencës dhe 1 ankesë ka rezultuar me heqje dorë nga ana e ankuesit.

Nga vitit 2007 kanë qënë të mbartura edhe 45 ankesa të të njëjtës natyrë, nga të cilat kanë përfunduar të gjitha. Nga këto, 9 janë zgjidhur në favor të qytetarëve, 7 kanë rezultuar të pabazuara, 3 jashtë juridiksionit, 14 jashtë kompetencës, 7 kanë përfunduar me heqje dorë nga ankuesit dhe 8 janë zgjidhur me rekomandime të pranuar.

Mjaft ankesa kanë rezultuar të pabazuara, mbasi ankuesit kanë kërkuar pezullim të ekzekutimit të titujve ekzekutivë nga Gjykata e Lartë, ose kundër vendimit për kundërshtimin e vendimeve të pezullimit apo të pushimit të çështjes nga përmbartuesit gjyqësor. Për këto vendime ju është sugjeruar ankuesve që të ankohen në gjykatën kompetente, në bazë të nenit 617 të Kodit të Proçedurës Civile.

Ankesat kanë qënë pothuajse për të gjitha Zyrat e Përmbartimit në Tiranë e Rrethe. Sipas statistikave rreth 33 ankesa kanë qënë për zvarritje ekzekutimi nga Zyra Përmbartimore Tiranë, 21 ankesa nga Zyra Përmbartimore Pogradec, 12 kanë qënë ndaj Zyrës Përmbartimore Gjirokastrë, e më pas vijnë ankesa ndaj Zyrës Përmbartimore Vlorë, Durrës, Kurbin, Shkodër, Gramsh, Kavajë, Tropojë, Korçë, Sarandë etj.

Rezulton se më shumë ankesa për shërbimin përmbartimor pas ndërhyrjes tonë, janë përfunduar nga Zyra e Përmbartimit Tiranë. Statistikat tona tregojnë se kjo Zyra ka edhe një pjesë tepër të madhe të praktikave të të gjithë shërbimit Përmbartimor në rang vendi.

Në marrëdhënie me Avokatin e Popullit për vitin 2008, në përgjithësi të gjitha Zyrat Përmbartimore, ju janë përgjigjur kërkesave tona brenda afateve të kërkuara si dhe të shoqëruara edhe me kopjet e akteve dhe veprimeve proçeduriale përmbartimore të kryera. Më pas renditen për sa u takon çështjeve të ekzekutuara, Zyrat e Përmbartimit Gjirokastrë, Korçë, Pogradec, Durrës etj.

Rreth 50% e ankesave drejtuar Institucionit tonë, kanë të bëjnë me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë ku debitorë

janë institucionet shtetërore dhe që janë të detyruar të kthejnë shuma monetare të caktuara. Ky problem është i mbartur nga viti në vit dhe jo vetëm që nuk ka gjetur një zgjidhje, por debiti po shtohet si nga vendimet gjyqësore të reja, ashtu edhe nga ato për pagimin e interesave apo fitimit të munguar, duke u bërë kështu shqetësim kryesor si për Shërbimin Përmbarrimor, ashtu edhe për Institucionin e Avokatit të Popullit. Kryesisht në këto raste të dëmtuar janë protagonistët kryesorë, gjyqfituesit, të cilët pasi janë sorollatur dyerve të gjykatës disa vite derisa kanë marrë në dorë vendimin e saj që ju njeh të drejtën e dëmshpërblimit, pasi paguajnë edhe taksën për shpenzimet e përmbarrimit, nuk marrin asgjë me justifikimin se buxheti i institucionit që është debitor nuk ka para.

Ka edhe mjaft ankesa të tjera që kanë të bëjnë me mosrikthimin në punë të gjyqfituesve, mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore nga ana e Zyrave Vendore të Rregjistrimit të Paluajtshme etj. Me mjaft përparësi janë parë dhe trajtuar edhe ankesat ku titujt ekzekutiv kanë patur si objekt pensionet ushqimor ndaj fëmijëve, për vetë rëndësinë dhe problematikën sociale që ato paraqesin.

Në nderhyrjet tona me mjetet ligjore që na ka vënë në dispozicion ligji, jemi përpjekur në rradhë të parë të tërheqim vëmendjen e Qeverisë dhe institucioneve shtetërore debitore, duke kërkuar zbatimin me rigorozitet të nenit 142/3 të Kushtetutës, nenit 6 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut si dhe për ndryshimin e mentalitetit të tyre që konsiston në moskonceptimin e drejtë të fuqisë së vendimit gjyqësor të formës së prerë. Shpesh ka patur raste që ekzekutimin e vendimit gjyqësor, organe apo autoritete shtetërore e konsiderojnë si jo të detyrueshëm për zbatim, si fakultativ, për të mos thënë që nuk janë të pakta rastet kur marrin guximin që të shprehen se: "...vendimet janë ekzekutuar 50% dhe si të tilla mund të konsiderohen si të ekzekutuara tërësisht".

Gjithashtu një problem tjerër që ka dalë nga trajtimi i ankesave ka qënë edhe niveli jo gjithmonë i kënaqshëm i cilësisë së veprimeve të përmbarruesve gjyqësore, bazuar në kërkesat ligjore të Kodit të Proçedurës Civile. Në shumë raste, gjatë verifikimeve të ankesave me dosjet përmbarrimore, rezulton se ka veprime ose mosveprime, që janë tregues të mangësive të formimit profesional, pavarësisht shkakut apo motivit konkret, si mungesë e njohjes së legjislacionit civil dhe atij proçedural civil, keq interpretim të dispozitivit të vendimit gjyqësor, nënvleftësim, harresë, ngutje, etj.

Ndër shkaqet kryesore që kanë penguar ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë ka qënë edhe qëndrimi jo konsequent i përmbarruesve për zbatimin e kërkesave të ligjit. Janë jo të pakta rastet kur përmbarruesit gjyqësorë zbatojnë nenin 606 të Kodit të Proçedurës Civile

për dënim me gjobë të drejtuesve qëndror e lokal të cilët nuk zbatojnë vendimet gjyqësore. Por, thuhet se nuk zbatohet fare procedimi penal për t'i denoncuar për ndjekje penale në Prokurori sipas nenit 320 të Kodit Penal për moszbatim të vendimit të gjykatës.

Nuk janë të pakta edhe rastet kur Zyrat Përmbartimore nëpër rrethe nuk kryejnë veprimet përmbartimore për ekzekutimin e titullit ekzekutiv pa u paguar taksa përmbartimore prej gjyqfituesit. Ky qëndrim i Zyrave Përmbartimore është mbështetur në nenin 525 të Kodit të Procedurës Civile. Jo në pak raste gjyqfituesit nuk kanë patur mundësi për kryerjen e pagimit të taksës së ekzekutimit në masën 3 % apo 7% duke sjellë për pasojë mosgëzimin e së drejtës të fituar në rrugë gjyqësore. Kjo situatë paraqet domosdoshmërinë e zgjidhjes sa më parë të problemit në favor të gjyqfituesve, me anë të akteve ligjore dhe nënligjore. Ashtu sikundër nuk mund të pengohet dhe pushohet gjykimi i çështjeve civile për shkak të mospagimit të shpenzimeve gjyqësore nga paditësi (ose kërkuesi), po kështu nuk mund të pengohet dhe kushtëzohet kryerja e veprimeve përmbartimore për ekzekutimin e titullit ekzekutiv me parapagimin e taksës së ekzekutimit.

Të shumta janë rastet kur Zyrat Përmbartimore rikthejnë taksën e ekzekutimit për shkak të moszekzekutimit të titullit ekzekutiv në ngarkim të debitorit, pasi ky i fundit rezulton të mos ketë pasuri të sekuestrueshme. Kjo praktikë përforcon mendimin se pagimi i taksës së ekzekutimit të mund të kryhet me vjeljen e saj palës debitore në raport me shumën e vjelë në ngarkim të saj.

Qëndrime të tilla ndaj personave gjyqfitues, kanë ulur besimin e shtetasve ndaj organeve dhe nëpunësve të administratës, duke cënuar reputacionin e shkallën e besueshmërisë të sistemit tonë të drejtësisë. Sot në Shqipëri ekzekutimi i vendimeve gjyqësore është një handikap në sistemin e dhënies së drejtësisë, që në raste të veçanta vë në dyshim funksionimin e vetë sistemit.

Ndër rastet e paraqitura pranë Institucionit tonë mund të përmendim:

1. Ankesën e shtetasit B.H, i cili ankohej për moszekzekutimin dhe zvarritjen prej më shumë se 11 vitesh të vendimit gjyqësor të formës së prerë Nr. 2580 datë 06.11.1997, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Në këtë vendim ishte vendosur lënia në fuqi e vendimit Nr.44 datë 04.02.1997, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin si dhe detyrimi i Këshillit të Rrethit Kurbin, të paguante në favor të ankuesit pagën e punës nga periudha 31.01.1996 deri në 30.09.1996, në shumën prej 135.975 lekë.

Ankuesi duke mos gjetur një zgjidhje ligjore të problemit të tij si dhe duke menduar se i ishte shkelur e drejta e tij për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e moszekzekutimit dhe zvarritjes të vendimit gjyqësor të



mësipërm, i është drejtuar edhe Gjykatës tonë Kushtetuese, me qëllim vënien në vend të të drejtës së tij të cënuar prej vitesh.

Gjykata Kushtetuese nëpërmjet vendimit Nr. 43 datë 19.12.2007, kishte vendosur konstatimin e cënimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si pasojë e moszbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë Nr.44 datë 04.02.1997, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Ndodhur në kushte të tilla, edhe pas moszbatimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese nga ana e palës debitore, Prefekturës së Qarkut Lezhë, ankuesi përsëri ka insistuar dhe kërkoi edhe ndërhyrjen e Institucionit të Avokatit të Popullit. Nga shqyrtimi i këtij rasti nga ana e Institucionit tonë shkak kryesor për mosekzekutimin e këtij vendimi ishte bërë mungesa e fondeve nga ana e Prefekturës së Qarkut Lezhë. Për këtë rast ju drejtuar me rekomandime disa herë vetë Ministrit të Brendshëm si dhe Kryeministrit dhe kërkua që të bëhej e mundur çelja e një fondi të veçantë për Prefekturën e Qarkut Lezhë, apo në rast mungese fondi të bënin planifikimin për në buxhetin e vitit 2009.

Në përgjigje të rekomandimit tonë, shkresës me Nr. 107/1 Prot datë 22.01.2009, të ardhur nga ana e Prefekturës së Qarkut Lezhë si dhe shkresës Nr. 10 Prot datë 09.01.2009 të Zyrës Përmbartimore Lezhë, u vumë në dijeni se Ministria e Brendshme bëri të mundur akordimin e fondeve për likuidimin e vendimit gjyqësor të mësipërm në shumën 135.975 lëke si dhe shumën e detyrimit për interesat si shkak i mosekzekutimit të vendimit gjyqësor në shumën prej 141.808 lekë, pra gjithsej si shumë 277.783 lekë.

2. Ankesa e shtetasit Th.G, që prej 2 vitesh ankohej ndaj Zyrës Përmbartimore Gjyrokastër, lidhur me moskezekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë Nr. 862 datë 10.10.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër. Në këtë vendim ishte vendosur detyrimi i Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë të paguantë në favor të ankuesit pagën e 16 muajve punë si pasojë e zgjidhjes së kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme.

Zyra e Përmbartimit Gjyrokastër në përgjigjen e kthyer drejtuar institucionit tonë na vuri në dijeni se pengesë për ekzekutimin e këtij vendimi kishte qënë fakti i largimit nga puna të përmbartueses. Pas këtij qëndrimi nga ana e Zyrës Përmbartimore menjëherë u rekomandua marrja e masave të menjëhershme me qëllim ekzekutimin e këtij vendimi dhënë në favor të shtetasit Th.G. Pas këtij rekomandimi menjëherë u morrën të gjitha masat e nevojshme duke bërë të mundur ekzekutimin e këtij vendimi nga ana e Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe pagimin e pagës në favor të ankuesit.

3. Ankesa e shtetasit M.P, në të cilën ankohet ndaj Zyrës Përmbartimore Tiranë lidhur me mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të

forëms së prerë Nr. 27 datë 18.01.2007, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Në këtë vendim ishte vendosur detyrimi i Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjistikës të paguantë në favor të ankuesit shumë prej 643.605 lekë si pasojë e zgjidhjes së kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme. Pas marrjes në shqyrtim të ankesës ju drejtuam Zyrës Përmbartimore Tiranë ku kërkua shkaqet e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të mësipërm. Nga ana e tyre u vumë në dijeni se është përgatitur i gjithë dokumentacioni i nevojshëm ligjor për ekzekutimin e këtij vendimi, por ka mbetur pa u bërë likuidimi vetëm për mungesë të firmës së ministrit. Pas kësaj përgjigje ju drejtuam Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjistikës, ku në përgjigje të tyre u vumë në dijeni se vendimi gjyqësor i mësipërm u ekzekutua tërësisht.

4. Ankesa tjetër është ajo e shtetases B.K nga Kavaja, në të cilën ankohej ndaj Zyrës Përmbartimore Tiranë, lidhur me mosekzekutimin e vendimit gjyqësor Nr. 4182 datë 28.10.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në këtë vendim ishte vendosur detyrimi i Nën Prefekturës Kavajë të paguante në favor të saj shumë prej 1.077.839 lekë, si pasojë e zgjidhjes së kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme ligjore. Mbase shqyrtuam ankesën e kësaj shtetase, ju drejtuam Zyrës Përmbartimore Tiranë, për t'u informuar mbi shkaqet e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor. Nga ana e tyre u vumë në dijeni se shkak për mosekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor është bërë Nën Prefektura Kavajë pasi nuk disponon fonde të mjaftueshme për ekzekutimin e këtij vendimi. Pas kësaj përgjigje ju drejtuam Ministrisë së Brendshme me një rekomandim dhe kërkua marrjen e masave për çeljen e një fondi për Nën Prefekturën Kavajë, me qëllim ekzekutimin e këtij vendimi. Në përgjigjen e ardhur nga kjo ministri citohet se u bë e mundur çelja e fondit dhe ekzekutimi i këtij vendimi.

5. Ankuesi H.K ankohej ndaj Zyrës Përmbartimore Gjirokastrë, lidhur me mosmarrjen e masave për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë Nr. 305 datë 27.09.2006. Në këtë vendim ishte vendosur detyrimi i Drejtorisë Rajonale të Rrugëve të paguante në favor të ankuesit 7 paga mujore si pasojë e zgjidhjes së kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme. Pas marrjes në shqyrtim të kësaj ankese ju drejtuam Zyrës Përmbartimore Gjirokastrë ku kërkua me një informacion, shkaqet e mosekzekutimit të këtij vendimi. Në përgjigje të tyre vihem në dijeni se ekzekutimi i këtij vendimi ka mbetur pezull pasi është larguar nga puna përmbartuesi i çështjes. Pas kësaj përgjigje i drejtuam menjëherë një rekomandim Zyrës Përmbartimore Gjirokastrë, ku rekomanduam marrjen e masave të menjëhershme si dhe aplikimin e sanksioneve ligjore në përputhje me Kodin e Proçedurës Civile dhe Kodin Penal për personat që janë bërë pengesë për ekzekutimin e këtij vendimi. Në përgjigjen e ardhur

për këtë rekomandim vihemi në dijeni se në favor të ankuesit u bë i mundur ekzekutimi tërësisht i këtij vendimi.

6. Ankesa e shtetasve G.M dhe M.K të cilët ankohen ndaj Zyrës Përmbartimore Durrës, lidhur me mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë Nr. 368 datë 13.07.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë. Në këtë vendim ishte vendosur detyrimi i Prefekturës së Qarkut Durrës, të paguajë në favor të ankuesve pagën përkatëse si pasojë e zgjidhjes së kontratave të punës pa shkaqe të arsyeshme. Pas marrjes në shqyrtim të kësaj ankese menjëherë ju drejtuam Zyrës Përmbartimore Durrës, për të sqaruar shkaqet e zvarritjes dhe mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të mësipërm. Në përgjigje të kësaj zyre vihemi në dijeni se ekzekutimit i këtij vendimi është i pamundur pasi Prefektura e Qarkut Durrës ka mungesë fondesh. Pas kësaj përgjigje ju drejtuam me një rekomandim Drejtorisë së Planifikimit të Buxhetit pranë Ministrisë së Brendshme dhe rekomanduam marrjen e masave për çeljen e një fondi për Prefekturën e Qarkut Durrës, me qëllim ekzekutimin e vendimit gjyqësor Nr. 368 datë 13.07.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, dhënë në favor të shtetasve G.M dhe M.K. Sipas përgjigjes së ardhur pas këtij rekomandimi nga ana e Ministrisë së Brendshme u vumë në dijeni se në bazë edhe të kërkesës së bërë nga Prefektura e Qarkut Durrës u bë evidentimi i detyrimeve të vendimeve gjyqësore dhe u bë e mundur çelja e fondeve përkatëse për ekzekutimin e gjithë vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

7. Ankesë tjetër është ajo e shtetasit A. Sh. në të cilën ankohet ndaj Zyrës Përmbartimore Elbasan, lidhur me mosmarrjen e masave për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë Nr. 1859 datë 16.10.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Në këtë vendim është vendosur detyrimi i Z.V.R.P.P Elbasan, të kryejë të gjitha procedurat përkatëse për rregjistrimin e një pasurie të paluajtshme. Pas marrjes në shqyrtim të kësaj ankese ju drejtuam me një kërkesë për informacion Zyrës Përmbartimore Elbasan, lidhur me shkaqet e mosekzekutimit të këtij vendimi gjyqësor. Në përgjigjen e ardhur nga kjo zyrë vihemi në dijeni se nga ana e Z.V.R.P.P është refuzuar ekzekutimi i këtij vendimi dhe rregjistrimi i pasurisë në emër të ankuesit pasi vendimi Nr. 525/2 datë 17.03.1995, i K.K.Pronave dhe planvendosja nuk plotësojnë kërkesat e nevojshme për t'u quajtur akte administrative si dhe dokumenti bazë që njih ankuesin si pronar nuk gjendet në arshivën e komisionit të kthimit të pronave. Pas kësaj përgjigje menjëherë i rekomanduam Zyrës Përmbartimore Elbasan aplikimin e sanksioneve ligjore ndaj personave që bëhen pengesë në ekzekutimin e këtij vendimi si dhe Z.Q.R.P.P Tiranë të marrin të gjitha masat e nevojshme me qëllim ekzekutimin e vendimit gjyqësor të mësipërm dhënë në favor të ankuesit. Në përgjigjen e ardhur nga Z.Q.R.P.P Tiranë, vihemi në dijeni se pas

materialit të administruar si dhe bazuar në ligjin Nr. 7843 datë 13.07.1994 “Për Rregjistrimin e pasurive të paluajtshme”, u urdhërua vazhdimi i procedurave të rregjistrimit të pasurisë objekt i kërkesës së paraqitur nga ankuesi.

Krahas rasteve të përmendura më sipër, të cilat janë zgjidhur në favor të ankuesve, vlejné për t’u përmendur edhe disa raste të tjera të cilat edhe pse kanë vite, nuk arrijné të ekzekutohen me pretendimet e mungesës së fondeve apo shkaqe të tjera të pajustificuara ligjore.

1. Ankesa e një grupi prej 16 punonjësish të Zyrës Arsimore Rajonale Pogradec, të cilët ankohen ndaj Zyrës Përmbartimore Pogradec, lidhur me mosmarrjen e masave për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec. Në këto vendime ishte vendosur detyrimi i Zyrës Arsimore Rajonale Pogradec, të paguante ndaj ankuesve dëmshpërblimin si pasojë e zgjidhjes së kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme ligjore. Pas marrjes së kësaj ankese menjëherë ju drejtuam me një kërkesë Zyrës Përmbartimore Pogradec për të sqaruar shkaqet e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të mësipërme. Në përgjigje të tyre vihemi në dijeni se shkak për mosekzekutimin e këtyre vendimeve ka qënë mungesa e fondeve që posedon Zyra Arsimore që të bëjë të mundur ekzekutimin e këtyre vendimeve. Gjithashtu nga ana e Zyrës Arsimore Rajonale Pogradec, jemi vënë në dijeni se këto vendime nuk mund të ekzekutohen edhe për vitin 2009, pasi nuk është dhënë asnjë fond për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

2. Ankesa e shtetasit P.G i cili ankohet ndaj Zyrës Përmbartimore Mirditë, e cila prej më shumë se 4 vitësh nuk bën ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë. Kështu Gjykata e Apelit Tiranë, nëpërmjet vendimit Nr.172 datë 17.02.2004, ka vendosur ndër të tjera detyrimin e shtetasit B. P. të prishë ndërtimin e bërë në parcelën e ankuesit.

Duke e vlerësuar ankesën e këtij shtetasit të drejtë dhe të bazuar në ligj, menjëherë i jemi drejtuar Zyrës Përmbartimore Mirditë dhe kemi kërkuar të informohemi rreth shkaqeve ligjore të mosekzekutimit të këtij vendimi. Në përgjigje të tyre vihemi në dijeni se shkak për mosekzekutimin e këtij vendimi është bërë mungesa e një fadrome prishëse për rrethin e Mirditës.

Pas kësaj me anë të dy rekomandimeve ju drejtuam vetë Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor dhe Ministrit të Drejtësisë dhe kërkuar marrja e masave të menjëhershme dhe gjetja e një fadrome prishëse me qëllim ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë Nr. 172 datë 17.02.2004, të Gjykatës së Apelit Tiranë, dhënë në favor të ankuesit.

Në përgjigjen e ardhur lidhur me këto rekomandime na u sqarua se do merren masa për ekzekutimin e këtij vendimi. Por ky vendim gjyqësor ende nuk ka gjetur asnjë zgjidhje ligjore.

3. Rast tjetër është ankesa e një grupi prej 9 ish ushtarakësh të cilët ankohen ndaj Zyrës Përmbartimore Vlorë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, nëpërmjet vendimeve përkatëse të formës së prerë ka vendosur detyrimin e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Vlorë, të kryej veprimet përkatëse për lidhjen e pensionit si dhe të bëhet likuidimi i detyrimeve financiare të papaguara respektivisht për secilin ankues.

Pas marrjes në shqyrtim të kësaj ankese, nga ana e Zyrës Përmbartimore Vlorë vihemi në dijeni se është kryer kërkesë për “çelje fondi“ pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, meqë financimi i fondit të sigurimeve të ushtarakëve tërhiqet nga I.S.SH. Tiranë, sipas kriterëve të përcaktuara prej tyre, por deri më sot akoma nuk është marrë asnjë masë ligjore për ekzekutimin e këtyre vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Nga shqyrtimi i të gjitha rasteve që kanë patur të bëjnë me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore, duam të ritheksojmë dhe njëherë së është koha që institucionet që administrojnë financat shtetërore, të ballafaqohen me këtë realitet, të mbajnë përgjegjësitë që ju takojnë dhe të punojnë për zbutjen e problemit me mundësitë reale financiare të disponueshëm. Sipas informacionit të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit pranë Ministrisë së Drejtësisë, rezulton se për vitin 2009 janë në proces ekzekutimi 1031 çështje me palë debitore shtetin (organe shtetërore). Gjithashtu i duhet kushtuar vëmendje forcimit të ndjenjës së përgjegjësisë së administratorëve shtetërorë në raport me ligjin, që në veprimet e tyre të përditshme në marrëdhënie me individët, të jenë të kujdesshëm në raporte të tilla të ndjeshme, si dhe respektimin e pronës private, të marrëdhënieve të punës, të interesave të tjera të ligjshme të individëve, pasi cënimi i tyre pa të drejtë, jo vetëm që cënon demokracinë, por rëndon buxhetin e shtetit.

Reforma për rritjen e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë mbetet një nga shqetësimet e vazhdueshme për sistemin e drejtësisë në Shqipëri. Reformat në këtë sektor janë në proces dhe janë përqëndruar në ndryshimet legislative të cilat synojnë të përmirësojnë shërbimin përmbartimor. Për këtë arsye janë propozuar ndryshime në Kodin e Procedurës Civile të cilat lidhen ekskluzivisht me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Gjithashtu, Qeveria Shqiptare me qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor që synon rritjen e numrit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, forcimit të imazhit publik të shërbimit përmbartimor në Shqipëri, rritjes së efektivitetit, transparencës, profesionalizmit dhe të buxhetit financiar të këtij shërbimi ka ligjësuar

liberalizimin e shërbimit përmbartimor ose më saktë ofrimin alternativ të shërbimit përmbartimor privat.

Nga një raport i Bashkimit Europian për vitin 2008, lidhur me konkluzionet e progres raportit për Shqipërinë evidentohet se ka patur një farë progresi në reformat e sistemit gjyqësor, por zbatimi i vendimeve gjyqësore në mënyrë të veçantë për çështjet civile është ende shumë i ngadaltë. Problemi kryesor që evidentohet është mosfunksionimin në mënyrë eficiente i shërbimit përmbartimor pasi ekzekutimi i vendimeve gjyqësore pengohet për shkak të mungesës së fondeve, paqartësisë së vendimeve gjyqësore dhe refuzimit të shumë organizmave qeveritare për të përmbushur detyrimet e tyre. Numri i vendimeve gjyqësore të ekzekutuara vazhdon të jetë ende në nivele të ulëta për shkak të ndikimit të faktorëve të tillë si: situata ekonomike e debitorëve, pengesa në gjetjen e vendbanimeve të debitorëve, situata gjeografike e territorit të vendit, aftësia profesionale e përmbartuesve, kushtet e vështira të punës etj. Vërehet edhe rënia e interesit të ekzekutimit nga organet shtetore, krahasuar me vitin 2005, kur vetë kryeministri Z. Berisha bëri thirrje të vazhdueshme për ekzekutimin e të gjithë vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Pavarësisht se u përqendruam tek mangësitë e zyrave të përmbartimit, theksojmë se sistemi i përmbartimit gjyqësor, ka edhe shumë shëmbuj e praktikë të mirë, dukshëm shumë më të mirë se vitet paraardhëse. Sfida që ka marrë shteti Shqiptar në kuadrin e intergimit në strukturat Euro-Atlantike dhe B.E. pa dyshim që ka në fokusin e saj si objektiv primar fushën e drejtësisë në kryerjen e reformave të thella dhe veçanërisht për rritjen e vendimeve të ekzekutuara.

Institucioni i Avokatit të Popullit edhe në të ardhmen do t'i kushtojë vëmendjen e duhur ankesave ndaj përmbartimit gjyqësor që çënojnë të drejtat dhe interesat e ligjshme të palëve në procesin gjyqësor.

### **c. Ankesa për Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) dhe disa probleme që kanë dalë për aktet nënligjore për regjistrimin e pasurive të paluajtshme**

Për vitin 2008 pranë Institucionit tonë janë paraqitur 117 ankesa, që si objekt të tyre kanë patur pretendime për zvarritje në regjistrimin e pasurisë të tyre të paluajtshme, veçanërisht të apartamenteve dhe oborreve të banesave private dhe zvarritje në procesin e marrjes së certifikatës së pronësisë. 23 ankesa kanë qënë të mbartura nga viti 2007.

Nga 140 ankesa gjithsej janë shqyrtuar 117, nga të cilat 49 janë zgjidhur në favor të ankuesve. Ndërsa 23 të tjera kanë kaluar për shqyrtim të mëtejshëm për vitin 2009.

Gjatë vitit 2008 ka patur një numër të konsiderueshëm të rasteve të zgjidhura në favor të shtetasve, krahasuar edhe në raport me vitet e tjera, çka tregon një përkushtim maksimal të institucionit të Avokatit të Popullit.

Ndër ankesat e zgjidhura në favor të shtetasve, përmendim ankesën e shtetasit N.G., ndaj ZVRPP Berat për vonesa në shqyrtimin e kërkesave për regjistrimin fillestar të një pasurie, që figuronte në emër të gruas suaj, F.G., si dhe mospajisjen me çertifikatën e pronësisë për këtë pasuri.

Ankesa e shtetasës N.H. ndaj Z.V.R.P.P Pogradec për vonesa në regjistrimin e pasurisë dhe pajisjen me dokumentacionin përkatës të pasurisë.

Ankesa e shtetasit Y.Ll., në cilësinë e njërit prej trashëgimtarëve ligjorë të ish-pronarit B.Ll., ndaj ZVRPP Tiranë për zvarritje në procesin e regjistrimit të pasurisë mbi bazën e një titulli të vlefshëm pronësie, zvarritje që kishin shkaktuar mbivendosje të pronës së tij dhe cënim të të drejtave reale të pronësisë për shkak të regjistrimeve të tjera të kryera mbi këtë pasuri të paluajtshme etj.

Ankesa e shtetasit S.K., ndaj Z.V.R.P.P Tiranë lidhur me mosregjistrimin e të drejtës së tij të parablerjes të njohur me vendim të KKKP Tiranë.

Shtetasi Sh.D., ankohej ndaj ZVRPP Durrës lidhur me një vendim për fshirjen e regjistrimit të paligjshëm të pasurive të paluajtshme për shkak të mbivendosjeve.

Shtetasi P.D. për zvarritje nga ana e Z.V.R.P.P Korçë në regjistrimin e një vendimi gjyqësor në regjistrat e pasurive të paluajtshme.

Përveç ankesave të përfunduara në favor të shtetasve, 67 ankesa kanë rezultuar të pa bazuara, jashtë juridiksionit tonë ose jashtë kompetence, pasi kanë qënë në vetvete konflikte pronësie që kërkojnë zgjidhje gjyqësore. Janë konsideruar të pabazuara për faktin se thuajse të gjithë ankuesit konsiderojnë cënim të të drejtave të tyre, përmbushjen e një detyrimi ligjor siç mund të jetë paraqitja pranë sporteleve të ZVRPP e mbajtësit të titullit të pronësisë apo plotësimi dhe dorëzimi i dosjes së pronës që kërkojnë të regjistrohet. Ky fenomen vihet re zakonisht gjatë procedurave që ndiqen nga qytetarët për regjistrimin e apartamenteve të privatizuara, të cilët megjithëse orientohen për detyrimin e tyre ligjor për të dorëzuar dosjen e plotë të privatizimit të apartamentit, nuk e përmbushin një detyrim të tillë, dorëzojnë vetëm një kopje të kontratës së shit-blerjes dhe më pas ankohen nëpër institucione të ndryshme për zvarritje të procedurës së regjistrimit.

Të pabazuara janë klasifikuar edhe rastet kur shtetas të ndryshëm kanë kërkuar ndërhyrjen tonë me qëllim që tu shmangeshin detyrimeve financiare që ato duhet të shlyenin ndaj ZVRPP për të bërë të mundur fillimin e procedurës respektive.

Mos njohja e ligjit dhe mos përgatitja e dokumentave të duhura për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme, janë shkak kryesor që mosveprimet e Z.V.R.P.P.-ve në rrethe, një pjesë e madhe e individëve t'i konsiderojnë shkelje të të drejtave dhe interesave të tyre të ligjshme.

Kështu një pjesë e ankesave kanë qënë të pabazuara, pasi regjistrimi nuk ju është bërë për shkak të mosplotësimit të dokumentacionit përkatës ligjor dhe të mos pasjes së aktit të pronësisë për oborret funksionalë. Ankuesit janë orientuar rast pas rasti dhe ju është sugjeruar forma dhe mënyra e veprimeve që duhet të bëjnë, përfshirë edhe ndjekjen e rrugës gjyqësore për fitimin e pronësisë së oborreve të banesave private me parashkrimin fitues. Lidhur me këtë fakt, deri tani ka qënë e parashikuar në një Vendim të Këshillit të Ministrave që poseduesit e pasurive, të cilët figuronin në regjistrat e pasurive të paluajtshme si "oborr në përdorim" duhet t'u drejtoheshin ZRAKKP-ve, me qëllim që ajo tu kthehej kundrejt një pagese në pronësi këtyre poseduesve. Tashmë nga Ministria e Drejtësisë është në fazën e hartimit një projektligj që do të lehtësojë pikërisht këto procedura për kalimin në pronësi pa kundërshtim të pasurive të paluajtshme që figurojnë në përdorim të poseduesve të tyre.

Mendojmë se ky është një qëndrim i drejtë ndaj këtyre shtetasve, të cilët posedojnë prej vitesh në mënyrë të ligjshme një pasuri të paluajtshme, pronësia e së cilës u ishte mohuar dekada më përpara, mohim i cili vazhdon akoma përderisa ato nuk mund të konsiderohen "de jure" pronar të këtyre pasurive.

Një mangësi që sjell zvarritje në shqyrtimin e këtyre ankesave dhe keq kuptime në marrëdhëniet tona me ankuesit, janë vonesat e pajustificuara në kthimin e përgjigjeve nga disa Z.V.R.P.P. në rrethe, që nuk respektojnë afatet ligjore në kthimin e përgjigjeve apo të ecurisë së rekomandimeve konkrete, duke shkelur Kodin e Procedurave Administrative. Kjo vazhdon të mbetet një e metë e madhe e këtyre zyrave.

Gjatë vitit 2008 ka patur një bashkëpunim të mirë me ZVRPP Tiranë, ku pavarësisht faktit të fluksit të madh të punës për shkak të shtrirjes së madhe të zonës që mbulon kjo zyrë dhe numrit të lartë të ankesave të paraqitura nga qytetarët ndaj kësaj Zyre, drejtuesit e kësaj Zyre i kanë krijuar kushtet e duhura nëpunësve të Institucionit të Avokatit të Popullit për verifikimin e ankesave në vend, konsultimin dhe ballafaqimin e tyre me përgjegjësit e sektorëve përkatës, me qëllim që të arrihet përfundimi i shqyrtimit të ankesës brenda afateve ligjore.

Shkak i vonesave të dhënies së informacionit dhe shpjegimeve të kërkuara nga ana e Regjistruesve të ZVRPP në rrethe, vazhdon të jetë neglizhenca dhe mosrespektimi i detyrimeve ligjore për t'i kthyer përgjigje brenda afateve ligjore si kërkesave të qytetarëve, ashtu edhe



Institucionit tonë. Megjithëse ka patur edhe raste të shumta ku pengesë në shqyrtimin e rasteve dhe identifikimin e saktë të problemit të ngritur ka qenë edhe mosplotësimi i saktë i dokumentacionit për aplikim. Pas sugjerimit tonë për plotësimin e këtyre mangësive, kërkesat e ankuesve janë përmbushur nga ana e Z.V.R.P.P.

Rëndësi të veçantë për mirëfunksionimin dhe administrimin sa më të mirë të punës së këtyre Zyrave është ai i rritjes së shkallës së transparencës të Z.V.R.P.P. në marrëdhëniet dhe komunikimin e tyre me qytetarët. Forcimi i infrastrukturës së tyre, siç është rasti i përmirësimeve rrënjësore me ambientet e reja të funksionimit të Z.V.R.P.P. të rretheve Tiranë, Durrës, etj, ku përveç të tjerave, është rritur ndjeshëm numri i sporteleve dhe i juristëve që kontaktojnë direkt gjatë gjithë orarit zyrtar me aplikuesit, padyshim që, do t'u shërbejë më mirë nevojave të qytetarëve dhe do të çojë në fund të fundit në rritjen e besimit të tyre ndaj këtyre organeve mjaft të rëndësishme të administratës publike.

Vlen të theksohet se gjatë këtij viti ka nisur zbatimin e ligjit "Për verifikimin e titujve të pronësisë", i cili ka sjellë bllokimin e dhënies së titujve të pronësisë nga ana e Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, duke qenë se ka patur një fluks kërkesash me pretendimet për abuzime në zbatim të ligjit 7501, "Për tokën bujqësore" dhe pritjet që të jepet vendimi përfundimtar mbi pretendimet e ngritura. Veprimtaria e këtij Komisioni parashikon edhe një bashkëpunim të ngushtë me subjekte shtetërore, sikurse është Zyra e Regjistrimit të Pasurisë, që në mënyrë periodike i drejtohet me shkresa për verifikim ligjshmërie, për një numër të caktuar njerëzish që kanë aplikuar për regjistrim prone. Në këtë kuadër regjistrimi fillestar i pronës pezullohet deri në momentin e konfirmimit të pronësisë së Komisionit të ngritur.

Një pjesë e shtetasve kanë vështirësi nga më të ndryshme dhe nuk e kanë regjistruar pronën pranë Zyres së Regjistrimit të Pasurisë. Sikurse dihet shpesh ajo është e bllokuar dhe pa verifikimin nga ky komision nuk mund të regjistrohet prona pranë ZVRPP-së. Këto pengesa ekzistojnë prej vitesh dhe kanë mbetur në këtë situatë. Një pjesë ka të bëjë me pasaktësinë në sipërfaqen e pronave, një pjesë tjetër ka edhe mbivendosje pronash. Veçanërisht komuna e Kasharit është mjaft problematike, ku ka shumë mbivendosje. Procesi i verifikimit ka sjellë bllokimin e marrjes së titujve të pronësisë në ZVRPP, pasi kur ka hyrë në fuqi ligji është e sanksionuar se Hipoteka nuk mund të funksionojë, s'mund të bëjë regjistrime pronësie pa dhënë vendimin Komisioni.

Nga ana tjetër theksojmë se është e domosdoshme përsheptimi i procedurave konkrete në reformën e tokës dhe regjistrimin fillestar të saj, me qëllim që të kemi një përjasje jo vetëm të legjislacionit tonë kombëtar me Acquis Communautaire në kuadër të detyrimeve që ka marrë vendi ynë me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, por edhe të

situatës faktike ku çdo shtetas shqiptar të ushtrojë mbi pronën e tij të gjitha tagret e pronarit si edhe të disponojë një akt të ligjshëm që vërteton qënien e tij si pronar, ashtu si çdo qytetar europain i një Europe të bashkuar.

Bashkimi European ka përmbyllur procesin e ratifikimit të MSA-së me Shqipërinë dhe tashmë brenda një periudhe shumë të shkurtër hyn në fuqi Marrëveshja e Stabilizim Asocimit si marrëdhënie kontraktuale mes Shqipërisë dhe BE-së, duke rritur në këtë mënyrë detyrimet e Shqipërisë në përmbushjen e saj.

### **ç) Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave**

Gjatë vitit 2008 pranë institucionit të Avokatit të Popullit janë paraqitur 88 ankesa, midis të cilave edhe nga komunitete dhe grupe individësh, shoqata dhe sindikata, që kanë të bëjnë me problematikën e procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave nga AKKP si në qendër ashtu edhe në qarqe. Dy ankesa kanë qenë të mbartura nga viti 2007.

Duhet theksuar fakti se numri i ankesave ka qenë rreth një e treta më i vogël se sa viti 2007.

Nga ankesat e shqyrtuara gjatë vitit 2008, janë përfunduar 85 prej tyre, nga të cilat 33 janë zgjidhur në favor të ankuesve, 15 kanë qenë të pabazuara, 30 ankesa ishin jashtë kompetencave të institucionit të Avokatit të Popullit, dhe 7 çështje janë arkivuar për heqje dorë nga shqyrtimi i mëtejshëm. Pesë prej tyre, të depozituara pranë nesh në fund të vitit, mbarten për vazhdimin e trajtimit për vitin 2009.

Objekti i ankesave vazhdon të jenë pretendimet për zvarritje në shqyrtimin e kërkesave nga Agjencitë rajonale për njohjen dhe kthimin e pasurive të paluajtshme, ankesa kundër vendimeve të tyre përfundimtare, pretendime për mos kompensimin sipas mënyrave të përcaktuara në ligj për vendime të ish-KKKP të marra prej vitesh, shkelja e të drejtave të informimit dhe kërkesa për t'u njohur me procedurat për të aplikuar pranë organeve të kthimit dhe kompensimit të pronave etj.

Nga verifikimet e bëra rast pas rasti, ka dalë se një pjesë e konsiderueshme e tyre ishin të pabazuara ose jashtë kompetencave, pasi aktet e depozituara pranë Agjencive, kanë patur mangësi të theksuara; të tilla si mungesa dokumentacioni dhe të gen-planeve, mospërcaktimin e saktë të kufijve për identifikim të pronës së pretenduar, mungesës të vendimeve gjyqësore në rastet e mos pasjes së aktit të pronësisë, e të tjera si këto, që kanë bërë praktikisht të pamundur shqyrtimin e tyre. Ndërkohë që ka patur edhe ankesa, objekt i të cilave ka qenë pretendimi i shtetasve për njohje e kthim pronë vetëm mbi bazën e një vendimi gjyqësor për vërtetimin e faktit juridik të pronësisë mbi sipërfaqe të caktuara, vendime

deklarative që nuk regjistrohen në ZRPP të rretheve. Edhe këto çështje janë konsideruar të pabazuara në ligj nga ana jonë.

Për të gjitha këto raste, ju është sugjeruar ankuesve të plotësojnë sa më shpejt dokumentacionin e duhur, që mund ta sigurojnë në Arkivin e Shtetit apo në ato të rretheve, në zyrat e taksë-tatimeve, në kadastër, etj, shoqëruar me sqarime ligjore dhe proceduriale për realizimin e pretendimeve si ish të shpronësuar.

Nga çështjet që kishin të bënin me kontestimet për vendimet e A.K.K.P., ju është bërë e ditur se duhet bërë kundërshtimi i tyre në rrugë gjyqësore, sepse vetëm në këtë mënyrë, mund të arrihet në një zgjidhje me fuqi vendimi të detyrueshëm për zbatim nga të gjithë palët dhe organet shtetërore.

Nga shqyrtimi i një pjese të ankesave, rezultojnë pakënaqësi ndaj Agjencisë Qendrore të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe për mungesë të transparencës për kompensimin financiar që duhej realizuar në fund të vitit, si dhe për ndryshimin e shpeshtë të vlerës së trojeve, me tendencë uljeje. Megjithëse ankuesit i kishin plotësuar dhe dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara për këtë rast, nuk janë vënë në dijeni nëse përfitonin ose jo nga shuma e vënë në dispozicion të të shpronësuarve për vitin 2008. Sidoqoftë, kompensimi financiar aq i reklamuar, u shty javë pas javë dhe përfundimisht është lënë për një kohë të pacaktuar. Të njëjtat shqetësime ngrihen edhe në disa ankesa të tjera, ku ish pronarët kërkojnë kompensimin fizik të pronave të tyre, të njohura me vendim të KKKP, por që asnjëherë nuk janë bërë të ditura të dhënat për sasinë dhe zonat ku mund të përfitojnë nga ky fond.

Një nga çështjet e shqyrtuara dhe që është zgjidhur në favor të ankuesit është ajo që i takon shtetasit M. N. banues në qytetin e Fierit, i cili kërkonte ndërhyrjen e Avokatit të Popullit për vonesa të gjata nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Tiranë. Pas kërkesës tonë, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë, na ktheu përgjigje ku na bënte të ditur se vendimi i kërkuar i ishte dërguar menjëherë të interesuarit. Të njëjtën zgjidhje mori edhe ankesa e shtetasit Xh.H., banues në Tiranë, që pretendonte se i ishte shkelur e drejta e informimit, me gjithë kërkesat e përsëritura, nga e njëjta agjenci. Përmendim edhe rastin e ankesës së shtetasit V.M. banues në Vlorë, te cilit po i cënohej e drejta e pronësisë nga një keqkuptim midis ZRPP dhe AKKP, lidhur me përmbajtjen dhe interpretimin e një vendimi të kësaj të fundit. Pas ndërhyrjeve tona drejtuar të dy institucioneve, u arrit që gjithçka të zgjidhej pozitivisht.

Marrëdhëniet tona institucionale me Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe Zyrat Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për vitin 2008 kanë qënë relativisht të mira. Përgjigjet e kthyerat, me disa përjashtime, kanë qënë brënda afateve ligjore dhe të shoqëruara me kopje të vendimeve të tyre.

### 3. Ankesat për pushtetin gjyqësor dhe administratën gjyqësore. Kontributi i Avokatit të Popullit për Reformën në Drejtësi

Institucioni i Avokatit të Popullit dhe gjykatat janë dy institucionet më të rëndësishme për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ndhimja e institucionit të Avokatit të Popullit, i cili është jashtë gjyqësorit, luan një rol të rëndësishëm për rritjen e efektivitetit dhe besimit të publikut tek gjyqësori.

Në bazë të Kushtetutës dhe të ligjit “Për Avokatin e Popullit” juridiksioni i Avokatit të Popullit në lidhje me gjyqësorin është i tillë, që as prek dhe as rrezikon pavarësinë e gjyqtarëve në dhënien e vendimeve gjyqësore.

Nga praktika disa vjeçare del se ne kemi marrëdhënie të mira dhe mirëkuptim me gjyqësorin. Edhe në të ardhmen marrëdhëniet tona do vazhdojnë të jenë korrekte në këtë drejtim. Kjo sepse të gjithë jemi të interesuar që të realizohen e të respektohen me përpikmëri të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Avokati i Popullit në punën e tij gjatë verifikimit të ankesave dhe kërkesave ka dhënë ndihmën e duhur në punën e gjykatave duke njoftuar në çdo rast me shkrim Ministrin e Drejtësisë, apo Inspektoriatin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për shkelje të ndryshme proceduriale të kryera nga gjyqtarë të veçantë, si dhe për shkelje të kryera nga administrata gjyqësore.

Avokati i Popullit nga ana e tij ndihmon edhe duke kërkuar që organet e administratës shtetërore të zbatojnë patjetër vendimet gjyqësore në të gjitha rastet kur ato kanë marrë formë të prerë. Në këtë mënyrë ne ndihmojmë që të rritet autoriteti i pushtetit gjyqësor, ndaj degës së ekzekutivit, i cili ka treguar në disa raste, se nënvlerëson fuqinë e vendimeve gjyqësore, duke i bërë në këtë mënyrë një dëm të madh imazhit të shtetit të së drejtës.

Avokati i Popullit gjatë kësaj periudhe ka patur akses të kufizuar në gjykatë dhe në asnjë rast gjatë veprimtarisë sonë nuk kemi prekur apo cënuar pavarësinë e gjyqësorit.

#### **Problematika e ankesave**

Gjatë vitit 2008 ndaj gjykatave kanë ardhur me shkrim për shqyrtim gjithsej 312 ankesa, nga të cilat 161 prej tyre kanë qënë kundër vendimeve gjyqësore dhe si të tilla nga ana jonë janë refuzuar. Në këtë numër nuk përfshihen edhe ankesa të tjera që i ka prituri Sektori i Pritjes së Popullit dhe i ka dhënë ndihmë juridike ankuesve, por kanë qënë jashtë juridiksionit tonë.

Për 156 ankesat e tjera, duke i analizuar sipas objektit të tyre, rezulton se ato kanë qënë për këto probleme :

Vendin kryesor të ankesave të ardhura edhe gjatë këtij viti ndaj gjykatave, e zënë ato për zvarritje pa shkaqe ligjore të gjykimeve për çështje të ndryshme si në fushën penale dhe atë civile.

Në disa ankesa ndaj gjykatave është kërkuar ndihma dhe ndërhyrja e Avokatit të Popullit për të përfaqësuar palët ndërgjyqëse në shkallët më të larta të gjyqësorit, në mënyrë të veçantë në Gjykatën e Apelit apo në Gjykatën e Lartë, me arsyetim se ato nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për të përballuar marrjen e një avokati privat.

Legjislacioni ynë e njeh të drejtën e shërbimit ligjor falas, por ky shërbim rezulton të ketë probleme sidomos në rastin e kërkesave për rishikim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë pranë Gjykatës së Lartë për çështje të ndryshme penale.

Për shkak të vështirësive ekonomike shumë qytetar nuk kanë mundësi financiare për të siguruar një avokat privat dhe klinikat ligjore që ofrojnë këtë mundësi janë shumë të pakta, për të mos thënë mosekzistente nëpër rrethe të ndryshme të vendit ( ka vetëm 2 klinika ligjore falas në Tiranë).Për më tepër legjislacioni aktual penal ka disa zbrazëti pasi mundësia për të patur një avokat falas të siguruar nga shteti njihet vetëm në shkallë të parë dhe të dytë të gjykimit, dhe jo në gjykimin që bëhet në Gjykatën e Lartë, duke i mohuar kështu të drejtën e njohur me Kushtetutë të të pandehurit për tu mbrojtur gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë.

Me daljen e ligjit nr.10039 datë 22.12.2008 “Për Ndhimën Juridike” nga Kuvendi i Shqipërisë, mendojmë se u zgjidh edhe ky problem për të ardhmen. Kështu objekt i këtij ligji janë kushtet, lloji, mënyra edhe procedurat për dhënien e ndihmës juridike nga shteti, për mbrojtjen e lirive e të të drejtave themelore të individit, si dhe të interesave të tjerë të ligjshëm të tij.

Ankesa kanë ardhur edhe ndaj gjykimeve dhe vendimeve gjyqësore të marra në mungesë të palëve, ose të subjekteve përkatëse. Palët mbas vënies në dijeni të këtyre gjykimeve dhe vendimeve gjyqësore të marra, janë ankuar tek ne duke kërkuar ndihmën dhe ndërhyrjen tonë për prishjen e këtyre vendimeve nga organet më të larta gjyqësore.

Edhe gjatë këtij viti kanë ardhur në disa raste ankesa për veprime e qëndrime të njëanshme të gjyqtarëve të veçantë gjatë gjykimeve konkrete dhe është kërkuar ndihma dhe ndërhyrja e jonë për përjashtimin e tyre nga gjykimi i çështjes.Në të gjitha rastet nga ana e jonë është bërë sqarimi i duhur ligjor mbi shkaqet e përjashtimit të gjyqtarëve dhe procedurat e gjykimit të tyre nga gjykata.

Ankesa kanë ardhur edhe ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë ndaj të cilëve është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë dhe është kërkuar ndihma dhe ndërhyrja e Avokatit të Popullit për pezullimin e

ekzekutimit të vendimit gjyqësor derisa të shqyrtohet rekursi nga Gjykata e Lartë.

Po kështu ka patur ankesa ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë kur palët kanë zbuluar prova të reja shkresore dhe për këtë është kërkuar ndihma dhe ndërhyrja e Avokatit të Popullit për t'ju drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikim vendimi. Për ankesat ndaj vendimeve civile në përgjigjet e kthyer kemi sqaruar se këto kërkesa për rishikim vendimi, së bashku me provat e reja të zbuluara pas dhënies së vendimit, mund të përgatiten me ndihmën e një avokati privat, i cili bën edhe mbrojtjen në gjykatë.

Në disa raste ankesa kanë ardhur ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë duke pretenduar se nga gjykatat gjatë gjykimit të çështjeve të tyre nuk janë respektuar të gjitha kërkesat e ligjit material e procedurial për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste është kërkuar ndihma dhe ndërhyrja e Avokatit të Popullit që çështja e tyre të dërgohet për gjykim në Gjykatën Kushtetuese, për të kërkuar që vendimet gjyqësore të deklarohen antikushtetuese ose kërkohet ndihma dhe ndërhyrja e jonë që çështja e tyre të dërgohet për gjykim në Gjykatën e Strasburgut.

Ankesa kanë ardhur edhe ndaj vendimeve gjyqësore ku janë marrë masa të rënda dënimi nga gjykata dhe është kërkuar ndihma dhe ndërhyrja e Avokatit të Popullit në Gjykatën e Apelit apo në Gjykatën e Lartë, me qëllim që ndaj tyre të zbatohet Amicus Curie (Miku i gjykatës).

Ankesa kanë ardhur edhe për zvarritje të padrejta nga administrata e gjykatave në drejtim të dërgimit të dosjeve për gjykim nga Gjykatat e Rretheve në Gjykatat e Apelit apo në Gjykatën e Lartë dhe anasjelltas.

Po kështu ankesa kanë ardhur edhe për faktin se, ndonëse kanë përfunduar gjykimet, palëve nuk u jepen kopjet e vendimeve nga administrata gjyqësore.

Ankesa kanë ardhur edhe ndaj gjyqtarëve të veçantë të Gjykatave të Shkallës së Parë apo të Gjykatave të Apelit, duke i akuzuar ato për veprime korruptive dhe kërkohet që nga Avokati i Popullit të fillohet procedimi disiplinor si për shkelje të ndryshme në detyrë ashtu dhe për korrupsion.

Nga ana jonë, në zbatim të kërkesave të nenit 17/b të ligjit "Për Avokatin e Popullit" ankesat e bëra, së bashku me dokumentet shoqëruese të tyre, i janë dërguar për shqyrtim organit kompetent, Inspektoriatit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ose Ministrisë të Drejtësisë i cili ka të drejtën e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore dhe ato të Gjykatave të apelit.

Gjatë vitit 2008 nga institucioni i Avokatit të Popullit, janë dërguar 21 raste ose ankesa për kompetencë shqyrtimi në Këshillin e Lartë të Drejtësisë.

Nga analiza e ankesave të ardhura ndaj gjykatave vërehet se në përgjithësi ka besim ndaj institucionit tonë dhe arrihet deri aty sa ankuesit të paraqesin edhe prova shkresore apo fakte të ndryshme për të argumentuar dhe bërë vlerësimet e vendimeve gjyqësore.

Për këto ankesa nga ana jonë në çdo rast janë bërë sqarimet e nevojshme për rrugën ligjore që duhet ndjekur si dhe argumentat kushtetuese dhe ligjore se vendimet gjyqësore nuk mund të prishen ose ndryshohen nga institucioni ynë, por vetën nga gjykatat më të larta mbi bazën e ankimeve dhe rekurseve të parashikuara në ligj.

Gjatë vitit 2008 për gjithë ankesat e ardhura ndaj gjykatave, në 29 raste ato janë zgjidhur në favor të ankuesve.

### **Kontributi i Avokatit të Popullit për Reformën në Drejtësi**

Nga praktika e punës sonë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, gjatë shqyrtimit të mjaft ankesave, dhe ballafaqimet e tyre me ligjet në fuqi, ne kemi konstatuar se duhen zgjeruar garancitë ligjore të individëve (shtetasve) për t'i mbrojtur dhe zbatuar liritë dhe të drejtat themelore. Pikërisht ky ka qenë edhe synimi ynë në dërgimin e një numri jo të vogël rekomandimesh gjatë vitit 2008, në kuadrin e Reformës në drejtësi.

1. Rekomandim për ndryshimin e nenit 58 të Kodit të Procedurës Penale, dërguar më datën 23.09.2008. Ky rekomandim u arsyetua si vijon:

Nga ankesat e paraqitura para nesh, në mjaft raste është pretenduar që çështjet penale janë zgjidhur nga ana e Gjykatës në dëm të viktimës, duke u pushuar çështja penale apo të pandehurit janë dënuar lehtë thjesht për shkaqe korrupsioni të lidhur ndërmjet prokurorëve dhe gjyqtarëve. Kurse të dëmtuarit nuk kanë patur asnjë mundësi reagimi kundër vendimeve të gjykatës, sepse nuk janë pale në gjykim dhe prokurori nuk bën ankim. Sipas ligjit ekzistues familjarët e viktimës gjatë procesit gjyqësor veçse mund të kërkojnë shpërblimin e demit, por nuk mund të bëjnë ankim në gjykatën më të lartë kundër vendimit të gjykatës që jep pafajësi për personin e akuzuar si vrasës apo trafikant, kundër masave të dënimit që konsiderohen të lehta etj, sepse këtë të drejtë e ka vetëm prokurori. Kështu mund të përmendim kërkesën e familjes së ish komisar Gani Malushit, kërkesat e familjeve të viktimave të tragjedisë së 9 janarit 2004, mjaft ankesa të viktimave të trafikut njerëzor etj. Kodi i Procedures Penale lejon personat e familjes së viktimave nga kryerja e një vepre penale, për t'u përfaqësuar në mënyrë direkte në gjyq ose me një avokat mbrojtës të tyre, por vetëm për të kërkuar shpërblimin e demit të shkaktuar.

Duke patur parasysh edhe rekomandimin tone, me ligjin nr.8813 datë 13.06.2002, u shtua pika 3 në nenin 58 të Kodit të Procedurës

Penale. Sipas kësaj shtese “I dëmtuari ka të drejtë të parashtrijë kërkesa në organin e procedurës dhe të kërkojë marrjen e provave. Kur kërkesa e tij nuk pranohet nga prokurori, ai ka të drejtë të ankohet në gjykatë brenda 5 ditëve nga marrja e dëgjimit”. Por kjo shtesë nuk lejon të dëmtuarin t’i ushtrojë këto të drejta gjatë gjykimit dhe të ankohet kundër vendimit të gjykatës.

Prandaj sugjeruam që pika 1 e nenit 58 të Kodit të Procedurës Penale të ndryshohet si vijon: “Personi i dëmtuar nga veprat penale ose trashëgimtarët e tij kanë të drejtë të kërkojnë procedimin e fajtorit, të marrin pjesë në gjykimin e tij si pale si dhe të kërkojnë shpërblimin e demit”. Kurse në pikën 3 të nenit 58 të shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: “Gjatë shqyrtimit gjyqësor personi i dëmtuar ka të drejtë të kërkojë marrjen e provave si dhe të ankohet kundër vendimit të gjykatës”. Kjo do të bënte të mundur ballancimin e mbrojtjes së të pandehurit dhe të interesave të viktimës nga ana tjetër.

Ky rekomandim është ngritur vazhdimisht edhe në Raportet tona Vjetore pas vitit 2002, është pranuar në parim si rekomandim i drejtë. Por deri tani nuk ka gjetur ende zgjidhje nëpërmjet plotësimit të Kodit të Procedurës Penale.

Në këtë rekomandim ne përmendëm se në mënyrë jo ligjore, pa qenë e parashikuar në Kodin e Procedurës Penale që ka qenë në fuqi, kjo e drejtë është zbatuar në vitin 1991 në gjyqin për viktimat e 2 prillit 1991 në Shkodër, për avokatin e caktuar nga familjarët e viktimave në atë kohë, të ndjerin z. Nazif Bezhani. Pra, nuk ka pse tani pas rreth 18 vitesh të mos rregullohet me ligj ky problem që, në fakt, veç të tjerave, lufton korrupsionin në drejtësi.

Në lidhje me këtë rekomandim, Ministri i Drejtësisë më datën 19.01.2009 na është përgjigjur:

**I. Rekomandimi i parë ku propozohet nga ana juaj të ndryshohet neni 58 i Kodit të Procedurës Penale, çmohet si i panevojshëm për arsyet që vijojnë:**

Shtesat e propozuara në këtë dispozitë, për t’i dhënë të drejtën personit të dëmtuar për të marrë pjesë në çdo rast si palë në gjykim (dhe rrjedhimisht për të patur të drejtën e ankimit të vendimit gjyqësor në çdo rast) del jashtë natyrës së një procesi gjyqësor penal sipas legjislacionit procedural penal shqiptar. Ju e dini që e drejta penale dhe e drejta procedurale penale janë pjesë të së drejtës publike, çka do të thotë se shteti shfaqet si subjekt i tyre, duke u përfaqësuar nga prokurori. Është pikërisht shteti, nëpërmjet prokurorit që mbron interesat dhe të drejtat e personit të dëmtuar në procesin penal, në rastin e veprave penale me rrezikshmëri të konsiderueshme shoqërore, sepse në këto raste cënohen indirekt edhe interesat dhe vlerat e shoqërisë në tërësi.



Gjithashtu, ju duhet ta dini, që në përcaktimin e kësaj zgjedhjeje të sistemit ligjor, është marrë në konsideratë fakti që shteti ka burimet njerëzore të duhura (nëpërmjet rekrutimit të njerëzve me meritat e duhura profesionale në cilësinë e prokurorit dhe të shërbimeve të policisë gjyqësore) dhe mjetet logjistike e financiare të duhura për të realizuar një mbrojtje efektive të të drejtave të personit të dëmtuar, të afërmëve të tij dhe të shoqërisë në tërësi.

Nga ana tjetër, ju e dini që ligji procedural penal i jep një set të gjerë të drejtash të dëmtuarit nga vepra penale, ku përfshihen e drejta për të paraqitur kallëzim, e drejta për t'u ankuar kundër vendimit të mosfillimit dhe vendimit të pushimit të çështjes penale nga prokurori, e drejta për të kërkuar shpërblimin e dëmit material nga vepra penale, si dhe e drejta për të kërkuar marrjen e provave të caktuara. Për më tepër, për ushtrimin e këtyre të drejtave, i dëmtuari mund t'i drejtohet edhe gjykatës.

Ne e konsiderojmë jo adekuat këtë përgjigje dhe do mundohemi të realizojmë rekomandimin tonë në të ardhmen, me ndryshime të mundëshme që do të bëhen në Kodin e Procedurës Penale.

2. Rekomandim për plotësimin e nenit 449 të Kodit të Procedurës Civile, dërguar më datën 23.09.2008. Ky rekomandim u arsyetua si vijon:

Në Institucionin tone kanë ardhur dhe vazhdojnë të vijnë mjaft ankesa kundër vendimeve të gjykatave, përfshirë edhe ato të pezullimit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore që bën Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë. Qytetarët ankohen sepse për të marrë vendimet gjyqësore që pezullohen atyre ju është dashur shpesh here të bëjnë gjyqe për 3-4 vjet ose më shumë dhe kur vjen momenti i shumëpritur prej tyre për ekzekutimin e vendimit, marrin dijeni se pala tjetër ka siguruar vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë për pezullim të ekzekutimit. Kolegji Civil zbaton nenin 449 të Kodit të Procedurës Civile, duke e marrë vendimin në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve apo avokatëve të tyre. Por ne mendojmë se ky nen duhet ndryshuar, duke lënë të drejtën e pezullimit, por të kushtëzohet me zhvillimin e një seance të hapur, me pjesëmarrjen e palëve apo avokatëve të tyre.

Pezullimi i vendimeve të formës së prerë është një moment shumë i rëndësishëm dhe nuk duhet të bëhet vetëm pas kërkesës së një pale, asaj që ka humbur gjyqin.

Prania e palës gjyqfituese në një seancë gjykimi të shkurtër të kërkesës për pezullim do të realizojë një të drejtë kushtetuese për të paraqitur pretendimet e tyre ndaj kërkesës për pezullim. Si rrjedhojë Gjykata e Lartë do të ketë mundësinë të marrë një vendim sa më të drejtë. Gjithashtu kjo mënyrë gjykimi në prezencën e palëve rrit përgjegjësinë e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, rrit transparencën si dhe mbyll shtigje për akuza për korrupsion, të cilat nuk janë të pakta për të gjitha shkallët e

gjqësorit shqiptar, përfshirë dhe Gjykatën e Lartë. Prandaj rekomandua që në nenin 449 të Kodit të Procedurës Civile të shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

**“Në këtë rast vendimi merret në seancë, në prezencë të palëve që duhet të njoftohen me shpallje, jo më pak se 5 ditë më parë”.**

Edhe këtë rekomandim e kemi paraqitur disa herë në Raportet tona vjetore para Kuvendit të Shqipërisë

Në lidhje me këtë rekomandim, po më datën 19.01.2009 Ministri i Drejtësisë na është përgjigjur se:

**II. Rekomandimi i dytë ku propozohet nga ana juaj të ndryshohet neni 449 i Kodit të Procedurës Civile, çmohet si i panevojshëm për arsyet që vijojnë:**

Nisur nga përmbajtja e këtij neni, e lidhur kjo me nenin 479 “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit”, konstatojmë se ligjvënësi nuk ka vendosur asnjë detyrim të shprehur për zhvillimin e këtyre seancave me ose pa praninë e palëve. Aty ku ligjvënësi ka synuar që gjykimi të zhvillohet pa pjesëmarrjen e palëve, e ka përcaktuar shprehimisht një gjë të tillë si në rastin e vlerësimit të elementëve formalë të rekursit në nenin 480 të Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon shprehimisht:

*“Mospranimi i rekursit vendoset nga kolegji i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit pa pjesëmarrjen e palëve”.*

Rrjedhimisht, përmbajtja e nenit 479 nuk është e rastit sepse i mbulon të dyja situatat:

(1) rastin kur Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë gjatë procedurës në dhomën e këshillimit për vlerësimin e elementëve formale të rekursit konstaton një rast flagrant të cënimit të të drejtave dhe ekzistencën e pasojave të rënda të pariparueshme. Në këtë rast, edhe pa pjesëmarrjen e palëve, Kolegji Civil mund të urdhërojë pezullimin e ekzekutimit të vendimit; dhe

(2) rastin kur Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë gjatë gjykimit konstaton një shkak për pezullimin e ekzekutimit të vendimit. Në këtë rast, Kolegji Civil, me pjesëmarrjen e palëve, ky Kolegj mund të urdhërojë pezullimin e ekzekutimit të vendimit.

Ne vazhdojmë t’i qëndrojmë mendimit se pezullimi i vendimeve pa qenë të pranishme palët krijon shtigje për padrejtësi dhe korrupsion.

3. Rekomandim për të bërë të mundur realizimin e detyrës së Avokatit të Popullit për ankesat kundër vendimeve gjyqësore të formës së prerë, duke bërë plotësimet e duhura në Kodin e Procedurës Penale dhe Civile, bazuar edhe në Rekomandimet e Këshillit të Europës, dërguar më datën 02.10.2008. Ky rekomandim u arsyetua si vijon:

Zyra e Avokatit të Popullit ka patur në vazhdimësi, qysh nga fillimi i saj në vitin 2000, dhe ka mjaft ankesa për vendimet gjyqësore të formës

së prerë. Por deri tani nuk mund të veprojë për këto ankesa. Ndryshimet e ligjit “Për Avokatin e Popullit”, të miratuara nga Parlamenti me ligjin Nr. 9398 datë 12.05.200, e parashikojnë edhe trajtimin e këtyre ankesave, por pa përcaktuar rastet dhe mjetet e ndërhyrjes së Avokatit të Popullit.

Kështu që në nenin 25 të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, pas ndryshimeve, thuhet shprehimisht se:

“Avokati i Popullit pranon ankesa, kërkesa ose njoftime për shkelje të të drejtave të njeriut, që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor, **vendimet e formës së prerë** dhe procedurat gjyqësore. Hetimi dhe kërkesa e Avokatit të Popullit nuk prekin pavarësinë e gjykatës në marrjen e vendimeve”. Ndryshimi u bë vetëm për faktin që Avokati i Popullit të mund të pranojë ankesa edhe për vendimet e formës së prerë, sepse për të drejtat e tjera të Avokatit të Popullit kjo dispozitë nuk ka ndryshuar. Ndryshimet u bënë duke patur parasysh përvojën dhe ligjin polak, që i jep akses Ombusmanit edhe mbi vendimet gjyqësore të formës së prerë.

Në Komisionin e Ligjeve në atë kohë, (maj 2005) u tha se kjo do të mundësohet duke bërë më vonë ndryshimet përkatëse në Kodin e Proçedurës Penale dhe në Kodin e Proçedurës Civile, si rruga e duhur ligjore për trajtimin nga Avokati i Popullit të ankesave të qytetarëve kundër vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Kështu që duhet bërë plotësimi konkret i ligjeve, përkatësisht i neneve 438, 449, 451 dhe 453 të Kodit të Proçedurës Penale si dhe të nenit 494 të Kodit të Proçedurës Civile.

Mjetet dhe mënyrat e reagimit të Avokatit të Popullit ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë, gjithmonë duhen kuptuar si një kompetencë për të ushtruar të drejtën e paraqitjes së kërkesës për rishikim të këtyre vendimeve në Gjykatën e Lartë, si një nga mjetet e jashtëzakonshme që ligji u njeh subjekteve përkatëse në këto raste.

Sipas plotësimeve të propozuara, Avokati i Popullit do të bëhet një nga subjektet që kanë të drejtë të kërkojnë rishikim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga ana e gjykatave, si dhe do të kërkojë rishikimin e qëndrimit të Kolegjeve të Bashkuara në Gjykatën e Lartë lidhur me vendimet unifikuese. Gjithmonë bëhet fjalë që Avokati i Popullit, pas ankesës së qytetarëve, **do të bëjë kërkesa për rishikim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë** në rastet kur sita e kontrollit gjyqësor ka lejuar edhe gabime gjyqësore, për të cilat nuk ka mjet tjetër korrigjimi. Është fakt se ligji sot lejon të dënuarin apo prokurorin që të bëjnë kërkesa rishikimi. Por, shpesh herë të dënuarit apo viktimat e krimeve (familjarët e tyre), nuk kanë mundësi ekonomike për të paguar avokatë të aftë për të bërë kërkesa rishikimi.

Kjo kompetencë e Avokatit të Popullit për të bërë kërkesa rishikimi në Gjykatën e Lartë të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, duhet

kuptuar se gjithmonë do të jetë në çmimin e gjykatës vendimi përfundimtar, pranimi ose refuzimi i kërkesës për rishikim. **Pra nuk ka prekje të pavarësisë së gjyqësorit.** Përvoja e Ombusmanit polak ka treguar se nuk ka asnjë përplasje të pushteteve. Nuk mund as të supozohet ndonjë keqpërdorim i kësaj të drejte nga ana e Ombusmanit, veçse rrit shkallën e kontrollit mbi drejtësinë e vendimeve si dhe garancitë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Dhënia e kësaj kompetence Avokatit të Popullit mendojmë se është nevojë edhe për arsye të tjera. Nga këto mund të përmendim:

1. Komiteti i Ministrave të shteteve anëtare të Këshillit të Europës, gjatë sesionit të 114, më 12 maj 2004, ka miratuar Rekomandimin Rec (2004) 6 “Mbi përmirësimin e mjeteve të brendshme të ankimit”, botuar në Fletoren tone Zyrtare, nr. ekstra, në korrik 2007 (fq.13-17). Ndër të tjera në këtë Rekomandim thuhet:

“Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në Strasburg po përballet me një numër gjithmonë në rritje të kërkesave. Kjo situatë rrezikon efektshmërinë afatgjatë të sistemit dhe për rrjedhojë, kërkon një reagim të fuqishëm nga palët kontraktuese. Është pikërisht në këtë kontekst, që disponueshmëria e mjeteve efektive ankimore të brendshme bëhet veçanërisht e rëndësishme. Përmirësimi i mjeteve ankimore ekzistuese të brendshme ka shumë mundësi që të ketë efekt sasior dhe cilësor në punën e Gjykatës:

- në njërin anë, volumi i kërkesave që janë për t’u shqyrtuar do të zvogëlohet: më pak kërkesues do të ndjeheshin të detyruar të sillnin çështje përpara Gjykatës, nëse shqyrtimi i ankimeve të tyre nga autoritetet e brendshme do të ishte mjaftueshmërisht i plotë;

- nga ana tjetër, shqyrtimi i kërkesave nga gjykata do të lehtësohet nëse një shqyrtim lidhur me themelin e çështjes është kryer më parë nga një autoritet i brendshëm, në sajë të përmirësimit të mjeteve ankimore të brendshme.

Për pasojë, ky rekomandim inkurajon shtetet anëtare të shqyrtojnë sistemet e tyre respektive ligjore në dritën e jurisprudencës së Gjykatës dhe nëse është e nevojshme, të marrin masat e domosdoshme dhe të përshtatshme që të garantojnë, nëpërmjet legjislacionit ose praktikës gjyqësore, mjetet efektive ankimore sikurse përcaktohen nga neni 13. Shqyrtimi mund të kryhet rregullisht ose në vijim të një gjykimi të Gjykatës”.

Po në këtë Rekomandim të Këshillit të Europës thuhet se:

“Autoriteti” i referuar në nenin 13 **jo domosdoshmërisht duhet të jetë një autoritet gjyqësor**, por nëse nuk është i tillë, kompetencat dhe garancitë që ai ofron janë relevante për të përcaktuar nëse mjeti ankimor që ai parashikon është në të vërtetë efektiv”.

Dihet se Avokati i Popullit nuk është autoritet gjyqësor, por mendojmë se në këtë kuadër, pranimi i këtij rekomandimi të Avokatit të Popullit do të përbëjë edhe një realizim të një rekomandimi të paraqitur nga një organizëm i rëndësishëm ndërkombëtar, siç është Këshilli i Europës.

Për t'u realizuar Rekomandimi i Këshillit të Europës konkretisht në Kodin e Proçedurës Penale ndryshimet që propozohen janë:

I. Në nenin 438 duhet të shtohet pika 5 si vijon:

5. **“Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë rishqyrtimin e çështjes dhe të çdo vendimi të Kolegjeve të Bashkuara”**

II. Në pikën 2 të nenit 449, pas fjalës “prokurorit”, duhet të shtohet **“ose të Avokatit të Popullit”**. Kështu që pika 2 e nenit 449 bëhet “Vendimet e pafajësisë për krime mund të rishikohen me kërkesën e prokurorit ose të Avokatit të Popullit, por me kusht që të mos kenë kaluar 5 vjet nga dhënia e vendimit”.

III. Në nenin 451 të shtohet pika c:

c) **Avokati i Popullit**

IV. Në nenin 453, pika 1 duhet të ndryshohet duke caktuar që kërkesa e rishikimit të shqyrtohet nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në seancë të hapur në praninë e palëve. Kështu që kjo dispozitë duhet të bëhet: **“Kërkesa e rishikimit shqyrtohet nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në seancë të hapur, me praninë e palëve”**.

Gjithashtu në Kodin e Proçedurës Civile, në nenin 494, në paragrafin e dytë duhet të shtohet: **“ose Avokati i Popullit”**. Kështu që ky paragraf bëhet: **“Pala e interesuar ose Avokati i Popullit mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë, kur:...”**

Konkluzioni është se aksesimi i Avokatit të Popullit mbi vendimet gjyqësore, thjesht rrit garancitë për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve, rrit transparencën e gjyqësorit si dhe pjesëmarrjen e publikut në dhënien e drejtësisë nga ana e gjykatës. Ky përfundim është nënvizuar vazhdimisht edhe në konferenca gjyqësore, kur është diskutuar për një pavarësi më të madhe të gjyqësorit nga politika si dhe nga format e presionit korruptiv. Si i tillë aksesimi i Avokatit të Popullit nuk çënon aspak pavarësinë e gjyqësorit, përkundrazi ndihmon punën e tij. Rritja e kompetencave në këtë drejtim për Institucionin e Avokatit të Popullit është një tregues dhe kërkesë e një shoqërie dhe qeverisje demokratike të zhvilluar, një mjet për të rritur kontrollin e ndërsjelltë ndërmjet veprimtarisë së dy institucioneve që garantojnë të drejtat e njeriut, që janë gjykatat dhe Avokati i Popullit.

Në lidhje me këtë Rekomandim, më datën 17.02.2009 Ministri i Drejtësisë na ka kthyer këtë përgjigje:

“Në përgjigje të shkresës tuaj në lidhje me rekomandimin e parashtruar nga ana juaj, për të bërë të mundur realizimin e detyrës së

Avokatit të Popullit për ankesat kundër vendimeve gjyqësore të formës së prerë, duke bërë plotësimet e duhura në Kodin e Procedurës Penale dhe Civile, bazuar edhe në rekomandimet e Këshillit të Evropës, pasi kemi analizuar në mënyrë të plotë nga pikëpamja legislative, efektivitetin e mjeteve të ankimit, ku parashtrijmë mendimin e Ministrisë së Drejtësisë si vijon:

Respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut përbëjnë themelet e shtetit ligjor. Vendi ynë ka bërë hapa pozitivë në kuadrin e plotësimeve të detyrimeve që rrjedhin nga konventat ndërkombëtare duke krijuar mekanizma ligjorë të përshtatshëm me qëllim mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të njeriut.

Referuar legjislacionit kombëtar, rishikimi i vendimit të formës së prerë është parashikuar shprehimisht në legjislacionin procedural civil dhe penal, duke përcaktuar rastet specifike që përbëjnë shkak për të kërkuar rishikimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si dhe subjektet të cilat kanë të drejtë të parashtrijmë këtë pretendim.

Nisur nga natyra e procesit gjyqësor, ligjëvënësi me të drejtë ka parashikuar si një mjet ankimi kundërshtimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për palët të cilat janë të përfshira në mënyrë të drejtëpërdrejtë në proces. Roli dhe pjesëmarrja e tyre gjatë procesit, si dhe interesi i drejtëpërdrejtë lidhur me cënimin e të drejtave të tyre, legjitimojnë dhe të drejtën e tyre për të kundërshtuar vendimet gjyqësore të formës së prerë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Referuar Rekomandimit të Komitetit të Ministrave (2004) 6 të Këshillit të Evropës, ku shtrohet si problematike situata në GJEDNJ, lidhur me numrin në rritje të kërkesave, sjellim në vëmendje se çështja e ezaurimit të mjeteve të brendshme për GJEDNJ nënkupton para se gjithash kontrollin nëse në rastin **konkret ka mjete ankimi**, dhe nëse evidentohet se ato ekzistojnë, verifikohet efektiviteti i tyre, p.sh a njihet ose mohohet e drejta për t'iu drejtuar gjykatës (e **drejta** e aksesit).

Në këtë këndvështrim, përveç mjeteve të zakonshme të ankimit, në legjislacionin kombëtar, është parashikuar edhe e drejta e individit për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, për çështje që lidhen në mënyrë të drejtëpërdrejtë me interesat e tij.

Gjithashtu, njesimi apo ndryshimi i praktikës gjyqësore nga Gjykata e Lartë është kompetencë ekskluzive e kësaj të fundit që buron drejtpërsëdrejti nga Kushtetuta, ku në nenin 141/2 të saj thuhet se: “Për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë ka të drejtë të tërhiqet për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore”.

Kodi i Procedurës Penale dhe Kodi i Procedurës Civile parashikojnë rastet kur Gjykata e Lartë gjykon në Kolegje të Bashkuara, ku përfshihet edhe njësimi apo ndryshimi i praktikës gjyqësore. Tërheqja

bëhet me vendim të Kryetarit të Gjykatës së Lartë në rastet kur lind nevoja për njësimin apo ndryshimin e praktikës gjyqësore ose në rastet kur gjatë shqyrtimit të çështjeve të ardhura në Gjykatën e Lartë, çmohet se Rekursi paraqet rëndësi për njësimin ose unifikimin e praktikës gjyqësore.

Nga kuadri ligjor i mësipërm rezulton se autoriteti i vetëm për të vendosur mbi nevojën për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore është vetë Gjykata e Lartë. Kjo gjë justifikohet nga fakti se është Gjykata e Lartë që gjatë shqyrtimit të çështjeve gjykon objektivisht mbi nevojën e njësimin të praktikës apo ndryshimit të vendimeve të mëparshme unifikues, me qëllim zgjidhjen e drejtë të çështjes, përshtatjen e saj me realitetin juridik e social të kohës. Në këto kushte, mendojmë se asnjë autoritet tjetër, përfshirë edhe Avokatin e Popullit, nuk mund të bëjë vlerësime objektive mbi nevojën e rishikimit të vendimeve unifikuese.???

Gjithashtu, në vijim të sa më sipër, theksojmë se misioni kryesor i institucionit të Avokatit të Popullit, në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjin specifik që rregullon veprimtarinë e tij, ka të bëjë me mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike. Në këtë kuadër, ky institucion në rast të shkeljes së të drejtave të njeriut, ka të drejtë të paraqes rekomandime pranë organeve kompetente për të rivendosur të drejtën e shkelur. I vetmi rast kur ky institucion mund të parashtrijë një kërkesë për të vënë në lëvizje gjykatën është ai i parashikuar në nenin 134/dh të Kushtetutës, ku parashikohet e drejta për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Për sa më sipër, çdo parashikim tjetër që ka për qëllim përcaktimin e kompetencave të tjera jashtë natyrës dhe misionit të Avokatit të Popullit, do të binte ndesh me kornizën kushtetuese të këtij institucioni.

Në konkluzion, duke mbajtur në konsideratë edhe faktin që një element i rëndësishëm i shtetit të së drejtës është edhe siguria juridike për çështje të konsideruara si të zgjidhura në mënyrë përfundimtare, mendojmë se përcaktimi i rrethit të subjekteve që kanë të drejtën e ankimit si dhe rasteve që përbëjnë shkak për rishikimin e vendimeve të formës së prerë, sipas ligjit është i drejtë. Kjo bazohet edhe në orientimin e Kodit të ri të Procedurës Penale drejt sistemit akuzator, ku roli i palëve në debat është vendimtar si dhe në përcaktimin e mënyrës së atakimit të vendimeve të formës së prerë me anën e institutit të rishikimit. Për më tepër, siç e dini, në këtë procedurë, në ndryshim nga Kodi i mëparshëm i Procedurës Penale, nuk parashikohet as kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë si mjet i jashtëzakonshëm i goditjes së vendimeve të formës së prerë, e cila ka qenë kompetencë ekskluzive e Prokurorit të Përgjithshëm”.

Siç konstatohet, kjo përgjigje nuk është e plotë për shkakun se në fakt në nenin 25 të ligjit “Për Avokatin e Popullit” vazhdon të jetë e drejta e Avokatit të Popullit për të pranuar ankesa kundër vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Për këtë çështje Ministri i Drejtësisë nuk shprehet.

4. Rekomandimi për nxjerrjen e ligjit “Për hetuesin (investigatorin) privat”, dërguar më datën 09.07.2008. Ky rekomandim u arsyetua si vijon:

Gjatë rreth 18 viteve të shtetit të ri demokratik në Shqipëri ka zhvillime mjaft pozitive në fushën e njohjes dhe realizimit të lirive themelore dhe të të drejtave të njeriut. Kjo situatë pozitive me standarte të pranueshme është edhe si rrjedhojë e ekzistencës dhe zbatimit të Kushtetutës dhe legjisllacionit të përparuar për të drejtat e njeriut si dhe të institucioneve përkatëse moderne që janë ngritur dhe vazhdojnë të ngrihen në këto fusha. Në këtë kuadër gjykojmë se është e nevojshme që të përgatitet edhe ligji “Për hetuesin (investigatorin) privat” sepse prej vitesh në zyrën e Avokatit të Popullit kanë ardhur ankesa dhe kërkesa që në themel argumentojnë nevojën e njohjes nga shteti dhe funksionimit të institucionit të investigatorit privat. Kështu ky mund të veprojë në rastet kur policia kriminale dhe prokuroria kanë dështuar që të zbulojnë p.sh. autorët e një vrasje, një grabitjeje, vjedhjeje apo aksidenti dhe të dëmtuarit apo familjarët duan që të angazhojnë me mjetet e tyre financiare një hetues apo një studio me hetues private. Ky organizëm privat të jetë i njohur nga shteti, të ketë kompetenca të caktuara sipas Kodit të Procedurës Penale, i cili (ky Kod) do të caktojë se çfarë dhe si do të trajtohen provat që do të mbledhë hetuesi privat. Ligji i posaçëm për këtë organizëm privat do të caktojë mënyrën e organizimit të këtij instituti (dhoma e hetuesve privatë), juridiksionin, të drejtat dhe detyrimet, kompetencat e këshillit kombëtar, të Ministrisë së Drejtësisë, kushtet për të ushtruar profesionin e hetuesit privat, objektin e aktivitetit të tij, shpërblimin, procedurat për marrjen e masave disiplinore etj.

Ne gjykojmë se krijimi i një organizmi të tillë do ketë ndikim pozitiv në luftën kundër kriminalitetit, do të ulë shkallën e korrupsionit në organet e policisë kriminale dhe të prokurorisë si dhe do të krijojë konkurrencën edhe në fushën e zbulimit të krimeve. Për lehtësi, ne kemi marrë si model jo vetëm projektligjin Italian për këtë çështje, që jua kemi dërguar bashkëlidhur, por edhe bazën ligjore aktuale për ushtrimin e këtij profesioni në Itali.

Në lidhje me këtë rekomandim, më datën 08.10.2008, Ministri i Drejtësisë na ka kthyer përgjigje se:

“Në përgjigje të shkresës Tuaj Nr. 161 Prot., datë 09.07.2008, me anë të së cilës rekomandohet përgatitja e ligjit “Për hetuesin (investigatorin) privat”, pas shqyrtimit të materialit të dërguar nga ana



juaj, ju vëmë në dijeni se Ministria e Drejtësisë, është angazhuar në përgatitjen e një studimi mbi mundësinë e përfshirjes së këtij instituti në legjisllacionin shqiptar”.

Ky rekomandim do të vazhdojë të ndiqet, duke bashkëpunuar ngushtë me Ministrinë e Drejtësisë.

5. Duke patur parasysh problemet që kanë dalë herë pas here për sigurinë e gjyqtarëve, kemi dërguar një rekomandim për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të ligjit Nr.9110 dt.24.07.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda”. Rekomandimi i është drejtuar Kryeministrit, Ministrit të Drejtësisë dhe për dijeni Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Në nenin 10 të këtij ligji të sipërcituar, parashikohet se brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Këshilli i Ministrave, pasi të ketë marrë edhe mendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, duhet të nxjerrë aktet nënligjore të nevojshme lidhur me sigurimin dhe ruajtjen e posaçme të mjediseve të punës, ruajtjen e afërt fizike, mbrojtjen e familjes dhe atë pasurore si dhe të masave të tjera që lidhen me mbrojtjen e posaçme të Gjykatave për Krimet e Rënda, të gjykatave të Apelit për Krimet e Rënda si dhe të gjyqtarëve të tyre.

Duke qënë se afati i parashikuar në ligj ka kaluar dhe nuk janë nxjerrë aktet nënligjore, nga ana e Avokatit të Popullit u dërgua Rekomandimi për nxjerrjen e tyre. Për këtë problem na është kthyer përgjigje nga Qeveria me dt.05.07.2007 ku thuhet se Drejtoria e Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë, po përgatit aktet e nevojshme, dhe se është drejtë përfundimit të këtij procesi. Por realisht deri tani akoma nuk janë nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore nga Qeveria për këtë qëllim.

6. Një problem tjetër ka lidhje me ngritjen e një institucioni edukimi për rastet e kryerjes së veprave penale nga persona të mitur që kryejnë krime dhe për shkak të moshës së tyre në bazë të nenit 12 të K.Penal nuk mbajnë përgjegjësi penale. Kështu nga shqyrtimi i ankesës Y.H. nga rrethi i Beratit rezultoi se ndaj djalit të tij R.H. 13 vjeç që ka kryer krimin e vrasjes ndaj shtetasës E.S me datë 12.11.2007 gjykata ka vendosur vendosjen e tij në një institucion edukimi dhe në fakt një institucion i tillë nuk ekziston në vendin tonë.

Me shkresën tonë datë 28.02.2008 për këtë qëllim ju dërgua një Rekomandim Ministrit të Drejtësisë, Kryeministrit dhe Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë, për ngritjen e këtij institucioni.

Ministria e Drejtësisë me shkresën e saj datë 02.12.2008, na njofton se në muajin korrik 2008 nga ana e Ministrisë së Drejtësisë është bërë një studim me propozime konkrete për nevojën e ndërtimit të një institucioni për trajtimin e të miturve që kanë kryer vepra penale para

mbushjes së moshës për përgjegjësinë penale dhe ky studim do vihet në zbatim në të ardhmen.

#### 4. Ankesat për Prokurorinë

Sipas Kushtetutës sonë Prokuroria nuk bën pjesë në juridiksionin e Ministrisë së Drejtësisë, por për lehtësi studimi e kemi përfshirë pas saj.

Veprimtaria e punës së Avokatit të Popullit, në shqyrtimin e ankesave të shtetasve ndaj organit të Prokurorisë ka konsistuar në zbatimin korrekt dhe objektiv të Kushtetutës, ligjit që normon punën tonë dhe ligjit proçedural penal.

Në rastet e konstatimit të shkeljeve të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve në procesin penal, duke bashkëpunuar me Prokurorinë, kemi synuar që ato t'i shërbejnë qëllimit të mirë për përmirësimin e punës së Prokurorisë në drejtim të respektimit të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut.

Për vitin 2008 në Institucionin tonë **360** shtetas të ndryshëm kanë paraqitur **214** ankesa apo kërkesa, të cilat kanë patur për objekt veprimtarinë e punës së organit të Prokurorisë. Mënyra e përfundimit të ankesave për vitin 2008 është: **49** ankesa janë zgjidhur në favor ose 20 përqind, **50** ankesa kanë qënë jashtë juridiksionit, **86** ankesa jashtë kompetence, dhe **19** ankesa kanë qënë të pabazuara. Për vitin 2008 kanë kaluar për shqyrtim 10 ankesa. Gjatë vitit 2008 janë shqyrtuar dhe 10 ankesa të mbartura nga viti 2007, të cilat kanë përfunduar në këtë mënyrë: 3 ankesa janë zgjidhur në favor, 4 ankesa jashtë kompetence dhe 3 jashtë juridiksionit.

Edhe për vitin 2008 ankesat e shtetasve ndaj veprimtarisë së organit të Prokurorisë janë shqyrtuar me përparësi. Për ankesat që kanë qënë brënda kompetencës sonë, Avokati i Popullit ka bërë vlerësimet e rastit dhe ka urdhëruar kryerjen e procesit të hetimit administrativ nëpërmjet realizimit të veprimeve të nevojshme si marrja e deklarimeve të shtetasve të ndryshëm, këqyrja e dokumentave, kryerja e ekspertimeve mjeko-ligjore ose teknike me specialistë të fushave përkatëse, apo duke studiuar dosje hetimore për të cilat Prokuroria kishte vendosur mosfillimin e proçedimit penal, pushimin apo pezullimin e çështjes penale.

Për mjaft ankesa është shkuar në vendbanimin e ankuesit ose kërkuarit apo janë kryer veprimet në vënd, duke marrë dhe shpjegimet apo informacionin e nevojshëm në organin e Prokurorisë, ndaj të cilit shtetasi ka bërë ankimin.

**A.** Gjatë shqyrtimit të ankesave për vitin 2008, vihet re se objekti i tyre është i njëjtë me objektin e ankesave të paraqitura edhe gjatë vitit

2007. Në mënyrë të grupuar shtetasit ankohen ndaj Prokurorisë:

### **1. Për zvarritje në hetimin e çështjeve penale**

Raste të tilla mund të përmendim ankesën e shtetasve B.SH. nga Tirana; B.G. nga Fieri; E.M. nga Tropoja; Sh.C. nga Durrësi; P.V. nga Mirdita etj.

-Në Institucionin e Avokatit të Popullit një numër i konsiderueshëm ankuesish nga rrethe të ndryshme të vendit ngrenë shqetësimin për zvarritje në hetimin e çështjeve penale për krime të rënda si “Vrasje”, “Trafikim të lëndëve narkotike”, “Trafikim të të miturve” apo dhe vepra të tjera penale si “Falsifikim të dokumenteve” etj. Kështu në ankesën e tij shtetasi P.V. nga Mirdita ankohej ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë për zvarritje në hetimin e çështjes penale në ngarkim të djalit të tij të mitur B.V, akuzuar për veprën penale të “Vjedhjes së pasurisë” filluar datë 10.08.2007. Pasi janë kryer disa veprime hetimore, organi i Prokurorisë Sarandë i ka dërguar aktet e procedimit penal Prokurorisë së Rrethit Gjirokastër seksionit të të miturve, ndërsa çështja është dërguar në gjyq pas 6 muajve dhe konkretisht, më datën 07.02.2008.

-Në ankesën e tij shtetasi B.M. nga Tropoja ka ngritur shqetësimin për zvarritje të pajustificuara në hetimin e procedimit penal nr. 92 të vitit 2007, filluar më datën 11 gusht pas kallëzimit të tij për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve dhe rezultateve të zgjedhjeve”, parashikuar nga neni 326 i Kodit Penal. Ndonëse kishte kaluar mbi një vit nga fillimi i hetimit, pavarësisht veprimeve hetimore të kryera, ende nuk kishin mbaruar hetimet. Aktet e këtij procedimi penal ishin dërguar për studim pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

-Në ankesën e tij shtetasi B.G. nga Baçova e Fierit ka ngritur shqetësimin për zvarritje të pajustificuara në hetimin e procedimit penal nr.350 të vitit 2005 në ngarkim të tij, akuzuar për veprën penale të “Kultivimit të bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284/1 i Kodit Penal. Janë kryer veprimet e para hetimore që lidhen kryesisht me proces verbalin e kontrollit të banesës, për sekuestrimin dhe mandej asgjësimin e sendeve provë materiale, vendimi për kryerjen e ekspertimit kimik të bimëve, dhe disa deklarime shtetasve si kryeplakut të fshatit dhe më datën 27.12.2005, është marrë vendim për njoftimin e akuzës e proces verbalit të pyetjes të pandehurit B.G. Nga verifikimi i materialeve të dosjes rezultoi gjithashtu se, për një periudhe kohore, nga data 13 tetor 2005 deri më datën 13 prill 2007, janë marrë gjashtë vendime për zgjatjen e afatit të hetimit nga tre muaj për secilin dhe afati i fundit është lënë data 15.07.2007. Kurse vendimi për dërgimin e çështjes në gjyq mban datën 05.07.2007. Pikërisht më datën 05.07.2007 është përpiluar dhe proces verbali për ekzekutimin e urdhërit të ndalimit dhe po në këtë ditë

Prokurori ka dërguar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, kërkesën për vleftësimin dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”. Për zvarritjen e pajustificuar dhe shkeljet proceduriale të konstatuara në hetimin e këtij procedimi penal, kemi dërguar rekomandimin Prokurores së Përgjithshme për marrjen e masave disiplinore ndaj prokurorit të çështjes N.T. Rekomandimi u pranua dhe prokurorit ju tërhoq vëmendja.

- Në ankesën e tij shtetasi L.K. nga Vlora ankohej ndaj Prokurorisë së atij rrethi e cila ka zvarritur hetimin e çështjes penale nr.1384 të vitit 2007 për veprën penale të “Mjekimit të pakujdesshëm”, parashikuar nga neni 96 i Kodit Penal. Pas kryerjes së disa veprimeve hetimore, aktet e këtij procedimi penal i janë dërguar për kompetencë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka bashkuar procedimet në një procedim të lidhur me nr.882. Pavarësisht se organi i Prokurorisë ka kryer veprime hetimore si dhe ka kërkuar kryerjen e një ekspertimi mjeko-ligjor me grup ekspertësh, çështja penale është zvarritur në mënyrë të pajustificuar.

Gjatë shqyrtimit të ankesave janë ndeshur edhe raste kur hetimet janë zvarritur si rezultat i kthimit të përgjigjeve të letërporosive nga autoritetet e shteteve të tjera me vonesë. Të tilla janë rastet e ankesave të shtetasve E.M. nga Tropoja akuzuar për veprat penale të “Trafikimit të femrave në bashkëpunim” dhe “Marrëdhënies seksuale me dhunë”, parashikuar nga nenet 114/b/III-të dhe 102 të Kodit Penal. Procedimi penal është filluar nga Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë më datën 22.09.2006 dhe është përfunduar në vitin 2008, për arsye se përgjigja e letërporsisë gjyqësore dërguar U.N.M.I.K-ut Kosovë ka ardhur me vonesë. Rasti i ankesës së shtetasit B.SH. nga Tirana, akuzuar për veprat penale të “Vrasjes së kryer në rrethana të tjera cilësuese në mënyrë të rrezikshme për jetën e shumë personave”, parashikuar nga neni 79 gërma “ë” e Kodit Penal. Procedimi penal është filluar më datën 22.06.2006 dhe është dërguar në gjyq më datën 10.12.2008, edhe pse letërporositë nga autoritetet e drejtësisë greke kanë ardhur më datën 13.04.2008.

Nga studimi dhe analiza e rasteve, kur hetimet e procedimeve penale janë zvarritur në mënyrë të pajustificuar nga organi i Prokurorisë, konstatohet se zvarritjet e tejzgjatura në hetimin e çështjeve penale shpesh nuk kanë qënë justifikuese. Zvarritjet flasin sa për mosplanifikim në kryerjen e veprimeve hetimore të gjithanshme dhe në vazhdimësi, ashtu dhe për moskontroll të prokurorit që ndjek hetimin ndaj oficerëve të policisë gjyqësore. Shpesh, zvarritjet e hetimeve të procedimeve penale kanë patur si shkak transferimin e çështjeve penale nga një rreth tek tjetri duke shpallur moskompetencën gjatë hetimeve paraprake, kërkesë kjo e parashikuar nga neni 84 i Kodit të Procedurës Penale. Ankesat e shtetasve për zvarritje në hetimin e çështjeve penale kanë qënë dhe ndaj Prokurorisë për Krime të Rënda. I tillë është rasti i ankesës së shtetasit K.T. nga Vlora; P.D. nga Fushë-Kruja; N.R. nga Lazarati i Gjirokastrës.

Shtetasit V e N.S dhe familjarët e tyre nga Saranda kanë ngritur shqetësimin për zvarritje në hetimin e procedimit penal që bën fjalë për veprat penale të “Vrasjes në rrethana të tjera cilësuese” dhe “Torturës me pasoja të rënda”, parashikuar nga nenet 79 “c” dhe 87 e 25 të Kodit Penal, për të cilën Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë ka filluar procedimin penal qysh më datën 16.10.2007. Konstatohet se më tepër duhet të vlerësohet momenti i regjistrimit të veprës penale në regjistrin penal që disponon organi i Prokurorisë, për të pasqyruar në të me vërtetësi dhe emrin e personit që i atribuohet vepra penale, mbasi nga ky moment fillon afati i hetimit të çështjes penale, parashikuar nga neni 287/1 e Kodit të Procedurës Penale.

Nuk duhet të abuzohet në disa raste duke zgjatur hetimin e çështjes me justifikimin se vepra penale është pa autor, kur në kallëzimin e tyre drejtuar Prokurorisë, shtetasit tregojnë dhe për autorin e veprës penale.

Konstatohet se nga ana e Prokurorisë në disa raste nuk tregohet kujdesi dhe interesimi i nevojshëm për marrjen sa më shpejt të përgjigjeve të akteve të ekspertimeve të ndryshme si, mjeko-ligjore, kimike për lëndët narkotike, kriminalistike etj.

## **2. Për moskryerje të hetimeve të gjithanshme dhe objektive**

Të tilla janë rastet e ankesave të shtetasve D.K. nga Velipoja e Shkodrës, SH.H nga Gjirokastra; A.A. nga Delvina; N.P.K nga Rrësheni i Mirditës; V.D. nga Fieri; K.B. nga Korça; R.F nga Tirana etj.

Më konkretisht ankesat e tyre kanë konsistuar në mosvënien para përgjegjësisë ligjore të autorit dhe bashkëpunëtorëve në kryerjen e krimit; në mosnjoftimin e akuzave për të gjitha veprat e kryera nga të pandehurit; në mosnxjerrjen e motiveve që kanë shtyrë autorët në kryerjen e veprës penale; në ndryshimin e kualifikimit të veprës nga një vepër më e rëndë në veprën më të lehtë në ngarkim të pandehurit; në moskryerjen e ekspertimeve të ndryshme mjeko-ligjore apo tekniko-grafike të nënshkrimit etj. Për rrjedhojë moskryerja e hetimeve të gjithanshme në disa raste ka sjellë për pasojë dhe pezullimin e hetimit apo pushimin e çështjes penale.

- Kështu në ankesën e tij shtetasi D.K. nga Velipoja e Shkodrës ankohet ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër për arsye se nuk ka kryer hetime të gjithanshme dhe objektive me qëllim vënien para përgjegjësisë ligjore të autorit të veprës penale të “Vrasjes me dashje” e mbetur në tentativë në ngarkim të shtetasit P.K. Nga verifikimi i kryer rezultoi se organi i Prokurorisë më datën 27.02.2006 ka regjistruar procedimin penal Nr. 160 për veprat penale të “Kanosjes” dhe “Mbajtjes pa lejë të armëve luftarake”, parashikuar nga nenet 84 dhe 278/2 të Kodit Penal. Pas kryerjes së disa veprimeve hetimore, Prokuroria më datën

22.06.2006 ka vendosur pezullimin e hetimit duke i kaluar aktet për veprime të mëtejshme Policisë Kriminale në Komisaratin e Policisë Shkodër.

Pas letrës së ankuesit D.K. është zhvilluar një hetim i pavarur duke u marrë shpjegime personave që kanë dijeni për ngjarjen, administruar dokumente akte shkresore si dhe studjuar materialet e dosjes hetimore të pezulluar. Më pas është arritur në përfundimin se vendimi i pezullimit të hetimit është i pabazuar në ligj dhe prova. Ai është rrjedhojë e një hetimi të njëanshëm, aspak objektiv e joprofesional. Për këto arsye i kemi rekomanduar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër shfuqizimin e vendimit të pezullimit të procedimit penal nr. 160 të vitit 2006 dhe rifillimin e hetimit të pezulluar.

- Shtetasi A.A. nga Delvina me detyrë oficer i policisë në Komisaratin e Policisë Kufitare të Sarandës, ankohet ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë për arsye se, si rrjedhojë e një hetimi të njëanshëm e ka marrë padrejtësisht në përgjegjësi penale për “Kundërshtim të punonjësit të rendit publik”. Akuza ka lidhje me ngjarjen e ndodhur më datën 11.05.2008 në stadiumin e qytetit ku zhvillohej ndeshja e futbollit ndërmjet ekipeve të Delvinës dhe Gjirokastrës dhe pas shënimit të golit nga skuadra e Delvinës tifozët kanë janë afruar tek hekurat rrethuese të fushës për të takuar lojtarët, por ka ndërhyrë policia e cila ka tejkalluar kompetencat duke ushtruar dhunë ndaj tij, xhaxhait S.A dhe shtetasve të tjerë nga Delvina që shikonin ndeshjen.

- Shtetasi K.B. nga Korça ankohej ndaj Prokurorisë për moskryerje të hetimeve të gjithanshme në vrasjen e ish bashkëshortes së tij P.B. ngjarje e ndodhur në datën 09.08.2004. Ai është arrestuar dhe është mbajtur padrejtësisht në burg për më tepër se një vit dhe mandej është liruar. Ndërsa hetimet e çështjes janë pezulluar dhe aktet kanë kaluar për ndjekje të mëtejshme policisë kriminale në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Korçë.

- Edhe për vitin 2008, shtetas të ndryshëm kanë paraqitur ankesa ndaj Prokurorisë për hetimin e çështjeve penale të “Mjekimit të pakujdesshëm” me pasoja humbjen e jetës së të afërmëve të tyre. Këto ankesa janë për ngjarje të viteve 2004-2007 dhe si të tilla janë ankesa e shtetasit A.B. nga Lushnja; L.SH. nga Vlora; I. Ç. nga Durrësi; M.K. nga Elbasani etj.

Kështu në ankesën e tij shtetasi A.B nga Lushnja, ankohej ndaj Prokurorisë së atij rrethi e cila ka pushuar çështjen penale 203 të vitit 2004 për veprën penale të “Mjekimit të pakujdesshëm” me pasojë dëmtimin e rëndë të vajzës së tij D.A. Pas kundërshtimit të vendimit në Gjykatë, aktet e këtij procedimi penal i kanë kaluar përsëri Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lushnje e cila është duke kryer të gjitha detyrat e lëna nga gjykata, ndërmjet të tjerave dhe ekspertimin teknik kriminalistik të

kartelës klinike të fëmijës D.B.

### **3. Për shkelje proceduriale në kryerjen e veprimeve hetimore**

Këto ankesa kanë konsistuar për ndalimin e paligjshëm të personave, mosnjohim të akuzës në ngarkim të tyre, mbajtje tej afateve të hetimeve paraprake apo dhe ndjekjen penale në një kohë që për të njëjtën akuzë ka patur proces gjyqësor nga autoritetet e drejtësisë të shteteve të tjera.

- I tillë është rasti i ankesës së shtetasit J.L. nga Lushnja, ndaj të cilit dhe disa personave të tjerë Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lushnje më datën 03.02.2008 ka regjistruar procedimin penal Nr.36, për veprën penale të “Vrasjes me paramendim” e kryer në bashkëpunim dhe “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga nenet 78 e 25 dhe 278/2 të Kodit Penal. Më datën 10.02.2008 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje ka vendosur masën e sigurimit “Arrest në burg” për personat nën hetim J.L. etj, si persona që u atribuohet vepra penale dhe “Veprimeve që pengojnë zbulimin e së vërtetës”, parashikuar nga neni 301 e 25 të Kodit Penal. Gjatë hetimit organi i Prokurorisë ka kryer veprime hetimore, ka zgatur dhe afatet e hetimit dhe më datën 23.10.2008 ka vendosur ndarjen e çështjes për disa prej të pandehurve. Më datën 31.10.2008 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje me vendimin Nr. 97 ka vendosur humbjen e fuqisë së paraburgimit dhe më pas ndaj ankuesit është caktuar masë sigurimi “ Arrest në shtëpi”. Pavarësisht ankimit në Gjykatën e Apelit që ka bërë organi i Prokurorisë shtetasi J.L. ka qëndruar në paraburgim për një periudhë prej tre muaj e gjysëm.

- Me iniciativën e Avokatit të Popullit është kryer hetimi i rastit të bërë publik në media dhe konkretisht në “Gazetën shqiptare” të datës 17.07.2008 në artikullin “ *E harrojnë në qeli , kallëzon prokurorin*”. Nga hetimi i bërë nga punonjësit e institucionit të Avokatit të Popullit dhe dokumentacioni i administruar në I.E.V.P. “Ali Demi” Tiranë rezultoi se :

Me vendimin nr. 276 datë 14.11.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shtetasi K.P. është dënuar në mungesë me 6 muaj burgim për veprën penale të “Dezertimit”, parashikuar nga neni 33/1 të Kodit Penal. Më datën 11.03.2008 shtetasi K.P. është ndaluar në Pikën e Kalimit Kufitar në Kakavijë të Gjirokastrës.

Meqenëse shtetasi K.P. ishte dënuar në mungesë, pa masë sigurimi dhe nuk kishte dijeni për vendimin e dënimit, nëpërmjet avokatëve mbrojtës të tij i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesë “*për rivendosjen në afat të ankimit*” kundër vendimit të gjykatës, dhe “*pezullimin e ekzekutimit të vendimit penal duke urdhëruar lirimin e menjëhershëm të tij*”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.587 akti datë, 01.04.2008 ka vendosur pranimin e kërkesës së shtetasit

K.P. për rivendosjen në afat të ankimit, ndërsa kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit penal e ka rrëzuar. Nga veprimet e paligjshme të Prokurorisë shtetasi K.P. ka qëndruar padrejtësisht në burg për një periudhë prej 3 muaj e 17 ditë. Në këto kushte Avokati i Popullit i ka rekomanduar Prokurores së Përgjithshme, *“fillimin e hetimit ndaj 4 Prokurorëve që janë marrë me ekzekutimin e këtij vendimi penal për veprat penale të “Mosmarrjes së masave për ndërprerjen e paligjshme” dhe “Shpërdorim të detyrës”.*” Po kështu edhe ndaj shtetasit B.D., dënuar në mungesë me 6 muaj burgim për veprën penale të “Dezertimit”, parashikuar nga neni 33/1 të Kodit Penal Ushtarak. Nga veprimet e paligjshme të Prokurorisë shtetasi B.D. ka qëndruar padrejtësisht 8 ditë në burg.

Në praktikën e punës së organit të Prokurorisë, siç rezulton dhe nga ankesat e paraqitura në Institucionin e Avokatit të Popullit, ka patur dhe raste të tjera të ngjashme si shtetasi A.S. ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë për qëndrim të padrejtë në burg për 2 muaj e 7 ditë; shtetasi F.K. ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë për qëndrim të padrejtë në burg për 35 ditë; shtetasi I.SH. ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për qëndrim të padrejtë në burg për 8 ditë etj. Mbi këtë shqetësim Institucioni i Avokatit të Popullit ka iniciuar në datën 5 dhjetor të vitit 2008 një seminar me Ministrinë e Drejtësisë dhe Prokurorinë e Përgjithshme. Seminari doli me përfundime konkrete me qëllim përmirësimin e punës nga Prokuroria e Gjykata, inicimin për rregullime ligjore në dispozitat përkatëse të Kodit të Proçedurës Penale që bëjnë fjalë për veprimet që kryen prokurori për ekzekutimin e vendimeve penale etj.

#### **4. Për akuzë të padrejtë apo rëndim të akuzave në ngarkim, në momentin e marrjes në përgjegjësi penale**

Rastet që ankuesit i janë drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit për akuzë të padrejtë të ngritur nga organi i Prokurorisë kanë qënë kryesisht ato kur të pandehurit kanë marrë pafajësi nga Gjykata, apo kur Gjykata ka kthyer aktet e çështjes organit të Prokurorisë dhe më pas kjo e fundit, ka vendosur pushimin e hetimit të çështjes penale. I tillë është rasti i ankesës së shtetasit R.S. nga Durrësi i cili ankohet ndaj Prokurorisë së atij rrethi që e ka akuzuar padrejtësisht djalin e tij E.S. për vjedhje të ciklotomotorit.

- Gjatë shqyrtimit të disa ankesave është konstatuar se, organi i Prokurorisë ka vepruar në mënyrë të nxituar dhe të pabazuar në verifikimin e ngjarjes me të gjithë elementët që përbëjnë veprën penale apo duke mosvlerësuar të dhënat e paraqitura me qëllim për fillimin e hetimit të proçedimit penal. I tillë është rasti i ankesës së shtetasit I.S. nga



Durrësi i cili ankohet ndaj Prokurorisë së atij rrethi për arsye se ka akuzuar padrejtësisht R.S. për veprën penale të “Heqjes së paligjshme të lirisë”. Nga verifikimi i kryer nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës rezultoi se fillimisht ndaj të pandehurit është kërkuar masë sigurimi “Arrest në burg me afat 15 ditor” dhe mandej në përfundim të këtij afati, është kërkuar “Detyrim për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore”. Konstatohet se, organi i Prokurorisë nuk ka patur provat e mjaftueshme për akuzën në ngarkim të shtetasit R.S.

Pas studimit të ankesave është konstatuar se ato janë drejtuar në Institucionin tonë menjëherë pas marrjes së vendimit nga Prokuroria. Kështu nga ana e jonë ankuesit janë sqaruar për ndjekjen e rrugës ligjore, për të kundërshtuar vendimin në gjykatë, e drejtë kjo e përcaktuar në nenin 291/2 të Kodit të Proçedurës Penale.

**5. Për mosnjoftim apo njoftim me vonesë për mënyrën e zgjidhjes së kallëzimit apo përfundimit të çështjes penale, si p.sh ankesat e shtetasve V.T. nga Tirana; I.V. nga Vlora; A.P. nga Fieri etj.**

- Rast i spikatur është ankesa e shtetasit V. T. nga Tirana, i cili ankohet ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për njoftimin me 2 muaj vonesë të vendimit të mosfillimit të proçedimit penal që lidhet me vdekjen e vëllait të tij TH.T. Nga studimi i dokumenteve të ndryshme dhe akteve shkresore rezultoi se, nga ana e Policisë Gjyqësore dhe Prokurorisë nuk ishin kryer veprimet e nevojshme me qëllim verifikimin adresës së banimit të të ndjerit TH.T. dhe mandej njoftimit të pjesëtarëve të familjes për të kryer dhe varrimin e tij, veprim që u krye nga Njësia Bashkiake. Shtetasi V.T. edhe pse mori njoftim me vonesë për vendimin e mosfillimit të proçedimit, menjëherë është drejtuar me ankesë pranë Institucionit të Avokatit të Popullit. Pas kryerjes së një hetimi të pavarur dhe studimit të akteve të administruara në dosjen hetimore, u konkludua se shtetasi K.G. kishte të drejtë dhe për rrjedhojë vendimi i mosfillimit të proçedimit penal ishte i pabazuar në ligj. Në këto rrethana Avokati i Popullit i paraqiti Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, “Rekomandim për shfuqizimin e vendimit të mosfillimit të proçedimit penal Nr. 2389 datë 25.05.200”, i cili u pranua. Pas shfuqizimit të vendimit të mosfillimit të proçedimit penal, Prokuroria urdhëroi rregjistrimin e proçedimit penal për veprën penale të “Mjekimit të pakujdesshëm”, parashikuar nga neni 96 i Kodit Penal.

- Për vitin 2008 janë marrë në shqyrtim dhe disa ankesa të shtetasve të cilët i janë drejtuar me kërkesë-ankesa Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm në rastet kur nga Prokuroritë në rrethe, është vendosur mosfillimi i proçedimit penal apo pushimi i hetimit të çështjes, por nga ajo Zyre nuk është kthyer përgjigje, ose përgjigja është dërguar me

vonesë. Raste të tilla janë ankesat e shtetasve P.B. dhe H.Z. nga Tirana etj. Konstatohet se nga ana e Prokurorëve në Drejtorit pranë Prokurorisë së Përgjithshme të cilët marrin ankesat e shtetasve, nuk tregohet kujdes i duhur për verifikimin e tyre dhe kthimin e përgjigjes sa më parë.

## **6. Për mosvënie në lëvizje apo mosvlerësim të kallëzimit të shtetasve**

Në praktikën e punës të organit të Prokurorisë janë konstatuar raste kur personat e marrë në përgjegjësi penale, ndaj të cilëve është ushtruar dhunë fizike nga punonjësit e policisë, kanë paraqitur kallëzim penal para punonjësit të Prokurorisë. Kallëzimi jo vetëm nuk është marrë, por dhe nuk është bërë vlerësimi i nevojshëm. Është detyra e Prokurorit që, mbi pretendimin e ankuesit (të pandehurit) apo konstatimet e tij kur dëmtimet janë të dukshme, të marrë kallëzimin duke e vlerësuar atë dhe menjëherë të përpilojë vendimin për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor. I tillë është rasti i filluar me iniciativën e Avokatit të Popullit për ushtrim dhune nga oficerët e policisë gjyqësore ndaj shtetasve të arrestuar A.G dhe O.V.

Të ngjashme janë edhe rastet e ankesës të shtetasve SH.E. dhe H.E. nga Shijaku i Durrësit, të cilët ankohen për ushtrim dhune nga punonjësit e policisë, pasi ata kishin shkuar për të liruar një territor ku do të ndërtohej shkolla. Pas ushtrimit të dhunës nga policia ndaj tyre nuk është kryer ekspertim mjeko-ligjor e mandej është filluar ndaj tyre procedimi penal për veprën penale të “Kundërshtimit të punonjësit të rendit publik.

## **7. Për bllokime apo sekuestrime të sendeve provë materiale, për mosdhënie të tyre gjatë fazës së hetimit apo për dhënie të tyre me vonesa**

Vihet re se në disa Prokurori të Rretheve Gjyqësore, në praktikën e hetimit të çështjeve penale kur vendoset sekuestrimi i mjeteve në aksidentet automobilistike apo sendeve prova materiale të tjera, ka një tendencë që ato nuk u kthehen personave që ju takon gjatë fazës së hetimit, ose në raste të tjera ato kthehen me vonesë, ndonëse janë kryer veprimet e nevojshme si ekspertime autoteknike, akte ekspertimi për vlerësime etj.

Kjo kërkesë përcaktohet në mënyrë të qartë në Pikën 2 të nenit 190 të Kodit të Procedurës Penale, “**Disponimi i provës materiale**” ku thuhet shprehimisht se: “*Provat materiale mund t’u kthehen personave që u përkasin edhe para mbarimit të procedimit, kur nuk dëmtohet zgjidhja e çështjes*”.

- E tillë është ankesa e shtetasit E.K. nga Kavaja i cili ankohej ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë për arsye se, nuk kishte kryer

veprime të shpejta me qëllim marrjen e mjetit të tipit “Benz” të bllokuar si send provë materiale, pas arrestimit të djalit të tij A.K. Sipas ankuesit, mjete ishte në pronësi të tij dhe ai e përdorte për punë. Në këto rrethana është komunikuar me drejtuesin e Prokurorisë së atij rrethi dhe pas paraqitjes së dokumentave që vërtetonin pronësinë e mjetit, është bërë dorëzimi sipas rregullave shtetasit E.K.

- Në kërkesën e tij shtetasi B.M. nga Klosi i Matit, kërkon ndërhyrjen e Institucionit të Avokatit të Popullit me qëllim kthimin e pasaportës për jashtë shtetit të djalit të tij A. M, bllokuar për verifikim. Pas interesimit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Mat rezultoi se, pas kryerjes së ekspertimit teknik pasaporta ishte e rregullt dhe për rrjedhojë ajo ju dorëzua të interesuarit, shtetasit B.M. Rast tjetër është ai i shtetasit R.Ç. nga Lushnja, kur Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lushnje pas arrestimit të dhëndrit të tij J.L., ka sekuestruar dhe mjetin që ankuesi kishte në pronësi. Pas komunikimit me drejtuesin e atij organi, shtetasi R.Ç. duke patur me vehte dokumentat që vërtetonin pronësinë mbi atë mjet, e ka marrë atë sipas rregullave.

#### **8. Mosmarrje të masave për kryerjen e ekspertimeve të ndryshme si mjeko-ligjor, neuropsikiatrik apo dhe riekspertimeve autoteknike**

- Shtetasi Y.XH. nga Puka ankohej ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pukë për arsye se, nuk kishte kryer gjatë fazës së hetimit paraprak ekspertimin mjeko-ligjor të vëllait të tij, ngjarje e ndodhur në vitin 2001. Ankuesi nuk ka qënë dakort me përgjigjen e dhënë nga Prokuroria se shkak i vdekjes së vëllait të tij ishte “*infarkti i miokardit*” dhe se ai ka kërkuar disa herë ekzumimin e kufomës për të kryer riekspertim dhe nxjerrë shkakun e vërtetë të vdekjes. Nga ana jonë ankuesi u sqarua se, ai ka të drejtë të paraqesë para Prokurorisë një kërkesë për kryerjen e ekzumimit të kufomës, e cila duhet të jetë e argumentuar e miratuar dhe nga pjestarë të tjerë të familjes së viktimës.

-Ankesa e shtetasit H.Z. nga Tirana, i cili ankohej ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për faktin se, në proçedimin penal nr. 1306 të vitit 2006 për veprën penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor” me pasojë dëmtimin e djalit të tij J.Z., nuk është kryer riekspertim mjeko-ligjor për të nxjerrë konkluzione të sakta, pasi akti i parë i ekspertimit doli në konkluzionin se dëmtimi i shkaktuar hyn në kategorinë e “dëmtimeve të lehta”.

- Shtetësja E.E. nga Shijaku ankohej ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për arsye se, nuk kishte kryer ekspertimin psikiatriko-ligjor të vëllait të saj M.E., dënuar për krimin e “vrasjes me paramendim” mbetur në tentativë, me 10 vjet burgim. Rast i ngjashëm është edhe

ankesa e shtetas P.D. nga Fushë –Kruja, e cila ankohej ndaj Prokurorisë për Krime të Rënda që nuk ka kërkuar kryerjen e ekspertimit psikiatriko-ligjor ndaj djalit të saj K.D. akuzuar për veprën penale të “Trafikimit të armëve dhe municionit”. Vetëm në fillim të seancës gjyqësore janë paraqitur raportet për gjëndjen mendore të tij dhe Gjykata ka vendosur kryerjen e ekspertimit psikiatriko-ligjor të pandehurit K.D.

Konstatohet se, nga ana e Prokurorive në disa raste nuk tregohet kujdesi dhe interesimi i nevojshëm për marrjen e përgjigjeve të akteve të ekspertimeve të ndryshme, si mjeko-ligjore, kimike për lëndët narkotike, kriminalistike etj, duke qëndruar në pritmëri në një kohë që aktet janë përfunduar, por për arsye burokratike nuk u janë dorëzuar atyre. Shpesh, nga ana e Prokurorëve nuk merren pretendimet e të dëmtuarve nga vepra penale apo familjarëve të tyre lidhur me konkluzionet e nxjerra nga ekspertët e fushave të ndryshme, apo kërkesa për rikryerje të ekspertimit me grup ekspertësh.

- Avokati i Popullit ka vlerësuar dhe ndjekur me përparësi dhe rastet e ankesave të shtetasve që kanë pësuar dëmtime fizike apo të shëndetit mendor nga veprime ose mosveprime të punonjësve të policisë, apo mjekët kurues për kohën që ata kanë qënë të arrestuar. Në këto raste jo vetëm janë administruar dokumentat shkresore siç janë kartelat mjekësore etj, por dhe është përpiluar vendimi për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor, i cili është dërguar Institutit të Mjekësisë Ligjore. Tek ekspertët e këtij Instituti kemi gjetur predispozicionin e nevojshëm për realizimin e aktit mjeko-ligjor dhe sjelljen e tij në Institucionin tonë brenda afateve të kërkuara. Të tilla janë rasti i ndjekur me iniciativë nga Avokati i Popullit me të dëmtuar shtetasit A.G, O.V etj, ndaj të cilëve është ushtruar dhunë fizike nga oficerët e policisë gjyqësore në Komisaratin e Policisë Sarandë. Për këtë rast Avokati i Popullit ndërmorri një hetim të pavarur dhe njëkohësisht caktoi dhe ekspertë të tjerë jashtë Institutit të Mjekësisë Ligjore. Mandej në përfundim ka dërguar Rekomandimet përkatëse në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Vlen të theksohet fakti se, Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore, për rastet e ushtrimit të dhunës nga punonjësit e policisë së shtetit kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor të dëmtuarve, duhet ta bëjnë konform udhëzimit Nr. 22 datë 23.01.2003 të Shërbimit Qëndror të Ekspertimit mjeko-ligjor, dhe konkretisht ekspertimi duhet të bëhet nga mjeku-ligjor dhe një ekspert mjeko-ligjor i Institutit të Mjekësisë Ligjore në Tiranë. Ky udhëzim nuk njihet nga prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore si dhe mjekët ligjorë, prandaj është kërkuar rifreskimi i tij dhe dërgimi për dijeni gjithë organeve të mësipërme.

Gjithashtu, organi i Prokurorisë në këto raste duhet të bashkëpunojë me ekspertin mjeko-ligjor në rrethet përkatëse me qëllim

realizimin korrekt dhe objektiv, jo vetëm për ekzaminimin e të dëmtuarit, pasqyrimin e të dhenave në aktet shkresore, por dhe në dhënien e konkluzioneve të sakta për llojin e dëmtimeve të shkaktuara.

## **9. Ankesa për ngjarje të ndodhura para dhe pas vitit 2000**

- Për vitin 2008 janë marrë në shqyrtim dhe një numër ankesash të shtetasve për vepra penale, sidomos për vrasje të ndodhura para dhe pas vitit 2000, por që nga ana e Prokurorisë është vendosur pezullimi i hetimit për moszbulim të autorit. I tillë është rasti i ankesës së shtetasës V.T. nga Mati e cila ankohej ndaj Prokurorisë dhe Policisë së atij rrethi për moszbulimin e autorëve të vrasjes së vëllait N.D.H dhe të xhaxhait V.GJ.H, ngjarje e ndodhur në datën 07.08.2001 në Urakë të Rrethit të Matit. Nga verifikimi i kryer në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Mat rezultoi se, më datën 10.07.2006 është shfuqizuar vendimi i pezullimit të hetimit të proçedimit penal nr.79, e vitit 2001 dhe janë rifilluar hetimet. Por nga veprimet e kryera nuk u arrit të gjëndeshin prova që të identifikonin autorët e vrasjes. Aktualisht proçedimi penal është ripezulluar.

Rast tjetër është dhe ankesa e shtetasit E.I. nga Vlora i cili ankohej ndaj Prokurorisë së atij rrethi për moskryerjen e veprimeve të gjithanshme me qëllim zbulimin e autorit të vrasjes së vajzës së tij E.I. 22 vjeç. Ngjarja ka ndodhur më datën 15.12.2007 ku në vëndin e quajtur “Jonufër” të qytetit të Vlorës gjatë vijës bregdetare është gjetur e vrarë vajza e tij që ishte shtatzënë.

Konstatohet se për këto çështje, të cilat fillojnë mbi bazën e ngjarjes dhe që jo vetëm janë me rrezikshmëri të madhe shoqërore, por dhe që kanë tronditur komunitetin e më gjërë, ndonëse janë kryer veprimet e para hetimore të domosdoshme, nuk ka qenë predispozicioni i duhur për kryerjen e veprimeve të gjithanshme për zbulimin e autorit të veprës penale, si dhe mungon bashkëpunimi mes prokurorisë dhe policisë kriminale. Për rrjedhojë, shpesh hetimet pezullohen dhe materialet e çështjes i dërgohen policisë kriminale. Atje shpesh nuk ka asnjë impenjim për bashkëpunim për ndjekjen në vazhdimësi të çështjes dhe analizën e tyre të herëpashershme. Në këto kushte, ato mbeten pa veprime nga policia kriminale duke mbetur edhe kriminelët pa u ndëshkuar.

Nga ana jonë për një pjesë të mirë të këtyre rasteve është bërë verifikimi në vënd, duke u marrë kontakt si me drejtues të Prokurorisë, ashtu dhe me ata të policisë kriminale. Në takimet e kryera kemi orientuar dhe insistuar në kryerjen e shpejtë të veprimeve dhe ndjekjen në vazhdimësi të çështjeve të pezulluara.

## **10. Ankesa për kërkesat e prokurorëve për masat e sigurimit apo të dënimit**

- Ka edhe ankesa nga shtetasit për masa të ulta dënimi për autorët e veprave penale ku ata, ose pjesëtarë të familjes janë të dëmtuar, si p.sh. ankesa e shtetasit N.P.K nga Rrësheni i Mirditës i cili ankohej ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për arsye se në hetimin e çështjes penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor” me pasojë vdekjen e bashkëshortes së tij, me autor shtetasin N.M, ngjarje e ndodhur më datën 02.01.2008 ka ndryshuar kualifikimin e veprës duke e akuzuar drejtuesin e mjetit për “Drejtimit të mjetit pa dëshmie aftësie” dhe “Largim nga vendi i aksidentit”. Pas përfundimit të hetimit dhe dërgimit të çështjes në gjyq autori i veprave penale është dënuar me 4 muaj burgim me kusht për 2 vjet.

- Në raste të tjera ankesat e shtetasve janë drejtuar ndaj organit të Prokurorisë e cila sipas tyre, ka kërkuar masë sigurimi “arrest në burg” pa mbajtur parasysh rrethana të tilla që lidhen me moshën, e për rrjedhojë duhet të kërkonte masë sigurimi më të butë. Të tilla janë rasti i ankesës së shtetasit F.M. nga Durrësi, ku prokurori ka kërkuar masë sigurimi “arrest në burg” ndaj djalit të tij A.M. nxënës shkollë në vitin e dytë të shkollës së mesme, me moshë 16 vjeç, për veprën penale të “vjedhjes me armë”; Ankesa e shtetasit Xh.F. ndaj Prokurorisë Sarandë për kërkesë për masë sigurimi “arrest në burg” ndaj djalit A.F. me moshë 15 vjeç, akuzuar për veprën penale të “vjedhjes së pasurisë” kryer në bashkëpunim.

- Ka edhe ankesa nga shtetasit për caktim mase sigurimi “arrest në burg” ndaj personave të tyre të afërm, por që vuajnë nga sëmundje mendore. Të tilla janë ankesa e shtetasës Z. J. ndaj Prokurorisë Korçë, ndaj djalit të saj E.J. akuzuar për veprat penale të “Vrasjes me dashje” e mbetur në tentativë dhe “Prishjes së qetësisë publike”; ankesa e shtetasit V.L. ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier për djalin e tij L.L. për vjedhje të pasurisë në një pastiçeri në qytetin e Patosit; ankesa e shtetasës S. B ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat, për kërkesë për caktim mase sigurimi “arrest në burg” ndaj bashkëshortit të saj A.B për “Dëmtim me dashje të pronës” dhe “Vjedhje të pasurisë”, duke dëmtuar pajisje të skrapit në pusin e naftës me qëllim shitje të materialeve, por i detyruar nga kushtet e rënda ekonomike në familje.

- Ka edhe ankesa të shtetasve drejtuar ndaj organit të Prokurorisë e cila sipas tyre ka kërkuar masë të lartë dënimi me burgim ndaj fëmijëve apo të afërmeve të tyre, të akuzuar për vepra penale të ndryshme si p.sh. ankesa e shtetasës L.N. nga Fushë-Arrësi e cila ankohet ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pukë për arsye se, ka kërkuar deklarinim fajtor dhe dënimin me 24 vjet burgim të bashkëshortit të saj L.P.N për

veprën penale të “Vrasjes me paramendim” kryer në vitin 2000; Ankesa e shtetasit J.R. nga Cërriku i Elbasanit për kërkesën e Prokurorit për masë dënimi të lartë prej 6 vjet burgim ndaj djalit të tij L.R. akuzuar për veprat penale të “Vjedhjes së pasurisë” dhe “Mbajtjes pa lejë të armëve luftarake” etj.

Nga ana jonë ankuesit janë sqaruar për mosndërhyrjen e Avokatit të Popullit në pavarësinë e organeve të drejtësisë, kërkesë kjo e përcaktuar në nenin 145 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe të drejtën që kanë për t’u ankimuar kundër vendimit të gjykatës duke i u drejtuar instancave përkatëse gjyqësore sipas procedurave të parashikuara në ligj. Pavarësisht nga sa sipër, shqetësimi i tyre mbetet një problem që mendojmë se duhet rregulluar për të futur të drejtën e ankimit të viktimës ndaj vendimeve gjyqësore. Pra, të përmirësohet Kodi i Procedurës Penale në drejtim të dhënies së të drejtës që avokati i viktimës të ketë të drejtë të ankohet kundër vendimit të pafajësisë apo masës së dënimit.

## **11. Ankesa për hetimet në çështjet e aksidenteve automobilistike**

-Për periudhën që analizohet ka patur dhe raste kur, shtetas të ndryshëm ankohen për “mbyllje” të çështjeve për veprën penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor” me pasoja të rënda për jetën apo shëndetin e shtetasve. Të tilla janë ankesat e shtetasve K.M, XH.D dhe XH.XH nga Tirana; H.F. nga Patosi etj.

-Kështu shtetasi K.M. nga Tirana, ka kërkuar ndërhyrjen e Avokatit të Popullit për kryerjen e hetimeve objektive në procedimin penal që bën fjalë për veprën penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor” me pasojë dëmtimin e rëndë të bashkëshortes së tij T.M, hetuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Autori i veprës penale shtetasi F.R. i cili ka qënë drejtuesi i mjetit është lënë i lirë dhe fillimisht organi i Prokurorisë ka vendosur pushimin e çështjes penale. Mbi ankesën e shtetasit K.M në Prokurorinë e Përgjithshme është bërë *“shfuqizimi i vendimit të pushimit të çështjes dhe rifillimi i hetimit”*. Pas kryerjes së hetimeve të gjithanshme dhe objektive çështja penale është dërguar në gjyq.

- Shtetësja XH.D. nga Tirana L.M. ankohej ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë, për arsye se kishte kërkuar masë sigurimi “Detyrim për paraqitje në Policinë Gjyqësore ” për drejtuesin e mjetit M.N. autor i veprës penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor”, me pasojë dëmtimin e saj të rëndë dhe dëmtimin e shtetasit R.L. Organi i Prokurorisë ka kërkuar kryerjen e një ekspertimi tjetër autoteknik me grup ekspertësh të pavarur dhe në funksion me

konkluzionet e ekspertëve do të vendosë për mënyrën e përfundimit të hetimit.

Nga studimi dhe analiza e bërë ankesave të paraqitura në Institucionin tonë arrijmë në përfundimin se, nga ana e Prokurorisë jo gjithmonë bëhet vlerësimi i duhur i këtyre çështjeve, të cilat fillojnë mbi bazën e ngjarjes dhe kërkojnë kryerje të shpejta të veprimeve të para hetimore të papërsëritshme, njohuri profesionale në fushën autoteknike dhe objektivitet. Njëanshmëria, dhënia e konkluzioneve të pasakta dhe të padrejta në aktet e ekspertimit mjeko-ligjor ose autoteknik, moskryerja e veprimeve të gjithanshme, janë pasoja të vendimeve të pabazuara të ndërmarra nga policia gjyqësore e të miratuara nga Prokuroria. Nga ana tjetër, ato sjellin zvarritje në hetimin e çështjeve penale dhe pasoja të tjera që lidhen me probleme sociale, deri në acarimin e marrëdhënieve ndërmjet autorëve të veprës me familjarët e të dëmtuarve apo viktimave të shkaktuara nga vepra penale. Veç sa sipër, këto qëndrime ndikojnë negativisht në rritjen e numrit të aksidenteve në shkallë vëndi, i cili për vite me radhë është mjaft shqetësues.

**B.** Nga shqyrtimi i ankesave të ndryshme që janë konsideruar të drejta për shkeljet e konstatuara, Avokati i Popullit i ka paraqitur Prokurorit të Përgjithshëm, apo drejtuesve të Prokurorive në rrethe 7 rekomandime, të cilat përgjithësisht janë mirëpritur dhe pranuar. Në mënyrë të grupuar rekomandimet tona drejtuar organit të Prokurorisë, paraqiten si më poshtë:

**1.** Rekomandimi drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër për dijeni Prokurores së Përgjithshme, *“Për shfuqizimin e vendimit të pezullimit të proçedimit penal Nr. 160 të vitit 2006, dhe rifillimin e hetimit të pezulluar”*. (Ankesa e shtetasit D.K. nga Velipoja e Shkodrës). Rekomandimi është në shqyrtim.

**2.** Rekomandim drejtuar Prokurores së Përgjithshme *“Për shfuqizimin e vendimit të mosfillimit të proçedimit penal në lidhje me kallëzimin penal Nr. 2389 të vitit 2008 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe fillimin e hetimit për veprën penale të “Mosdhënies ndihmë”, parashikuar nga neni 97 i Kodit Penal”*. (Ankesa e shtetasit V.T. nga Tirana). Rekomandimi është pranuar dhe pasi është kryer shfuqizimi i vendimit të mosfillimit të proçedimit penal, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka rifilluar hetimet për veprën penale të *“Mjekimit të pakujdesshëm”*.

**3.** Rekomandimi drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë, *“Për shfuqizimin e vendimit të pushimit të çështjes penale Nr. 61 të vitit 2007”* (Ankesa e shtetasit F.K. nga Tirana, për ushtrim dhune nga punonjësit e policisë së burgjeve ndaj djalit të saj A.K. që ishte duke vuajtur dënimin në I.E.V.P.Rrogozhinë). Rekomandimi është pranuar dhe



pasi është shfuqizuar vendimi i pushimit janë rifilluar hetimet. Proçedimi penal ndodhet në fazën e hetimit paraprak.

4. Rekomandimi drejtuar Prokurores së Përgjithshme *“Për fillimin e hetimit ndaj prokurorëve të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë A.P. e P.B. për veprën penale të “Mosmarrjes së masave për të ndërprerë gjëndjen e paligjshme”, parashikuar nga neni 251 i Kodit Penal dhe K.SH. e P.F. për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës” , parashikuar nga neni 248 e Kodit Penal”*. (Filluar me inisiativën e Avokatit të Popullit për shtetasin e arrestuar K.P.) Për rekomandimin nuk është kthyer përgjigje.

5. Rekomandimi drejtuar Prokurores së Përgjithshme *“Për fillimin e hetimit për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 e Kodit Penal në ngarkim të zj.E.XH. Prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe z. S.M e I.D. oficerë të policisë gjyqësore në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Durrës”*. Për rekomandimin nuk është kthyer përgjigje nga Prokuroria e Përgjithshme.

6. Rekomandimi drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë, *“Për zhvillimin e hetimeve për veprën penale të “Torturës” në ngarkim të oficerit të policisë gjyqësore A.H. në Komisaratin e Policisë Sarandë”* (Me inisiativën e Avokatit të Popullit, pas ushtrimit të dhunës në Komisaratin e Policisë Sarandë ndaj shtetasve të arrestuar A.G. dhe O.V.). Rekomandimi është pranuar, por Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka filluar hetimin për veprën penale të *“Kryerjes së veprimeve arbitrare”*.

7. Rekomandimi drejtuar Prokurores së Përgjithshme *“Për marrjen e masave disiplinore ndaj Prokurorvë z. N.T. dhe B.B. në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier, për zvarritje të pajustificuara, shkelje proçeduriale dhe moskryerje të një proçesi të rregullt ligjor në hetimin e proçedimit penal Nr. 350 në ngarkim të pandehurit B.G”*. (Ankesa e shtetasit B.G. dhe e avokatit të tij mbrojtës Ll.K.). Rekomandimi është pranuar dhe ndaj prokurorëve që kanë hetuar çështjen është marrë masë disiplinore *“tërheqje vëmëndje”*.

Vlen të theksohet fakti se për të gjitha rekomandimet e sipërpërmëndura drejtuar Prokurorive në rrethe të ndryshme gjyqësore të vëndit, nga ana jonë është vënë në dijeni Prokurori i Përgjithshëm, i cili pas shqyrtimit të tyre, jo në të gjitha rastet ka kthyer përgjigje brënda afatit ligjor në Institucionin e Avokatit të Popullit.

Për vitin 2008, vlen për t’u theksuar fakti se nga ana e Prokurorive në rrethe, ka një vlerësim më të mirë dhe korrekt në rekomandimet e dërguara nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Për rrjedhojë të gjitha rekomandimet tona janë pranuar. Por ka edhe raste që ndonjë Prokurori si ajo e Sarandës dhe e Durrësit, ngurojnë të dërgojnë informacione apo akte, s’japin për studim dosje penale për të cilat janë pushuar hetimet prej

tyre, por për të cilat ka patur ankesa nga shtetasit, apo dërgojnë informacionet me vonesë etj. Këto prokurorë nuk kanë parasysh ndryshimet e bëra me Ligjin Nr. 9398 datë 12.05.2005 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin Për Avokatin e Popullit”, ku janë qartësuar kompetencat tona edhe në marrëdhënie me Prokurorinë dhe sipas të cilave të gjitha kërkesat tona ndaj prokurorive kanë qënë dhe janë të bazuara në ligj. Thelbi është se këto prokurorë nuk dëshirojnë kontrollin mbi punën e tyre.

## 5. Ministria e Brendshme

Gjatë këtij viti ndaj Ministrisë së Brendshme dhe organeve të pushtetit vendor kanë ardhur gjithsej 635 ankesa, kërkesa apo njoftime. Nga këto 233 kanë qënë ndaj institucionit të Ministrisë së Brendshme dhe të Policisë së Shtetit, ndërsa 401 kanë qënë ndaj organeve të pushtetit vendor si Këshillave të Qarqeve, Prefekturave, Bashkive, Komunave dhe Zyrave të Gjendjes Civile.

A. Pranimi dhe shqyrtimi me përparësi dhe me rigorozitet i ankesave dhe kërkesave ndaj organeve të Ministrisë së Brendshme dhe të Policisë së Shtetit ka qënë dhe do të vazhdojë të mbetet një nga prioritetet tona kryesore. Kjo jo vetëm për faktin se ky organ i administratës publike përbën strukturën që përfaqëson fuqinë shtrënguese të shtetit, por edhe për vetë specifikën e Policisë Shqiptare, e cila krahas arritjeve pozitive, vazhdon të ketë në radhët e saj elementë të pakulturuar, të papërgatitur profesionalisht, të pa trajnuar me konceptet e shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të Njeriut, të korrumpuar etj.

Në institucionin tonë për sektorin e Policisë gjatë vitit 2008 kanë ardhur gjithsej 233 ankesa, kërkesa apo njoftime. Kanë përfunduar 213 ankesa si vijon: 79 ose rreth 37% janë zgjidhur në favor, 30 kanë qënë jashtë juridiksionit, 98 kanë qënë të padrejta, kurse 6 ankues kanë hequr dorë. Janë mbartur për shqyrtim në vitin 2009, 18 ankesa.

Gjatë këtij viti për rastet që kemi vërtetuar shkelje të ligjit, janë bërë 3 rekomandime për fillimin e ndjekjes penale, nga të cilat 1 është pranuar dhe 2 janë në shqyrtim. Gjithashtu janë bërë edhe 11 rekomandime për dhënien e masave disiplinore ndaj 17 punonjësve të Policisë, nga të cilat 8 janë pranuar dhe 3 janë në shqyrtim. Mbi bazën e rekomandimeve tona janë dhënë masa disiplinore ndaj 14 punonjësve të Policisë që kanë bërë shkelje të akteve ligjore ose nënligjore.

## **Ankesat e trajtuara ndahen sipas problemeve të mëposhtme:**

### **I. Ankesat për torturë dhe keqtrajtim të shtetasve.**

Këto ankesa janë vlerësuar më tepër, sepse kur ato kanë rezultuar të vërteta, kanë qënë shkelje të rënda të nenit 25 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë që parashikon se: *“Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerezor ose poshtërues”*. Njëkohësisht ato janë edhe dhunime të rënda të nenit 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Në institucionin tonë janë administruar 34 ankesa për torturë dhe keqtrajtime të shtetasve nga Policia e Shtetit. Nga këto, kanë përfunduar 31, ndërsa 3 janë në shqyrtim. Pas përfundimit mënyra e zgjidhjes së tyre është: 9 ankesa janë vlerësuar të drejta, 14 të pa bazuara, 7 kanë qënë jashtë juridiksionit dhe 1 ankues ka hequr dorë sepse punonjësi i Policisë i kërkoi falje atij.

Theksojmë se këtë vit numri i ankesave për torturë dhe keqtrajtime ka qënë në rritje në krahasim me vitin e kaluar, me 11 raste më shumë. Ky fakt është një tregues regresiv i Policisë së Shtetit dhe duhet t’u tërheqë vëmendjen drejtuesve të saj. Ata duhet të organizojnë më mirë punën edukuese dhe profesionale me efektivat e tyre, me qëllim parandalimin e këtij fenomeni të papranueshëm për shtetin e së drejtës dhe shoqërinë demokratike që po ndërtojmë e konsolidojmë në vendin tonë.

Për rastet kur kemi vërtetuar pretendimet e ankuesve për torturë apo keqtrajtime nga punonjësit e Policisë kemi bërë rekomandime për organet përkatëse. Gjatë vitit 2008 për rastet e torturës, i janë bërë 2 rekomandime organit të Prokurorisë për fillimin e ndjekjes penale ndaj 3 punonjësve të Policisë, nga të cilat 1 është pranuar dhe 1 është në shqyrtim. Gjithashtu për rastet e keqtrajtimit fizik kemi bërë 2 rekomandime për dhënien e masave disiplinore ndaj 5 punonjësve të Policisë të cilat janë pranuar.

Si raste të ankesave për torturë dhe keqtrajtime të shtetasve të vërtetuara mund të përmendim:

1. Rasti i ndjekur me iniciativë pas bërjes publike, më datën 06.11.2008, në disa media për ushtrim dhune fizike ndaj shtetasit A. G. nga punonjësit e Policisë të Komisarariatit Sarandë.

Shqetësimin e ngritur nga media e vlerësua seriozisht dhe për këtë arsye kryem një hetim administrativ të pavarur të këtij rasti.

Më datën 08.11.2008 një ekip i Avokatit të Popullit ka shkuar në Sarandë sapo ka marre informacion për ngjarjen e ndodhur të keqtrajtimit të shtetasit Aristidh Glluçaj nga Gjormi i Vlorës, i cili ndodhej që nga data 6 nëntor 2008 në spitalin e Sarandës në gjendje të rëndë. Pas kryerjes

së hetimeve të pavarura, qysh më datë 8 nëntor 2008, Avokati i Popullit i kishte kërkuar verbalisht Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë fillimin e hetimit për veprën penale të “*Torturës*” sipas nenit 86 të Kodit Penal ndaj oficerit të policisë gjyqësore Sarandë Ardit Hasanaga dhe ka kërkuar për të hetime të shpejta, të drejta dhe objektive, për të zbatuar parimin kushtetues se: Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Kjo kërkesë është bërë sepse policia dhe prokuroria e Sarandës e kanë shkelur këtë parim dhe deri më datën 11 nëntor 2008 nuk kanë zbatuar ndaj këtij oficeri policie as masën e ndalimit dhe as atë të arrestimit në flagrance, në një kohë që këto organe këto masa i zbatojnë pa mëshirë dhe me nxitim ndaj fukarenjve, qoftë kur janë edhe në gjendje traumatike, por që shkelin ligjin në kushtet e nevojës ekstreme, për të siguruar bukën e gojës për vete dhe familjarët e tyre.

Ky rekomandim ka të bëjë me ushtrimin e dhunës fizike nga ana e oficerit të Policisë më datën 6 nëntor 2008 në ambientet e Komisarariatit të Policisë Sarandë ndaj disa shtetasve shqiptare, të cilët ishin të shoqëruar në këto ambiente me dyshimin për tentative për kalim të paligjshëm të kufirit shqiptaro grek.

Pa u ndalur më tej në rrethanat e ngjarjes, që janë pasqyruar në mënyrë të hollësishme në rekomandimin zyrtar drejtuar Prokurorisë së Rrethit të Sarandës, Avokati i Popullit shprehu publikisht në një konferencë shtypi më datën 11.11.2008 shqetësimin e tij për këtë rast shumë të rëndë të ushtrimit të Torturës. Gjithashtu me këtë rast i kujtoi opinionit publik, gjithë institucioneve dhe drejtuesve të shtetit shqiptar, organeve të drejtësisë, organizmave ndërkombëtarë brenda dhe jashtë vendit dhe mediave shqiptare se:

**E para**, fushata e tolerancës zero në luftën kundër trafikëve, në asnjë rast nuk mund dhe nuk duhet të legjitimojë ushtrimin e dhunës deri në kufijtë e torturës nga ana e policisë së shtetit shqiptar ndaj shtetasve shqiptare.

Avokati i Popullit ka bindjen se menaxhimi i integruar i kufijve ka shënuar përmirësime cilësore dhe për këtë organet e policisë duhen përsëritur. Por kjo nuk justifikon zbatimin e masave të dhunshme policore, në kufijtë e torturës ndaj personave që tentojnë të kalojnë kufirin në mënyrë të paligjshme. Në kemi bindjen se policia e shtetit i ka të gjitha mundësitë dhe informacionin e mjaftueshëm për të kryer identifikimin e personalitetit të personave që shoqëron apo ndalon. Të quash organizator të trafikut një qytetar të thjeshtë e të varfër deri në ekstrem, që merr rrugën e emigrimit me një copë bukë e djathë në trastë, kjo nuk është luftë kundër trafikut, por alibi e luftës kundër trafikut, sepse edhe në rastin konkret vetëm se kamuflohen autoret dhe organizatorët e vërtetë të këtij trafiku.

**E dyta**, rasti me i fundit i dhunës ne Sarande na kujton te gjithëve ngjarjen e vitit 2003 ne Korçe, kur një shtetas shqiptar humbi jetën nga dhuna e policisë, e për pasojë pesë punonjës policie u dënuan nga gjykata deri me 15 vjet burg. Edhe në atë rast reagimi i policisë dhe prokurorisë ndaj fajtorëve ishte me shumë vonesë. Mos vallë duhet pritur që ndonjë shtetas tjetër të vdesë nga dhuna policore që këto organe të veprojnë? Deri kur do vazhdojnë këto shfaqje oportunitizmi dhe mbrojtje të policëve nga prokurorët?? Po gjyqtarja e Sarandës pse nuk reagoi kur dy personat e rrahur u paraqitën në atë gjendje para saj? Po kur njëri prej tyre u “këput” para syve të saj, pse nuk urdhëroi masat penale që ja lejon ligji ndaj autorëve të torturës?? Të gjitha këto janë shkelje të hapura ligji nga prokurorët dhe gjykata e Sarandës. Del në dukje pyetja e përhershme që bëjnë shtetasit shqiptarë: - Pse shkelin ligjet prokurorët dhe gjyqtarët dhe pse nuk ndëshkohen ata?

**E treta**, është e vërtetë se vetëm pak ditë me parë, ne ujërat e liqenit të Butrintit në Sarandë ishte përmbysur një varkë dhe humbën jetën disa qytetarë, njëra bashkë me foshnjën e saj, të cilët ishin nisur te kalonin kufirin në mënyrë te paligjshme. Të gjitha autoritetet e larta shtetërore bënë shumë mirë që shprehën ngushëllimet e tyre me këtë rast. Por, si Avokat i Popullit unë shtroj pyetjen: Po sikur edhe i arrestuari i tanishëm për kalim te paligjshëm te kufirit A.G. te kishte pasuar fatin tragjik te viktimave te lartpërmendura, çfarë do te kishin bere autoritetet shtetërore? Padyshim qe do te kishin shprehur ngushëllimet e tyre. Ndërsa në kohën qe ai u kap dhe është gjallë, policët e po këtij shteti ushtrojnë ndaj tij Torturë, pasojat e se cilës qytetarët shqiptarë i kanë parë me dhimbje edhe ne ekranet e televizionit. Dhe veç kësaj, në gjendje të rënduar shëndetësore, gjykata vendosi ndaj tij “arrest në burg për 30 ditë”?, në një kohë që ndaj kriminelëve që ushtruan torturën bën një sy qorr dhe një vesh shurdh.

**E katërta**, kujtojmë që Avokati i Popullit prej kohësh dhe vazhdimisht ka ndërhyrë pranë autoriteteve greke dhe maqedonase për rastet kur policët e tyre kanë ushtruar dhune ndaj qytetareve shqiptare qe kane kaluar ne mënyrë te paligjshme kufirin. Por është e patolerueshme ushtrimi i kësaj dhune nga ana e policisë se shtetit shqiptar, në një kohë që këta shtetas shqiptarë veçse duhen pyetur, të këshillohen dhe të kthehen të sigurtë në vendbanimet e tyre. Këto veprime i kryen rregullisht edhe policia greke, ndonëse shtetasit shqiptarë e kanë konsumuar krimin e kalimit të paligjshëm të kufirit. Pse policia shqiptare sillet më ashpër ndaj shtetasve të saj se edhe policia greke kohët e fundit?

Sa me sipër, Avokati i Popullit bëri të ditur se kishte komunikuar me drejtues te Prokurorisë se Përgjithshme, te Policisë se Shtetit dhe te Ministrisë se Brendshme, për te vene para përgjegjesisë oficerin e policisë Ardit Hasanbega e të tjerë, pasi ky i fundit ne kushte gjakftohtësie dhe

vullneti te plote, ne zyrat e Komisarariatit te Policisë te Sarandës, (jo në ambientet e paraburgimit) kishte konsumuar veprën penale te Torturës, parashikuar nga Neni 86 i Kodit Penal. Aq më tepër që ky krim dënohet vetëm me burgim nga katër deri në dhjetë vjet. Por deri atë ditë nuk kishte njoftim se ndaj tij ishte marrë ndonjë masë ndalimi. Prandaj ju bë thirrje Prokurores së Përgjithshme dhe Ministrit të Brendshëm që të reagojnë ndaj kërkesave të Avokatit të Popullit sepse detyra e tyre është të mos bien në pozitat inaktive të organeve që varen prej tyre në Sarandë. Në të kundërtën do të vlerësoja se inaktiviteti i tyre për të vënë para përgjegjësisë policët që torturojnë njerëz dhe shkelin të drejtat e njeriut, do më detyronte të zbatoj detyrën dhe të drejtën që më njeh Kushtetuta e Shqipërisë sipas pikës 2 të nenit 63 të saj, që t’i kërkoj Kuvendit të flas dhe të dëgjohem para tij për çështjen e rëndësishme të torturës ndaj qytetarëve shqiptarë.

Avokati i Popullit, theksoi se edhe në cilësinë e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka ushtruar dhe do të ushtrojë në mënyrë periodike kontrole të befasishme në të gjitha ambientet e burgimit dhe paraburgimit, në komisariate dhe spitale psikiatrike, në aeroporte dhe ambiente të tjera të mbyllura, ku ushtrimi i dhunës është eventualisht me i mundshëm.

Me këtë rast, Avokati i Popullit synoi dhe kërkoi që rasti i Sarandës të bëhet precedent për të gjithë ata punonjës policie që abuzojnë me fuqinë që u jep rroba dhe autoriteti i policisë së shtetit. Mosndëshkimi i rasteve të tilla rrezikon t’u kthejë qytetarëve ndjenjën e pasigurisë dhe të frikës, për pasojë të mosbesimit dhe urrejtjes ndaj shtetit të tyre.

Prokuroria e pranoi rekomandimin tonë dhe e filloi ndjekjen penale ndaj punonjësit të Policisë Ardit Hasanbega, ndaj te cilit u aplikua në pasditen e datës 11 nëntor 2008 edhe masa e sigurimit “arrest në burg”. Mirëpo ajo e filloi çështjen penale për veprën penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250 i K.Penal dhe jo për veprën penale të “Torturës”, parashikuar nga neni 86 i K.Penal.

Ne gjykojmë, se qëndrimi i mbajtur nga Prokuroria e rrethit Sarandë dhe vlerësimi i bërë prej saj në këtë rast, nuk është ligjor dhe objektiv, sepse nga provat e administruara nga ana jonë, të cilat ia dërguam organit të Prokurorisë, provohej plotësisht se punonjësi i Policisë Ardit Hasanbega kishte konsumuar elementët e veprës penale të “Torturës”. Të dëmtuarit i ishin shkaktuar vuajtje të rënda fizike nga ana e punonjësit të Policisë me qëllim marrjen prej tij të informatave dhe pohimeve për kryerjen e veprës penale të “Ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit”, parashikuar nga neni 298/3 i Kodit Penal, që siç rezultoi në fakt, nuk ishte kryer prej tij. Çështja vazhdon në hetim për vitin 2009.

2. Një ekip i kryesuar nga vet Avokati i Popullit, më datën 21.11.2008 ushtroi një inspektim në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Shkodër, ku ndodhet edhe Komisariati i Policisë i Rrethit Shkodër, me qëllim për të parë në vend respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar, arrestuar apo ndaluar nga Policia u konstatua se:

Në këtë organ vendor të policisë ishin tre dhoma shoqërimi, të cilat për nga ndërtimi, siguria dhe përmasat ishin dhoma izolimi (me dyer hekuri, shula e të mbyllura me dryna). Ato ishin pa ndriçim natyral, të pa lyera dhe pa stola e tavolina, por nuk kishte të shoqëruar brenda tyre. Pas interesimit tonë lidhur me numrin e personave të shoqëruar në momentin që ne po bënim inspektimin, u sqaruam se personat e shoqëruar atë ditë, po pyeteshin nga Oficerët e Policisë Gjyqësore nëpër zyra.

Pasi u bë këqyrja e dhomave të shoqërimit, u ngjitëm në katin e tretë ku ndodheshin personat e shoqëruar. Në korridorin e katit të tretë pamë disa persona me të cilët morëm takim dhe pasi u prezantuam, i pyetëm për arsyen e ndodhjes së tyre në Polici. Ata na shpjeguan se ishin marrë nëpër shtëpi nga Policia dhe shoqëruar që në orët e para të mëngjesit. Veprimet e Policisë ishin kryer nga ora 05.00-07.00. Nga punonjësit e Policisë ju ishte thënë se do të shoqëroheshin në Polici për një verifikim. Personat e shoqëruar të cilët ndodheshin në korridor quheshin, N. A., Z. Z., M. M. dhe M. K.. Nga pyetja e tyre rezultoi se, në Polici ishin të shoqëruar edhe dy persona të tjerë T. A. dhe E. A.. Shtetasi T. A. ishte duke u pyetur në një zyrë aty nga dy Oficerë të Policisë Gjyqësore, Erzen Cera, me detyrë Shef Sektori Kundër Krimeve të Rënda në DPQ Shkodër dhe Erdit Rreçeku, me detyrë Specialist për Hetimin e Krimeve në këtë drejtori. Ndërsa E. A. 20 vjeç, djali i N. A., rezultoi që në ato momente të ishte futur në një zyrë tjetër. Në fakt punonjësit e Policisë me në krye Zv/Drejtorin, i cili ishte në krye dhe udhëhiqte këto veprime të Policisë Gjyqësore, nuk na treguan se ishte shoqëruar edhe shtetasi E. A.. Nga ana jonë u kërkua informacion se ku ndodhej ai në ato momente dhe kërkua që ta sillnin në takim me ne.

Ai erdhi dhe u pyet se përse gjendej në Polici, për çfarë e kishin pyetur dhe si e kishin trajtuar gjatë pyetjes. Shtetasi E. A. na shpjegoi se: “Një grup policësh i kishin shkuar në shtëpi rreth orës 05.00 të asaj date dhe e kishin pyetur nëse ishte shtëpia e N. A.. Pasi ai u kishte konfirmuar këtë fakt, ata e kishin pyetur se ku ndodhej babai i tij. Ai ju kishte thënë se ishte tek xhaxhai i tij në Grudë. Policët ikën dhe pas rreth 10 minutash ishin kthyer dhe kishin marrë E. A. duke i thënë se do të vinte në Polici për një sqarim. Në makinën e Policisë ai kishte parë edhe xhaxhain e tij T. A. dhe një person tjetër i panjohur prej tij. Fillimisht punonjësit e Policisë e kishin çuar në katin e tretë, duke e lënë në këmbë në pritje për rreth një orë. Më pas e pyetën atë lidhur me autorët e vrasjes së shtetasit M. D., ngjarje e ndodhur në vitin 1997 te Ura e Bunës në Shkodër, kur ai

ishite 9 vjeç. Ai ju kishte thënë punonjësve të Policisë se nuk dinte gjë për autorin e saj. Pas pyetjes ai ishte dërguar në katin e parë në dhomat e shoqërimit, në korridorin e tyre, por duke u mbyllur me derë hekuri dhe dryn. Aty ai ka parë babanë e tij të mbyllur në qeli. Pas rreth 30 minutash, ai është dërguar përsëri në zyrën e katit të tretë, ku ndodheshin tre persona civile dhe është pyetur rreth autorëve të vrasjes. Pasi E. A. u ka thënë se nuk dinte asgjë, dy prej tyre e kanë qëlluar me pëllëmbë duke i thënë që “të tregonte se për ndryshe do ta fusnin në burg”. Pas ballafaqimit të bërë, ai njohu punonjësit e Policisë që e kishin pyetur e qëlluar me pëllëmbë atë, të cilët ishin Erzen Cera dhe Erdit Rreçeku. Ndërsa për z. Artan Hasani, me detyrë Zëvendës drejtor në DPQ Shkodër ai tha se kishte qenë prezent gjatë pyetjes së tij, por nuk e kishte qëlluar.

Pas pyetjes për herë të dytë, ai përsëri është dërguar në dhomat e shoqërimit. Aty i ka thënë babait se, “e qëlluan me pëllëmbë dy civilë”, (këtë fakt e dëshmoi edhe babai i tij N. A. gjatë pyetjes nga ana jonë). Më pas ai ishte marrë nga dhomat e shoqërimit dhe ishte futur në një zyrë në katin e tretë. Sqarojmë se, në momentin që ai u takua nga ana jonë, ne konstatuam shenjat e dhunës në fytyrën e tij, në faqen e majtë, e cila ishte e skuqur. Për këtë ai u fotografua.

Nga pyetja e të shoqëruarve dhe e punonjësve të Policisë Artan Hasani, Erzen Cera dhe Erdit Rreçeku, të cilët po kryenin veprime me të shoqëruarit, u informuam se personat e shoqëruar ishin marrë nga Policia dhe po pyeteshin rreth vrasjes në vitin 1997 të shtetasit M. D.. Sipas Policisë, marrja e tyre ishte bërë në bazë të urdhërit të dt. 19.11.2008 të Zv/Prokurores së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Nga shpjegimet e dhëna prej punonjësve të Policisë rezultoi që shtetasi N. A. ishte person i dyshuar si autor i vrasjes së shtetasit M. D., ndërsa të tjerët kishin dijeni për rrethanat e hetimit.

Nga këqyrja e librit të personave të shoqëruar në këtë organ rezultoi se më dt. 21.11.2008, nga 6 persona të shoqëruar në fakt në Polici, ishin të regjistruar vetëm 3 prej tyre. Ora e shoqërimit të tyre ishte 07.00, ndërsa arsyeja e shoqërimit ishte për verifikim.

Nga shqyrtimi në tërësi i këtij rasti ne konstatuam se:

1. Personat e mësipërm ishin marrë në Polici në zbatim të urdhrit dt. 19.11.2008 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Pra në kuadrin e një hetimi penal dhe në këto kushte duhej të zbatoheshin normat e K.Pr.Penale. Veprimet e Policisë për shoqërimin dhe pyetjen e 6 personave të cituar më sipër ishin bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe konkretisht;

a) Me nenin 312 të K.Pr.Penale, sipas të cilit, *“thirrja e personave të cilët mund të tregojnë rrethana të dobishme për qëllimet e hetimit, duhet bërë me urdhër, i cili përmban gjeneralitetet e personit, ditën, orën,*



*vendin e paraqitjes dhe paralajmërimin për shoqërim të detyrueshëm në rast mosparaqitje pa patur pengesë të ligjshme”.*

Në këtë rast nga punonjësit e Policisë Gjyqësore që kishin kryer veprimet e pyetjes me personat e mësipërm nuk ishte bërë asnjë urdhër apo flet-thirrje për personat e shoqëruar jo vetëm nga prokurori, por as edhe nga Oficerët e Policisë Gjyqësore të cilëve u ishte deleguar kryerja e disa veprimeve hetimore. Sqarojmë se urdhri i prokurorisë të cilin e cituam më sipër, që sipas punonjësve të Policisë ka shërbyer si bazë për kryerjen e veprimeve të tyre në këtë rast, bënte fjalë për pyetjen e tyre dhe jo për shoqërim të detyrueshëm, sikurse ishte vepruar në fakt.

b) Me nenin 100 të ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, sipas të cilit *“punonjësi i Policisë duhet të bëjë njoftim për paraqitje (me fletnjoftim apo verbalisht) për të marrë informacion për të identifikuar shkelësit e mundshëm të ligjit”.*

c) Me nenet 11/6, 101 dhe 106 të ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, në të cilat parashikohet shoqërimi në Polici për shkaqe administrative i personave dhe rastet e shoqërimit. Rasti konkret për t’u pyetur nuk parashikohet në rastet e shoqërimit të personave në Polici.

2. Pyetja e shtetasit E. A., duke i kërkuar të dhëna në ngarkim të babait të tij, vjen në kundërshtim të hapur me nenin 158/a të K.Pr.Penale, sipas të cilit, *ai, si gjini (i paslindur i N. A.) përjashtohet nga detyrimi për të dëshmuar.* Sqarojmë se sipas Policisë, N. A. ishte person i dyshuar si autor i vrasjes së M. D. dhe për këtë arsye nuk mund të pyetej djali për babanë, aq më tepër që ai ka qenë 9 vjeç kur ka ndodhur ngjarja.

3. Megjithëse në fakt kishte 6 persona të shoqëruar në Polici, ishin regjistruar vetëm 3 prej tyre. Mosregjistrimi i 3 të tjerëve në librin e personave të shoqëruar përbën shkelje të nenit 103/1 të ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”.

4. Për rreth 4 orë, punonjësit e Policisë megjithëse kishin pyetur disa prej të shoqëruarve dhe ndonjërin prej tyre edhe disa herë, nuk kishin përpiluar asnjë procesverbal pyetje. Disa herë ju kërkuar të paraqisnin ato, por thoshin se “i kishin në kompjuter, se si kishin përfunduar” e justifikime të tjera të pa bazuara në ligj.

5. Futja dhe nxjerrja e të shoqëruarve disa herë në dhomat e shoqërimit, të cilat sikurse theksuam më lart ishin të mbyllura me hekura, përbën presion, dhunë psikologjike dhe cënim të lirisë së tyre. Këto veprime, të cilat vijnë në kundërshtim me parimet dhe rregullat e hetimit, ishin ushtruar me qëllim për të pranuar apo dëshmuar rreth autorësisë së vrasjes së shtetasit M. D.

6. Veprimet e punonjësve të Policisë Erzen Cera dhe Erdit Rreçeku duke e goditur me pëllëmbë shtetasin E. A., si dhe presioni i bërë atij për

të dëshmuar për autorin e vrasjes se përndryshe do të burgosej, vijnë në kundërshtim të plotë e të hapur me:

a) Nenin 25 të Kushtetutes tonë, i cili parashikon se: *“Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës”*.

b) Nenin 3 të Konventës Europiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të Njeriut, i cili parashikon se: *“Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, as dënimit ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese”*.

7. Gjithashtu veprimet e punonjësve të policisë të kryera ndaj personave të shoqëruar vijnë në kundërshtim të plotë dhe të hapur edhe me:

a) Nenin 1, pikën 2 të ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 *“Për Policinë e Shtetit”*, i cili parashikon se: *“Misioni i Policisë është të ruajë rendin dhe sigurinë publike, në përputhje me ligjin dhe duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut”*.

b) Nenin 4, pikën 1, germa “b” të ligjit *“Për Policinë e Shtetit”*, i cili parashikon si përgjegjësi të Policisë, *“të parandalojë, të zbulojë dhe hetojë, në përputhje me ligjin penal dhe me ligjin procedural, veprat penale dhe autorët e kryerjes së tyre”*.

Në përfundim të hetimit të këtij rasti arritëm në konkluzionin se, veprimet e kryera nga punonjësit e Policisë Erzen Cera dhe Erdit Rreçeku ndaj shtetasit E. A. vinin në kundërshtim të hapur e të plotë jo vetëm me aktet normative ligjore të sipërpërmendura, por në të njëjtën kohë përmbanin edhe elementët e figurës së veprës penale të *“Torturës”*, parashikuar nga neni 86/25 i Kodit Penal, i ndryshuar me ligjin nr. 9686 datë 26.02.2007, sipas të cilit:

*“Kryerja me dashje e veprave, nëpërmjet të cilave një personi i janë shkaktuar vuajtje të rënda, fizike apo mendore, nga një person, që ushtron funksione publike, ose me nxitjen apo miratimin e tij, të hapur ose të heshtur, me qellim:*

*a) për të marrë prej tij ose një tjetri informata ose pohime;*

*b) për ta ndëshkuar për një veprim të kryer ose që dyshohet të jetë kryer prej/ose një personi tjetër;*

*c) për ta frikësuar ose bërë presion mbi të ose një person tjetër;*

*ç) për çdo qëllim tjetër të bazuar në çfarëdolloj forme diskriminimi;*

*d) çdo akt tjetër çnjerëzor apo poshtëruës;*

*përbëjnë veprë penale dhe dënohen me burgim nga katër deri në dhjetë vjet.”*

Gjithashtu konstatoam se, me veprimet e kryera ndaj shtetasve N. A., E. A., T. A., M. K., Z. Z. dhe M. M. në formën e shoqërimit të tyre në polici në orët e para të mëngjesit dhe pa ju dërguar më parë fletë thirrje, fletnjoftimi apo njoftim verbal sikurse parashikojnë dispozitat ligjore;

mbajtjes në dhomat e shoqërimit të mbyllura me dyer hekuri e dryna, duke i cënuar rëndë lirinë atyre; mos regjistrimit të 3 prej personave në librin e personave të shoqëruar; pyetjes së shtetasit E. A. për t'i marrë informata në ngarkim të babait të tij, punonjësit e Policisë Erzen Cera dhe Erdit Rreçeku kishin konsumuar edhe elementët e figurës së veprës penale të *“Kryerjes së veprimeve arbitrare”*, parashikuar nga neni 250 i K.Penal, cili parashikon se: *“Kryerja e veprimeve ose dhënia e urdhrave arbitrare nga ana e punonjësit që kryen një funksion shtetëror ose një shërbim publik gjatë ushtrimit të detyrës së tij, të cilat prekin lirinë e shtetasve, dënohet me gjobe ose me burgim gjer në shtatë vjet”*.

Veprimet e kundërligjshme punonjësit e Policisë i kishin kryer në bashkëpunim për shkak dhe gjatë ushtrimit të detyrës dhe funksionit të tyre shtetërore, njëri si Shef Sektori Kundër Krimeve të Rënda dhe tjetri Specialist për Hetimin e Krimeve në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Shkodër.

Për këto arsye dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 21/ç, të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”* dhe në vijim të përmbushjes së detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 9094 dt. 03.07.2003 *“Për Ratifikimin e Protokollit Opsional të Konventës kundër Torturës dhe Ndëshkimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT)”*, i rekomandua Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër fillimin e hetimit në ngarkim të punonjësve të Policisë Erzen Cera dhe Erdit Rreçeku, efektiv të Drejtorisë së Policisë të Qarkut Shkodër, për veprat penale të *“Torturës”* dhe të *“Kryerjes së veprimeve arbitrare”*, të kryera në bashkëpunim, parashikuar respektivisht nga nenet 86 e 25 dhe 250 e 25 të Kodit Penal.

Njëkohësisht i rekomandua që t'i kërkonte Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër zbatimin e masës ndaluese *“pezullimi i ushtrimit të një detyre”*, ndaj punonjësve të Policisë Erzen Cera dhe Erdit Rreçeku, parashikuar nga neni 240/1/a e vijues të K.Pr.Penale.

Ndërsa për Zëvendësdrejtorin e Policisë së Qarkut Shkodër Artan Hasani, i rekomandua Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit që t'i jepte masë disiplinore për mosmarrje të masave të nevojshme për parandalimin e shkeljeve të ligjit nga varësit e tij. Rekomandimet janë në shqyrtim dhe nuk na janë kthyer përgjigjet e tyre.

Por në lidhje me këtë rast përmendim se Drejtoria e Policisë së Qarkut Shkodër, e mbështetur nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit më datën 22.11.2008 ndërmoi aktin e paprecedent të kallzimit në prokurorinë e rrethit të Shkodrës të Avokatit të Popullit dhe ndihmësave të tij, me akuzën e *“prishjes së hetimeve, ndërhyrjes së paligjshme në veprimtarinë procedurale të policisë gjyqësore”* etj. Ky akt i policisë pati reagim të ashpër dhe u dënua me forcë si presion i hapur ndaj Avokatit të Popullit nga disa organizma ndërkombëtare të rëndësishme siç është

Amnesty International, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Komiteti Shqiptar i Helsinkit etj. “Avokati i Popullit është një institucion i pazevendesueshem dhe ne e mbeshtesim fort, sikunder denojme fort çdo akt dhune. Padija kundër Avokatit të Popullit është një gabim i rëndë. E vleresojmë punën e policisë, por herë pas herë behen gabime dhe ajo duhet kontrolluar. Shqipëria tashmë i ka këto mekanizma, sikunder është Avokati i Popullit, të cilit i uroj të vazhdojë punën e mirë jo vetëm në emër të OSBE-se, por edhe të Këshillit të Evropës”, tha para gazetarëve, pas takimit me Avokatin e Popullit më datën 27.11.2008 Ambasadori Bosch, Kryetari i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

Avokati i Popullit, nga ana e tij shprehu gadishmerinë për vazhdimin e bashkëpunimit të frutshëm me strukturat e Policisë së Shtetit, duke kërkuar njëkohësisht edhe shprehjen e qendrimit të qartë prej tyre lidhur me kallezimin penal që Policia e Shkodrës depozitoi në Prokurori kundër Avokatit të Popullit.

“Kjo padi është pa asnjë shans, por unë kërkoj denimin e këtij veprimi, i cili në rast se do të kthehej në precedent, do të dekurajonte mjaft ekspertet e Avokatit të Popullit në ushtrim të detyrave të tyre funksionale për të inspektuar dhe kontrolluar komisarjatet e policisë, dhomat e shoqërimit dhe të ndalimit si dhe burgjet, ku të drejtat e njeriut eventualisht shkelen rëndom”, tha Avokati i Popullit gjatë takimit me Ambasadorin Bosch.

Avokati i Popullit kërkoj me këto rast që ky incident të mos instrumentalizohet politikisht nga cilado forcë politike si dhe vlerësoj qendrimin publik të Organizatës Amnesty International dhe të medias shqiptare për sensibilizimin që ka krijuar lidhur me ndeshkimin e rasteve të dhunës në përgjithësi, por edhe për rastin e fundit në veçanti.

Në deklaratën e tij Ministri i Brendshëm vlerësoj bashkëpunimin e Avokatit të Popullit por nuk e dënoi veprimin e Policisë së Shkodrës. Një qendrim të njëjtë mbajti edhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në deklaratën e saj për shtyp, të publikuar po më datën 27.11.2008. Por mjaft pozitiv është fakti se këtë veprim të policisë e dënoi Kryeministri Berisha si në takimin e zhvilluar me Avokatin e Popullit më datën 04.12.2008 ashtu dhe në Analizën vjetore të Policisë së Shtetit më datën 25.12.2008. Kurse kohët e fundit jemi njoftuar se Prokuroria e rrethit të Shkodrës e ka refuzuar si të pabazuar në ligj kallzimin (padinë) kundër Avokatit të Popullit.

3. Në një rast një punonjës i institucionit tonë është bërë dëshmitar okular i një ngjarje të shëmtuar ndodhur në ambjentet e Komisarjatit të Policisë Nr. 1 Tiranë. Rreth orës 15.45, në datën 24.09.2008 një makinë e Policisë solli në oborrin e komisarjatit një qytetar të prangosur. Pasi e zbritën nga makina e Policisë i shoqëruar nga dy policë, qytetari ra për e

dhunës fizike barbare të një punonjësi tjetër policie, i cili e goditi disa herë me shkop gome në pjesë të ndryshme të trupit. Në rastin konkret dhe në momentin e dhunimit, shtetasi i shoqëruar nuk po bënte asnjë lloj rezistence ndaj punonjësve të Policisë. Në këto kushte nuk ishte e nevojshme asnjë lloj përdorimi të forcës nga punonjësi i Policisë dhe as ushtrimi i dhunës ndaj tij. Shqetësues në këtë ngjarje ishte edhe fakti, se megjithëse në momentin e keqtrajtimit fizik të qytetarit ishin prezent shumë punonjës të Policisë në oborrin e Komisarariatit të Policisë Nr. 1, por asnjëri prej tyre nuk ndërhyri për të parandaluar sjelljen brutale, çnjerëzore e të kundërligjshme të kolegut të tyre.

Në kushte të tilla filluam hetimin për identifikimin e autorit të kësaj ngjarjeje.

Punonjësit tanë në bashkëpunim me Shefin e Komisarariatit, identifikuan autorin e dhunës, i cili ishte punonjësi i Policisë Ulian Shpataraku, efektiv i Komisarariatit të Policisë Nr. 1 Tiranë, me detyrë patrullë e përgjithshme. Ai u thirr nga ana jonë dhe u pyet rreth kësaj ngjarjeje. Gjatë pyetjes ai pranoi se e kishte goditur të shoqëruarin për shkak të irritimit si pasojë e kundërshtimit të dhunshëm dhe fyerjes që shtetasi i shoqëruar N. Ll. ju kishte bërë punonjësve të Policisë në momentin që ata ndërhyjnë për ndërprerjen e konfliktit që ai kishte patur me disa persona të tjerë. Ndërkohë, nga ana jonë u identifikuan edhe dy punonjësit tjerë të Policisë, Gjergji Ylli dhe Neritan Qeraxhi të cilët kishin bërë shoqërimin e shtetasit N. Ll.. Theksojmë se qëndrimi i tyre jo korrekt u demonstrua jo vetëm me indiferencën në momentin e keqtrajtimit të të shoqëruarit prej tyre, por edhe gjatë pyetjes nga ana jonë. Ata në mënyrë të papërgjegjshme mohuan keqtrajtimin e bërë këtij shtetasi nga kolegu i tyre.

Veprimet e dhunshme të punonjësit të Policisë Ulian Shpataraku ndaj shtetasit të shoqëruar N. Ll. janë në kundërshtim me misionin ligjor të Policisë së Shtetit dhe detyrën e punonjësit të Policisë. Ato janë të kundërligjshme dhe vijnë në kundërshtim të hapur me aktet normative të mëposhtme:

1. Nenin 25 të Kushtetutës tonë, i cili parashikon se: *“Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues”*.

2. Me nenin 3 të Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të Njeriut, i cili parashikon se: *“Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, as dënimit ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese”*.

3. Nenin 1, pikën 2 të ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 *“Për Policinë e Shtetit”*, i cili parashikon se: *“Misioni i Policisë është të ruajë rendin dhe sigurinë publike, në përputhje me ligjin dhe duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut”*.

Ndërsa qëndrimet indiferente të punonjësve të Policisë Gjergji Ylli dhe Neritan Qeraxhi, duke mosndaluar veprimet e kundërligjshme të kolegut të tyre dhe mosraportimin e shkeljes së kryer prej tij tek eprorët, vijnë në kundërshtim të plotë dhe të hapur me nenin 72 të ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, i cili parashikon se: *“Punonjësi i Policisë i raporton eprorit përkatës ose, në mungesë të tij, eprorit të eprorit, çdo shkelje për të cilën ai ka dyshime të mjaftueshme të besojë se është kryer nga një punonjës tjetër i Policisë, pavarësisht nëse ai ka marrë dijeni për këtë shkelje gjatë kryerjes së detyrës ose në rrethana të tjera”*.

Ne gjykojmë se qëndrimi i këtyre dy policëve që jo vetëm nuk parandaluan dhe raportuan ngjarjen, por në veçanti gënjeshtrore e tyre gjatë pyetjes në institucionin tonë është një fenomen mjaft i dëmshëm dhe që duhej ndëshkuar rëndë, mbase më tepër se sa autori i dhunës. Qëndrimi i tyre është rrjedhojë e një mentaliteti të vjetër e që vazhdon të jetë i pranishëm në radhët e efektivave të Policisë së Shtetit.

Sikurse përshkruam dhe argumentuam më sipër, këto veprime të punonjësve të Policisë të cituar më sipër përbëjnë shkelje të rëndë të të drejtave kushtetuese e ligjore të shtetasit N. Ll.. Ndërkohë ato krijojnë premisa për humbjen e besimit publik ndaj Policisë dhe për uljen e imazhit të saj para opinionit publik.

Gjithashtu gjatë shqyrtimit të këtij rasti konstatojmë se, nga punonjësit e Policisë dhe eprorët e tyre kishte mangësi të theksuara të njohjes së akteve normative të brendshme dhe ndërkombëtare të cilat bëjnë fjalë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Po kështu konstatojmë se nga efektivat e Policisë kishte mungesë informacioni për Institucionin e Avokatit të Popullit, për misionin kushtetues, detyrat dhe të drejtat ligjore të tij.

Megjithëse kjo ngjarje ishte shumë e rëndë dhe përmbante elementë të veprës penale, nga ana jonë në trajtimin e këtij rasti u mbajt parasysh edhe qëndrimi reagues i punonjësit të Policisë Ulian Shpataraku, pranimi i shkeljes ligjore, pendimi i thellë që ai demostroi, moshja e re dhe eksperiencia e vogël në Polici të tij, e cila ishte rreth një vjeçare. Ndërkohë vlerësuam edhe qëndrimin pozitiv të Shefit të Komisarariatit të Policisë Nr. 1 Tiranë z. Nikoll Vatnikaj për të goditur e ndëshkuar këto fenomene negative në radhët e efektivit që ai drejton.

Për sa më sipër dhe për të parandaluar shkelje të tilla në të ardhmen, i rekomandojmë drejtuesit të këtij komisariati t’i jepte masa disiplinore punonjësit të Policisë Ulian Shpataraku si autor i drejtpërdrejtë i ushtrimit të dhunës si dhe ndaj punonjësve të Policisë Gjergji Ylli e Neritan Qeraxhi të cilët qëndruan indiferentë ndaj veprimeve të kundërligjshme të kolegut të tyre, si dhe për mosraportim të shkeljes tek eprorët.

Rekomandimi u mirëprit dhe të tre punonjësit e Policisë të cituar më sipër dhe komandanti i tyre Sherif Quku u ndëshkuan me masa disiplinore.

## **II. Ankesat për veprime të tjera të paligjshme apo të parregullta nga Policia**

Kanë qenë 118 ankesa për veprime arbitrare të punonjësve të Policisë, nga të cilat 1 për kontroll të paligjshëm banese; 21 për arrestime, ndalime dhe për shoqërime të paligjshme në Polici; 30 veprime të tjera arbitrare; 24 për mosevidencim apo mos ndjekje të kallëzimeve apo të ankesave; 4 për mospajisje me pasaporta; 8 për gjoha administrative të padrejta nga Policia Rrugore dhe 30 për veprime të tjera të kundërligjshme apo të parregullta, si për sende të sekuestruara apo bllokuara nga Policia; për mosdhënie dokumentash të ndryshme etj. Nga 118 ankesat e regjistruara në këtë rubrikë, 39 prej tyre janë konsideruar të drejta. Si raste të zgjidhjes pozitive mund të përmëndim:

1. Rasti i konstatuar më dt. 07.03.2008, gjatë inspektimit në dhomat e sigurimit të Komisarariatit të Policisë Nr. 3 Tiranë. Gjatë këtij inspektimi u konstatua se, në këto dhoma mbahej së bashku me të arrestuarit e rritur edhe shtetasi i mitur M. V., i datëlindjes 04.09.1990, banor i qytetit Tiranë. Gjatë pyetjes së tij rezultoi, se ai më dt. 06.03.2008, ishte kapur në flagrancë duke i vjedhur një sasi kablli elektrik. Pas kapjes në flagrancë nga i dëmtuari ai është shoqëruar në Polici, fillimisht në Komisariatin e Policisë Nr. 2 Tiranë dhe më pas në Komisariatin e Policisë Nr. 3 Tiranë. Në këtë komisarariat ai është marrë në pyetje dhe arrestuar në orën 22.00 nga Oficeri i Policisë Gjyqësore Grigor Prifti, efektiv i Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë. Gjithashtu u konstatua, se veprimet proceduriale të pyetjes dhe arrestimit të tij ishin bërë në kundërshtim me ligjin, K.Pr.Penale sepse ishin bërë pa prezencën e mbrojtësit dhe të punonjësit social apo prindërve të tij, duke mos i dhënë atij ndihmën e detyrueshme juridike dhe psikologjike, sepse ishte i mitur.

Nga ana jonë u pyet edhe Oficeri i Policisë Gjyqësore, Grigor Prifti. Ai shpjegoi se këto veprime në kundërshtim me ligjin, me të arrestuarin M. V., i kishte kryer për shkak se nuk kishte mundur të gjente avokat dhe psikolog në orët e vona të natës. Ndërsa prindërit e tij nuk kishin shkuar në Polici për arsye se i ati nuk ishte gjetur në shtëpi, ndërsa e ëma e të arrestuarit kishte qenë e sëmurë.

Pavarësisht “përpjekjeve” të punonjësit të Policisë për gjetjen e mbrojtësit dhe të prindërve të tij, në fund të fundit ai, veprimet proceduriale i kishte kryer pa prezencën e tyre. Ne gjykuam se në këtë rast, veprimet e tij janë kryer në kundërshtim të plotë dhe të hapur me

dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të K.Pr.Penale, të ligjit “Për Policinë e Shtetit”.

Këto veprime të Oficerit të Policisë Gjyqësore Grigor Prifti përbëjnë shkelje të rënda ligjore të të drejtave të të pandehurit të mitur M. V.. Mirëpo, nga ana jonë në disa raste është konstatuar se shkelje të tilla vijnë jo vetëm për mosnjohje të akteve normative apo të pakujdesisë nga punonjësit e Policisë Gjyqësore, por edhe për shkak të mungesës së organizimit të punës e të bashkëpunimit të drejtuesve të Policisë me Dhomën e Avokatëve dhe Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor. Gjithashtu, gjatë shqyrtimit të ankesave të të pandehurve të mitur, lidhur me mungesën e sigurimit të mbrojtjes dhe të psikologut gjatë kryerjes së veprimeve procedurale të pyetjes dhe arrestimit në flagrancë, konstatojmë që organi i prokurorisë nuk e ka kryer si duhet funksionin e tij ligjor, të kontrollit të hetimeve paraprake dhe se ka qëndruar indiferent ndaj shkeljeve të tilla të dispozitave të K.Pr.Penale nga Oficerët e Policisë Gjyqësore, të cilat sjellin pasoja juridike të pavlefshmërisë së akteve”.

Për sa më sipër dhe për të parandaluar shkelje të tilla në të ardhmen, i rekomanduam Drejtorit të Policisë së Qarkut Tiranë dhe Prokurorit të Rrethit Gjyqësor Tiranë që t’i jepnin masë disiplinore Oficerit të Policisë Gjyqësore Grigor Prifti dhe atë t’ia komunikonin në prani të efektivit. Të organizonin më mirë punën me Dhomën e Avokatëve dhe me OJF-të që kanë si objekt të veprimtarisë së tyre “mbrojtjen e të drejtave të të miturve”, me qëllim për të siguruar ndihmën juridike dhe psikologjike në të gjitha rastet e kryerjes nga Oficerët e Policisë Gjyqësore të veprimeve procedurale për të cilat prania e tyre është e detyrueshme. Të ushtronin në mënyrë të vazhdueshme kontroll ndaj akteve procedurale të përpiluara nga Oficerët e Policisë Gjyqësore me të pandehurit e mitur lidhur me respektimin e të drejtave dhe detyrimeve ligjore për ndihmën juridike dhe psikologjike. Gjithashtu në këtë rast rekomanduam që të arrestuarit e mitur të ndahen nga të arrestuarit madhor dhe të mbahen në dhoma më vete.

2. Ankesa e bërë nga familjarët e shtetasve S. D. etj, ndaj Komisarariatit të Policisë Vlorë. Sipas ankuesve, më datën 31.03.2007, rreth orës 21.00 shtetasit S. D. etj, ishin shoqëruar dhe mbaheshin padrejtësisht nga Komisarati i Policisë Vlorë dhe se atyre nuk ju jepej informacion megjithëse kishin kaluar disa orë nga afati maksimal i shoqërimit të tyre në Polici. Gjithashtu sipas tyre, Policia gjatë shoqërimit kishte përdorur dhunë duke i keqtrajtuar ata.

Për verifikimin e pretendimeve të ankuesve, shkoi në Vlorë një ekip të institucionit tonë. Punonjësit tanë pasi u takuan me ankuesit, shkuan në dhomat e izolimit të Komisarariatit të Policisë Vlorë dhe morën takim me personat për të cilët bënte fjalë ankesa.



Për sa më sipër, nga nd/komisionerët e Avokatit të Popullit që hetuan këtë ankesë u konstatua se:

1. Kushtet e jetesës në dhomat e izolimit të Komisarariatit të Policisë Vlorë ishin shumë të këqija dhe jashtë çdo standardi. Kapaciteti i tyre ishte i vogël dhe se në to nuk mund të mbaheshin 18 persona, siç ndodhi ditën kur u bë inspektimi. Po kështu edhe dhomat e shoqërimit të shtetasve në Polici ishin në të njëjtin ambient, pa kushtet minimale higjeno-sanitare dhe të qëndrimit, pa stola, me dritare të vogla (frëngji), me dyer hekuri dhe të mbyllura me dryna. Për të shkuar në dhomat e shoqërimit duhej që të kaloje më parë tre porta hekuri të mbyllura me dryna.

2. Dy procesverbale të arrestimit në flagrancë të përpiluara nga Oficeri i Policisë Gjyqësore Elidon Imeraj dhe konkretisht të arrestimit të shtetasve B. L. dhe V. L. nuk kishin të shënuar orën e arrestimit të tyre. Theksojmë se në bazë të neneve 144, 250 të K.Pr.Penale, shënimi në procesverbal i çastit (orës) së arrestimit në flagrancë është një element i rëndësishëm mbi bazën e të cilit fillojnë të llogariten efektet e paraburgimit. Ndërsa në bazë të nenit 258 të K.Pr.Penale, nga çasti (ora) e arrestimit ose ndalimit fillon afati i 48-të orëve, brenda të cilës prokurori kërkon vleftësimin e masës së sigurimit në gjykatën e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimit.

3. Shefi i Komisarariatit të Policisë Vlorë, Asllan Shyti, në kundërshtim të plotë dhe të hapur me dispozitat e Kushtetutës, të K.Pr.Penale dhe ligjit nr. 9109, datë 17.07.2003, “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë”, nuk ka lejuar që avokati i të arrestuarit B. L., Petraq Çurri, të merrte takim me klientin e tij pas arrestimit. Ai i ka kërkuar atij prokurorë nga familjarët, ndërkohë që i arrestuari ishte madhor, me zotësi të plotë për të vepruar dhe se avokatin ja kishte kërkuar vet drejtpërdrejtë punonjësit të Policisë Gjyqësore që kishte bërë arrestimit e tij. Me këtë veprim, Shefi i Komisarariatit kishte demonstruar mangësi të theksuara juridike dhe profesionale.

Moslejimi i avokatit për të qënë i pranishëm gjatë ndalimit, arrestimit, hetimit apo gjykimit të personit, si dhe për të marrë takim me personin të cilit i është hequr liria, kur ai kërkohet nga vetë personi i ndaluar ose arrestuar, përbën një shkelje të rëndë kushtetuese dhe ligjore.

Për sa më sipër dhe për të parandaluar shkelje të tilla në të ardhmen, i rekomandua Drejtorit të Policisë së Qarkut Vlorë që të jepte masa disiplinore ndaj Shefit të Komisarariatit të Policisë Vlorë Asllan Shyti dhe Oficerit të Policisë Gjyqësore Elidon Imeraj, si dhe t’i komunikonte ato në prani të efektivit. Gjithashtu rekomandua që të merreshin masa të menjëhershme dhe të kërkoheshin fonde financiare në organet e prore për të përmirësuar kushtet e jetesës në dhomat e sigurimit dhe të shoqërimit të

shtetasve në Komisarlatin e Policisë Vlorë. Rekomandimi u mirëprit dhe u pranua.

3. Rasti i filluar me inisiativë pas publikimit në media të disa shqetësimeve të qytetarëve të ndryshëm ndaj Komisarlatit të Policisë Rrugore Tiranë dhe Seksioneve të Policisë Rrugore në rrethe të ndryshme të vendit. Në media ngrihej shqetësimi lidhur me, radhët e gjata në sportele për të paguar gjobat dhe indiferenca e punonjësve të policisë për t'u shërbyer qytetarëve, vendosja e gjobave në mungesë dhe të padrejta nga policët rrugorë ndaj qytetarëve, bllokimi i dokumenteve drejtuesve të mjeteve për shkak të mospagimit të gjobave të vendosura atyre.

Për të zgjidhur shqetësimet e konstatuara më sipër, i rekomandua Drejtorit të Drejtorisë së Qarkullimit Rrugorë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit që të merrte masa të menjëhershme organizative për zbatimin nga organet e Policisë Rrugore të detyrimeve që rrjedhin nga neni 199 i K.Rrugor, lidhur me njoftimin e shkeljeve kundërvajtësve në mungesë, ndërprerjen e menjëhershme të veprimeve arbitrare të punonjësve të Policisë Rrugore që kanë të bëjnë me bllokimin e dokumentacionit të mjetit për drejtuesit të cilët nuk kanë paguar gjobën administrative si dhe zbatimin ndaj tyre të të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga neni 203 i K.Rrugor lidhur me vjeljen e gjobave. Gjithashtu rekomandua bashkëpunim më të mirë të Policisë me Postën Shqiptare, duke rishikuar marrëveshjen e lidhur për këtë qëllim, për rakordimin e shpejtë ndërmjet Policisë dhe Postës lidhur me pagimin e gjobave. Në këtë kuadër sugjerua të shihej mundësia e ngritjes së një sistemi kompjuterik të përbashkët, i cili do të shkurtonte kohën e rakordimit. Ndërkohë të kërkohet prej Postës që vjelja e gjobave të prapambetura të bëhet jo vetëm në një zyrë të vetme, por edhe në zyrat e tjera të saj. Rekomandimi u mirëprit dhe u pranua.

4. Ankesa e shtetasës V. S. me banim në Pogradec, e cila na shkruante se, është me arsim të lartë dhe ka qënë e martuar me shtetasin N. E.. Ata e kishin zgjidhur martesën midis tyre. Pas zgjidhjes së martesës, ish burri e keqtrajtonte dhe kërcënonte atë në mënyrë të vazhdueshme me qëllim që ajo të largohej nga banesa që ishte pronë e përbashkët e tyre. Një nga rastet e përdorimit të dhunës fizike ndaj saj, ankuesja përshkruante atë të dt. 04.07.2008, ku ish burri i saj e kishte goditur barbarisht me grushte e shqelma duke i lënë shenja të dukshme në trup, që vërtetoheshin nga disa fotografitë e bëra pas dhunimit, të cilat ajo na i kishte dërguar së bashku me ankesën, si dhe nga Akt Dëshmia Mjekoligjore. Gjithashtu atë ditë, ish burri i saj, e kishte kërcënuar atë se do ta vriste dhe më pas do të vriste edhe veten. Për këtë rast ankuesja kishte shkuar dhe bërë kallëzim në Komisarlatin e Policisë Pogradec, *mirëpo ajo pretendonte se kallëzimi i saj nuk ishte pranuar nga*

*punonjësit e Policisë me pretendimin, se ajo nuk kishte dëshmitarë. Ankuesja i ishte përgjigjur punonjësve të Policisë, se nuk kishte ku t'i gjente dëshmitarët në mes të natës në shtëpinë e saj, por këtë fakt e provonin shenjat e dhunës në trupin e saj, të cilat ajo ua kishte treguar.*

Sikurse provohet nga shqyrtimi i këtij rasti, nga punonjësit e Policisë të Komisarariatit Pogradec dhe të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Korçë, të cilët janë vënë në dijeni të përdorimit të dhunës në familje, nuk është ndjekur rasti i ankueses për dhunimin e saj nga ish bashkëshorti, nuk është mbajtur raport për të regjistruar konstatimet e dhunës, si dhe nuk janë filluar hetimet kryesisht. Nga punonjësit e Policisë nuk i është kërkuar gjykatës lëshimi i urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes. Gjithashtu, ata nuk e kanë informuar ankuesen (viktimën) për të drejtat ligjore të saj për të kërkuar mbrojtje dhe për institucionet të cilave ajo duhet t'i drejtohet sipas ligjit të cituar më sipër.

Për sa më sipër dhe për të parandaluar shkelje të tilla në të ardhmen, i rekomandua Drejtorit të Policisë së Qarkut Korçë që të bënte verifikimet e nevojshme lidhur me këtë rast, ta analizonte atë me objektivitet e korrektësi dhe në përfundim, ndaj punonjësve të Policisë të cilët nuk kanë zbatuar detyrimet ligjore të parashikuara nga ligji nr. 9669, dt. 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” të jepte masa disiplinore. Si bazë ligjore për dhënien e masave disiplinore do të shërbente neni 8, pika 5 e këtij ligji, ku thuhet se: *“Personat të cilët marrin dijeni për shkak të detyrës apo autoritetit të ngarkuar për zbatimin e këtij ligji dhe nuk veprojnë në zbatim të tij, ngarkohen me përgjegjësi administrative dhe/ose penale, duke zbatuar sanksione të përcaktuara në nenet 248 dhe 251 të K.Penal”*. Që të merrte masat e nevojshme duke ngarkuar me detyra konkrete Seksionin për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës në Familje, pranë Drejtorisë së Policisë të Qarkut Korçë, me qëllim ndjekjen ligjore të rastit të denoncuar nga ankuesja. Gjithashtu i rekomandua që të merrte masat e nevojshme për njohjen e efektivitetit të Policisë me ligjin nr. 9669, dt. 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, me qëllim parandalimin e shkeljeve të tilla në të ardhmen.

Rekomandimi u mirëprit dhe ndaj punonjësit të Policisë Andir Shuli, me detyrë Specialist për Hetimin e Krimeve të Lehta u dha masa disiplinore “Shtyrje të afatit të gradimit për një vit”, ndërsa ndaj punonjësit të Policisë Miklovan Kararaj, me detyrë Specialist në Seksionin për Krimet e Rënda u dha masa disiplinore “Shtyrje e afatit të gradimit për 6 muaj”. Gjithashtu në zbatim të rekomandimit tonë, ju dërgua Komisariateve të Policisë Korçë, Pogradec, Devoll dhe Kolonjë materiali lidhur me mbrojtjen nga dhuna në familje, i cili u punua me efektivat e Policisë.

5. Rasti i bërë publik në “Gazetën Shqiptare” të datës 18.12.2008, e cila kishte botuar artikullin me titull “*Polici, dhunë sanitares dhe Shefes së Shërbimit te Pediatria*”. Sipas artikullshkruesit rezultonte se, më datën 11.12.2008, një punonjës Policie kishte shkuar në zyrën e Shefes së Shërbimit në Spitalin Pediatrik në Tiranë dhe e kishte kanosur e fyer atë për shkak të detyrës, sepse ajo nuk i kishte vizituar fëmijën e tij. Gjithashtu rezultonte se, punonjësi i Policisë kishte përdorur dhunë ndaj një sanitareje që ishte me shërbim te dera e pavijonit, duke e përplasur atë në tokë. Më tej përshkruhej se, punonjëset e mjekësisë kishin njoftuar Komisarjatin e Policisë Nr. 4 Tiranë dhe kishin kërkuar të bënin kallzim për ngjarjen e ndodhur, por ato ishin sorollatur dhe kallzimi nuk i ishte marrë, etj.

Duke mbajtur parasysh dhunën e ushtruar ndaj disa mjekëve kohët e fundit, këtë rast i cili bënte fjalë jo vetëm për veprime të dhunshme ndaj punonjësve të mjekësisë, por për më tepër që autor i dhunës ishte një punonjës Policie, që me ligj është i detyruar që të mbrojë jetën dhe të drejtat e qytetarëve, e vlerësuam si tepër serioz.

Në përfundim të shqyrtimit të këtij rasti arritëm në konkluzionin se:

I. Punonjësi i Policisë Adem Tahiri, efektiv i strukturave qëndrore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me sjelljen dhe veprimet e kryera ndaj punonjësve të mjekësisë ka konsumuar elementët e figurave të tre veprave penale, të parashikuara respektivisht nga nenet 238 “Kanosja për shkak të detyrës”, 239 “Fyerja për shkak të detyrës” dhe 90 “Dëmtime të tjera me dashje”, të Kodit Penal.

Sjellja e tij në këtë rast vjen në kundërshtim edhe me VKM-në nr. 786, datë 04.06.2008 “Për miratimin e Rregullores së Disiplinës së Policisë së Shtetit”.

Duke patur parasysh rrethanat e kryerjes së këtyre veprimeve dhe gjendjen psikologjike të tij në ato momente për shkak të fëmijës së sëmurë, si dhe kërkesat e ankuesëve që, për arsye personale e familjare kërkuan që ai të ndëshkohet administrativisht dhe jo penalisht. Për këtë punonjës Policie i kemi rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhënien e masës disiplinore. Deri tani nuk është kthyer përgjigje.

II. Punonjësi i Policisë Agron Breçani nuk ka marrë masat e nevojshme për marrjen e kallzimit, shoqërimin e autorit në Polici (pavarësisht se ai ishte punonjës Policie) dhe kryerjen e veprimeve të tjera procedurale, megjithëse rasti ishte në kushtet e flagrancës. Gjithashtu ai nuk ka zbatuar as detyrimin për të njoftuar eprorët e tij dhe SHKB-në, për përfshirjen në vepër penale të punonjësit të Policisë Adem Tahiri.

Për këtë punonjës Policie i rekomandua Drejtorit të Policisë së Qarkut Tiranë dhënien e masës disiplinore. Rekomandimi u mirëprit dhe atij ju dha masa disiplinore “vërejtje me paralajmërim”.

Ne gjykojmë se, sjellja e punonjësve të veçantë të Policisë në këtë mënyrë me qytetarët, duke i kërcënuar e fyer apo duke mos i mbajtur kallëzim dhe përcjellë ata nga një organ në tjetrin nuk është korrekte dhe e moralshme për organet e Policisë. Organet e Policisë janë të obliguara ligjërisht që me punën dhe sjelljen e tyre t'u ofrojnë qytetarëve shërbim profesional, të paanshëm, me etikë dhe të shpejtë, me qëllim që jo vetëm t'u mbrojnë e respektojnë të drejtat kushtetuese e ligjore atyre, por t'i bëjë ata edhe më bashkëpunues me Policinë në realizimin e misionit të saj ligjor për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike. Sjelljet sorollatëse të qytetarëve duke i çuar nga një organ Policie në tjetrin, zvarritëse e neglizhuese për të evidentuar e ndjekur kallëzimet apo ankesat e tyre, përveç uljes së imazhit të Policisë së Shtetit, sjellin edhe humbjen e besimit publik tek ky organ.

III. Punonjësi i SHKB-së, Edmond Ibraliu, megjithëse ka marrë dijëni për kryerjen e veprave penale nga një punonjës i Policisë së Shtetit, pavarësisht se ngjarja nuk kishte ndodhur në sektorin që ai mbulon dhe faktit, që sikurse ai shpjegoi verbalisht se nuk ndodhej në Tiranë atë ditë, nuk ka vënë në dijëni jo vetëm eprorin e tij të drejtpërdrejtë, por as edhe sektorin e SHKB-së që mbulon efektivin e Drejtorive Qendrore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Ndërkohë theksojmë, se ai refuzoi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit dhe nuk dha shpjegime me shkrim. Këto qëndrime të tij vijnë në kundërshtim me dispozitat e akteve ligjore.

Për sa më sipër dhe për të parandaluar qëndrime dhe sjellje të tilla të punonjësve të SHKB-së në të ardhmen, i rekomandua Drejtorit të Përgjithshëm të SHKB-së që t'i jepte masë disiplinore punonjësit të SHKB-së Edmond Ibraliu, efektiv i Sektorit të SHKB-së në Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë. Të analizonte këtë rast dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit të nxirrnin akte nënligjore për rregullimin e veprimtarisë së shërbimeve respektive në rastet kur kallëzohen punonjës Policie, pavarësisht se ato nuk bëhen në organin apo sektorin përkatës për ndjekjen e tyre, me qëllim evidentimin e plotë të kallëzimeve dhe ankesave të shtetasve, si dhe ndjekjen e tyre. Gjithashtu rekomandua që masat që do të merreshin në zbatim të rekomandimeve tona të përgjithësohen në efektivat e Policisë së Shtetit dhe të SHKB-së, me qëllim që të mos përsëriten raste të ngjashme në të ardhmen. Rekomandimi u mirëprit dhe atij ju dha masa disiplinore "vërejtje".

### **III. Ankesat ndaj Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit, për mos respektimin e të drejtave të punonjësve të tyre**

Në Institucionin tonë gjatë vitit 2008 janë bërë 14 ankesa nga punonjës Policie dhe punonjës të tjerë të strukturave mbështetëse të Ministrisë së Brendshme për largime të padrejta nga puna, mosdhënie të dokumenteve dhe për shkelje të të drejtave të tjera ligjore nga eprorët e tyre. Kemi trajtuar edhe ankesa të tilla që bënin fjalë për shkelje të të drejtave ligjore ekonomike e financiare të qindra policëve. Sipas tyre, motivacioni dhe shkaqet ligjore të largimit nga puna nuk kanë qenë të bazuara dhe shpesh herë fiktive, si dhe nuk janë zbatuar kriteret ligjore dhe profesionale.

Ankesat e punonjësve të Policisë i kemi vlerësuar me prioritet dhe përkushtim. Gjykimi ynë është se, nëse nuk do të kujdesemi për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të punonjësve të Policisë, nuk mund të kemi të drejtë morale që të kërkojmë prej tyre respektimin e të drejtave të të tjerëve. Përmbushja e detyrimeve të shtetit në cilësinë e punëdhënësit për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të tyre kushtetuese dhe ligjore do të sjellë pamëdyshje motivim dhe përkushtim të punonjësve të Policisë në kryerjen e misionit ligjor të Policisë të përcaktuar në nenin 1 të ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, atë ... *të ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike, në përputhje me ligjin dhe duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut.*

Këtë gjykim dhe vlerësim për të respektuar të drejtat kushtetuese dhe ligjore të vetë punonjësve të Policisë, ja kemi bërë të ditur dhe theksuar herë pas here titullarëve të Ministrisë së Brendshme dhe të Policisë së Shtetit, si nëpërmjet rekomandimeve për çështje të caktuara, ashtu edhe publikisht në aktivitete të përbashkëta apo aktivitete të tjera të organizuara nga ana jonë.

Si shembuj të rasteve të trajtimit të këtij problemi mund të përmendim:

1. Rasti i ndjekur me iniciativë pas publikimit në disa media të shqetësimeve të ngritura nga punonjës i Policisë së Shtetit D. M.. Ai ishte efektiv i Rajonit të Policisë Vorë, Tiranë, me detyrë Specialist i Policisë së Rendit. Në datën 15.03.2008, kur ndodhi ngjarja e Gërdecit në Tiranë, ai meqenëse mbulonte këtë zonë ka shkuar në drejtim të vendit të ngjarjes. Gjatë rrugës, në afërsi të vendit të ngjarjes, në momentin që ishte duke i dhënë ndihmë të plagosurve nga shpërthimi në fabrikën e çmontimit të municioneve në Gërdec, është plagosur edhe vetë nga shpërthimi i dytë. Nga kjo plagosje atij i ishin thyer dy këmbët dhe kishte pësuar djegie në pjesën e pasme të trupit. Për të bërë mjekimin e tij, ai ishte dërguar nga autoritetet shtetërore shqiptare në Spitalin e Selanikut

në Greqi. Sipas medias, ankuesi pretendonte se në spitalin grek nuk kishte marrë mjekimin e plotë e të duhur dhe si pasojë, për shkak të infeksionit, gjendja e tij shëndetësore ishte rënduar duke rrezikuar të humbiste njëren këmbë. Për këto arsye ai ishte rikthyer në Shqipëri me shpenzimet e veta dhe ishte shtruar në spitalin privat turk, pranë Spitalit Ushtarak në Tiranë. Sipas tij, mjekët e këtij spitali i kishin thënë se megjithëse kishin bërë maksimumin e mundshëm, ai nuk mund të riaftësohej në spitalet që shërbejnë në Shqipëri dhe se duhet të shkonte në ndonjë spital të specializuar jashtë vendit. Mirëpo megjithëse nga eprorët e tij ishin bërë disa përpjekje për të bërë të mundur dërgimit e tij jashtë vendit, këto përpjekje nuk ishin konkretizuar. Gjithashtu në media ishte ngritur edhe shqetësimi i punonjësit të Policisë për mos dëmshpërblimin e tij për shpenzimet e bëra privatisht dhe për dëmtimin e shëndetit në krye të detyrës nga shpërthimi i ndodhur në Gërdec.

Këtë rast e vlerësuam me përparësi dhe i dëmtuari u takua personalisht nga Avokati i Popullit. Ai konfirmoi të vërtetat shqetësimet e publikuara nga media dhe dha pëlqimin për ndjekjen e këtij rasti nga Avokati i Popullit.

Për të bërë të mundur mjekimin dhe rehabilitimin e shtetasit D. M. të dëmtuar në krye të detyrës, i rekomanduam Ministrin të Shëndetësisë dhe Ministrin të Brendshëm që ta vlerësonin me prioritet këtë rast dhe të bënin të mundur dërgimin e tij për mjekim në ndonjë klinikë të specializuar jashtë vendit duke përballuar edhe shpenzimet përkatëse. Gjithashtu i Rekomanduam Drejtorin të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit që të bënte dëmshpërblimin e tij si për dëmtimin e shëndetit ashtu edhe për shpenzimet që ai kishte bërë. Ndërkohë morëm vendim për ekzaminimin e tij nga Instituti i Mjekësisë Ligjore Tiranë. Nga ekzaminimi i bërë rezultoi se dëmtimet e shtetasit D. M. hynin në kategorinë e “plagosjes së rëndë”.

Rekomandimi për mjekimin e tij jashtë vendit u pranua menjëherë dhe ai u dërgua për kurim në një spital në Itali . Pas disa ndërhyrjeve kirurgjikale gjendja e tij u përmirësua. Ndërsa rekomandimi për dëmshpërblimin e tij, megjithëse na u premtua nuk u bë. Për të realizuar këtë të drejtë të ligjshme i sugjeruam të dëmtuarit që t’i drejtohej gjykatës me kërkesë padi. Gjithashtu atij i dhamë edhe Aktdëshminë Mjekoligjore, me qëllim që ta përdorte si provë shkresore në gjykatë.

2. Ankesa e ish punonjëses së Policisë E. H., e cila kishte qenë në detyrën e kontrollores në Komisariatit e Policisë Rinas. Ajo na shkruante se me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 1162/1, dt. 30.12.2006, është larguar nga Policia me motivacionin “për shkurtim të funksionit organik”. Ankuesja pretendonte, se ky urdher është i paligjshëm dhe se motivacioni i tij nuk është i vërtetë, sepse në fakt nuk është shkurtuar funksioni organik dhe se në vendin e saj të punës është

emëruar një person tjetër. Në ankesë ajo ngrite edhe shqetësimin, se i janë shkelur edhe procedurat ligjore në rastin e largimit. Për këto arsye kishte bërë ankim administrativ, por nuk kishte marrë asnjë përgjigje. Gjithashtu ajo na shkruante se, meqenëse kishte vendosur t'i drejtohej gjykatës, kishte kërkuar që t'i jepeshin kopje të dokumenteve që kishin të bënin me largimin e saj nga Policia, por dokumentet e kërkuara nuk i ishin dhënë.

Në bazë të kërkesës tonë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, midis të tjerave na informoi se, ankuesja është larguar nga Policia për shkak të shkurtimit të funksionit organik. Gjithashtu na vuri në dijeni, se ajo ishte në proces gjyqësor për këtë problem dhe se të gjitha dokumentet e kërkuara do t'i viheshin në dispozicion gjatë gjykimit.

Nëpërmjet rekomandimit i kërkuam që të na dërgonte dokumentet e kërkuara nga ankuesja E. H.. Gjithashtu rekomanduam që të merreshin masat e nevojshme që në të ardhmen nga administrata e Policisë së Shtetit të mos përsëriten shkelje të kësaj natyre, të cilat kanë të bëjnë me të drejtën kushtetuese dhe ligjore të informimit të shtetasve. Rekomandimi u mirëprit dhe na u dërguan dokumentet e kërkuara, të cilat ia dhamë ankueses. Ajo i paraqiti në procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Apelit Tiranë. Gjykata i vlerësoi ato si prova në favor të ankueses dhe mbi këtë bazë e prishi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

#### **IV. Rekomandime dhe propozime në fushën legjislativë**

Gjatë shqyrtimit të disa ankesave të ndryshme ne kemi konstatuar se shkelen të drejtat kushtetuese e ligjore të punonjësve të Policisë për shkak të mos nxjerrjes dhe miratimit të akteve normative nënligjore në bazë e për zbatim të ligjeve. Gjithashtu kemi konstatuar se ka edhe akte nënligjore, të cilat bien ndesh ose janë nxjerrë në kundërshtim me dispozitat kushtetuese e ligjore dhe shkelnin në mënyrë masive të drejtat e qytetarëve. Kështu p.sh. mund të përmendim:

1. Ankesat e disa punonjësve të Policisë së Shtetit të cilët ngrinin shqetësimin për mosrespektimin e ligjit lidhur me kohëzgjatjen javore të punës dhe të pushimit. Sipas tyre, ata punojnë jo më pak se 48 orë në javë, nuk bëjnë dy ditë pushim në javë, nuk bëjnë pushim në ditët e festave zyrtare dhe se nuk paguhen për mbikohën e punës. Ndërkohë ata pretendonin se ky shqetësim ka vite që ekziston në radhët e Policisë, por nga drejtuesit e saj nuk janë bërë dhe nuk po bëhen përpjekje për zgjidhjen e këtij problemi.

Në fakt, ky shqetësim ishte ngritur verbalisht herë pas here nga punonjësit e Policisë së Shtetit në takime të ndryshme që kanë patur me përfaqësuesit e institucionit të Avokatit të Popullit. Mirëpo për shkak të procedurës ligjore, e cila kërkon formalizimin me shkrim të ankesave apo



kërkesave të personave të dëmtuar apo të interesuar, ne nuk e kemi regjistruar e shqyrtuar atë më parë.

Pas bërjes me shkrim të ankesave në institucionin tonë, për verifikimin e këtij shqetësimi përfaqësuesit tanë morën takime me punonjës të niveleve të ndryshme të Policisë së Shtetit, në organet vendore dhe qendrore të saj. Ata e konfirmuan të vërtetë këtë shqetësim veçanërisht në strukturat vendore të Policisë, të cilat janë më të prekura prej tij. Gjithashtu u informuam, se për rregullimin e këtij problemi nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ishte përgatitur dhe dërguar në Këshillin e Ministrave projektvendimi “Për kohën e punës dhe të pushimit të punonjësve të Policisë së Shtetit”, por ai nuk ishte miratuar.

Për të bërë të mundur zgjidhjen e këtij problemi, i rekomanduam Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë që Këshilli i Ministrave të miratonte VKM-së “Për kohën e punës dhe të pushimit të punonjësve të Policisë së Shtetit” në bazë e për zbatim të nenit 87, pika 6 të ligjit nr. 9749, dt. 04.06. 2007 "Për Policinë e Shtetit". Rekomandimi është mirëpritur dhe na është premtuar se ky problem do të zgjidhet.

2. Ankesat e bëra nga disa shtetas të ndryshëm, të cilët ankoheshin për mospajisjen e tyre me pasaporta për jashtë shtetit. Sipas tyre, shkak për mospajisjen e tyre me pasaporta nga organet e Policisë së Shtetit është bërë fakti se ata janë të shpallur në kërkim nga Policia. Shpallja e tyre në kërkim është bërë si për rastet kur ata janë të dyshuar për kryerjen e një veprë penale, ashtu edhe kur janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë si autorë të veprave penale.

Nga interesimi që bëme rreth këtij problemi në organet e Policisë së Shtetit, drejtuesit e tyre na informuan se këtë veprim pengues për të pajisur me pasaporta shtetasit që janë në kërkim nga Policia e mbështesin në Urdhërin e Ministrit të Rendit Publik Nr. 1980, dt. 04.06.2004 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MRP Nr. 1627, dt. 22.01.2002 “Mbi procedurat për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”.

Sikurse përcaktohet edhe në ligj, pasaporta për jashtë shtetit është dokumenti që vërteton identitetin dhe shtetësinë shqiptare të mbajtësit të saj, me anën e të cilit ai mund të dalë e të hyjë nga dhe në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe të udhëtojë nga një shtet i huaj në një tjetër”. Pajisja e çdo shtetasi shqiptar me pasaportë, duke përfshirë edhe ata që janë në kërkim nga organet e Policisë apo të drejtësisë i bën të identifikueshëm ata. Duke qenë të identifikueshëm atëherë është më e lehtë edhe gjetja e kapja e tyre nga autoritetet kompetente të shteteve të huaja. Pra pajisja me pasaportë e personave që janë në kërkim do të lehtësojë edhe punën e organeve policore shqiptare dhe të shteteve të tjera për identifikimin dhe kapjen e tyre.

Po kështu mund të themi se edhe procedura e aplikimit dhe e dorëzimit të pasaportave shtetasve që janë në kërkim i krijon mundësi organeve të Policisë për të marrë informacion nëpërmjet dokumentacionit që ata dorëzojnë lidhur me vendndodhjen e tyre, brenda apo jashtë shtetit. Marrja e këtij informacioni ndihmon organet e Policisë për të organizuar punën me metodat dhe format ligjore për kapjen e tyre vetë apo në bashkëpunim me homologët ndërkombëtarë.

Ndërsa, mospajisja e tyre me pasaporta ndikon në të kundërtën, në fshehjen e identitetit të tyre, duke lëvizur jashtë shtetit me pasaporta fallso apo edhe pa to dhe për rrjedhojë edhe në shmangien e tyre ndaj detyrimeve ligjore. Këto argumente të mësipërme i mbrojnë edhe mjaft specialistë të policisë që janë konsultuar nga ne.

Për të bërë të mundur zgjidhjen e këtij problemi, i rekomandua Ministrit të Brendshëm që të bënte revokimin e pjesshëm të Urdhrit të Ministrit të Rendit Publik Nr. 1980, dt. 04.06.2004 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MRP Nr. 1627, dt. 22.01.2002 “Mbi procedurat për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit” dhe konkretisht të paragrafit të tretë të pikës 1 të tij, ku urdhërohet: *“Specialisti i kërkimit pengon për procedurë të mëtejshme aplikimet e shtetasve që janë në kërkim”* sepse është antikushtetuese. Gjithashtu i rekomandua që të merrte iniciativën ligjvënëse për plotësimin e ligjit nr. 8668, dt. 23.11.2000 “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, me qëllim që të legjitimohet e drejta e Ministrit të Brendshëm për të nxjerre akte nënligjore për të rregulluar situatën në përputhje me nenin 118 të Kushtetutës. Rekomandimi i mirëpritur dhe u informua se rregullimi i këtij problemi do të bëhet nëpërmjet miratimit të akteve normative që do të dalin për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaporta te reja gjatë vitit 2009.

## **V. Inspektive në dhomat e shoqërimit dhe të sigurimit të administruara nga Policia e Shtetit, si dhe në ambiente të tjera ku u shërbehet qytetarëve nga Policia**

Në vazhdimësi gjatë vitit 2008 kemi bërë disa inspektive nga ekipe të Avokatit të Popullit në dhomat e sigurimit të organeve vendore të Policisë në shkallë vendi.

Nga inspektimet konstatua se, kjo detyrë nuk po zbatohet me korrektësi, sepse në dhomat e sigurimit të organeve të Policisë mbahen ende të paraburgosur ndaj të cilëve ishte caktuar masa e sigurimit “arrest në burg”. Ne gjykojmë se mbajtja e personave të arrestuar në dhomat e sigurimit të organeve të Policisë së Shtetit vjen në kundërshtim me aktet e përmendura më sipër. Në të njëjtën kohë konstatuam se, ky veprim përbën shkelje të të drejtave të paraburgosurve, për faktin se këto

ambjente nuk kanë standartet e kërkuara, kanë kubaturë të vogël, disa janë pa ajrim dhe të ndaluarve ju shkelet e drejta e ajrimit, ka mungesë të kushteve higjeno-sanitare, si dhe personeli i sigurimit të tyre është i patrajnuar në këtë fushë.

Si raste të konstatimit të shkeljeve gjatë inspektimeve mund të përmendim:

1. Inspektimin e bëra në dhomat e shoqërimit dhe të sigurimit (izolimit), si dhe në ambjentet e aplikimit për pasaporta të shtetasve në Komisarariatet e Policisë dhe në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë dhe në Vlorë, ku konstatoam se:

I. Lidhur me shoqërimin e shtetasve dhe ambientet ku mbahen këta persona:

1. Shoqërimi i personave në organet e Policisë bëhet jo gjithmonë sipas kritereve ligjore të përcaktuara në nenet 11/6, 101/1/ “a” dhe “b” dhe 106 të ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”. Kështu konstatoam, se shoqërohen në Polici persona jashtë kritereve ligjore të përcaktuara në dispozitat e mësipërme, si p.sh. në Komisariatin e Policisë Nr. 2, 3, 4 dhe 5 në Tiranë dhe në Vlorë. Por kishte raste që të trajtohen si të shoqëruar persona kur janë të dyshuar si autorë të veprave penale, si p.sh. në Komisariatin e Policisë Nr. 3 dhe 4 Tiranë, apo dhe në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë. Apo kur janë dëshmitarë të një ngjarjeje, raste këto për të cilat duhet aplikuar e drejta e “njoftimit për paraqitje në Polici”, e parashikuar në nenin 100 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” dhe jo të bëhet shoqërimi i tyre në Polici me detyrim.

Nga shqyrtimi rasteve të mësipërme dhe pyetja e punonjësve të Policisë, të cilët kishin urdhëruar shoqërimin e shtetasve në Polici, rezultoi se këto shkelje të ligjit ishin pasojë e mosnjohjes së konceptimit të ri dhe i kritereve ligjore të shoqërimit të përcaktura në ligjin e ri “Për Policinë e Shtetit”. Fatkeqësisht në radhët e Policisë, duke përfshirë edhe drejtuesit e saj, vazhdon të ekzistojë konceptimi i shoqërimit të shtetasve në organet e Policisë sipas ligjit të vjetër dhe të zbatohen kushtet dhe rastet e parashikuara prej tij, ndonëse ai është shfuqizuar.

2. Të shoqëruarve në të gjitha organet e Policisë ju bëhet kontrolli personal dhe ju hiqen e bllokohen sendet personale si telefona etj, veprim i cili nuk është në përputhje me ligjin. Në nenin 108 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” është parashikuar bllokimi i sendeve, si përjashtim vetëm në rastet kur sendet përbëjnë kërcënim të çastit ndaj rendit dhe sigurisë publike.

Kontrolli i personave të shoqëruar është shkelje e hapur e të drejtës kushtetuese të paprekshmërisë personale të personit. Ky veprim vjen në kundërshtim me nenin 37/3 të Kushtetutës tonë, ku thuhet se: “Askujt nuk mund t’i bëhet kontroll vetjak jashtë procesit penal, me përjashtim të

*rasteve të hyrjes në territorin e shtetit dhe të daljes prej tij ose për të mënjanuar një rrezik që i kanoset sigurimit publik”.*

Njëkohësisht ky veprim vjen në kundërshtim edhe dispozitat e K.Pr.Penale, nenet 202 e vijues, të cilat parashikojnë kontrollin i personit. Neni 202 i K.Pr. Penale parashikon se:

“1. Kur ka arsye të bazuara për të menduar se dikush fsheh në personin e tij prova materiale të veprës penale ose sende që i përkasin veprës penale, gjykata merr vendim për kontrollin personal....

3. Në rast flagrance ose në rast ndjekje të personit që është duke ikur dhe që nuk lejojnë nxjerrjen e një vendimi kontrolli, Oficerët e Policisë Gjyqësore kryejnë kontrollin e personit ose të vendit, duke zbatuar rregullat e caktuara në nenin 299”.

Gjithashtu konstatoam, se në rastet kur shtetasve të shoqëruar ju hiqen dhe bllokohen sendet personale, nga punonjësit e Policisë nuk mbahet (hartohet) e nuk jepet poseduesve procesverbali përkatës, siç parashikohet në nenin 108, paragrafi i dytë i ligjit “Për Policinë e Shtetit”.

3. Librat e shoqërimit të shtetasve në Polici shpesh plotësohen pa shumë përgjegjësi. Aty nuk pasqyrohet saktë shkaku ligjor i shoqërimit, p.sh. në Komisaratin e Policisë Nr. 3 Tiranë, ishin kapur në flagrancë dy shtetas duke shitur sende të vjedhura dhe për këtë ata u ndaluan. Mirëpo në librin e shoqërimit figuronte se ata ishin shoqëruar në Polici për verifikim. Në Komisaratin e Policisë Nr. 4 Tiranë, ishin marrë dy shtetas si autorë të dyshuar të dëmtimit me dashje të pronës dhe kërcënimit të një shtetasi, ndërsa në libër figuronte se ishin të shoqëruar për konflikt. Po kështu edhe në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë ishin marrë 3 shtetas si autorë të dyshuar për kryerje të veprave penale, ndërsa në libër figuronte si të shoqëruar për verifikim.

4. Nuk ka dhoma shoqërimi të shtetasve të ndara, për meshkujt, femrat dhe për të miturit, sipas konceptimit të bërë nga ligji i ri nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”. Vetëm në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë ka 1 dhomë për femra dhe 1 dhomë për të mitur, por nuk ka për të rritur. Ndërsa në Komisaratin e Policisë Nr. 1 Tiranë ka vetëm 1 dhomë shoqërimi.

5. Dhomat e ashtuquajtura për të shoqëruar, në fakt si nga përmasat, ndriçimi, ashtu edhe nga konceptimi dhe trajtimi i personave të shoqëruar, janë dhoma izolimi, sepse janë me dyer hekuri, të mbyllura me dryna dhe pa ndriçim. Në ndonjë komisarariat duhet të kalosh 3 porta hekuri për të shkuar në dhomën e “shoqërimit”, si p.sh. në Vlorë. Por të tilla dhoma shoqërimi, brenda tre dyerve të hekurta e të mbyllura, kemi konstatuar edhe në disa rrethe të tjera gjatë inspektimeve të kryera më parë si p.sh. në Komisaratin e Policisë Dibër.

6. Ne shumicën e rasteve, “dhomat e shoqërimit” nuk janë të pajisura me stola apo karrige për t’u ulur të shoqëruarit dhe nuk janë të pastra e të lyera.

II. Lidhur me të ndaluarit, të arrestuarit dhe ambientet që mbahen këta persona:

1. Në dhomat e sigurimit (izolimit) të organeve të mësipërme që i inspektuam vazhdonin të qëndronin persona të paraburgosur ndaj të cilëve ishte caktuar masa e sigurimit “arrest në burg”, si dhe persona të ndaluar për ekzekutimin e vendimeve penale me burgim të formës së prerë, të dhënë në mungese dhe nuk ishin dërguar në institucionet e paraburgimit dhe ato të burgimit në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për shkak të pengesave që krijonte vazhdimisht kjo e fundit. Koha e qëndrimit të tyre në ambientet e Policisë pas caktimit të masave të sigurimit varioje nga 1 deri 36 ditë. Kështu p.sh.

- Në Komisariatit e Policisë Nr. 1 Tiranë kishte 4 persona ndaj të cilëve nga gjykata ishte caktuar masa e sigurimit “arrest në burg” dhe 1 person të ndaluar.

- Në Komisariatit e Policisë Nr. 2 Tiranë kishte 1 person ndaj të cilit gjykata kishte caktuar masën e sigurimit “arrest në burg” dhe 1 person të ndaluar.

- Në Komisariatit e Policisë Nr. 3 Tirane kishte 5 persona ndaj të cilëve nga gjykata ishte caktuar masa e sigurimit “arrest në burg”.

- Në Komisariatit e Policisë Nr. 4 Tiranë kishte 5 persona ndaj të cilëve nga gjykata ishte caktuar masa e sigurimit “arrest në burg”.

- Në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë kishte 4 persona ndaj të cilëve nga gjykata ishte caktuar masa e sigurimit “arrest në burg” dhe 1 person të ndaluar.

- Në Komisariatit e Policisë Vlorë kishte 4 persona ndaj të cilëve nga gjykata ishte caktuar masa e sigurimit “arrest në burg” dhe 1 person të ndaluar.

2. Vazhdon të ketë raste që të arrestuarit e mitur mbahen së bashku me të arrestuarit madhorë. Kështu p.sh. në Komisariatit e Policisë Nr. 1 Tiranë kishte 1 të mitur dhe në Komisariatit e Policisë Nr. 3 Tirane kishte 2 persona të mitur.

3. Gjithashtu vazhdon të ketë raste që të arrestuarve të mitur nuk ju sigurohet mbrojtja e detyrueshme me avokat, si dhe ndihma (asistenca) psikologjike, siç parashikohet në nenet 35 e 49 të K.Pr.Penale. Kështu p.sh. në Komisariatit e Policisë Nr. 3 Tiranë konstatuam që i mituri M. V., ishte pyetur për veprën penale të vjedhjes pa praninë e detyrueshme të mbrojtësit dhe pa praninë e punonjësit social apo prindërve të tij. Sqarojmë se për këtë rast bëmë edhe rekomandim të veçantë.

4. Në disa raste të arrestuarve dhe të ndaluarve, në procesverbalet e arrestimit dhe të ndalimit ju shënohet ora e përpilimit të këtyre dokumenteve dhe jo ora faktike, si çasti kur atyre ju është privuar liria në fakt. Gjatë kryerjes së veprimeve verifikuese nga punonjësit e Policisë, ata padrejtësisht trajtohen si të shoqëruar edhe në rastet e kapjes në flagrancë. Duke i trajtuar në këtë mënyrë, atyre nuk ju llogaritet në kohën e paraburgimit dhe më pas edhe atë të vuajtjes së dënimit koha, gjatë së cilës bëhen verifikimet apo veprimet e ndryshme proceduriale, kohë e cila mund të shkojë deri në 10 orë. Theksojmë se në bazë të neneve 144, 250 të K.Pr.Penale, shënimi në procesverbal i çastit (orës) së arrestimit në flagrancë ose të ndalimit është një element i rëndësishëm mbi bazën e të cilit fillojnë të llogariten efektet e paraburgimit. Ndërsa në bazë të nenit 258 të K.Pr.Penale, nga çasti (ora) e arrestimit ose ndalimit fillon afati i 48-të orëve, brenda të cilës prokurori kërkon vleftësimin e masës së sigurimit në gjykatën e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi.

5. Në të gjitha organet që i inspektuam, dhomat e izolimit janë të papërshtashtme për banim dhe nuk plotësojnë standardet minimale të nevojshme për jetesë. Të gjitha janë të palyera, të mbipopulluara dhe pa dushe për t'u larë. Sikurse përmendëm edhe më sipër, ndodh që në këto dhoma të qëndrojnë të arrestuar për një kohë mbi një muaj pa u larë asnjëherë. Në disa organe të tjera ka edhe probleme të tjera shqetësuese, si në Komisaratin e Policisë Nr. 4 Tiranë dhomat e izolimit janë nëntokë, me shumë lagështi dhe pa ajrim. Ndërsa në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë dy dhoma janë pa dritare e për rrjedhojë edhe pa ajrim.

6. Në disa komisarate, si në Komisaratin e Policisë Nr. 2, 4, 5, 6 Tiranë dhe në Vlorë, në ambientet e Policisë sidomos të shoqërimit dhe arrestimit mungojnë posterat për të drejtat e personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga policia.

7. Në të gjitha organet e Policisë mungojnë formularë në gjuhë të huaj për të drejtat e personave të shoqëruar, të ndaluar apo arrestuar kur këta janë shtetas të huaj.

8. Të ndaluarve dhe arrestuarve në Polici, nuk ju bëhet detyrimisht kontroll mjekësor lidhur me sëmundjet që mund të kenë, aq më tepër kur bëhet fjalë për sëmundje ngjitëse, të cilat përbëjnë rrezik dhe mund t'i marrin edhe personat që janë në të njëjtën dhomë me të infektuarin. Ata vizitohen nga mjeku vetëm në rastet kur kanë shqetësime dhe e kërkojnë vetë atë. Normalisht mendojmë se ky kontroll duhet t'u bëhet brenda 24 orëve të para të ndalimit apo arrestimit.

### III. Ambientet e aplikimit për pasaporta të shtetasve:

Në pjesën më të madhe të Komisariateve të Policisë në Tiranë, ambientet ku qytetarët aplikojnë për pajisjen e tyre me pasaporta për jashtë shtetit janë të papërshtatshme dhe jo dinjitoze. Ka zyra të vogla,

por që për qytetarët aplikues nuk ka ambiente me tavolina e karrige për të plotësuar formularët përkatës, apo për të pritur kur ka radhë. Bëjnë përjashtim për mirë Komisariati i Policisë Nr. 3 Tiranë dhe Komisariati i Policisë Vlorë. Ndërsa në Komisaratin e Policisë Nr. 5 Tiranë, si zyrë për punonjësit e Policisë që bëjnë pranimin e dokumentacionit për pajisjen me pasaporta shërben një kioskë llamarine e vendosur jashtë territorit të komisarimit, ndërsa qytetarët bëjnë aplikimin në teren të hapur.

#### IV. Konstatime të tjera:

Në disa Komisariate Policie mungojnë afishimet për orarin e pritjes së shtetasve nga titullarët e organit dhe të shefave të sektorëve me qëllim që qytetarët të orientohen dhe të mos sorollaten për bërjen e kërkesë-ankesave të tyre.

Konstatimet e përshkruara më sipër përbëjnë shkelje të të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese e ligjore të shtetasve. Ndërkohë, ato ulin imazhin dhe prestigjin e organeve të Policisë së Shtetit dhe për rrjedhojë edhe të vetë shtetit, si garant për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të shtetasve.

Për të rregulluar gjendjen e përshkruar më sipër në organet vendore të Policisë dhe për të parandaluar shkelje të tilla në të ardhmen, i rekomanduar Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Drejtësisë, Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, si dhe vumë në dijeni Kryeministrin e Republikës së Shqipërisë dhe Kryetarin e Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut dhe Sigurinë, që:

1. Të merren masa të menjëhershme për përmirësimin e kushteve të qëndrimit (jetesës) në dhomat e sigurimit të arrestuarve dhe të ndaluarve në të gjitha organet vendore të Policisë së Shtetit.

2. Të merren masa të menjëhershme për ndërtimin e dhomave të shoqërimit të shtetasve në të gjitha organet vendore të Policisë së Shtetit, sipas konceptimit të ligjit të ri nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, duke krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt dhe të miturit.

3. Të merren masa të menjëhershme për ndërtimin në të gjitha organet vendore të Policisë së Shtetit të ambienteve të përshtatshme për shtetasit që aplikojnë për t’u pajisur me pasaporta për jashtë shtetit.

4. Të merren masa të menjëhershme për njohjen e efektivave të Policisë me ligjin e ri “Për Policinë e Shtetit” dhe të kërkohet zbatimi me rigozitetin e kriterëve ligjore lidhur me rastet e shoqërimit të shtetasve në organet e Policisë si dhe për trajtimin dinjitoz të tyre.

5. Të kërkohet nga Oficerët e Policisë Gjyqësore të cilët bëjnë arrestime dhe ndalime që të respektohen me korrektesë dispozitat ligjore të K.Pr.Penale lidhur me shënimin në procesverbal të çastit (orës së saktë)

të arrestimit apo ndalimit të shtetasve dhe të mos trajtohen ata fillimisht si të shoqëruar.

6. Për të gjitha rastet e arrestimit apo të ndalimit të të miturve të merren masat për t'ju siguruar atyre ndihmën e detyrueshme juridike dhe psikologjike. Ndërkohë të merren masat e nevojshme për moslejimin e qëndrimit të të miturve në të njëjtat dhoma izolimi me të rriturit.

7. Të merren masat e nevojshme për transferimin nga ambientet e Policisë, në institucionet e paraburgimit dhe burgimit, në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, të të gjithë të paraburgosurve ndaj të cilëve është vendosur masa e sigurimit “arrest në burg” dhe e të ndaluarve për efekt të ekzekutimit të vendimit penal të dënimit të tyre në mungesë me “burgim”,

8. Të vendosen në ambientet e Policisë, duke përfshirë edhe ato të sigurimit dhe shoqërimit, postera me të drejtat e personave të arrestuar, ndaluar dhe shoqëruar. Ndërkohë të përgatiten sa më shpejt edhe formularë në gjuhë të huaj ku të pasqyrohen këto të drejta, të cilat t'ju serviren shtetasve të huaj kur të ketë raste të tilla.

9. Të merren masa të menjëhershme për kontrollin mjekësor të çdo personi të arrestuar dhe ndaluar nga Policia që në momentet e para të heqjes së lirisë, por jo më vonë se 24 orët e para.

10. Të vendoset në ambientet e jashtme, në të gjitha organet vendore të Policisë së Shtetit, orari i pritjes së shtetasve nga drejtuesit vendorë dhe punonjësit e tjerë të Policisë.

Rekomandimet e mësipërme u mirëpritën në parim, por në fakt zbatimi praktik i tyre le shumë për të dëshiruar.

## **V. Rekomandime për parandalimin e torturës dhe formave të tjera të keqtrajtimit dhe shkeljeve të ligjit nga Policia**

Në raportet e viteve të fundit, në mënyrë të përsëritur kemi bërë disa rekomandime, për të cilat gjykojmë se respektimi i tyre do të sillte parandalimin e torturës dhe formave të tjera të keqtrajtimit dhe të shkeljeve të ligjit nga Policia. Megjithëse ato ja kemi dërguar Ministrisë së Brendshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, konstatojmë se edhe pas këmbënguljes tonë të vazhdueshme, pjesa më e madhe e tyre nuk janë zbatuar. Kështu p.sh. mund të përmendim:

1. Nuk janë marrë masat e nevojshme që të sigurohet e drejta e vizitës nga një mjek për personat e privuar nga liria, qysh në fillim të privimit të tyre nga liria. Kjo e drejtë duhet gjithashtu të nënkuptojë të drejtën që këta persona kanë për t'u ekzaminuar, nëse ata dëshirojnë, nga një mjek i zgjedhur prej tyre.

Për realizimin e kësaj të drejte gjithashtu duhet që:



- Të gjitha ekzaminimet mjekësore të personave të privuar nga liria e tyre prej Policisë të jenë larg dëgjimit të Policisë dhe vetëm nëse kundërshton mjeku. Për ndonjë rast të veçantë, larg edhe shikimit të punonjësve të Policisë kur ata vizitohen nga mjeku.

- Rezultatet e çdo ekzaminimi, si dhe çdo deklaratë e bërë nga personi i vizituar, duhet të shënohen nga mjeku dhe të jenë në dispozicion të personit të privuar nga liria dhe të avokatit të tij.

2. Personave të privuar nga liria prej Policisë, nuk u dorëzohen formularë ku të pasqyrohen e saktësohen të drejtat e tyre. Këta formularë duhet që të jenë të disponueshëm edhe në gjuhë të huaj. Për më tepër, të interesuarit duhet të ftohen që të firmosin një deklaratë që ata kanë qënë të informuar mbi të drejtat e tyre.

3. Nuk është nxjerrë udhëzimi (kod i sjelljes) për marrjen në pyetje nga Policia. Ky kod duhet ndër të tjera të trajtojë aspektet e mëposhtme; t'i tregohet sistematikisht të ndaluarit identiteti i personave të pranishëm gjatë marrjes në pyetje (emri dhe/ose matrikulli); kohëzgjatja e lejuar e një seance pyetjesh; periudhat e pushimit ndërmjet këtyre seancave dhe pauzat gjatë marrjes në pyetje; vendi apo vendet ku mund të mbahet një seancë e tillë; nëse do t'i kërkohet të ndaluarit të qëndrojnë në këmbë gjatë marrjes në pyetje; dhe që ndalohet marrja në pyetje e personave nën ndikimin e drogës, alkoolit, ilaçeve ose nën një gjendje tronditjeje. Ky kod duhet gjithashtu të parashikojë që të shënohet sistematikisht momenti i fillimit dhe i përfundimit të çdo marrje në pyetje, identitetin e çdo të pranishmi gjatë çdo seance pyetjeje, si dhe çdo kërkesë të formuluar nga i ndaluari gjatë kësaj seance. Situata e personave veçanërisht të pambrojtur (për shembull, minorenët, personat e prekur nga sëmundje ose mangësi mendore) duhet të bëhen objekt i garancive specifike.

4. Nuk zbatohen të drejtat e mësipërme edhe për personat e mbajtur nga Policia për qëllime administrative. Nga inspektimi i bërë gjatë këtij viti në disa Komisariate të Policisë në shkallë vendi kemi konstatuar se në disa raste “shoqërimi në Polici” përdoret ndaj personave të dyshuar për një vepër penale. Pra shoqërimi përdoret jo për të sqaruar veprime administrative, por me qëllim hetimesh për vepra penale dhe mbas kohës së “shoqërimit” bëhen veprime procedurale të ndalimit ose arrestimit. Po kështu kemi konstatuar disa raste të kryerjes së veprimeve që çojnë në kërkimin dhe mbledhjen e të dhënave në mënyrë të paligjshme, duke shkelur pikën 2 të nenit 32 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Të dhëna të tilla mund të përmendim ato që janë marrë nën efektin e dhunës fizike.

5. Nuk është nxjerrë nga autoritetet policore qarkorja që të sqarojë se koha e mbajtjes së personit, për arsye administrative ose gjyqësore duhet të llogaritet brenda afatit kohor të caktuar për paraqitjen e një personi para një gjyqtari, që, sipas nenit 28 të Kushtetutës, është jo më

tepër se 48 orë. Nga verifikimi i disa ankesave ka rezultuar se koha e ndalimit ose arrestimit fillon pas asaj të shoqërimit, që në disa raste edhe ajo ka qenë tej afatit ligjor.

6. Titullarët dhe kuadrot drejtues të Policisë nuk ushtrojnë kontroll të vazhdueshëm në lidhje me librat e regjistrimit dhe të mbajtjes së personave në ambientet e Policisë, me qëllim që ato të plotësohen saktë e të mos manipulohen për të mbuluar shkeljet e ligjit. Kemi konstatuar disa raste që shënimet në këto regjistra nuk përputhen me kohën e saktë të qëndrimit të tyre në Polici, ndërsa në raste të veçanta ata nuk regjistrohen.

7. Nuk ka ndryshuar koncepti për personat e shoqëruar në Polici, të cilët duhet të mbahen në dhoma shoqërimi dhe jo ndalimi, jo të prangosur ose në dhoma të mbyllura me dryn, siç veprohet në disa raste. Po kështu nuk ka ambiente për të shoqëruarit e mitur dhe femra. Dhomat duhet të jenë me kushte të përshtatshme higjienosanitare dhe të pajisura me karrige e tavolina. Këto mangësi fatkeqësisht janë të pranishme dhe shumë të dukshme edhe në pjesën më të madhe të Komisariateve të Policisë në Kryeqytet, ku pretendojmë dhe synojmë të kemi një Polici më të kulturuar dhe më të civilizuar.

8. Nuk janë ndryshuar e përmirësuar kushtet e mbajtjes së të ndaluarve e të arrestuarve në dhomat e paraburgimit në ambientet e Policisë, me qëllim që:

- të respektohen në mënyrë strikte kriteret e parashikuara lidhur me çështjen e hapësirës minimale për të ndaluarin, si dhe
- të ndahen të rriturit nga minorenët dhe t'i kushtohet këtyre të fundit një vëmendje e veçantë në planin e shëndetit dhe të edukimit.

9. Megjithëse në muajin qershor të vitit 2007 u bë kalimi i të gjitha dhomave të paraburgimit dhe i personelit të tyre nga varësia e Ministrisë së Brendshme në atë të Ministrisë së Drejtësisë, kemi konstatuar se ka shumë raste që të paraburgosurit dhe në disa raste edhe të dënuarit mbahen në dhomat e sigurimit të Policisë. Dërgimi i të paraburgosurve në dhomat e paraburgimit që në momentin e vlerësimit të masës së sigurimit në organet gjyqësore, do të krijonte mundësinë për të vënë efektivisht në jetë të gjitha dispozitat e caktuara në “Rregulloren mbi sigurimin dhe trajtimin e të burgosurve”, të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 96, datë 09.03.2000.

Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë ka insistuar vazhdimisht për realizimin e kësaj detyre, por Ministria e Drejtësisë dhe veçanërisht Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka sjellë pengesa.

Përveç zbatimit të rekomandimeve të mësipërme, nga organet e Policisë duhet të punohet më shumë për të zbatuar një nga detyrat kryesore institucionale të saj të përcaktuara në nenin 1 të ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, atë ... të ruajtjes së rendit dhe

*sigurisë publike, në përputhje me ligjin dhe duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut. Për realizimin e kësaj detyrë është e domosdoshme që:*

1. T'i jepet një përparësi më e madhe edukimit dhe formimit profesional në vazhdimësi të punonjësve të Policisë të të gjitha roleve dhe gradave. Në këto programe duhet të zërë një vend të rëndësishëm edukimi i tyre me ndjenjën e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut. Niveli kulturor e profesional, njohja dhe respektimi i të drejtave të njeriut, si dhe aftësia komunikuese të jenë kritere përcaktuese në rekrutimin, mbajtjen në punë dhe përzgjedhjen në emërimet e ngritje në detyrë të punonjësve të policisë të të gjitha roleve.

2. Duhet që autoritetet politike dhe teknike të niveleve më të larta të dalin herë pas here, më shpesh dhe më fort, me mesazhe të qarta që dënojnë rreptë rastet e torturës dhe të keqtrajtimit të shtetasve nga punonjës të veçantë të Policisë. Ky veprim duhet të përsëritet me intervale të rregullta nga drejtuesit në të gjitha shkallët e Policisë. Kjo në veçanti t'u theksohet punonjësve të Policisë të ngarkuar me marrjen në pyetje të personave të privuar nga liria. Është mjaft pozitive se këtë mesazh e dha Kryeministri Berisha në fjalën e tij të mbajtur në analizën vjetore të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për vitin 2008. Mesazhi publik, i bërë nga Kryeministri, për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve, të të miturve dhe të paraburgosurve nga punonjësit e Policisë është shumë i rëndësishëm. Mirëpo do të ishte mirë që këtë mesazh ta bënin herë pas here edhe drejtuesit e Ministrisë së Brendshme dhe të Policisë së Shtetit. Konstatojmë me shqetësim faktin se, as Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit dhe as Drejtori i Policisë së Qarkut Tiranë në raportet e tyre gjatë analizave vjetore respektive të vitit 2008, ku ne ishim të ftuar, nuk kishin pasqyruar dhe nuk thanë asnjë fjalë për respektimin e të drejtave kushtetuese e ligjore të shtetasve nga punonjësit e Policisë së Shtetit. Ata nuk përgjithësuan e kritikuan asnjë rast të torturës e keqtrajtimit të shtetasve nga Policia, ndërkohë që raste të tilla gjatë vitit 2008, të konstatuara nga ana jonë, OJF-të e ndryshme dhe media, janë të konsiderueshme. Ky qëndrim nuk i shërben aspak parandalimit të shkeljeve të tilla nga punonjësit e Policisë në të ardhmen.

3. Në të gjitha ambientet e Policisë të vendosen menjëherë posterat e përgatitura në bashkëpunim me institucionin tonë, të cilat bëjnë fjalë për respektimin e të drejtave të njeriut dhe parandalimin e dhunës nga punonjësit e Policisë. Ato do të shërbejnë jo vetëm për personat e shoqëruar apo të paraburgosur në Polici, por edhe si një kujtesë e vazhdueshme për punonjësit e Policisë dhe do t'i ndihmojë ata në zbatimin me rigoroze të ligjit. Është konstatuar se edhe ato që janë vënë, janë hequr pa patur asnjë shkak.

4. Bashkëpunimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit me Institucionin e Avokatit të Popullit, në kuadër të punës për mbrojtjen e

të drejtave dhe lirive të njeriut, megjithëse ka qenë i mirë, duhet të rritet e përsoset më tej në të ardhmen. Këtij qëllimi do t'i shërbej edhe organizimi i aktiviteteve të përbashkëta me temë për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nga punonjësit e Policisë së Shtetit.

## 6. Ministria e Mbrojtjes

Për vitin 2008 ndaj strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes janë bërë 144 kërkesa e ankesa nga subjekte që janë ushtarakë apo ish ushtarakë. Nga këto janë përfunduar 105 ankesa, si dhe 79 të tjera, që kanë qenë ankesa të mbartura nga viti 2007. Janë në shqyrtim për vitin 2009, 39 ankesa që kanë ardhur në muajt e fundit të vitit 2008 të marra gjatë organizimit të ditëve të hapura në repartet ushtarake.

Duke analizuar ankesat e ardhura në Institucionin tonë për vitin 2008, del se ato janë bërë kryesisht nga oficerë, nënoficerë, nga punonjës civilë, ushtarë si dhe ushtarakë të dalë në rezervë.

Nga ankesat e përfunduara gjatë vitit 2008 rezulton se 31 ankesa ose 29.5 përqind e tyre kanë gjetur zgjidhje pozitive. Në 3 raste ankesat kanë përfunduar duke bërë rekomandime me shkrim që janë pranuar. Ky është një tregues i kënaqshëm që tregon efikasitetin e punës sonë si dhe bashkëpunimin e frytshëm me Ministrinë e Mbrojtjes. Ndërsa 5 ankesa kanë qenë jashtë kompetencës tonë, 51 kanë qenë ankesa të pabazuara, dhe 2 ankesa kanë qenë jashtë juridiksionit. Në 3 raste ankesat kanë përfunduar me heqje dorë nga ankuesi.

Gjatë vitit 2008 zyra e Avokatit të Popullit ka marrë takim me një numër të madh subjektesh ushtarake, të cilët kanë prezantuar ankesat e tyre. Për rastet që ata kanë gjykuar ankesat janë bërë me shkrim.

Në përgjithësi objekti i ankesave të prezantuara pranë Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2008 ka qenë si vijon:

1. Ankesa për mobilizim në shërbimin ushtarak në kundërshtim me ligjin.
2. Ankesa për pensionin suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
3. Ankesa për mosdhënie e gradës sipas ligjit.
4. Ankesa lidhur me mos strehimin e ushtarakëve.
5. Ankesa për mënyrën e trajtimit me ushqim.
6. Ankesa për mos zbatimin e normave të veshmbathjes.
7. Ankesa për shërbimin shëndetësor.
8. Ankesa për kohën e punës dhe pushimit.
9. Ankesa për mos kompensimin e qirasë së banesave.

10. Ankesa për transportin nga vëndi i punës për personelin ushtarak.

11. Ankesa për pensionet e ulta të ushtarakëve të dalë në rezervë para vitit 1992.

12. Ankesa për moszbatim të ligjit për daljen e ushtarakëve në rezervë.

13. Ankesa kundër Komisionit të Statusit të Veteranit dhe Dëshmorëve të Atdheut.

Në zbatim të Rezolutave të Kuvendit të Shqipërisë, ku parashikohet si objektiv organizimi i ditëve të hapura, për të pritur ankesat e ushtarakëve në repartet ushtarake, gjatë këtij viti u bë i mundur edhe falë një bashkëpunimi të ngushtë me Komandat e reparteve ushtarake ku u organizuan ditët e hapura. Organizimi i ditëve të hapura vërteton se është mënyra më efikase, për të larguar ngurimin e kësaj kategorie individësh për të bërë ankesa apo kërkesa lidhur me problemet e ndryshme që ata i shqetësojnë.

Gjatë ditëve të hapura janë takuar rreth 1200 ushtarë, marinarë, oficerë dhe nënoficerë të Forcave të Armatosura. Nga grupi i ekspertëve të zyrës sonë, atyre ju është shpjeguar qëllimi i takimeve, si dhe ju janë shpjeguar kompetencat e zyrës së Avokatit të Popullit. Nga takimet individuale janë marrë 104 ankesa dhe kërkesa. Takimet u organizuan pa praninë e eprorëve të oficerëve, ushtarëve apo marinarëve që paraqitën ankesat. Një numër jo i vogël ankesash të paraqitura në ditët e hapura, në një kohë që problemet kishin një kohë të gjatë pa u zgjidhur, morën zgjidhje brenda një kohe të shkurtër.

Disa nga problemet më kryesore kanë qenë:

1. Ankesat e ngritura nga disa ushtarakë për trajtim me strehim apo shtesë sipërfaqe banimi. Këto çështje janë parashikuar në ligjin nr. 9210, datë 23.03.2004, "Për Statusin e Ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë" dhe konkretisht në nenet 21, 38, dhe 39 si dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij. Nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes ky problem vazhdon të zgjidhet nëpërmjet: a) Rritjes së fondit të dhënies së kredive për strehim nga buxheti i shtetit, i cili deri tani ka qënë i kufizuar. Për vitin 2008 shuma e fondit të parashikuar ishte 100 milion lekë. Kjo shumë është e pamjaftueshme për plotësimin e nevojave të ushtarakëve në krahasim me numrin e shumtë të kërkesave për strehim. Për këtë u sugjerua rritja e fondit të kredisë për strehim për ushtarakët e Forcave të Armatosura.

b) Nëpërmjet kompensimit të qerave të banesave. Nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm është nxjerrë urdhëri për ngritjen e komisioneve pranë Komandave përkatëse për testimin e tregut të qirave të banesave. Më pas u ngrit Komisioni Qëndror në Ministrinë e Mbrojtjes, u ra dakort me Ministrinë e Financave lidhur me vlerën e qirasë dhe në të njëjtën

kohë u miratua fondi prej 85.000.000 lekë për këtë qëllim. Nga kjo përfituan rreth 500 ushtarakë aktiv. Për këtë vit janë bërë propozimet përkatëse për të përcaktuar çmimin mesatar të qirasë së banesës i cili sipas gërmës “c” të pikës 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 524 datë 30.07.2004, përcaktohet çdo vit.

c) Strehimit të ushtarakëve në ambiente të cilat dalin të lira nga ristrukturimi i Forcave të Armatosura. Në kuadër të përpjekjeve të vazhdueshme të Institucionit të Avokatit të Popullit, për përmirësimet që duhen bërë në këtë fushë më 30 Dhjetor 2008 është përsëritur rekomandimi për plotësimin e kërkesave të nenit 39 të Ligjit Nr. 9210, datë 23.03.2004 “Për Statusin e Ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, që bën fjalë për daljen e një Vendimi të Këshillit të Ministrave për të përcaktuar kriteret e përfitimit nga ushtarakët të së drejtës së parablerjes për objektet (bashkë me trojet funksionale), të dala të lira nga ristrukturimi i Forcave të Armatosura dhe që mbeten pronë e shtetit për nevoja për strehim. Dalja e një vendimi të tillë ishte parashikuar brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit. Por ndonëse ka kaluar një kohë e gjatë, rreth katër vjet që ligji ka hyrë në fuqi, një vendim i tillë ende nuk ka dalë.

2. Për problemin e trajtimit me ushqim. Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 88 datë 28.01.2008 “Për miratimin e normave të trajtimit me ushqim të efektivave ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, u përcaktua rritja e normave të ushqimit të efektivave ushtarakë. Në zbatim të këtij vendimi kanë dalë edhe aktet nënligjore zbatuese siç është urdhri nr. 388, datë 13.03.2008 i Ministrit të Mbrojtjes “Për trajtimin me ushqim të efektivave ushtarak të F.A. të Republikës së Shqipërisë” si dhe urdhri nr. 324, datë 27.03.2008 i Komandës së Forcës së Bashkuar, “Për trajtimin me ushqim të efektivave ushtarakë të Forcës së Bashkuar”.

3. Për problemin e normave të veshmbathjes nga Drejtoria e Logjistikës çdo vit rinovohet urdhri i Ministrit të Mbrojtjes për përmirësimin e normave të veshmbathjes. Në tabelat e reja për oficerët e trupës e të shtabeve janë përmirësuar normat e veshmbathjes, veçanërisht në drejtim të cilësisë së saj.

4. Lidhur me ankesat për kohën e punës dhe pushimit, Drejtoria e Operacioneve dhe Stërvitjes në Shtabin e Përgjithshëm, për të realizuar pushimet në ditët e shtuna ka bërë ndryshimin e programit stërvitor për vitin 2008, duke kaluar nga katër cikle stërvitore në tre cikle stërvitore, me qëllim që të garantohet pushimi i ushtarakëve. Mbas çdo cikli stërvitor kryhen 15 ditë pushim.

5. Shtetasi F.L. nga Durrësi ka prezantuar pranë nesh ankesën e tij, pasi djali i tij D.L. ishte thirrur në shërbimin e detyrueshëm ushtarak në kundërshtim me ligjin, sepse familja e tij ishte në gjendje të rëndë

ekonomike. Zyra jonë pas pranimit të ankesës dhe verifikimeve të nevojshme i kërkoi shpjegime Drejtorisë së Personel Organizimit pranë Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Në përfundim u njoftuam se për ushtar D.L. ka dalë urdhëri për ndërprerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak. Të kësaj natyre janë edhe 17 ankesa të tjera të cilat u paraqitën gjatë ditëve të hapura. Në dy raste të tjera për ankuesit ka dalë urdhëri i shefit të Shtabit të Përgjithshëm për ndërprerje të shërbimit të detyrueshëm ushtarak.

6. Në Brigadën e Stërvitjes në Bunavi, një numër i konsiderueshëm i efektivit u ankuan se nga ana e komandës së repartit nuk organizohej shërbimi shëndetësor sipas kërkesave dhe nevojave të tyre. Po kështu të kësaj natyre ishin edhe ankesat e bëra nga efektivit i repartit nr.1101, Vau i Dejës në Shkodër të cilët u ankuan kundër mjekut të repartit i cili kishte shfaqje të theksuar të neglizhencës në dhënien e shërbimit shëndetësor. Për këto raste zyra jonë ka hyrë në një dialog konstruktiv me komandat e reparteve, të cilat kanë shpjeguar se këto janë raste të veçuara dhe se janë duke marrë masa për përmirësimin e gjendjes.

7. Ankesat e ushtarakëve apo ish ushtarakëve që ndërpresin karrierën apo e kanë ndërprerë atë kohë më parë në kuadrin e reformës në Forcat e Armatosura qysh nga viti 1992 e në vazhdim zënë një vend të konsiderueshëm. Këta persona ankohen jo vetëm që masa e pensionit të tyre është më e ulët se pensioni i kolegeve të tyre që kanë dalë në pension pas vitit 1993, edhe pse kanë qenë të barazvlefshëm në detyrë, por ata kundërshtojnë edhe iniciativën e Qeverisë, për të ndryshuar ligjin nr. 9418, datë 20.05.2005 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”. Kërkesa apo ankesa të kësaj natyre kanë paraqitur jo vetëm individë të caktuar, por edhe shoqata e grupime të tjera ish ushtarakësh. Mbi bazën e kërkesës së Shoqatës Kombëtare të Ushtarakëve në rezervë të Shqipërisë Avokati i Popullit studjoi projekt ligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9418, datë 20.05.2005” Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili ndodhej për shqyrtim e miratim në Kuvendin e Shqipërisë. Me shkresën nr. 160, datë 07.07.2008 Avokati i Popullit mendimet e tij ia parashtrroi Kryetarit të Komisionit Parlamentar për Çështjet ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, Kryetarit të Komisionit për Ekonominë dhe Financat si dhe Kryetarit të Komisionit për Sigurinë Kombëtare. Dihet që kjo çështje vazhdon të mos gjejë zgjidhjen e duhur.

8. Ka edhe ankesa të tilla si ajo e shtetasit F.S, i cili është ankuar se jo vetëm është larguar padrejtësisht nga puna, por se i është mohuar edhe e drejta për të marrë me shkrim një vendim të largimit nga puna. Kurse E.C. ka pretenduar se ka punuar prej një kohe të gjatë oficer aktiv,

por nuk i japin me shkrim urdhrin e lirimit nga detyra. Ushtaraku Z.G. në kohën që do të gradohej në vitin 2005, megjithëse nuk kishte mbushur kohën për të avancuar në gradë është marrë në shqyrtim, por për këtë nuk ka marrë asnjë njoftim. Në përfundim, në vitin 2008 atij i refuzohet e drejta për të shqyrtuar kërkesën për avancim në gradë, me arsyetimin se mundësia e shqyrtimit të avancimit në gradë është vetëm dy herë. Pavarësisht se është e drejta e Komisionit të Lartë të Karrierës, i cili ka autoritetin për vlerësimin e ushtarakut për të përparuar në gradë, ne mendojmë se në përzgjedhjen e efektivit për të nxjerrë në rezervë duhet të ketë më shumë qëndrime objektive e të vlerësohen më tepër edhe të drejtat e ushtarakëve.

9. Numri i përgjithshëm i ankesave të ardhura për vitin 2008, kundër Komisionit të Statusit të Veteranit dhe Dëshmorit të Atdheut ka qenë 8 ankesa.

Vendimi i K.M. nr. 748 datë 11.11.2004 “Për një ndryshim në vendimin nr. 190, datë 03.05.1995 “Për Statusin e Veteranit të Luftës Antifashiste Nacional - Çlirimtare të Popullit Shqiptar” ka caktuar që Komisioni Qëndror dhe stafi i tij teknik, të vazhdojnë veprimtarinë deri më 31.12.2006, vetëm për personat që e fitojnë këtë status me vendim gjykatë të formës së prerë. Krahas mundësisë që i dha vendimi i mësipërm i Këshillit të Ministrave ankuesve lidhur me përfitimin e statusit nëse plotësoheshin kërkesat e parashikuara në aktet ligjore për këtë qëllim, edhe zyra e Avokatit të Popullit u angazhua totalisht në ndihmë të ankuesve, të cilëve ju rekomandoi që të kundërshtonin vendimin administrativ që kishte bërë refuzimin e statusit të tyre. Për këtë, në disa raste ju kemi përgatitur ankuesve modelin tip të kërkesë padisë për kundërshtim akti-administrativ. Por nga ana e veteranëve që pretendonin se ishin të tillë, nuk u bënë përpjekjet e duhura ligjore për të marrë statusin e pretenduar. Tani ata vazhdojnë ta kërkojnë atë, ndonëse me vendim të Këshillit të Ministrave veprimtaria e Komisionit për Statusin e Veteranit është mbyllur që në 30 Korrik 2002.

10. Nga viti në vit janë grumbulluar gjithsej 491 dosje me kërkesa për dhënien e statusit të Dëshmorit të Atdheut, të cilat prisnin mbledhjen e Komisionit përkatës për të shqyrtuar kërkesat, por ende edhe sot një pjesë e mirë e këtyre ankesave kanë ngelur pa u shqyrtuar nga Komisioni.

Nga verifikimet tona të bëra kohët e fundit rezulton se, kanë mbetur ende rreth 268 dosje pa u shqyrtuar. I është kërkuar Zv.kryeministrit që të përshpejtohet puna për shqyrtimin e këtyre dosjeve në një kohë sa më të shkurtër, duke bërë mbledhje më të shpeshta të Komisionit.

11. Një prioritet i rëndësishëm i punës së Avokatit të Popullit në vazhdimësi ka qenë zgjidhja e ankesave të ushtarakëve aktiv në lidhje me trajtimin e tyre financiar. Duke marrë shkas nga ankesat e grumbulluara



në Ditët e Hapura për problemin e trajtimit financiar të ushtarakut të Forcave të Armatosura (paga e pamjaftueshme), veçanërisht për pagat e ulta dhe shtesat mbi pagë për dëmtim shëndeti u bë e mundur që, në zbatim të urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes, nr. 535, datë 23.04.2007, “Për krijimin e grupit të punës për rishikimin e trajtimit me pagë e shtesë mbi pagë të ushtarakëve dhe studimin e pagave të nëpunësve sipas strukturës së pagës së institucioneve në varësi të Ministrisë së linjës”, grupi i punës ka përgatitur katër tabela pagash sipas të cilave përafrohet pagesa e ushtarakut aktiv të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë me ato të vëndeve të N.A.T.O. Pritet miratimi nga Këshilli i Ministrave.

Gjatë punës së saj, Njësia e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës dhe ndëshkimeve të tjera çnjerëzore ka bërë disa inspektime. Në përfundim të tyre ka bërë rekomandimet për përmirësimin e kushteve për trajtimin e ushtarakëve të dënuar me masë "ndalim disiplinor" si më poshtë:

<b>Kujt i drejtohet</b>	<b>Data e dërgimit</b>	<b>Përfundimi</b>
Reparti Ushtarak Nr.1100 Zall Herr, Komandantit të Brigadës të Reagimit të Shpejtë Gjeneral Brigade Viktor Bërdo	26.09.2008	Rekomandimi është pranuar. Nga verifikimi në vend u konstatua se rekomandimet e bëra janë zbatuar.
Reparti Ushtarak Nr.12000 Zall-Herr, Komandantit të Regjimentit Komando, Kolonel Xhemal Gjunkshi	14.10.2008	Rekomandimi është pranuar. Në përgjigjen e saj komanda sqaron se janë marrë masat për plotësimin e standardeve të rekomanduara.
Komandantit të Brigadës së Stërvitjes Baza Bunavi, Kolonel Drini Nikolla	13.11.2008	Rekomandimi është pranuar. Në përgjigjen e saj komanda sqaron se janë marrë të gjitha masat për realizimin në praktikë të rekomandimeve.

Gjithashtu Avokati i Popullit kreu me iniciativën e tij më datë 22.10.2008 një inspektim në Repartin Ushtarak Nr.1101 Vau Dejës për respektimin e të drejtave të ushtarakëve dhe trajtimin e tyre. Konstatuam se në Brigadën e Reagimit të Shpejtë kishte vlerësim dhe rregullorja përkatëse zbatohet në të gjitha kërkesat. Godina ku ndodheshin ambientet e ndalimit disiplinor ishte e ndërtuar rishtazi. Ambienti i ndalimit disiplinor ndahej në dy dhoma, secila me tualet më vete. Njëra nga dhomat shërbente për fjetje dhe tjetra për qëndrimin dhe ajrosjen e ushtarakut gjatë ditës. Këto dhoma ishin të pajisura me tavolina dhe

karrige. Gjithashtu ishin të afishuara disa nga të drejtat e ushtarakut. Rregullorja e jetës së brendshme dhe Rregullorja “Për organizimin e komisionit disiplinor dhe procedurat për dhënien, ekzekutimin e administrimin e masave disiplinore për ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”. Mendojmë se plotësimi i kushteve të lartpërmendura, përveç se është një detyrim ndikon pozitivisht në edukimin e ushtarakëve me respektin për disiplinën dhe rregullin në jetën dhe veprimtarinë e repartit.

Në prioritetet e Punës së Institucionit të Avokatit të Popullit edhe për vitin 2009 do të jetë organizimi i Ditëve të Hapura dhe inspektimeve me grup ekspertësh në reparte të ndryshme, të Forcave Tokësore, Ajrore dhe Detare me qëllim tërheqjen e ankesave nga ushtarët, nënoficerët dhe oficerët e Forcave tona të Armatosura si dhe bashkëpunimi më i ngushtë me Drejtoritë e ndryshme në Ministrinë e Mbrojtjes dhe strukturat e tjera ushtarake për zbatimin korrekt të ligjit dhe zgjidhjen e drejtë të ankesave të ushtarakëve apo edhe të punonjësve civilë që punojnë në Forcat tona të Armatosura.

Është kënaqësi të përsërisim konstatimin tone se Ministria e Mbrojtjes është një nga dikasteret e Administratës sonë Publike ku me përjashtim për pak raste, por në përgjithësi, kemi gjetur partnerë të gatshëm për të bashkëpunuar në mënyrë institucionale, me qëllimin e mirë dhe të vetëm për zgjidhjen e drejtë të problemeve dhe shqetësimeve të ushtarakëve.

Bashkëpunimi i mirë me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm është realizuar në kontaktet direkte me drejtues dhe specialistë të drejtorive përkatëse, të ngarkuara për problemet dhe shqetësimet e ankesave të ushtarakëve dhe të veteranëve. Këtij qëllimi i kanë shërbyer edhe informacionet e dërguara Ministrit të Mbrojtjes ku parashtrijmë ankesat dhe problemet e pazgjidhura.

## 7. Ministria e Financave

Numri i ankesave, kërkesave dhe njoftimeve drejtuar Avokatit të Popullit nga shtetas dhe persona juridikë për shkeljen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të tyre nga administrata financiare, ku përfshihen Ministria e Financave, organet doganore, tatim-taksat, Agjencia Kombëtare e Privatizimit, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe bankat është 186. Nga ky numër, 17 ankesa i janë adresuar Ministrisë së Financave si institucion, 2 ankesa Degëve të Drejtorive Doganore në rrethe, 14 i janë adresuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Degëve të Tatim-Taksave në rrethe, 2 ankesa ndaj Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, 147 ankesa për Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe 4

ankesa për Bankat e nivelit të dytë dhe Bankës Kombëtare të Shqipërisë. Krahas këtyre ankesave gjatë vitit 2008 janë përfunduar edhe 51 ankesa të mbartura nga viti 2007, nga të cilat 10 kanë qenë të pabazuara, 16 kanë qenë jashtë juridiksionit, 13 kanë qenë jashtë kompetence, 4 ankesa janë zgjidhur në favor, 3 ankesa janë arkivuar pasi ankuesit kanë hequr dorë nga shqyrtimi i mëtejshëm i ankesës së tyre, dhe nga 5 ankesa të trajtuara me rekomandim 4 prej tyre kanë rezultuar të zgjidhura pozitivisht ndërkohë që 1 nuk është pranuar.

\*  
\*      \*

Për vetë Ministrinë e Financave, kemi pasur gjithsej 17 ankesa. Nga këto, 3 ankesa kanë qenë të pabazuara, 4 kanë rezultuar jashtë juridiksionit të Institucionit të Avokatit të Popullit, 5 ankesa janë konsideruar me mungesë kompetence, 1 ankesë është zgjidhur në favor që në fazën e parë të ndërhyrjes dhe verifikimit, 1 ankesë është zgjidhur në favor pas paraqitjes së rekomandimit përkatës nga Avokati i Popullit, dhe 3 ankesa rezultojnë të jenë ende të hapura për trajtim.

Në lidhje me ankesat e drejtuara këtij institucioni, do të trajtojmë dy prej tyre, për të cilat është ndërhyrë me rekomandim nga ana e zyrës së Avokatit të Popullit.

1. Kështu konkretisht pranë Avokatit të Popullit u paraqitën një grup gazetarësh si përfaqësues të medias së shkruar, të cilët prezantuan shqetësimin e tyre lidhur me Urdhërin Nr. 18, datë 17.01.2008 të Ministrit të Financave, “Për numrin e të punësuarve në median e shkruar”.

Urdhëri në fjalë, sipas ankuesve prekte në mënyrë direkte interesat e subjekteve të shtypit që ata drejtonin, pasi përveç paligjshmërisë juridike të aktit të nxjerrë nga ana e Ministrit, ky urdhër mund të përdorej si presion ndaj medias, duke ngarkuar në mënyrë selektive me përgjegjësi ligjore dhe duke çuar në arbitraritet mekanik vetëm media të edituara që kritikojnë Qeverinë.

Duke parashtruar të gjitha sqarimet e gazetarëve për këtë çështje, Institucioni i Avokatit të Popullit kërkoi shpjegime nga Ministri i Financave, dhe në informacionin e ardhur për këtë qëllim sqarohet se dalja e këtij urdhëri ishte në vijim të një procesi reforme pune të Ministrisë së Financave. Në kuadër të angazhimeve të marra nga pala shqiptare në Memorandumin e Politikave Ekonomike dhe Fiskale me FMN-në, një ndër objektivat strukturore ishte: “Rritja e numrit të taksapaguesve të kontributeve të sigurimeve shoqërore deri në 410 mijë.” Prandaj, ky urdhër i Ministrit të Financave, (gjithmonë sipas qëndrimit të këtij Institucioni), përbënte një akt administrativ të tij, për një strukturë të caktuar në varësi të tij siç ishte Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për

të përcaktuar një metodologji të caktuar gjatë ushtrimit të kontrolleve të organeve tatimore në evidentimin e saktë të numrit të të punësuarve në një sektor të caktuar siç është rasti i medias së shkruar.

Ky urdhër, thuhej në informacionin e dhënë nga Ministri i Financave, nuk ishte publikuar në Fletoren Zyrtare, dhe si i tillë, ishte i detyrueshëm për zbatim vetëm nga administrata tatimore.

Institucioni i Avokatit të Popullit vërejti se në Urdhërin me Nr. 18, datë 17.01.2008 të Ministrit të Financave, mungonin arsyetimi i qartë mbi bazën e cilit ligj kishte dalë apo zbatohet urdhëri përkatës.

Duke studjuar urdhërin në fjalë dhe përgjigjen përkatëse, Zyra e Avokatit të Popullit konkludoi se nga pikëpamja formale, Urdhëri rezultonte të kishte dalë në përputhje me nenin 102, pika 4 dhe nenin 119, pika 1 të Kushtetutës, dispozita këto që legjitimonin Ministrin të nxirrte urdhëra me karakter të brendshëm drejtuar njësive administrative që vareshin prej tij. Për më tepër, duke u bazuar në sqarimin e dhënë nga Ministri i Financave lidhur me qëllimin e urdhërit, që ishte ai i përcaktimit të një metodologjie nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve gjatë ushtrimit të kontrolleve të organeve tatimore, në funksion të detyrës së këtyre të fundit, në pamje të jashtme urdhëri dukej i bazuar.

Por, duke iu referuar menyrës se si ishte shkruar ky akt, duke filluar nga titulli i tij, dhe se si detyrohej Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të kryente kontrollet ndaj medias së shkruar, të krijohej përshtypja e tejkalimit të kompetencave nga ana e Ministrit të Financave. Së pari, duke pasur parasysh që urdhëri kishte dalë vetëm për median e shkruar, nuk rezultonte që ai të ishte nxjerrë në bazë apo zbatim të ligjit, “Për procedurat tatimore etj” pasi nuk rezultonte të kishte ndonjë ligj ku të përcaktohej apo të kushtëzohej që media e shkruar të deklaronte një numër fiks punonjësish të punësuar me rrogë fikse pranë saj.

Së dyti, duke detyruar Drejtorinë e Përgjithshme të zbatonte këtë urdhër gjatë ushtrimit të kontrolleve të saj, për rrjedhojë dilte që kërkohej respektimi i urdhërit të nxjerrë edhe nga subjektet e medias, të cilat nuk ishin njësi administrative të varura prej Ministrit të Financave. Kjo binte në kundërshtim me pikën 2 të nenit 119 të Kushtetutës, sipas të cilit: “Këto akte nxirren në bazë të ligjit dhe nuk mund të shërbejnë si bazë për të marrë vendime në lidhje me individët dhe subjektet e tjera”. Urdhëri i mësipërm, në mënyrën se si ishte formuluar kushtëzonte dhe përcaktonte rregulla për subjektet private.

Në këtë kuptim, duke u bazuar në qëllimin e mirë të urdhërit për përcaktimin e metodologjisë që duhej ndjekur nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve gjatë kontrolleve që ajo ushtronte ndaj subjekteve private të caktuara, siç ishte në këtë rast media e shkruar, Avokati i Popullit i rekomandoi Ministrit të Financave ndryshimin e Urdhërit Nr. 18 datë 17.01.2008 “Për numrin e të punësuarve në median e

shkruar”, në përshtatje me qëllimin e tij, duke nxjerrë një Udhëzim që të ishte me formë juridike më korrekte për rregullimin e problemit në fjalë.

Kjo gjë duhej bërë pasi, punonjësit tatimorë paraqisnin urdhërin e Ministrit të Financave si akt më vete përpara subjekteve të medias, duke e prezantuar atë si të detyrueshëm apo të pakundërshtueshëm, dhe jo thjesht si *një metodologji të caktuar gjatë ushtrimit të kontrolleve të tyre në evidentimin e saktë të numrit të të punësuarve në një sektor të caktuar*. Shifrat e dhëna në këtë urdhër mund të ishin orjentuese për punonjësit tatimorë gjatë kontrolleve që ata u bënë mediave të ndryshme të shkruara, por nuk mund të ishin taksative që të përcaktonin detyrimisht numrin e të siguruarve pranë këtyre mediave.

Ne jemi në pritje të një përgjigjeje nga ana e Ministrit të Financave lidhur me qëndrimin e tij për këtë problem. Gjithësesi nga Mediat nuk ka patur më ankesa.

2. Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit u paraqit ankesa e qytetarit Gj.T., ish nëpunës i nivelit drejtues në Ministrinë e Financave. Ankuesi ka paraqitur shqetësimin e tij, lidhur me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe moszbatimin e vendimit të Komisionit të Shërbimit Civil Nr.87 datë 24.02.2006, i cili ishte lënë në fuqi me vendimin Nr.447 datë 17.04.2007 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Nga verifikimet e bëra për këtë ankesë rezultoi se ankuesi kishte kryer detyrën e Sekretarit të Përgjishëm në Ministrinë e Financave, deri kur me Urdhërin e Ministrit Nr.524/2 datë 31.01.2006 ishte vendosur *“largimi nga shërbimi civil”*, me motivacion *“moskryerje si duhet e detyrave të tij funksionale”*.

Në rastin konkret përveç se kishim një vendim të Komisionit të Shërbimit Civil, i cili ishte ende i pa zbatuar, por kishim dhe një vendim të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili kishte lënë në fuqi vendimin Nr.87 datë 24.02.2006 të Komisionit të Shërbimit Civil, për ekzekutimin e të cilit nuk ishte marrë asnjë masë procedurale.

Në përputhje me pikën 2, të nenit 15, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, organet e pushtetit publik në përmbushje të detyrave të tyre, duhej të respektonin të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribonin në realizimin e tyre.

Për sa më sipër, ne paraqitëm rekomandimin për marrjen e masave për rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur ndaj ankuesit Gj. T., duke zbatuar vendimin Nr.87 datë 24.02.2006 të Komisionit të Shërbimit Civil, i cili kishte vendosur kthimin e ankuesit në pozicionin e mëparshëm të punës, pagimin e pagës për gjithë periudhën e qëndrimit pa punë padrejtësisht, duke filluar nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare, deri në ekzekutimin e këtij vendimi, vendim i cili ishte lënë në fuqi me vendimin Nr.447 datë 17.04.2007 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit u dërgua në vijim edhe një kërkesë tjetër për zbatim të rekomandimit, por nga ana e Ministrisë të Financave nuk ka pasur asnjë përgjigje për këtë problem. Kohët e fundit ankuesi na informoi se i ishte ofruar një vend tjetër pune, por jo ai ku ai ishte hequr padrejtësisht.

#### **a) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Degët në varësi të saj**

Për organin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve më vete, kemi pasur gjithsej 11 ankesa. Nga këto 2 ankesa kanë rezultuar të pabazuara, 2 ankesa janë konsideruar me mungesë kompetence, 2 janë zgjidhur në favor të ankuesve që në fazën e parë të ndërhyrjes së Institucionit të Avokatit të Popullit. Kurse 5 ankesa janë pranuar pjesërisht dhe janë zgjidhur në favor pas paraqitjes së rekomandimeve përkatëse nga Avokati i Popullit.

Për degët e organeve tatimore në rrethe kemi pasur 3 ankesa, nga të cilat 1 ankesë ka rezultuar jashtë juridiksionit, një ankesë në mungesë të kompetencës, 1 ankesë është zgjidhur në favor të ankuesit që në fazën e parë të ndërhyrjes së Avokatit të Popullit. Më hollësisht paraqiten rastet e trajtuara me rekomandime si më poshtë vijojnë:

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit u paraqitën 5 ankesa, në të cilat ankuesit, pretendonin se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ishte bërë pengesë në ekzekutimin e plotë të vendimeve gjyqësore të formës së prerë që ata dispononin. Në mbështetje të pretendimeve të tyre, ankuesit dispononin vendimet analoge të Gjykatës së Apelit Tiranë, si dhe të Kolegjit Civil në Gjykatës së Lartë, të cilët kishin lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Shërbimit Civil me anë të të cilit urdhërohej Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve: "... ti paguante ankuesit/ankueses pagën për gjithë kohën e qëndrimit pa punë...", që nga data e ndërprerjes padrejtësisht të marrëdhënieve të punës.

Në përgjigje të kërkesave për shpjegime që Zyra e Avokatit të Popullit i drejtoi për çdo ankesë të paraqitur pranë saj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, kjo e fundit përgjigjej zyrtarisht se kishte marrë të gjitha masat për zbatimin e vendimeve të mësipërme konform ligjeve në fuqi.

Institucioni ynë, me besimin e plotë që përgjigja e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ishte zyrtare, i konfirmoi faktin e mësipërm ankuesve duke i orjentuar të paraqiteshin pranë saj për realizimin e të drejtës së tyre. Në kundërshtim me këtë fakt, ankuesit kanë ripërsëritur pranë nesh pretendimet e tyre pas pak ditësh, pasi nga Zyra Juridike e Institucionit në fjale u ishte thënë se "pagesa që u takonte ishte xhiruar në llogarinë bankare që dispononin". Ndërkohë që zyra e financës kishte

mohuar të kishte kryer veprimet përkatëse për këtë llogari. Në vijim të kësaj të fundit, ankuesit sqaruan se kërkesës së tyre për pagimin e pagës për periudhën e mbetur pa punë, duke përfshirë edhe rritjen që mund t'i ishte bërë asaj gjatë kësaj periudhe si edhe detyrimin e punëdhënësit për të paguar kontributet në bazë të ligjit për sigurimet shoqërore, shëndetësore, suplementare dhe tatimin mbi të ardhurat, Drejtori Juridik i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, i ishte përgjigjur negativisht.

Duke marrë shkas nga këto ankesa që u paraqitën pranë Institucionit të Avokatit të Popullit me të njëjtin objekt ankimi, si dhe duke qenë të bindur se nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve po veprimeve në kundërshtim me ligjin (*duke qenë se vendimet e mësipërme ende nuk kishin gjetur zbatim*), për këto çështje u vijua me rekomandimet përkatëse. Në këtë kuptim, Institucioni i Avokatit të Popullit i rikujtoi drejtuesit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Ligjin me Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar me ligjin Nr. 9768, datë 09.07.2007, dhe nenin 6 të tij ku përcaktohej se: “*Sigurimet Shoqërore mbrojnë në mënyrë të detyrueshme gjithë shtetasit ekonomikisht aktivë në Shqipëri, ...*”. Në vijim të ligjit të mësipërm, në nenin 9 përcaktohej gjithashtu se: “*Personat e punësuar dhe punëdhënësit e tyre janë të detyruar të paguajnë kontribut për sëmundje, dhe pensione në një shumë që varet nga paga e tyre totale (bruto)*”, si dhe nenin 79 të tij ku citohej se: “*Punëdhënësi është i detyruar: ... – të bëjë sigurimin nga dita që i punësuar fillon punë...*” Pra në këtë kontekst, në rast se ankuesve u njihej e drejta të përfitonin pagën e dy viteve të mbetura pa punë, sipas vendimeve të gjykatave, atëherë shuma e përcaktuar si pagesë i legjitimonte ata si persona ekonomikisht aktiv, që të përfitonin një pagë të rregullt nga një marrëdhënie e rregullt pune. Në rast të kundërt, një pagesë e përftuar pa ndalesat për sigurimet shoqërore, shëndetësore, suplementare dhe tatimin mbi të ardhurat, nuk ishte tjetër veç se një punë në të zezë, e cila në rrugë ligjore duhej të ndalohej dhe penalizohej.

Në këtë kuptim, vetë përcaktimi i vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Apelit Tiranë, ku thuhej se: “*ti paguajë ankuesit/ankueses pagën për gjithë kohën e qëndrimit pa punë...*”, nënkuptonte gjithashtu pagën që rridhte nga një marrëdhënie e rregullt pune, dhe mospagimi i kontributeve të detyrueshme në bazë të ligjit të sipërcituar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 557, datë 16.08.2006, nuk ishte gjë tjetër veç se një interpretim personal dhe jo ligjor i vendimit gjyqësor të formës së prerë nga ana e Institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Po në këto rekomandime, Avokati i Popullit argumentoi se periudha e qëndrimit pa punë të ankuesve, jo për faj të tyre siç rezultonte dhe nga vendimet gjyqësore të formës së prerë, quhej periudhë e siguruar dhe përfshihej në vjetërsinë e punës së ankuesve si nëpunës të Drejtorisë së

Përgjithshme të Tatimeve, për efekt pensioni. Nocioni i pagës së nëpunësit civil (neni 18 i ligjit “Statusi i Nëpunësit Civil”) dhe nocioni i pagës bruto, e cila ishte paga bazë sipas përcaktimit të nenit të sipërcituar dhe pagesa e kontributeve që duhej të paguante punëdhënësi për llogari të punëmarresit, ishte sqaruar dhe përcaktuar qartë në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar me ligjin Nr. 9768, datë 09.07.2007, si në VKM, nr. 557, datë 16.08.2006.

Në rrethana të tilla, zyra e Avokatit të Popullit kërkoi vullnetin dhe predispozicionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për respektimin dhe zbatimin e ligjit në drejtim të mbrojtjes së lirive themelore të shtetasve. Për te kontribuar në këtë drejtim Institucioni i Avokatit të Popullit shpjegoi gjithashtu se kishte për detyrë të parandalonte proceset gjyqësore të panevojshme. Orjentimi i dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve që ankuesit ti drejtoheshin gjykatës përsëri për të shkruar me fjalë të tjera atë që shpjegohet qartë në vendimet e tyre dhe që sqarohet në aktet ligjore dhe nënligjore të përshkruara më sipër, u gjykua si i pavënd nga zyra jonë.

Kështu u argumentua në vijimësi se, po veprimeve në kundërshtim me Nenin 142 paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhej se “*Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore*”. Në këtë kontekst nënvizuam gjithashtu faktin se vendimet gjyqësore të formës së prerë nuk duheshin konsideruar si çështje dëshire, si dhe nuk mund të interpretoheshin në menyrë subjektive nga askush, por duheshin konceptuar si detyrime ligjore për tu respektuar me përpikmëri nga të gjithë drejtuesit e institucioneve shtetërore.

Gjithashtu, u analizua se mosveprimi nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, binte ndesh edhe në aktet ndërkombëtare e konkretisht me Nenin 6/1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Kështu e drejta për një proces të rregullt ligjor do të ishte iluzion, nëqoftëse rendi juridik i një shteti anëtar të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut do të lejonte që ky vendim gjyqësor me karakter përfundimtar dhe të detyrueshëm do të mbetej pa u zbatuar në dëm të ndonjërit nga palët. Sipas kësaj dispozite ligjore, mos ekzekutimi i vendimeve gjyqësore e bënte mjetin ankimor gjyqësor të paefektshëm në rezultat.

Po në këtë kuptim, Zyra jonë komunikoi edhe verbalisht me Drejtorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Por Drejtori, jo vetëm që nuk pranonte t’i rikthente në punë ankuesit, por duke qenë se disa prej tyre kishin filluar punë në vende të tjera, insistonte që të zbatonte vetëm pjesërisht vendimet e gjykatës, duke u mohuar ankuesve që së bashku me pagimin e pagës së munguar për kohën e mbetur pa punë, t’u paguante dhe sigurimet përkatëse shoqërore



e shëndetësore, plus diferencat në rritje që i ishin bërë ndërkohë pagës nga momenti i largimit nga puna.

Për këtë rast, Zyra e Avokatit të Popullit iu drejtua në vijim edhe Ministrit të Financave duke i kërkuar këtij të fundit: ushtrimin e autoritetit të Ministrit për të udhëzuar administratën e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për zbatimin korrekt të rekomandimeve të dërguara nga Zyra e Avokatit të Popullit. Nga Ministria e Financave u informuam se për këtë çështje ishin marrë të gjitha masat e duhura administrative dhe financiare nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për të përmbushur me përpikmëri dispozitivin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Por Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, vazhdoi në pozicionimin e saj lidhur me ekzekutimin e pjesshëm të vendimeve gjyqësore që dispononin ankuesit.

Institucioni i Avokatit të Popullit, duke konsideruar këtë qëndrim krejt të pabazuar dhe të paligjshëm nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në përfundim të përpjekjeve për plotësimin e të drejtave të qytetarëve, i orientoi ankuesit që për një ekzekutim të rregullt të vendimeve gjyqësore dhe në përmbushje të të drejtave që iu takonin me ligj lidhur me përfitimin e gjithë kohës së qëndrimit pa punë, t'i drejtoheshim sërish Gjykatës së Apelit Tiranë për sqarim dhe interpretim të vendimit në bazë të nenit 314 të Kodit të Procedurës Civile.

#### **b) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Degët në varësi të saj**

Për këtë organ së bashku me degët e rretheve kemi pasur gjithsej 2 ankesa. Të dy këto ankesa janë zgjidhur në favor të ankuesve, pas rekomandimeve që u ka drejtuar Institucioni i Avokatit të Popullit autoriteteve doganore në qendër dhe në rreth.

Ankesat në fushën doganore, kryesisht prezantojnë si objekt të tyre mungesën e informacionit, aplikimin e mënyrave selektive gjatë zhdoganimit të mallrave dhe zbatimin jo të rregullt të procedurave të përcaktuara me ligj për këtë qëllim, si në rastin e mëposhtëm:

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, u paraqit ankesa e qytetarit A. Sh., në cilësinë e administratorit të subjektit "SHAMKU", i cili pretendonte për bllokim të padrejtë të mallit të tij nga ana e Degës së Doganës Durrës.

Nga dokumentacioni bashkëngjitur ankesës rezultoi se subjektit "SHAMKU" i ishte bllokuar malli më datën 20.02.2008, për shkak të një borxhi të vjetër të vitit 2000 që kishte pasur bashkëshortja e tij, znj. L. Sh. administratore e një subjekti tjetër me emrin "LULE SHAMKU". Sipas Degës së Doganës Durrës, ky veprim ishte bërë pasi ishte konstatuar se

realisht debitorja kryesore ishte bashkëshortja e A. Sh., pavarësisht se subjektet nën administrimin e secilit ishin të ndryshme.

Zyra e Avokatit të Popullit e pa të arsyeshme të rekomandonte gjetjen e mjeteve ligjore dhe juridikisht të vlefshme për detyrimin e debitorës L. Sh., të paguante kundrejt Degës Doganore Durrës, dhe ç`bllokimin e mallit të bllokuar padrejtësisht prej kaq kohësh të një subjekti juridik tjetër, i cili nuk mbarte asnjë përgjegjësi për detyrime të pashlyera në drejtim të autoriteteve doganore. Ky subjekt rezultonte të ishte në mënyrë absolute i rregullt kundrejt gjithë detyrimeve të paguara deri në fund në drejtim të Degës së Doganës Durrës.

Në përgjigje të rekomandimit të Avokatit të Popullit, Dega e Doganës Durrës informoi se subjektin “SHAMKU” i ishin kryer procedurat doganore dhe ishte lënë i lirë për të kryer zhdoganimin e mallit.

### **c) Agjensia Kombëtare e Privatizimit**

Për vitin 2008 ka pasur 2 ankesa ndaj Agjencisë Kombëtare të Privatizimit. Nga këto 1 është konsideruar jashtë kompetence dhe 1 është zgjidhur në favor të ankuesit.

Ankesat e këtij viti, kishin të bënin kryesisht me zgjatjen e afatit për pranimin e dokumentacionit nga ky organ, lidhur me procedurat e njohjes si aksioner gjatë privatizimit të shoqërisë Alb-Telekom. Më vonë doli se për këtë problem ka pasur dhe shumë ankesa të tjera. Avokati i Popullit pas studimit të kujdesshëm të të gjitha pretendimeve të qytetarëve, sqaroi se autoriteti kompetent për zgjatjen e këtij afati ishte Ministri i Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës. Zyra e Avokatit të Popullit iu drejtua AKP-së, dhe Ministrisë të METE-s. Si përfundim afatet kohore për dorëzimin e dokumentacioneve në fjalë u shtynë.

Një informacion më të plotë me ankesa më të detajuara për këtë problem, përshkruhet në pjesën më vete për ankesat drejtuar Shoqërisë Alb-Telekom.

### **d) Instituti i Sigurimeve Shoqërore**

Gjatë vitit 2008 pranë Institucionit tonë janë paraqitur 147 ankesa drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe strukturave në varësi të tij. Janë përfunduar 130 ankesa. Nga këto kanë rezultuar 54 ankesa të pabazuara, 24 jashtë juridiksioni, 24 jashtë kompetence, 1 heqje dorë dhe 27 të zgjidhura në favor të ankuesve. Në proces shqyrtimi janë 17 ankesa. Gjithashtu janë shqyrtuar dhe përfunduar 22 ankesa të mbartura nga viti 2007. Nga këto ankesa, 4 kanë rezultuar të pabazuara, 10 jashtë

kompetence, 4 jashtë juridiksionit, 1 me heqje dorë dhe 3 të zgjidhura në favor të ankuesve.

Problematika që ngrihet në ankesat e qytetarëve është pothuajse e njëjtë si në vitet e tjera paraardhëse. Konkretisht qytetarët ankohen për masën e përfitimit të pensionit të pleqërisë, mosnjohjen e vjetërsisë në punë, mosdhënien e invaliditetit nga Komisionet përkatëse të Caktimit të Aftësisë për Punë, mospërfitimin e shtesave të pensionit të pleqërisë, zvarritje burokratike nga organet kompetente, për kohën e daljes në pension, mospërfitimin e pensionit familjar, mospërfitimin e pensionit si nënë me shumë fëmijë, sigurimin e detyrueshëm për personat e vetëpunësuar në bujqësi, për mospërfitim të kompensimit të energjisë elektrike, për ndërprerje të trajtimit të veçantë si minator, për moslllogarritje të saktë të masës së pensionit të parakohshëm, etj.

Përgjithësisht nga këto ankesa kemi evidentuar se shpesh herë ankuesit, kryesisht për mosnjohje të Ligjit, nuk kanë konsumuar shkallët e ankimit administrativ në Komisionet e Apelit pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore si dhe në Komisionin Qëndror të Apelit pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Në këto raste ndihma jonë juridike ka qenë e favorshme duke i dhënë mundësinë qytetarit të qartësohet për problemin e tij, pa i hyrë procedurave të zgjatura administrative. Këtë veprim ua kemi orientuar që ta kryejnë në një moment të dytë, në qoftëse nuk mbeten të kënaqur dhe më pas t'i drejtohen komisioneve përkatëse të Apelit.

Gjithashtu nga ana e Institucionit tonë është bërë një punë jo e vogël për informimin e qytetarëve për zhvillimet e herë pas herëshme lidhur me përmirësimet në Ligjin nr.7703 datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” si dhe mbajtjen në kontakt të vazhdueshëm të tyre për fazat e rishikimit të këtij legjislacioni. Kjo sepse është konstatuar fakti se shumë qytetarë kur i drejtohen Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore marrin përgjigje në mënyrë verbale dhe jo shkresore, duke mos u qartësuar për kërkesat e tyre.

Si konkluzion i punës tonë, lidhur me këtë organ duhet të theksojmë faktin se nga trajtimi i mjaft ankesave, të cilat pas shqyrtimit kanë rezultuar të pabazuara, është bërë punë për sqarimin ligjor të problemeve të parashtruara nga ankuesit.

Në bazë të të gjitha evidentimeve, statistikave dhe observimeve të nxjerra si dhe bazuar në rolin e Institucionit të Avokatit të Popullit që ndikon dhe përçon vizionin e mirëqeverisjes, është arritur në konkluzionin se Qeveria Shqiptare së bashku me institucionet e tjera përkatëse, me gjithë arritjet e deritanishme, duhet të jetë më efektive në politikat që lidhen me fushën e sigurimeve shoqërore.

Ky konkluzion ka dalë pasi shumica e ankuesve problemin e masës së pensionit që ata përfitojnë, e shohin në këndvështrimin e një

diskriminimi që u bëhet atyre nga shteti për punën që ata kanë bërë për vite me radhë. Ata kërkojnë të ketë edhe një bazë më të mirë për politikën që ndjek shteti në fushën e sigurimeve shoqërore. Megjithëse kohe pas kohe janë bërë përmirësime ligjore në këtë fushë, përsëri vihet re se ka kundërthënie, evazivitet, diferenca të masës së pensioneve të qytetarëve në kushte të njëjta pune etj. Por këto ndryshime dalin jashtë juridiksionit të veprimtarisë së Institucionit të Avokatit të Popullit.

Konkretisht, në këtë kuadër, duke marrë shkas nga ankesat e qytetarëve, po paraqesim problematikat e mëposhtme:

Së pari, në lidhje me trajtimin e diferencuar të minatorëve, problem të cilin e kemi parashtruar edhe në raportin vjetor 2007.

Në ankesat e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, kërkojnë të kenë një status të veçantë si dhe të rriten pensionet aktuale.

Duke i vlerësuar si të drejta shqetësimet e tyre kemi ndërhyrë pranë organeve kompetente . Nga ana e Ministrisë Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta na është konfirmuar fakti se me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.9356 datë 17.03.2005 “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr.8685 datë 09.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, u vendos që trajtimi i punonjësve të nëntokës të rritet ose të indeksohen sa herë dhe në masën e rritjes së pensioneve dhe më e rëndësishmja është që periudha gjatë të cilave përfitohet ky trajtim të njihet si vjetërsi pune.

Për këtë problem, Ministria e Financave përgatiti projekt-vendimet përkatëse për rritjen e pensioneve dhe të gjitha përfitimeve të tjera. Kurse në Kuvend ndodhet projekt-ligji “Për statusin e minatorit”.

- Gjithashtu pranë institucionit tonë kanë paraqitur ankesa ish minatorë që kanë punuar në miniera të ndryshme të vendit tonë, në lidhje me pezullimin e dosjeve të trajtimit të veçantë të tyre.

Ne kërkuam shpjegime shkresore pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe morëm takime me specialistë të sigurimeve shoqërore për bazueshmërinë ligjore të ndërprerjes së menjëhershme të trajtimit të veçantë të ish minatorëve. Në përgjigjet e tyre, si verbale ashtu dhe shkresore, sqaronin se nga ana e tyre ishte ndërmarrë një proces auditimi për të gjitha përfitimet e realizuara pas 1 janarit të vitit 1997. Duke qenë se dosjet e tyre kishin rezultuar me probleme në dokumentacionin e kërkuar ligjor, ishin pezulluar deri në verifikimin e plotë të tyre. Për personat që ishin bërë verifikimet, ishte hequr masa e pezullimit të përfitimit dhe ju ushte dhënë përfitim për kohën e pezullimit.

Pra, në këtë kuadër të ndërmjetësimit, ne do të vazhdojmë të insistojmë konform ligjeve në fuqi për mbrojtjen e të drejtave të ish minatorëve.

**-Së dyti**, për rritjen e masës së pensioneve të pleqërisë për personat që kishin dalë në pension pleqërie gjatë vitit 1994.

Pretendimi i të gjithë ankuesve që kishin fituar të drejtën e daljes në pension pleqërie gjatë vitit 1994, ishte se megjithëse nëpërmjet vendimeve të Këshillit të Ministrave ishin bërë korrigjime të pensioneve për periudha të ndryshme kohore, masa e pensionit të tyre nuk ishte e njëjtë me personat që kishin dalë në pension pleqërie para vitit 1993.

Për këtë problem kërkuam shpjegime si pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, ashtu dhe pranë Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, nëse do të ndërmerrej ndonjë studim për një tjetër fazë të ngushtimit të diferencave të këtyre pensioneve, duke qenë se zbutja e dallimeve në masën e pensioneve ishte kryer gradualisht në 5 etapa dhe aktualisht shumë pensionistë kërkonin që të mos kishte diferencime në masën e pensioneve për punë të të njëjtit nivel dhe profesion.

Nga ana e MPCSSH-së, na u konfirmua fakti se me zbatimin e pesë fazave të reformës së ngushtimit të diferencave të pensioneve ishte arritur të parafrohen pensionet e caktuara para vitit 1993 me ato pas, me rreth 98% nga 58% që ishte para fillimit të reformës, por ky proces nuk kishte përfunduar.

**Së treti**, për mosnjohjen e vjetërsisë në punë të bashkëshortit/es së ushtarakut, që kishin përfituar pagesën e papunësisë për vitet 1993-2003.

Nga ankesat e ardhura pranë Institucionit tonë, rezulton i pazgjidhur prej disa vitesh problemi i mosderdhjes së kontributit të sigurimeve shoqërore për bashkëshortët e ushtarakëve që kishin përfituar pagesën e papunësisë për vitet 1993-2003.

Nga analiza e dispozitave ligjore e nënligjore që rregullonin këtë çështje, konstatoam sa më poshtë:

Më datë 03.07.1991, është miratuar Ligji Nr.7496 “Për Statusin e Ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”. Nga viti 1991 deri në 1999, ekzistonte një ligj i përbashkët si për punonjësit e policisë, ashtu dhe ato të ushtrisë. Ndërkohë, më datë 25.11.1999 ishte miratuar Ligji Nr.8553 “Për Policinë e Shtetit”, i cili përcaktonte shtesat mbi pagën bazë dhe kompensimet për privacionet dhe humbjet që i krijoheshin punonjësit të policisë, për shkak të nevojave të punës e të shërbimit.

Në zbatim të këtij neni, u miratua VKM nr.507 datë 18.07.2003 “Për kompensimet, për privacionet dhe humbjet që i krijoheshin punonjësit të policisë së shtetit, për shkak të nevojave të punës dhe të shërbimit”.

Pra, me këtë akt nënligjor u rregullua detyrimi i institucioneve, të cilët jepnin pagesën e papunësisë, për të derdhur kontributet shoqërore. Por kjo, vetëm për periudhën pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Kështu, që nga viti 1993 deri në vitin 2003 ishte parashikuar vetëm në ligj njohja e periudhës së përfitimit të pagesës së papunësisë në

vjetërsinë e punës, pa u mbështetur me derdhjen reale të pagesave të sigurimeve. Pra, ligji nga njëra anë u njihte të drejtën të gjithë personave që kjo pagesë papunësie t'u njihej si vjetërsi punë. Ndërsa nga ana tjetër asnjëherë ky parashikim ligjor nuk u detajua me një akt nënligjor, i cili të parashikonte detyrimin e Institucioneve për të derdhur kontribute shoqërore. Administrata publike në vitet 1993-2003 nuk kishte realizuar detyrimin e saj për të zgjidhur problemin në fjalë. Këtë mosfunksionim të administratës publike nuk duhej ta vuanin qytetarët.

Për sa më sipër i rekomanduam Kryeministrit, Ministrit të Mbrojtjes, Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave: **1.** Marrjen e të gjitha masave organizative dhe ligjore për identifikimin e numrit të përgjithshëm të personave që kishin përfituar pagesën e papunësisë nga Ligji Nr.7496 datë 03.07.1991 “Për Statusin e Ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, për të përcaktuar faturën financiare, e cila duhej të derdhej pranë sigurimeve shoqërore, në mënyrë që periudha 1993-2003 t'u njihej realisht si vjetërsi pune të interesuarve.

**2.** Nxjerrjen e një akti normativ për derdhjen nga Buxheti i Shtetit, të shumës përkatëse pranë sigurimeve shoqërore për periudhën 1993-2003, me qëllim që të zgjidhej në praktikë problemi.

Në përgjigje të rekomandimit, Ministri i Financave, ndër të tjera sqaroi se: Meqënëse pagesa e papunësisë për personat që kishin përfituar nga Ligji Nr.7496 datë 03.07.1991 “Për Statusin e Ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” ishte bërë nga organet në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Brendshme, atëhere ishin këto dy ministri që mund të nxirrnin të dhëna të sakta për identifikimin e numrit të personave që kishin përfituar pagesën e papunësisë nga Ligji nr.7496 datë 03.07.1991 “Për Statusin e Ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Në momentin e identifikimit të personave që kishin përfituar pagesën e papunësisë, ajo ministri ishte e gatshme për dhënien e ndihmës për nxjerrjen e akteve normative për derdhjen nga Buxheti i Shtetit të shumës përkatëse pranë sigurimeve shoqërore për periudhën 1993-2003.

Në këto kushte në vijim, ne i rekomanduam Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Mbrojtjes dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Informativ Shtetëror për marrjen e masave për identifikimin e numrit të përgjithshëm të personave që kishin përfituar pagesën e papunësisë nga Ligji Nr.7496 datë 03.07.1991 “Për Statusin e Ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, për periudhën 1993-2003.

Për sa më lart, në përgjigje të rekomandimeve tona, jemi informuar se këto institucione kanë përgatitur listat me identitetet përkatëse për të gjithë personat që kishin përfituar pagesën e papunësisë dhe i kanë dërguar pranë Ministrisë së Financave.

Në funksion të përmirësimeve të mundëshme që mund të rezultojnë pozitive, Zyra jonë është në vazhdimësi të proceseve të rishikimeve dhe analizave të legjislacionit në fushën e sigurimeve shoqërore, proces i cili do të pasohet me rekomandimet përkatëse në këtë fushë.

Së fundi, duhet të theksojmë se bashkëpunimi ndërmjet Institucionit tonë me administratën qendrore dhe lokale të Sigurimeve Shoqërore ka qenë rezultativ, duke vërejtur një përgjegjshmëri në rritje të kësaj administrate.

### **e) Bankat**

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit janë paraqitur gjatë vitit 2008 4 ankesa, kundër bankave që operojnë në Shqipëri.

Për shkak se këto ankesa kanë pasur si objekt kryesisht marrëdhëniet e ankuesve si klient me bankat e nivelit të dytë që operojnë në vëndin tonë ato janë konsideruar jashtë juridiksionit. Qytetarët janë orientuar për rrugët që duhej të ndiqnin për zgjidhjen e problemeve të parashtruara. Por ne po thellohem që për të ardhmen të ndalemi më mirë në ankesat e kësaj natyre, që kanë të bëjnë me shërbimet ndaj qytetarëve, në kuadër të së drejtës së konsumatorëve.

## **8. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve**

Gjatë vitit 2008 për çështje apo problematika që lidhen me veprimtarinë e Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve dhe organet e saj në varësi, rezultojnë gjithsej 133 ankesa të paraqitura. Për vetë ministrinë janë trajtuar 16 ankesa, nga të cilat 1 ankesë është ende në shqyrtim. Nga këto janë zgjidhur në favor 4 ankesa, jashtë juridiksionit dhe kompetencës kanë qenë 9 ankesa, ndërsa për 2 prej tyre jemi në kushtet e heqjes dore të ankuesve nga ankesa.

Pjesa më e madhe e ankesave ndaj M.P.P.T.T. është ndaj procedurës së shpronësimeve për interes publik dhe më konkretisht kundër vlerës së dëmshpërblimit të përfituar nga shtetasit, për dëmshpërblimin e pronës si pasojë e përdorimit për interes publik të saj. Në këto raste, ankuesit fillimisht janë sqaruar për të drejtat e tyre mbi këtë proces.

Përderisa nuk parashikohet ankimi në rrugë administrative, ankuesit janë orientuar t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, në vëndin ku ndodhet organi që ka përcaktuar çmimin e pronës, e cila është përfshirë në proces shpronësimi, sepse vetëm gjykata ka fuqi vendimmarëse, të detyrueshme për zbatim.

Megjithatë, në të gjitha rastet kur kemi konstatuar se ka qenë i mundur shqyrtimi administrativ i çështjes, kemi ndërhyrë për zgjidhjen e çështjes në favor të ankuesit si p.sh. për ankesën e shtetasit H.B. ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve për rrezikun e dëmtimit të shtëpisë së tij dhe 8 banesave të tjera për shkak të zgjerimit të trasesë të segmentit rrugor Bulqizë-Ura e Cerencit.

Në përgjigjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve sqaroheshim se pas ankimit të shtetasit H.B pranë Avokatit të Popullit, kishte filluar ndërtimi i mureve mbrojtës, të cilët përfundimisht do të zgjidhnin këtë ankesë.

Gjithsesi duke e konsideruar numrin e ankesave të trajtuara lidhur me procedurën e shpronësimeve relativisht të ulët, konstatojmë se është rritur angazhimi dhe përgjegjshmëria e strukturave përkatëse për procedurat e shpronësimit, dhe rrjedhimisht për respektimin e të drejtës së pronës si një nga të drejtat themelore të njeriut.

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit janë paraqitur 10 ankesa në lidhje me veprimtarinë e Entit Kombëtar të Banesave, prej të cilave 8 ankesa kanë qenë jashtë kompetencës tonë dhe 2 ankesa janë zgjidhur në favor të ankuesve.

Problematika e parashtruar ka patur të bëjë kryesisht me termat financiare të aplikueshme në marrëdhëniet midis Entit Kombëtar të Banesave dhe personave që përfitojnë banesë me kosto të ulët. Këto tarifa janë më të larta që prej hyrjes në fuqi të Udhëzimit nr. 19 datë 13.09.2007 “Për përcaktimin e rregullave të përgjithshme të zbatimit të programit të banesave me kosto të ulët”, i cili rriti çmimin e banesave për m<sup>2</sup> si dhe atë të shesheve funksionale të objekteve.

Një ndër rastet e paraqitura është ankesa e një grupi banorësh nga qyteti i Korçës, të cilët ishin trajtuar me banesë me kosto të ulët nga Enti Kombëtar i Banesave dega Korçë, në vitin 1994. Për shkak të marrjes së lejes së shfrytëzimit nga Entit Kombëtar të Banesave në fund të vitit 2007, çmimi me të cilin do të vlerësoheshin këto banesa i referohej Udhëzimit të mësipërm. Këta shtetas paraqitën pretendimin se çmimi i banesave të tyre duhej të përlllogaritej në bazë të legjislacionit para hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi.

Në përgjigje të kërkesës tonë për shpjegime, Enti Kombëtar i Banesave sqaronte se çmimet e banesave dhe shesheve funksionale kishin ndryshuar sipas Udhëzimit nr.19, i detyrueshëm për t’u aplikuar në rastin konkret për shkak të marrjes së lejes së shfrytëzimit pas daljes së këtij Udhëzimi.

Në një vështrim të përgjithshëm të veprimtarisë së Ministrisë të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit si dhe strukturave në varësi të saj, vlen të përmendet progresi i arritur deri më tani në fushën e infrastrukturës rrugore, dhe konkretisht punimet për ndërtimin e akseve



rrugore të rëndësishme si p.sh., rruga Durrës - Kukës, Levan - Tepelenë, si dhe rikonstruksioni i rrugëve ekzistuese, të cilat do t'i shërbejnë qarkullimit më të madh të njerëzve dhe mallrave brenda vendit dhe kalimin tranzit të tyre. Nga ana tjetër, më shumë vëmendje i duhet kushtuar sinjalistikës rrugore dhe mirëmbajtjes së tyre, me qëllim rritjen e sigurisë së qarkullimit rrugor, i cili mbetet një problem tepër shqetësues.

Në këtë kontekst përmendim rekomandimin e Avokatit të Popullit pranë Ministrit të M.P.P.T.T., në muajin Korrik 2007, në lidhje me gjendjen e rënduar të trafikut sidomos gjatë sezonit veror, të aksit rrugor Plepa – Durrës – Kavajë. Në këtë rekomandim u kërkua marrja e masave të menjëhershme për zgjidhjen e problematikës së trafikut të mbingarkuar në këtë aks. Në fund të vitit 2008 ka filluar puna për zgjerimin e këtij aksi të rrugës, e cila do të lehtësojë lëvizjen e shtetasve dhe sigurinë e tyre, duke realizuar nga pikëpamja thelbësore, kërkesat e parashtruara në rekomandimin tonë.

Një çështje tjetër e filluar me inisiativë dhe ndjekur prej 2 vjetësh tashmë nga institucioni lidhet me shërbimin hekurudhor. Në vitin 2006 Avokati i Popullit pasi inspektoi në të gjithë vendin dhe la detyra për përmirësimin e kushteve të këtij shërbimi, konstaton se pothuajse nuk është bërë asgjë për rritjen cilësore të tij. Gjithashtu infrastruktura e këtij shërbimi përballet me vështirësi të shumta, pasi gjendja e binarëve dhe shinave vazhdon të jetë e rënduar. Në fakt rrjeti hekurudhor ngelet një nga më të papërshtatshmit dhe si rrjedhojë më pak të preferuarit për udhëtime brenda vendit, duke shërbyer më së shumti në transportin e mallrave.

Duke mbajtur në vëmendje problematikat komplekse të këtij dikasteri në interes të qytetarëve, por edhe në interesin e përgjithshëm të zhvillimit ekonomik të vendit, Avokati i Popullit do të vazhdojë edhe në të ardhmen të ndjekë me përgjegjësi këtë veprimtari për të dhënë kontributin e tij në përmirësimin e shërbimeve publike që i ofrohen individit nga MPPTT dhe strukturat e saj vartëse.

#### **a. Inspektoriati Ndërtimor e Urbanistik Vendor dhe Kombëtar**

Hyrja në fuqi e dispozitave ligjore që synojnë eliminimin e paligjshmërisë së ndërtimeve pa leje në të gjithë territorin e vendit, si një eksperiencë negative në kuadrin e zhvillimit të vendit, tashmë kanë zhvendosur fokusin në këto çështje, duke i parë ato jo vetëm si probleme sociale, urbanistike dhe të cilësisë së jetesës, por si probleme që tashmë janë shtruar për zgjidhje përfundimtare.

Organet apo institucionet të cilat me ligj janë ngarkuar për trajtimin e zgjidhjen e këtyre çështjeve, pas përfundimit të funksioneve

konstatuese, tashmë janë përfshirë së bashku me individët kundravajtës në një proces funksional, atë të legalizimit të këtyre ndërtimeve pa leje.

Dy janë ligjet e miratuara nga ana e Kuvendit të Shqipërisë, për zbatimin e të cilave rezultojnë të ketë dhe ankesa pranë zyrave të Institucionit.

Konkretisht, Ligji nr. 9482 datë 03.04.2006 “Për legalizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, i pasuar nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 438 datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo”, si dhe Ligji nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”.

Megjithatë, gjykojmë se pavarësisht konceptimit që jepet në këtë ligj për krijimin dhe funksionimin e Inspektoriatit Ndërtimor e Urbanistik, mbeten ende momente të paqarta të cilat, janë evidentuar gjatë praktikës së zbatimit të ligjit.

Vazhdon të mbetet problematik, raporti ndërmjet Inspektoriateve Ndërtimore e Urbanistike të Bashkive, Komunave apo të Qarqeve (I.N.U.V.), me Inspektoriatin Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar (I.N.U.K.). Janë trajtuar disa raste kur vendime për prishje të marra nga I.N.U. vendor janë shfuqizuar me vendime të I.N.U.K., ndërkohë që ligji parashikon ndërhyrjen e kësaj të fundit vetëm kur nuk ushtrohen kompetencat ligjore nga I.N.U.V., apo në rastet kur objekti i paligjshëm është ndërtuar në parqe kombëtare, apo zonë turistike.

Një problem tjetër shqetësues i vërejtur gjatë trajtimit të ankesave të qytetarëve të paraqitura pranë institucionit, është afati i parashikuar në neni 13 të ligjit “Për inspektimin e ndërtimit” për ekzekutimin e vendimit për prishje. Në këtë dispozitë parashikohet shprehimisht se afati për zbatimin e vendimit të I.N.U.V.-ve apo Kombëtar është deri 60 ditë. Pra realisht ndërhyrja mund të realizohet që të nesërmen e marrjes së vendimit për prishje, duke mos i lënë kohën e nevojshme shtetasit, të ushtrojë të drejtën e tij të ankimimit në rrugë administrative apo gjyqësore. Gjithashtu kjo dispozitë shkel të drejtën e individit për një proces të rregullt ligjor të sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Konvetën evropiane për të drejtat e njeriut.

Gjatë trajtimit të ankesave të paraqitura, problematik është fakti se I.N.U.V.-ja ushtron kompetencat e tij mbi bazën e dy standarteve të ndryshme, duke i dhënë të drejtë respektivisht edhe zaptuesit të tokës, edhe pronarit të saj të ligjshëm. Me dy standarte kuptojmë ndërhyrjet selektive të I.N.U.-ve në rastet ku ndërtimi është në proces legalizimi.

Në fakt Ligji për legalizimet nuk parashikon shprehimisht, mosndërhyrjen e I.N.U.V.-ve në rastet kur ndërtimi është në proces legalizimi, por kthimin e tij në gjëndjen e mëparshme në rast se objekti legalizohet. Është pikërisht kjo dispozitë e cila lë vend për veprime

abuzive, por të paatakueshme nga ana ligjore të I.N.U.V.-së, e cila në fund të fundit nuk ka detyrim dhe kompetencë të gjykojë nëse një objekt do të legalizohet ose jo.

Së dyti, referuar ligjit subjekti i interesuar duhet të provojë se ndërtimi i kryer prej tij është ndërtuar para datës 03.04.2006. Nga praktika e deritanishme, por edhe nga vëzhgimet e bëra në këtë drejtim del se është abuzuar pasi janë pranuar për proces legalizimi, objekte të përfunduara pas kësaj date apo që do të ndërtohen në të ardhmen. Janë pranuar gjithashtu në proces legalizimi objekte të ndërtuara me konstruksion të përkohshëm, si p.sh. kioska, tenda dyqanesh etj., apo edhe objekte të cilat akoma nuk ekzistojnë.

Praktika e mosekzekutimit të vendimit për prishje që po ndiqet në rastet kur ndërtimi është deklaruar pranë degëve të A.L.U.I.Z.N.I.-it, konstatohet si një problem që nuk mund të lihet në heshtje dhe që ka të bëjë me mos harmonizimin e parashikimeve të Ligjit “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, me legjislacionin tjetër në fuqi. Konkretisht mosekzekutimi i vendimit për prishje, bie në kundërshtim me parashikimet e bëra në gërmat “a” dhe “b”, të nenit 131 të Kodit të Proçedurave Administrative, në të cilat përcaktohen shprehimisht rastet kur pezullohet proçedura e ekzekutimit të një akti administrativ dhe që është në fuqi. Ky është një tjetër konstatim që evidenton një praktikë, e cila nuk duhet lënë thjesht në dëshirën e organeve specifike, sepse patjetër do të sillte veprime ose mosveprime abuzive në dëm të shtetasve, palë në këtë proçedim administrativ.

Gjatë vitit 2008, për problematikën e ndërtimeve pa leje që lidhet me veprimtarinë e organit të Inspektoriateve Ndërtimore e Urbanistike, në përputhje me parashikimet e Ligjit nr.9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, rezulton të jenë shqyrtuar 76 ankesa.

Nga ankesat e shqyrtuara deri në fund të vitit 2008, rezultojnë të përfunduara 68 ankesa dhe janë ende në shqyrtim 8 ankesa.

Përsa i përket çështjeve të përfunduara, ka rezultuar se janë zgjidhur në favor 17 ankesa, jashtë juridiksionit dhe kompetencës kanë qenë 35 ankesa, ndërsa për 14 prej tyre jemi në kushtet e pabazueshmërisë së ankesës ose braktisjes së proçedimit administrativ.

Ashtu si dhe vitin e kaluar trajtimi i çështjeve që kanë të bëjnë me ndërtimet pa leje në vitin 2008, shfaq një veçori që lidhet me fazën tranzitore në të cilën kaloi organi i Policisë të Ndërtimit, me hyrjen në fuqi të Ligjit “Për inspektimin e ndërtimit”.

Problematika e kësaj faze ka të bëjë me kalimin e praktikave dokumentare, nga Policia e Ndërtimit tek I.N.U.-të, fazë e cila ishte parashikuar specifikisht në Ligjin “Për inspektimin e Ndërtimit”, të realizohej në një periudhë tre mujore. Por ka raste konkrete të trajtuara nga ana jonë kur shtetasi kërkonte ekzekutimin e vendimit për prishje të

Policisë Ndërtimore, ndërkohë që kopja analoge e këtij vendimi nuk disponohej ende nga I.N.U.-ja e Bashkisë apo e Komunës, çka ka sjellë për pasojë edhe mosekzekutimin e atij vendimi, pra mospërbushjen e një detyrimi nga ky Inspektoriat. Gjithsesi në të tilla raste, përveç ndërhyrjes institucionale nga ana jonë, ankuesit janë orientuar që të paraqesin një ankesë të re pranë INUV-së.

Si konkluzion mund të thuhet se transformimi i Policisë së Ndërtimit në Inspektorat Ndërtimor ka filluar të japë rezultate në disiplinimin e fushës së ndërtimit. Në fakt një ndër arsytet e transformimit të Policisë Ndërtimore në I.N.U në varësi të pushtetit lokal, ishte krijimi i një institucioni më të ndjeshëm dhe gjithmonë në korrent të veprimtarisë së paligjshme në fushën e ndërtimeve, më afër shtetasve për çdo problem që ato kishin në këtë fushë dhe në të gjithë territorin e vendit.

Për sa i përket rasteve të ankesave, të cilat janë zgjidhur në favor të ankuesve, por dhe atyre që kanë rezultuar jashtë kompetencave të institucionit, ka dalë se jo rrallë konstatohet inaktivitet apo përzgjedhje selektive në ekzekutimin e vendimeve, që përbën një tregues negativ në përmbushjen e detyrimeve që përcaktohen prej Ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”. Praktika të tilla duhet të shmangen dhe forca e ligjit duhet të ushtrohet njësoj mbi të gjithë, duke mos diskriminuar njeri për shkaqe nga më të ndryshmet.

Në këtë kuptim përmirësimet legislative të nevojshme si edhe konsolidimi i mëtejshëm i këtij organi do të sillte një mbrojtje më efektive të të drejtave të qytetarëve si edhe një zbatim më rigoroz të këtij Ligji nga organet e ngarkuara më këtë qëllim, për të shmangur në këtë mënyrë veprime apo mosveprime abuzive në dëm të tyre.

Gjithsesi Avokati i Popullit nuk do të ngurojë të ushtrojë kompetencat e tij edhe në të ardhmen, për të qenë më aktiv në mbrojtjen e të drejtave të shtetasve të thjeshtë apo të komuniteteve të gjera të popullsisë nga ndërtimet informale që çenojnë cilësinë e jetës së përditshme.

## **b. Ankesat për Ujësjellës Kanalizimet**

Gjatë vitit 2008, janë shqyrtuar 12 ankesa që kanë patur të bëjnë me Ndërmarrjet e Ujësjellësit dhe Kanalizimeve. Nga këto 4 ankesa janë zgjidhur në favor, 1 është ende në shqyrtim. 7 kanë qenë jashtë juridiksionit dhe 5 ankesa kanë qenë me mungesë të kompetencave tona.

Në vijim po trajtojmë disa nga ankesat e zgjidhura pozitivisht:

**1.** Pranë institucionit të Avokatit të Popullit u paraqit ankesa nga qytetarja M. S., e cila pretendonte se Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizime (N.U.K.) Tiranë nuk tregonte asnjë interesim lidhur me mungesën prej një muaji të ujit të pijshëm, në të gjithë pallatet në zonën ku ajo banonte. Kjo mungesë shkakohej nga ndërhyrja abuzive në rrjetin e sistemit të

furnizimit që përdornin pishinat, në akuadromin e Tiranës. Ky shqetësim ishte bërë prezent disa herë pranë ndërmarrjes Ujësjiellës Kanalizime nga ankuesja dhe nga banorë të tjerë të zonës. Por edhe pse ishte konstatuar ndërhyrja abuzive nga punonjës të ndërmarrjes, nuk ishte gjetur akoma zgjidhje.

Duhet theksuar se interesimi ynë institucional pranë kësaj ndërmarrje, ishte jo verifikues për sa i përket pretendimeve të kësaj qytetareje, por konsistoi në zgjidhjen faktike të kësaj çështje, për vetë faktin e rëndë të mungesës së furnizimit me ujë të rreth 50 familjeve. Eksperti i Institucionit i ngarkuar për trajtimin e kësaj çështjeje, fillimisht asistoi në konstatimin e ndërhyrjes së paligjshme nga kundravajtësit si dhe më vonë në prishjen e kësaj ndërhyrje, e cila përfundimisht solli dhe furnizimin normal të zonës me ujë të pijshëm.

**2.** Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit u paraqit një ankesë nga shtetasi A. M., me anë të së cilës pretendonte se i ishte mohuar e drejta për informim lidhur me një kërkesë, drejtuar Sh.A. Ujësjiellës Kanalizimeve Pukë, për marrjen e disa dokumentave pas largimit të tij nga vendi i punës si teknik ndërtimi pranë kësaj ndërmarrjeje. Nga Zyra e Avokatit të Popullit u kërkuan shpjegime dhe në përgjigje të tyre, nga SHAUK Pukë, u dërgua informacioni i kërkuar prej ankuesit.

**3.** Ankesa e qytetarit Z. K. me banim në qytetin e Shkodrës, për ndotje të ujit që vinte në banesën e tij.

Konkretisht, ai sqaronte se kishte rreth 5-6 muaj që uji shkonte në banesën e tij i ndotur. Për këtë ai pretendonte se i ishte drejtuar disa herë Ndërmarrjes së Ujësjiellës Kanalizimeve Shkodër. Në përgjigje të kërkesës së Institucionit të Avokatit të Popullit, N.U.K. Shkodër sqaroi se nga ana e saj ishte bërë verifikimi në vend i gjëndjes dhe se blloku i pallateve në lagjen e qytetarit Z.K furnizohej me ujë nga një rrjet tubacionesh çeliku dhe xinkatesh që ishte i amortizuar. Megjithë shërbimin e bërë nga N.U.K.-ja Shkodër, për mirëmbajtjen e tyre, problemet përsëriteshin. Në përfundim, defektet e konstatuara në rrjetin e jashtëm u riparuan dhe nga N.U.K. Shkodër na u premtua se nuk do të kishte më probleme në furnizimin me ujë të banorëve.

Në përfundim, mund të themi se shërbimi i ujësjiellës kanalizimeve ka pasur përmirësime në shërbimin e tij gjatë vitit 2008, megjithatë problemet në rrjetin shpërndarës të tij nuk kanë munguar. Me gjithë kalimin në varësi të pushtetit vendor të këtij shërbimi gjatë vitit 2008, është e nevojshme të theksohet nevoja emergjente e investimeve për zëvendësimin e rrjetit të amortizuar me qëllim garantimin e cilësisë së ujit të pijshëm. Kjo mund të bëhet shpejt, siç kemi rekomanduar edhe më parë ose nëpërmjet rrugës së privatizimit ose dhënies me kontratë konçesioni.

### **c. Ankesa ndaj shoqërisë së telefonisë fikse, Alb-Telekom**

Ankesat e paraqitura pranë zyrës së Avokatit të Popullit ndaj kësaj shoqërie kanë qenë 16, nga të cilat 3 ankesa kanë rezultuar të pabazuara, 2 jashtë juridiksionit dhe 10 janë zgjidhur në favor të ankuesve. Një ankesë është akoma nën trajtim gjatë vitit 2009.

Duke qenë se kjo shoqëri është privatizuar, ankuesit kanë paraqitur pretendimet e tyre lidhur me përjashtimin nga listat e privatizimit, si aksionerë të Shoqërisë Albtelekom me qendër në Tiranë, si dhe në filialet e saj në Sarandë, Fier, Pukë, Peshkopi, Skrapar, Librazhd, Tiranë etj. Për shkak se afati i dorëzimit të dokumentacionit kishte mbaruar, Zyra e Avokatit të Popullit menjëherë filloi shqyrtimin e saj.

Për këtë qëllim kërkua shpjegime nga organet përkatëse, Drejtoria e Përgjithshme e Albtelekomit Sh.A dhe pranë Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financës. Nga ana e METE-s u informua se pas urdhërit të parë të publikimit të këtij lajmi për punonjësit dhe ish punonjësit, me qëllim që mos të mohohet e drejta e privatizimit, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës nxorri urdhërin e dytë Nr.133 datë 26.02.2008 me anë të të cilit urdhërohet një publikim i dytë për shitjen e paketës së aksioneve për punonjësit e shoqërisë Albtelekom SHA. Ky urdhër përcaktonte një afat tjetër të plotësimit dhe dorëzimit të dokumentacionit përkatës.

Gjithashtu nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike pranë Ministrisë së Financave, u informua se ky publikim ishte realizuar dhe në median elektronike. Një kopje të kësaj përgjigjeje iu dërgua dhe ankuesve për njohje më të hollësishme.

Gjithashtu pranë Zyrës së Avokatit të Popullit u paraqitën dhe kërkesa për t'u informuar lidhur me mundësinë e përfitimit nga privatizimi i Alb-Telekomit.

Konkretisht ankuesi G. Ll. parashtronte se kishte punuar në Telekomini e Vaut të Dejës, nga ku kishte dalë në pension në vitin 1986 dhe ndaj kërkonte disa sqarime nëse mund të përfitonte si ish punonjës i kësaj Ndërmarrjeje.

Në përgjigjen e dhënë, zyra e Avokatit të Popullit sqaroi qytetarin e interesuar se Urdhëri i fundit i Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës ka qenë me nr.133, datë 26.02.2008 ku urdhërohet një publikim i dytë për shitjen e paketës së aksioneve për punonjësit e Sh.A. Albtelekom. Në këtë kuptim, rezultoi përfitues nga privatizimi i Sh.A. Albtelekomi punonjësit që kishin dalë në reformë në vitin 2001 si dhe punonjësit aktuale në ditën e nënshkrimit të kontratës së shitjes së aksioneve. Pra qytetari që kishte paraqitur kërkesën e tij, nuk futej në kategorinë e ish punonjësve përfitues nga ky privatizim.

## 9. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

Për vitin 2008 janë trajtuar gjithsej 28 ankesa për vetë Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Së bashku me numrin e çështjeve të ndjekura me organet në varësi të METE-s janë trajtuar gjithsej 87 ankesa, nga të cilat 25 prej tyre pas shqyrtimit kanë rezultuar të pabazuara, 11 kanë qenë jashtë juridiksionit, 21 në mungesë të kompetencave, 15 janë zgjidhur në favor të ankuesve, 1 ankesë është arkivuar pasi ankuesi ka hequr dorë, dhe 14 ankesa janë ende në shqyrtim.

Problematikat kryesore me të cilat është përballur puna e Avokatit të Popullit me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe strukturat administrative në varësi të saj janë:

1. Avokati i Popullit u vu në dijeni në fillim të vitit 2008, për ndryshimet e reja të ligjit Nr.9072 dt.22.05.2003 “*Për sektorin e energjisë elektrike*”, në të cilat krahas të tjerash entit shpërndarës KESH sha mund ti kalonin një sërë kompetencash për konstatimin e kundravajtjeve administrative dhe vendosjes së gjobave ndaj shkelësve në rrjetin elektrik.

Duke qenë të vetëdijshëm që tashmë KESH sha kishte marrë të gjitha kompetencat e Policisë Elektrike për shkak të suprimimit të këtij institucioni shtetëror, natyrshëm lindi debati mbi llojin e atributit që mund të gëzonte ky ent furnizues në fushën e kundravajtjeve administrative.

Nisur nga ekskluziviteti që i jepte Ligji Nr.7697 dt. 7.04.1993 “*Për kundravajtjet administrative*” i ndryshuar, organeve të administratës shtetërore qëndrore ose vendore, për konstatimin e kundravajtjeve administrative dhe vendosjen e gjobave, menduam se kjo çështje duhej parë me rezervë.

Në bindjen tonë KESH sha apo çdo ent tjetër furnizues që mund të merrte këtë cilësi pas proçeseve të privatizimit të këtij sektori, për shumë element ligjorë të organizimit dhe funksionimit ishte larg të qenit organ i administratës publike. Ndaj dhe i shprehëm mendimin tonë Ministrit të METE-s, se dhënia e një atributi të tillë në favor të KESH sha-së ishte një veprim i nxituar që vlente të korrigohej sa më parë konform legjislacionit në fuqi.

Avokati i Popullit në këtë sugjerim, duke njohur cilësinë e autoritetit të Ministrit të METE-s si propozues i draftit të ndryshimeve ligjore të mësipërme u interesua të njohë opinionin e tij, duke qenë i hapur për bashkëpunim për këtë çështje.

Lidhur me përmbajtjen e kërkesës së mësipërme, nga ndërhyrjet tona të herëpashërshme pranë kësaj Ministrie, si dhe nga komunikimi verbal me Drejtuesin e ERE-s zotin Bujar Nepravishta, na u bë e njohur

se: Me ndryshimet që iu bënë Ligjit nr. 9072 datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” sipas Ligjit nr. 9913 datë 5.5.2008, tashmë OSSH-ja (Operatori i Sistemit të Shpërndarjes) nuk do të kishte më kompetenca për gjobvënie në rast të kundravajtjeve administrative që do të konstatoheshin. Po sipas këtij informacioni, për shkeljet e konstatuara të abonentëve të ndryshëm të energjisë elektrike, u bënë ndryshime në Kodin Penal, ku këta të parët do konsideroheshin tashmë si kundravajtës të veprës penale. Këto ndryshime megjithëse ishin në formë drafti, i ishin paraqitur Komisionit të Ligjeve në Parlament për diskutim, dhe më vonë u miratuan dhe në sesion Parlamentar.

Për sa më sipër, vlerësuam se shqetësimi i cili ishte ngritur nga Avokati i Popullit dhe sugjeruar Ministrit të METE-s që OSSH-ja të mos kishte kompetenca për gjobvënie ndaj shkelësve në rrjetin elektrik, gjëndeje tashmë i pasqyruar në Kodin Penal. Nëpërmjet ndryshimeve të këtij të fundit, abonentët e cilësuar si shkelës apo që kanë ndërhyrë në rrjetin elektrik, do të gjykohen për veprë penale në bazë të provave nga Gjykatat e vëndit.

2. Në kuadër të ankesave që ka trajtuar Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2008, u paraqit ankesa e disa banorëve të Fshatit Zemblak Korçë, të cilët kishin që nga viti 2002 që kërkonin të dëmshpërbleheshin, si pasojë e ndërtimit të linjës 110 kv Zemblak-Korçë. Konkretisht, rezultonte se KESH sha gjatë vitit 2002 kishte kryer ndërtimin e linjës 110 kv Zemblak Korçë, duke zënë një pjesë të konsiderueshme të tokave bujqësore të rreth 70 familjeve me anë të shtyllave dhe nënstacionit përkatës.

Për këtë qëllim, përfaqësuesit e familjeve pronarë kishin paraqitur disa herë kërkesa për nxitjen e procesit të shpronësimit në organet më të larta shtetërore. Por megjithë këtë nuk ishte mundësuar një zgjidhje përfundimtare.

Lidhur me këtë ankesë të përsëritur, zyra e Avokatit të Popullit kishte paraqitur një rekomandim gjatë vitit 2007, drejtuar KESH dhe METE ku kërkoi përfundimin e menjëhershëm të procedurave për marrjen e kundërvlerës së tokës.

Për këtë problem gjatë trajtimit të mëparshëm nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës na ishte bërë e ditur se ishte ngritur një Komision i Posaçëm i Shpronësimit, i cili do të merrte në shqyrtim kërkesat e banorëve në fjalë, duke bërë propozimet përkatëse në Këshillin e Ministrave.

Megjithatë, duke qenë se çështja nuk gjeti zgjidhje gjatë vitit 2007, sikundër u premtua nga përfaqësuesit e METE-s, ankuesit riparaqitën kërkesat e tyre pranë zyrës së Avokatit të Popullit.

Drejtori i Përgjithshëm i KESH sha për këtë problem në vitin 2008, na ka sqaruar se bazuar në Ligjin Nr. 8561 datë 22.12.1999 “Për



shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshme të pasurisë pronë private për interes publik”, KESH sha në cilësinë e kërkesit, me shkresën nr. 13023/2 datë 24.11.2006 kishte dërguar në METE dosjen e plotë të shpronësimit të pronarëve të dëmtuar nga ndërtimi i linjës në fjalë, në përputhje me kërkesat e ligjit. Ishte kërkuar disa herë, në mënyrë të përsëritur, përsheptimi i shqyrtimit sa më i parë i kërkesave të banorëve të dëmtuar. Megjithatë akoma nuk ishte bërë shqyrtimi i dosjes për përfundimin e procedurave për kalimin e akteve për miratim në Këshillin e Ministrave.

Aktualisht, kjo çështje vijon të ndiqet nga zyra jonë.

#### **a. Ankesat për Korporatën Elektroenergjitike (KESH) Sh.A.**

Gjatë vitit 2008 Avokati i Popullit ka trajtuar 59 ankesa kundër KESH-sha, nga të cilat, 12 ankesa janë zgjidhur pozitivisht, 19 prej tyre kanë rezultuar të pabazuara, 19 kanë qenë jashtë juridiksionit dhe kompetencave dhe 9 ankesa janë ende në shqyrtim. Në vijim do të prezantojmë problematikën që ka hasur Avokati i Popullit gjatë shqyrtimit të ankesave për shërbimin që ofron KESH sha ndaj konsumatorëve:

1. Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, u paraqit ankesa e e qytetarit F. Sh., i cili pretendonte se Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) nuk i lejonte vendosjen e sahatit të ri matës në banesë. Megjithëse ankuesi sqaronte se kishte bërë pagesën e mandatit me Nr.324 datë 10.11.2007 (për lidhje të re), por për arsye se objekti figuronte debitor nga një abonent i mëparshëm, atij i mohohej e drejta e gëzimit të lirë të pronës së tij. Sipas ankuesit, në objektin në fjalë kishte banuar më parë një person tjetër, i cili njihej si debitor në shumën 14 milion lekë. Ankuesi pretendonte në vijim se, këtij personi i ishte lidhur kontrata me Nr.D 150 387 në shtëpinë e tij pa marrë leje për këtë veprim nga ana e tij.

Duke pretenduar se nuk kishte faj për sa figuronte në regjistrat e KESH sha, ankuesi hodhi dyshime se lejimi i abonentit debitor për të konsumuar energji pa paguar, kishte pasur mbështetje korruptive nga persona të veçantë të OSSH-së.

Në analizë të fakteve të paraqitura, ne u njohëm me shkresën e Drejtorisë Zonale Tiranë ku konfirmohej se: Ankuesi F. Sh, kishte bërë kërkesë pranë Drejtorisë Zonale Tiranë për lidhje të re, si dhe kishte bërë pagesën e mandatit Nr.324 datë 10.11.2007 (Për lidhje të re). Por, pas verifikimeve të bëra nga Zona ishte konstatuar se në objektin Furrë Buke në Rrugën “Ferit Xhajko”, përderisa ekzistonte një lidhje e energjisë elektrike, kontatori përkates, dhe kishte një kontratë furnizimi me energji elektrike, nuk mund të realizohej që për të njëjtin subjekt të kishte 2

lidhje energjie. E vetmja rrugë ligjore për rastin konkret ishte kërkesa për ndryshim emri në kontratën e furnizimit me energji elektrike”.

Në vijim, në një përgjigje dërguar Drejtorisë së Shërbimit të Kontrollit, Drejtoria zonale e KESH sha, pranonte faktin se kontrata në emër të debitorit A. B., i cili nuk ishte pronar i objektit por qeramarrës, ishte lidhur në mënyrë të parregullt dhe jo ligjore, për shkak të mungesës së dokumentacionit të duhur. Në vijim, po në këtë shkresë citohej se: *“Në bazë të detyrimit të nxjerrë nga Institucioni ynë për periudhën nga data 01.01.2002 deri në datën 30.11.2007 për abonentin A. B. kanë filluar procedurat për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë”*.

Nga investigimi i rrethanave u njohëm se në bazë të pikës 6.3.1 të kontratës së furnizimit me energji elektrike për abonentët jofamiljarë ishte bërë ndërprerja e energjisë elektrike për subjektin, deri në shlyerjen e detyrimit. Kjo gjë kishte sjellë si pasojë dhe përjashtimin e pronarit të objektit nga gëzimi dhe përfitimet që rridhnin nga e drejta e pronës së tij.

Nga ngjarja e bërë prezente në këtë ankesë, ne paraqitëm rekomandimin e argumentuar se privimi që i ishte bërë qytetarit F. Sh. duke i ndërprerë prej shumë kohësh furnizimin me energji elektrike për arsye se objekti nën pronësinë e tij, kishte qenë në përdorim nga debitori A. B., i njohur si abonent i Koorporatës KESH sha dhe debitor i saj, ishte i padrejtë. Si rrjedhojë lejimin e qytetarit F. Sh. të marrë energji.

Nga komunikimi që patëm me drejtuesit e OSSH-së na u bë e njohur se rekomandimi i zyrës tonë ishte marrë parasysh, dhe tashmë qytetari F. Sh gëzonte të drejtën si konsumator i lirë i energjisë elektrike, pa qenë i detyruar të paguante shumën e debisë së njohur për një abonent të mëparshëm.

**2.** Një ankesë tjetër e paraqitur pranë Avokatit të Popullit gjatë vitit 2008, ishte ajo e qytetarit A. M. me anë të së cilës pretendonte se nga ana e njësisë OSSH Tiranë, i ishin faturuar shuma afrofe, megjithëse banesa e tij ishte e pajisur me sahat të rregullt për matjen e energjisë elektrike.

Për këtë gjë, kishte kërkuar disa herë nga OSSH-ja zonale, që të verifikohet sahati në praninë e tij, por kjo kërkesë nuk ishte marrë parasysh.

Për sa më sipër, ne kërkuam disa herë nga OSSH-ja zonale të verifikohet rasti i ankuesit A. M., si dhe të na bëhej i njohur shkaku se përse qytetarit i faturoheshin shuma afrofe në një kohë kur ishte i pajisur me sahat të rregullt matës.

Në përgjigje të kërkesave tona, ne u sqaruam se ankesa e qytetarit ishte marrë në konsideratë dhe kishte gjetur zgjidhje.

Në vijim po parashtrijmë shkurtimisht disa problematika të përgjithësuara të vëna re në punën e KESH sha dhe OSSH-së për vitin 2008. Konkretisht, është vënë re se qytetarët vijojnë të paraqesin ankesa

për abuzime gjatë punës së faturistëve të OSSH-së, lidhur kjo me ata abonentë të cilët disponojnë sahatë të rregullt matës në banesa. Megjithë disponibilitetin e OSSH-së për të ballafaquar sahatet me qytetarët, përsëri nuk është rregulluar totalisht gjendja e krijuar. Por qytetarët që u janë faturuar afrofe në një kohë kur matësat e tyre tregonin shifra të tjera më të ulëta, dhe ky fakt konsiderohet të jetë bërë shkelje e hapur për konsumatorët. Shpesh abonentët kanë paguar detyrime të tepërta, të cilat realisht nuk janë rimbursuar kurrë. Nga ana e drejtuesve të OSSH-së janë marrë masa kryesisht kundrejt faturistëve të zonave përkatëse, por për interesat ekonomike të cënuara të konsumatorëve nuk është bërë asgjë.

Ritheksojmë fenomenin që dëmton ndjeshëm abonentët në vend, dhe që mbetet ende premtim i pambajtur nga ana e KESH sha për instalimin e të gjithë matësive, gjë që do të sillte moseleminimin e faturimit afrofe. Kjo tregon edhe një herë mungesën e seriozitetit të kësaj kompanie për të përmbushur në kohë një detyrim ligjor që rrjedh nga viti 2004, dhe i cili vijon të shtyhet deri në fund të çdo viti pasardhës. Për sa kohë do vazhdojnë faturimet afrofe në arkëtimin e të ardhurave të KESH sha, kjo kompani do të vijojë të mos jetë e besueshme për konsumatorin dhe do të kontestohet vazhdimisht.

## 10. Ministria e Shëndetësisë

Gjatë vitit 2008 për Ministrinë e Shëndetësisë dhe institucionet në vartësi të saj ka patur gjithsej 46 ankesa e kërkesa. Janë zgjidhur në favor 20 ankesa, 7 kanë rezultuar të pabazuara, 13 kanë qënë jashtë juridiksionit dhe jashtë kompetence, 10 raste janë zgjidhur me rekomandim dhe për 3 ankesa është hequr dorë nga ankuesit për trajtimin e mëtejshëm. Janë në fazën e shqyrtimit pranë Zyrës tonë 3 ankesa.

Nga viti 2007 kanë qënë të mbartura 6 raste, nga të cilat 4 janë zgjidhur në favor, 1 ankesë ka qënë jashtë juridiksionit dhe 1 jashtë kompetence.

Avokati i Popullit e ka konsideruar shërbimin shëndetësor një ndër objektivat primare të punës së tij, pasi cilësia e shëndetit dhe e mbrojtjes së tij është një nga të drejtat më elementare që duhet të garantojë Shteti Shqiptar në dobi të të gjithë individëve që kanë nevojë për të.

Problematika e çështjeve që kanë të bëjnë me këtë ministri ka qënë kryesisht lidhur me vendimet për largimet nga detyra, transferime, zvarritje të procedurave administrative, kërkesa Ministrisë së Shëndetësisë për t'u kuruar jashtë shtetit, trajtimi i të sëmurëve me probleme të shëndetit mendor etj. Këtë vit, Institucioni i Avokatit të Popullit ka ushtruar në mënyrë aktive kompetencën që i është dhënë nga ligji, për të kryer inspektime edhe në institucionet publikë shëndetësore,

konkretisht në disa spitale infektive si dhe ka riinspektuar spitalet psikiatrike. Kjo veprimtari i ka dhënë punes tonë hapësira të reja për të përmbushur sa më mirë misionin kushtetues, në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individëve.

Ka rezultuar nga inspektimet e realizuara, se shërbimi shëndetësor për shëndetin mendor kishte të meta si në menaxhimin mjekësor dhe ekonomik, ashtu dhe në zbatimin e ligjit. Brenda shërbimit shëndetësor, qendrat psikiatrike mbeten “*Thembra e Akilit*” pasi përmbajnë një problematikë të theksuar dhe komplekse që pengon zhvillimin e një modeli të ri dhe bashkëkohor shëndetësor.

**A.** Në mënyrë të detajuar rezultatet e inspektimit të realizuara nga Njësia për Parandalimin e Torturës pranë Avokatit të Popullit, sipas kërkesave të Ligjit Nr.8092 dt.21.03.1996 “*Për Shëndetin Mendor*”, i janë dërguar Ministrisë së Shëndetësisë, përfshirë edhe rekomandimet përkatëse:

#### **Për spitalin psikiatrik Tiranë:**

1. Krijimin e një shërbimi më vete me personel kujdestar dhe edukator vetëm për fëmijë dhe adoleshentë duke i dhënë statusin e një klinike dhe shkëputjen e saj imediate nga godina e Psikiatrisë së të miturve.

2. Marrjen e masave urgjente për punësimin e punonjësve social dhe të një mësuesi pranë këtij reparti, pasi kjo kategori meriton një vëmendje specifike, e parë kjo edhe në këndvështrimin e përgjithshëm të këtij sistemi.

3. Përmirësimin e paisjeve hotelerikë si krevatë dhe komodina dhe zëvendësimin e xhamave të dritareve me xhama të pathyeshëm për sigurinë maksimale të pacientëve të strehuar.

Në përgjigje të Rekomandimit, Ministria e Shëndetësisë u angazhua për vënien në jetë të strategjisë së shëndetit mendor si dhe marrjen e masave për zbatimin e të gjitha rekomandimeve të bëra nga Avokati i Popullit në një kohë sa më të shkurtër.

#### **Për spitalin psikiatrik Elbasan**

1. Shtimin e organikës në mjekë psikiatër në Spitalin Psikiatrik Elbasan për një trajtim sa më të plotë të pacientëve të shtruar .

2. Marrjen e masave për nxjerrjen nga ky spital të pacientëve që janë të sëmurë mendorë kronike, pasi qëndrimi i tyre në këto ambiente ishte thjesht për arsye strehimi dhe jo kurimi.

3. Miratimin e një kuote të re ushqimore, pasi në gjëndjen aktuale të çmimeve në treg ajo nuk plotëson nevojat jetike të pacientëve.

4. Eliminimin e të gjitha mangësive të konstatuara në rekomandim.

Ministria e Shëndetësisë ju përgjigj Rekomandimit tonë, duke u angazhuar për vënien në jetë të Strategjisë së shëndetit mendor si dhe marrjen e masave për shtimin e mjekëve psikiatër pranë këtij spitali si dhe vazhdimin të negociatave me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe shanseve të Barabarta për zgjidhjen e kategorisë së të sëmurëve mendore kronik që strehohen në këtë spital. Gjithashtu kjo ministri sqaron se është në proces zgjidhje edhe ngritja e kuotës ushqimore për këtë kategori pacientësh.

### **Spitali Psikiatrik Vlorë**

1. Marrjen e masave emergjente për rikonstrukcion të godinave të Spitalit Psikiatrik në Vlorë.
2. Furnizimin me paisje hotelerie (veshmbathje, komodina, shtretër, paisje kuzhine) me qëllim përmirësimin e shërbimit shëndetësor psikiatrik.
3. Shtimin e kuotës ushqimore për të përballuar çmimet e tregu në rritje.
4. Shtimin e numrit të mjekëve dhe personelit tjetër ndihmës për përmirësimin e trajtimit të këtyre të sëmurëve.

### **Spitali psikiatrik Shkodër**

- Marrjen e masave emergjente për rikonstrukcionin total të Godinës së Spitalit Psikiatrik në Shkodër, si dhe zëvendësimin e të gjitha paisjeve hotelerike, me qëllim përmirësimin e shërbimit shëndetësor psikiatrik, për të ngritur standartet e tij.

Ministria e Shëndetësisë ju përgjigj rekomandimit tonë duke u angazhuar për ndërtimin e një godine të re me 35 shtreter për shërbimin akut si dhe ishte në proces ndërtimi tre shtëpitë “Mimoza”, që do të shërbenin për akomodimin e të sëmurëve kronike dhe përmirësimin e gjëndjes së tyre.

**B.** Njësia për Parandalimin e Torturës pranë Avokatit të Popullit, ka realizuar gjithashtu inspektime në Spitalin Infektiv të Tiranës dhe Repartin Infektiv në Spitalin Ushtarak.

Organeve qendrore përgjegjëse për rregullimin e gjëndjes ju rekomanduam:

1. Duke e konsideruar trajtimin e punonjësve si të pambështetur në ligj, Avokati i Popullit kërkoi të merreshin masa urgjente për zgjidhjen e situatës, pasi është detyrë e rëndësishme e institucioneve shtetërore që të marrin të gjitha masat e nevojshme ligjore dhe administrative për parandalimin apo minimizimin e rrezikut të transmetimit të këtyre infeksioneve spitalore tek personeli mjekësor.

2. Duke pasur parasysh mungesat në infrastrukturën përkatëse për implementimin sa më efektiv të masave parandaluese, një element i

rëndësishëm në këtë drejtim do të ishte mbështetja financiare që ministria duhet t'ë sigurojë për punonjësit e kësaj kategorie. Për këtë arsye kemi rekomanduar hartimin e një rregulloreje të veçantë të këtij spitali në lidhje me procedurat e trajtimit të pacientëve në kushte karantine.

3. Duke e konsideruar karantinën si një procedurë mjeksore që kufizon liritë dhe të drejtat e personit, Avokati i Popullit mendon se gjatë këtij trajtimi, stafi mjekësor duhet të jetë i trajnuar edhe për të drejtat e pacientëve dhe trajtimin e tyre në respekt të veçantë ndaj ligjit dhe dinjitetit njerëzor.

4. Eshte shumë e rëndësishme marrja e masave për, krijimin e ambjenteve të veçanta në spitalin infektiv për t'i paraprirë rasteve të epidemive që mund të sjellin futjen e tyre në karantinë, duke respektuar standartet.

5. Mbështetja financiare e punonjësve të stafit mjekësor që punojnë në spitalin infektiv (mjek dhe infermier) dhe konkretisht dhënia e shtesës për kushte pune të diferencuar nga kategoritë e tjera edhe sipas ligjit 8689, dt.16.12.2000, "Për Parandalimin e Përhapjes së Infeksionit HIV/AIDS" paraqitej e domosdoshme.

Përsa më sipër i jemi drejtuar Drejtorisë së Qendrës Spitalore Universitare dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Spitalit Ushtarak.

Në përgjigje të rekomandimeve, nga ana e Drejtoreshës së QSUT-së jemi njoftuar për ngritjen e një grupi pune për hartimin e rregullores së veçantë mbi kushtet e trajtimit të pacientëve në karantinë në Spitalin infektiv si dhe përmirësimin e kompensimit ekonomik të personelit që punon me këta pacientë. Në të njëjtën kohë dhe Drejtori i Përgjithshëm i Spitalit Ushtarak u informuam se shumë shpejt dhe ky institucion do të hartojë një rregullore të brëndshme të repartit të infektivit për trajtimin e pacientëve në karantinë.

Përsa i përket Rekomandimit lidhur me përmirësimin ekonomik të personelit që punon me këta pacient u informuam se, me Vendim të Keshillit të Minsitrave u parashikua shtesë për kushte pune, në masën 8000 (tetë mijë) lekësh, edhe për mjekët me tituj e grada shkencore, që janë pjesë e këtij shërbimi.

**C.** Gjatë vitit 2008 Institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar një sërë ankesash nga individë të ndryshëm apo dhe me inisiativë, nga të cilat përmendim:

**1.** Me inisiativën e Institucionit, pas shkrimit në Gazetën Shqiptare me titullin "*Policia shoqëron nënën, foshnja i vdes nga uria*" më datën 08.02.2008, dy ndihmës komisionerë kanë shkuar në vënd për verifikimin e ngjarjes. Nga verifikimet tona rezultoi se:

Shtetasi B. B. me familjen e tij ishte i ardhur nga Mirdita dhe vendosur në Fushë- Mamuras të Kurbinit para disa vitesh. Ai jetonte në

një banesë njëkatëshe, në kushte tejet të vështira, me bashkëshorten e tij dhe tre fëmijë të mitur. Por foshnja e prindërve Bushati, ka vdekur më datën 05.02.2008, rreth orës 16.30, pas 2 ditëve nga thirrja e Besnikut për t'u paraqitur në Komisarriatin e Policisë Kurbin. Foshnja, sipas punonjësve të shëndetësisë që e kanë vizituar, ka qënë shumë e dobët dhe në kushte të mosushqyerjes. Ata i kanë thënë prindërve të foshnjës për të shtruar atë në spital, por ata kanë refuzuar shtrimin dhe e kanë marrë me vete në shtëpi. Shtetasi dhe gruaja e tij ishin fajtorë, për ngjarjen e vdekjes së fëmijës së tyre. Gjëndja e tyre tejet e vështirë ekonomike, kushtet shumë të këqija të banimit, niveli i ulët arsimor, janë bërë shkak për mosushqyerjen dhe moskujdesjen ndaj fëmijës, me pasojë vdekjen e saj.

Si rrjedhojë konkluduar që në veprimet e punonjësve të policisë së shtetit në Kurbin nuk ka patur ndonjë shkelje. Fëmija ka vdekur 2 ditë pasi prindërit e saj kanë qënë në polici dhe vdekja, nuk ka ardhur për shkak të mosushqimit të foshnjës për atë kohë që ata kanë qënë në polici.

Në këtë çeshtje kemi konkluduar se shteti ynë nuk mund të vazhdojë praktikën e vjetër që të lejojë që për neglizhencë apo çdo shkak tjetër, prindërit apo kujdestarët e të miturve (fëmijëve), por edhe të të moshuarve si dhe personave me aftësi të kufizuara, të vendosin për jetën e tyre, në rastet kur shërbimi shëndetësor rekomandon që këta persona duhet të shtrohen në spital. Kujdestaria ligjore e tyre, në të drejtat e tyre civile, nuk duhet të shkojë deri në kufijtë që kujdestarët të vendosin për jetën e tyre. Prandaj ka ardhur koha që shteti të ndryshojë disa rregulla të vjetruara (p.sh. që prindi firmos në kartelë dhe nuk lejon shtrimin në spital për foshnjën për të cilën personeli shëndetësor rekomandon shtrimin apo dërgimin në spital). Prandaj kemi vlerësuar se ka vend për rregullimin e legjislacionit. Duke patur parasysh rastin konkret dhe faktin që nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë ishte duke u përgatitur Projekt Ligji “Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” i rekomanduam Ministrisë së Shëndetësisë të parashikonte në dispozitat përkatëse të Projektligjit:

1. Në nenin 9, “Përgjegjësitë dhe të drejtat e shtetasve”, tek pika 1, Shtetasit janë përgjegjës për:... të shtohet një paragraf tjetër, gërma “f” me këtë përmbajtje: “zbatimin e detyrave që kanë ndaj fëmijëve të sëmurë, të të moshuarve, personave me aftësi të kufizuara dhe mosrefuzimin e këshillave të mjekut për rastet e shtrimit të tyre në spital”.

2. Në nenin 15, “Shërbimi i urgjencës mjekësore”.... të shtohet në pikën 1 një paragraf me këtë përmbajtje: “Shërbimi i urgjencës mjekësore dhe mjeku specialist, për rastet kur shtetasit refuzojnë shtrimin në spital për fëmijët e sëmurë, të moshuarit apo personat me aftësi të kufizuara janë të detyruar të njoftojnë drejtorinë e shërbimit mjekësor nga varen si

dhe drejtuesit e pushtetit vendor për të marrë masa që i sëmuri të shtrohet në spital”.

Në përgjigje të ndërhyrjes tonë jemi informuar zyrtarisht se Kryeministri ka porositur Ministrinë e Shëndetësisë të marrë parasysh këto rekomandime në përmirësimin e legjislacionit.

2. Ankesën e shtetasit B. GJ., banues Tiranë. Prej kohësh në katin e 9-të pallatit ku ai banon ushtron aktivitetin privat Laboratori “Nora Med”. Në këtë laborator kryen analiza për pacientë me sëmundje nga më të ndryshmet. Shqetësimi i ankuesit dhe banorëve të tjerë kishte të bënte me faktin se pacientët e laboratorit, të cilët mund të vuajnë nga sëmundje që janë ngjitëse, përdorin të njëjtat ambiente të përbashkëta me banorët e pallatit. Kështu i njëjti ashensor përdorej për pacientët dhe për transportimin e mbeturinave të laboratorit.

Në përfundim të hetimit ndërhyrja jonë u realizua në dy drejtime;

*Së pari*, në drejtim të kontrollit të zbatimit të ligjshmërisë nga ana e këtij subjekti gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij. Konstatimet tona ju referuan organeve kompetente, konkretisht Inspektoriatit Sanitar Shteteror i jemi drejtuar me *Rekomandim për ushtrimin e kontrollit ndaj Klinikës Mjekësore “Nora Med”*. Në përgjigje të këtij rekomandimi, u informuam se Inspektoriatit Sanitar Shteteror ushtroi kontrollin përkates, nga i cili rezultoi se veprimtaria e këtij subjekti ushtrohet konform kërkesave të parashikuara në ligj.

*Së dyti*, në drejtim të përmirësimit të akteve ligjore e nënligjore që parashikojnë kriteret të cilat duhet të përmbushë një subjekt për të ushtruar një veprimtari private në fushën e Shëndetësisë.

Nga trajtimi i rasteve konkrete, kemi konstatuar se Klinikat mjekësore private, shumica prej tyre, e ushtrojnë aktivitetin e tyre në apartamente brënda një pallati ku banojnë individë të ndryshëm. Si pasojë, pacientët të cilët do t’i nënshtrohen ekzaminimeve përkatëse, që mund të vuajnë nga sëmundje të ndryshme, edhe ngjitëse, përdorin të njëjtat ambiente, si ashensor, shkallë etj, si dhe banorët e pallatit. Pa përmendur këtu transportin që mund t’i bëjnë mbeturinave të cilat mund të jenë dhe të rrezikshme.

Duke ju referuar akteve ligjore e nënligjore që janë në fuqi, konkretisht Ligjit “Për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse”, V.K.M. Nr. 238 datë 10.04.2003 “Për liçensimin e veprimtarive private në fushën e Shëndetësisë”, arritëm në konkluzionin se në këto akte nuk rezultojnë kërkesa specifike lidhur me kushtet e objektit fizik ku subjekti do të ushtrojë veprimtarinë e tij. Por nga ana jonë është konstatuar fakti se që laboratorit apo klinika ka një ambient me vete, apartament, nuk parandalon përhapjen e sëmundjeve të caktuara tek banorët e pallatit.

Në keto kushte kemi shprehur mendimin se para hartimit të akteve të reja nënligjore të ngrihet një grup ekspertësh që të për caktojë se sa



është risku që banorët e një pallati marrin përsiper kur përdorin të njëjtat ambiente me të sëmurë që kërkojnë të diagnostikohen në klinikat private të cilët ushtrojnë aktivitetin në pallatin e tyre.

Gjithashtu, është konstatuar se, aktet ligjore e nënligjore në fuqi nuk parashikojnë asnjë strukturë kontrolluese lidhur me standartin e shërbimit shëndetësor të ofruara nga ana e subjekteve private të licencuar nga Ministri i Shëndetësisë. Sa më sipër nevojitet që si në Ligjin “Për Kujdesin Shëndetësor” dhe në aktet nënligjore që do të dalin në zbatim të tij, të parashikohet ngritja e një strukture të tillë.

Një konstatim tjetër që ka dalë nga ankesa ka të bëjë me formatin zyrtar të dokumentacionit që duhet të plotësoje aplikuesi për të marrë leje të ushtrimit të një veprimtarie në fushën e Shëndetësisë.

Përmendim këtu raportin vlerësues, për të cilin kemi konstatuar se ky dokument ka të meta kryesisht nga ana formale. Konkretisht, në vlerën e raportit të eksperteve, në dosjet e aplikuesve, ekziston një dokument që titullohet “*Formulari për hapjen e laboratorit mjekësor klinik-biokimik privat*”, i cili plotësohet nga aplikuesi. Në fund të këtij formulari, firmosin disa persona, të cilët sipas shpjegimeve verbale të specialistëve të sektorit të licencimit, janë mjekë të specializuar në drejtimet ku do të zhvillohet veprimtaria e subjektit të caktuar. Pra vlen për t’u theksuar se ky dokument ka një rëndësi shumë të madhe përse i përket ligjshmërisë së veprimtarisë së subjektit, për këtë arsye ai duhet të hartohet duke respektuar elementët thelbësor të një dokumenti zyrtar. Hartuesit e tij duhet të detajojnë se sa kërkesat ligjore e nënligjore janë respektuar nga subjekti konkret aplikues. Natyrisht, është e rëndësishme të theksojmë se, nuk mundet të kontrollohet respektimi i kërkesave ligjore nëpërmjet një formulari i cili ka vetëm dy alternativa, të cilat nuk mund të japin një përgjigje të saktë për realitetin faktik.

Pas këtyre konstatimeve, duke qënë se jemi vënë në dijeni se Ministria e Shëndetësisë ka përfunduar procesin e hartimit të projektligjit “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i jemi drejtuar me rekomandim konkretisht për *Përmirësimin e akteve ligjore e nënligjore të cilët parashikojnë standartet që duhet të plotësojnë personat fizike a juridike që të ushtrojnë një aktivitet privat në fushën e Shëndetësisë*. Në përgjigje të këtij Rekomandimi jemi informuar se rekomandimet tona do të merren në konsideratë në hartimin e akteve të reja ligjore e nënligjore.

**3.** Urdhëri i Farmacistëve si një ent publik, i cili është ngritur dhe funksionon në bazë të Ligjit Nr.9150, date 30.10.2003, ka parashtruar disa sugjerime lidhur me ndryshimet e Ligjit Nr.9323, date 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”.

Institucioni i Avokatit të Popullit si një institucion që mbron të drejtat dhe liritë themelore të individëve, më shumë se çdo gjë tjetër vlerëson jetën dhe shëndetin e shtetasve dhe për këtë arsye, si një

mediator nuk ka nguruar dhe nuk nguron të gjejë forma sa më efektive institucionale për të përmbushur misionin e tij kushtetues të garantimit të tyre.

Me qëllim për të motivuar ndryshimet ligjore, gjithkush që është faktor apo aktor i shërbimit farmaceutik, aq më tepër Urdhëri i Farmacistëve, duhet të marrë pjesë dhe të jetë një grup shumë i rëndësishëm i interesit që të shprehë mendimet dhe sugjerimet e tij, në drejtim të përmirësimit të standardeve që kërkon koha dhe ritmi i zhvillimit.

Për këtë arsye, Ministrit të Shëndetësisë i është sugjeruar të mirëpresë dhe të pasqyrojë vërejtjet dhe mendimet e Urdhërit të Farmacistëve dhe për t'i materializuar ato në ndryshimet e ligjit të sipërcituar.

Në përgjigje të sugjerimit tonë, u informuam se nga ana e Ministrit të Shëndetësisë, do të ngrihej një grup pune ku do të merrnin pjesë të gjithë grupet e interesit në hartimin e aktit ligjor.

**4.** Ankesën e shtetasit L.Z., lidhur me refuzimin e KMCAP për të pranuar një raport të nxjerrë nga një klinikë private.

Ankuesi shpjegoi se ka qënë i detyruar t'i bëjë një ndërhyrje kirurgjikale nipit të tij në një Klinikë Private, pasi në Spitalet shtetërore nuk i jepnin sigurinë për gjëndjen pas operatore. Megjithatë në kushte të vështira ekonomike, ai mundi të sigurojë këtë ndërhyrje në një klinikë private, pikërisht në Klinikën "Royal Diagnostik Center". Pas këtij operacioni raporti mjekësor i mjekut përkatës, u dërgua në KMCAP për të përfituar me pas ndihmën ekonomike për një vit. Ky raport nuk ishte pranuar nga KMCAP me pretendimin se duhej një vullë nga QSUT. Natyrisht Qendra Spitalore Universitare nuk mund të vendoste një vullë në një raport që nuk ishte prodhuar prej saj. Në këto kushte ai ka mbetur pa rrugë zgjidhje, për të vetmen arsye që si zgjidhje të vetme të shqetësimit të tij ka zgjedhur një Klinikë Private, zgjedhja ka qënë si alternativë e vetme shpëtimi për nipin e tij të mitur. Gjithashtu kjo klinikë është e licencuar nga shteti me të gjitha të drejtat dhe detyrimet ligjore.

Institucioni ynë edhe më parë e ka ngritur këtë shqetësimin me Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, për rastin e bërë prezent nga përfaqësuesit e Klinikës "Royal Diagnostik Center". Por përgjigjia e mbërritur nga kjo Drejtori, i referohej një përgjigje që Ministria e Shëndetësisë i ka përcjellë Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta, sipas të cilës për të gjitha rastet e drejtuara në KMCAP, të zbatohet Rregullorja datë 30.05.2005 "Për organizimin, të drejtat, detyrat dhe funksionimin e Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për punë të Invalidëve", rregullore e cila miratohet nga I.S.SH dhe Ministria e Shëndetësisë.

Sipas kesaj Rregullore, Kreu III, pika 1 parashikon se :...drejtimi për në KMCAAP bëhet nga *institucionet mjekësore me shtretër*, kur i sëmuri drejtohet në KMCAAP për herë të parë, duke u pajisur me Fletë Drejtimi për në KMCAAP”.

Sipas Drejtorisë Planifikimit Spitalor pranë Ministrisë së Shëndetësisë, del se në rregulloren e datës 30.05.2005, të sipërcituar, përcaktohet se drejtimi për herë të parë në K.M.C.A.P, behet nga institucionet mjekësore me shtretër, duke i pajisur me Fletë Drejtimi për në KMCAAP”, pra nuk përcaktohet nëse duhet të jenë publike apo private. Pra nuk përjashtohen institucionet private me shtretër nga ky rregull.

Duke qënë se ekzistojnë institucione me shtretër private, të cilat janë liçensuar rregullisht dhe mbikqyren nga Ministria e Shëndetësisë, nuk ka asnjë shkak apo arsye se, përse ato duhet të kufizohen nga ushtrimi i kësaj të drejtë, e cila përderisa nuk pengohet ligjërisht lejohet, aq më tepër që vetë rregullorja nuk ka parashikuar ndonje klauzolë të tillë përjashtuese.

Nuk ekziston asnjë shkak i ligjshëm, që pacientët që kurohen në kushte spitalore në Klinikat Private, sikurse është rasti që ju bëjmë prezent, të mos kenë të gjitha të drejtat sikurse pacientët e tjerë që kurohen në institucionet mjekësore shtetërore, aq më tepër që jo të gjitha shërbimet ofrohen nga këto të fundit.

Ky konkluzion i zyrës tonë ishte i njëjtë dhe me qëndrimin e Ministrisë së Shëndetësisë për këtë çështje, e cila na informoi se nisur nga këto shqetësime, Drejtoria e Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Ministria e Shëndetësisë kanë ngritur një grup pune të përbashkët për rishikimin e Rregullores “Për organizimin, të drejtat, detyrat dhe funksionet e Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë të Invalidëve”, për t’i dhënë zgjidhje përfundimtare këtyre shqetësimeve.

Nga sa më sipër, duke vlerësuar se aktet ligjore dhe nënligjore nuk kishin asnjë pengesë për të marrë fletën e drejtimit, pavarësisht klinikës ku trajtohen të sëmurët nëse janë private apo publike, iu drejtuam me një Rekomandim Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore. Ky rekomandim u pranua nga ana e Drejtorisë Arsimore Rajonale duke zgjidhur pozitivisht ankesën.

**5.** Ankesën e tre të plagosurve nga tragjedia e datës 15.03.2008 në Gërdec dhe të kuruar në spitalin e Barit, Itali.

Konkretisht shtetasit M. H., K.K. dhe A.S ishin dërguar për kurim në Spitalin e Kirurgjisë Plastike në Bari, Itali. Pas disa ditësh kurimi, se bashku me familjaret që i kanë shoqëruar u kthyen në Shqipëri.

Për të vëzhguar gjëndjen e tyre, ju ishte planifikuar një vizitë tjetër mjekësore. Për këtë qëllim ata kishin plotësuar dokumentacionin e nevojshëm së bashku me epikrizën e spitalit në Bari dhe i dorëzuan dosjet

pranë Ministrisë së Shëndetsisë për të kërkuar vizat në konsullatën italiane.

Të tre të plagosurit e mësipërm, humbun tre data takimesh vizitash pranë spitalit të Barit për arsye të vonesave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe jo vetëm kaq, por situata e tyre shëndetësore u rëndua.

Në keto kushte nga ana jonë ju dërgua Rekomandim Ministrinë të Shëndetësisë për të marrë masat e nevojshme për të bërë të mundur dërgimin e tyre sa më parë në Spitalin e Barit. Ky rekomandim u pranua dhe të sëmuret, ndonëse me vonesë, morën vizat dhe shkuan në Itali.

## 11. Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Gjatë vitit 2008, arsimit dhe shkenca, dy nga degët kryesore të veprimtarisë së administratës, janë përballur me sfidat të cilat kanë derivuar kryesisht nga zbatimi i Planit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit. Në këtë kontekst, ngritja e nivelit të arsimit të përgjithshëm, arsimit dhe trajnimit profesional, arritja e objektivave të Deklaratës së Bolonjës për sistemin e arsimit të lartë, garantimi i mosdiskriminimit në bazë të gjinisë, ngjyrës, origjinës etnike ose fesë në të gjitha nivelet e arsimit dhe trajnimit, si dhe rritja e nivelit të strukturave dhe veprimtarive arsimore dhe trajnuese, janë disa nga drejtimet kryesore të zhvillimeve pikërisht në këtë fushë.

Gjatë vitit 2008 ka patur 43 ankesa apo kërkesa të ardhura ndaj Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe institucioneve në vartësi të saj. Janë në fazën e shqyrtimit pranë Zyrës sonë 7 ankesa. Në favor janë zgjidhur 8 ankesa apo kërkesa, kanë qenë jashtë juridiksionit dhe kompetencës 16 ankesa, të pabazuara 5 ankesa, ndërsa për 1 çështje rekomandimi dërguar organit përkatës është refuzuar. Për 4 ankesa subjektet kanë hequr dorë nga trajtimi i tyre

Nga viti 2007 janë mbartur për shqyrtim 20 ankesa, nga të cilat 4 janë zgjidhur në favor, 3 jashtë juridiksionit dhe kompetencës, 10 të pabazuara, 1 rekomandim është refuzuar, 1 është pranuar dhe për 1 ankesë subjekti ka hequr dorë nga trajtimi i saj.

Një numër jo i vogël ankesash kanë patur si objekt marrëdhëniet e punësimit në sektorin e arsimit, duke filluar që nga problemi i pagesës, shpërblimeve, trajtimeve të veçanta apo edhe i largimeve nga puna të mësuesve.

Në raportin e vitit të kaluar, kemi ngritur një sërë problemesh që lidhen me mënyrën e rregullimit ligjor të marrëdhënieve të punës së personelit mësimdhënës në sistemin parauniversitar, ashtu dhe në drejtim të moszbatimit të drejtë të këtij kuadri ligjor nga ana e organeve përgjegjëse. Ne kemi rekomanduar :

- Domosdoshmërinë e rregullimit të posaçëm ligjor apo nënligjor të kushteve dhe kriterëve që duhet të përmbushë një person që të punësohet si mësues në arsimin parauniversitar.

- Parashikimi në mënyrë të qartë dhe pa ekuivoqe i procedurës së aplikimit për vend pune, si dhe i mënyrës së zgjidhjes së konflikteve që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës për personelin mësimdhënës në arsimin parauniversitar

- Ballafaqimin e mendimeve të grupeve të interesit, në procesin e hartimit të Dispozitave të reja Normative për arsimin parauniversitar, në mënyrë që të jenë jo vetëm në përputhje me ligjet, por dhe me kushtet e reja të cilat janë bërë prezente.

Ne kemi shprehur mendimin se në projekt ligjin “Për lirinë e fesë dhe marrëdhëniet e ndërsjella me shtetin”, duhet të shtohet një parashikim, pikërisht në nenin që trajton kufizimet e lirisë së fesë.

Për këtë kemi propozuar që neni të ketë përmbajtje:

*“Ndalohet mbajtja e shenjave ose veshjeve, në Institucionet e sistemit arsimor parauniversitar publik nëpërmjet të cilave mësuesit dhe nxënësit manifestojnë në mënyrë dukshme përkatësinë e tyre fetare”.*

Ky rekomandim i është dërguar Komitetit Shtetëror të Kulteve si dhe për dijeni Kryeministrit, Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministrit të Arsimit dhe Shkencës si dhe Ministrit të Drejtësisë.

Nga ankesat e trajtuara përmendim:

1. Ankesën e punonjësve të Qendrës së Fizikës Bërthamore të Zbatuar aktualisht në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, të Universitetit të Tiranës (ish Instituti i Fizikës Bërthamore) nga punonjësit prej 3 janarit të vitit 2008 dhe në vazhdim, si dhe për faktin se procesi i reformimit po realizohej duke mos zbatuar asnjë dispozitë të Kodit të Punës, mosveprim i cili solli shumë shkelje të tjera të së drejtës së këtyre punonjësve.

Gjatë shqyrtimit të ankesës ka rezultuar se:

Gjatë reformimit të këtij Instituti u konstatuan shumë shkelje të të drejtave kundrejt punonjësve dhe të procedurave që duhet të ndiqeshin. Jo vetëm kaq, por zvarritjet pa shkak të Ministrisë së Arsimit sollën një sërë pasojash, të cilat duhet të rregullohen me investimin e gjithë organeve përgjegjëse, por kryesisht të Ministrisë së Arsimit.

Gjithashtu kemi konstatuar se Vendimi i Keshillit të Ministrave Nr.563 date 22.08.2007 "Për krijimin e Qendrës së Fizikës Bërthamore të Zbatuar dhe Autoritetit Atomik Shqiptar, pranë Universitetit të Tiranës", i cili ka dalë me propozim të Ministrit të Arsimit e Shkencës, ka rregulluar vetëm çështje të tilla si krijimin e kësaj Qendre, ndryshimin e varësisë administrative dhe numrit e punonjësve respektive, por nuk ka zgjidhur pasojat që vijnë si rezultat i kësaj reforme, pra të ish punonjësve që dalin

të papunë dhe ju shkurtohet vendi i punës, ndërkohë që pjesa më e madhe e tyre janë profesorë me tituj dhe grada shkencore, me eksperiencë pune shumë vjeçare.

Ne keto kushte, u çmua e nevojshme që të iniciohej nga Ministria e Arsimit nxjerrja e një akti nënligjor nga Qeveria, ku të përcaktoheshin saktësisht zgjidhja e pasojave në drejtim të trajtimit financiar të ish punonjësve të Institutit të Fizikës Berthamore, të cilët do të dilnin të papunë nga zbatimi i kësaj reforme.

Duke qënë se rasti konkret nuk preku thjesht një individ por një grupim jo të vogël individësh, të cilët vuajten pasojat e barrierave të panevojshme administrative që thjesht ndërlikojnë sistemin dhe nuk e bëjnë atë efikas, i jemi drejtuar me rekomandim Ministrisë së Arsimit dhe Rektoratit të Universitetit të Tiranës, për marrjen e masave administrative dhe bashkëpunimin midis organeve përgjegjëse që investon Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.563 date 22.08.2007 "Për krijimin e Qendrës së Fizikës Berthamore të Zbatuar dhe Autoritetit Atomik Shqiptar", për zgjidhjen e pagimit të pagës së papaguar deri tani, për ish punonjësit e Institutit të Fizikës Berthamore, për periudhen 3 janar deri në 1 Prill të vitit 2008, si dhe inicimin e Ministrisë së Arsimit pranë Qeverisë për nxjerrjen e një akti nënligjor që do të rregullojë pasojat e kësaj reforme, në drejtim të trajtimit financiar të punonjësve që dalin të papunë nga zbatimi i saj. Ky rekomandim nuk është pranuar nga Ministria e Arsimit. Në këto kushte ankuesit u orientuan të ndjekin rrugën gjyqësore.

2. Ankesën e shtetasit A. V., i cili në vitin 2008, duke dashur që t'i nënshtrohet përsëri provimeve të lëndëve me zgjedhje për të vazhduar studimet e larta, u gjend para refuzimit nga ana e Drejtorisë Arsimore Tirane për t'u rregjistruar. Kjo pasi nuk dispononte diplomën origjinale të pjekurisë, pasi i kishte humbur së bashku me një sërë dokumentash të tjera të cilat ndodheshin në makinën që i kishin vjedhur.

I gjendur në këto kushte, ai kishte kërkuar lëshimin e duplikatës nga shkolla e mesme, por ajo i ishte refuzuar duke mos ju dhënë as arsytet ligjore të këtij refuzimi.

Në keto kushte ai u ankua kundër pengesave administrative për të realizuar të drejtën e tij kushtetuese për arsimim, pra për të vazhduar studimet e larta.

Sipas qëndrimit të mbajtur nga administrata e arsimit për të gjithë ata persona të cilëve për një arsye ose tjetër i ka humbur Deftesa origjinale e pjekurisë, ju mohohet në mënyrë kategorike e drejta për të vazhduar studimet e larta, pasi ata nuk pranohen të rijapin provimet me zgjedhje, si kusht për vazhdimin e studimeve të larta. Ne gjykojmë se përjashtimi kategorik është i papranueshëm dhe shkel të drejtat e njeriut. Shteti nëpërmjet organeve dhe personave kompetente duhet të gjejë

zgjdhjet ligjore për të bërë të mundur që shtetasit e tij të realizojnë me barazi të drejtat e shpallura nga Kushtetuta dhe ligjet përkatëse.

Në këto kushte i kemi rekomanduar Ministrit të Arsimit dhe Shkencës që kësaj pike të Rregullores për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit, duhet t'i shtohet dhe një paragraf ku të parashikohet e drejta për t'u rregjistruar për provimet me zgjedhje edhe për ata persona të cilët nuk kanë diplomë origjinale të pjekurisë, por kanë dokumenta të cilët provojnë mbarimin e shkollës së mesme, duke theksuar detyrën e organit kompetent të verifikojë vertetësinë e dokumentacionit të paraqitur.

Në përgjigje të Rekomandimit, nga ana e Ministrisë së Arsimit jemi informuar se sygjerimet tona do të merren në konsideratë nëse do të bëhet një rishikim i nenit 26 të Rregullores.

## 12. Ministria e Punëve të Jashtme

Zyra e Avokatit të Popullit, nëpërmjet trajtimit të ankesave të prezantuara pranë saj, me rekomandimet dhe ndërhyrjet përkatëse, ka synuar të ndikojë për një veprimtari ligjore dhe sa me efikase jo vetëm të strukturave të Ministrisë së Punëve të Jashtme në Shqipëri, por dhe të misioneve të saj diplomatike e konsullore që veprojnë jashtë.

Ne zbatim të funksioneve kushtetuese e ligjore të Institucionit të Avokatit të Popullit, bashkëpunimi me Ministrinë e Punëve të Jashtme për përgatitjen e raporteve në zbatim të Konventave në të cilat vendi ynë ka aderuar, ka rezultuar i suksesshëm.

Vlen të përmendet këtu:

1- Kontributi për hartimin e Raportit periodik 5-7 të Shtetit Shqiptar për "Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit Racial (IERCD) për tu paraqitur pranë Komitetit përkatës të OKB-se.

2. Kontributi për hartimin e Raportit të 3-te Periodik për Konventën e OKB-se për "Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave CEDAW", për tu paraqitur pranë Komitetit përkatës të OKB-se.

3- Kontributi lidhur me Opinionin e Dytë të Komitetit Këshillues të Konventës Kuadër për Minoritetet.

Gjate vitit 2008 ka patur dhe janë shqyrtuar 41 ankesa dhe kërkesa për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ambasadat dhe Konsullatat e Republikës së Shqipërisë. Ka rezultuar se 12 ankesa kanë qene jashtë juridiksionit të Zyrës së Avokatit të Popullit, 14 ankesa i janë dërguar për kompetence Drejtorisë Konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe

Ambasadave, 8 ankesa janë zgjidhur ne favor te kërkuesit dhe 7 ankesa janë ende ne shqyrtim.

Disa prej ankesave kane te bëjnë me pretendime te ndryshme te qytetareve shqiptare kundër përfaqësive diplomatike te vendeve te huaja te akredituara ne Shqipëri, prandaj ato cilësohen jashtë juridiksionit tone.

Ne përfundim te shqyrtimit te ankesave, duke patur parasysh specifikën e tyre, ankuesve u është dhënë ndihmesa dhe konsulenca e nevojshme ligjore dhe ne raste te tjera praktikë i janë kaluar për kompetence Drejtorisë Konsullore te Ministrisë se Punëve te Jashtme.

Nder ankesat e marra ne shqyrtim nga Zyra e Avokatit te Popullit, përmendim:

1. Ankesa e disa shtetasve shqiptare lidhur me tarifat e larta që duhet të paguajnë për shërbimet telefonike dhe legalizimet e dokumenteve me përfaqësitë e huaja diplomatike te akredituara ne Shqipëri.

Konkretisht, ankuesit te cilët punojnë dhe jetojnë ne Greqi ose edhe ne Shqipëri, legalizimet e dokumentave te cilat ju duhen për nevojat e tyre ne shtetin fqinjë, tashme i bëjnë pranë Ambasadës Greke ne Tirane. Sipas tyre, vetëm për te përcaktuar kohen e takimit me sektorin konsullor te Ambasadës, atyre u duhet te paguajnë rreth 1 000 leke te reja shpenzime telefonike. Lidhja telefonike kryhet me numrat për telefonat celulare 09004044004 ose 09007074000, ne një kohe qe ka mjaft mundësi qe te behet instalimi me linja normale te telefonit me kabëll (jo mobile). Gjithashtu pre legalizimin e një dokumenti (p.sh një çertifikate), shtetasit shqiptare paguajnë 2800 leke te reja. Pra, shpenzimet qe duhet te bëjnë ata (shtetasit shqiptare) janë tepër te larta, krahasuar me nivelin mesatar te të ardhurave te tyre.

Pretendimi qe ankuesit parashtruan ishte se bazuar ne parimin e reciprocitetit, Ambasadat e shteteve te mësipërme kur vendosin tarifat për shërbimet e ofruara, duhet te ketë ne konsiderate trajtimin respektiv qe u behet shtetasve greke, italiane apo franceze për te njëjtat shërbime nga Konsullatat e Shtetit Shqiptar ne ato vende. Kjo ankesë ka mbetur pa përgjigje nga Ministria e Jashtme.

2. Ankesa e një grupi ish ambasadorësh te Republikës se Shqipërisë. Objekti i saj ishte mosparashikimi ne buxhetin e Ministrisë se Punëve te Jashtme te fondit te kontributeve të sigurimeve shoqërore për bashkëshortët/et e nëpunësve të përfaqësive diplomatike të vendit tone, ashtu siç dhe përcaktohet shprehimisht në nenin 46, paragrafi 1 të Ligjit nr.9095 datë 3.07.2003 "Për Shërbimin e Jashtëm në Republikën e Shqipërisë": "Për personelin e Përfaqësive Diplomatike, koha e qëndrimit jashtë shtetit i njihet për efekt të vjetërsisë në punë dhe të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore edhe



bashkëshortit/es, i cili/e cila shoqëron nëpunësin në përfaqësinë diplomatike".

Për shqyrtimin e kësaj ankese, shkëmbyem korrespondencën përkatëse me Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme e me pas dhe me Ministrin e Financave, Ministrin e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta si dhe me Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

Ankuesit shpjeguan se janë munduar që këtë problem ta zgjidhin në rrugë institucionale me strukturat përkatëse të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Por sipas tyre: "megjithë dëshirën e mirë të shprehur nga strukturat përkatëse, për fat të keq konstatojmë që edhe në buxhetin e Ministrisë për vitin 2008 nuk është parashikuar zgjidhja financiare e këtij problemi".

Nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme, jemi sqaruar se:

“Ministria e Punëve të Jashtme me Urdhrin nr. 406 date 3.09.2007 ka ngritur grupin e punës për këtë problem, i cili konkludoi lidhur me numrin e personave ndaj të cilëve duhet të derdhet ky kontribut që nga viti 1994, në mënyrë që të bëhet përlllogaritja e fondit përkatës. Drejtoria e Financës në Ministrinë e Punëve të Jashtme duke mos pasur një akt zyrtar ku të përcaktohet paga baze mbi të cilën do bëhet përlllogaritja e fondit që do të duhej për të përballuar këto kontribute për kategorinë e parashikuar në ligj, ka kërkuar përcaktimin e kësaj page nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale duke bërë me dije për këtë problem edhe Ministrinë e Financave. Aktualisht Institucionet në fjalë ende nuk kanë kthyer një përgjigje mbi bazën e se cilës do të vijohet me tej. Pas përgjigjes së Institucioneve në fjalë dhe në përputhje me to, MPJ do të hartojë projektvendimin për tu miratuar nga Këshilli i Ministrave duke i dhënë zgjidhjen përfundimtare këtij problemi”.

Mbi këtë baze ju drejtuam me pas për shpjegime Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministrisë së Financave.

Në përgjigjen e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta sqarohet se:

“Mbështetur në Ligjin nr.7703 date 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në RSH" nënin 58, pika 2 “Këshilli i Ministrave mund të deklarojë edhe periudha të tjera si periudha të sigurimit duke u derdhur kontributi në fondin e sigurimit shoqëror nga buxheti i shtetit” si dhe duke qenë se Ligji nr.9095 date 3.07.2003 “Për Shërbimin e Jashtëm në RSH” nënin 46 ju njeh kohen e qëndrimit jashtë shtetit, për efekt të vjetërsisë në punë, bashkëshortit/es të cilët shoqërojnë nëpunësin në përfaqësinë diplomatike, buxheti i shtetit duhet të paguaje kontributet mbi bazën e pagës minimale mujore për efekt kontributesh të sigurimeve

shoqërore e shëndetësore, te caktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave”.

Rezulton gjithashtu se Instituti i Sigurimeve Shoqërore, i është drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme për këtë problem me disa shkresa, duke kërkuar:

“a- Hartimin e një projektvendimi për mbulimin me fonde, me destinacion pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për personelin që shoqëron nëpunësin në përfaqësinë diplomatike, për sigurimin e periudhave të kaluara të tyre.

b- Programimin e fondeve për sigurimin e personelit që shoqëron nëpunësin në përfaqësinë diplomatike gjatë hartimit të treguesve të projektbuxhetit, për vitin e ardhshëm.

Përveç kësaj në këto shkresa Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka shprehur gatishmërinë për të dhënë ndihmën me specialiste të sigurimit dhe të pensioneve. Por nga Ministria e Jashtme nuk i është kthyer asnjë përgjigje dhe nuk kanë pasur asnjë kërkesë për bashkëpunim”.

Pra rezulton se të paktën që nga viti 2005 problemi qëndron i pazgjidhur nga neglizhenca e strukturave që merren me Buxhetin dhe Personelin në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Kështu që kjo kategori personash, pra bashkëshortët/et e nëpunësve të përfaqësive tona diplomatike nuk kanë përfituar ende nga parashikimi i bere në nenin 46, paragrafi 1 të Ligjit nr.9095 datë 3.07.2003 "Për Shërbimin e Jashtëm në Republikën e Shqipërisë", ndonëse mund të këtë prej tyre që humbasin mjaft për mospërfitim të pensionit që ju takon.

Për këtë qëllim në Qershor 2008 i kemi rekomanduar Ministrin të Punëve të Jashtme:

1. Marrjen e masave të shpejta për zgjidhjen e problemit të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për bashkëshortët/et, që shoqërojnë nëpunësin në përfaqësinë diplomatike.

2. Fillimin e ecurisë disiplinore për shqyrtimin e punës së personave përgjegjës për këtë çështje, me qëllim marrjen e masave administrative për moskryerje të detyrës së tyre.

Megjithëse kemi kërkuar përgjigje lidhur me Rekomandimin në fjale, nga ana e kësaj Ministrie nuk kemi marrë asnjë lloj përgjigjeje zyrtare. Problemi ende nuk ka marrë zgjidhjen e kërkuar, prandaj në vazhdojmë ta kemi në ndjekje.

Shumica e ankesave të prezantuara pranë nesh kanë të bëjnë me pengesat që hasin shtetasit shqiptarë si jashtë vendit, por edhe në Shqipëri, lidhur me legalizimin e dokumentave, dhënien e vizave për qëllime të ndryshme etj.

Në këndvështrimin tonë, mbështetur në detyrimin ligjor që ka Shteti Shqiptar në mbrojtje të interesave të Republikës së Shqipërisë dhe shtetasve ose personave juridike të saj, brenda kufijve të lejuar nga e

drejta ndërkombëtare, Ministria e Punëve të Jashtme dhe përfaqësitë tona diplomatike e konsullore jashtë vendit, kanë mundësi dhe hapësira të bëjnë me shume për t'i ardhur në ndihmë shtetasve shqiptare.

### 13. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

Numri i ankesave të shqyrtuara nga Institucioni ynë lidhur me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSSHB) si dhe të institucioneve në varësi të saj, Shërbimin Social Shteteror, Shërbimin Kombëtar të Punësimit, Inspektoriatin Shteteror të Punës si dhe strukturat e tyre në rrethe ka qenë **40**.

Numri i ankesave për vetë Ministrinë ka qenë **31**. Nga këto janë përfunduar **28** ankesa. Kanë rezultuar **6** ankesa të pabazuara, **5** jashtë juridiksionit, **9** për moskompetencë, **7** të zgjidhura në favor të ankuesve, **1** heqje dorë dhe janë në proces shqyrtimi **3** ankesa. Gjithashtu janë shqyrtuar dhe përfunduar **2** ankesa të mbartura nga viti 2007 e kanë rezultuar **1** ankesë e pabazuar, **1** ankesë jashtë kompetence.

Qytetarë të ndryshëm janë ankuar për probleme të marrëdhënieve të punës, për moszbatim të Kodit të Punës për pagesat e punonjësve, për problemet në fushën e sigurimeve shoqërore etj.

Në vijim po trajtojmë disa nga problematikat e ankesave që janë shqyrtuar:

**1.** Shoqata e Invalidëve të Punës në Tropojë paraqiti ankesë pranë Institucionit tonë për moszbatim të drejtë të Vendimeve të Këshillit të Ministrave për Invalidët e Punës në lidhje me mosrritjen e pensioneve për shkak të çmimeve, për të drejtën e punësimit etj.

Nga Ministria e Punës na u konfirmua fakti se me urdhër të Kryeministrit është ngritur grupi ndërministror i punës, i cili po vazhdon punën me përfaqësues nga MPÇSSHB-ja, Ministria e Financave, dhe me ekspertë të Bankës Botërore. Qëllimi i këtij grupi është reformimi i sistemit të sigurimeve shoqërore dhe konkretisht përmirësimi i skemës së pensioneve, nëpërmjet përmirësimit të legjislacionit ekzistues.

Gjithashtu në muajin Mars 2008 me përfaqësues nga Ministria e Financave, Ministria e Punës, Ministria e Drejtësisë dhe me grupet e interesit ka filluar puna për hartimin e Projekt-Vendimit “Për statusin dhe kriteret e përfitimit të statusit të invalidit të punës”.

E drejta për punësim të invalidëve të punës jo vetëm që është e sanksionuar në legjislacionin e punës, por edhe është trajtuar me përparësi, por sipas tyre, vështirësia qëndron në hapjen e vendeve të punës për këtë target grup.

Invalidët e punës kanë të drejtën e formimit falas në kurset e formimit profesional. Në këtë kuadër u informuam se në kurset që ofronte Qendra e Lëvizshme për Zonën Verilindore në Kukës, Pukë dhe Bajram Curri, e cila ka filluar të funksionojë që nga viti 2007 për invalidët e punës ishte hapur vetëm kursi i gjuhës së huaj. Do të operohej dhe me kurse të tjera profesionale, në të cilat mund të përfshihen edhe invalidët e punës.

Duke patur parasysh vërejtjet tona, MPCSSHB-premtoi që për vitin 2009 t'i jepet përparësi pjesëmarrjes së invalidëve të punës në programet e nxitjes së punësimit, në bashkëpunim me zyrat përkatëse të punësimit. Duhet theksuar se programet aktive të punësimit, përqëndrohen në programet e nxitjes së punësimit. Prandaj këto programe duhet të konsiderohen si një nga format më të rëndësishme në krijimin e vendeve të reja të punës, ruajtjen e atyre ekzistuese apo në formimin nëpërmjet punës.

**2. Këshilli Sindikal i Kantjerit Detar të Pashalimanit në Vlorë,** paraqiti një ankesë për kriteret e lidhjes së pensioneve të pleqërisë.

Sipas tyre, pagat ndryshojnë çdo vit, ndërsa tavanë në llogaritjen e pensioneve nuk ndryshon, duke mos iu përgjigjur rritjes së pagave të punonjësve, të cilët në bazë të pagave bruto derdhen dhe kontributet shoqërore.

Pretendimi i tyre qëndronte në faktin që në lidhjen e pensioneve të pleqërisë të merret për bazë 75% i pagës bruto dhe jo neto.

Në kuadrin e ndërmjetësimit tonë institucional për këtë problem, u informuam se është ngritur një grup pune nën drejtimin e Ministrisë së Financave për të studiuar e propozuar reformën e pensioneve për periudhën afatgjatë. Nga diskutimet paraprake me grupin e punës, është menduar se formula e llogaritjes së pensioneve do të ndryshohet për t'u lidhur më shumë masa e përfitimeve me masën e kontributeve të paguara. Aktualisht, kjo është në fazën e studimit.

**3. Ish punonjësit e Uzinës së Bakrit në Rubik,** paraqitën kërkesën e tyre për uljen e vjetërsisë së punës dhe moshës së pensionit të pleqërisë.

Ne kërkuam shpjegime pranë MPCSSHB-së dhe u informuam se në vitin 2004 është ngritur një grup pune ndërministror "Për studimin e efekteve që rrjedhin nga rritja e moshës së daljes në pension për punonjësit që kryejnë punë të vështira". Vendimi ishte miratuar në Këshillin Kombëtar të Punës dhe ishte diskutuar edhe në Komisionet e Kuvendit. Konkluzioni i studimit ishte që përkohësisht këta punonjës të trajtoheshin financiarisht, por jo duke u ulur moshën e pensionit. Pra pa çenuar skemën e pensioneve. Mbi këtë konkluzion është hartuar dhe projektligji përkatës, i cili është në procedurat e shqyrtimit.

**4. Një grup punonjësish të Zyrës Rajonale të Punësimit në Tiranë,** paraqitën ankesën e tyre për Drejtorinë Rajonale të Punësimit në Tiranë.

Ata pretendonin për shkelje të kryera nga njësia administrative e Drejtorisë së Auditimit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, gjatë kontrollit audit të Drejtorisë Rajonale të Punësimit në Tiranë.

Zyra jonë, pas studimit me vëmendje të ankesës dhe pas kontaktimit me punonjëset e rezultuara me shkelje nga grupi i Auditit në fjalë, si dhe duke e konsideruar si mjaft të rëndësishëm rritjen e standarteve të mirëadministrimit dhe ligjshmërisë së veprimtarisë së organeve të administratës publike, i kërkoi shpjegime ish Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, z.Koço Barka, duke kërkuar njëkohësisht dhe brenda kompetencave që i njeh ligji, pezullimin e Aktit Administrativ, deri në përfundim të shqyrtimit nga ana e tij të rastit konkret.

Në përgjigje të kërkesës sonë, Ministri argumentoi arsyet për marrjen e masave administrative ndaj punonjësve të Zyrës së Punësimit në Tiranë.

Në këto kushte, ne këshilluam që për zgjidhjen e çështjes së tyre, sipas dispozitave të Kodit të Punës, punonjësit duhet t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor për të kërkuar rivendosjen e të drejtave të shkelura.

**5.** Disa punonjës të shtypshkronjës “Urtësia” paraqitën ankesën e tyre lidhur me moszbatimin e Kodit të Punës në procesin e kryerjes së detyrave të përditshme.

Në ankesë theksohej se nga drejtoria e kësaj shtypshkronje nuk ishte lidhur kontratë pune sipas legjislacionit përkatës. Shumë punonjës punonin me 2 turne tre herë në javë dhe nuk paguheshin, turni i tretë nuk paguhej 1 orë më shumë sipas ligjit, nuk paguheshin ditët e pushimit, ditët e festave zyrtare, nuk u njihej raporti mjekësor dhe kishin një pagë 14.000 lekë, në një kohë kur sipas vendimit të qeverisë nuk duhet të ketë pagë më të vogël se 16.000 lekë.

Nga ana e punonjësve ishte kërkuar vazhdimisht që t'u paguhet vlera monetare për punët e kryera ose në të kundërt të punohet vetëm 8 orë.

Sipas ankuesve, përgjigja e kthyer nga administrata e kësaj shtypshkronje, ka qenë se nuk kishin fonde dhe kërkesat e tyre qenë ligjore dhe të bazuara në Kodin e Punës.

Në këto rrethana u kërkua nga Inspektoriati Shtetëror i Punës, si organ kompetent, që të ushtronte kontroll për veprimet e parregullta dhe antiligjore të kryera nga drejtuesit e shtypshkronjës “Urtësia”, duke mos zbatuar Kodin e Punës.

Pas kontrollit të ushtruar nga inspektorët, u konstatuan shkelje të të drejtave të punonjësve dhe u morën masa për zbatimin korrekt të kontratave individuale sipas Kodit të Punës.

Duke qënë se një nga objektivat në fushën e mbrojtjes shoqërore, sipas Marrëveshjes së Stabilim Asociimit është përmirësimi i sistemit të mbrojtjes sociale për të luftuar përjashtimin social dhe diskriminimin, inspektoriatet që janë në varësi të kësaj ministrie, duhet të vazhdojnë të bëjnë një punë më të madhe për kontrollin e subjekteve private për të siguruar respektimin e të drejtave të punonjësve.

Me iniciativën e Avokatit të Popullit, më datë 24.07.2008 është bërë një inspektim në Qendrën Pritëse të Viktimave të Trafikut në Linzë të Tiranës.

Kjo qëndër përbëhet nga dy godina të veçuara nga njëra-tjetra, ku njëra përdoret për emigrantët e paligjshëm dhe tjetra për viktimat e trafikut.

Nga drejtuesi i kësaj qendre na u shpjegua se në godinën që përdoret për emigrantët e paligjshëm, trajtoheshin persona të cilët kishin hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe ishin në pritje të riatdhesimit ose të azilkërkuesve të cilëve u është refuzuar qëndrimi në pritje për t'u larguar.

Monitorimi i standarteve bëhet një herë në muaj nga vetë drejtuesi i kësaj qendre dhe dy herë në vit nga inspektorë të standarteve. Qendra dispononte një rregullore të plotë të funksionimit të saj, por jo një të veçantë vetëm për mënyrën se si duhet të rregulloheshin marrëdhëniet për emigrantët e paligjshëm.

Nga sa më lart, gjykuam se në tërësinë e tyre kushtet e ofruara për emigrantët e paligjshëm ishin të kënaqshme dhe ishte për t'u lavdëruar puna e stafit dhe drejtorit të këtij institucioni.

Megjithatë ne menduam se përgatitja e një rregulloreje specifike për trajtimin e veçantë për emigrantët e paligjshëm ishte një domosdoshmëri për të respektuar të drejtat e tyre. Prandaj në hartimin e saj, Avokati i Popullit është i gatshëm të japë kontributin e tij, duke bashkëpunuar për miratimin e një rregullore të pranueshme dhe brënda standarteve.

Duke e konsideruar strehimin e kësaj kategorie në këtë qëndër si një procedurë që kufizon liritë dhe të drejtat e personit, menduam se gjatë këtij trajtimi, stafi punonjës duhet të jetë i trajnuar edhe për të drejtat e tyre, duke i respektuar ato sipas ligjit dhe dinjitetit njerëzor.

Në kuadrin e plotësimit të standarteve të shërbimeve sociale, lidhur me masat që duhet të merreshin për përmirësimin e punës në këtë qendër, ne Rekomanduam:

- Hartimin e një rregulloreje të veçantë në gjuhën shqipe dhe angleze për organizimin dhe funksionimin e jetës së brendshme për personat e strehuar përkohësisht në këtë qendër.

- Ekzaminimin fillestar të emigrantëve me një komision mjeksor dhe hapjen e kartelave të vecanta mjeksore individuale.

- Krijimin e kushteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të një përkthyesi me kohë të plotë ose të pjesshme në varësi të nevojave të qendrës.

Rekomandimi ynë u pranua dhe ka filluar puna për hartimin e një rregulloreje specifike në gjuhë shqipe dhe angleze për organizimin dhe funksionimin e jetës së brendshme për personat e strehuar përkohësisht në këtë qëndër sipas standarteve të miratuara në vitin 2008.

Avokati i Popullit është i vendosur të trajtojë këto çështje dhe në të ardhmen, duke vijuar inspektime periodike. Në përmbushje të kësaj detyre jemi të hapur për bashkëpunim në interes të ndërsjelltë për përmbushjen e misionit tonë.

### **a. Shërbimi Social Shtetëror**

Ankesa të paraqitura në Institucionin e Avokatit të Popullit drejtuar Shërbimit Social Shtetëror për vitin 2008 rezultojnë **9**. Nga këto janë përfunduar **8** ankesa, nga të cilat, **1** ankesë e pabazuar, **4** ankesa jashtë kompetence, **3** ankesa në favor të ankuesve dhe është akoma në proces shqyrtimi **1** ankesë.

Gjithashtu janë shqyrtuar dhe përfunduar **3** ankesa të mbartura nga viti 2007. Nga këto ankesa, kanë rezultuar **2** të pabazuara dhe **1** ankesë me heqje dorë.

Ankesat kanë qenë për ndërprerje të ndihmës ekonomike, largime të padrejta nga detyra, vendosjen e fëmijëve në qendra rezidenciale të përkujdesit shoqëror, për pagesën e personave me aftësi të kufizuar etj.

Në vijimësi po paraqesim disa nga ankesat të trajtuara në këtë fushë:

**1.** Qytetarja M.K, banuese në Tiranë, ankohej ndaj Zyrës së Ndihmës dhe Përkrahjes Sociale pranë Njesisë Administrative nr.4 në Tiranë për mosdhënien e së drejtës për të përfituar ndihmë ekonomike.

Konkretisht ajo shprehej se familja e saj përbëhej nga 6 anëtarë, ndërkohë që ajo vetë dhe bashkëshorti i saj ishin të papunë. Jetonte në kushte të vështira ekonomike dhe ishte e sëmurë.

Pasi kryem verifikimet e nevojshme pranë Njesisë Administrative nr.4, e informuam ankuesen se problemi i saj u zgjidh pozitivisht, pasi familja e saj do të përfitojë ndihmë ekonomike në masen 100%.

**2.** Shtëtasi L.N, banues ne komunën Oblikë – Shkodër, ankohej për ndërprerjen e ndihmës ekonomike nga Zyra e Ndihmës Ekonomike dhe Përkrahjes Sociale pranë asaj komune.

Pas ndërhyrjes sonë për këtë problem, sqaruam ankuesin se për të përfituar përsëri ndihmën ekonomike, duhet të rinovonte dokumentat dhe t'i paraqiste pranë komunës ku ai ka vendbanimin për t'u bërë sërish përfitues i kësaj ndihme.

3. Qytetari Q.T, banues në Ura-Vajguore, ankohej ndaj Qëndrës së Zhvillimit Rezidencial në Berat për mosinformimin e nipit të tij E.T, i cili ishte jetim dhe kishte lindur i sëmurë si dhe të moskthimit të përgjigjes për kërkesën që kishte bërë.

Lidhur me ankesën në fjalë Zyra Rajonale e Shërbimeve Sociale Berat na sqaroi se duke qënë se djali i sëmurë, E.T ishte me prapambejtje të thellë mendore, nuk ka institucione specifike të përkujdesit social për të trajtuar diagnozat me prapambejtje të thellë mendore dhe moshë të madhe të personit. Por organizatat jofitimëprurëse, ofruan mbështetje dhe përkujdesje të veçantë për nipin e shtetasit Q.T.

4. Shoqata ë Invalidëve Paraplegjikë e Tetraplegjikë, dega Durrës, ankohej për moszbatimin e Urdhrit të përbashkët nr.276, datë 8.02.2007 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për personat me dëmtim të palcës kurrizore që duhet të komisionohen vetëm njëherë dhe të marrin Statusin e Invalidit Para-Tetraplegjik përgjithmonë si dhe për mosinformimin për këtë problem.

Konkretisht, ankesa konsistonte në heqjen e së drejtës për këtë lloj përfitimi nga KMCAP-i në Durrës, ndërkohë që shpreheshin se vetëm KMCAP-i Epror e ka këtë të drejtë. Kjo ankesë drejtohej ndaj Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror në Durrës, pasi pranë atij komisioni është mjeku që përfaqëson atë drejtori.

Gjithashtu ata shpreheshin se me gjithë kërkesat e përsëritura nuk kishin arritur të merrnin asnjë përgjigje zyrtare.

Në përgjigje të kërkesës sonë, Shërbimi Social Shtetëror, na informoi se për personat me aftësi të kufizuar ose invalidë që komisionohen, për mbrojtjen e të drejtave të këtyre kategorive shoqërore në nevojë, problemin e kësaj shoqate e përcollën pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore me rekomandimin për dhënien e statusit të përhershëm për të dëmtuarit definitivë të palcës kurrizore.

Në lidhje më problemin e ngritur nga kjo shoqatë për mosinformimin dhe moskomunikim me këtë kategori sociale, mosdhënie sqarimesh që bie ndesh me etikën e nënpunësit civil, mjekes pranë ShSSH-së në Durrës iu dha vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra.

Ajo që është konstatuar dhe që vazhdimisht i është vënë theksi nga Zyra jonë gjatë trajtimit të ankesave lidhur me shërbimin social, është se vazhdojnë të ekzistojnë mundësitë e pakta të vëndit për të siguruar shëndetin dhe mirëqënien e popullsisë. Këto mundësi janë të kompromentuara nga infrastruktura e dobët, lëvizjet e mëdha demografike, mungesat e përkohshme të stabilitetit të brëndshëm dhe kapacitetet e dobëta teknike të strukturavë përkatëse. Në këtë kontekst



vëmë në dukje se ristrukturimi dhe reformimi i shërbimeve sociale duhet të jetë një element prioritar lidhur dhe me uljen e varfërisë.

Ministritë përkatëse të fushës së zbatimit të detyrueshëm të politikave në fushën e ndihmës dhe përkujdesit shoqëror, duhet të vazhdojnë punën e nisur për përsosjen e këtyre politikave, të përmirësimit të legjislacionit dhe përshtatjes së tyre me standartet më të larta të vendeve të përparuara demokratike.

#### 14. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave

Përpjekjet e Avokatit të Popullit edhe për vitin 2008, në ndihmë të një mjedisi sa më të shëndetshëm dhe në respektim të normave të lejuara, kanë qenë në fokus të punës tonë.

Gjatë vitit 2008 janë trajtuar 9 ankesa për Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave kryesisht për ndotjen e mjedisit. Nga këto, 2 ankesa kanë qenë të pabazuara, 4 ankesa kanë qenë jashtë kompetencave dhe juridiksionit dhe 3 ankesa janë zgjidhur në favor të individëve.

Në vijim po trajtojmë shkurtimisht çështjet e zgjidhura pozitivisht për këtë fushë:

1. Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit u paraqit në mënyrë të përsëritur, ankesa e qytetarit A. B., me banim në fshatin Qerek-Kruje, i cili ankohej për ndotje të mjedisit nga hedhja e mbeturinave urbane në territorin e fshatit nga një firmë e kontaktuar nga Bashkia Kamëz.

Ankuesi në emër të të gjithë banorëve të këtij komuniteti pretendonte se firma private e kontraktuar nga ana e Bashkisë Kamëz, duke depozituar mbeturina në afërsi të fshatit, kishte shkaktuar probleme serioze për shëndetin e banorëve dhe sidomos femijëve në fshat.

Zyra jonë, në analizë të fakteve të parashtruara nga të dy palët, argumentoi me rekomandim dërguar Inspektoriatit të Mjedisit, edhe Bashkisë Kamëz, se meqenëse vendi i depozitimit të mbeturinave ishte i miratuar me vendim të KRRT-se Bashkisë Kamëz, kjo nuk do të thoshte që mbetjet e hedhura nuk kishin pasoja negative mbi shëndetin dhe mjedisin e banorëve të zonës.

Nga ana tjetër nuk rezultonte të kishte asnjë raport kontrolli lidhur me verifikimin e situatës në vend nga autoritetet përgjegjëse.

Për sa më sipër rekomanduam ushtrimin e kontrolleve nga Inspektoriatit i Mjedisit, organi që kishte liçensuar veprimtarinë, Inspektoriatit Sanitar Shtetëror dhe Inspektoriatit Bashkiak ndaj veprimtarisë së zotëruesve të mbetjeve urbane, lidhur me depozitimin e mbeturinave të Bashkisë Kamëz, në Argjinaturën e lumit Tërkuzë, për

shkak të rrezikimit të shëndetit të komunitetit në këtë vend nga ndotja e mjedisit.

Në përgjigje të rekomandimit tonë Inspektoriati Sanitar Shtetëror, i cili pranoi sugjerimet e mësipërme dhe informoi ndër te tjera se: Në bazë të kërkesës tonë, inspektorët e Inspektoriatit Sanitar Shtetëror së bashku me përfaqësuesit e Bashkisë Kamëz, kanë ushtruar kontroll në vend-depozitimim e mbeturinave urbane pranë "Argjinaturës së lumit Tërkuzë", dhe eliminimin e të metave janë lënë për zbatim detyrat:

Të evitohet hedhja e mbeturinave pranë rrjedhës së lumit;

Të fillojë sistemimi i fushë-grumbullimit të mbeturinave me rrugë, kanale etj;

Të bëhet grumbullimi me dhé, dhe përgje të mbeturinave;

Të ndalohet djegia e mbeturinave dhe të vendosen tabela për ndalimin".

2. Ankesa e qytetarit A. K., në të cilën ngrinte pretendimet e tij ndaj Bashkisë, Zyrës së Mjedisit si dhe I.N.U.V-së Sarandë, lidhur me lejimin e ndërtimit të një furre buke jashtë çdo parametri teknik në vitin 2006 në katin e parë të pallatit ku ai banonte, nga ana e Bashkisë Sarandë ishte dhënë leja për ndërtimin e një furre buke. Sipas qytetarit, ky ndërtim ishte jashtë çdo rregulli e norme njerëzore pasi furra punonte natë e ditë pa orar, nuk kishte asnjë kusht higjieno-sanitar dhe gjithë kohën banorët përreth ishin nën efektin e nxehtësisë dhe erës së majasë së bukës. Gjithashtu, zhurma e brumatriçes pas orës 22:00 deri në 24:00 ishte mjaft shqetësuese për gjithë banorët e pallatit.

Avokati i Popullit pasi ndërhyri pranë autoriteteve përkatëse dhe mori sqarimet e duhura për këtë rast, vuri në dijeni ankuesin se:

Më datë 29.12.2008, nga ana e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Vlorë, në bashkëpunim me përfaqësues të Bashkisë, Drejtorisë Juridike, Drejtorisë së Tatim-Taksave dhe Policisë Bashkiake u ushtrua kontroll ndaj subjektit fizik A. M., i cili kryente aktivitetin e prodhimit të bukës në katin e parë të pallatit të banesës. Në akt-kontrollin e mbajtur këtij subjekti i ishte lënë për detyrë marrja e masave për eliminimin e zhurmave, temperaturave si dhe përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për t'u pajisur me Autorizimin Mjedisor, në rast se ai do të vazhdonte të ushtronte aktivitetin në këtë ambient. Nga shtetasi A. M. u deklarua se do të largohet nga ai ambient".

3. Një ankues nga Saranda pretendonte për mosdorëzimin e një sipërfaqe kullote, e cila i ishte kthyer me vendim të K.K.K.P Sarandë me nr. 32 datë 16.11.2000, dhe kjo nuk ishte dorëzuar akoma nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor Sarandë. Konkretisht, qytetari A.K. sqaronte se pavarësisht se ishin mbajtur proçes verbalet për dorëzimin e pronës, nga ana e Shërbimit Pyjor Sarandë nuk ishin kryer akoma ndryshimet

përkatëse në fondin kadastral, duke i hequr kështu mundësinë për të administruar pronën e tij.

Në fakt ashtu dhe siç rezultonte nga Proçes Verballi i dorëzimit bashkëngjitur ankesës, bëhej fjalë për një sipërfaqe kullote të cilën ankuesi e dispononte në bashkëpronësi me shtetas të tjerë. Në të tilla kushte, referuar legjislacionit në fuqi, ankuesi u orientua për të paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor ku ndodhej prona, një kërkesë padi me objekt “Pjestim Pasurie”. Me anë të këtij vendimi të gjykatës, do të përcaktoheshin kufijtë realë të pronës së ankuesit, duke bërë të mundur zbatimin e vendimit të K.K.K.P. Sarandë nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor Sarandë.

## 15. Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

Për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për vitin 2008 kanë ardhur gjithsej 7 ankesa, nga të cilat janë të përfunduara 5 ankesa, dhe 2 janë ende për trajtim të mëtejshëm. Nga ankesat e përfunduara rezulton se 1 ka qenë e pabazuar, 1 është konsideruar jashtë juridiksionit, 2 jashtë kompetence.

Problematika e ankesave që kanë patur të bëjnë me këtë Ministri kanë qenë kryesisht shkelja e së drejtës së autorit, si dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve nëpër institucionet në varësi të këtij organi qëndror.

1. Nga ankesat që janë në shqyrtim përmendim një kërkesë të ligjshme që ngrihet nga ana e disa punonjësve të Muzeut Arkeologjik të qytetit të Durrësit. Konkretisht, këta punonjës pretendonin se nuk ishin paguar pagat e tyre që prej muajit Janar 2008.

Në përgjigje të kërkesës tonë për shpjegime M.T.K.R.S.-ja, ndër të tjera sqaronte se: “Sipas VKM nr. 559 datë 22.08.2007 “Për bashkimin e disa Instituteve të Akademisë së Shkencave, organizimin e tyre në Qendrën e Studimeve Albanologjike, si dhe funksionimin e kësaj Qendre në periudhën kalimtare”, MTKRS-ja ka përmbushur detyrimin e saj duke punësuar 2 ish-punonjës të stafit që punonin në muze, duke krijuar kushte për vijim optimal të veprimtarisë”. Duke analizuar argumentet e paraqitura nga të dy palët, rezultonte se përgjigja e dhënë nga M.T.K.R.S.-ja nuk i jepte asnjë zgjidhje problemit të pagave të papaguara të punonjësve të Muzeut Arkeologjik Durrës.

Lidhur për sa më sipër, Avokati i Popullit kontestoi pretendimin se M.T.K.R.S.-ja kishte përmbushur detyrimin e saj duke punësuar 2 ish-punonjës të stafit që punonin në muze.

Prandaj rekomanduam pagimin e pagave të papaguara që nga muaji Janar 2008 nga Ministria e Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve, për punonjësit e Muzeut Arkeologjik Durrës që kishin kaluar në varësinë e

saj, si dhe zbatimin e dispozitave përkatëse të Kodit të Punës në rast të largimit të tyre nga puna. Kjo çështje është ende e hapur nga Zyra jonë, në pritje të qëndrimit të mëtejshëm zyrtar të kësaj Ministrie.

2. Shtetasit A. P., në cilësinë e kompozitorit dhe autorit të veprave të ndryshme muzikore, u ankua për mosfunksionimin e instrumenteve të krijuar për mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe konkretisht, të Zyrës Shqiptare të të Drejtave të Autorit (ZSHDA). Sipas tij sistemi i mbrojtjes të të drejtave të autorit në Shqipëri nuk funksiononte për një kohë të gjatë dhe ky fakt bënte që autori të mos gëzonte dot frytet e punës së tij, në të kundërt të asaj që ndodhte në shumë vende fqinje.

Edhe pse ishte krijuar ZSHDA-ja, ankuesi shprehej se veprimtaria e saj në thelb ishte jashtë funksionit të mbrojtjes së të drejtave të autorit. Absurdi që ekzistonte në këtë rast, sipas ankuesit, qëndronte në faktin se gjobat e vendosura nga ana e organeve përkatëse shtetërore në rastet e evidentimit të shkeljes së të drejtës së autorit vileshin dhe merreshin nga shteti, ndërkohë që autori ndaj të cilit ishte kryer kjo shkelje nuk përfitonte asgjë.

Në këtë kuptim ankuesi theksonte se, sikundër funksiononte në rastin e bashkisë me punonjësit e saj tatimor që vilnin paratë dhe ia dërgonin ato institucionit në fjalë, ashtu duhej të funksiononte edhe me ZSHDA-në, e cila paratë që vileshin nga gjobat e vëna në rast shkelje të së drejtës së autorit, duhet t'ia çonte që të përfitonte direkt autori dhe jo shteti.

Për më tepër, ankuesi shprehej se, në ligj dhe për aq sa parashikonte ai, në lidhje me kompetencat e ZSHDA-së, mungonte thelbi i mbrojtjes së të drejtës së autorit, pasi konkretisht nuk përcaktohej se si mbrohej e drejta e autorit.

Veç kësaj ankuesi ngrinte pretendimin tjetër se, ligji "Për të drejtën e autorit", nuk përmbante apo nuk parashikonte sanksione.

Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit na sqaroi se përfitimi i gjobave administrative, të vendosura prej inspektoriatit të kësaj Zyre nga shteti dhe jo nga autorët të cilëve u shkeleshin të drejtat, kishte të bënte me parashikimin e nenit 130 të Ligjit nr.9380 datë 28.04.2005 "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të". Kjo ishte një gjobë administrative, e cila arkëtohej 100% nga buxheti i shtetit, nëpërmjet institucionit të policisë tatimore, si i ngarkuar me ligj.

Gjithashtu në këtë përgjigje thuhej që, ZSHDA-ja nuk kishte asnjë kundërshtim nëse ligjvënësi mendonte se kjo gjobe duhej të shkonte e gjitha në favor të autorëve të cënuar apo duhej ndarë në përqindje të caktuara ku të përfitonte, si shteti, ashtu dhe autori. ZSHDA-ja si institucion i administratës publike, ishte e detyruar të respektonte dhe të zbatonte ligjin që ishte në fuqi. Nga ana tjetër ZSHDA-ja, pretendonte se i kishte bërë me dije ankuesit se kishte të gjitha të drejtat procedurale

administrative dhe civile, për të kërkuar dëmshpërblimin e tij material dhe moral pranë gjykatës.

Në përgjigje konfirmoj se masat dhe sanksionet e parashikuara në ligj, nuk ishin në nivelin e duhur për të bërë të mundur respektimin dhe moscënimin e të drejtës së autorit. ZSHDA-ja ishte duke marrë kontakte të vazhdueshme, duke organizuar tryeza pune me ekspertë të Komisionit Europian me organizma ndërkombëtare të fushës të së drejtës së autorit, WIPO dhe CISAC, si dhe me gjithë aktorët dhe faktorët që ligji njihte, me qëllim të përgatitjes së një drafti për disa ndryshime dhe përmirësime në ligjin aktual.

Nga kontaktet e mbajtura me ZSHDA-në, u vumë në dijeni të faktit se filloi puna për rishikimin e dispozitave të Ligjit “Për të drejtën e Autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, veçanërisht për problemet që kishin dalë gjatë zbatimit të ligjit në këto tre vite. Në vlerësimin tonë ky është një proces i domosdoshëm edhe në kuadër të zbatimit të planit kombëtar, për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Ndër prioritetet afatshkurtra të miratuara në këtë plan, për sa i përket pronësisë intelektuale, ishte përcaktuar; “Miratimi i legjislacionit dhe forcimi i kapacitetit administrativ në fushën e të drejtave të Autorit”.

Ndërkohë, në prioritetet afatmesme të këtij plani kombëtar përcaktohet që; “Të zbatohet në mënyrë të përshtatshme e drejta e pronësisë intelektuale dhe të shënohen arritje me të mira në fushën kundër piraterisë dhe falsifikimeve”.

Lidhur me shqetësimin e ankuesit për mosparashikimin e fondeve nga ana e institucioneve të artit dhe kulturës (Teatrit Kombëtar, Teatri i Operës dhe Baletit etj), për të mundësuar pagesën e të drejtës së autorit për veprat që këto institucione vinin në skenë, gjykuam se ishte një çështje e cila, duhej të parashikohej në dispozitat ligjore përkatëse, për më tepër kur kishte filluar puna për rishikimin e dispozitave të Ligjit “Për të drejtën e Autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”.

Për sa më sipër, i rekomanduam Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve: realizimin e iniciativës legjislative, për ndryshimet e nevojshme ligjore në Ligjin nr.9380 datë 28.04.2005 “Për të drejtën e Autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, për të mundësuar një mbrojtje sa më efikase për të drejtat e autorit në Shqipëri, në përputhje me kërkesat e standartet e “Acquis communautaire”.

## 16. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

A. Gjatë vitit 2008 për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit janë regjistruar 6 ankesa, nga të cilat 3 ankesa kanë qenë jashtë kompetencave dhe juridiksionit dhe 2 ankesa janë zgjidhur në favor të shtetasve.

Ankesat e paraqitura kanë patur për objekt problemet e administrimit të tokave bujqësore, mungesën e një informacioni të detajuar për mënyrën e subvencioneve për veprimtarinë fermere, mos ekzekutimet e vendimeve gjyqësore të formës së prerë si dhe largimet nga puna.

Në vijim po paraqesim shkurtimisht ankesat e trajtuara nga institucioni ynë gjatë vitit 2008

1. Shtetasi V.K., ishte administrator i një shoqërie dhe ushtronte aktivitetin e shpërndarjes së karburantit me pakicë. Gjatë vitit 2005 në pikën e tij të shpërndarjes së karburantit, kishte shpërndarë për fermerët, sasi karburanti të konvertuar në tollona, për të cilët duhet të ishte kompesuar në leke sipas një marrëveshjeje të lidhur me përfaqësuesit e Projektit 2KR, si dhe me Drejtorinë e Bujqësisë dhe Ushqimit të Qarkut Gjirokastër.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, ankuesi u sqarua që t'i drejtohej së pari Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, sepse nuk kishte ndjekur shkallët e ankimit administrativ. Në rast se nga ana e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, ankuesi nuk do kishte informacion për mënyrën e zgjidhjes së problemit të parashtruar, atëherë ankesa e tij do të shqyrtohej më tej nga ana jonë.

2. Ankesa e shtetasit S.B., banor i fshatit Topojë, Komuna Zagori, rrethi Gjirokastër, për mospërfitim të pagës së tij mujore për një periudhë të caktuar nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Ankuesi, me profesion mjek veteriner, sqaronte se kishte qenë me detyrë inspektor veteriner, për Komunat Pogon dhe Zagori prej datës 02.12.1992 deri në datën 01.05.2007, datë në të cilën është larguar nga puna për shkak të reformës që përfshiu këtë sektor. Më tej ai theksonte se për periudhën 1 janar 2007 deri në datën 30 prill 2007, nga ana e kësaj Drejtorie nuk ishte paguar, megjithëse kishte qenë në marrëdhënie pune të vazhdueshme. DRBUMK-së Gjirokastër na vuri në dijeni se ishin bërë të gjitha përpjekjet për sigurimin e një fondi për likuidimin e detyrimeve të prapambetura në favorin e ankuesit. Ishte vetëm çështje kohe dhe me sigurimin e këtij fondi nga Ministria e linjës, ankuesi do të mund të përfitonte të gjitha të drejtat e tij.

3. Ankesa e banorëve të fshatit Kalivarë, në rrethin e Pukës, për ndotje të mjedisit nga shoqëria turke që shfrytëzonte minierën e bakrit në Munellë.

Ata pretendonin se mbeturinat toksike nga punimet e firmës, derdheshin në lumë, duke dëmtuar ujin e pijshëm, mjedisin, faunën dhe gjithçka tjetër në këtë zonë. Banorët në kërkesat e tyre kërkonin që të ndërtoheshin rezervuarë filtrimi për mbeturinat që derdheshin dhe mundësisht hedhja e tyre të bëhej në stinën e dimrit. Ata gjithashtu pretendonin se u ishin drejtuar disa herë drejtuesve të organeve të pushtetit lokal, por nuk kishin marrë përgjigje për problemet e tyre.

Avokati i Popullit, kërkoi angazhimin e strukturave lokale dhe mbikqyrëse të veprimtarive të tilla, për të sqaruar konkretisht masat që ishin marrë nga ana e tyre për verifikimin dhe eliminimin e kësaj ndotjeje duke kërkuar njëkohësisht verifikimin në vend të këtyre pretendimeve dhe informimin e Avokatit të Popullit për rezultatet konkrete të tij.

Mbi bazën e rezultateve të kontrollit të ushtruar nga Inspektoriati i Mjedisit u kërkua:

a. Ndryshimi i lejes mjedisore me qëllim rishikimin e kushteve të lejes mjedisore për aktivitetin e shfrytëzimit të bakrit, miniera Munellë, si rezultat i shfaqjes së elementeve të reja ekologjike të panjohura në kohën e dhënies së saj, dhe ndotjes tej normave të lejuara.

b. Lidhur me shkarkimin e ujërave nga miniera e Munellës, të rishikohej projekti i sistemit të tre dekantueseve dhe filtruesve të tyre përpara vënies në punë.

Nga specialistët e drejtorive teknike, organet e pushtetit lokal dhe Inspektoriati i Mjedisit, u hartua leja mjedisore e ndryshuar.

4. Ankesa e shtetasit S.M. i cili paraqiti pretendimet e tij ndaj Shërbimit dhe Inspektoratit Veterinar Tiranë lidhur me shkeljen e moralit profesional. Ai u ankua se produktet ushqimore me origjinë shtazore nuk kontrolloheshin konform ligjit, bagëtitë thereshin në ambiente të jashtme, jashtë çdo norme, duke cënim të dispozitave ligjore për shëndetin publik.

Duke qenë se ankuesi nuk kishte paraqitur një ankesë zyrtare pranë Shërbimit dhe Inspektoratit Veterinar, me anë të një shkrese zyrtare u orientua ta bëjë një gjë të tillë, duke i bashkëngjitur dokumentet që ai dispononte. Ndërkohë që me një shkresë përcjellëse iu drejtuam zyrtarisht Shërbimit dhe Inspektoratit Veterinar duke i kërkuar që të informohej ankuesi rreth procedurës që ndiqet, mbi bazën e ankimit të paraqitur pranë Institucionit të Avokatit të Popullit.

5. Në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të konsumatorit, Institucioni Avokatit të Popullit kërkoi verifikimin e produkteve me origjinë nga Kina që dyshohen për substanca të dëmshme për shëndetin. Kjo sepse gjatë vitit 2008 tregjet europiane ishin vënë në alarm prej

ushqimeve me origjinë kineze, pasi mjaft produkte të tilla janë konstatuar me substanca sintetike dhe kimike, të dëmshme për shëndetin.

Në mjaft vende të Bashkimit Europian dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pas shfaqjes së këtij problemi, kishte nisur mbledhja dhe groposja masive e këtyre produkteve duke vendosur dhe embargon për artikuj dhe produkte me origjinë kineze.

Duke patur parasysh këtë shqetësim, Avokati i Popullit u interesua pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, nëse kishte hyrë në Shqipëri qumësht pluhur i importuar nga Kina.

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, zyrtarisht informoi Avokatin e Popullit, se për vitin 2008 nga Kina në Shqipëri, nuk kishte hyrë qumësht pluhur, por kishte hyrë rreth 140 ton qumësht koncentrat i njohur me emrin “Panda”.

Pas këtij informacioni dhe shqetësimi të përbashkët, Avokati i Popullit i rekomandoi Ministrin të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministres së Shëndetësisë që të procedohej me analizimin e produktit, qumësht koncentrat i emëruar “Panda”.

Megjithatë më tej në shtyp u shpreh shqetësimi edhe për artikuj të tjerë të importuara nga Kina, fakt i cili kërkonte një kontroll dhe ekspertizë të gjithanshme dhe të thelluar.

Për këtë arsye Avokati i Popullit kërkoi që të ushtrohet kontroll në të gjitha tregjet shqiptare për produkte me origjinë nga Kina, si dhe në veçanti të kryheshin analizat për produktin e qumështit koncentrat “Panda”, prezent në të gjitha tregjet tona, pasi mbrojtja e jetës dhe shëndetit të konsumatorit, është një prioritet dhe një e drejtë themelore e njeriut.

Në ndjekje të rekomandimit tonë Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, na bëri me dije se shqetësimi për skandalin e shtesës së melaminës në qumësht ka bërë të mundur ndjekjen e zinxhirit të eksportit për në Shqipëri të qumështit me origjinë Kinën që me datë 27.09.2008.

Mbi bazën e verifikimeve të kryera rezultonte se Shqipëria importonte nga Kina vetëm qumësht të kondensuar Panda, dhe se Drejtoria e Përgjithshme e Sigurisë Ushqimore në MBUMK si dhe Drejtoritë Rajonale kishin bërë kontrollin dhe bllokimin e produktit qumësht Panda, kishin marrë mostra, të cilat ishin dërguar në Institutin Superior të Shëndetit në Romë/Itali. Produkti do të qëndronte i bllokuar në magazinë dhe nuk do të lejohej të futej në territorin e Shqipërisë një sasi tjetër, pa marrë përgjigjen nga laboratorit i specializuar.

Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në kuadrin e masave parandaluese për rritjen e mbrojtjes së konsumatorit, urdhëroi ndalimin e importit për në Republikën e



Shqipërisë të qumështit dhe produkteve me bazë qumështi nga Kina, bllokimin e qumështit dhe produkteve me bazë qumështi me origjinë nga Kina të magazinuara në vend deri në analizimin e tyre, si dhe bllokimin e tregtimit të qumështit dhe produkteve me bazë qumështi që ndodheshin në treg me origjinë nga Kina deri në marrjen e rezultateve të analizave për përmbajtjen e melaminës.

Me datën 08.10.2008 erdhën zyrtarisht rezultatet e analizave nga laboratorit i Institutit Superior të Shëndetit në Romë, i cili garantonte se me analizat e plota të kryera me HPLC mostrat e dërguara nga ana e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të analizuara prej tyre ishin brenda të gjitha normave për konsum të lejuara nga BE-ja për përmbajtjen e melaminës në produkt.

Në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, gjatë muajit Dhjetor 2008, u zhvillua Konferenca Kombëtare “Mbrojtja e të Drejtave të Konsumatorëve”.

Rezultatet dhe rekomandimet e kësaj Konference pasqyrohen në një seksion të veçantë të këtij raporti.

## **B. Ankesa për çështje të Ligjit “Për Tokën”**

Janë 55 ankesat e bëra prezent para institucionit tonë për vitin 2008, që kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit nr.7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, i ndryshuar, përfshirë edhe kontestimet e ish pronarëve të tokave bujqësore për këtë Ligj. Nga këto kanë përfunduar 51, nga të cilat 7 ankesa, janë zgjidhur në favor të ankuesve, ndërsa 4 të tjera janë mbartur për vazhdimin e trajtimit për në vitin 2009. Objekti i ankesave është mosdhënia e tokës fizikisht, pavarësisht se janë pajisur prej vitesh nga Komisionet e Tokave me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi, për mosplotësim me tokë sipas frymëve, për mbivendosje të sipërfaqeve të tokave, konflikte kufinjsh tokash midis fshatrave dhe komunave, për mos plotësimin nga ana e komunave dhe bashkive të dokumentacionit përkatës dhe përcjelljen e tyre në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në rreth për regjistrimin fillestar, kundërshtimin e Ligjit dhe kërkesa për ndërhyrje legjislative për anulimin e tij në zona të veçanta të vendit, si në Bregdet. Një pjesë e mirë e ankesave janë të mbartura në vite për shkaqe nga më të ndryshmet, ku në mënyrë të veçante ka spikatur puna e dobët e ish komisioneve të tokave në tërë hierarkinë e tyre, si dhe mos funksionimi i tyre për arsye subjektive në intervale kohe të gjata në fshatra dhe njësi të ndryshme të pushtetit vendor.

Pjesa më e madhe e ankesave të trajtuara, 32 raste, kanë qenë jashtë kompetencave tona. Kjo për shkak të mos pasjes dijeni nga ankuesit të hyrjes në fuqi të Ligjit nr.9948, dt. 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën

bujqësore”, i cili jo vetëm i dha fund procesit të ndarjes dhe rindarjes së tokës bujqësore, si dhe krijimit të titujve të pronësisë mbi të, por edhe ngriti struktura të reja, Komisionin Qeveritar të Tokës dhe Komisionet Vendore pranë prefektit të çdo qarku, nën autoritetin dhe varësinë e drejtpërdrejtë nga ky i fundit. Ligji ka përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e Komisioneve Vendore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të evidentuara për kufijtë e tokës bujqësore ndërmjet fshatrave dhe rretheve brenda qarkut, midis individëve dhe ish komisioneve të tokave në fshat, konfliktet midis personave fizike dhe juridike, mosmarrëveshjet ndërmjet palëve kur është vendosur gjyqësisht zgjidhja e tyre në rrugë administrative, zëniet dhe pushtimet e tokës dhe për verifikimin e bazueshmerisë së titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore. Mbi këtë bazë të re legjislatore, subjekteve ankues të këtyre natyrave ju është sugjeruar të aplikojnë me kërkesa individuale pranë komisioneve vendore. 12 ankesat e tjera, kanë qenë për juridiksionin gjyqësor.

Nga ankesat që janë zgjidhur pozitivisht, po përmendim dy raste konkrete. I pari ka të bëjë me një ankesë në tremujorin e parë të vitit 2008, të një grupi banorësh të një fshati në rrethin e Sarandës me të cilën kërkonin ndërhyrjen e Komisionit të Tokës në Qark për të verifikuar dhe zgjidhur probleme të krijuara nga ish komisionet e tokës në fshat, gjatë zbatimit të Ligjit nr.7501, dt 19.07.1991 “Për tokën”. Pas ndërhyrjes tonë institucionale pranë Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe veçanërisht në Komisionin e Qarkut Vlorë, u arrit shqyrtimi i problemeve nga ky i fundit dhe dërgimin e vendimit përkatës për zbatim në Komunë. Nga të dhënat e konfirmuara rezultoi se mosmarrëveshjet e lindura prej vitesh, u zgjidhen duke rivendosur kështu edhe qetesinë në komunitet.

Rasti i dytë, përsëri si kohë, para hyrjes në fuqi të Ligjit nr.9948, dt. 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësor”, ka të bëjë me një ankesë të një shtetasi ndaj Komisionit të Tokës së Bashkisë të qytetit ku banon, për t’i dhënë tokë bujqësore në pronësi, si përfitues nga Ligji 7501 “Për tokën”. Kjo sepse Gjykata e Shkallës së Parë e kishte nxjerrë padinë e tij jashtë juridiksionit, për ta zgjidhur në rrugë administrative. Edhe në këtë rast, u kërkuar nga Kryetari i Bashkisë, që njëkohësisht ishte edhe kryetar i komisionit, ta trajtonte çështjen për të rivendosur një të drejtë, të shkelur prej kohësh nga komisionet e mëparshme. Në përgjigjen e tij Kryetari na bëri të ditur faktin se është duke u bërë azhurnimi i zonës për evidentimin e tokave të lira, si kontigjent për t’ia dhënë në pronësi ankuesit. Edhe për këtë praktikë jemi vënë në dijeni për një përfundim në favor të qytetarit ankues.

## 17. Veprimtaria e Nënseksionit të të Drejtave të Fëmijëve (NDF)

Avokati i Popullit ka synuar të japë një kontribut të veçantë në luftën për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve me anë të trajtimit të ankesave individuale, ashtu dhe të hetimit me iniciativën e tij të rasteve të bëra publike si dhe të shqyrtimit të legjislacionit dhe dhënies së rekomandimeve për ndryshime apo përmirësime të nevojshme.

Gjatë këtij viti janë trajtuar 96 raste ankesash apo kërkesash me objekt shkeljen e të drejtave të fëmijëve. Disa prej ankesave, kërkesave apo dhe rasteve të shqyrtuara me iniciativë preknin të drejtat e një numri të konsiderueshëm fëmijësh.

Është punuar për një koordinim të përmirësuar dhe proaktiv mes NDF-së dhe agjensive shtetërore si dhe organizmave të ndryshme që mbrojnë të drejtat e fëmijëve, për një ambjent më përgjegjës mbi politikat si dhe për ndërhyrje të qëndrueshme të Qeverisë për të drejtat e fëmijëve.

Gjatë vitit 2008 është përgatitur dhe dërguar Parlamentit të Shqipërisë Raporti i Veçantë i punës së Avokatit të Popullit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Nënseksioni raportoi pranë Sekretariatit Kombëtar Teknik për Fëmijët (SKTF) mbi masat e marra nga NDF për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Fëmijët.

Në vijimësi të angazhimit të Institucionit të Avokatit të Popullit në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Fëmijët dhe Planit të Veprimit, detyrat e Institucionit tonë kanë qenë të përcaktuara në Objektivin 1 të Planit të Veprimit të Strategjisë: “Ngritja e strukturave institucionale, sigurimi i burimeve financiare dhe kapaciteteve njerëzore për zbatimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve”. Konkretisht, Plani i Veprimit përcakton në pikën 1.3 “Fuqizimi i Sektorit për Fëmijët pranë Zyrës së Avokatit të Popullit”. Nënseksioni përgatiti ashtu si çdo vit informacionin mbi zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Fëmijët dhe Planit të Veprimit për periudhën Qershor 2007-Maj 2008 për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Në këtë informacion janë dhënë aktivitetet kryesore të ndërmarra nga Institucioni i Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit, është përpjekur që të përmbushë detyrimet që dalin nga objektivi i caktuar dhe është munduar që të jetë gjithnjë i përfshirë në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve.

Në kuadër të bashkëpunimit me organizatat jofitimprurëse si dhe institucionet e tjera shtetërore, me synimin e nxitjes së promovimit e të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, Nënseksioni edhe gjatë këtij viti ka marrë pjesë në mjaft aktivitete, workshope dhe konferenca. Disa prej këtyre aktiviteteve kanë qenë:

1- Pjesëmarrje në Tryezën e rrumbullakët “Roli i shërbimit avokator falas në Shqipëri në mbrojtje të të drejtave të njeriut”, organizuar në Mars 2008 nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

2- Pjesëmarrje në kursin e trajnimit “Lobim dhe Advokim për të Drejtat e Fëmijëve”, organizuar nga Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri -CRCA, me 3-4 Prill 2008.

3- Pjesëmarrje në takimin e dytë të punës të Rrjetit të Ombudsmanëve për Fëmijë të Evropës Juglindore, 12 Qershor 2008, Novi Sad-Vojvodinë. Në këtë takim ndër të tjera u diskutuan rrugët e mëtejshme të bashkëpunimit të Ombudsmanëve për Fëmijët të Rajonit, si dhe mënyra e funksionimit të websitit, roli dhe përgjegjësitë e të gjithë anëtarëve të rrjetit, si dhe përcaktimi i tematikës së konferencës së ardhshme vjetore të këtij rrjeti.

4- Workshopi kombëtar: “Drejt krijimit të Linjës Kombëtare të Telefonit për Fëmijët në Shqipëri”, organizuar nga UNICEF dhe Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri, më 17 Qershor 2008. Qëllimi i workshopit ishte diskutimi mbi rëndësinë e krijimit të Linjës Kombëtare të Telefonit për Fëmijët, të paraqesë problemet që ndeshin fëmijët në Shqipëri në lidhje me keqtrajtimin dhe shfrytëzimin e tyre, të vlerësojë nevojat për ngritjen e linjës së telefonit, si dhe të shqyrtojë modelet ekzistuese kombëtare dhe ndërkombëtare.

5- Nënseksioni ka përgatitur materialin përkatës për Zyrën e UNICEF, Tiranë për Kongresin e 3 Botëror kundër Shfrytëzimit Seksual të Fëmijëve dhe Adoleshentëve, të mbajtur më 24-28 nëntor 2008. Kjo pasi Zyra e UNICEF-it do të asistonte Qeverinë Shqiptare për përmbushjen e formularit për progresin e zhvillimet e fundit lidhur me masat e marra në luftën kundër shfrytëzimit të fëmijëve. Dokumenti është përgatitur me kërkesë të raporterit special të Kongresit, në bashkëpunim me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministrinë e Brendshme, dhe Avokatin e Popullit.

6- Pjesëmarrje në grupin e punës për hartimin e projektligjit kundër dhunës dhe abuzimit të fëmijëve, organizuar nga CRCA, Nentor 2008

7- Pjesëmarrje në workshopin “Për hartimin e projektligjit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”, organizuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, me datë 7 Nëntor 2008.

8- Takim me përfaqësuesen e Fshatrat e Fëmijëve SOS, lidhur me studimin kombëtar për të rinjtë dhe fëmijët pa kujdes prindëror për problematikat me të cilat ata përballen. Takimi kishte për qëllim marrjen e opinionit në kuadër të problematikave dhe çështjeve që ka trajtuar Avokati i Popullit, 14 Nëntor 2008.

9- Seminari Rajonal “Roli i parlamentarëve për parandalimin dhe reagimin ndaj shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe adoleshentëve”, 14-15 Dhjetor 2008, organizuar nga Kuvendi i Shqipërisë dhe Unioni i

Ndërparlamentarëve. Përfaqësuesja e Nënseksionit në panelin “Të bëjmë funksionale ligjet kombëtare” ka relatuar mbi “Funksionin e Avokatit të Popullit dhe veprimtaria e tij në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve”.

Çështjet konkrete të trajtuara nga Nënseksioni si dhe nga gjithë Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2008, që kanë lidhje me të drejtat e fëmijëve.

Gjatë vitit 2008, Zyra e Avokatit të Popullit ka shqyrtuar gjithsej 96 raste ankesash që kanë patur lidhje me të drejtat e fëmijëve. Duhet të kemi parasysh se tashmë ky Nënseksion funksionon vetëm me një ndihmëskomisioner, për shkak të përfundimit të projektit me Save the Children dhe mbylljes së Zyrave rajonale, për mungesë buxheti. Embrioni i Nënseksionit vepron vetëm në zyrën qendrore në Tiranë, ku një ndihmëskomisioner merret me problemet e fëmijëve.

Nga 96 ankesa 36 kanë rezultuar jashtë juridiksionit apo kompetencës së Avokatit të Popullit, 33 ankesa kanë qenë të pabazuara, janë në shqyrtim 7 ankesa dhe 38 ankesa janë zgjidhur në favor të ankuesve.

Numri më i madh i ankesave për fëmijët vijnë nga prindërit osë të afërmit e tyre.

Objekti i ankesave ka qenë për trajtimin e veçantë të fëmijëve, për përmirësimin e kushteve në shkolla, mosdhënien e ndihmës ekonomike nga Bashkia dhe mospërfitimin e statusit të jetimit, mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore për detyrimin ushqimor të prindërve, vendosjen e fëmijëve jetimë në qendra rezidenciale, përmirësimin e kushteve të strehimit, shkeljen e të drejtave të fëmijëve nga organet e administratave të shteteve të huaja, mosregjistrimin e fëmijëve, dhe moszbatimin e procedurave ligjore për rastet e fëmijëve në konflikt me ligjin, apo ankesa për të drejtat e fëmijëve nga prindërit që vuajnë dënime me heqje lirie, etj.

Po paraqesim disa raste, që janë përfunduar me rekomandim nga Zyra jonë:

**1.** Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur një njoftim Fondacioni “Terre des Hommes”, Korçë, objekt i të cilit ishte fati i dy fëmijëve (M.J dhe H.J). Të dy fëmijët ishin të braktisur faktikisht nga prindërit, janë gjetur në rrugë në qytetin e Korçës, dhe nga Fondacioni Terre des Hommes po punohej në mënyrë që të dy fëmijët të strehoheshin në një institucion rezidencial për fëmijë. Edhe përgjegjësja e shërbimit social pranë Bashkisë Korçë na u drejtua për të ndërmjetësuar lidhur me sistemimin sa më emergjent të dy fëmijëve. Problemin ia drejtua për kompetencë Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Shërbimit Social Shtetëror. Dhe në këtë rast konstatuam sensibilizimin e Shërbimit Social Shtetëror për zgjidhjen pozitive të problemit, pra sistemimin e fëmijëve në një institucion rezidencial për fëmijët.

2. Në Nëntor 2008, Institucioni i Avokatit të Popullit kreu një inspektim në Insitucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vaqarr, Tiranë.

Ndër problemet e konstatuara ishte dhe fakti që në godinën e vetme të Burgut Vaqarr strehohen aktualisht 166 të dënuarit, nga të cilët 13 të mitur. Duhet nënvizuar fakti se megjithë meremetimet e pjesshme dhe disa lyerje, godina e këtij burgu është në nivele të konsiderueshme amortizimi. Në ambientet ku ishin strehuar të miturit nuk kishte mbipopullim. Por dhomat ishin të ftohta, me sistem elektrik të dëmtuar si dhe me lagështirë. Madje edhe biblioteka ku këta të fundit kalonin një pjesë të mirë të kohës kishte të njëjtat kushte. Një tjetër problem që u konstatua nga ankesat e të dënuarvë ishte dhe mungesa e ofrimit të një larmie asortimentesh ushqimore, sipas normativave ditorë dietikë.

Në përfundim të konstatimeve të mësipërme, Avokati i Popullit parashtrroi mendimin se hapja e qendrës penitenciare për të miturit në Kavajë do të zgjidhë përfundimisht problemin e mbipopullimit në Burgun e Vaqarrit. Veçse ky zhvillim duhet të shoqërohet edhe me një sërë investimesh në këtë burg për të arritur një nivel optimal standartesh. I rekomandua Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve përmirësimin e kushteve dhe trajtimit të të dënuarve të Burgut Vaqarr, Tiranë si dhe *mundësimin sa më parë të hapjes së qendrës penitenciare për të miturit në Kavajë, si një veprim që do të ulë menjëherë mbipopullimin në Burgun e Vaqarrit.*

3. Në ankesën e shtetasës Xh.V, e cila vuan dënimin në Burgun 325, Tiranë, paraqitej shqetësimi i saj si nënë e cila nuk kishte mundësi të takonte fëmijët e saj ditëve të shtuna. Kjo pasi ditët e tjera të javës këta fëmijë ishin të angazhuar në shkollë dhe për këtë shkak ishte bërë e pamundur takimi me ta.

Avokati i Popullit i rekomandoi Drejtorisë së Burgut 325 dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve që të mundësojnë takimet me familjarët edhe ditët e pushimit. Përgjigja që morëm lidhur me këtë problem, ishte zgjidhja shumë e shpejtë pozitive. Pra mundësimi i takimeve me familjarët edhe ditët e pushimit.

4. Në ankesën e qytetarit D.B, nga Gjirokastra parashtrohej problemi i mosregjistrimit në Gjendjen Civile të fëmijës që i ka lindur në Greqi. Ai kishte marrë dokumentin e lindjes së fëmijës, por i është refuzuar regjistrimi në Shqipëri, për arsye se dokumenti duhej vulosur në Ministrinë e Brendshme e në Ministrinë e Jashtme të Greqisë, e më pas në Ambasadën Shqiptare në Athinë. Ankuesi për arsye dokumentacioni e kishte të pamundur vajtjen në shtetin grek. Ndaj i gjendur përballë këtij fakti ka kërkuar ndihmën e Zyrës sonë.

Pasi ia dërguam për kompetencë shqyrtimin e këtij rasti Drejtorisë Konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme, në përgjigjen që morëm n u dhanë sqarime për dy rrugë të mundshme për rrugëzgjdhjen e situatës

në të cilën ndodhej ankuesi. Së pari, mundësia e legalizimit të dokumentacionit nga ndonjë i afërm apo i njohur i pajisur me prokurë të posaçme, që më pas do të paraqitej pranë gjendjes civile në Greqi për tërheqjen e dokumentit.

Dhe së dyti, në rast pamundësie, Ministria e Punëve të Jashtme, në bazë të ankesës së marrë, do të veprojë për zgjidhjen e kërkesës nëpërmjet Përfaqësisë diplomatike në vënd. Por theksohej se kjo rrugë ndiqet në raste shumë të veçanta dhe kur janë shteruar të gjitha mundësitë e tjera.

**5.** Shtetasi A.K, banues në Shijak, u ankua për shoqërimin e fëmijës së tij 6 vjeçar nga dy punonjës të Policisë Shijak. Kjo pasi shtetasi M.K kishte bërë kallëzim në Komisaratin e Policisë Shijak, se fëmija F.K i kishte vjedhur atij një çantë. Punonjësit e Policisë e kishin kapur fëmijën kur po kthehej në shtëpi, në rrugë dhe e shoqëruan tek Furgoni i Policisë. Në fakt të atit të fëmijës, këtë veprim ja treguan dy fëmijë 12-13 vjeç që kishin parë momentin e takimit të fëmijës me dy punonjësit dhe se si ata e futën në Furgonin e Policisë, pa prezencën e një prindi. Ndërkohë që i ati ka vajtur në vend ka gjetur fëmijën të frikësuar, e në gjendje mjaft të rëndë emocionale, ndaj tij ishte bërë presion psikologjik. Për tu ankuar ai i është drejtuar Komisaritatit të Policisë Durrës, shefi i krimeve të të cilit i ka thënë që çështjen do të vijojnë ta ndjekin.

Në përfundim të hetimit të kësaj ankese, konkludua se fëmija është shoqëruar nga dy punonjësit e policisë jo në prezencën e prindërve apo të një psikologu. Ai është pyetur në një gjendje mjaft të rëndë emocionale e psikologjike, gjë që përbën veprim të parregullt dhe në kundërshtim me kërkesat ligjore. Veprimet e dy punonjësve të Komisaritatit Shijak, vinin në kundërshtim me nenin 40 të Konventës së OKB “Për të drejtat e fëmijës”, dhe akte të tjera ligjore e nënligjore.

Ndaj sa më sipër i drejtuam Rekomandimin për marrjen e masës disiplinore ndaj dy punonjësve të Policisë Shijak G.D dhe T. D, në bazë të Ligjit 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, rekomandim i cili u pranua nga Shefi i Komisaritatit të Policisë Shijak.

**6.** Shtetasit Y.H dhe F.H, nga qyteti i Beratit janë ankuar se djali i tyre i mitur 13 vjeçar R. H nga data 12.11.2007 e në vazhdim mbahej i izoluar në Spitalin Rajonal në Berat. Ai kontrollohej e ruhej nga punonjës të policisë së shtetit.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë kishte filluar procedimin penal, mbasi ky i mitur është identifikuar si autor i vrasjes së shtetases E.S. Mbi kërkesën e organit proçedues, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Vlorë, për vendosjen e shtetasit R. H në një institucion edukimi për të mitur. Ngarkohej Policia Gjyqësore me zbatimin e këtij vendimi.

Nga verifikimi ynë rezultoi se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, i ka kërkuar Ministrisë së Drejtësisë të konfirmohet institucioni i vuajtjes së masës edukuese që do të zbatohet në rastin konkret ndaj të miturit R.H.

Po kështu ajo, në funksion të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, ka kërkuar që nga ana e Ministrisë së Drejtësisë të konfirmohet sa më parë, se cili është institucioni i caktuar për ekzekutimin e masave edukuese për të miturit që kanë kryer vepra penale, por që për shkak të moshës nuk kanë përgjegjësi penale.

Rezulton se në të dy rastet nga ana e Ministrisë së Drejtësisë nuk është kthyer asnjë përgjigje.

Ndërkohë kemi konstatuar se gjykatat, ndonëse konstatojnë kushtet ligjore të aplikimit të masës edukuese të vendosjes së të miturve në një institucion edukimi, ato hezitojnë në dhënien e vendimeve të tilla për shkak të mungesës së institucionit të edukimit.

Ndaj i rekomanduam Ministrit të Drejtësisë të propozojë në Qeveri marrjen e të gjitha masave të nevojshme organizative, teknike, materiale dhe financiare për krijimin e institucionit të edukimit *për vendosjen e të miturve që kanë kryer vepra penale, por nuk kanë mbushur moshën 14 vjeç.*

Në përgjigjen që morëm nga Ministri i Drejtësisë sqarohet se në muajin Korrik 2008, pas Studimit të kryer nga Instituti Kërkimor i të Drejtave të Njeriut dhe Drejtësisë Sociale në Universitetin e Londrës (HRJS) për zbatimin e Rekomandimeve të Komitetit për Parandalimin e Torturës të Këshillit të Europës, Ministria e Drejtësisë ka përgatitur disa propozime konkrete të argumentuara ndër të cilat është propozuar edhe nevoja për ndërtimin e një institucioni për trajtimin e të miturve që kanë kryer vepra penale përpara mbushjes së moshës për përgjegjësi penale. Duke u përcaktuar si prioritete të Ministrisë së Drejtësisë, këto propozime janë përcjellur pranë autoriteteve përgjegjëse të Këshillit të Europës për shqyrtimin dhe financimin e tyre. Me sigurimin e fondeve të nevojshme për ngritjen e kësaj qendre, Ministria e Drejtësisë do të angazhohet për ngritjen dhe vënien në punë të këtij institucioni, qëllimi i të cilit do të është edukimi dhe pengimi i të miturve për tu përfshirë sërish në veprimtari të paligjshme si dhe aftësimi i tyre për tu integruar në shoqëri në kushte të barabarta me moshatarët e tyre jashtë institucionit.

Si përfundim, mund të themi se Avokati i Popullit është i angazhuar seriozisht të japë një kontribut me rëndësi të veçantë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Kjo duke rritur si ndërgjegjësimin e individëve të komunitetit, ashtu dhe të administratës publike në lidhje me të drejtat dhe përgjegjësitë reciproke në mbrojtjen e garantimin e të drejtave të fëmijëve.



## Nevoja e ngritjes së Ombudsmanit të Fëmijeve

Nuk duhet te harrojmë që të drejtat e njeriut fillojnë me të drejtat e fëmijëve. Një shoqëri që respekton të drejtat njerëzore të fëmijëve, brenda nje gjenerate e me tej, mund të behet një shoqëri që respekton me rigorozitet të drejtat e njeriut në standardet më të larta. Fëmijët kane nevoja te posaçme dhe si rrjedhojë si individë ata kane statusin e tyre. Për këtë arsye, shteti dhe shoqëria e kanë për detyrë që t'i njohin kërkesat dhe te drejtat e tyre, si të drejta të individëve të veçantë.

Neni 54 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë garanton te drejtën e fëmijëve te kenë një mbrojtje te veçantë nga shteti. Nderkohe që, Konventa e Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Mbi të Drejtat e Fëmijës”, e ratifikuar nga shteti yne më 28 Shkurt te vitit 1992, përbën pikën më të gjerë të referencave ligjore dhe politike për çështjet e të drejtave të fëmijës.

Por pavaresisht ketij kuadri ligjor tashme ekzistues ne vend, realiteti i mbrojtjes dhe respektimit te te drejtave te femijeve eshte problematik. Keqtrajtimi i fëmijëve është sot një nder problemet me te mprehta me te cilat ballafaqohet shoqëria shqiptare. Gjithnjë e me tepër po behet i pranishëm realiteti i hidhur i keqtrajtimit te fëmijëve ne forma te ndryshme brenda dhe jashtë familjes, duke filluar nga rrahjet, përdhunimet dhe deri tek vrasjet apo vetëvrasjet. Po kështu, Shteti shqiptar, te gjithë ne, nuk nderohemi dhe nuk duhet të na zërë gjumi derisa edhe një fëmije i vetëm do te vazhdoje të mos shkojë ne shkollë për shkak te ngujimit. Ndërsa është rritur përgjegjësia ndaj disa shkeljeve të të drejtave të fëmijëve, kryesisht nga komuniteti i OJF-ve, numri i fëmijëve të cilëve nuk u janë respektuar të drejtat është duke u rritur.

Ne keto kushte, fëmijëve u nevojitet një organizëm i posaçëm që të shumëfishoje zërat e tyre, në mënyrë që kërkesat dhe interesat e tyre të paraqiten në mënyrë sa më efektive tek Qeveria dhe shoqëria si një e tërë. Me mungesën e mekanizmit të posaçëm koordinues dhe monitorues për zbatimin e të drejtave të fëmijëve, Qeveria, komuniteti dhe OJF-të kanë kapacitete të kufizuara për të marrë masa më efektive, edhe për shkak të mungesës së burimeve njerëzore dhe financiare.

Për t'ju përgjigjur kërkesave te Konventës se Kombeve te Bashkuara mbi te Drejtat e Fëmijës vitet e fundit, ne te gjithë botën, janë ngritur organizma të posaçëm për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave te fëmijëve. Prandaj në mjaft vende këto detyra ju janë caktuar me ligj institucioneve të veçanta të pavarura, që shpesh quhen Ombudsmanë për fëmijët. Norvegjia është vendi i parë, i cili në vitin 1981 ka caktuar një Ombudsman të veçantë për të drejtat e fëmijëve. Zyrat e Ombudsmanëve për fëmijët në botë, përveç trajtimit të ankesave konkrete lidhur me te drejtat e tyre, punojnë edhe për promovimin e këtyre të drejtave, ashtu siç

përcaktohet dhe ne Konventën e OKB-së. Por terminologjia që përdoret për emërtimin e këtyre zyrave është e ndryshme. Ata quhen Ombudsman ose “Komisioneri për Fëmijët”, ose “Mediatori i fëmijëve” etj.

Institucioni i Avokatit të Popullit në Shqipëri është strukturë e specializuar, por mbulon fusha të gjera për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Gjate gjithë veprimtarisë së tij, nepermjet Nenseksionit për të drejtat e femijeve apo bashkepunimit me organizma të ndryshëm nderkombetare që veprojnë në fushën e të drejtave të femijeve, ai është marrë edhe me çështjet që kanë të bëjnë me fëmijët, si një zgjidhje ndaj problemeve dhe shqetësimeve që lidhen me mungesat në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në vend. Amendimi i ligjit “Për Avokatin e Popullit”, për të zgjidhur problemet që kishin dalë gjatë zbatimit të tij në praktikë për të mbrojtur fëmijët, u bë realitet, pas miratimit nga Kuvendi i Shqipërisë të Ligjit nr.9398, datë 12.05.2005 “Për disa ndryshime në Ligjin nr.8454 date 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”. Ndër të tjera, si më të rëndësishme për t’u përmendur në këtë kontekst janë nenet 13 dhe 19/1 të këtij Ligji. Këto i dhanë frymëmarrje dhe mundësi më të mëdha veprimi sidomos Nenseksionit për të drejtat e fëmijëve, duke lejuar shqyrtimin e rasteve të shkeljes së të drejtave të fëmijëve edhe me iniciativë dhe pa pasur kufizimin për të marrë pëlqimin e palës së dëmtuar që, në çdo rast, me që është fëmijë, është shpesh e pa mundur për ta marrë. Gjithashtu neni 19/1 përmend institucionet shtetërore apo të administratës publike ku Avokati i Popullit apo personat e autorizuar prej tij kanë të drejtë të hyjnë në çdo kohë, pa kufizim e pa autorizim paraprak, por duke vënë në dijeni titullarin e institucionit, si në burgje, dhoma paraburgimi, në reparte apo institucione shtetërore, spitale psikiatrike, në azile, në shtëpi fëmije. Pra janë përfshirë në mënyrë specifike edhe shtëpitë e fëmijëve, spitalet e tyre etj.

Por, ne gjykojmë se Avokati i Popullit nuk ka gjithë burimet e nevojshme për të dhënë mbështetjen e duhur për fëmijët. Prandaj krijimi me ligj të veçantë i një institucioni të posaçëm të pavarur për të Drejtat e Fëmijëve (Ombudsman apo Komisioner për Femijet), do të jete një kunderpergjigje për një zgjidhje optimale për çështjet kryesore ku ka probleme me të drejtat e fëmijëve.

Krijimi i këtij institucioni të pavarur, i cili do të jete “garantues” i zbatimit të Konventës së të Drejtave të Femijes dhe do veproje për të promovuar të drejtat e Femijeve tek Parlamenti, Qeveria dhe shoqëria civile, do të ndikojë gjithashtu në politikën, duke krijuar forume ku të degjohet zeri i femijeve, duke riparë aksesin e femijeve në sistemin e ankimimit dhe për t’ju pergjigjur ankesave individuale. Ky institucion duhet të ketë kapacitetin jo vetëm për të hetuar cënimet e të drejtave të fëmijëve dhe të japë zgjidhje për këtë çështje, por sidomos të bëjë bashkëpunimin me aktorët dhe faktorët e tyre në fushën e mbrojtjes dhe

promovimit të të drejtave të fëmijëve, nëpër shkolla, Universitete, qendra të banuara, në media, sipas një strategjie të detajuar, por edhe të mbështetur me burime njerëzore dhe financiare si nga buxheti i shtetit apo donatorë të ndryshëm brenda dhe jashtë vendit.

Objektivi themelor i krijimit të një institucioni të veçantë e të qëndrueshëm për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, është ngritja e standardeve të përmirësimit të të drejtave dhe shërbimeve për fëmijët, për të influencuar më shumë në politikat dhe praktikat e qeverisë, në zbatim të Strategjisë Kombëtare për Fëmijët dhe Planit të Veprimit të kësaj Strategjie, miratuar me VKM nr.368, date 31.05.2005 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për fëmijët”, si dhe të Strategjisë Kombëtare për luftën kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve, viktima të trafikimit.

Avokati i Popullit mendon se rritja e vëmendjes ndaj çështjeve të të drejtave të fëmijëve, sidomos për raportet mes problemeve të fëmijëve dhe interesit të zyrtarëve publikë, për to është një nevojë urgjente. Me krijimin e Ombudsmanit (Komisionerit) për fëmijët, mund dhe duhet të besojmë së kushtet e përmirësuara të jetesës së fëmijëve e të të rinjve do të jenë akoma më në qendër të vëmendjes.

Ne përputhje me bazat kryesore të “Parimeve të Parisit”, të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, për ngritjen e institucioneve të pavarura, për monitorimin, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të individëve, **Ombudsmani apo Komisioneri për Fëmijët** duhet:

- Të mbështesë fëmijët dhe të rinjtë në mbrojtje të të drejtave të tyre dhe të punojë për të realizuar gjithmonë interesin me të lartë të tyre;
- Të ndër marrë studime për politikat dhe për një kuptim e zbatim sa më efektiv të interesit me të mirë të fëmijës nga të gjithë.
- Të paraqesë rekomandime për Parlamentin, Qeverinë dhe të gjithë aktoret e tjerë lidhur me atë çka është me e mira për fëmijët dhe të rinjtë;
- Të presë e të shqyrtojë ankesa nga dhe për fëmijët, si nga ata vetë, ashtu dhe nga personat në moshe madhore lidhur me të drejtat e fëmijëve.

Fushat ku mund të veprojnë institucioni i të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri, mund të jenë mbrojtja e atyre fëmijëve që janë të ekspozuar ndaj kriminalitetit në rritje (duke përfshirë trafikimin), ndaj varfërisë, arsimimit të pamjaftueshëm, varësisë nga drogat, lypjes, dhunës dhe abuzimit seksual, punës së detyruar etj. Gjithashtu ky institucion do të kryejë analiza për të identifikuar arsyet bazë për mosfunksionimin e strukturave të autoriteteve publike në mbrojtje të fëmijëve si dhe do të rekomandojë zgjidhje për Parlamentin dhe Qeverinë kur marrin vendime që kanë të bëjnë me fëmijët.

Ne rrugën për zbatimin e plotë të Konventës dhe të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga aktet ndërkombëtare, Ombudsmani i Fëmijëve do të luajë një rol strategjik për:

- Promovimin e prioritetit sa më të lartë të interesit të fëmijës dhe një vizioni më të gjerë për problemet e fëmijëve, për shkak të fokusimit të problemeve me të cilat merret.

- Përmirësimi i qëndrimeve publike lidhur me fëmijët.

- Ndikimi në ligje, politika dhe praktika duke ju drejtuar me rekomandime dhe propozime specifike Parlamentit dhe Qeverisë.

- Promovim dhe koordinim i veprimtarisë të të gjitha mekanizmave qeveritare për çështjet me fëmijët në të gjitha nivelet.

- Nxitje e përdorimit efektiv të burimeve për fëmijët.

- Nxitje e inkurajim i të drejtës së shprehjes së opinioneve të fëmijëve dhe inkurajim i Qeverisë dhe publikut që t'i kushtojë atyre vëmendjen e duhur.

- Përgjigje për problemet individuale dhe ankesat e fëmijëve, dhe kur është nevoja, të iniciojë apo të mbështesë me ndihmë ligjore fëmijët.

- Një përqendrim mbi fëmijët më të cënuar, që jetojnë në kushte të vështira, të diskriminuar dhe të nxjerrë në plan të dytë nga mungesa e burimeve dhe kushteve për një jetë me cilësi të mirë.

- Një identifikim aktiv i faktorëve dhe një kritikë më të fortë ndaj detyrimeve shtetërore dhe të OJF-ve, po ashtu edhe komuniteteve për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve në Shqipëri.

- Koordinimi i përmirësuar dhe proaktiv mes Ombudsmanit (Komisionerit) dhe agjensive shtetërore si dhe organizmave të ndryshme që mbrojnë të drejtat e fëmijëve, për një ambient më përgjegjës mbi politikën si dhe për ndërhyrje të qëndrueshme të qeverisë për të drejtat e fëmijëve.

- Gjithashtu promovimi i pjesëmarrjes së fëmijëve shton vlerën ndaj suksesit të të gjitha iniciativave për të mbështetur fëmijët, si dhe do të bëjë të mundur që të dëgjohet zëri i tyre. Institucioni i posaçëm do të ketë njohuri me të thella mbi situatën e fëmijëve dhe të drejtave të tyre në vend dhe do të përcaktojë më mirë veprimet që duhen marrë kur ka shkelje të këtyre të drejtave. Këtu përfshihen:

- a. Studimet specifike mbi fëmijët në lidhje me çështje të ndryshme.

- b. Sigurimin se një pjesë e rëndësishme e njohurisë së punës vjen nga vetë fëmijët.

- c. Sigurimin e aktorëve kyç me informacionin e përshtatshëm mbi politikën dhe veprimet për të reflektuar një përjasje mbi të drejtat e fëmijëve ndaj të gjitha çështjeve që dëmtojnë fëmijët.

- d. Analiza gjithëpërfshirëse të situatës së të drejtave të fëmijëve në vend dhe faktorët e ndryshëm që influencojnë zbatimin e tyre, duke ndjekur parimet e KDF-së të Kombeve të Bashkuara.

e. Vlerësimi i mungesave në legjislacion, do të krijojë një bazë për pranimin e përgjithshëm publik të praktikave më të mira të drejtave të fëmijëve.

Nëpërmjet ndryshimeve të nevojshme ligjore, organizimi i posaçëm për fëmijët do të pozicionohet të punojë më me efikasitet dhe me një mandat më të fortë për ta, duke u mbështetur më gjerësisht nga autoritetet qendrore dhe lokale në të gjithë Shqipërinë.

Në një kuptim më të gjërë, të gjithë fëmijët në Shqipëri, të drejtat e të cilëve janë shkelur, do të përfitojnë. Përfitues do të jënë mijëra fëmijë të cilët do të përfitojnë në mënyrë direkte dhe jo direkte me anë të ndërhyrjeve, apo përmirësimeve në legjislacion si edhe nëpërmjet rekomandimeve që do ndikojnë në mënyrë pozitive gjendjen për fëmijët në Shqipëri. Ombudsmeni apo Komisioneri për Fëmijët dhe OJF-te në Shqipëri do të punojnë në partneritet për të përmirësuar mbrojtjen institucionale dhe kujdesin efektiv me të gjitha institucionet shtetërore, në dobi të interesit më të lartë të fëmijëve.

Gjate vitit 2008, Avokati i Popullit ka paraqitur një Raport të posaçëm para Kuvendit të Shqipërisë për të bërë të njohur më në thellësi gjendjen e fëmijëve, veprimtarinë e institucionit në këtë fushë, si dhe nevojën për krijimin e bazës së nevojshme ligjore për institucionalizimin dhe forcimin e punës për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Pra, efektivisht kjo është një nga çështjet që Avokati i Popullit e gjykon shumë të rëndësishme dhe që kërkon një zgjidhje të shpejte, për respektimin e parimit të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijëve në Republikën e Shqipërisë.

## **18. Veprimtaria e Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës**

Institucioni i Avokatit të Popullit ka patur që në themelimin të tij një aktivitet mjaft të spikatur, lidhur me evidentimin dhe parandalimin e rasteve të torturës, trajtimit çnjerëzor dhe degradues. Shpesh veprimtaria e Institucionit të Avokatit të Popullit ka qenë subjekt referimi në mjaft raporte ndërkombëtare, në të cilat është vënë theksi mbi rëndësinë e evidentimit dhe eliminimit të rasteve të dhunës.

Si rrjedhojë e natyrshme e veçorive dhe arritjeve të punës tonë në këtë fushë, në Qershor të vitit 2007 Avokati i Popullit në bashkëpunim me Qendrën Shqiptare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës zhvilloi një seminar të përbashkët me Temë “Shqipëria pa Torturë”. Qëllimi i këtij takimi ishte të hidheshin ide dhe të jepeshin propozime mbi mënyrën se si do të vihej në zbatim Ligji Nr. 9094 dt.03.07.2003 “Për Ratifikimin

e Protokollit Opsional të Konventës kundër Torturës dhe Ndëshkimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT)”.

Në përfundim të diskutimeve dhe analizave mbi rolin e MKPT-se, në praninë edhe të përfaqësuesve të qeverisë dhe shoqërisë civile, Institucioni i Avokatit të Popullit u evidentua si organi më i përshtatshëm që plotësonte të gjitha kushtet për të kryer një veprimtari të tillë. Ky institucion, sipas tyre, plotësonte tërësisht kriteret ndërkombëtare të ashtuquajtura “Parimet e Parisit” duke qenë i pavarur dhe duke gëzuar kompetenca të plota ligjore për të realizuar inspektime dhe për të patur akses në çdo ambient sigurie.

Me miratimin e buxhetit të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2008, nga ana e Qeverisë u shtua fondi i pagave për 5 vende të reja pune, me anë të cilave u nënkuptua plotësimi i kushteve financiare për të përmbushur detyrën e MKPT-së. Ky veprim shënoi fillimin “de facto” të punës së Avokatit të Popullit në rolin e MKPT-se. Nënvizojmë termin “de facto”, pasi ky funksion i ri nuk u shoqërua me një akt tjetër politik, i cili të kishte si qëllim formalizimin e njohjes së MKPT-se me anë të një rezolute nga Kuvendi i Shqipërisë.

Megjithëse kërkesa për njohjen formale si MKPT u paraqit në Kuvendin e Shqipërisë nga Avokati i Popullit në Shkurt të vitit 2008, ajo nuk u pasqyrua në Rezolutën përkatëse, për shkak të volumit dhe shpejtësisë së procedurave kuvendore të procesit të raportimit.

Duke qenë se një veprim i tillë ka një rëndësi të veçantë sidomos në aspektin e njohjes ndërkombëtare të MKPT-se, veçanërisht për instancat e OKB-se që monitorojnë punën për krijimin e tyre, shpresojmë se në përmbajtjen e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për veprimtarinë e Avokatit të Popullit për vitin 2008 një vendim i tillë do të gjejë pasqyrim.

Pavarësisht sa më lart, duke e konsideruar këtë veprim si thjesht të një natyre formale, Avokati i Popullit, për shkak të akordimit të fondeve, miratoi në strukturën e tij Njësinë për Parandalimin e Torturës të përbërë nga 5 punonjës, duke filluar kështu zyrtarisht në Janar të Vitit 2008 detyrën e tij si MKPT.

Vizioni i ndërtimit dhe vënies në punë me efikasitet të MKPT-së është strukturuar nga ana e Avokatit të Popullit në 5 drejtime kryesore:

### **1. Vënia në funksionim;**

Modeli për krijimin dhe vënien në funksionim të MKPT-se është miratuar sipas formës së inkorporuar institucionale pranë Avokatit të Popullit. Për vënien në funksionim të tij janë konsultuar një sërë aktesh, manualesh dhe eksperiencash të vëna në dispozicion nga Shoqata e Parandalimit të Torturës (APT) me qendër në Gjeneve Zvicër, nga Komiteti për Parandalimin e Torturës i Këshillit të Evropës, si dhe nga Ombudsmani i Mbretërisë së Danimarkës.

## **2. Kryerja e inspektimeve;**

Me rekrutimin e stafit punonjes, që nga muaji Korrik deri në fund të muajit Nentor 2008 Njësia për Parandalimin e Torturës ka inspektuar 50 objekte ku përfshihen 9 burgje, 9 qendra paraburgimi, 8 reparte ushtarake, 4 spitale psikiatrike dhe 3 qendra spitalore infektive, 2 qendra azilkerkuesish dhe emigrantesh të paligjshëm dhe 15 Komisariate të Policisë.

Pas këtyre inspektimeve Avokati i Popullit ka paraqitur 45 rekomandime me shkrim pranë institucioneve përkatëse, duke kërkuar përmirësimin e kushteve dhe të trajtimit të personave që ju është privuar liria. Në disa raste gjatë inspektimeve është konstatuar dhune fizike dhe për këtë janë kryer veprimet konkrete, duke kallëzuar penalisht në Prokurori autorët e dyshuar me funksione publike. Për këto raste flitet gjerësisht në vijim të raportit sipas fushave konkrete.

Njëkohësisht nga ana e Njesisë për Parandalimin e Torturës janë trajtuar edhe 345 ankesa të marra gjatë inspektimeve për të cilat janë kryer veprime konkrete dhe janë paraqitur rast pas rasti edhe rekomandime përkatëse. Veprimtaria për këto ankesa shpjegohet gjerësisht në fushat e veçanta të trajtuara në këtë raport.

Avokati i Popullit për kryerjen sa më të programuar dhe me cilësi të inspektimeve ka hartuar në vijimësi plane masash dhe programe periodike për qendrat që do të vizitohen nga Njësia për Parandalimin e Torturës. Njëkohësisht për çdo ambient inspektimi janë hartuar formularë të gatshëm, të cilët parashikojnë një listë standartesh, të cilat duhet të kontrollohen nga ekspertet përkatës të zyrës.

## **3. Promovimi i veprimtarisë së MKPT-se;**

Duke e konsideruar të rëndësishëm aspektin njohës dhe promovues të veprimtarisë së MKPT-se, Avokati i Popullit ka ndërmarrë një sërë takimesh, si dhe ka bashkëorganizuar një sërë aktivitetesh me tematikë mbi parandalimin e torturës, duke e faktorizuar punën e MKPT-së.

Konkretisht gjatë vitit 2008 janë zhvilluar 5 tryeza të rrumbullakta me përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Policisë së Shtetit, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Shoqërisë Civile etj.

Në Shkurt, Korrik dhe Dhjetor të Vitit 2008 në bashkëpunim me Qendrën Shqiptare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës dhe Qendrën Daneze të Viktimave të Torturës, Avokati i Popullit ka zhvilluar tre tavolina të rrumbullakta, me anë të të cilave ka kërkuar të sensibilizojë organet qendrore të shtetit dhe shoqërinë civile mbi procesin e ngritjes së MKPT-se dhe rëndësinë e kësaj strukture në parandalimin e torturës. Për këtë qëllim në muajin Korrik 2008, pjesë e një prej këtyre takimeve u bë edhe Ombudsmeni i Mbretërisë së Danimarkës, i cili parashtroi rëndësinë e MKPT-se duke dhënë eksperiencën e vendit të tij mbi këtë aspekt.

Në muajin Tetor 2008 Avokati i Popullit zhvilloi një konferencë të përbashkët me Ministrinë e Brendshme dhe me Policinë e Shtetit. Qëllimi kryesor i këtij takimi ishte njohja dhe bashkëpunimi i ngushtë i këtyre strukturave me MKPT-në si kusht parësor për parandalimin e rasteve të dhunës në ambientet e policisë.

Në muajin Dhjetor 2008 Avokati i Popullit zhvilloi një konferencë të përbashkët me Ministrinë e Drejtësisë, Prokurorinë e Përgjithshme dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve. Qëllimi kryesor i këtij takimi ishte njohja dhe zgjidhja e problematikave të dala gjatë inspektimeve të MKPT-se lidhur me respektimin e të drejtave të burgosurve dhe paraburgosurve.

Në kuadër të bashkëpunimit dhe promovimit në aspektin ndërkombëtar të veprimtarisë së MKPT-se, përfaqësues të Njesisë për Parandalimin e Torturës kanë marrë pjesë në dy takime ndërkombëtare të zhvilluara nga Këshilli i Evropës, lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut në burgje dhe në polici. Në këto takime, nga ana e eksperteve tanë janë dhënë mendime dhe është kërkuar eksperiencia e vendeve të tjera për të aplikuar sa më mirë në praktike inspektimet në këto ambiente.

Se fundi nuk duhet lënë pa përmendur puna mjaft e mirë që është bërë për informimin publik të veprimtarisë së MKPT-se, nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të Avokatit të Popullit, organeve të shtypit etj. Në këtë rast pasqyrimi i rezultateve të inspektimeve apo punës për zbardhjen e rasteve të dhunës në burgje, komisariate policie etj, ka qenë një avantazh i madh për ndërgjegjësimin e publikut në denoncimin e fenomeneve negative të keqtrajtimit apo abuzimit me detyrën të punonjësve shtetëror. Një rol të pazëvendësueshëm në këtë rast ka luajtur marrëdhënia mjaft e ngushtë me median e shkruar dhe atë vizive. Falë këtij bashkëpunimi gjatë vitit 2008 është rritur në mënyrë të ndjeshme pasqyrimi i pjesëmarrjes së Avokatit të Popullit në zgjidhjen e mjaft ngjarjeve apo problemeve që kanë shqetësuar qytetarët.

#### **4. Rekomandimet legjislative**

Një nga veprimtaritë funksionale të MKPT-se ka qenë edhe paraqitja e rekomandimeve me karakter legjislativ, të cilat nëpërmjet propozimit për ndryshime dhe amendime të akteve ligjore dhe nënligjore, ka patur si synim të përmirësojë kuadrin ligjor në fuqi për parandalimin e torturës dhe respektimit të të drejtave të individëve.

Në Mars 2008 Avokati i Popullit u ftua të jepte propozimet e tij në një debat kuvendor për ndryshimet e reja në Ligjin “Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve”. Në përfundim të këtij debati u arrit që të pranohet propozimi i Avokatit të Popullit që në përmbajtje të ndryshimeve ligjore të përfshihej edhe veprimtaria mbikëqyrëse e MKPT në sistemin penitenciar, si një organizëm garant për respektimin e të drejtave dhe trajtimin e të dënuarve.



Në Maj 2008, Avokati i Popullit paraqiti me cilësinë e MKPT-së një Raport të Posaçëm në Kuvendin e Shqipërisë, në lidhje me gjendjen e shëndetit mendor. Megjithëse ky raport nuk është shqyrtuar ende nga Kuvendi, ai përmban një sërë problematikash të mprehta që shoqërojnë çdo ditë respektimin e te drejtave të njeriut, veçanërisht në burgje dhe spitale psikiatrike.

Në vazhden e përpjekjeve për përmirësimin e kuadrit ligjor në fuqi, Avokati i Popullit në rolin e MKPT-se ka dhënë kontributin e tij të veçantë, duke dhënë mendime dhe propozime me shkrim për përmirësimin e Ligjit “Për Policinë e Burgjeve”, Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, Rregulloreve të veçanta të ambienteve të sigurisë së Policisë së Shtetit. Njëkohësisht përfaqësues të Njësisë për Parandalimin e Torturës janë caktuar si pjesëtar të Konsorciumit për reformën në burgje, si dhe anëtarë të bordit të projektimit të godinave të reja të burgjeve dhe paraburgimit në vend. Në këto borde janë dhënë mendime lidhur me respektimin e standarteve mbi trajtimin e personave të dënuar.

### **5. Raportimet dhe bashkëpunimi ndërkombëtar**

MKPT-ja është një funksion, i cili kërkon pa dyshim një punë të veçante në kuadër të raportimit ndërkombëtar. Në këtë drejtim, që me krijimin e Njësisë për Parandalimin e Torturës janë vendosur lidhje me përfaqësues në Nënkomitetin Kundër Torturës të OKB-së, Komitetin kundër Torturës së OKB-së si dhe me Komitetin për Parandalimin e Torturës të Këshillit të Evropës.

Gjithashtu përfaqësues të Njësisë për Parandalimin e Torturës janë bërë pjesëtarë të grupeve të punës pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme Shqiptare, lidhur me përgatitjen e raporteve pranë Këshillit të Evropës dhe Komitetit kundër Torturës (CAT) të OKB-se. Për këtë të fundit nga ana e Avokatit të Popullit si Mekanizëm Kombëtar është paraqitur gjate vitit 2008 edhe një raport i posaçëm përmbledhës që ka patur lidhje me parandalimin e torturës.

Ndërkohë në bashkëpunim me Ministrinë e Jashtme po vijojnë komunikimet me Nënkomitetin kundër Torturës të OKB-së, lidhur me të dhënat dhe informacionet që ata kërkojnë në mënyrë periodike për punën e MKPT-së.

#### **Sfidat**

Duke qenë një veprimtari e re dhe shumë specifike, parandalimi i torturës nëpërmjet inspektimeve periodike ka patur edhe sfidat dhe vështirësitë e tij. Konkretisht problemet që kemi hasur i kemi ndare në dy shtylla kryesore:

1. Probleme të sigurimit të bazës së nevojshme materiale dhe logjistike për të kryer një punë me efikasitet dhe profesionalizëm;

2. Probleme në mangësitë e disa institucioneve shtetërore për të njohur dhe vlerësuar drejt aksesin dhe detyrat që duhet të ushtrojë Avokati i Popullit në rolin e MKPT-së.

Në vështrim të pikës së parë mund të nënvizojmë se puna e kryer nga ana jonë është përcjellë gjatë vitit 2008 me mungesa të mëdha. Konkretisht në mjaft raste, kur është konstatuar dhunë gjatë inspektimeve, Avokati i Popullit ka ndjerë nevojën e dhënies së një mendimi të pavarur nga ekspertë të fushave të ndryshme (sociologjike, psikiatrike, psikologjike, mjeko-ligjore etj). Vetëm në një rast kjo është mundësuar nga fonde të OJF-ve, pasi shteti shqiptar nuk ka lëvruar financime shtesë për këtë veprimtari, përveç pagave të stafit.

Gjithashtu, ashtu siç jemi shprehur edhe më lart, vijojnë të mbeten problem sigurimi i fondeve të veçanta për blerje pajisjesh pune, kancelarie, dieta, automjete, aparate dixhitale audio dhe video etj. Duke mos patur mbeshtetje financiare logjistike nga ana e Qeverisë, Institucioni i Avokatit të Popullit u detyrua të vinte në funksion të kesaj strukture pajisje të huazuara nga seksionet e tjera si psh, kompjutera, kancelari, pajisje zyre, automjet etj.

Nisur nga këto vështirësi, Avokati i Popullit në të gjitha takimet e zhvilluara me përfaqësues të shtetit shqiptar, partnerë të tjerë vendas dhe të huaj ka kërkuar që të ndihmohet me bazë materiale, pasi aktualisht e ka të vështirë të përmbushë në mënyrë të plotë detyrën e tij.

Në vështrim të pikës së dytë, Avokati i Popullit shpesh herë ka vënë re se megjithë veprimtarinë e tij promovuese për MKPT-në, disa institucione nuk janë përshtatur dhe kanë krijuar pengesa të pajustificueshme në kryerjen e detyrës tone. Kjo është vënë re sidomos në pengesat për të hyrë në ambientet e sigurisë së Komisariateve të Policisë në Tiranë, Gjirokastrë, Vlorë etj. Gjithashtu në disa raste nuk janë lejuar që punonjës të zyrës tonë të marrin me vete brenda këtyre ambienteve pajisje fotografimi për të provuar me fakte dhunën.

Për të gjitha këto raste, Avokati i Popullit ka komunikuar me Ministrin e Brendshëm, Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve etj. Pas këtyre komunikimeve është vënë re një angazhim dhe përgjegjshmëri më e madhe e këtyre strukturave për të reaguar në mënyrë ligjore në përkrahje të punës tonë. Gjithsesi sërish në praktike vihen re mangësi nga niveli ekzekutiv i punonjësve të këtyre strukturave.

### **Parashikimet për të ardhmen**

Avokati i Popullit për vitin 2009 ka miratuar një program të ri inspektimi, në të cilin numërohen 120 inspektime në të gjithë vendin, duke përfshirë këtu Komisariate Policie, Burgje, Qendra Paraburgimi, Spitale, Reparte Ushtarake etj.

Në këto inspektime, MKPT-ja është orientuar t`ju rikthehet edhe një herë objekteve të inspektuara më parë, për të parë dhe nxjerre në pah ndryshimet e bëra sipas propozimeve të Avokatit të Popullit.

Gjithashtu është menduar të forcohet bashkëpunimi me OJF-te për të realizuar grupe të përbashkëta inspektimi, të cilat do të kenë në përbërje të tyre specialiste nga të gjitha fushat që nevojiten, si p.sh.: psikolog, mjek ligjor, mjek psikiatër, sociolog etj.

Gjate këtyre inspektimeve një rol të veçantë do të kenë dhe përfaqësues të medias, të cilët me pasqyrimin e kësaj veprimtarie dhe problematikave që do të konstatohen do të japin një shtyese të madhe për ndërgjegjësimin e organeve shtetërore për zgjidhjen e tyre sa më të shpejtë.

Në kuadër të promovimit të punës dhe bashkëpunimit me organet e administratës publike, gjate vitit 2009 është menduar të organizohen takime dhe konferenca të përbashkëta me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë, lidhur me trajtimin dhe respektimin e të drejtave të ushtarakëve; me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Spitalet Psikiatrike dhe Infektive për respektimin e të drejtave të pacienteve dhe kushtet e trajtimit të tyre, si dhe me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për trajtimin e emigrantëve të paligjshëm dhe azilkërkuesve në vendin tonë.

Avokati i Popullit do të intensifikojë bashkëpunimin me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe me organizmat ndërkombëtare për të hartuar dhe raportuar në mënyrë sa më efektive veprimtarinë e tij në rolin e MKPT-së.

Për këtë veprimtari pritet që gjatë vitit 2009 Avokati i Popullit të publikojë raportin e parë të përmbledhur mbi veprimtarinë e MKPT-se, i cili krahas paraqitjes së tij në Nënkomitetin kundër Torturës në OKB, do t`i vihet në dispozicion edhe Kuvendit të Shqipërisë dhe institucioneve të tjera të larta në vend.

Ne mendojmë se përmbushja me sukses e detyrave në vitin e parë të detyrës së MKPT-se dhe realizimi i plotë i objektivave për vitin në vazhdim janë një provë e qartë e përgjegjësisë tona. Ky angazhim demonstroi qartë se Avokati i Popullit i ka të gjitha aftësitë për të punuar për një Shqipëri pa torturë dhe për standarde të larta të të drejtave të njeriut, duke e renditur kështu Shqipërinë në 10 vendet e para në Evropë që e kanë aplikuar me sukses këtë nismë.

Ne shpresojmë se besimi që na është dhënë nga Kuvendi i Shqipërisë për të përmbushur këtë veprimtari dhe mbështetja e Qeverisë Shqiptare e bërë publike nga vetë Kryeministri, kanë një rol mjaft domethënës që motivon së tepërmi aftësitë tona për të realizuar detyrimet kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut.

## 19. Veprimtaria e Avokati të Popullit pas tragjedisë së ndodhur në fshatin Gërdec

Nga shpërthimi i lëndëve plasëse në një fabrikë private të demontimit të municioneve, në fshatin Gërdec të rrethit Tirane, në datën 15 Mars 2008 humbën jetën 26 shtetas të pafajshëm. Midis tyre kishte gra dhe të mitur, si dhe u plagosën më shumë se 300 të tjerë. Gjithashtu u dëmtuan me qindra banesa, prona dhe objekte social-ekonomike, private apo shtetërore, të shoqëruara me pasoja të karakterit psikologjik, mjedisor, të marrëdhënieve shtet-individ, të përgjegjësive të të zgjedhurve dhe të emëruarve në administratën publike, etj.

Ngjarja, pavarësisht shkaqeve që e sollën, tregoi frymën e solidaritetit të lartë të të gjithë kombit me të dëmtuarit. Në të njëjtën kohë, u provua edhe impenjimi dhe koordinimi i mirë ndër-institucional i të gjithë strukturave shtetërore, për dhënien e ndihmës se menjëhershme dhe për minimizimin e pasojave.

Avokati i Popullit, në ushtrim të funksioneve të tij, kontaktoi menjëherë me përfaqësues të niveleve të ndryshme të pushtetit qendror dhe vendor dhe me banorë të zonës së dëmtuar, nga ku mori informacionin paraprak ndër të tjera dhe për problemet që shqetësonin banorët e dëmtuar nga tragjedia. Në vijim, u ngritën grupe pune me ekspertë të institucionit që ndoqën në Bashkinë e Vorës dhe fshatrat për rreth, procesin e verifikimit të dëmeve të pasurive nga komisionet përkatëse të krijuara nga shtabi i emergjencës në prefekturë dhe u trajtuan mbi 40 ankesa të familjeve të dëmtuara nga shpërthimi. Problemet dhe shqetësimet e tyre lidhur me transparencën e procesit të dëmshpërblimit për dëmet materiale dhe të shëndetit, të shumës së ndihmave dhe donacioneve të dhëna për rastin në fjalë, ju bënë të ditura Ministrit të Brendshëm.

Në përgjigjen e tij të datës 05.05.2008, Ministri i Brendshëm, zoti Bujar Nishani, konfirmoi se vlerësimet dhe rivlerësimet e pasojave për çdo subjekt, përfshirë edhe ankuesit, ishin bërë dhe do të bëheshin me transparencë të plotë. Po kështu, na u konfirmua se, Këshilli i Ministrave, nëpërmjet dy vendimeve të tij, i kishte akorduar Bashkisë së Vorës një shumë prej 6.950.000 lekësh për përbalimin e situatës dhe ishin trajtuar me ndihmë financiare 136 persona të plagosur.

Por në vijim, nga banorët e prekur na u prezantuan dhe ankesa që kishin të bënin me mostransparencën e Bashkisë Vorë në administrimin e ndihmave dhe donacioneve të ndryshme, të marra nga persona fizikë apo juridikë privatë, vendas apo të huaj si dhe nga persona juridikë publikë për menaxhimin sa më të shpejtë të situatës së krijuar nga tragjedia e Gërdecit. Ankuesit ngritën pretendime për shumën e ndihmave dhe donacioneve të përfituara si dhe mënyrën e menaxhimit të tyre nga ana e

Bashkisë Vorë, duke pretenduar trajtim të pabarabartë dhe shkelje të të drejtave të tyre.

Në situata emergjente të krijuara nga fatkeqësi, të tilla siç ishte rasti i Gërdecit, marrja nga ana e publikut në mënyrë të saktë, të plotë, të përshtatshme e të shpejtë e informacionit të nevojshëm e ndër të tjera dhe bërja e transparencës për ndihmat dhe donacionet e dhëna, ku përfitues direkt të tyre, janë njerëzit e prekur nga fatkeqësia, është shumë i rëndësishëm.

Avokati i Popullit, duke gjykuar se informimi i publikut të interesuar në një rast të tillë, merr rëndësi të veçantë dhe mënjanon çdo lloj paragjykimi lidhur me trajtimin e njerëzve të prekur dhe dhënien në kohën e duhur të ndihmës së nevojshme, me qëllim rritjen e efektshmërisë në zbatueshmërinë e ligjit dhe transparencën e administratës, rekomandoi marrjen e masave për publikimin (afishimin) në vende të dukshme dhe lehtësisht të aksesueshme nga publiku të informacionit që dispononte, lidhur me ndihmat dhe donacionet e përfituara nga Bashkia Vorë, për administrimin e situatës së krijuar nga fatkeqësia e ndodhur në fshatin Gërdec, në 15 Mars 2008. Ky rekomandim u zbatua menjëherë nga Bashkia e Vorës.

Ngjarja e ndodhur në periferi të Tiranës, përveç viktimave dhe tronditjes së opinionit publik, ishte edhe një këmbanë alarmi për gjithë shoqërinë shqiptare për të shqyrtuar nivelin e sigurisë së jetës.

Institucioni i Avokatit të Popullit, duke marrë shkas nga kjo tragjedi dhe realiteti konkret, bazuar në detyrat e tij kushtetuese në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të individëve dhe për të ndikuar në mirëqeverisjen e vendit, larg praktikave rutinore, duke patur parasysh se e drejta e jetës së shtetasve dhe e pronës shpesh kërcënohet nga objekte dhe veprimtari të ndryshme, që përbëjnë burim rreziku të shtuar, ndërmori nismën për të kërkuar verifikimin nga të gjithë njësitë e qeverisjes vendore të këtyre objekteve dhe veprimtarive. Gjatë këtij procesi u pat parasysh se pas viteve 90-të ishte domosdoshmëri përshtatja e shtetit dhe e të gjithë strukturave të tij, e modelimit të jetës ekonomike, politike, dhe shoqërore me parimet e një shoqërie të lire, demokratike dhe pluraliste, me normat e ekonomisë së tregut të lire, me lirinë e mendimit dhe të gjithë të drejtat e tjera të njeriut të pranuar.

Nga reformat që shoqëruan këto ndryshime në ekonomi, u mbyllën shumë fabrika, ndërmarrje jo efikente, u shkrinë të gjitha kooperativat bujqësore, u bë ristrukturimi i Forcave të Armatosura në përputhje me objektivat e reja të sigurisë, e morën jetë shumë nisma të tjera, që sollën midis pasojave të tjera, edhe stoke të mëdha dhe pa perspektivë në qarkullimin civil; materiale të lëndë të rrezikshme për jetën dhe pronën, të tilla si armatime dhe municione, të llojeve të ndryshme, kimikate industriale, pesticide, rezerva amoniaku, zhive etj.

Nga fenomenet, konceptimet dhe qëndrimet indiferente që shoqëruan periudhën e tranzicionit, u shtuan dhe veprimtaritë dhe objektet me burim rreziku të shtuar, të tilla si ndërhyrjet në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, objekte ndërtimore me dëmtime të rënda, shumëfishimi i transportit të njerëzve dhe mallrave, futja e teknologjive të moderne, rritjet e ritmeve në ndërtim, etj, që natyrshëm rrisin potencialisht rreziqet për komunitetin.

Avokati i Popullit kërkoi nga çdo komunë dhe bashki, evidentimin në territoret ku ushtronin juridiksionin e tyre të objekteve të konsideruara burim rreziku të shtuar për shëndetin dhe jetën e popullatës, vendndodhjen dhe pronarin, shtetëror apo privat.

Gjithashtu kërkua të viheshim në dijeni të veprimeve konkrete në ushtrimin e detyrimeve të tyre ligjore në baze të Ligjit nr. 8652, dt.31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar.

Me kënaqësi konstatojmë se reagimet e të gjitha njësive të qeverisjes vendore, të prefektëve dhe të këshillave të qarqeve, ishin pozitive për vetë rëndësinë e çështjes. Këtë e tregojnë përgjigjet e shpejta të tyre, në të cilat dukej interesimi konkret për verifikimin në çdo zonë të komunave, bashkive apo qarqeve të objekteve dhe veprimtarive me burim rreziku të shtuar, identifikimi i tyre i saktë jo vetëm si objekte por edhe pronësia e tyre. Në shumë raste këto të dhëna shoqëroheshin edhe me veprimet e tyre të ndërmarra për parandalimin e ngjarjeve të rënda, si kërkesa drejtuar organeve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri, të inspektorateve të mjedisit, atij shëndetësor, urbanistik apo teknik. Nga përgjigjet e ardhura u krijua një tablo më e plotë për situatën në vend të problemeve që kishin të bënin me kushtet e ndërtimit, të sigurisë, të liçensimit dhe ruajtjes nga zjarri në pikat e depozitimit dhe të tregtimit të gazit të lëngshëm, naftës dhe nënprodukteve të saj, me gjendjen teknike të digave të rezervuarëve të ujit, të hidrocentraleve dhe të dambave, të pikave të ruajtjes së armatimit dhe municionit luftarak, të gjëndjes së disa ndërtesave të amortizuara, të kabinave elektrike dhe të linjave ajrore, të depove të ruajtjes së pesticideve apo kimikateve të tjera të rrezikshme, të depove të ujeshellsave, e shume objekte dhe veprimtari të tjera të këtyre natyrave.

### **1. Për armët dhe municionet**

Rekomandimi ynë i parë ju drejtua Ministrit të Mbrojtjes dhe Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë. Ne të nenvizojmë faktin se inisiativa e ndërmarrë nga institucioni i Avokatit të Popullit, synonte që të rriste nivelin e përgjegjësisë dhe të vinte në levizje të gjitha organet shtetërore dhe autoritetet publike të ngarkuara nga ligji me kontrollin dhe disiplinimin e veprimtarive dhe objekteve me burim rreziku të shtuar. Rekomandojmë rritjen e shkallës së përgjegjësisë të strukturave perkatese të

ushtrise dhe te bashkepunimit te tyre me organet vendore dhe qendrore te administrates publike, per marrjen e masave, per vetë specifikën e dikasterit, në disa nga objekte qe konsiderohen potencialisht me rrezikshmeri per jeten, mjedisin dhe pronen e shtetasve, publike dhe shtetërore dhe per te cilat kerkohej informacion, për depot, ambientet e reparteve ushtarake, tunelet apo magazinat e ruajtjes se lendeve plasëse, kimike dhe toksike, të armatim-municionit, ndermarrjet, uzinat e destinuar per prodhim ushtarak dhe poligonet për demontimin e municionit luftarak.

Ngjarjet e meparshme qe kishin ndodhur ne disa objekte te ruajtjes së municion-armatimit, informacionet qe kishte dhene vetë Ministria e Mbrojtjes për ekzistencen e nje kontigjenti jo te vogel te lendeve shperthyese, te veshtiresive objektive ne miradministrimin dhe kontrollin e tyre, te nismave te bashkepunimit te saj me organizma nderkombetare per neutralizimine tyre, si dhe te dhenat e mediave te ndryshme, ishin nje shkak tjetër per të bërë rekomandimin per marrjen e masave te menjehereshme organizative-teknike per riverifikimin e gjendjes faktike ne te gjitha objektet ushtarake me burim rreziku te shtuar. U kerkua nese ato ishin në perputhje me kerkesat e akteve ligjore dhe ato nenligjore qe kishin te benin me ruajtjen, mirembajtjen, sigurinë, transportin, demontimin dhe shkatërrimin ne poligone, uzina e ndermarrje ushtarake, forcimin e sherbimit periodik teknik dhe te rregullave te hyrjes te materialeve dhe të njerëzve në objektet ushtarake, sigurimin e mjeteve te mbrojtjes nga zjarri, masat parandaluese nga agjentet e fenomenet e mundshme atmosferike si dhe marrjen e masave të rrepta administrative dhe penale ndaj kujtdo që me veprime apo mosveprime cenonte sigurine e këtyre objekteve.

Rekomandimi shoqërohej edhe listën e disa objekteve ushtarake qe sipas njoftimeve te organeve te pushtetit vendor, paraqesnin me teper rrezikshmeri dhe per te cilat kerkohej nje trajtim me i shpejte.

Ky rekomandimi u mireprit nga Ministria e Mbrojtjes. Në përgjigjen e tij, Ministri i Mbrojtjes, zoti Gazmend Oketa, midis te tjerave nënvizonte që: “Ju informoj se Ministria e Mbrojtjes vazhdon te punoje ne menyre intensive, si per identifikimin e objekteve ushtarake te cilat mund te perbejne shqetesim dhe qe mund te konsiderohen me burim te shtuar rreziku per jeten dhe shendetin e individeve, ashtu edhe ne zvoglimin dhe menjanimin e ketyre rreziqeve”.

Shtabi i Pergjithshem dhe strukturat e tjera ne Ministrine e Mbrojtjes, planizuan dhe percaktuan rregulla te forta per asgjesimin e te gjithë municionit dhe armatimit te tepert dhe te panevojshme. Keshilli i Ministrave, ne muajin Tetor 2008 pergatiti nje projekt ligj per percaktimin e poligoneve per asgjesimin e tyre dhe e dergoi per miratim ne Kuvend. Ligji nr.10017, dt.13.11.2008 “Per percaktimin e poligoneve

per asgjesimin e municioneve të Forcave të Armatosura te Republikes se Shqiperise” percakton tetë zona demontimi dhe rregullat për administrimin e tyre, rajonet tokesore, hapësira detare dhe korridoret ajrore te kufizuara përkoheisht per qarkullim lundrim apo fluturim ne baze te nje njoftimi paraprak 30 ditor, realizimin e asgjesimit te municionit jo me afer se kater kilometra nga digat, rezervuaret, qendrat e banuara dhe nga instalimet e shpimit dhe shfrytezimit te naftes, kompensimin e dëmeve dhe njoftimin e popullsisë.

## **2. Për mbrojtjen nga zjarri dhe impiantet e gazit**

Nje rekomandim tjetër i Avokatit te Popullit lidhur me marrjen e masave per kontrollin e verifikimin e normave dhe kushteve teknike te percaktuara ne lejet dhe autorizimet përkatëse, te masave te sigurise, te atyre të mbrojtjes nga zjarri, dhenien e asistences teknike ne te gjitha impiantet, instalimet, depot, njesite tregëtare ushqimore ku tregtohen edhe bombula gazi, stacionet e tregtimit te gazit, naftes dhe nenprodukteve te tyre, largesite e tyre nga zonat e banuara ju eshte derguar prefekturave të 12 qarqeve, Inspektoriatit Qendror Teknik ne Ministrine e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes, Drejtorive te Policise se Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimit ne Ministrine e Brendshme dhe ne qarqe. Nepermjet tij, kerkohej nje zbatim i sakte i te gjitha normave ligjore per nje problem teper te rëndesishem dhe që kerkon vemendjen e duhur per faktin e shtrirjes se rrjetit te tregtimit te karburanteve ne te gjithë territorin e vendit, veçanësisht ne Tiranë, anashkalimi i te cilave mund te sjelle pasoja dhe cenime te renda te interesave te një rrethi shumë te madh individësh. Edhe ky rekomandim shoqërohej me nje listë te gjate, sipas qarqeve, te objekteve te ruajtjes apo tregtimit te naftes dhe gazit te lengshem, më problematike sipas te dhenave te marra nga te gjitha komunat dhe bashkise e Republikës. Per statistikë, përmëndim se vetëm për qarkun e Tiranës, jane mbi 50 stacione te tilla, pa permendur numrin e dyqaneve ne katet e para te pallateve te banuara ku tregtohen bombula gazi te madhesive te ndryshme, se bashku me ushqimet e produkte te tjera.

Ky kontroll i rekomanduar nga Avokati i Popullit, ishte dhe vazhdon te jetë deri ne perfundim te tij, nje ngarkesë tepër e madhe per organet e lartpermendura, veçanërisht per Inspektoriatin Qëndror Teknik, duke marre parasysh personelin e tyre dhe mjetet ndihmese te limituara që ju janë vene ne dispozicion, si dhe hapësirën e gjere te kesaj veprimtarie me burim rreziku të shtuar. Per keto arsye dhe per ndjenjën e larte te pergjegjesise ne punen e bere konkretisht dhe për bashkëpunimin midis tyre dhe me institucionin tonë, meritojnë nje pergezim te veçantë.

Gjate kontrollit te ushtruar ne Qarkun e Tiranës, Inspektoriati Qendror Teknik, brenda kompetencave te tij, ka konstatuar shkelje te natyrave te ndryshme ne shume njesi te tregtimit apo depozitimit te



karburanteve. Keshtu per pese subjekte te tilla eshte kerkuar ndjekja penale, jane lene akte ndalesa per dhjete subjekte te tjera, ne kater raste eshte konstuar mungesa te dokumentacionit, dy stacioneve te tregtimit te gazit ju eshte bllokuar aktiviteti. Jane konstatuar edhe mangesi te tilla qe Inspektoriati ka lejuar vazhdimin e veprimtarise me kusht per rregullimin e tyre brenda nje afati te caktuar. Sipas Akt Kontrollit te Inspektoriatit, ne qytetin e Tiranës te gjitha satacionet e tregtimit te karburanteve jane ndertuar para vitit 2005 dhe e kane filluar aktivitetin e tyre para daljes se Urdherit te Ministrit te Ekonomise, Tregtimit dhe Energjetikes, nr. 184, dt.05.07.2005, me te cilen operohet per zbatimin e normave dhe kushteve teknike te impianteve, instalimeve dhe pajisjeve që sherbejne per transportimin, depozitimin dhe tregtimin e naftes, gazit dhe nenprodukteve te tyre. Ne shume raste konstatohet se prane ketyre subjekteve jane bere ndertime pa leje pas fillimit te aktivitetit tregtar te tyre.

Ndersa ne Qarkun e Beratit, Inspektoriati Qendror Teknik pas ushtrimit te kontrollit ka bllokuar 13 dyqane qe mbushnin bombola me gaz te lengshem me transvazim, ka bere akt-ndalesa ne 37 impiante te mbushjes dhe tregtimit te gazit dhe depozita, ka hequr nje depozite gazi me kapacitet 5000 litra, ka mbyllur nje impiant furnizimi me gaz dhe ka lënë disa akt kontrolli per zbatim detyrash.

Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes, ne vartesine administrative te te ciles eshte Inspektoriati Qendror Teknik, ka mirëpritur rekomandimet tona per funksionimin sa me normal dhe brenda standarteve te kerkuara te sigurise ne tregun me shumice dhe pakice te nenprodukteve te gazit dhe te naftes. Pas kontrolleve te ushtruara ne qarqe të ndryshme, ka vepruar menjëherë me marrjen e masave perkatese per nje tregtim sa me normal dhe brenda kushteve teknike dhe ne mbrojtje te jetes se njerezve. Gjithashtu nga strukturat e Ministrisë, eshte përgatitur projekt-vendimi “Per marrjen e masave emergjente per permiresimin e situates se sigurise si dhe te veprimtarive ne instalimet dhe impiantet qe sherbejnë per depozitimin, transportimin dhe tregtimin e naftes, gazit dhe nenprodukteve te tyre”, i cili eshte derguar per marrje mendimi në disa ministri.

### **3. Për sigurinë e digave të hidrocentraleve dhe dambave të ujit**

Një rekomandim tjetër i Avokatit të Popullit, eshte ai për marrjen e masave te menjehershme organizative për kontrollin e verifikimin e kushteve teknike dhe të sigurisë të digave të rezervuareve të ujit, të hidrocentraleve dhe të dambave, drejtuar Komitetit Kombëtar të Digave të Larta pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtise dhe Energjetikës dhe Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. Objekte të tilla janë digat e ndryshme si dhe dambat, objekte ndërtimore

nivelngritëse, ujëmbledhëse dhe depozitformuese të materialeve të ngurta, të shpërndara në të gjithë vendin, dhe që për specifikën e tyre paraqesin rrezik për komunitetin dhe mjedisin, në rast dëmtimesh.

Për identifikimin e të gjitha këtyre objekteve, që vleresohen si ndertime me burim rreziku të shtuar, kemi kerkuar nga te gjitha njesite e qeverisjes vendore, bashki dhe komuna, informacion per ekzistencen ose jo të tyre, në territoret qe ato administrojne dhe te problemeve te sigurisë dhe plotësimit te standarteve teknike, që në rrethana të caktuara, në rast prishje eventuale të tyre, mund të kthehen në burim fatkeqësish, me pasoja katastrofike për jeten e njerezve dhe te ekonomise.

Në informacionin e hollësishëm, të dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit të Burimeve dhe Ofrimit të Shërbimeve në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, jepen të dhëna mbi gjëndjen e 626 digave të sistemit të ujitjes dhe kullimit të kësaj ministrie. 351 diga administrohen nga Drejtoritë Ekzekutive të 16 Bordeve të Kullimit në shkallë vëndi, 262 diga administrohen nga Shoqatat e Përdoruesve të Ujit dhe 13 të tjera nga Federata e Shoqatave të Përdoruesve të Ujit, me një kapacitet të projektuar prej rreth 558 milion m<sup>3</sup> ujë, për ujitjen e 184.000 ha tokë bujqësore. Pavarësisht nga përpjekjet e bëra për të ruajtur sigurinë e digave, veprimi i shume faktoreve objektive dhe subjektive ka ndikuar në shumë raste negativisht në sigurinë e tyre në përgjithësi. Nisur nga analiza me e fundit e gjëndjes së digave të bujqësisë, thuhet në informacion, rezulton se ato janë në gjendje teknike të vështirë dhe nevoja e ndërhyrjes në to, duke i paraprirë me studime e projektme dhe mandej me financime, është e karakterit emergjent. Megjithëse deri më sot, në asnjë nga digat nuk ka patur prishje totale me pasoja të dëmshme, dëmtimet e shfaqura në nënobjektet e digave, mund të jenë nxitja e parë e thellimit të dëmtimit të metejshëm me pasoja të rrezikshme. Ky shqetësim behet me i madh po te mbajme parasysh se po plotesohet afati i shfrytëzimit të tyre, si dhe faktin qe ne anen e poshteme te tyre jane bere ndërtime të ndryshme. Si faktorë të gjëndjes të vështirë teknike të digave renditen : numuri i madh i tyre, ndërtimi në një periudhë kohe të shkurtër dhe vështirësia e mbulimit me specialiste te kualifikuar dhe me mjete; ne 15 vitet e fundit procesi i monitorimit teknik te tyre ka qene i dobet si pasoje e ndryshimeve organizative të drejtorive të ujrave, apo nga largimi i personelit inxhiniero-teknik; nga mungesa e fondeve financiare dhe problemet që ka krijuar vetë legjislacioni për ujitjen dhe kullimin; Federatat e Përdoruesve të Ujit nuk përmbushin detyrimet e tyre ligjore dhe për shkak të numrit të vogël të punonjësve të tyre. Për plotësimin e një pjese të konsiderueshme të këtyre mangësive, kërkohen vlera monetare në rreth 100 milionë dollarë. Për vitin buxhetor 2009 e në vazhdim, sipas informacionit të lartpërmendur, në kuadrin per pergatitjes e projekteve për vitet 2009-

2011, për digat janë parashikuar investime në shumën 200 milion lekë ose 2 milion dollarë.

Për sa i takon gjëndjes së digave të H/C, kemi marrë përgjigje nga Koorporata Elektroenergjetike Shqiptare, që i ka këto objekte në administrim. Pasi bën të ditur skemen për ruajtjen dhe kontrollin e tyre periodik, KESH evidenton si shqetësim të përhershëm ndertimet pa kriter të bëra poshtë digave, dhe se ndërtimet që janë gjithnjë të kërcënuara nga ujrat e hidrocentraleve. Për këtë kërkohet një përkushtim dhe bashkëpunim më i madh i organeve të pushtetit vendor, për dhënien e lejeve të ndërtimit dhe të dhenies zgjidhje problemeve të krijuara. Koorporata garanton se e ka gjëndjen e digave nën kontroll dhe brënda kushteve teknike të funksionimit të tyre.

Gjatë vitit 2008 ka patur në rrethe të ndryshme edhe aksidente të tjera si pasojë e veprimtarive dhe objekteve me burim rreziku të shtuar. Kështu në datën 29.09.2008, në qëndrën e mbushjes dhe tregtimit të gazit të lengshëm, në pronësi të subjektit “Cani” sh.p.k. në fshatin Lapardha, Komuna Otlak, Berat, si rezultat i shkeljes së rregullave të sigurimit, gjatë mbushjes së depozites së gazit me kapacitet 3000 litra nga një autoçisternë, gjetën vdekjen dy persona dhe u plagosën dy të tjerë. Në vëndngjarje, me nismën e vetë Avokatit të Popullit, shkoi një grup ekspertësh nga institucioni jonë për të bërë një hetim të pavarur. Nga marrja e shpjegimeve nga personat që kishin dijeni për ngjarjen, përfshi familjarë të viktimave, dëshmitarë të pranishëm në ngjarje dhe punonjës të administratës së Komunës Otlak, nga kqyrja e vëndngjarjes dhe e dokumentacionit të subjektit në organet shtetërore përkatëse, rezultoi se pronari (viktimë në ngjarje) ishte i paformuar profesionalisht, kishte mungesë dokumentacioni të subjektit, si vërtetimi për respektimin e kushteve teknike dhe projekti teknologjik të miratuara nga IQT, mungonin aksesorët e sigurisë, të matjes dhe të mbajtjes së depozitës së gazit të pakolauduar. Konkluzionet tona u konfirmuan edhe nga përgjigja e Inspektoriatit Qëndror Teknik, datë 29.10.2008, dhe nga verifikimet e bëra në vënd në bazë të kërkeses tonë. Ky aktivitet biznesi përfundimisht u mbyll.

#### **4. Për rreziqet e apartamenteve të banimit**

Në bazë të ankesës të disa familjeve, për gjëndjen e rëndë teknike të pallatit ku banonin, me nr.1149, në lagjen “28 Nëntori”, në Vlorë, u bë verifikimi i tij. Nga shqyrtimi i çështjes rezultoi se pallati pesë katesh, në murin e tij të jashtëm, në pjesën perëndimore, kishte një çarje në të gjithë lartësinë e tij. Sipas Akt-Kontrollit të Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Shërbimeve Publike në Bashki, të datë 17.06.2004 rezultonte se dëmtimet në disa apartamente në katet e sipërme të ndërtesës kishin ardhur nga ndërtimi pranë saj (rreth një metër larg) të një godine trekateshe, nga një firmë tjetër ndërtimi. Lidhur për sa u konstatua, u kërkua nga Bashkia

Vlorë, një informacion për rrugë zgjidhjet që mendohej t'i jepej problemit. Në përgjigjen e tij, Kryetari i Bashkisë, zoti Shpëtim Gjika, pranon se gjëndja teknike e ndërtesës është e rëndë dhe se Këshilli Bashkiak ka vendosur që në dispozicion të banorëve të vihet një sipërfaqe trualli për një ndërtim të ri, pasi të sigurohen mjetet financiare.

Aksidente të ngjashme, sidomos gjatë mbushjes së bombulave të gazit dhe përdorimit të tyre në ambiente banimi ose publike, kanë ndodhur disa. Për fat të mirë kanë përfunduar vetëm me lëndime të lehta të disa personave. Për arsye objektive, kryesisht për shkak të organikës dhe të mjeteve financiare që ka Avokati i Popullit, rastet e hetimeve dhe shqyrtimeve në vend të tyre janë të kufizuara.

Duhet pranuar se në disa raste, tepër të rralla, kemi patur reagime, nga organe të pushtetit vendor apo institucione qendrore lidhur me kërkesat apo rekomandimet tona për verifikimin dhe marrjen e masave parandaluese në këto lloj veprimtarish, duke i konceptuar si mangësi të punës së tyre. I kemi vlerësuar dhe i vlerësojmë si keqkuptime që kishin dhe kanë të bëjnë me konceptimin e terminologjisë “objekte dhe veprimtari me burim rreziku të shtuar”. Ky përcaktim, që e gjen trajtimin e vet ligjor në nenin 622 të Kodit Civil si “Përgjegjesi nga ushtrimi i një veprimtarie të rrezikshme” nënkupton përgjegjesinë e një personi, fizik apo juridik, privat apo shtetëror, që kryen një veprimtari të rrezikshme nga vetë natyra e saj ose nga natyra e sendeve të përdorura, dhe që u shkakton dëm personave të tjerë. Personi detyrohet të shpërblejë dëmin, përveç kur provon se ka përdorur të gjitha masat e përshtatshme e të nevojshme, për mënjanimin e dëmit. Kjo normë ligjore konsiderohet si “përgjegjësi pa faj”, që rrjedh nga demet e shkaktuara nga vete natyra, teknologjite e avancuara dhe cilesitë e rrezikshme e sendeve, objekteve apo veprimtarise që kryhet nga njerezit, dhe jo nga kryerja me dashje e nje demtimi konkret. Të tilla janë të gjitha llojet e transportit të pasagjereve, të tregtimit të sendeve të rrezikshme për jetën e njeriut apo të ndezëshme, të impianteve dhe të transportimit të energjise elektrike, të rritjes dhe mbarështimit të kafsheve, të parqeve zoologjike, digat e rezervuareve, e shumë të tjera, që në momente të caktuara dhe, për shkaqe nga më të ndryshmet (difekte teknike, situata të vështira natyrore si tërmete, stuhi, shkarkime elektrike, gabime njerëzore pa dashje, tërbimi ose veprime agresive të bagëtive dhe gjedhit, mos rruajtja mirë e një egërsire, goditjet elektrike në sistemin e shpërndarjes, etj).

Në vijim të nismës për verifikimin e objekteve dhe veprimtarive me burim rreziku të shtuar, Avokati i Popullit do të vazhdojë ta ndjekë problemin në vazhdimësi, për rëndësinë që ka garantimi i parametrave të sigurisë në ruajtje të jetës, shëndetit dhe pronës, kryesisht nëpërmjet mjeteve të tij të vëna në dispozicion nga vetë Kushtetuta dhe ligji, në bashkëpunim të ngushtë edhe me mediat. Kjo do të bëhet për

ndërgjegjësimin e njerëzve për të qënë më kërkues dhe vigjilent në parandalimin në të ardhmen të ngjarjeve të tilla të rënda. Sidomos administrata publike, duhet të punojë kundër çdo neglizhence burokratike, për tregues ekzigjentë në zbatimin rigoroz të ligjit nga çdo subjekt, si dhe të mbështesë organet përkatëse, me mjete dhe fonde të nevojshme.

## KREU I KATERT

### 1. E drejta e Avokatit të Popullit për rekomandime legjislative

Në nenin 24 të Ligjit “Për Avokatin e Popullit” parashikohet e drejta e Avokatit të Popullit për rekomandime legjislative. Në këtë dispozitë përcaktohet se: “Kur Avokati i Popullit vëren se është vetë përmbajtja e ligjit ose e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre shkakua që krijon premisa për shkelje të të drejtave të njeriut, të njohura nga Kushtetuta ose ligjet e tjera, ka të drejtë:

a. t’u rekomandojë organeve që kanë të drejtën ligjvënëse të bëjnë propozime për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve;

b. t’u propozojë organeve të administratës ndryshimin ose përmirësimin e akteve nënligjore; mosshqyrtimi i propozimit brenda 30 ditëve sjell si pasojë pezullimin e fuqisë së akteve nënligjore që shkaktojnë shkelje të të drejtave dhe lirive.

c. të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me kërkesën për shfuqizimin e akteve të tilla”.

Qysh nga fillimi i veprimtarisë në qershor të vitit 2000 deri në fund të vitit 2008, institucioni ynë e ka përdorur shpesh herë këtë të drejtë, kur ka konstatuar gjatë shqyrtimit të ankesave, kërkesave apo njoftimeve se janë kushtet e mësipërme për të bërë rekomandime për përmirësimin e legjislacionit. Është e qartë se nga ndryshimi i një ligji apo akti nënligjor me karakter normativ (jo individual, për një person të caktuar) rregullisht përfiton jo vetëm personi i caktuar që ankohet, por përfitojnë të gjithë personat që kanë të bëjnë me marrëdhëniet që rregullon ligji apo akti nënligjor i nxjerrë, ndryshuar apo përmirësuar me rekomandim të Avokatit të Popullit. Që këtë del rëndësia e madhe e përdorimit të këtij mjeti pune nga Avokati i Popullit.

Siç del nga Pasqyra nr.1, gjatë periudhës 2000-2008 janë bërë 57 rekomandime drejtuar organeve që kanë të drejtën ligjvënëse (deputetëve të Kuvendit, Kryeministrit dhe anëtarëve të Qeverisë) që të bëjnë ata propozime për ndryshime apo përmirësime të ligjeve. Për vitin 2008 janë bërë 11 të tilla. Nga 57 rekomandime janë pranuar 45 që kanë rezultuar me 29 ndryshime apo përmirësime të ligjeve; 16 janë në fazën e projektit për miratim në Kuvend apo ne Qeveri; 8 janë refuzuar dhe 4 janë pa përgjigje zyrtare.

Në Pasqyrën nr.2 janë pasqyruar rekomandimet për ndryshime apo plotësime të akteve nënligjore normative që ka në kompetencë të nxjerrë Këshilli i Ministrave (Qeveria) për periudhën 2000-2008. Nga 39 rekomandime (3 janë bërë në vitin 2008) janë pranuar 37, që kanë rezultuar 28 me ndryshime, përmirësime apo nxjerrje të akteve nënligjore nga Qeveria; 9 janë në fazën e projektit; 1 është refuzuar dhe 1 është pa përgjigje zyrtare.

Kurse në Pasqyrën nr.3 janë pasqyruar rekomandimet për ndryshime apo plotësime të akteve nënligjore normative në kompetencë të ministrave dhe drejtuesve të institucioneve të tjera qendrore. Nga 44 rekomandime (4 janë bërë në vitin 2008) janë pranuar 40, nga të cilët për 31 janë bërë ndryshimet apo përmirësimet; 9 janë në fazën e projektit; 2 janë refuzuar, kurse 2 janë pa përgjigje.

Në përfundim, nga 140 rekomandime, propozime apo kërkesa me karakter legjislativ janë pranuar deri tani gjithsej 122 prej tyre, ose rreth 87%. Mund të themi se rezultatet janë të kënaqshme, sepse nga 122 të pranuar, për 88 prej këtyre rekomandimeve janë bërë ndryshimet apo përmirësimet e ligjeve apo akteve nënligjore. Kurse 34 rekomandimet e tjera janë në proces realizimi. Për lehtësi studimi gjithë rekomandimet e bëra dhe ndryshimet e realizuara gjatë vitit 2008 janë shënuar me gërma të zeza.

**Evidenca e rekomandimeve per plotësime apo ndryshime te ligjeve te Kuvendit te Shqipërisë  
Per periudhen 2000-2008**

<b>Nr</b>	<b>Ankuesi</b>	<b>Permbajtja e rekomandimit</b>	<b>Kujt i drejtohet</b>	<b>Data e dergimit</b>	<b>Përfundimi</b>
<b>1</b>	Ankesa e 70 ish ushtarakëve të larguar nga detyra.	Rekomandim: “Për një ndryshim në Ligjin Nr. 8087 datë 13.03.1996 <i>“Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve në F.A. të Republikës së Shqipërisë e konkretisht nenit 19/1 për ndryshimin e termit “braktisje në detyrë”</i> ”.	Komisionit Parlamentar të Mbrojtjes në Kuvend, i cili mori iniciativën legjislative.	16.03.2001	Rekomandimi është pranuar. Doli Ligji Nr. 8948 datë 03.10.2002, i cili bëri ndryshimet në nenin 19/1, sipas rekomandimit të Avokatit të Popullit.
<b>2</b>	Ankesa e shtetasit K.D.	Rekomandim: “Për iniciimin e nxjerrjes së një ligji për rregullimin e simboleve fetare në shkollat publike”	Kryeministrit. Ministrit të Arsimit dhe Shkencës	26.04.2001	Ministri i Arsimit ka pranuar që të nxjerrë një udhëzim për të rregulluar këtë problem, por deri tani nuk është nxjerrë.
<b>3</b>	Federata e Sindikatave të Punonjësve të Transportit	Rekomandim: “Ndryshimi i Ligjit Nr.8435 datë 28.12.1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, në lidhje me taksën për rregjistrimin vjetor të automjeteve dhe taksën për aks	Ministresë së Transporteve, Ministresë së Financave, Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rrugor.	20.07.2001	Rekomandimi është pranuar. Doli Ligji Nr. 8840 datë 11.11.2001 që rriti përqindjen e D.P.T. Rrugor si agjent tatimor në 20 përqind, duke ndryshuar nenin 4 të ligjit.
<b>4</b>	Ankesa të ish pronarëve	Rekomandim: “Propozohen ndryshime në Ligjin nr. 7665 datë 21.01.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”,	Komisionit të Ligjeve, ekonomisë e financave në Kuvend. Ministrit	12.10.2001	Rekomandimi është pranuar. Shfuqizuar me nenin 30 të Ligjit Nr. 9235 datë



		për shfuqizimin e neneve 7/ç dhe 13 të tij.	të Turizmit e Rregullimit Territorit		29.07.2004 “Për kthimin e kompesimin e pronës”.
5	Ankesa të shtetasve	Rekomandim: Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin Nr. 8097 datë 21.03.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”.	Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale. Komisionit parlamentar të çështjeve kushtetuese dhe ligjeve.	14.12.2001 Përsëritur në datën 06.03.2003	Rekomandimi është pranuar në parim, por nuk është miratuar në ndryshimet që i janë bërë ligjit.
6	Ankesa të shtetasit J.L.	Rekomandim: “ Për ndryshimin e nenit 6, pika 2 të Ligjit Nr. 8360 datë 10.06.1998 “Për kriteret dhe mënyrat e shpërndarjes të pasurive të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjërë”.	Zëvendëskryeministrit dhe Ministrit të Punëve e Çështjeve Sociale. Komisionit Parlamentar për Punën dhe Çështjet Sociale	14.12.2001	Pa përgjigje.
7	Ankesa të shtetasve	Rekomandim: “ Dërgohen propozime për marrjen e nismës ligjvënëse lidhur me përmirësime e ndryshime të akteve ligjore e nënligjore për përfundimin e procesit të rivlerësimit e rishpërndarjes së pasurisë së ish kooperativave bujqësore si dhe, ndryshime në Ligjin Nr. 8435 datë 28.12.1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”	Ministrit të Bujqësisë. Ministrit të Financave. Kryeministrit.	26.12.2001	Pa përgjigje.
8	Ankesa nga	Rekomandim: “Për rregullimin ligjor të punës	Ministrit të	2001	Rekomandimi është pranuar dhe rregulluar me nenin 31 të Ligjit “Për statusin e ushta-

	ushtarakët	jashtë orarit dhe shërbimit 24 orësh”.	Mbrojtjes		rakut” dhe mbi këtë bazë dhe me rregullore të Ministrisë së Mbrojtjes.
9	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “Për përgatitjen e Ligjit “Për zhdëmtimin e personave të dëmtuar”, në zbatim të nenit 44 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.	Kryeministrit dhe Ministrit të Drejtësisë	24.12.2001	Rekomandimi është pranuar pjesërisht. Doli Ligji Nr. 9381 datë 28.04.2005 “Për kompesimin e burgimit të padrejtë”.
10	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “ Për zbatimin e nenit 10 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për lidhjen e marrëveshjeve me bashkësitë fetare dhe miratimin e tyre në Kuvendin e Shqipërisë”.	Dërguar të gjithë Kryeministrave.	16.01.2002 Përsëritur në 09.12.2005	Rekomandimi është pranuar. Është lidhur marrëveshja me Komunitetin Katolik nëpërmjet Ligjit Nr. 8902 datë 23.05.2002. <b><i>Ne daten 24.10.2008 u nënshkruan edhe marrëveshjet me Komunitetin Mysliman, Orthodhoks dhe ate Bektashian.</i></b>
11	Ankesa nga Shoqata e të Verbërve	Rekomandim: “Për domosdoshmërinë e ndryshimit të Ligjit Nr. 8098 datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbrit”.	Zv/Kryeministrit dhe Ministrit të Punëve e Çështjeve Sociale	02.04.2002	Rekomandimi është pranuar në parim. Eshte miratuar strategjia kombëtare për personat me aftësi të kufizuara, me ane te VKM nr. 8 dt.7.01.2005 “Strategjia Kombetare per personat me aftesi te kufizuar”. Ne vazhdim ka dale VKM nr.1325 date 1.10.2008 “per

					nje ndryshim ne VKM nr.277 date 18.06.1997 “Per perfitimet nga statusi i te verberit”, i ndryshuar”.
<b>12</b>	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “Për bërjen e disa ndryshimeve në Ligjin Nr. 8388 datë 05.08.1998 “Për grumbullimin e armëve dhe municioneve luftarake”	Kryeministrit. Kryetarit të Kuvendit.	16.04.2002	Rekomandimi është pranuar pjesërisht. Kuvendi zgjati afatin e veprimit të Ligjit, duke miratuar Ligjin Nr. 9018 datë 06.03.2003 “Për mbledhjen e armëve, të municioneve dhe materialeve të tjera luftarake”
<b>13</b>	Banorë të komuniteteve në Tiranë, Durrës dhe Librazhd	Rekomandim: “Për përgatitjen sa më shpejt të projekteve për plotësimin e legjislacionit për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe të ambientit nga rrezatimet jo jonizuese të telefonisë celulare”.	Ministrit të Mjedisit. Ministrit të Shëndetësisë. Ministrit të Drejtësisë.	13.05.2002 Përsëritur në dt. 27.10.2004	Është kthyer përgjigje nga Ministritë. Po përgatitet nje draft i ri nga Instituti i Fizikes Berthamore, por akoma nuk eshte paraqitur në Qeveri.
<b>14</b>	Ankesa e shtetasit B.I.	Rekomandim: “Për një plotësim në Ligjin Nr. 7710 datë 18.05.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore”, lidhur me parashikimin e procedurës së ankimit administrativ kundër vendimeve të seksioneve përkatëse të Bashkive apo Komunave”.	Zv/ Kryeministrit dhe Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	09.05.2002	Rekomandim është pranuar dhe zgjidhur me nenin 25 të Ligjit Nr. 9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe përkujdesin shoqëror”.
<b>15</b>	Ankesa e shtetasit Th.K	Rekomandim: “Për ndryshimin e e ligjit Nr. 7889 datë 14.02.1994 “ <i>Për statusin e invalidit</i> ” për përfitimin e një shtese mujore mbi pensionin e invaliditetit, për të gjithë të	Zv.Kryeministrit Ministrit të	12.06.2002	Rekomandimi është pranuar dhe problemi është zgjidhur me nenin 17 të Ligjit Nr. 9418 datë 20.05.2005 “Për

		aksidentuarit gjatë kryerjes së shërbimit ushtarak”.	Mbrojtjes		sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.
16	Konferenca Kombëtare Dhjetor 2001	Rekomandim: “ Mbi masat që duhen marrë për zbatimin e Rekomandimeve të Konferencës Kombëtare “ <i>Shteti dhe shoqëria civile në mbrojtje të të drejtës së jetës</i> ”, që të krijohet një organizëm shtetëror për të kontrolluar gjakmarrjen etj.	Kryeministrit, disa ministrave	10.09.2002	Rekomandimi u pranua. Doli Ligji Nr. 9389 datë 04.05.2005 “Për Këshillin Koordinativ për luftën kundër gjakmarrjes”
17	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “Për marrjen e masave për të realizuar ndryshimin e Ligjit Nr. 5840 datë 20.02.1979 “ <i>Për rregjistrimin e akteve të gjëndjes civile</i> ”, me qëllim çrregjistrimin e personave të vdekur nga listat e zgjedhësve”.	Kryeministrit. Kryetarit të Kuvendit	11.09.2002	Rekomandimi u pranua. Neni 57/7 i Ligjit nr.8950 datë 10.10.2002 i lejon zyrat e gjendjes civile të zgjidhin problemin duke ju drejtuar vetë gjykatës.
18	Ankesa të ish pronarëve	Rekomandim: “Të përshpejtohet procesi legjislativ në bazë të nenit 181 të Kushtetutës për miratimin e akteve nënligjore që rregullojnë problemet e pronësisë, mosdhënien e titullit “ <i>person i stimuluar në fushën e turizmit</i> ”, ndalimin e tjetërsimit të pronës shtetërore të rregjistruar dhe bllokimin e privatizimit apo të dhënies me qera të objekteve shtetërore dhe trojeve të tyre”	Kryetarit të Kuvendit. Komisioneve Parlamentare dhe Qeverisë.	19.09.2002	Rekomandimi është pranuar. Doli Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë Nr. 9 datë 03.10.2002, e cila i kërkoi Qeverisë dhe organeve të qeverisjes vendore që deri në hartimin e projektligjit të ri “Për kthimin e Kompesimin e pronave” të ndërpritet tjetërsimi dhe dhënia me qera e pronave shtetërore.
		Rekomandim: “Për masat që duhen marrë në			Rekomandimi u pranua.

19	Ankesat e ish pronarëve	zbatim të neneve 41/1 dhe 181/2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë”, me qëllim rregullimin e drejtë dhe përfundimtar të çështjes së pronave.	Kryeministrit. Kryetarit të Kuvendit.	19.09.2002	Dolën ligjet Nr. datë 29.07.2004, Nr. 9388 datë 04.05.2006 “Për kthimin dhe kompesimin e pronës”.
20	Ankesat e ish pronarëve	Rekomandohet të merret në konsideratë Vendimi nr.26 datë 24.04.2001 i Gjykatës Kushtetuese në projektligjin “Për kthimin dhe kompensimin e ish pronarëve”	Kryetarit të Kuvendit. Komisioneve parlamentare në Kuvend	28.10.2002	Rekomandimi u pranua. Neni 8/2 i ligjit nr.9235 datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës ish pronarëve”
21	Me iniciativën e Avokatit të Popullit.	Rekomandim: Për plotësimin e Ligjit Nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”.	Komisionit të Ligjeve dhe të Drejtave të Njeriut në Kuvend, i cili mori iniciativën legjislative.	25.11.2002	Rekomandimi është pranuar. Doli Ligji Nr. 9071 datë 22.05.2003 Për një ndryshim në Ligjin Nr. 8328 datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajnimin e të dënuarve me burgim”
22	Njoftimi i zotit Pjetër Arbërori	Rekomandim: “Për përmirësimin e nenit 4 të Ligjit Nr. 8292 datë 25.02.1998 “Për Forcat Speciale dhe ato të Ndërhyrjes së Shpejtë”, sepse nuk lejohet hetimi i policëve që bëjnë pjesë në këto forca, kur akuzohen për vepra penale.	Komisionit të Ligjeve dhe të Drejtave të Njeriut në Kuvend, i cili mori iniciativën legjislative dhe e paraqiti në Kuvend.	26.11.2002 Përsëritur në 2006	Nuk u miratua projektligji në seancë parlamentare. Eshtë ribërë propozimi, drejtuar Komisionit të Ligjeve dhe Sigurisë Kombëtare si dhe në projektligjin “Për Policinë e Shtetit”. Me ligjin nr.9748 date 4.06.2007 “Per Policine e Shtetit”, neni 4 eshte lene ne fuqi.
		Rekomandim: “Për plotësimin e Ligjit Nr. 8609 datë 08.05.2000 “Kodi Zgjedhor i Repu-	Komisionit Bipar-	13.02.2003	Kerkesa ju drejtua Gjykares Kushtetuese me

23	Me iniciativën e Avokatit të Popullit.	<i>blikës të Shqipërisë</i> ” për t’u mundësuar gjithë të dënuarve që të votojnë në zgjedhjet për pushtetin vendor.	tizan në Kuvend.	Përsëritur në datën 20.10.2006	dt.23.02.2007, e cila me vendimin e saj nr.40 dt.16.11.2007 e rrezoi kete kerkese.
24	Ankesa e shtetasit S.H.	Rekomandim: “Për zbatimin dhe përmirësimin e legjislacionit në fushën e sigurimeve shoqërore”, ku është propozuar “Ndryshimi i nenit 59 të Ligjit Nr. 7703 datë 11.03.1993 <i>“Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”</i> ”.	Kryeministrit. Ministrit të Punës e Çështjeve Sociale. Komisionit Parlamentar të Punës e Çështjeve Sociale.	23.09.2003.	Rekomandimi është pranuar. Doli Ligji Nr. 977 datë 21.04.2005 “Për disa ndryshime e shtesa në Ligjin nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar, neni 18.
25	Ankesa nga shtetas dhe shoqata	Rekomandim: “ Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr. 8087 datë 13.03.1996 <i>“Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, Ministrisë së Rendit Publik dhe Shërbimit Informativ Shtetëror”</i> ”.	Kryeministrit	19.11.2003	Rekomandimi është pranuar. Zgjidhur me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 9418 datë 20.05.2005 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të F.A. të Republikës të Shqipërisë”. Neni 14 pika 6 e tij.
26	Një numer i madh të dënuarish që vuajnë dënime në burgje.	Rekomandim: “ Propozohet ndryshimi në Ligjin nr. 7941 datë 31.01.1995 për hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 7895 datë 27.01.1995 <i>“Për Kodin Penal në Republikën e Shqipërisë”</i> ”.	Komisionit të Drejtave të Njeriut në Kuvend. Një grup deputesh morën iniciativë legjislative.	20.11.2003 Përsëritur në datën 08.03.2006	Ne seancen plenare te dates 14.06.2007, Parlamenti ka diskutuar ndryshimet e rekomanduara, te cilat nuk u miratuan.

27	Ankesa e ish gjeneralit Y. D.	Rekomandim: “Bërja e një statusi të veçantë për ushtarakët madhorë duke u nisur nga rasti i ish gjeneralit Y.D”.	Ministrit të Mbrojtjes	24.03.2004	U mor parasysh në ndryshimet e Ligjit Nr. 9171, datë 22.01.2004 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në FA të R. Shqipërisë dhe konkretisht Pika 2 e nenit 22 ku thuhet: “Statusi i gjeneralëve pas daljes së tyre në rezervë/lirim rregullohet me VKM. Doli VKM Nr. 542 datë 12.08.2004 “Për statusin e ushtarakut me gradë madhore në FA pas daljes në lirim”.
28	Me iniciative te Avokatit te Popullit	Rekomandohet plotesimi i legjislacionit qe mungon dhe kontrolli i atij ekzistues, ne lidhje me ndotjet elektromagnetike qe rrezikojne shendetin e njerezve.	Ministrit te Mjedisit Ministrit te Shendetesise <b>Ministrit te Punes dhe Çeshtjeve Sociale, etj.</b>	28.10.2004	<b>Rekomandimi u pranua. Eshte miratuar dhe ka hyre ne fuqi Ligji nr.9973 date 28.07.2008 “Per disa ndryshime te Ligjit nr.8025 date 9.11.1995 “Per mbrojtjen nga rrezatimet”.</b>
29	Ankesa të	Rekomandim: “Për plotësimin e nenit 28 të	Ministrisë së	03.11.2004 <b>Perseritur ne</b>	Rekomandimi u pranua si i drejtë. <b>Pas perseritjes se tij ne daten 17.06.2008, Ministria e</b>

	ndryshme	Ligjit “Për Statusin e Ushtarakut”.	Mbrojtjes	<i>date</i> 17.06.2008	<i>Mbrojtjes ka konfirmuar se çeshtjet perkatese do te zgjidhen rast pas rasti me VKM.</i>
30	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “ Propozime për përmirësimin e Kodit Zgjedhor”, me qëllim që numurimi i votave në çdo zonë elektorale të bëhet nga tre gjyqtarë.	Bashkëkryetarëve të Komisionit Parlamentar për Reformën Zgjedhore	22.11.2004	Rekomandimi nuk është pranuar.
31	Ankesa e shtetasit D.M.	Rekomandim: “Për plotësimin e nenit 40 të Ligjit Nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, me qëllim përfundimin e pensionit familjar pas vdekjes së bashkëshortit, nga bashkëshortja ose bashkëshorti student nën moshën 25 vjeç	Komisionit të Ligjeve në Kuvend. Institutit të Sigurimeve Shoqërore.	28.01.2005 16.03.2005	Rekomandimi nuk është pranuar.
32	Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë	Rekomandim: “Propozim për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9209 datë 22.03.2004 “Për legalizimin e shtesave në ndërtim” për të thjeshtuar procedurat e legalizimeve dhe për të ulur masën e gjobave.	Kryeministrit. Komisionit parlamentar të Ligjeve, e Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregëtisë e Mjedisit.	16.03.2005 Përsëritur më datën 16.09.2005	Rekomandimi është pranuar. Doli Ligji Nr.9482 datë 16.02.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa lejë”, ku është përfshirë edhe rekomandimi i Avokatit të Popullit.
33	Me iniciativën e Avokatit të	Rekomandim: “Për disa shtesa e ndryshime të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999, plotësuar më	Kryetarit të Kuvendit. Mori inisia-		Rekomandimi është pranuar. Doli Ligji Nr. 9398 datë



	Popullit	ligjin nr. 8600 datë 10.04.2000 <i>“Për Avokatin e Popullit”</i> .	tivë një grup deputetësh	01.04.2005	12.05.2005.
34	Shoqata Uniteti Kombëtar	Rekomandim: “Për zhbllokimin e situatës së krijuar nga mosfutja në përdorim e letrave me vlerë dhe bonove të privatizimit”	Kryeministrit. Ministrit të Financave. Ministrit të Ekonomisë dhe Energjitikës.	12.10.2005	Rekomandimi u pranua. Doli ligji Nr.9516 datë 18.04.2006
35	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “Propozim për një ndryshim në Ligjin Nr.8436 datë 28.12.1998 <i>“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”</i> , për të caktuar afate për qëndrimin në detyrë të kryetarëve dhe zëvendëskryetarëve të gjykatave.	Kryetares së Kuvendit. Kryetari të Komisionit për çështjet ligjore Kryeministrit	08.11.2005	<b>Rekomandimi është pranuar. Eshte perfshire në ligjin “Për disa ndryshime në ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, i cili është miratur më datën 18.02.2008.</b>
36	Grup Shoqatash	Rekomandim: “Për ndërmarrjen e iniciativës ligjore për parashikimin ligjor të termit <i>“Taksë e drejtpërdrejtë”</i> në Ligjin nr. 8977 datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë” si dhe në Ligjin nr. 8982 datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave vendor”, për cilësimin ligjor të llojeve të <i>“taksave vendore të drejtpërdrejta”</i> për efekt të përjashtimit të veteranëve të luftës, invalidëve dhe të të verbërve”.	Ministrit të Financave, Ministrit të Brendshëm, Komisionit të Financës dhe Buxhetit në Kuvend.	23.11.2005	Rekomandimi u pranua në parim, por nuk është përfshirë deri tani në ligjet e miratuara.
37	Me iniciativën e Avokatit të	Rekomandim: “Për ndryshimin dhe përmirësimin e përmbajtjes së nenit 86 të	Ministrit të Drejtësisë.	16.12.2005	Rekomandimi u pranua. Me Ligjin nr.9686 dt.26.02.2007 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.7895

	Popullit	<i>Kodit Penal, për veprën penale të “torturës”.</i>			dt.27.1.1995 “Kodi Penal”, i ndryshuar, u be ndryshimi i nenit 86 te Kodit Penal, sipas rekomandimit tone.
38	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “ Për marrjen e iniciativës për rregullimin ligjor të ndërtimeve të objekteve fetare”.	Kryeministrit Ministrit të Punëve Publike etj.	28.12.2005	Rekomandimi u pranua në parim. <i>Megjithate në draft projektligjin për urbanistikën që është ne proces diskutimi ne Qeveri, nuk është parashikuar konkretisht ky rregullim deri tani.</i>
39	Ankesa nga Shoqata joqeveritare	Rekomandim: “Për ndryshimin dhe përmirësimin e Ligjit Nr. 8950 datë 10.10.2002 “Për Gjendjen Civile” ndryshuar më Ligjin Nr. 9029 datë 13.03.2003 dhe Ligjin nr. 9229 datë 29.04.2004” për regjistrimin e fëmijëve të paregjistruar.	Ministrit të Brendshëm. Kryeministrit.	12.07.2006	<i>Rekomandimi u pranua. Me Ligjin nr.9929 dt.28.06.2008 “Per disa ndryshime ne ligjin nr.8950 dt.10.10.2002 “Per gjendjen civile”, i ndryshuar, jane bere ndryshimet e kerkuara.</i>
40	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: Për projektligjin “Për pagat, Shpërblimet dhe Strukturat e Institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”.	Kryetarit të Komisionit të Çështjeve Ligjore. Grupeve Parlamentare	13.07.2006	Nuk u pranua nga Qeveria dhe Kuvendi. Pas ankimimit ne Gjykatën Kushtetuese, me vendimin e saj nr.19 date 3.05.2007 është vendosur shfuqizimi i disa neneve të Ligjit nr.9584 date 17.07.2006 “Për pagat, Shpërblimet dhe Strukturat e Institucioneve të pavarura

					kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj” sipas kërkesës tonë.
41	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: Për plotësimin e Ligjit Nr. 9087 datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, për të rregulluar tre çështje: votimi i të burgosurve në zgjedhjet lokale, ndalimi i pjesëmarrjes së fëmijëve në fushatat elektorale dhe zgjedhja e zëvendës kryetarit të komunës apo bashkisë direkt nga populli, njëjloj si kryetarët.	Bashkëkryetarëve të Komisionit Parlamentar për Reformën Zgjedhore. Kryetarit të Komisionit të Çështjeve Ligjore.	20.10.2006	Për të burgosurit shih pikën 23 të kësaj pasqyre. Për dy propozimet e tjera nuk ka përgjigje zyrtare.
42	Koalicioni për barazi gjinore	Rekomandim: “ Për parashikimin në Kodin Zgjedhor të kuotave jo më pak se 30% për pjesëmarrjen e grave në politikë”.	Bashkëkryetarëve të Komisionit për Reformën Zgjedhore.	25.10.2006 Perseritur ne 4.07.2008	<b>Rekomandimi është pranuar. Është përfshirë në nenin 15 të Ligjit nr.9970 date 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”.</b>
43	Ankesa e shtetasit O.Xh.	Rekomandim për plotësimin në Ligjin nr.9588 date 25.07.2006 “Per rilloaritjen e pensioneve”, i cili do të mundësojë trajtimin e kategorise së pensionistëve të periudhes Tetor-Dhjetor 1993, që është përjashtuar për trajtim nga ky ligj	Ministrit të Financave. Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale e Shansëve të Barabarta	8.01.2007	Rekomandimi u pranua në parim nga Ministria e Financave. Por pas një ekspertize konkrete për rilloaritjen e mundshme për efekt të ndryshimit të ligjit, ka rezultuar se nuk do të kishte ndonjë efekt në rritjen e pensionit për pensionistet që mund të përfitonin nga rekomandimi.

44	Me iniciative te Avokatit te Popullit	Rekomandim për ndermarrjen e iniciatives per shfuqizimin e dispozitave te Kodit Penal Ushtarak qe permbajne denimin me vdekje në kohë ne gjendje lufte apo situatë te jashtezakonshme, ne zbatim te protokollit 13 te Konventes Europiane per Mbrojtjen e te Drejtave te Njeriut dhe Lirive Themelore.	Kryetares se Kuvendit. Kryeministrit. Ministrit te Drejtesise.	19.02.2007	Rekomandimi eshte pranuar. Kuvendi miratoi Ligjin nr.9722 dt. 30.04.2007 me ane te te cilit shfuqizoi ne Kodin Penal Ushtarak te gjitha denimet me vdekje.
45	Me iniciative te Avokatit te Popullit	Rekomandim per pergatitjen e ligjit per ngritjen e nje autoriteti mbikqyres te pavarur, pergjegjes per mbrojtjen e te dhenave personale ne Shqiperi.	Kryeministrit. Ministrit te Drejtesise.	03.04.2007	<b><i>Rekomandimi eshte pranuar. Kuvendit i Shqiperise ka miratuar dhe ka hyre ne fuqi Ligji nr.9887 date 10.03.2008 “Per mbrojtjen e te dhenave personale”, ku parashikohet ngritja e institucionit te Komisionerit per mbrojtjen e te dhenave personale.</i></b>
46	Me ankese te disa shtetasve	Rekomandohet nisma ligjore per perfshirjen e rreth 400 familjeve te zones se Berdeneshit Sarande brenda territorit administrative te nje njesie vendore	Kryeministrit. Ministrit te Brendshem.	20.11.2007	Rekomandimi eshte pranuar. Ministri i Brendshem ka urdheruar ngritjen e nje grupi pune per studimin e zones dhe dhenien e mendi-meve per zgjidhjen ligjore te problemit.

## 2008

47	<i>Me insiative te Avokatit te Popullit</i>	<i>Rekomandohet rregullimi i posaçem ligjor apo apo nenligjor i kushteve dhe kritereve qe duhet te permbushe nje person qe duhet te punesohet si mesues ne arsimin parauniversitar; parashikimi ne menyre te qarte dhe pa ekuivoke i procedures se aplikimit per vend pune, si dhe i menyres se zgjidhjes se konflikteve qe rrjedhin nga marrdheniet e punes per personelin mesimdhenes ne arsimin parauniversitar</i>	<i>Ministrin te Arsimit dhe Shkences</i>	11.02.2008	<i>Nuk ka pergjigje</i>
48	<i>Me insiative te Avokatit te Popullit</i>	<i>Rekomandohet pershpjtimi i punes per realizimin e ndryshimeve ligjoreper thjeshtimin e sistemit e te procedurave ne dhenine e rinovimin e lejeve te drejtimit te automjeteve, sipas sistemit "One stop service".</i>	<i>Ministrin te Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit Drejtorese se Pergjithshme te Sherbimeve te Transportit Rrugor</i>	5.05.2008	<i>Rekomandimi eshte pranuar ne parim. Nga ana e Ministrise se Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe nga ana e Drejtorese se Pergjithshme te Sherbimeve te Transportit Rrugor, po punohet per rishikimin e legjislacionit te fushes ne teresi dhe te kesaj ceshtje ne vecanti.</i>
		<i>Rekomandohen ndryshime ne Ligjinnr.9380</i>	<i>Ministrin te</i>		<i>Rekomandimi u pranua ne parim. Nga ana e Zyres Shqiptare te te Drejtave te Autorit, eshte konfirmuar se ndryshimet e propozuara</i>

49	<i>Ankesa e shtetasit A.P</i>	<i>date 28.04.2005 “Per te drejten e autorit dhe te drejtat e tjera te lidhura me te”</i>	<i>Turizimit, Kultures, Rinise dhe Sporteve Zyres Shqiptare te te Drejtave te Autorit</i>	<i>12.05.2008</i>	<i>jane pjese e ndryshimeve qe do te propozohen se shpejti nga Ministri i Turizmit, Kultures, Rinise dhe Sporteve, per Ligjin “Per te drejten e autorit dhe te drejtat e tjera te lidhura me te”</i>
50	<i>Me iniciativen e Avokatit te Popullit</i>	<i>Rekomandohet hartimi e paraqitja per miratim e projekt-ligjit “Per kthimin e kompensimin e prones se luajtshme”.</i>	<i>Ministrin te Drejtesise Ministrin te Financave Komisionit per Çeshtjet Ligjore, Administraten Publike dhe te Drejtat e Njeriut</i>	<i>4.06.2008  Perseritur ne 18.12.2008</i>	<i>Ne shqyrtim</i>
51	<i>Me iniciativen e Avokatit te Popullit</i>	<i>Rekomandohet ndryshimi dhe permiresimi i Ligjit nr.9087 date 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikes se Shqiperise”, per ndalimin e pjesemarrjes se femijeve ne fushata elektorale.</i>	<i>Kuvendit te Shqiperise Komisionit Parlamentarte Reformes Zgjedhore Komisioni per Çeshtjet Ligjore, Administraten Publike dhe te Drejtat e Njeriut</i>	<i>4.07.2008</i>	<i>Nuk u miratua</i>

52	<i>Me inisiativen e Avokatit te Popullit</i>	<i>Rekomandohet pergatitja e ligjit “Per hetuesin (investigatorin) privat”</i>	<i>Kryeministrit Ministrit te Drejtesise</i>	<i>9.07.2008</i>	<i>Rekomandimi u pranua ne parim. Ministria e Drejtesise po pergatit nje studim per mundesine e perfshirjes se ketij projektligji ne sistemin tone ligjor.</i>
53	<i>Ankesa e shtetasit B.Gj</i>	<i>Rekomandohet permiresimi i akteve ligjore dhe nenligjore te cilet parashikojne standartet qe duhet te plotesojne personat fizike a juridike qe te ushtrojne nje aktivitet privat ne fushen e shendetesise</i>	<i>Ministrit te Shendetesise</i>	<i>10.07.2008</i>	<i>Rekomandim i pranuar.</i>
54	<i>Me inisiativen e Avokatit te Popullit</i>	<i>Rekomandohet plotesimi i Ligjit nr.8668 date 23.11.2000 “Per pajisjen e shtetasve shqiptare me pasaporte per jashte shtetit”, ne perputhje me nenin 118 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise</i>	<i>Ministrit te Brendshem</i>	<i>19.09.2008</i>	<i>Rekomandimi u pranua ne parim. Eshte konfirmuar se do te behen plotesimet perkatese kur te filloje pajisja e shtetasve me pasaporta te reja gjate vitit 2009.</i>
55	<i>Me inisiativen e Avokatit te Popullit</i>	<i>Rekomandohen disa shtesa dhe ndryshime ne Kodin e Procedures Penale dhe Kodin e Procedures Civile ne kuader te reformes ne drejtesi</i>	<i>Ministrit te Drejtesise</i>	<i>23.09.2008</i>	<i>Ne shqyrtim.</i>
	<i>Me</i>	<i>Rekomandim per te bere te mundur realizimin e detyres se Avokatit te Popullit</i>			

<b>56</b>	<i>inisiativen e Avokatit te Popullit</i>	<i>per ankesat kunder vendimeve gjyqesore se prere, duke bere plotesimet e duhura ne Kodin e Procedures Penale dhe Civile, bazuar ne rekomandimet e Keshillit te Europes</i>	<i>Ministrit te Drejtesise</i>	<i>2.10.2008</i>	<i>Nuk ka pergjigje.</i>
<b>57</b>	<i>Ankesa e nje OJF-je</i>	<i>Rekomandohet ndryshimi i pikes 8 te nenit 55 te Ligjit nr.8410 date 30.09.1998 “Per radion e televizionin publik e privat ne Republiken e Shqiperise”, per te zgjeruar lirine e shprehjes.</i>	<i>Kryeministrit</i>	<i>6.10.2008</i>	<i>Ne shqyrtim.</i>



**Evidenca e rekomandimeve për nxjerrje, ndryshime apo plotësime në aktet nënligjore të  
Këshillit të Ministrave per periudhen 2000-2008**

<b>Nr</b>	<b>Ankuesi</b>	<b>Permbajtja e rekomandimit</b>	<b>Kujt i drejtohet</b>	<b>Data e dergimit</b>	<b>Përfundimi</b>
<b>1</b>	Ankesa e shtetasit M.Sh. etj.	Rekomandim: “Propozohet shtyrja e afatit të veprimit të V.K.M. Nr. 585 datë 11.12.1997 “ <i>Për evidentimin e familjeve që kanë humbur banesat nga rënia e skemave piramidale</i> ”, si dhe plotësimi i listave të kreditorëve.	Kryeministrit	16.06.2000	Rekomandimi u pranua në parim. Por pa nxjerrë V.K.M. u plotësuan listat e kreditorëve në njësitë e qeverisjes vendore.
<b>2</b>	Shtetasti A.R. ish pronar trualli	Të shfuqizohet si antikushtetuese shkronja “c” e pikës 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.119, datë 18.03.2000 “Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive që veprojnë në sektorët strategjikë” si dhe pikës 4 të V.K.M. nr.438, datë 14.08.1995 “Për privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore të transformuara në shoqëri tregtare” për çmimin e truallit që i është kthyer ish pronarëve	Gjykatës Kushtetuese	15.11.2000	Kërkesa u pranua. Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj nr.26, datë 24.04.2001 vendosi: 1. Shfuqizimin si antikushtetues të pikës 1, shkronja ‘c’ të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.119, datë 18.03.2000 “Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive që veprojnë në sektorët jostrategjikë”. 2. Pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.438 datë 14.08.1995 “Për privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore të transformuara në shoqëri tregë-

					tare”.
3	Ankesa te shtetasve	Rekomandim: “Për pagesën nga Agjensia Kombëtare e Privatizimit për taksën e rregjistrimit të pasurive të paluajtëshme që ju ka shitur personave fizikë ose personave privatë”.	Kryeministrit Ministrit të Financave Agjensisë Kombëtare të Privatizimit	11.05.2001	Rekomandimi u pranua. Doli VKM Nr. 386 datë 31.05.2001”Për pagesën e taksës së kalimit të pronësisë nga privatizimi i pronës shtetërore”.
4	Shoqatat e “Dëshmorëve të Atdheut”, dega Fier dhe Krujë	Rekomandim: “Për nxjerrjen e disa akteve nënligjore për zbatimin e Ligjit Nr. 8607 datë 27.04.2000 “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”.	Kryeministrit	08.10.2001	Rekomandimi është pranuar. Doli VKM Nr. 151 datë 25.04.2002 “Për statusin Dëshmor i Atdheut”.
5	Ankesa të shoqatave të ish pronarëve	Rekomandimi që të nxirren Vendimet e Qeverisë në përputhje me vendimin nr.26 datë 24.04.2001 të Gjykatës Kushtetuese	Ministrit të Ekonomisë	24.10.2001	Rekomandimi u pranua. Me VKM nr.119 datë 27.02.2003 u riformulua gërma “c” e pikës 1 të VKM nr.119 datë 18.03.2000, sipas Vendimit nr.26, datë 24.04.2001 të Gjykatës Kushtetuese
6	Ankesa e një numuri të madh të dënuarish që vuajnë denimin në burgje	Rekomandim: “Për plotësimin e kërkesave të Ligjit Nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, për kriteret e shpërblimit të punës së të dënuarve.	Kryeministrit Ministrit të Drejtësisë	13.05.2002 <b>Perseritur ne date 17.07.2008</b>	Pranuar në parim. Eshte pergatitur nje projektvendim, qe nuk është derguar per miratim ne Keshillin e Ministrave
7	Ankesa e shtetasit A.M.	Rekomandim: “Për shfuqizimin e pikës 1 të VKM nr.24.10.2001 dhe urdhërit të Ministrit të Arsimit “Për kuotat shtesë të Shkollave të Larta”, që	Kryeministrit. Ministrit të	04.07.2002	Rekomandimi është pranuar. Doli VKM Nr. 362 datë

		krijonte diferencim për kandidatët për studentë në shkollat e larta	Arsimit		18.07.2002
8	Disa familjare te punonjesve te policise, te vrare ne krye te detyres	Rekomadim: “Per permiresimin e V.K.M. Nr. 552 date 27.11.1999 “ <i>Per trajtimin ekonomik e financiar te familjareve te punonjesve te policise te vrare e plagosur per shkak te detyres</i> ”.	Keshillit te Ministrave. Ministrit Rendit Publik	06.12.2002 <b><i>Perseritur disa here dhe heren e fundit, date 12.12.2008</i></b>	Rekomandimi është pranuar. Eshte bere projektvendimi dhe eshte derguar për miratim në Qeveri dy here. Eshte kthyer per t’u ripunuar per shkak te kosos financiare.
9	Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë	Kërkesë: Të shfuqizohet si antikushtetues Vendimi nr.441 datë 26.09.2002 i Këshillit të Ministrave “Për ndalimin e menjëhershëm të veprimtarisë së shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit në shtretërit e lumenjve”	Gjykatës Kushtetuese	13.12.2002	Pranuar. Para shqyrtimit të çështjes në Gjykatën Kushtetuese, Qeveria nxori Vendimin nr.19 datë 10.01.2003 “Për disa ndryshime në vendimin nr.441 datë 26.09.2002
10	Ankesa e shtetasit Q.H.	Rekomandim: “Për të deklaruar (konstatuar) pavlefshmërinë absolute të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 226 datë 20.08.2002 “Për komunikimin me organet e medias së shkruar dhe elektronike”.	Kryeministrit	27.05.2003	Rekomandimi u pranua. Kryeministri me urdhërin Nr. 157 datë 12.11.2003 revokoi urdhërin Nr. 226 datë 20.08.2002.
11	Ankesa e shtetasit Q.H	Rekomandim: “ Për ndryshimin e VKM Nr. 64 datë 02.02.2001 “ <i>Për inkuadrimin e gradave ushtarake, në gradat e Policisë së Shtetit dhe për caktimin e funksioneve organike që do të ushtrohen sipas tyre</i> ”.	Këshillit të Ministrave, Ministrit të Rendit Publik	29.05.2003	Rekomandimi nuk u pranua. Por pati efektet e tij pozitive. Eshtë bërë i mundur korigjimi i shumë rasteve të dhënies së gradave në mënyrë të padrejtë.
12	Ankesa e shtetasit S.H.	Rekomandim: “Për përmirësimin e udhëzimit Nr. 1 datë 24.12.2002 “Për llogaritjen dhe indeksimin e bazës së vlerësuar për efekt pensioni”. Zbatimi me akt nënligjor i parashikimeve të nenit 61 Pika 1 të Ligjit Nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për	Kryeministrit etj.	23.09.2003	Rekomandimi është pranuar. Në zbatim të këtij rekomandimi doli VKM Nr. 357 datë 01.06.2004 e VKM Nr. 374 datë 31.05.2005 “Për përcaktimin e

		sigurimet shoqërore në R.Shqipërisë”, dhe udhëzimit Nr. 1 datë 24.12.2002 “Për llogaritjen dhe indeksimin e bazës së vlerësuar për efekt pensioni”.			koefiçie-ntëve të indeksimit të bazës së vleësimit vjetor individual për llogaritjen fillestare të pensioneve”.
13	Ankesa e shtetasit Xh.K dhe i një numuri të madh të veteranëve nga i gjithë vëndi.	Rekomandim: “Për ndërmarjen e inisiativës për hartimin e projektvendimit për caktimin e një afati të ri për paraqitjen e dokumenteve para Komisionit Qëndror të <i>Statusit të Veteranit</i> , me qëllim njohjen e statusit të veteranit”.	Ministrit të Mbrojtjes	26.11.2003	Është pranuar dhe për këtë ka dalë VKM Nr.748 datë 11.11.2004, i cili zgjati afatin deri më 31.12.2006. Afati është zgjatur edhe për vitin 2007.
14	Ankesa e shtetasit G.D.	Rekomandim: “Mbi hartimin e një projektvendimi për trajtimin e detyrimeve ndaj shtetit, ndaj sigurimeve shoqërore dhe të tretëve që rrjedhin nga zbatimi i marrëveshjes së konçesionit të formës BOT për uzinën e ferrokromit Elbasan dhe për minierat e kromit Prrrenjas e Pojskë, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike e Privatizimit dhe Shoqërisë italiane Darfo SPA”.	Këshillit të Ministrave.	2003	Pranuar. Janë bërë ndryshime në ligj që falin detyrimet e papaguara ndaj Sigurimeve Shoqërore
15	Ankesa e Infosoft System” Sh.a.	Rekomandim: “Për revokimin e paragrafit që parashikon formularin e “Autorizimit të Prodhuesit” në kapitullin e tretë të Udhëzimit të K.M. Nr. 1 datë 01.01.1996 “Për Prokurimin Publik” ndryshuar me VKM Nr.3 datë 10.07.2003 “Për disa ndryshime të VKM. Nr. 1 datë 01.01.1996 “Për Prokurorimin Publik”.	Kryeministrit	13.12.2003	Rekomandimi është pranuar nga ana e Agjensisë së Prokurimit Publik. Ne dokumentet standarte per blerjen e mallrave, te miratuara ne perputhje me Ligjin nr.9643 date 20.11.2006 “Per prokurimin Publik”, eshte hequr ky formular.

16	Ankesa e shtetasit N.GJ.	Rekomandim: “Për përfshirjen në listën e subjekteve që përfitojnë pension suplementar të nënpunësve të Komisionit të Shërbimit Civil dhe të Avokatit të Popullit”.	Kryeministrit. Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale.	08.07.2004.	Rekomandimi u pranua. Shtesat përkatëse të kerkuara janë pasqyruar në VKM nr.467 datë 23.06.2005 “Per disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.382 datë 20.05.1996 “Per zbatimin e ligjit nr.8097 datë 21.03.1996 “Per pensionet shtetërore suplementare të personave, që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar”.
17	Ankesa të punonjësve të policisë së burgjeve	Rekomandim:“Për përshpejtimin e procedurave për miratimin e VKM për trajtimin e të gjitha strukturave të Policisë së Burgjeve, sipas nenit 12 të Ligjit Nr. 8321 datë 02.04.1998 “Për Policinë e Burgjeve”.	Ministrit të Drejtësisë	22.12.2004	Rekomandimi u pranua. <b><i>Çeshtja është zgjidhur perfundimisht me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.10032 datë 11.12.2008 “Per policine e burgjeve”.</i></b>
18	Ankesa të shtetasve	Rekomandim: “Për marrjen e të gjitha masave në bashkëpunim dhe me institucionet e tjera qëndrore, për dhënien e tokës bujqësore në pronësi në bazë të Ligjit Nr. 7501 datë 19.07.1991 “Për tokën” subjekteve që ende nuk kishin marrë ose nuk janë plotësuar me tokë në pronësi”.	Ministrit të Bujqësisë. Kryeministrit	09.03.2005	Rekomandimi u pranua. Ka dalë VKM Nr.291 datë 06.05.2005 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 230 datë 22.07.1991 “Për krijimin e Komisionit të Tokave” në fshatra të cilat shqyrtojnë mosmarrëveshjet dhe konfliktet brenda fshatit, që kanë lindur në vijimësi të procesit të ndarjes së tokës dhe që në kohën e shqyrtimit nuk

					kanë marrë zgjidhje ligjore”.
19	Ankesa e shtetasit B.K.	Rekomandim: “Për përshpejtimin e procedurave lidhur me funksionimin e Komisionit Shtetëror Trepalësh, si dhe për nxjerrjen e akteve nënligjore për ish të përndjekurit politikë”.	Kryeministrit.	24.03.2005 Përsëritur në datën 02.11.2005	Rekomandimi nuk ka përgjigje.
20	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “Për rritjen e transparencës dhe zbatimin e Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare” duke përgatitur një Rregullore tip”.	Kryeministrit.	12.10.2005	Rekomandimi u pranua ne parim. Më konkretisht shih nr.38 tek Pasqyra nr.3
21	Ankesa të shtetasve	Rekomandim: “Për përgatitjen e akteve të reja nënligjore në zbatim të Ligjit Nr. 9380 datë 28.04.2005 “Për të drejtat e autorit dhe te drejtat e tjera të lidhura me të”.	Ministrit të Financave Ministrit Turizmit, Kulturës, Rinisë e Sporteve.	18.10.2005	Rekomandimi u pranua. Ne zbatim te Ligjit nr.9380 date 28.04.2005 “Per te drejtat e autorit dhe te drejtat e tjera te lidhura me te”, ka dale VKM nr.232 date 19.04.2006 “Per krijimin dhe funksionimin e zyres shqiptare per te drejtat e autorit; VKM nr.343 date 6.06.2007 “Per miratimin e tarifave te sherbimit qe ofron zyra shqiptare per te drejtat e autorit”.
22	Ankesa e shtetasit A.K.	Rekomandim: “Për përgatitjen e akteve të reja nënligjore në zbatim të Ligjit Nr. 9267 datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigu-rimeve, risigurimeve dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe	Ministrit të Financave. Këshillit të Ministrave	18.11.2005	Rekomandimi u pranua. Ka dale Udhezimi i Ministrit te Financave, nr.24 date 15.11.2007 “Mbi trajtimin e demeve te mbuluara nga kontrata e

		<i>risigurime</i> ".	Autoritetit Mbikqyrës të Sigurimeve.		sigurimit te detyrueshem te mbajtesve te mjeteve motorike".
23	Ankesa të shumta	Rekomandim: "Për situatën e çmimeve të operatorëve të telefonisë së lëvizshme dhe propozimi për miratimin sa më parë të Metodologjisë së caktimit të tarifave nga ERT".	Entit Rregullator të Telekomunikacionit	25.11.2005	Rekomandimi është pranuar. Aktualisht Metodologjia është miratuar nga Këshilli i Ministrave me VKM nr.855 date 18.06.2008 "Per miratimin e metodologjise te rregulimit te tarifave te organizmit me fuqi te ndjeshme ne treg AMC sh.a dhe tarifave te interkonjeksionit.
24	Ankesa e shtetasit P. S. etj.	Rekomandim: "Kërkohej përshpejtimi i procedurave për ndryshimin e VKM Nr.146 datë 26.02.1998 "Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve".	Ministrit të Arsimit. Finacave dhe Punëve Publike.	2005	Rekomandimi është pranuar. VKM nr.146 date 26.02.1998, është ndryshuar me hyrjen ne fuqi te VKM nr.166 date 7.02.2007.
25	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: "Për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit Nr.9389, datë 04.05.2005 "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues të Gjaktarrjes"	Kryeministrit.	02.02.2006 Përsëritur 2007	Rekomandimi është pranuar, por deri tani nuk janë nxjerrë aktet nënligjore.
26	Ankesa të shtetasve dhe organizatave joqeveritare	Kërkesë për shfuqizimin si antikushtetues të 1. V.K.M. nr.43, datë 27.01.2006 "Për shmangien e nepotizmit dhe ndikimin e pushtetit në rekrutimin dhe karrierën e personelit të administratës publike". 2. V.K.M. nr.44, datë 27.01.2006 "Për shmangien e nepotizmit në administratën publike".	Gjykatës Kushtetuese	09.02.2006	Rekomandimi është pranuar. Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj nr.20 datë 11.07.2006 vendosi shfuqizimin

	të të drejtave të njeriut	3. V.K.M. nr.48, datë 27.01.2006 “Për disa shtesa në vendimin nr.205 datë 13.04.1999 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë”			e tre vendimeve të Qeverisë.
27	Ankesa nga shtetas të ndryshëm	Rekomandim për përgatitjen e projektvendimit të Qeverisë për zbatimin e neneve 8, 9, 10 dhe 11 të ligjit nr.8661, datë 18.09.2000 “Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit”	Kryeministrit Ministrit të Brendshëm	03.03.2006	Rekomandimi është pranuar. Është përgatitur projekt vendimi dhe është dërguar për miratim në Qeveri dy here dhe është kthyer për t’u ripunuar për shkak të kostos financiare. Në këtë projektvendim janë përfshirë edhe ndryshimet e VKM nr.552 dt. 27.11.1999 “Për trajtimin ekonomik e financiar të familjareve të punonjësve të policisë të vrarë e plagosur për shkak të detyrës”, të propozuara nga ana jone.
28	Shoqata e Talasemikëve të Shqipërisë	Rekomandim: “ Për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit Nr. 8032 datë 16.01.1995 “ <i>Për shërbimin e transfuzionit dhe kontrollit të gjakut të produkteve të tij dhe transplantimeve</i> ”.	Ministrit të Shëndetësisë	13.03.2006	Rekomandimi është pranuar, është miratuar strategjia për gjak të sigurtë.
29	Ankesa të shtetasve	Rekomandim për hartimin dhe paraqitjen për miratim të projekt vendimit të Qeverisë, për vënien në zbatim të nenit 51 të ligjit nr.9135 datë 11.09.2003 “Për mbrojtjen e konsumatorit”.	Ministrit të Ekonomisë	20.03.2006	Rekomandimi është pranuar. <b><i>Është miratuar nga Kuvendi dhe ka hyrë në fuqi ligji nr.9683 dt.28.01.2008 “Për ushqimin”, pjesë e të cilit është edhe mbi-</i></b>



					<i>kqyrja e tregut.</i>
30	Ankesa nga shtetas të ndryshëm	Rekomandim: “Per aktet nenligjore te Ligjit Nr. 9232 date 13.05.2004 “ <i>Per programet sociale per strehimin e banoreve te zonave urbane</i> ”.	Ministrit te Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve	29.03.2006	Rekomandimi u pranua. Ne zbatim te ligjit, ka dale VKM nr.258 date 28.04.2005 “Per kushtet, normat dhe standartet qe duhet te plotesojne banesat sociale me qera, te cilat blihen ne treg”. Ministri i Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve ka nxjerre Udhezimin nr.2 date 4.04.2007 “Per miratimin e koston mesatare te banesave, nga Enti Kombetar i Banesave dhe te koeficientit “K” per vitin 2007”.
31	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “ Për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit Nr.9110, datë 24.07.2003 “ <i>Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Për Krime të Rënda</i> ”.	Kryeministrit. Ministrit të Drejtësisë	24.05.2006 Perseritur ne daten 03.03.2008	Rekomandimi u pranua. Ne date 18.04.2008, eshte kthyer pergjigje. Ministria e Drejtësisë ka përgatitur projekt vendimin per kete problem.
32	Ankesa nga ushtarakët	Rekomandim për plotësimin e kërkesave të nenit 39 të Ligjit nr.9210 datë 23.03.2004 “Për Statusin e Ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” për kriteret e përfitimit nga ushtarakët të së drejtës së parablerjes për objektet ushtarake të dala të lira.	Ministrit të Mbrojtjes	30.05.2006	Ministria e Mbrojtjes e pranoi rekomandimin, por nuk kanë dakort ministritë e tjera. <b>Rekomandimi u perserit ne daten 30.12.2008 dhe eshte ne shqyrtim.</b>
	Ankesa të	Rekomandim: “Për shfuqizimin e Pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 87, datë	Kryeministrit. Ministrit të		Rekomandimi është pranuar pjesërisht, tarifa e recetes eshte

33	shtetasve	15.02.2006 <i>“Për administrimin dhe mbulimin e shpenzimeve të recetave me rimbursim”</i>	Financave, Ministrit të Shëndetësisë	21.12.2006	hequr vetem per nje kategori te caktuar personash, me VKM nr.727 dt.30.10.2007.
34	Me iniciative te Avokatit te Popullit	Rekomandohet hartimi dhe paraqitja per miratim prane Keshillit te Ministrave te projektvendimit mbi kriteret licensuese te eksperteve te demeve, si detyrim qe buron nga neni 89 i Ligjit nr.9267 dt.29.07.2004 <i>“Per veprimtarine e sigurimit, te risigurimit dhe ndermjetesimit ne sigurime dhe risigurime”</i>	Kryeministrit. Kryetares se Agjencise se Mbikqyrjes Financiare.	13.03.2007	<b><i>Rekomandimi u pranua. Eshte nxjerre VKM nr.164 date 28.01.2008 “Per kriteret e procedurat e licensimit te vleresuesve te demeve ne sigurime”, si dhe eshte miratuar Rregullorja e AMF-se nr.18 date 27.03.2008 “Per organizimin e testimit per vleresuesit e demeve ne sigurime”.</i></b>
35	Me iniciative te Avokatit te Popullit	Rekomandohet marrja e masave te menjehereshme per botimin ne Fletoren Zyrtare te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr.565 dt. 9.08.2006 <i>“Per mbrojtjen e shtresave ne nevoje nga rritja e çmimit te energjise elektrike”.</i>	Kryeministrit. Ministrit te Financave. Ministrit te Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta	17.07.2007	Rekomandimi eshte pranuar. VKM nr.565 dt.9.08.2006 u botua ne Fletoren Zyrtare Nr.Ekstra 25, faqe 3, Viti 2007.
	Me iniciative	Rekomandohet plotesimi i kerkesave te nenit 401 te Kodit Detar te Republikes se Shqiperise, per	Ministrit te Puneve Publike, Transporteve dhe Telekomunikacionit.		Rekomandimi eshte pranuar ne parim. Nga ana e Ministrise se

36	te Avokatit te Popullit	hartimin dhe kalimin per miratim ne Keshillin e Ministrave te disa vendimeve te veçanta me karakter nderministerial.	Ministrit te Financave. Ministrit te Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave.	31.07.2007	Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave po hartohen drafte ne lidhje me ndotjen ne hapesiren detare.
<b>2008</b>					
37	Ankesa e shtetasit Xh.M	<i>Rekomandohet marrja e masave organizative dhe ligjore per zgjidhjen e problemit te mosderdhjes se kontributeve shoqerore te bashkeshortit/es te ushtarakeve qe kane perfituar pagesen e papunesise per periudhen 1993-2003</i>  <i>Ne vijim, rekomandohet marrja e masave per identifikimin e numrit te pergjithshem te personave qe kane perfituar pagesen e papunesise, ne baze te Ligjit nr.7496 date 3.07.1991 "Per statusin e ushtarakut te Forcave te Armatosura te Republikes se Shqiperise", per periudhen 1993-2003.</i>	<i>Kryeministrit Ministrit te Financave Ministrit te Brendshem Ministrit te Mbrojtjes</i>  <i>Ministrit te Mbrojtjes Ministrit te Brendshem Drejtorit te SHISH</i>	<i>30.05.2008</i>  <i>16.07.2008</i>	<i>Rekomandimi eshte pranuar.Ne pergjigje te ketij rekomandimi, Kryeministri ka kerkuar ndjekjen e kesaj çeshtje nga ana e ISSH-se.</i>  <i>Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendeshme dhe SHISH, i kane bere listat e personave qe kane perfituar pagesen e papunesise dhe eshte percaktuar numri i pergjithshem i tyre. Keto te dhena i jane derguar Ministrise se Financave.</i>

38	<i>Me iniciative te Avokatit te Popullit</i>	<i>Rekomandohet miratimi i VKM-se per kohen e punes dhe te pushimit te punonjesve te Policise te Shtetit, ne baze e per zbatim te nenit 87/6 te Ligjit nr.9749 date 4.06.2007 “Per Policine e Shtetit”.</i>	<i>Kryeministrin</i>	<i>16.09.2008</i>	<i>Ne shqyrtim.</i>
39	<i>Me iniciative te Avokatit te Popullit</i>	<i>Rekomandohet marrja e masave per te rregulluar ligjerisht trajtimin e veçante te te semureve qe vendosen ne kushte karantine si dhe pagesen e personelit qe punon ne Spitalin Infektiv</i>	<i>Ministres se Shendetesise Drejtores se QSUT-se</i>	<i>16.09.2008</i>	<i>Rekomandimi eshte pranuar. Ka dale vendimi i Keshillit te Ministrave i dates 24.12.2008 “Per disa ndryshime e shitesa ne VKM nr.306 date 27.06.2002 “Per miratimin e struktures dhe te nivelit te pagave te punonjesve me arsim te larte ne sistemin e Ministrise se Shendetesise dhe Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, ne sistemin e Ministrise se Mbrojtjes”, i ndryshuar. Gjithashtu Drejtoria e QSUT-se ka ngritur nje grup pune per hartimin e nje rregulloreje per kushtet e trajtimit te pacienteve qe vendosen ne karantine ne Spitalin Infektiv.</i>

**Evidenca e rekomandimeve për nxjerrje, ndryshime apo plotësime për aktet nënligjore të ministrave dhe drejtuesve të institucioneve të tjera qendrore për periudhën 2000-2008**

<b>Nr</b>	<b>Ankuesi</b>	<b>Permbajtja e rekomandimit</b>	<b>Kujt i drejtohet</b>	<b>Data e dergimit</b>	<b>Përfundimi</b>
<b>1</b>	Subjekte private të qytetit të Korçës	Rekomandim: “Për shfuqizimin e Pikës 4 të Udhëzimit të Ministrit të Shëndetësisë Nr. 362 datë 18.08.2000 “ <i>Mbi zbatimin e detyrave për dhënien e lejës higjeno-sanitare</i> ”.	Ministrit të Shëndetësisë	27.09.2000	Rekomandimi u pranua.
<b>2</b>	Ankesat e një numri të konsiderueshëm qytetarësh.	Rekomandim: “ Për masat që duhen marrë për zbatimin e Ligjit Nr. 8503 datë 30.06.1999 “ <i>Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare</i> ”, me qëllim që çdo autoritet publik të nxjerrë rregullore.	Kryeministrit. Çdo ministri edhe institucioni qendror, çdo organi të pushtetit vendor	09.11.2000 Përsëritur datë 24.01.2002	Rekomandimi është pranuar pothuajse nga të gjitha ministratë, institucionet qendrore dhe organet e pushtetit vendor.
<b>3</b>	Shtetasi R. R. në emër të 49 familjeve nga Tirana.	Rekomandim: “ Mbi problemin e 49 familjeve të shpronësuara nga Ujëmbledhësi i Bovillës me qëllim që projektvendimi i paraqitur të dërgohet sa më parë për shqyrtim në Këshillin e Ministrave”.	Ministrit të Punëve Publike	27.09.2000	Kthyer përgjigje pozitive më datën 19.02.2001. Por megjithatë problemi nuk është zgjidhur me ndonjë akt nënligjor, por me vendime gjykatë
<b>4</b>	Ankesa të studentëve pasuniversitarë	Rekomandim për rivendosjen e së drejtës së shkelur në lidhje me tarifat e regjistrimit për specializim	Ministrit të Arsimit	12.01.2001	Pranuar. Ministri i Arsimit u përgjigj se do të ndryshojë Udhëzimin

		pasuniversitar			përkatës
5	Ankesa të shtetasve	Rekomandim për ndryshimin në Udhëzimin nr.39 datë 31.03.1999 të Këshillit Mbikqyrës të Bankës së Shqipërisë	Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë	15.02.2001	Rekomandimi u pranua
6	Ankesa nga ushtarakët	Rekomandim: “Për një ndryshim në VKM Nr. 379 datë 26.06.1995 “Për privatizimin e objekteve që dalin të lira nga ristrukturimi”	Ministrit të Mbrojtjes	13.04.2001	Pranuar dhe kanë dalë VKM Nr. 524 datë 30.07.2004 dhe VKM Nr. 452 datë 09.07.2004 “Për marrje kredi me interes”.
7	Ankesa të shtetasve	Rekomandim: “Për nxjerrjen e një udhëzimi të përbashkët, për mbajtjen e proces verbaleve të kallëzimit të personave të keqtrajtuar nga policia jashtë shtetit”.	Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Rendit Publik	03.07.2001	Rekomandimi u pranua. Doli Udhëzimi i Përbashkët i Prokurorit të Përgjithshëm dhe i Ministrit të Rendit Publik Nr. 2037 dhe 1210 datë 23.07.2001
8	Ankesa të shtetasve	Rekomandim: “ Për marrjen e masave dhe nxjerrjen e udhëzimeve që përcakton V.K.M. Nr. 335 datë 20.06.1998 “Për procedurat për zbatimin e vendimeve gjyqësore për detyrimet që prekin buxhetin e shtetit”.	Ministrit të Drejtësisë. Ministrit të Financave	19.11.2001	Rekomandimi është pranuar nga Ministria e Financave, por nuk është vepruar nga Ministria e Drejtësisë
9	Ankesa të të dënuarve	Rekomandim: “ Për plotësimin e kërkesave të Ligjit Nr. 8092 datë 03.02.1996 “Për shëndetin mendor”, për të nxjerrë rregulloren “Për masat e sigurimit të personave për të cilët gjykata ka marrë masën mjekësore të mjekimit të detyruar”.	Ministrit të Shëndetësisë Ministrit të Drejtësisë	13.05.2002	Rekomandimi është pranuar. U krijua Instituti për kurimin e të dënuarve me trauma psikike e përdoruesve të drogës në Krujë.
		Rekomandim: “Për krijimin e kushteve për funksio-	Kryeministrit		Rekomandimi është pra-

<b>10</b>	Ankesa të të dënuarve	nimin e Komisionit Mbikqyrës të Ekzekutimit të Vendimeve me Burgim, sipas kreut të tretë të Ligjit Nr. 8331 datë 21.04.1994 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”.	Ministrit të Drejtësisë,	11.11.2002	nuar. Është ngritur, por nuk funksionon në vazhdimësi. Komisioni Mbikqyrës.
<b>11</b>	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “Për rritjen e objektivitetit të ekspertimeve mjeko-ligjore, në rastet e vdekjeve të shtetasve kur dyshohet se janë dhunuar nga punonjës policie apo nëpunës të shtetit”.	Instituti të Mjekësisë Ligjore.	16.01.2003	Rekomandimi u pranua. Doli Udhëzimi Nr. 22 datë 27.01.2003, i cili udhëzon kryerjen e ekspertimit me grup ekspertësh ku njëri duhet të jetë patjetër nga Instituti i Mjekësisë–Ligjore.
<b>12</b>	Ankesa e policit Q.H.	Rekomandim: “ Për përmirësimin e Urdhërit Nr. 1661 datë 08.04.2002 “Për komunikimin me media”.	Ministrit të Rendit Publik	28.05.2003	Rekomandimi u pranua në parim, por nuk u ndryshua
<b>13</b>	Pas një inspektimi në Spitalin psikiatrik Tiranë	Rekomandim për zbatimin e nenit 23 të ligjit nr.8092 datë 03.02.1996 “Për shëndetin mendor” në spitalin psikiatrik Tiranë për të nxjerrë një rregullore për komisionin që përlligj masat e kufizimit fizik	Ministrit të Shëndetësisë	13.06.2003 Përsëritur 2007	Rekomandimi pa përgjigje
<b>14</b>	Ankesa të punonjësve të policisë	Rekomandim: “ Për ndryshimin e urdhërit të Ministrit të Rendit Publik Nr. 1484 datë 18.06.2001, pika 14 dhe urdhër shërbimit Nr. 1172 datë 04.04.2003 të Drejtorit të Policisë së Shtetit pika 8, duke zgjatur afatin e pranimin të ankesave të punonjësve të policisë për gradat deri më 31.12.2004”.	Ministrit të Rendit Publik	16.12.2003	Rekomandimi u pranua më datën 20.01.2004.

<b>15</b>	Ankesa të shtetasve.	Rekomandim: “ Të rishikohen për ulje tarifat e shitjes së energjisë elektrike të miratura me vendimin e E.R.E Nr. 22 datë 30.12.2003”.	Entit Rregullator të Energjisë	12.02.2004	Rekomandimi u pranua. U ulën pjesërisht tarifat e energjisë elektrike.
<b>16</b>	Ankesa e shtetasit A.T.	Rekomandim: “Për revokimin e Urdhërit Nr. 191 datë 22.04.2002 dhe për mospërfshirjen në përbërje të Komisionit Qëndror të Përmirësimit Racor (KQPR-së) të antarëve të subjekteve të tjera konkurrese”	Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimor	12.10.2004	Rekomandimi u pranua. Revokuar me Urdhërin e Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit Nr. 223 datë 12.05.2005
<b>17</b>	Me iniciativë të Avokatit të Popullit (Pas inspektimit në dhomat e parburgimit Berat)	Rekomandim: “Për shfuqizimin e rregullores “Për sigurimin dhe trajtimin e të paraburgosurve” miratuar me Urdhërin e Ministrit të Rendit Nr. 1075/2 datë 15.09.1999 dhe urdhërimin për zbatimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Sistemit të Paraburgimit”, miratuar me urdhër të Ministrit të Dretjesisë Nr. 3750/2 datë 23.07.2003”	Ministrit të Dretjesisë dhe të Rendit Publik	29.03.2005	Rekomandimi u pranua. Kthyer përgjigje se është përgatitur drafti i rregullores ku janë marrë në konsideratë të gjitha vërejtjet e Avokatit të Popullit
<b>18</b>	Ankesa e shtetasit B.V.	Rekomandim: “Për shfuqizimin e një pjese të Urdhërit Nr. 110 datë 20.04.2004 të Ministrit të Industrisë dhe Energjitikës “Mbi miratimin e strukturës së Policisë Elektrike”	Ministrit të Industrisë dhe Energjitikës. Për dijeni Kryeministrit.	31.03.2005	Nuk është kthyer përgjigje zyrtare.
<b>19</b>	Ankesa e shtetasit L.D.	Rekomandim:“Për bërjen e ndryshimeve në rregulloren e Institutit të Policisë Shkencore, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Rendit Publik Nr. 751 datë 16.01.2003, duke parashikuar që në rastet e ndodhjes së ngjarjeve të rënda në ambjentet e	Ministrit të Rendit Publik	30.05.2005	Rekomandimi u pranua në parim. Ne datë 16.02.2006 Drejtori i Përgjithshëm i



		policisë ose jashtë saj, por që kanë si autorë të dyshuar punonjës policie, në kqyrjen e vëndit të ngjarjes dhe në kryerjen e veprimeve ekzaminuese të marrin pjesë dhe ekspertë privatë të specialiteve përkatëse”.			Policisë së Shtetit sugjeron që t’i drejtohem Prokurorit të Përgjithshëm.
20	Ankesa e shtetasit L.D. Pas vetvrasjes së shtetasit A. D. në Komisariatin e Policisë Nr. 4 Tiranë.	Rekomandim: “Për shfuqizimin e udhëzimit të Ministrit të Rendit Publik Nr. 168 datë 20.10.1993 “Për rregullat e shoqërimit të shtetasve në Komisariate, Reparte, Posta të Policisë dhe Zyra të tjera të tyre” si dhe për përgatitjen, miratimin dhe vënien në zbatim të Rregullores së re të shoqërimit të shtetasve në zyrat e policisë	Ministrit të Rendit Publik	28.06.2005	Rekomandimi u pranua. Me urdhërin e Ministrit të rendit Publik Nr. 1749 datë 29.07.2005, u bë shfuqizimi i urdhërit të mësipërm dhe u miratua Rregullorja e Policisë së Shtetit.
21	Ankesa e shtetasit A. B.	Rekomandim: “Kërkohet shfuqizimi i nenit 10 paragrafi i tretë i Rregullores së Fakultetit Histori Filologji të Universitetit të Tiranës”	Fakultetit Histori Filologji. Rektorit të Universitetit të Tiranës.	30.06.2005	Rekomandimi u pranua. Është shfuqizuar paragrafi i tretë i nenit 10 të Rregullores.
22	Ankesa e të dënuarve Z.F. dhe Gj.R. në Burgun e Burrelit.	Rekomandim: “Për rregullimin çështjes së uljes së dënimit për të dënuarit që punojnë në burgje dhe marrja e masave për korigjimin e pasojave të aktit të nxjerrë nga Prokurori i Përgjithshëm me shkresën nr. 3223 datë 08.10.2004, dërguar Prokurorive në rrethe”.	Ministrit të Drejtësisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm	22.09.2005	Rekomandimi nuk u pranua nga Prokurori i Përgjithshëm. dhe Ministri i Drejtësisë.
		<b>Rekomandohet revokimi i Urdherit të ish Prokurorit të Përgjithshëm nr. 3223 datë 08.10.2004.</b>	<b>Prokurores së Përgjithshme</b>	<b>17.07.2008</b>	<b>Rekomandimi është pranuar në parim. Ministria e Drejtësisë ka</b>

					<i>pergatitur nje projektligj per nje ndryshim ne Ligjin nr.8328 date 16.04.1998 “Per te drejtat dhe trajtimin e te denuarve me burgim”, qe do te mundesonte revokimin e Urdherit nr. 3223 datë 08.10.2004. Projekt ligji ndodhet per diskutim e miratim ne Keshillin e Ministrave</i>
23	Me iniciativën e Avokatit të Popullit. Vetvrasja e shtetasit A.B. në Komisarriatin e Policisë Nr. 3, Tiranë.	Rekomandim: “Për ndryshimin dhe përmirësimin e Kreut XII-të “shoqërimi i personave” të Rregullores së Shërbimeve të Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Rendit Publik Nr. 1749 datë 29.07.2005, si dhe për hartimin e Metodikës së njoftimit të akuzës dhe marrjes në pyetje të personave që dyshohen si autorë të veprave penale, ose që kanë dijeni për rrethana të hetimit”.	Ministrit të Brëndshëm.	22.12.2005	Rekomandimi u pranua në parim pjesërisht, në pikat e propozuara me shkresën e datës 20.02.2006 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Meqenese kjo rregullore ishte nxjerre ne baze e per zbatim te ligjit nr.8553 dt. 25.11.1999 “Per Policine e Shtetit”, i cili eshte shfuqizuar me ligjin nr.9749 dt.4.06.2007 “Per Policine e shtetit”, ne kuadrin e implemetimit te MSA po per-

					gatitet “Manuali i procedurave te punonjesve te Policise te Shtetit”.
24	Ankesa e shtetases L. G. etj.	Rekomandim: “Për dispozitat e reja normative që do të miratohen, për një mbrojtje sa më të mirë si të të drejtave të personelit që kujdeset për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe të drejtave të vetë fëmijve”.	Ministrit të Arsimit.	17.01.2006	Rekomandimi u pranua në parim. Është në proces rishikimi i dispozitave normative.
25	Ankesa e shtetases E.S.	Rekomandim: “Per shpejtimin e punes per hartimin e marreveshjes shqiptaro–greke, per perfitimn e sigurimeve shoqerore nga shtetasit e te dy vendeve”	Ministrit te Punes e Çeshtjeve Sociale Ministrit te Puneve te Jashtme Drejtorit te ISSH	15.02.2006	<b><i>Rekomandimi i pranua ne parim. Ne muajin Nentor 2008, Ministri i Punës, Çeshtjeve Sociale dhe shnaseve te Barabarta, ka kerkuar nga ana e Kryeministrit nxjerrjen e nje urdheri per ngritjen e nje grupi pune nderinstitucional, per pergatitjen e marreveshjeve dypaleshe jo vetem me shtetin Grek por edhe me shtete te tjera ku ndodhen emigrante shqiptare.</i></b>
26	Me iniciativen e Avokatit te Popullit	Rekomandim: “Per pershpejtimin e proçedurave per nxjerrjen e akteve nenligjore ne zbatim te Ligjit Nr. 9381 date 28.04.2005 “Per kompesimin per burgim te padrejte”.	Ministrit te Financave Ministrit te Drejtesise	27.03.2006	Rekomandimi u pranua dhe eshte perpiluar udhezimi i perbashket.

<b>27</b>	Ankesa të shtetasve dhe organizatave joqeveritare	Rekomandim për mospranimin e propozimit të KESH sha për rritjen e çmimit të energjisë elektrike për konsumatorët familjarë	Entit Rregullator të Energjisë	03.04.2006	E.R.E. me vendimin nr.27 datë 20.04.2006 nuk pranoi rritjen e çmimeve
<b>28</b>	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “Per permiresimin e akteve nenligjore te perbashketa per kqyrjen e vendit te ngjarjes ne ambjentet e Komisariateve te Policise, paraburgimit dhe ne burgje”.	Ministrin te Brendshem Prokurorit te Pergjithshem	07.04.2006	Rekomandimi u pranua.
<b>29</b>	Ankesa të të dënuarve	Rekomandim: “Per konstatimin si akt administrativ absolutisht te pavlefshem te Urdherit te Drejtorit te Pergjithshem te Burgjeve Nr. 1522 te vitit 2006 “Per organizimin dhe kryerjen e takimeve speciale”.	Ministrin te Drejtesise Kryeministrin	20.04.2006	Rekomandimi u pranua pjesërisht.
<b>30</b>	Ankesa të shtetasve	Rekomandim: “Per rishikimin e Udhezimit Nr. 6291 date 17.08.2005 “Per Evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve noteriale si dhe per organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale”.	Ministrin te Drejtesise Dhomes Kombetare te Noterise	12.05.2006	Rekomandimi u pranua pjesërisht
<b>31</b>	Me iniciativën e Avokatit të Popullit.	Rekomandim: “Per krijimin e kushteve te nevojshme Per funksionimin e Komisionit te Sherbimit Alternativ”.	Ministrin te Punes e Çeshtjeve Sociale. Ministrin te Mbrojtjes	26.09.2006	Rekomandimi u pranua. Janë krijuar kushtet

32	Ankesa të Mjekëve	Rekomandim: “Per hartimin dhe nxjerrjen e rregullores Per funksionimin e Qendres Spitalore Universitare “Nene Tereza” Tirane.	Ministrit te Shendetesise, Ministrit te Arsimit	13.10.2006	Rekomandimi u pranua. Hartimi i rregullores eshte ne fazen perfudimtare, draft-teksti i rregullores i eshte shperndare per mendim drejtorive te QSUT “Nene Tereza”.
33	Me iniciative te Avokatit te Popullit	Rekomandohet permiresimi i sherbimeve dhe vendosja e tarifave te reja ndaj kompanive te sigurimit per mbulimin e transportit te mjeteve motorike ne rast aksidenti	Agjencise se Mbikqyrjes Financiare	21.03.2007	Rekomandimi eshte pranuar. Eshte miratuar nje vendim i AMF-se per menyren e trajtimit te demeve nga aksidentet ku jane pasqyruar disa detyrime te reja qe duhet te respektojne kompanite private ne fushen e sigurimeve.
34	Me iniciative te Avokatit te Popullit	Rekomandohet marrja e masave per te vendosur ne pozita te ligjshme veprimtarine e KESH sh.a, ne kuader te permiresimit te menyres se matjes se konsumit te energjise elektrike, sepse ka përfunduar afati i aplokimit të faturimit afrofe.	Entit Rregullator te Energjise. KESH sh.a	20.04.2007	Rekomandimi eshte pranuar. Eshte nxjerre vendim per te shtyre afatin e vendosjes se mate-save. Ndersa per zbatimin e faturimit afrofe pa vendim te ERE, KESH sh.a i eshte vendosur gjobe.

<b>35</b>	Me iniciative te Avokatit te Popullit dhe ne bashkepunim me USAID dhe ISPL	Rekomandohet miratimi i rregullores tip “Per shqyrtimin e ankimeve administrative (RTAA)”	Gjithe organeve te Administrates Publike.	5.06.2007	Rekomandimi eshte pranuar dhe pjesa me e madhe e organeve te administrates publike, e ka miratuar kete draft te propozuar nga ne si rregullore te brendshme.
<b>36</b>	Me ankese te Dhomes se Tregtise se Tregtise se Bajram Currit.	Rekomandohet marrja e masave per lejimin e transportit te mallrave nepermjet doganes ne piken kufitare te Qafe Morines, Tropoje, si veprim qe nxit zhvillimin ekonomik dhe lehteson shkembimet tregtare te banoreve te zones.	Kryeminsitrit Ministrit te Financave	29.06.2007	Rekomandimi eshte pranuar. Ne baze te VKM nr.19 dt.19.01.2007, Drejtoria e Pergjithshme e Doganave emeroi punonjesit e sherbimit doganor ne Qafe Morine.
<b>37</b>	Me iniciative te Avokatit te Popullit	Rekomandohet marrja e masave per shpalljen e menjehershme ne publik te grafikut te kufizimeve te energjise elektrike ndaj klienteve familjare dhe jofamiljare	ERE KESH sh.a	13.07.2007	Rekomandimi eshte pranuar. KESH sh.a ka kryer publikimin e te gjitha orareve te kufizimeve me ane te njoftimeve te vecanta.
<b>38</b>	Me iniciative te Avokatit te Popullit dhe ne bashkepunim me USAID dhe ISPL	Rekomandohet miratimi i rregullores tip “Per te drejten e informimit”.	Gjithe organeve te Administrates Publike.	16.07.2007	Rekomandimi eshte pranuar dhe pjesa me e madhe e organeve te administrates publike, e ka miratuar kete draft te propozuar nga ne si rregullore te brendshme.

39	Ankesa e shtetasit H.P	Rekomandohet eliminimi i parregullsive te aktit administrativ, Rregullore “Per kriteret mjekesore per vleresimin e personave me aftesi te kufizuar”, miratuar me urdherin e perbashket te Ministrit te Shendetesise dhe Ministrit te Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta, nr.276 date 8.02.2007.	Ministrit te Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta Ministrit te Shendetesise	26.07.2007	Rekomandimi nuk eshte pranuar.
40	Me ankese te nje shtetasi	Rekomandohet marrja e masave te menjehershme per rikthimin ne pozita ligjore te gjendjes se krijuar nga levizja e kuadrit ne sektorin e auditit	Drejtorise se Pergjithshme te Rezervave te Shtetit	30.10.2007	Rekomandimi eshte pranuar. Drejtorise se Pergjithshme te Rezervave te Shtetit, ka nxjerre urdherin per rregullimin e organikes se stafit te auditit te brendshem.
<b>2008</b>					
41	<i>Me iniciative te Avokatit te Popullit</i>	<i>Rekomandohet hartimi i nje rregulloreje te veçante per emigrantet e paligjshem qe strehon Qendra Pritese e Viktimave te Trafikut, ne Linze, Tirane.</i>	<i>Ministrit te Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta Drejtoreshes se Sherbimit Social Shteteror Drejtorit te</i>	16.09.2008	<i>Rekomandimi eshte pranuar ne parim. Nga ana e Ministrise se Drejtesise ka filluar puna per hartimin e kesaj rregulloreje.</i>

			<i>Qendres Pritese, Linze</i>		
42	<i>Me iniciative te Avokatit te Popullit</i>	<i>Rekomandohet revokimi i pjesshem i Urdherit te Ministrit te Rendit Publik nr.1980 date 4.06.2004 “Per disa ndryshime ne Udhezimin e Ministrit te Rendit Publik nr.1672 date 22.01.2002 “Mbi procedurat per pajisjen e shtetasve shqiptare me pasaporte per jashte shtetit””.</i>	<i>Ministrit te Brendshem</i>	19.09.2008	<i>Rekomandimi eshte pranuar ne parim dhe eshte konfirmuar se do te behen ndryshimet perkatese kur te filloje pajisja e shtetasve me pasaporta te reja gjate vitit 2009.</i>
43	<i>Ankesa e shtetasit A.V</i>	<i>Rekomandohet plotesimi i Rregullores per Zhvillimin e Matures Shteterore ne Republiken e Shqiperise</i>	<i>Ministrit te Arsimit dhe shkences</i>	23.09.2008	<i>Nuk ka pergjigje</i>
44	<i>Me iniciative te Avokatit te Popullit</i>	<i>Rekomandohet ndryshimi i Urdherit nr.18 date 17.01.2008 “Per numrin e te punesuarve ne median e shkruar”, ne Udhezim “Per metodologjine e vleresimit te deklarimeve te subjekteve per numrin e te punesuarve ne median e shkruar”.</i>	<i>Ministrit te Financave</i>	7.10.2008	<i>Ne shqyrtim.</i>



## 2. Çështje të filluara me iniciativën e Avokatit të Popullit ("ex officio")

Sipas nenit 13 të Ligjit nr.8454, dt.4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar me ligjin nr. 9398, datë 12.05.2005, Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike, por me pëlqimin e të interesuarit ose të dëmtuarit.

Në rastet kur Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes me nismën e vet dhe kur kujdestari ose përfaqësuesi i tij ligjor nuk vepron, nuk kërkohet pëlqimi i të dëmtuarit kur është i mitur apo i paaftë mendërisht apo me aftësi të kufizuara ose për mbrojtjen e të drejtave të një numri të madh të individëve.

Në mbrojtje të interesave të një komuniteti të gjërë, të cilët mund të preken nga procedimi administrativ, Avokati i Popullit ka të drejtë të fillojë një procedim administrativ dhe të marrë pjesë në të, në përputhje me kërkesat e Kodit të Procedurës Administrative.

Këto ndryshime kanë hyrë në fuqi me 1 Korrik 2005.

Në tabelën e mëposhtme janë pasqyruar totali i çështjeve të filluara me iniciativë gjatë vitit 2007 dhe 2008.

	2007	2008
- Ankesa të drejta ose zgjidhur në favor	15	50
- Jashtë kompetence ose juriksionit	2	4
- Të refuzuara për shkak se nuk u bënë ankesa individuale sipas ligjit, ose gjatë shqyrtimit u tërhoqën, ose në përfundim doli se ankesa ishte e padrejtë apo e pavërtetë	2	15
- Në shqyrtim	7	16
<b>Totali</b>	<b>26</b>	<b>85</b>

Siç duket dhe nga tabela,. numri i rasteve të filluara me iniciativë gjatë vitit 2008 është rritur ndjeshëm. Për këtë kanë ndikuar inspektimet e kryera nga Avokati i Popullit në Komisarariatet e Policisë, në dhomat e paraburgimit dhe burgje si dhe takimet e zhvilluara me komunitetin gjatë "Ditëve të Hapura".

## ANEKSE

### 1. Letra falenderimi nga qytetarët dhe shoqatat

#### 1. I nderuar Z. Avokat i Popullit

Ju falenderoj për impenjimin e vazhdueshëm dhe dëshirën e mirë për t'na ndihmuar duke argumentuar dhe mbështetur kërkesën tuaj i nderuar Z.Dobjani brenda kuadrit ligjor.

Ndoshta fjalët më mungojnë për të formuluar mirënjohjen dhe falenderimin tim, ndaj gjestit tuaj mjaft human.

Me shumë respekt  
I dënuari R. D.

Vaqarr 29.02.2008

#### 2. Falenderim

Gjej rastin të falenderoj këtu Institucionin e Avokatit të Popullit, drejtuesin e tij Z.Ermir Dobjani me avokatët korrektë e të përkushtuar në mes të të cilëve po përmend Av.Sotiraq Nushin, me të cilin për këtë çështje kemi komunikuar shpesh dhe na janë përgjigjur saktë dhe në kohë. Por fatkeqësi se sipas Ligjit ky institucion qëndron vetëm në pozicionin e Rekomanduesit.

Botuar në Gazetën Republika më datë 16.09.2008

me autor Elmaz Ahmetaj

#### 3. Avokatit të Popullit

Z.Avokat!

Sinqerisht vlerësoj punën që bën Zyra e Avokatit të Popullit në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Unë kam 8 vjet që këtu shikoj të vetmen shpresë dhe Institucion që po pengon braktisjen e Atdheut nga shqiptarët e pa shpresë....?!

Pranoni mirënjohjen time për kontributin e dhënë nga ana e Zyrës së Avokatit të Popullit në zgjidhjen e kërkesë-ankesave të mia për shkeljen e të drejtave të mia nga Komisariati i Policisë Nr.1 Tiranë, Ministria e Mbrojtjes, etj.

Me respekt  
Nga Skënder Hasmeta

Oficer pranë Komandës së Forcës së Bashkuar Durrës  
Tiranë, më 20.06.2008

#### 4. I nderuar Z.Avokat i Popullit

Të nderuar bashkëpunëtorë të tij, Z. R. Poda dhe Z. I.Çeço

Tek ju unë drejtova një ankesë për largim nga puna dhe përgjigjia juaj ishte rikthim në detyrë. Kryetari i bashkisë nuk e zbatoi këtë rekomandim. Unë e apelova në gjykatë dhe shkallën e parë e fitova. Bashkia e hodhi në shkallë të dytë.

E shkruaj këtë letër për t'ju falenderuar për kontributin që ju dhatë për problemin tim. Ju shpreh konsideratat për profesionalizmin tuaj, përkushtimin për problemet e popullit dhe orientimin për zgjidhjen e tyre. Ju falenderoj si staf.

Takova në bashki përfaqësuesin tuaj, djalë i ri me përkushtim për të dëgjuar e orientuar ankuesit.

Më lejoni t'ju uroj suksese në mbrojtjen e së drejtës dhe në zgjidhjen e konflikteve

Me respekt  
Vjollca Çekani

Gjirokastër, 30.06.2008

#### 5. Avokatit të Popullit

I nderuar z.Avokat

Ju falenderojmë me përkushtimin më njerëzor për ndërhyrjen tuaj aktive me seriozitetin e duhur, në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, ku dërguat komisionerin tuaj atje z.Skënder Haluci. Pasi unë kisha kërkuar “mbrojtjen me ligj të familjes time” nga Prokuroria e Shtetit. Pas reagimit tuaj ka reaguar me shkrim dhe Drejtuesi i Prokurorisë Krimeve të Rënda. Them me sinqeritet se Ju z.Avokat dhe Institucioni Juaj, jeni bërë pjesë në jetën e halleve të këtij populli. Meritoni një vlerësim të madh njerëzor dhe jeni të respektuar nga gjithë ata qytetarë që e njohin respektin. Faleminderit që u përpoqët në mbrojtje të fëmijëve të mi të rritur jetimë. Vlerësuat faktet e mia, i dhatë mundësi familjes time të mbrohet me Ligjin 9205, dt.15.03.2004. Na keni vlerësuar për njerëz dhe na keni ndihmuar realisht për zgjidhje ligjore, nuk jeni kursyer me veprat tuaja të shpejta e të sakta.

Ky është vlerësimi im për ju si “Avokat i Popullit” dhe komisionerëve ju kërkoj ndjesë se kam vonuar këtë letër duke pritur familjen të gjejë dorë të sigurt, vlerësojmë përgjigjen tuaj brenda 7 ditësh na e dërguat. Nuk kam mundësinë, se të isha i lirë, do prononcohesha në Mediat publike disa herë rresht për Figurën e Institucionit të Avokatit të Popullit. Meritoni respektin më të plotë, tek gjithë populli që kupton ndihmën tuaj pa potere, pa zvarritje, pa njëanshmëri institucionale.

Me të vërtetë ju kemi shqetësuar disa herë rresht, por kur kemi hall. Tek ju kemi gjetur realisht ndërhyrjen pa rezerva, përkrahjen e plotë dhe aktive.

Letra ju postohet me familjen time se nuk e postojnë postat e Burgjeve

Peqin, 15.07.2008

Me respekt

I dënuari G. L.

#### 6. I nderuar Zoti DOBJANI,

Mora njoftimin Tuaj, ku na vini në dijeni për mendimet dërguar disa komisioneve parlamentare me shkresën Nr.160, datë 07.07.2008, për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.9418, datë 20.05.2005, “Për Sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Sa më sipër, Ju falenderoj për mbështetjen Tuaj dhe institucionit Tuaj ndaj të drejtave ligjore të Shoqatës Kombëtare të Ushtarakëve në Rezervë të Shqipërisë (SHKURSH) për zgjidhjen e problemeve social-ekonomike të anëtarësisë të saj.

Gjithashtu, Ju shpreh komplimentat e mia për argumentet juridike e profesionale dhe për mosrënien dakord me projektligjin e Qeverisë, i cili, në vend të përmirësujë gjendjen social ekonomike dhe të drejtave ligjore të ushtarakëve, e përkeqëson atë, duke cënuar parimin e sigurisë juridike dhe të barazisë përpara ligjit. Ai projekt nuk merr parasysh vendimin Nr.9, datë 26.02.2007 të Gjykatës Kushtetuese.

Ndërkohë, dëshiroj t’u bëj me dije, se projekti i mësipërm nuk ka kaluar akoma në Qeveri. Kështu që, nëse e shikoni të arsyeshme, t’ua dërgoni mendimet edhe Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Financave dhe Këshillit të Ministrave.

Duke përfunduar, më lejoni Zoti Avokat i Popullit, t’u paraqes falenderimet e mia më të sinqerta për mbështetjen dhe të shpreh bindjen se kjo mbështetje nuk do të na mungojë edhe në të ardhmen.

Me respekt

Presidenti i Shoqatës së Ushtarakëve në Rezervë të Shqipërisë  
Kolonel Mehdi POGACI

Tiranë, më 17.07.2008

## 7. Avokatit të Popullit

Për ankesën time drejtuar Avokatit të Popullit ju njoftoj se para disa ditësh është zgjidhur pozitivisht nga ana e sigurimeve shoqërore.

Meqenëse problemi është zgjidhur, nuk po marr pjesë në takimin e caktuar. Edhe një herë ju Faleminderit!

Me respekt  
Fiqiri Hoxha

Tiranë, më 15.09.2008

## 8. I nderuar z. AVOKAT I POPULLIT,

Siç e dini dhe Ju, me Institucionin Tuaj, në vijimësi, gjatë gjithë veprimtarisë, kemi patur e kemi kontakte e komunikime të pandërprera, jo vetëm institucionale e zyrtare, por dhe të drejtëpërdrejta për gamën e gjerë të shqetësimeve e të problematikave që, me ligj, Ju keni të drejtën e ndikimeve e të ndërhyrjeve të nevojshme në funksion të zgjidhjes së tyre.

Për hir të së vërtetës, tek Ju, personalisht dhe tek Institucioni Juaj, Ne, kemi gjetur kurdoherë një partner të përgjegjshëm e serioz. Në çdo rast, trajtesat e Rekomandimet Tuaja, në mbështetje të Kushtetutës e të ligjeve, kanë shërbyer për sqarimin, ndriçimin e zgjidhjen e problemeve dhe për vënien në lëvizje e shtytjen e strukturave shtetërore të të gjitha niveleve në funksion të këtyre zgjidhjeve.

Për gjithçka që keni bërë e po bëni, në emër të strukturave tona, ju falenderojmë sinqerisht, duke uruar që kontaktet, komunikimet e bashkëpunimi për këto problematika të zgjerohet e thellohet në të ardhmen.

Sindikata e Punonjësve të Transportit të Shqipërisë (SPTSH)  
Kryetari

Tiranë, më 22.09.2008

## 9. Letër falenderimi

Unë i nënshkruari Azbi Telhaj falenderoj Institucionin e Avokatit të Popullit që mundësoi rikomisionimin e vajzës time të sëmurë Emanuela Telhaj për të vazhduar pensionin e Invaliditetit.

Azbi Telhaj

Dt. 21.11.2008

## Media elektronike për vitin 2008

Nr.	ORGANI	DATA	TITULLI	PASQYRIMI
1	Top Channel	03.01.2008	AP dhe mireqeverisja, sfidat e vitit 2008	Interviste ne "New Day", A. Lazebeu
2	TVSH, Vizion+	10.01.2007	AP per te miturit dhe grate e burgosura	Prononcim, S. Haluci
3	Mediasat	11.01.2007	AP per reformen ne drejtesi dhe elementet e saj	Prononcim, E. Dobjani
4	TVSH, Shijak TV	11.01.2007	AP per mbipopullimin dhe keqtrajtimit ne burgje dhe paraburgim	Prononcim, A. Lazebeu
5	Ora News	12.01.2007	AP gjate 2007 dhe detyrat per 2008	Interviste, E. Dobjani
6	News 24	14.01.2007	AP dhe zgjedhjet vendore ne Komunen e Goses	Emisioni "Me zemer te hapur", S. Nushi
7	TVSH, TVA	16.01.2008	AP per sistemin e burgjeve dhe paraburgimit	Prononcim, S. Haluci
8	Alsats	22.01.2008	AP reagon per spitalet psikiatrike dhe gjendjen ne paraburgim dhe burgje	Prononcim, A. Lazebeu
9	Alsats	23.01.2008	AP dhe problematika e tij	Interviste, E. Dobjani
10	Mediasat	01.02.2008	AP ne prag te Raportit Vjetor	Interviste, E. Dobjani
11	News 24	02.02.2008	AP dhe problematika e drejtesise	Interviste, E. Dobjani
12	Koha TV	04.02.2008	AP per reformen zgjedhore dhe ate ne drejtesi, nevoja per referendume	Emisioni "60 Minuta", E. Dobjani
13	Top Channel	08.02.2008	AP propozon referendum per reformen zgjedhore	Interviste, E. Dobjani
14	News 24	08.02.2008	AP nis hetimin per vdekjen e femijes nga Mamurrasi	Prononcim, A. Lazebeu
15	Top Channel	14.02.2008	AP dhe problemet me te burgosurit	Emisioni Fiks Fare, A.Lazebeu
16	Mediasat	15.02.2008	AP do te nise inspektimin ne burgun e Peqinit	Prononcim, A. Lazebeu
17	Ora News	20.02.2008	Raportet e AP-se per burgjet	Prononcim, S. Haluci
18	TVSH, Ora News	21.02.2008	Mbi idene e AP-se per referendumin	Prononcim, A. Lazebeu

19	Ora News	03.03.2008	Per problemet ne KESH	Prononcim, E. Karamuça
20	News 24	04.03.2008	AP dhe ideja e referendumit per çeshtjet madhore	Prononcim, E. Dobjani
21	UFO TV	05.03.2008	Problematika e dites dhe AP	Interviste, E. Dobjani
22	TVSH, News 24	08.03.2008	AP per ligjin e pergjimeve	Prononcim, E. Dobjani
23	TVSH, Top Channel, Ora News, NTV, UFO, TVA etj	10.03.2008	AP organizon tryeze per Mekanizmin Kombetar Kunder Tortures	Prononcim, E. Dobjani
24	NTV	11.03.2008	AP ne ndjekje te problemeve	Interviste, E. Dobjani
25	TVSH, Alsat	12.03.2008	AP dhe Raporti i Departamentit Amerikan te Shtetit	Interviste, E. Dobjani
26	TVSH;Top Channel; News 24; TVA; Ora News; Shijak TV; UFO etj.	13.03.2008	Gjendja ne burgje, libri nje mik i mire	Prononcim, E. Dobjani
27	TVSH, Alsat	17.03.2008	Banoret e Gerdecit te demshperblehen	Prononcim, E. Dobjani
28	TVSH	17.03.2008	Debat mbi tragjedine e Gerdecit	Emisioni 7x7. E. Dobjani
29	UFO TV	26.03.2008	Mbi objektet me burim rreziku te shtuar	Interviste, E. Dobjani
30	TVSH	08.04.2008	AP mbi aspekte te reformes ne drejtesi	Prononcim, E. Dobjani
31	TVSH, Top Channel, Ora News, NTV, News 24, TVA etj	08.04.2008	AP dhe Qendra "Femijet Sot" ne Tryeze te Rrumbullaket per botimin e konventave te ratifikuara	Njoftim
32	Top News	16.04.2008	AP mbeshitet Presidentin e Republikes per ndryshimet e mundshme ne Kushtetuten e vendit	Interviste, E. Dobjani
33	A1 Tv	30.04.2008	AP takon Sekretarin Parlamentar ne Ministrine e Drejtesise se RF te Gjermanise	Njoftim
34	A1 Tv	30.04.2008	AP ne ndjekje te shqetesime ne burgun e Burrelit	Prononcim
35	Koha TV	05.05.2008	Problematika e Avokatit te Popullit ne faqen e pare	Emision, A. Lazebeu

36	Ora News, Koha TV	05.05.2008	Inspektimi i AP-se ne Burgun e Burrelit	Prononcim, S. Haluci
37	Top Channel	06.05.2008	Ne burgun e Burrelit eshte ushtruar dhune	Prononcim, E. Karamuça
38	Alsat	27.05.2008	AP dhe gjendja e sigurise ne miniera	Emision, E. Dobjani
39	News 24	28.05.2008	AP dhe problematika ne burgje	Emision, S. Haluci; E. Karamuca
40	TVSH; Top Channel; News 24; Alsat; Vizion+; Ora News; Klan; Mediasat etj.	29.05.2008	AP komenton Raportin e Amnesty International 2008 per situaten ne burgje dhe dhoma paraburgimi	Konference Shtypi, E. Dobjani
41	Top Channel, TVA, Shijak TV	03.06.2008	AP ne tryeze te rumbullaket per komitetet e parandalimit te krimit	Njoftim
42	Klan	07.06.2008	Gerdeci, alegori e indiferences se strukturave vendore dhe qendrore	Prononcim, A. Lazebeu
43	TVSH, Vizion +	08.06.2008	AP: "Kemi informuar Ministrine e Mbrojtjes qe Gerdeci te mos perseritet"	Prononcim, A. Lazebeu
44	2ATV	09.06.2008	AP fillon turneun e Diteve te Hapura ne Kavaje	Prononcim, H. Hysa
45	BBC	17.06.2008	AP ne forum per te drejtat e femijeve ne Shqiperi	Emision, A. Faskaj
46	TVSH, Top Channel	20.06.2008	AP mbi Raportin e Komisionerit per te Drejtat e Njeriut, Tomas Hammarberg	Prononcim, E. Dobjani
47	TVSH, Top Channel, News 24	24.06.2008	Mediatori i Republikes se Frances dhe AP takohen me Presidentin, Kryetaren e Kuvendit dhe personalitete te tjera	Njoftim
48	News 24; Ora News	11.07.2008	AP ne Tropoje per Dite te Hapur	Njoftim
49	Top Channel; Ora News; TVSH; Vizion + etj.	14.07.2008	AP ne Tryeze te Rumbullaket per Mekanizmin kunder Tortures	Njoftim
50	TVSH, Klan; Top Channel; Vizion +	15.07.2008	AP dhe Ombudsmani Danez per Tryezen e Rumbullaket kunder Tortures	Konference Shtypi, E. Dobjani- Gammeltoft Hansen
51	TVSH, Top Channel; Klan; Alsat	23.07.2008	AP: "Prokuroria mban ne burg nje te pafajshem"	Konference Shtypi, S. Haluci, E.Karamuça



52	News 24	24.07.2008	AP rikonfirmon gabimin e prokurorise	Prononcim, S. Haluci
53	News 24	27.08.2008	Inspektoret e AP-se ne paraburgimin e Lezhes per vetevrasjen	Njoftim
54	Ora News	27.08.2008	AP inspekton dhomat e shoqerimit ne Peshkopi si dhe paraburgimin e Lezhes	Njoftim
55	News 24	05.09.2008	AP kerkon shpjegime nga KKRRT per gjoben ndaj TV private	Njoftim
56	Top Channel	09.09.2008	AP per respektimin e te dhenave personale	Prononcim, A. Lazebeu
57	News 24	11.09.2008	AP ne Prishtine takohet me zyrtaret vendas	Njoftim
58	News 24	12.09.2008	AP inspekton paraburgimin ne Kukës	Njoftim
59	Ora News	22.09.2008	AP dhe problematika e tij	Interviste, E. Dobjani
60	News 24	22.09.2008	AP paralajmëron KKRRT-ne per vendosjen e gjobes se paligjshme	Prononcim, E. Dobjani
61	News 24	24.09.2008	AP rekomandon mosvendosjen e gjobes, KKRRT ben te kunderten	Njoftim
62	TVSH, Klan	24.09.2008	AP kerkon pajisjen me pasaporte edhe te te kerkuarve nga policia	Prononcim.E.Dobjani
63	Top News	25.09.2008	AP kerkon respektimin e te drejtave te policeve	Njoftim
64	TVSH, Alsat	25.09.2008	Policeve tu krijohen kushtet per shlodhje	Prononcim, A. Lazebeu
65	A1 Tv	26.09.2008	AP, Prokuroria, Drejtoria e Burgjeve per te drejtat e te burgosurve	Interviste, E. Dobjani
66	Mediasat	27.09.2008	AP mbi te drejtat e policeve	Prononcim, A. Lazebeu
67	Calvin Tv	03.10.2008	AP dhe reforma ne drejtesi	Interviste, E. Dobjani
68	New 24	03.10.2008	AP ne revolten e te burgosurve ne Fushe Kruje	Prononcim, S. Haluci
69	Top News	04.10.2008	AP:"Te burgosurit kane te drejte"	Njoftim
70	Radio Tirana	06.10.2008	AP flet per problemet qe zgjidh	Interviste, E. Dobjani
71	TVSH, Top Channel, Klan, Vizion+, Koha, Alsat etj	11.10.2008	Problematika e te drejtave te njeriut ne dhomat e policise, teme diskutimi mes Avokatit te Popullit, Ministrise se Brendshme dhe Policise se Shtetit	Njoftim
72	TVSH, News 24	08.11.2008	AP konfirmon dhunen ndaj te rinjve ne Komisarjatin e Sarandes	Prononcim, S. Haluci

73	Vizion +	11.11.2008	AP per gjendjen ne dhomat e paraburgimit ne komisarjate dhedhunen e policise ne Sarande	Emisioni Zip, E. Dobjani
74	Top Channel, News 24, Klan, Vizion+, TVSH, Mediasat etj	11.11.2008	AP denoncon dhunen policore ndaj te ndaluarve ne Sarande	Konference Shtypi, E. Dobjani
75	Top Channel	11.11.2008	AP mbeshitet prokurorine per reagimin ndaj rekomandimit te AP-se	Interviste, E. Dobjani
76	Top News	12.11.2008	Prokuroria dhe Ministria e Brendshme reagojne pas deklarates se AP-se	Njoftim
77	TVSH, News 24	12.11.2008	AP mbi dhunen e policise	Emision, E. Karamuça
78	Alsat	14.11.2008	AP rreth problematikes se tij me organet e policise dhe prokurorise	Interviste, E. Dobjani
79	TVSH, Klan, Top Channel, Vizion+ etj	18.11.2008	AP, OSBE, KSHH dhe Drejtoria e Pergjithshme e Burgjeve perurojne ne Burgun e Vaqarrit vendosjen e kutive te posaçme per te burgosurit ne te gjithe burgjet e vendit	Njoftim
80	Top News	18.11.2008	AP rifiton statusin A te akreditimit ne Komitetin Nderkombetar te Institucioneve te Drejtave te Njeriut ICC	Njoftim
81	News 24	21.11.2008	AP denoncon keqtrajtimin e te riut ne Shkoder	Njoftim
82	TVSH, Top Channel, News 24 etj	23.11.2008	Policia e Shkodres padit Avokatin e Popullit per prishje te hetimit	Njoftim
83	News 24	23.11.2008	AP e cileson qesharake padine e policise se Shkodres	Interviste, E. Dobjani
84	Top Channel	24.11.2008	AP komenton padine e policise se Shkodres si te pabazuar dhe shantazh ndaj tij	Prononcim, E. Dobjani
85	Ora News	24.11.2008	Veprimet e policise se Shkodres kane gene te gabuara	Prononcim, S. Haluca
86	Vizion +	24.11.2008	Policia e Shkodres ka vepruar ne shkelje te ligjit	Prononcim, E. Dobjani
87	A1Tv, KohaTV	24.11.2008	AP do te kerkoje akoma me shume mbrojtjen e te drejtave te njeriut nga Policia	Prononcim, E. Dobjani

88	Top Channel, Klan, Vizion +, Ora News, News 24, etj	27.11.2008	OSBE mbeshtet Avokatin e Popullit ne konfliktin me Policine	Njoftim
89	Top Channel, Klan, Vizion +, Ora News, News 24, etj	27.11.2008	AP: "I kerkoj Ministrit te Brendshem dhe Drejtorit te Pergjithshem te Policise te shprehin qendrimin ndaj veprimit te policise se Shkodres"	Prononcim, E. Dobjani
90	TVSH, Top Channel, Klan, Vizion +, Ora News, News 24, etj	28.11.2008	Policia e Shtetit: "AP nxorri sekretin hetimor, por ne do ta vazhdojme bashkepunimin me te"	Njoftim
91	Top Channel, Klan, Vizion +, Ora News, News 24, etj	29.11.2008	Shoqatat qe mbrojne te drejtat e njeriut mbeshtesin AP-ne	Njoftim
92	Top Channel, Klan, Vizion +, Ora News, News 24, etj	30.11.2008	Deputeti A. Isaraj e konsideron sulmin ndaj AP-se si kundervenie andikushtetuese	Njoftim
93	TVSH, Top Channel, Klan, Vizion +, Ora News, News 24, etj	05.12.2008	AP, Prokuroria e Pergjithshme dhe Ministria e Drejtesie ne nje Tryeze te Rrumbullaket per problematikat e punes	Njoftim
94	Top Channel, Klan, Vizion +, Ora News, News 24, etj	05.12.2008	Kryeministri Berisha shpreh mbeshtetjen e tij per Institucioni e Avokatit te Popullit	Njoftim
95	Top Channel, Klan, Vizion +, Ora News, News 24, etj	13.12.2008	AP ne forumin per te drejtat e minoriteteve seksuale, te femijeve dhe grave	Njoftim
96	TVSH, Top Channel, Klan, Vizion +, Ora News, News 24, etj	14.12.2008	AP ne Tryezen Nderparlamentare per dhunen seksuale ndaj femijeve dhe adoleshenteve	Njoftim
97	TVSH, Shijak TV, Vizion+ etj	16.12.2008	AP dhe ZMK bashkeorganizojne Konferencen Kombetare per mbrojtjen e te drejtave te konsumatorit	Njoftim

98	TVSH	17.12.2008	AP dhe problematika e tij per mbrojtjen e te drejtave te konsumatorit	Emisioni "Jo vetem kafe", E. Dobjani
99	Top News	18.12.2008	Ish kreu i SHISH-it tregon per letren derguar Avokatit te Popullit	Njoftim
100	Mediasat	18.12.2008	AP: "Me te drejtat e konsumatorit eshte abuzuar"	Prononcim, E. Dobjani
101	News 24	19.12.2008	AP ne analizen vjetore te policise	Njoftim
102	TVSH, Top Channel	19.12.2008	AP lexon Kushtetuten para policeve	Njoftim
103	TVSH	22.12.2008	AP dhe temat e dites nen fokusin e tij	Emisioni 7x7. E. Dobjani
104	TVSH, Top Cannel, Klan, News 24, Vizion+, Ora News etj.	26.12.2008	Kryeministri Berisha shpreh mbeshitetjen e tij per Institucionin e Avokatit te Popullit ne analizen vjetore te Policise se Shtetit	Njoftim
105	TVSH, Ora News, Shijak TV, Vizioin +	29.12.2008	AP promovon librin "Triptik Mediatik"	Njoftim
106	News 24	30.12.2008	"Triptik Mediatik" eshte vete rrugetimi i AP-se per te krijuar modelin e tij	Prononcim, A. Lazebeu

## Gazetat – Shtypi i shkruar për vitin 2008

NR	DATA	GAZETA	TITULLI	RUBRIKA
1	11.01.2007	Gazeta Shqiptare	AP: Dhune ne paraburgim, qelite te mbipopulluara, mungojne kushtet higjenike	Artikull
2	12.01.2007	Shqip	Leter edhe AP-se: "Ta pesosh kur respekton ligjin"	Artikull
3	16.01.2008	Telegraf	Pse AP nuk nderhyn per vjedhjen e sms-ve nga kompanite celulare?	Artikull
4	17.01.2008	Shqip	Te dhenat personale, ankim edhe tek AP	Njoftim
5	21.01.2008	Shqip	Problemet me administraten? Diferencen ta bejne elitat	Interviste, A. Lazebeu
6	23.01.2008	Gazeta Shqiptare	Leter AP-se per femijen vrases	Njoftim
7	23.01.2008	SOT	AP per problematiken e KESH-it	Prononcim
8	27.01.2007	Koha Jone	AP i shkruan Drejtorit te ri te Burgjeve: "Burgjet ne kaos mbipopullimi"	Artikull
9	30.01.2008	Telegraf	AP kerkon zgjerimin e aksit rrugor Plepa-Mali I Robit	Artikull
10	09.02.2008	Tirana Observer	AP mbeshtet kufizimin e mandatit te gjyqtareve	Prononcim
11	09.02.2008	Gazeta Shqiptare	AP e ka kerkuar kufizimin e mandatit te gjyqtareve qysh me 2005	Prononcim
12	09.02.2008	Shqip	Dobjani pro kufizimit te mandatit qysh me 2005	Prononcim
13	09.02.2008	Gazeta Shqiptare	AP kerkon qe reforma te votohet ne popull	Prononcim
14	10.02.2008	Gazeta Shqiptare	Mazhoranca: AP nuk duhet te flase per çeshtjet zgjedhore	Prononcim
15	10.02.2008	Metropol	PD-PR kundërshtojne idene e AP-se per referendumin	Njoftim
16	10.02.2008	Metropol	PS:"Propozimi i AP-se - ide e njohur, por e parakohshme"	Prononcim
17	15.02.2008	Tirana Observer	Avokati i Popullit i germezuar ne alfabetin shqip	Interviste, E. Dobjani
18	16.02.2008	Koha Jone	AP: "ERE te mos rrise tarifat e energjise"	Prononcim
19	16.02.2008	Shqip	Dobjani:"6 argumente kunder rritjes se çmimit te energjise"	Prononcim
20	16.02.2008	Zeri i Popullit	AP kunder rritjes se çmimit te energjise: Jane rritur edhe ushqimet	Prononcim
21	16.02.2008	Albania	Dobjani: "Shqyrtoni rastet e abuzimeve nga policia"	Artikull
22	19.02.2008	Albania	Dobjani: "KESH nuk duhej te kerkonte rritje te çmimit te energjise"	Artikull

23	21.02.2008	Shqip	AP: "Referendum per 4 çeshtje madhore"	Artikull
24	21.02.2008	Gazeta Shqiptare	Dobjani i shkruan Presidentit: "Referendum per sistemin elektoral"	Prononcim
25	21.02.2008	SOT	AP kerkon nga Presidenti Topi referendum per 4 çeshtje	Artikull
26	21.02.2008	Tirana Observer	AP: "Ideja ime per referendum popullor"	Artikull
27	21.02.2008	Shekulli	Reforma zgjedhore, Dobjani: Te pyetet populli	Artikull
28	21.02.2008	Zeri i Popullit	AP, 4 propozime per referendum popullor	Prononcim
29	21.02.2008	Ballkan	AP ben 4 propozime per referendum	Prononcim
30	24.02.2008	Albania	AP: "Hetoni punonjese e Gjendjes Civile"	Artikull
31	28.02.2008	Albania	AP kerkese Presidentit: "Te denuarve ne Greqi mund t'u falet denimi"	Artikull
32	02.03.2008	Panorama	Vezhguesit e AP-se ne burgun 302	Artikull
33	02.03.2008	Albania	AP: "Ministri i Arsimit te ndryshoje kriteret per emerimin e mesuesve".	Artikull
34	03.03.2008	Panorama	Drafti per te dhenat personale shmang Avokatin e Popullit	Artikull
35	03.03.2008	Shqip	AP sugjeron mundesine e faljes per 100 te denuar ne Greqi	Artikull
36	05.03.2008	Albania	AP sugjeron referendum per sistemin zgjedhor	Prononcim
37	05.03.2008	Koha Jone	AP leter Presidentit per referendum lidhur me sistemin	Njoftim
38	05.03.2008	Telegraf	AP: Referendum per sistemin zgjedhor	Prononcim
39	05.03.2008	Republika	AP leter Presidentit per referendum lidhur me sistemin	Njoftim
40	05.03.2008	SOT	AP kerkon referendum per reformen zgjedhore	Prononcim
41	11.03.2008	Tirana Observer	Ministri i Drejtesise mbeshtet Avokatin e Popullit	Prononcim
42	11.03.2008	SOT	AP: Ndryshime ligjore per trajtimin e te denuarve	Prononcim
43	11.03.2008	Standard	Tryeze per parandalimin e dhunes dhe tortures ne Shqiperi	Njoftim
44	11.03.2008	Panorama	AP: Hetim pa perjashtim te gjithe rasteve te tortures	Artikull
45	11.03.2008	Koha Jone	AP: "Policia dhe burgjet - Kujdes me torturat"	Prononcim
46	13.03.2008	Republika	AP takon Kreun e OSBE-se, Robert Bosch	Njoftim

47	13.03.2008	Gazeta Shqiptare	Dobjani takon Kreun e OSBE-se: Ne fokusin tone - te drejtat e njeriut	Njoftim
48	13.03.2008	Shqip	Dobjani-Bosch diskutojne per reformen zgjedhore	Njoftim
49	18.03.2008	SOT	AP ne Gerdec: Do te kerkoj demshperblimin e banoreve	Prononcim
50	22.03.2008	Metropol	AP e permend Gerdecin si rast qe ktheu rrezikun e jetes se shqiptareve	Njoftim
51	22.03.2008	Koha Jone	AP kerkon rishikimin e projektligjit te shendetesise	Artikull
52	23.03.2008	Albania	AP: "Gjyqtareve te krimeve te renda t'u sigurohen jeta dhe familja"	Prononcim
53	25.03.2008	Shqip	AP: "Me raportoni zonat me rrezik te shtuar".	Njoftim
54	27.03.2008	Shqip	AP u ben kerkese 400 komunave dhe bashkive per zonat e rrezikshme	Prononcim
55	27.03.2008	Standard	Raporti i AP-se: Dyndje kerkesash per t'u bere ish i perndjekur	Njoftim
56	27.03.2008	Standard	Raporti i AP-se, lume kerkesash ndaj ministrive	Njoftim
57	29.03.2008	Albania	AP: "Problem legalizimet dhe pronesia"	Artikull
58	29.03.2008	Koha Jone	AP u kerkon komunave dhe bashkive listen e zonave me rrezik te shtuar	Artikull
59	31.03.2008	Panorama	AP: "Vendimi per fshirjen e pronave - antikushetues"	Artikull
60	31.03.2008	Panorama	AP kerkon heqjen e gjobes dhe regjistrimin pa gjyq te femijeve	Njoftim
61	31.03.2008	Panorama	AP kundërshton rritjen me 20 perqind te çmimit te energjise	Artikull
62	31.03.2008	Shekulli	AP kerkon prej Ministrise se Shendetesise shpjegime per pretendimet e Urdherit te Mjekeve	Njoftim
63	01.04.2008	Albania	AP, Ministrit te Brendshem: "Pse duhen paguar oret shtese te policise"	Artikull
64	01.04.2008	Standard	Dobjani: "Konventat Nderkombetare, te paperkthyer ne shqip??"	Njoftim
65	01.04.2008	Metropol	AP, verejtje per Ministrin e Brendshem dhe te Arsimit	Prononcim
66	01.04.2008	Koha Jone	AP merr vleresime nga Komisioni i Ligjeve ne Kuvend	Njoftim
67	03.04.2008	Republika	AP: "Pse nuk paguhen oret shtese te policeve"	Artikull
68	03.04.2008	Tirana Observer	Specialiste te AP-se per Gerdecin	Njoftim

69	05.04.2008	Shqip	AP nis hetimet per denimin e fundit me vdekje ne Shqiperi	Artikull
70	09.04.2008	Tirana Observer	Cilat jane historite dhe ankesat qe kane marre pergjigje nga AP gjate 2007	Njoftim
71	09.04.2008	Gazeta Shqiptare	Te drejtat e femijeve mbledhin ekspertet e AP-se	Njoftim
72	11.04.2008	Metropol	AP merr detyrat per vitin 2008	Njoftim
73	11.04.2008	55	AP paraqet Raportin ne Kuvend	Njoftim
74	17.04.2008	Ballkan	AP: "Shqetesimet e Presidentit per Kushtetuten jane te drejta"	Prononcim
75	17.04.2008	Zeri i Popullit	AP mbeshtet Presidentin per shqetesimet lidhur me Kushtetuten	Njoftim
76	24.04.2008	Ballkan	AP veren shkeljet ne 4 komisarjate te Tiranes	Artikull
77	24.04.2008	Koha Jone	AP zbardh shkeljet ne komisarjate dhe qeli	Artikull
78	24.04.2008	Shekulli	AP konstaton shkelje neper qelite e Kryeqytetit	Artikull
79	29.04.2008	Albania	Fizikanet berthamore ankohen te AP per Ministrin e Arsimit	Artikull
80	30.04.2008	Gazeta Shqiptare	Inspektoret e AP-se ne Burgun e Burrelit	Njoftim
81	30.04.2008	Gazeta Shqiptare	AP heton per transparencen e ndihmave te Gerdecit	Artikull
82	30.04.2008	Koha Jone	Ekspertet e AP-se intervistojne 25 te denuar	Njoftim
83	30.04.2008	Korrieri	AP: "Burreli - Burgu i kushteve ekstreme"	Artikull
84	01.05.2008	Shqip	Dobjani i kerkon Pollos shpjegime per punonjesit e Fizikes Berthamore	Njoftim
85	03.05.2008	Koha Jone	AP: "Te denuarit e Burrelit nen terror dhe dhune".	Prononcim
86	04.05.2008	Revista Klan	Shtohen ankesat per kushtet e burgjeve tek AP	Artikull
87	05.05.2008	Metropol	Raporti AP-se: "Grate, te miturit dhe meshkujt e rritur ne nje dhome"	Artikull
88	05.05.2008	Metropol	AP kerkon qe aplikimet per pasaportat te behen ne zyra te pershtatshme	Artikull
89	05.05.2008	Metropol	AP konstaton qe nje i mitur eshte pyetur pa pranine e avokatit, prinderve ose psikologut	Artikull
90	06.05.2008	SOT	AP per burgun e Burrelit: "Te burgosurit keqtrajtohen nga gardianet"	Artikull
91	07.05.2008	Panorama	AP: "Burgu ne Burrel duhet mbyllur".	Prononcim



92	07.05.2008	Gazeta Shqiptare	AP dhe pretendimet e banoreve te Gerdecit	Njoftim
93	15.05.2008	Albania	AP: "Lum ankesash per ndihmat e tragjedise se Gerdecit"	Artikull
94	19.05.2008	Korrieri	AP: "76 te semure psikike-"peng" ne spitalin e Burrelit"	Artikull
95	21.05.2008	Albania	AP kryen inspektime ne komisariatet e policise	Artikull
96	22.05.2008	Korrieri	Ligji per Informacionin Zyrtar, ankesat tek Avokati i Popullit	Njoftim
97	23.05.2008	Standard	Inspektoret e Avokatit te Popullit dhe Komitetit te Helsinkit, takim me Arjan Selimin ne Burg	Njoftim
98	27.05.2008	Republika	AP: "Regjistrohesh mesatarisht 200 ankesa ne muaj"	Interviste. E. Dobjani
99	27.05.2008	Republika	AP: "Policia e ndertimit mashtron Kryeministrin per çeshtjen e Klement Pirros"	Artikull
100	28.05.2008	Albania	AP: "Te paraburgosurit e Korçes flene ne bodrum dhe ne dysheme".	Artikull
101	29.05.2008	Ballkan	Ne paraburgimin e Korçes ushtrohet dhune	Njoftim
102	29.05.2008	Gazeta Shqiptare	AP: "Te paraburgosurit rrihen ne qeli".	Artikull
103	29.05.2008	Koha Jone	AP konstaton kater raste te tortures brenda qelive	Artikull
104	30.05.2008	Shqip	AP nis hetimin per pasaportizimet ne Himare	Artikull
105	30.05.2008	Albania	AP komenton Raportin e Amnesty International per burgjet	Konference Shtypi
106	04.06.2008	Tirana Observer	AP: "Tu jepen viza italjane tre te plagosurve te Gerdecit"	Artikull
107	06.06.2008	Telegraf	Ushtaraket e Shkodres i shkruajne AP-se	Njoftim
108	06.06.2008	Albania	AP kerkon ligj te ri per kompensimin e prones se luajtshme	Artikull
109	07.06.2008	Shqip	AP paralajmeron Ministrin e Mbrojtjes: "Ka edhe 25 Gerdece te tjere"	Artikull
110	08.06.2008	Integrimi	AP e cileson Gerdecin, alegori te indiferences se strukturave vendore dhe qendrore	Prononcim, A. Lazebeu
111	08.06.2008	Albania	AP: "Qeveria duhet te paguaje sigurimet e grave te ish-ushtarakeve"	Artikull

112	09.06.2008	Shqip	AP:"Nje pjese e demshperbilmëve mund te mbulohen nga llogarite e sekuestruara te "Alba Demil".	Artikull
113	11.06.2008	Albania	AP:"Ministria e Mbrojtjes te marre masa, rrezikohen 25 zona te banuara"	Artikull
114	11.06.2008	Shekulli	AP: "Paraburgimi i Korçes, jashte standardeve"	Prononcim, S. Haluci
115	13.06.2008	Tema	Grevistevete te Gerdecit t'u ofrohet zgjidhje alternative	Prononcim, F.Nuni
116	25.08.2008	Korrieri	Mediatori Francez takon kreret e shtetit shqiptar	Njoftim
117	25.08.2008	"55"	Mediatori francez:"Prania e Institucionit te Ombudsmanit- garanci per kredibilitetin e nje shteti"	Njoftim
118	25.08.2008	Tema	Ministri i Drejtesise takon Avokatin e Popullit dhe Mediatorin e Frances	Njoftim
119	25.08.2008	Panorama	Kryetarja e Kuvendit, Topalli pret Mediatorin e Frances	Njoftim
120	25.06.2008	Republika	Avokati i Popullit i Frances: "Mbeshtesim ndryshimet pozitive ne Shqiperi"	Njoftim
121	25.06.2008	RD	Mediatori i Frances- Presidenti Topi: "Shqiperia, rol te rendesishem ne stabilitetin e rajonit"	Prononcim
122	25.06.2008	Albania	Ministri i Drejtesise pret Mediatorin e Frances dhe AP-ne	Njoftim
123	26.06.2008	Standard	AP kerkon prej 7 vjetesh nxjerrjen e ligjit per rregullimin e simbolikes fetare	Artikull
124	29.06.2008	Albania	AP"Ne Kruje, te burgosurve u lihen brisqe ne qeli"	Artikull
125	02.07.2008	Tirana Observer	AP:"Lustracioni, jo per ndeshkim e poshterim, por per te mbrojtur te drejtat e njeriut"	Prononcim
126	16.07.2008	Albania	Emigrantet ankohen tek AP per tarifat e larta te sherbimeve	Artikull
127	18.07.2008	Panorama	AP:"Ministria e Drejtesise te pergatise projektligjin per investigatorin privat"	Artikull
128	18.07.2008	Albania	AP:"Shqiptaret duan detektive private per tradhetine bashkeshortore"	Artikull
129	19.07.2008	Albania	AP, 5 ankesa te reja per pensionet e ushtarakeve	Artikull
130	21.07.2008	Gazeta Shqiptare	AP:"Te ndalohet trafiku parlamentar"	Artikull
131	24.07.2008	Shekulli	AP:"Dezertori harrohet 150 dite ne burg"	Konference Shtypi
132	24.07.2008	Ballkan	AP:"Prokuroria, ne burg te pafajshem"	Artikull

133	24.07.2008	Koha Jone	AP i rekomandon Kryeprokurores marrjen ne hetim te prokuroreve	Artikull
134	24.07.2008	Standard	AP, hetim kater prokuroreve	Artikull
135	24.07.2008	Panorama	AP sulm Prokurorise, Gjykata kishte vendosur ne favor te organit te akuzes	Artikull
136	27.07.2008	Shqip	AP per raportet e tij me gjykatat, prokurorine, te dhenat personale dhe lustracionin	Interviste, A. Lazebeu
137	31.07.2008	Standard	AP inspekon qelite pas vetvrasjes ne Peqin	Artikull
138	31.07.2008	Shqip	Ish punonjesit e policise ankohen te AP per mungesen e ligjit "Per hetuesin privat".	Artikull
139	02.08.2008	Tirana Observer	Avokati per Popullin ne 36 shkronja	Interviste, A. Lazebeu
140	02.08.2008	Koha Jone	AP konstaton mbipopullimin e burgut te Peqinit	Prononcim
141	11.08.2008	Shqip	Ushtaraket e larguar ankohen te Dobjani	Njoftim
142	28.08.2008	Telegraf	AP mbeshtet ushtaraket	Njoftim
143	03.09.2008	Telegraf	AP kerkon te mos behen dallime mes ushtarakëve	Artikull
144	04.09.2008	Telegraf	AP per pensionet suplementare te ushtarakeve	Prononcim
145	04.09.2008	Tirana Observer	AP dhe 20 shkeljet e konstatuara ne Burgun e Peqinit	Njoftim
146	05.09.2008	Koha Jone	AP vlereson letren e 7 te denuarve ne Burgun e Shen Kollit	Njoftim
147	06.09.2008	Albania	G99 leter AP-se: "Na u shkel e drejta per tu shprehur"	Njoftim
148	08.09.2008	Metropol	AP deklaroi se ne Burgun e Peqinit familjaret blejne radhen per te takuar te afermit	Artikull
149	12.09.2008	Zeri (Kosove)	AP i Shqiperise dhe ai i Kosoves kerkojne lehtesimin e procedurave per te burgosurit respektive	Njoftim
150	16.09.2008	Albania	Ish zyrtare ankohen te AP: "Policia dhe Prokuroria po na diskreditojne"	Artikull
151	16.09.2008	Republika	Perballe nje drejtesie te korrumpuar, falenderoj ekspertet e AP-se	Artikull
152	18.09.2008	Gazeta Shqiptare	AP kerkon hetim per prokuroret qe mbajten ne burg dezertorin	Njoftim
153	18.09.2008	ATSH	AP priti raportuesit e Keshillit te Evropes	Njoftim

154	19.09.2008	Koha Jone	Deshmitari dhe i pandehuri i rastit "Remzi Hoxha" kerkojne nga AP qe te nderhyje per dhenien e statusit te deshmitarit te mbrojtur	Artikull
155	20.09.2008	Shekulli	AP u pergjigjet kater te burgosurve shqiptare ne Patra	Njoftim
156	21.09.2008	Albania	AP ve alarmin se ne spital jane te pambrojtur edhe vete mjeket nga infeksionet	Artikull
157	22.09.2008	Shekulli	Personat ne kerkim te pajisen me pasaporte	Artikull
158	24.09.2008	Gazeta Shqiptare	AP: "Gjoha ndaj News 24 - joligjore	Njoftim
159	25.09.2008	Shqip	AP:"Policeve tu garantohen te drejtat njelloj si administrates publike"	Artikull
160	25.09.2008	Gazeta Shqiptare	AP akuzon KKRRT per veprime te paligjshme	Prononcim
161	26.09.2008	ATSH	AP priti ish europarlamentaret	Njoftim
162	30.09.2008	Albania	AP inspekton Qendren e Viktimave te Trafikut ne Linze	Njoftim
163	30.09.2008	Albania	AP liron te denuarin qe mbahej ne burg jashte afateve ligjore	Njoftim
164	30.09.2008	Zeri i Popullit	Nje qytetar lirohet nga burgu me nderhyrjen e AP-se	Njoftim
165	30.09.2008	Standard	Mbahej jashte afateve ligjore ne burgun e Tepelenes, lirohet nga ekspertet e AP-se	Njoftim
166	30.09.2008	Panorama	Ne burg padrejtesisht, lirohet nga AP	Njoftim
167	30.09.2008	Gazeta Shqiptare	AP dha sinjalet i pari per lenien ne qeli jashte afateve te burgimit	Njoftim
168	30.09.2008	Koha Jone	AP zbulon te burgosur jashte afateve ligjore	Njoftim
169	30.09.2008	Agon	Pse njerezit duhet te vuajne denimin padrejtesisht??	Artikull
170	30.09.2008	Ndryshe	AP liron te burgosurin e Tepelenes	Njoftim
171	01.10.2008	Gazeta Shqiptare	AP kerkon rritje pagash per mjeket dhe infermieret e Infektivit	Njoftim
172	01.10.2008	Shekulli	AP kerkon qe pacientet te Infektivit i Ushtarakut, te trajtohen ne karantine	Njoftim
173	04.10.2008	Ballkan	AP:"Trajtim çnjerezor ne burgun e Fushe Krujes"	Prononcim
174	04.10.2008	Shqip	AP:"Te burgosurit kane te drejte"	Njoftim
175	04.10.2008	Gazeta Shqiptare	AP:"Pretendimet e te burgosurve ishin te drejta"	Njoftim

176	04.10.2008	SOT	AP:"Te denuarit trajtohen ne kushte çnjerezore"	Njoftim
177	05.10.2008	Tirana Observer	AP rekomandon kontrole te rrepta ne dogane per ushqimet	Artikull
178	05.10.2008	Koha Jone	AP rekomandon kontrole te rrepta per produktet e rrezikshme	Artikull
179	05.10.2008	Shqip	AP njofton ministrat e shendetesise dhe bujqesise per qumeshtin kunez	Artikull
180	06.10.2008	Shqip	AP ve ne dyshim sigurine e çokollatave kineze	Artikull
181	07.10.2008	Albania	AP:"Kontrolloni ushqimet e ardhura nga Kina, rrezik per shendetin"	Artikull
182	09.10.2008	Gazeta Shqiptare	AP, jo vetem per koperture	Artikull
183	12.10.2008	Tema	AP dhe Policia e Shtetit diskutojne per te drejtat e te paraburgosurve	Njoftim
184	12.10.2008	Standard	AP dhe Ministria e Brendshme ne aktivitet te perbashket per te drejtat e njeriut	Njoftim
185	12.10.2008	Shqip	AP, Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit diskutojne per kushtet ne paraburgim	Njoftim
186	12.10.2008	55	Bashkepunimi AP-Policia e Shtetit, garanci per shtetin ligjor	Njoftim
187	12.10.2008	Koha Jone	Tryeze bashkepunimi mes AP dhe Policise	Njoftim
188	12.10.2008	Panorama	AP dhe Ministria e Brendshme per permiresimin e kushteve ne paraburgim	Njoftim
189	12.10.2008	Republika	AP dhe Ministri i Brendshem pranojne dhunen ne paraburgim	Njoftim
190	12.10.2008	RD	AP:"Policia, progres ne respektimin e te drejtave te njeriut"	Njoftim
191	12.10.2008	Albania	AP diskuton me Policine e Shtetit	Njoftim
192	12.10.2008	Agon	Ministri i Brendshem pranon rastet e dhunes ne polici	Njoftim
193	17.10.2008	ATSH	Homologu malazez i AP-se viziton Tiranen	Njoftim
194	25.10.2008	Telegraf	Rekomandim i AP-se per qendrat e paraburgimit ne Kukes	Artikull
195	26.10.2008	Panorama	AP kerkon ndeshkimin e policeve qe ushtruan dhune ne policine e Vlores	Artikull
196	26.10.2008	Metropol	AP:"Situete alarmante ne Komisarjatin e Vlores"	Njoftim

197	26.10.2008	Albania	Skandal ne Vlore, i mituri lihet ne nje qeli me te rriturin	Artikull
198	26.10.2008	Gazeta Shqiptare	AP kritikon policine e Vlores per dhune ndaj te ndaluarve	Njoftim
199	29.10.2008	Panorama	AP kerkon masa per policet qe shoqeruan 6-vjeçarin ne Shijak	Prononcim, S. Nushi
200	30.10.2008	Koha Jone	AP rekomandon trajnimin e policise lidhur me te drejtat e te miturve	Artikull
201	02.11.2008	Koha Jone	AP rekomandon marrjen nen hetim te dy policeve qe ushtruan dhune ne burgun e Fushe Krujes	Artikull
202	09.11.2008	Panorama	AP: "Efektivat te mesojne ligjin e policise".	Njoftim
203	09.11.2008	Koha Jone	AP konfirmon dhune ne Komisarjatin e Sarandes	Njoftim
204	09.11.2008	Gazeta Shqiptare	AP rekomandon ndarjen e femijeve nga te rriturit ne mjediset e spitaleve psikiatrike	Artikull
205	10.11.2008	Gazeta Shqiptare	AP per gjendjen ne ambientet e dhomave te shoqerimit dhe sigurise ne kater komisarjatat e Tiranes	Artikull
206	12.11.2008	Tema	Pas reagimit te AP-se, Sherbimi i Kontrollit te Brendshem ka ndaluar oficerin e policise	Njoftim
207	12.11.2008	Tirana Observer	Reagon AP dhe Prokurorja e Pergjithshme, arrestohet polici	Njoftim
208	12.11.2008	Zeri i Popullit	Dobjani denoncon dhunen e policise ne Sarande, Ina Rama : "Po hetojme"	Njoftim
209	12.11.2008	SOT	AP denoncon policine e Sarandes, torturuan te arrestuarin	Njoftim
210	12.11.2008	SOT	Reagon Ina Rama pas Dobjanit, arrestohet oficeri i policise	Njoftim
211	12.11.2008	Shekulli	AP Dobjani, tone te ashpra kunder policise, prokurorise dhe gjykates, qe mbrojtin oficerin Ardit Hasanbega	Konference Shtypi
212	12.11.2008	Shekulli	Prokuroria: Hetim i shpejte per dhunen	Njoftim
213	12.11.2008	Shekulli	Ministria e Brendshme: Arrestuam oficerin ne Sarande	Njoftim
214	12.11.2008	Metropol	Keqtrajtohet 18-vjeçari, AP kerkon hetim per oficeret e policise	Njoftim
215	12.11.2008	Korrieri	Pranga oficerit te policise, pas reagimit te AP-se	Njoftim
216	12.11.2008	Koha Jone	AP kerkon hetimin e kryeinspektorit per masakrimin e te ndaluarit	Artikull

217	12.11.2008	Koha Jone	Prokurorja leshon urdherin per hetim te shpejte	Njoftim
218	12.11.2008	Koha Jone	Drejtori i Policise se Shtetit shkarkon efektivin qe ushtroi dhune	Njoftim
219	12.11.2008	Ballkan	AP kerkon reagimin e ashper te Prokurorise dhe Ministrise se Brendshme per dhune ne paraburgime	Artikull
220	12.11.2008	Albania	AP kerkon hetim te shpejte per dhune policore ndaj 18-vjeçarit ne Sarande	Njoftim
221	12.11.2008	Gazeta Shqiptare	Shteti zgjohet pas alarmit te Avokatit te Popullit	Artikull
222	12.11.2008	Shqip	AP denoncoi paradite dhunen, ne dreke takoi Prokuroren, ne darke u krye arrestimi i policit	Artikull
223	13.11.2008	Shqip	AP kritikon prokurorine dhe gjykatën, KLD kontroll gjyqtarës se Sarandes per masen ndaj 18-vjeçarit	Artikull
224	13.11.2008	ATSH	AP pret Ambasadorin e ri te Mbreterise se Danimarkes ne Tirane	Njoftim
225	14.11.2008	Gazeta Shqiptare	AP kerkon masa per dy policet e Shijakut sepse evituan psikologun kur ndaluan femijen 6-vjeçar	Artikull
226	14.11.2008	SOT	AP:Policia shkel ligjin, merr ne pyetje nje 6-vjeçar.	Artikull
227	15.11.2008	Metropol	AP; Qarkullimi rrugor vendos gjoba pa dijenine e drejtuesve te mjetit	Artikull
228	15.11.2008	Korrieri	AP kritikon inaktivitetin e strukturave te policise dhe prokurorise	Njoftim
229	15.11.2008	Shekulli	AP rrugoreve: Kujdes me gjobat e makinave	Njoftim
230	15.11.2008	Albania	AP:I riu i dhunuar nga policia,ne gjendje te rende	Artikull
231	15.11.2008	Gazeta Shqiptare	Babai i 6-vjeçarit: U ankova te AP, kerkoj drejtesi	Artikull
232	17.11.2008	Gazeta Shqiptare	AP: Ja si abuzon policia rrugore me ligjin	Artikull
233	18.11.2008	Shqip	AP rifiton statusin A te akreditimit ne Komitetin Nderkombetar te Institucioneve te drejtave te Njeriut ICC	Njoftim
234	18.11.2008	Gazeta Shqiptare	AP dhe problemet ne inspektimin e qendrave te azilkerkuesve	Njoftim
235	22.11.2008	Shekulli	AP ze "mat" dy oficere te policise teksa kane ushtruar dhune ndaj 20 vjeçarit	Artikull

236	22.11.2008	Gazeta Shqiptare	AP do te kerkoje masa ndaj dy policeve qe shoqeruan dhe keqtrajtuane te riun ne Shkoder	Artikull
237	22.11.1008	Shqip	Dhuna ne komisarjate "plas" edhe ne Shkoder	Njoftim
238	22.11.2008	Metropol	Buxhetoret e demtuar i jane drejtuar Avokatit te Popullit per pagesat e vonuara	Artikull
239	24.11.2008	Telegraf	AP:"Policia po kryen veprime antikushetuese, ne vitin '97 i arrestuari ishte 9 vjeç"	Artikull
240	24.11.2008	Standard	Policia e Shkodres, padi ne prokurori ndaj AP-se. AP denoncoi dhunen ndaj 20 vjeçarit ne Shkoder	Artikull
241	24.11.2008	Korrieri	AP: Padia e policise, qesharake	Prononcim
242	24.11.2008	Metropol	AP: Denoncimi per dhune, shkak per padine	Njoftim
243	24.11.2008	Koha Jone	Policia çon Dobjanin ne Prokurori. Dobjani: Padia eshte qesharake	Artikull
244	24.11.2008	Shqip	Reagon AP: "Padia eshte budallallek me brire"	Prononcim
245	24.11.2008	Gazeta Shqiptare	AP inspekton burgun 325 dhe ate ne Kosove te Lushnjes. Gardianet pergjojne grate	Artikull
246	26.11.2008	Shekulli	Amnesty International del ne mbrojtje te Dobjanit pas konfliktit me policine	Njoftim
247	26.11.2008	Gazeta Shqiptare	Amnesty International: "Roli i Avokatit te Popullit eshte jetik"	Njoftim
248	26.11.2008	Albania	Amnesty International ne krah te Avokatit te Popullit	Njoftim
249	26.11.2008	Shqip	Padia ndaj Avokatit te Popullit, reagon Amnesty International	Njoftim
250	27.11.2008	Tema	Amnesty International reagon pas disa raste keqtrajtimesh ne polici	Njoftim
251	27.11.2008	Zeri i Popullit	Padia ndaj Avokatit te Popullit - kulmi i arbitraritetit	Njoftim
252	27.11.2008	Albania	Reagon Ministria e Brendshme: Kemi bashkepunim te mire me Avokatin e Popullit	Njoftim
253	27.11.2008	Ballkan	PS: "Stop dhunimit te qytetareve nga policia"	Njoftim
254	27.11.2008	Standard	Ministria e Brendshme: "Mos perfitoni politikisht, me Avokatin e Popullit kemi bashkepunim te mire"	Njoftim
255	27.11.2008	Koha Jone	Dobjani fut ne sherr PS me policine	Artikull



256	28.11.2008	Panorama	Policia sulmon AP-ne: "Nxorri sekretin e gjakmarrjes ne vitin 1997"	Artikull
257	28.11.2008	Panorama	OSBE: "Padia ndaj AP-se, nje gabim i rende"	Njoftim
258	28.11.2008	SOT	Policia e Shtetit vazhdon sulmet ndaj AP-se	Artikull
259	28.11.2008	SOT	OSBE mbeshtet AP-ne	Njoftim
260	28.11.2008	RD	Dobjani nxorri sekretin hetimor	Njoftim
261	28.11.2008	Koha Jone	Akuza te reja ndaj Dobjanit per nxjerrje te emrave te deshmitareve	Njoftim
262	28.11.2008	Koha Jone	OSBE jep mbeshtetje per Institucionin e AP-se	Njoftim
263	28.11.2008	Shqip	Policia e Shtetit: "Ne komunikimin me mediat, Dobjani ka nxjerre sekretin"	Njoftim
364	28.11.2008	Shqip	Kryetari i OSBE-se viziton Avokatin e Popullit	Njoftim
265	29.11.2008	Panorama	Kreu i Burgjeve: "Ministria bllokoi gjyqet per ulje denimi, te propozuara nga AP"	Artikull
266	29.11.2008	Zeri i Popullit	Dhuna ndaj AP-se, vazhde e dhunes ndaj institucioneve	Artikull
267	29.11.2008	Zeri i Popullit	Shoqatat per mbrojtjen e te drejtave te njeriut kerkojne respektimin e rolit te AP-se	Njoftim
268	29.11.2008	Tirana Observer	Komiteti Shqiptar i Helsinkit reagon per denoncimin e AP-se	Njoftim
269	01.12.2008	Gazeta Shqiptare	Sulmi ndaj AP-se, sulm antikushtetues	Njoftim
270	01.11.2008	Shqip	Arben Isaraj: "Konflikti me AP-ne, Policia po shkel ligjin"	Artikull
271	06.12.2008	Shqip	Berisha i shpreh mbeshtetje Dobjanit	Njoftim
272	06.12.2008	Korrieri	Kryeministri mbron Dobjanin	Njoftim
273	06.12.2008	Panorama	Berisha pret Dobjanin: "Vazhdo punen, do kesh mbeshtetjen time".	Njoftim
274	06.12.2008	Gazeta Shqiptare	Kryeministri mbeshtet Avokatine Popullit per veprimtarine e tij	Njoftim
275	06.12.2008	Shekulli	Berisha Dobjanit: Ke mbeshtetjen e qeverise	Njoftim
276	06.12.2008	Tribuna Qytetare	Duke degjuar deklaraten e Avokatit te Popullit	Artikull
277	06.12.2008	Zeri i Popullit	Reagimi i OSBE-se, Berisha i detyruar takon Dobjanin	Artikull
278	06.12.2008	RD	Prokuroria e Pergjithshme dhe Drejtoria e Pergjithshme e Burgjeve diskutojne per te drejtat e te denuarve	Njoftim

279	06.12.2008	Koha Jone	Padia, Berisha mbeshitet Dobjanin	Njoftim
280	06.12.2008	Tirana Observer	Ermir Dobjani takon Kryeministrin pas sulmeve	Njoftim
281	06.12.2008	Koha Jone	AP: "Prokuroria i dergon te denuarit vetem ne burgje te sigurise se larte"	Prononcim, S. Haluci
282	07.12.2008	Metropol	AP: "Permiresimi i kushteve ne burgje, anulohen 6 tendera"	Artikull
283	17.12.2008	Albania	Problemet e konsumatorit shqiptar ne konference kombetare	Artikull
284	17.12.2008	Korrieri	Ne konferencen kombetare te AP-se premtohet rritje e standarteve te produkteve ushqimore	Njoftim
285	17.12.2008	Telegraf	AP mban Konferencen Kombetare per te drejtat e konsumatorit	Artikull
286	17.12.2008	RD	Te drejtat e pacientit ne Konferencen Kombetare te organizuar nga AP dhe Zyra per Mbrojtjen e Konsumatorit (ZMK)	Artikull
287	17.12.2008	SOT	Dobjani ne Konferencen Kombetare: "Konsumatori shqiptar, i pambrojtur".	Interviste, E. Dobjani
288	17.12.2008	SOT	AP kritikon ligjet per mbrojtjen e konsumatorit	Njoftim
289	17.12.2008	55	AP diskuton ne Konference Kombetare per plan masash per mbrojtjen nga semundjet qe lidhen me ushqimin	Artikull
290	18.12.2008	Gazeta Shqiptare	Ministrja e Shendetesise "jep llogari" para AP-se ne Konferencen Kombetare	Artikull
291	18.12.2008	Shqip	Ish-kreu i SHIK-ut Klosi: "Ja letra qe i kam derguar AP-se per rastin e Remzi Hoxhes"	Artikull
292	18.12.2008	Koha Jone	AP: "Per shkollen e larte, le te pranohen edhe publikatat e shkolles se mesme"	Prononcim
293	19.12.2008	Gazeta Shqiptare	AP denon dhunen ndaj mjekeve	Prononcim
294	20.12.2008	Panorama	Dobjani ne analizen vjetore te policise u kujton efektive te respektojne te drejtat e njeriut	Njoftim
295	27.12.2008	SOT	Berisha pajton Policine me Avokatin e Popullit	Njoftim
296	27.12.2008	RD	Berisha: "AP te mbikqyre respektimin e te drejtave"	Njoftim
297	27.12.2008	Koha Jone	AP sugjeron rritjen e pagave te infermiereve	Artikull
298	27.12.2008	Gazeta Shqiptare	AP: "Rritja e pagave te infermiereve duhet bere per shkak te vecorise se punes se tyre"	Artikull
299	30.12.2008	Korrieri	AP promovon librin "Triptik Mediatik"	Njoftim

## STATISTIKE PERMBLEDHESE E MBULIMIT MEDIATIK 2008

### MEDIA E SHKRUAR

a)


<b>Artikuj</b>	<b>Njoftime</b>	<b>Intervista</b>	<b>Prononcime</b>	<b>Konferenca shtypi</b>	<b>Gjithsej</b>
121	128	6	41	3	299

### MEDIA ELEKTRONIKE

b)


<b>Njoftime</b>	<b>Prononcime</b>	<b>Intervista</b>	<b>Emisione</b>	<b>Konferenca shtypi</b>	<b>Gjithsej</b>
34	38	18	12	4	106

**Ankesa me shkrim te trajtuara gjate vitit 2008**  
**Totali 3287**




- Numri i ankesave të regjistruara gjatë vitit 2008
- Numri i ankesave të mbartura nga viti 2007

**Mënyra e zgjidhjes së ankesave dhe kërkesave të përfunduara gjatë vitit 2008,  
pavarësisht nëse kanë qenë brenda ose jashtë juridiksionit  
Totali 2922**




**Mënyra e zgjidhjes së ankesave dhe kërkesave që kanë qenë brenda  
juridiksionit gjatë vitit 2008  
Totali 1630**




- Ankesa të padrejta
- Ankesa në favor
- Me rekomandim ose propozim te refuzuar
- Heqje dore

**Gjendja e ankesave të marra në shqyrtim gjatë vitit 2008**  
**Totali 3287**



- Ankesa të përfunduara gjatë vitit 2008
- Ankesa që vazhdojnë të jenë në shqyrtim në vitin 2009


**Ankesa dhe kërkesa të paraqitura verbalisht pranë  
Zyrës së Pritjes së Popullit gjate vitit 2008  
Totali 1033**




- Ankesa verbale të regjistruara në sekretari për shqyrtim, pasi u bënë me shkrim
- Ankesa dhe kërkesa verbale, të cilave iu është dhënë përgjigje menjëherë, në zbatim të nenit 17/a dhe 17/b të ligjit.



**Ankesa, kërkesa dhe njoftime të trajtuara nga zyra e AP gjatë vitit 2008**  
**Totali 3657**




**Krahasimi i ankesave të ardhura për vitet 2000 - 2008,  
(përfshirë edhe ato që ju është dhënë përgjigje menjëherë)  
Totali 29357**




**Ankesa te ardhura ne vite**

## Shperndarja e ankesave te regjistruara gjate vitit 2008 sipas institucioneve Totali 2862 raste



**MEDIA E SHKRUAR PER VITIN 2008**



### MEDIA ELEKTRONIKE PER VITIN 2008

